RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"Auditim financiar dhe i përputhshmërisë në Shërbimin Social Shtetëror"

TIRANË, KORRIK 2026

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 5
3. Opinioni i auditimit 6
II. HYRJA 8
1. Objekti dhe qëllimi i auditimit 9
2. Identifikimi i çështjes 9
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim 9
4. Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH 10
5. Kriteret e vlerësimit 10
6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. 11
7. Metodat e auditimit 11
8. Dokumentimi i auditimit 11
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 12
1. Informacion i përgjithshëm 12
2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit 12
2.1. Auditimi i llogarive vjetore 12
2.2. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe veprimtaria e njësisë së auditit të brendshëm 26
2.3. Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit 33
2.4. Vlerësimi i veprimtarisë në kuadër të pagesave të ndihmës ekonomike (NE) dhe personave me aftësi të kufizuara (PAK) 69
A. Ndihma ekonomike 69
B. Skemat e aftësisë së kufizuar 159
2.5. Vlerësimi i veprimtarisë me fokus shërbimet sociale dhe institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror 173
2.6. Prokurimet e fondeve publike 185
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 204

Lista e Shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
DRSHSSH	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
IPSH	Institucion i Përkujdesjes Shoqërore
NE	Ndihma Ekonomike
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuar
KMCAP	Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë
KSHVAK	Komisioni Shumëdisiplinor për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar
KSHA	Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave
BPS	Biopsikosociale
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
DKPNEPAK	Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK
AB	Auditi i Brendshëm
MFK	Menaxhimi financiar dhe kontrolli
REK	Regjistri Elektronik Kombëtar

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Shërbimi Social Shtetëror është institucion buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, me seli në Tiranë, i organizuar në nivel qendror dhe rajonal në çdo qark të vendit. Misioni i tij është zbatimi i politikave shtetërore në fushën e ndihmës ekonomike, pagesave për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe administrimi dhe kontrolli i përdorimit të fondeve publike të destinuara për këto skema.

Në ushtrim të funksioneve të tij, SHSSH programon dhe monitoron fondet e ndihmës ekonomike dhe të pagesave për personat me aftësi të kufizuara, kontrollon zbatimin e legjislacionit nga njësitë e qeverisjes vendore, monitoron standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe koordinon proceset e planifikimit dhe financimit të shërbimeve sociale.

Gjithashtu, në nivel rajonal, strukturat e SHSSH ushtrojnë funksione kontrolli mbi zbatimin e legjislacionit dhe përdorimin e fondeve të skemave të asistencës sociale, verifikojnë të dhënat e përfituesve në regjistrat elektronikë kombëtarë dhe marrin vendimmarrje administrative për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij

Auditimi i këtij institucioni paraqet rëndësi të veçantë për shkak të rolit që Shërbimi Social Shtetëror ka në administrimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të skemave të asistencës sociale, si dhe në përdorimin e fondeve publike të destinuara për mbështetjen e kategorive në nevojë. Rëndësia e auditimit lidhet me nevojën për të vlerësuar përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon trajtimin me ndihmë ekonomike, përfitimet për personat me aftësi të kufizuara dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe me funksionimin e mekanizmave të kontrollit administrativ dhe verifikimit të kritereve të përfitimit, me qëllim garantimin e përdorimit të rregullt dhe në përputhje me ligjin të fondeve publike.

c. Qëllimi i auditimit

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Shërbimit Social Shtetëror me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon administrimin dhe zbatimin e skemave të asistencës sociale, përdorimin e fondeve publike dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit administrativ, për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2025.

Për auditimin financiar, qëllimi ishte vlerësimi nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e SHSSH-së në 31.12.2025, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditimi i llogarive vjetore dhe vlerësimi i organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit, saktësisë së paraqitjes së aktiveve dhe pasiveve, si dhe inventarizimit të pronës shtetërore;
- Vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe organizimi dhe veprimtaria e njësisë së auditimit të brendshëm;
- Planifikimi, programimi dhe monitorimi i buxhetit, përfshirë programimin e fondeve për skemat e ndihmës ekonomike (NE), përfitimeve për personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- Zbatimi i legjislacionit në administrimin dhe kontrollin e pagesave të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve për personat me aftësi të kufizuara;
- Vlerësimi i veprimtarisë me fokus shërbimet sociale dhe institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror;

• Zbatimi i legjislacionit në fushën e prokurimeve publike dhe realizimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Metodologjia e përdorur për kryerjen e auditimit është bazuar në një qasje të kombinuar cilësore dhe sasiore, mbi bazë risku, duke synuar sigurimin e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme audituese për mbështetjen e konkluzioneve të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme të auditimit: shqyrtimi i dokumentacionit dhe evidencave financiare e administrative, verifikimi i transaksioneve dhe regjistrimeve në sistemet elektronike, intervista me strukturat përgjegjëse në nivel qendror dhe rajonal, analiza e të dhënave, si dhe testimi i kontrolleve kyçe. Për realizimin e objektivave të auditimit janë aplikuar gjithashtu procedura të tilla si: shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës, procedura analitike dhe teste substanciale mbi kampione të përzgjedhura, në funksion të sigurimit të një niveli të arsyeshëm sigurie mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Grupi i auditimit ka konstatuar 56 gjetje dhe ka dhënë 68 rekomandime, nga të cilat 63 masa organizative dhe 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike. Nga auditimi u konstatuan efekte negative në administrimin e fondeve publike në vlerën totale 13,467,940 lekë, konkretisht 8,108,258 lekë si pasojë e pagesave të kryera në zbatim të vendimeve gjyqësore për çështje të marrëdhënieve të punës dhe 5,359,682 lekë si pasojë e administrimit joefektiv të skemës së ndihmës ekonomike, të lidhura me përfitime jo në përputhje me kuadrin ligjor.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me efektivitetin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sa i përket mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit. Sa i përket planifikimit dhe realizimit të buxhetit, u konstatua mungesë koherence ndërmjet PBA-së dhe realizimit faktik; metodologjia për planifikimin e fondeve të NE & PAK është e paazhornuara, duke ndikuar në saktësinë e parashikimeve; mangësi në monitorimin dhe raportimin e performancës buxhetore. Në fushën e ndihmës ekonomike, u konstatuan parregullsi lidhur me aktivitetin kontrollues për zbatimin e legjislacionit, ku procedurat e aplikuara nuk garantonin zbatimin e çdo kërkese ligjore, si tërheqja e pagesave nga personat e autorizuar me ligj dhe brenda afateve kohore, rastet e individëve që jetojnë jashtë vendit dhe përfitojnë në mënyrë të padrejtë, aplikimi i komisioneve/ tarifave postare te përfituesit e ndihmës ekonomike, mungesa e indeksimit të masës së ndihmës ekonomike, etj. Në fushën e pagesave të aftësisë së kufizuar, u konstatuan problematika në veprimtarinë e komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në skemën biopsikosociale, paratetraplegji dhe verbëri, kryesisht sa i përket afateve të trajtimit të rasteve dhe organizimit të punës. Në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror u konstatua mungesa e miratimit të metodologjisë për monitorimin e ofruesve të shërbimeve shoqërore, moskryerja e monitorimeve te të gjithë IPSH-të e financuara plotësisht ose pjesërisht nga buxheti i qeverisjes qendrore, etj.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, grupi i auditimit ka rekomanduar ndjekjen e hapave të nevojshëm për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sa i përket mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit.

Në fushën e ndihmës ekonomike, grupi i auditimit ka rekomanduar përmirësimin e kontrolleve automatike nëpërmjet sistemit, për të ulur riskun e gabimeve, përforcimin e hallkave të kontrollit në drejtori rajonale, standardizimin e disa tipologjie kontrollesh nga SHSSH-ja me qëllim unifikimin e procedurave të ndjekura gjatë kontrolleve të kryera, si dhe përmirësimin e aktiviteteve të kontrollit të ushtruara.

Në fushën e pagesave të aftësisë së kufizuar, grupi i auditimit ka rekomanduar plotësimin e bazës ligjore me qëllim zbatimin e plotë dhe të rregullt të kërkesave ligjore, përmirësimin e operacioneve të punës duke garantuar ofrimin e shërbimit në kohë të arsyeshme te individët, forcimin e mekanizmave monitorues dhe kontrollues ndaj veprimtarisë së komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, grupi i auditimit ka rekomanduar miratimin e metodologjisë për të garantuar uniformitetin dhe plotësinë e monitorimeve, kryerjen e monitorimeve në IPSH-të e financuara plotësisht ose pjesërisht nga buxheti i shtetit, marrjen e masave të nevojshme për licencimin e ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në varësi ose bashkëvarësi të SHSSH-së.

3. Opinioni i auditimit

Opinioni mbi auditimin financiar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shërbimit Social Shtetëror për vitin ushtrimor 2025, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e "*Bazës për opinion*" pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të njësisë më 31 dhjetor 2025, dhe në gjykimin profesional të audituesit të pavarur justifikojnë dhënien e një **opinioni të pamodifikuar me theksim çështje**[1].

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime jomateriale dhe jo të përhapura, ato prekin disa prej llogarive financiare dhe sipas gjykimit tonë nuk kanë efekt në rezultatin financiar të subjektit. Materialiteti i llogaritur në nivelin e 2% të totalit të aktiveve paraqitet në shumën 5,685,101 lekë. Shërbimi Social Shtetëror ka vepruar në përputhshmëri, me të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, me përjashtim të:

[1] "*Manuali i Auditimit Financiar*", i miratuar me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 246, datë 29.12.2022, pika 7.3.5 "Opinionet mbi auditimin financiar".

- Nuk janë hartuar Shënimet Shpjeguese sipas formatit nr. 5, të përcaktuar në Aneksin nr. 2 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, duke paraqitur vetëm një relacion shpjegues, i cili nuk përmbush kërkesat formale dhe përmbajtësore për plotësinë dhe transparencën e pasqyrave financiare;
- Janë evidentuar pasaktësi në klasifikimin e aktiveve, ku disa zëra janë trajtuar si "Inventar i imët" në vend të aktiveve afatgjata materiale (inventar ekonomik), duke sjellë mbivlerësim të shpenzimeve dhe nënvlerësim të aktiveve;
- Nuk është kryer çregjistrimi korrekt i aktiveve afatgjata të dala nga përdorimi, pasi është reflektuar vetëm kosto historike dhe jo amortizimi i akumuluar, si dhe amortizimi nuk është llogaritur sipas periudhës reale të përdorimit;
- Në rastin e këmbimit të mjeteve të transportit, aktivi i marrë nuk është regjistruar me vlerën kontabël të aktivit të dhënë, duke sjellë nënvlerësim të aktiveve dhe pasaktësi në paraqitjen e amortizimit dhe rezultatit financiar;
- Mungesa e evidencës analitike të detajuar për aktivet dhe amortizimin, e cila ka cenuar gjurmueshmërinë dhe besueshmërinë e informacionit kontabël.

Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë së aktivitetit të Shërbimit Social Shtetëror. Ky auditim është realizuar në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Rregulloren për Procedurat e Auditimit, Manualin për Auditimin e Përputhshmërisë, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik – ISSAI 4000.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencën audituese dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, është konstatuar se, në aktivitetin e SHSSH-së janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin". Këto devijime, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë me karakter material, por jo të përhapura dhe si të tilla justifikojnë dhënien e një **opinioni të kualifikuar**[2].

Baza për Opinionin

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona si audites janë të përshkruara në detaje në paragrafin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e përputhshmërisë".

Ne jemi të pavarur nga Shërbimi Social Shtetëror, sipas përcaktimeve të INTOSAI-P - 10 – Deklarata e Meksikës për Pavarësinë e SAI-t dhe ISSAI 130 – Kodi i Etikës, si dhe kemi respektuar të gjitha kërkesat etike për auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Kodin e Etikës së KLSH.

Ne besojmë se evidenca e auditimit e siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën e opinionit të kualifikuar, duke marrë në konsideratë natyrën dhe materialitetin e devijimeve të konstatuara, të cilat lidhen, ndër të tjera, me mangësi në kuadrin rregullator, dobësi në sistemet e kontrollit të brendshëm, mosrespektim të kërkesave ligjore dhe procedurale në administrimin e skemave të asistencës sociale dhe kujdesit shoqëror, si dhe raste me efekt financiar dhe ndikim në ekonomicitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:
- Mangësi në plotësimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator të brendshëm dhe të akteve nënligjore në fushën e asistencës sociale dhe kujdesit shoqëror, përfshirë mungesën e procedurave të shkruara për procese të rëndësishme funksionale dhe administrative që lidhen me organizimin dhe funksionimin e institucionit;

[2] "*Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë*", i miratuar me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 245, datë 29.12.2022, fq. 104.

- Mangësi në ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, të lidhura me pamjaftueshmërinë e strukturës organizative për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushëveprimin e institucionit, mungesën e gjurmëve të auditimit për procese kyçe në fushën e asistencës sociale dhe kujdesit shoqëror, si dhe mungesën e një sistemi efektiv monitorimi të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Shpenzime në vlerën 8,108,258 lekë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës, si dhe ekzistenca e proceseve të tjera gjyqësore ende në shqyrtim, që përbëjnë risk për krijimin e detyrimeve të reja financiare për institucionin;
- Mosindeksim i masës së ndihmës ekonomike që prej vitit 2022, në kundërshtim me kërkesat e akteve nënligjore në fuqi, duke ndikuar në ruajtjen e vlerës reale të përfitimit për familjet në nevojë dhe në arritjen e objektivave të skemës së asistencës sociale.
- Mangësi në ushtrimin e funksionit të kontrollit mbi zbatimin e legjislacionit të asistencës sociale në skemën e ndihmës ekonomike, përfshirë mosverifikimin e plotë të tërheqjes së pagesave nga personat e autorizuar dhe brenda afateve ligjore, mosadministrimin e plotë të dokumentacionit verifikues për hyrje-daljet jashtë vendit, si dhe mbulim të pamjaftueshëm me verifikime social-ekonomike në banesë dhe mosrealizim të plotë të planeve të kontrollit.
- Mangësi në procesin e verifikimit të aplikimeve për ndihmë ekonomike, ku sinjalizimet automatike të sistemit për deklarime të rreme nuk janë marrë në konsideratë në kohën e duhur, duke sjellë përfitime të padrejta nga fondet publike në vlerën 1,663,742 lekë;
- Mangësi në administrimin e skemës së ndihmës ekonomike që kanë sjellë përfitime financiare në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, si pasojë e pranimit të aplikimeve pa respektuar afatin ligjor 6-mujor të penalizimit për rastet e deklarimit të rremë, ose fshehjes së informacionit, me efekt financiar në vlerën 3,695,940 lekë, si dhe mungesës së gjurmës së auditimit për dokumentimin e rasteve përjashtimore;
- Mangësi në funksionimin e strukturave të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, përfshirë mosrespektimin e afateve procedurale për trajtimin e ankesave dhe rasteve me divergjencë, mosaplikimin e aktiviteteve të kontrollit mbi veprimtarinë e KMCAP-eve të nivelit të parë dhe epror dhe Komisioneve të Shqyrtimit të Ankesave, mangësi në kuadrin nënligjor lidhur me paketën higjieno-sanitare në skemën biopsikosociale, si dhe mungesën e mekanizmave referues për personat e paaftë për punë që nuk përfitojnë pension invaliditeti për shkak të kriterit të periudhës së sigurimit.
- Mangësi në ushtrimin e funksionit të monitorimit në fushën e kujdesit shoqëror, përfshirë mungesën e një metodologjie të miratuar për monitorimin e ofruesve të shërbimeve sociale, kufizimin e monitorimeve vetëm në institucionet në varësi dhe bashkëvarësi të institucionit dhe jo në të gjithë ofruesit që financohen nga buxheti i qeverisjes qendrore, si dhe devijimin nga funksioni ligjor i Qendrave të Zhvillimit për personat me aftësi të kufizuar, ku një pjesë dominuese e rezidentëve rezulton mbi moshën përfituese të përcaktuar ligjërisht.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 17/1 prot., datë 13.01.2026, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt "*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*" për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2025, në subjektin Shërbimi Social Shtetëror, u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë, nga data 14.01.2026 deri më datë 14.04.2026, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. D. P;
2. K. N;
3. A. M;

4. A. M;
5. A. R.

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit

Objekti i auditimit lidhet me vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë administrative, ekonomike dhe financiare të Shërbimit Social Shtetëror me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, në drejtim të administrimit dhe përdorimit të fondeve publike për skemat e asistencës sociale, funksionimit të strukturave qendrore dhe rajonale, si dhe zbatimit të procedurave përkatëse të kontrollit administrativ, për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2025. Qëllimi i auditimit ishte vlerësimi i nivelit të zbatimit të legjislacionit në fuqi në ushtrimin e funksioneve institucionale, evidentimi i parregullsive të mundshme dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë me kërkesat ligjore dhe forcimin e mekanizmave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në përfundim të auditimit është hartuar raporti përkatës mbi bazën e vlerësimit të evidencës së mbledhur dhe gjetjeve të konstatuara gjatë procesit auditues.

2. Identifikimi i çështjes

Auditimi i përputhshmërisë u krye në Shërbimin Social Shtetëror, me fokus vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë institucionale me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon administrimin dhe monitorimin e skemave të asistencës sociale, përdorimin e fondeve publike për ndihmën ekonomike (NE), përfitimet për personat me aftësi të kufizuara (PAK), si dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror (SHKSH). Vlerësimi është bazuar në analizën e veprimtarisë së strukturave përgjegjëse për planifikimin dhe administrimin e fondeve buxhetore, zbatimin e procedurave të kontrollit administrativ dhe verifikimit të përfituesve, funksionimin e sistemeve elektronike të regjistrave kombëtarë të asistencës sociale, si dhe monitorimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve sociale në nivel kombëtar dhe vendor. Si kritere vlerësimi janë përdorur dispozitat e legjislacionit në fuqi në fushën e asistencës sociale dhe menaxhimit financiar publik, përfshirë ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale" dhe aktet nënligjore përkatëse në zbatim të tij, ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore përkatëse në zbatim të tij, legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, legjislacionin për prokurimin publik, Statutin e Shërbimit Social Shtetëror të miratuar me VKM nr. 135, datë 07.03.2018, etj.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim

Strukturat drejtuese të Shërbimit Social Shtetëror janë përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë institucionale në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon administrimin e skemave të asistencës sociale, përdorimin e fondeve publike dhe monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel qendror dhe rajonal. Në këtë kuadër, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për planifikimin dhe administrimin e fondeve të destinuara për skemat e ndihmës ekonomike dhe përfitimet për personat me aftësi të kufizuara, funksionimin e sistemeve të kontrollit administrativ dhe verifikimit të përfituesve, administrimin e regjistrave elektronikë kombëtarë të asistencës sociale, si dhe për monitorimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve sociale dhe institucioneve rezidenciale të përkujdesit shoqëror. Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për krijimin dhe funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sigurimin e respektimit të procedurave të prokurimit publik, si dhe për garantimin e saktësisë dhe besueshmërisë së informacionit financiar dhe administrativ të prodhuar nga institucioni, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

4. Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin një konkluzion mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit të audituar me kriteret e përcaktuara ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushat e audituara, mbi bazën e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme të siguruar gjatë procesit të auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI). Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe të kryejë auditimin në mënyrë të tillë që të sigurojë një nivel të arsyeshëm sigurie nëse veprimtaria e subjektit është zhvilluar në përputhje me kriteret e përcaktuara. Siguria e arsyeshme përfaqëson një nivel të lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet do të identifikojë çdo rast mospërputhjeje që mund të ekzistojë. Në kryerjen e auditimit, audituesit kanë ushtruar gjykimin profesional dhe skepticizmin profesional, si dhe kanë aplikuar procedura auditimi të përzgjedhura në funksion të vlerësimit të riskut dhe rëndësisë materiale të çështjeve të audituara. Auditimi ka përfshirë vlerësimin e evidencës së mbledhur nëpërmjet procedurave të auditimit, me qëllim sigurimin e një baze të arsyeshme për shprehjen e konkluzionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe për formulimin e rekomandimeve për përmirësimin e praktikave institucionale.

5. Kriteret e vlerësimit

Lloji i dokumentit:	**Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore**
Ligje:	- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; - Ligji nr. 57, datë 18.07.2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*"; - Ligji nr. 121/2016 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*"; - Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", i ndryshuar; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; - Ligji nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar; etj.
VKM:	- VKM nr. 135, datë 07.03.2018 "*Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror*"; - VKM nr. 152, datë 13.03.2024 "*Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024 – 2030 dhe të planit të veprimit të saj*"; - VKM nr. 150, datë 20.03.2019 "*Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror*"; - VKM nr. 597, datë 04.09.2019 "*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike*", i ndryshuar; - VKM nr. 136, datë 07.03.2018 "*Për funksionimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror*"; - VKM nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*";

Akte të tjera nënligjore	- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar; etj. - Akte nënligjore në fushën e shërbimit social (SHS), ndihmës ekonomike (NE) dhe personave me aftësi të kufizuar (PAK); - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme*"; - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*"; - Udhëzime dhe Rekomandime të APP-së për mirëzbatimin e legjislacionit të prokurimit publik; - Udhëzimet standarde të Ministrisë përgjegjëse për financat, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, si dhe për menaxhimin financiar dhe kontrollin; etj.

6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Standardet e auditimit:	- INTOSAI-P 1-9, 10-99; - ISSAI 100-129; - ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899; - ISSAI 200-299; ISSAI 2000-2899; - GUID 2900-2999; GUID 4900-4999.

7. Metodat e auditimit

Metodat e auditimit të përdorura për arritjen e objektivave të auditimit janë bazuar në kombinimin e testeve të ndryshme të auditimit, duke përfshirë testet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, testet substanciale mbi transaksionet dhe procedurat analitike mbi të dhënat financiare dhe administrative të institucionit. Në funksion të sigurimit të evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme audituese janë përdorur metoda të tilla si: shqyrtimi i dokumentacionit financiar dhe administrativ, verifikimi i transaksioneve dhe regjistrimeve në sistemet elektronike, testimi i kontrolleve kyçe të brendshme, procedurat analitike krahasimore, pyetësorë, si dhe intervista me strukturat përgjegjëse. Këto metoda janë aplikuar në mënyrë të kombinuar, në varësi të natyrës së çështjeve të adituara, me qëllim krijimin e një baze të arsyeshme për vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së institucionit me kriteret e përcaktuara ligjore dhe nënligjore.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit, është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022, në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 7, datë 17.01.2024.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Shërbimi Social Shtetëror është institucion buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, i organizuar në nivel qendror dhe rajonal, me mision zbatimin e politikave shtetërore në fushën e asistencës sociale dhe monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar dhe vendor. Veprimtaria e tij përfshin administrimin dhe monitorimin e skemës së ndihmës ekonomike, përfitimeve për personat me aftësi të kufizuara, funksionimin e regjistrave elektronikë kombëtarë të asistencës sociale, si dhe monitorimin e standardeve të shërbimeve sociale dhe institucioneve rezidenciale të përkujdesit shoqëror. Rëndësia e këtij auditimi lidhej me rolin që Shërbimi Social Shtetëror kishte në administrimin dhe monitorimin e përdorimit të fondeve publike të destinuara për kategoritë në nevojë, si dhe me përgjegjësinë institucionale për zbatimin e legjislacionit në fushën e asistencës sociale dhe mbikëqyrjen e standardeve të shërbimeve sociale. Në këtë kuadër, auditimi synoi të vlerësonte nivelin e përputhshmërisë së veprimtarisë institucionale me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të kontribuonte në forcimin e mekanizmave të menaxhimit financiar dhe kontrollit në funksion të mirëpërdorimit të fondeve publike.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditimi i llogarive vjetore

Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Në kuadër të auditimit të llogarive vjetore për vitin 2025, u vlerësua organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), nga ku rezultoi se, si pjesë e njësive të qeverisjes së përgjithshme, SHSSH organizon dhe raporton kontabilitetin në përputhje me:
Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*"; Ligjin nr. 10296/2010, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar; Ligjin nr. 9936/2008, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar; si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.
Referuar Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 dhe Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e parimit të konstatimit për qëllime raportimi financiar, ndërkohë që flukset monetare dhe ekzekutimi i buxhetit evidentohen mbi bazë cash.
Nga auditimi konstatohet se SHSSH ka organizuar dhe mban kontabilitetin në përputhje me këtë parim të dyfishtë (accrual për raportim financiar dhe cash për ekzekutimin buxhetor), siç përcaktohet në udhëzimet e lartpërmendura.
Regjistrimi i të dhënave dhe përpunimi i veprimeve ekonomike-financiare në SHSSH kryhet nëpërmjet programit Excel dhe jo nëpërmjet një programi kontabël, çka nuk garanton përmbushjen e plotë të kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, në veçanti në drejtim të kontrollit të brendshëm, gjurmueshmërisë së transaksioneve dhe integritetit të të dhënave financiare.
Nga verifikimi i pasqyrave financiare të SHSSH rezultoi se ato janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 8/2018, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5/2022, duke përfshirë pasqyrat kryesore financiare dhe shënimet shpjeguese përkatëse.
Regjistrimet kontabël janë kryer në mënyrë kronologjike dhe në përputhje me klasat e llogarive sipas planit kontabël për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ndërsa elementët monetarë janë paraqitur në monedhën funksionale "*lekë*". Periudha raportuese shtrihet nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit ushtrimor.
Pasqyrat financiare të paraqitura nga SHSSH paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 1 "Pasqyrat financiare 2025 të paraqitura nga SHSSH

Formati	Emërtimi i pasqyrës	Paraqitur
Nr. 1	Pasqyra e pozicionit financiar;	✓
Nr. 2	Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);	✓
Nr. 3	Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow), sipas metodës direkte;	✓
Nr. 4	Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;	✓
Nr. 5	Shënimet shpjeguese;	⊗
Pasqyrat statistikore:		
Nr. 6	Investimet dhe burimet e financimit;	✓
Nr. 7/a	Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike);	✓
Nr. 7/b	Format Nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto);	✓
Nr. 8	Format Nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave .	✓

Burimi: SHSSH, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela më sipër konstatohet se, nga ana SHSSH, nuk janë hartuar Shënimet Shpjeguese, si formatit të përcaktuar në Aneksin nr. 2, Formati nr. 5, të Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar me Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, duke vepruar në kundërshtim me bazën ligjore të sipërcituar. Megjithatë, konstatohet se SHSSH ka hartuar "*Relacion mbi përgatitjen dhe mbylljen e llogarisë vjetore të vitit 2025*", i cili përmban informacion shpjegues mbi disa elementë të pasqyrave financiare**, por nuk zëvendëson dhe nuk përmbush kërkesat formale dhe përmbajtësore të Shënimeve Shpjeguese**, sipas formatit dhe strukturës së përcaktuar në udhëzimin përkatës. Mungesa e Shënimeve Shpjeguese sipas kërkesave ligjore cënon plotësinë, transparencën dhe kuptueshmërinë e pasqyrave financiare të raportuara.
Shërbimi Social Shtetëror ka dërguar pasqyrat financiare pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2456, datë 12.03.2026, të protokolluara në Degën e Thesarit me nr. 1015/54, datë 12.03.2026, në zbatim të pikës 118 të Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, ku përcaktohet se: "*Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit*". Nga verifikimi rezultoi se pasqyrat financiare janë nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm, znj. R. Xh, në cilësinë e nëpunësit autorizues, si dhe nga nëpunësi zbatues (hartuesi i pasqyrave), z. F. S, në përputhje me kërkesat e *Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, konkretisht në pikën 3/ë të nenit 12, ku përcaktohet: *"Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Financave. Sistemi i kompjuterizuar i thesarit mund të përdoret për kontabilizimin dhe raportimin e transaksioneve financiare të njësisë publike, bazuar në kriteret e vendosura nga Ministria e Financave; f) ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve"*, si dhe në pikën 4/d të nenit 11, ku përcaktohet se: *"Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: f)planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së njësisë publike"*.

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Pasqyra e pozicionit Financiar më 31.12.2025
Aktivet
Aktivet afatshkurtra dhe afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar të SHSSH, më 31.12.2025 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 2: "Paraqitja e seksionit të aktiveve të SHSSH për 2025 vs 2024"

Nr.	Llog.	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
1	**A**	**A K T I V E T**	**284,255,026**	**481,716,328**
2		**I. Aktivet Afat shkurtra**	**257,669,538**	**451,869,871**
3		**1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre**	**154,257,811**	**359,856,911**
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke	71,902,811	300,000,000
6	520	Disponibilitete ne Thesar	82,355,000	59,856,911
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**19,299,389**	**18,307,008**
12	31	Materiale	2,045,162	1,664,465
13	32	Inventar I imët	17,254,227	16,642,543
21		**3.Llogari te Arkëtueshme**	**84,112,337**	**73,705,951**
33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	84,112,337	73,705,951
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**-**	**-**
37	409	Parapagime		
42		**II. Aktivet Afat gjata**	**26,585,488**	**29,846,457**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**3,204,000**	**5,975,061**
45	202	Studime dhe kërkime	3,204,000	5,975,061
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**23,381,488**	**23,871,396**
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	20,539,610	21,620,643
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	-	-
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	550,812	716,965
53	215	Mjete Transporti	373,635	257,211
56	218	Inventar ekonomik	1,917,431	1,276,577
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	-	-
62		**4.Investime**	-	-
63	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Për Aktive Afatgjata materiale		-

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit

I. Aktivet Afatshkurtra

Në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2025 aktivet afatshkurta paraqiten në vlerën 257,669,538 lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 "*Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*" në shumën 154,257,811lekë;
- Llogaritë e Klasës 2 "*Gjendje inventari qarkullues*" në shumën 32,080,970 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 "*Llogari të arkëtueshme*" në shumën 84,112,337 lekë.

1. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre (klasa 5) përbëhet nga:

Nga auditimi i zërit "*Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre*", u konstatua se ky zë përbëhet nga llogaritë "*Mjete monetare në bankë*" dhe "*Disponibilitete në Thesar",* si më poshtë:

- *"Mjete monetare në bankë*" (llog. 512, 56) në fund të vitit 2025 paraqiten në shumën 71,902,811 lekë, të cilat përfaqësojnë gjendjen e likuiditeteve në llogaritë bankare të SHSSH dhe konfirmohen me gjendjen e datës 31.12.2025 sipas ekstraktit bankar (statement) të C. Bank. Në fund të vitit 2024, kjo llogari paraqitet në shumën 300,000,000 lekë.
- "*Disponibilitete në Thesar*" (llog. 520) në fund të vitit 2024 paraqiten në shumën 82,355,000 lekë, ndërsa në fund të vitit 2025 në shumën 59,856,911 lekë. Kjo llogari paraqitet më e lartë nga viti paraardhës në shumën 22,498,089 lekë.

Nga krahasimi dhe verifikimi i të dhënave rezultoi se shumat e mësipërme rakordojnë me vlerat e paraqitura në Formatin F3 "*Pasqyra e flukseve monetare*", konkretisht me tepricën në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor, ku shuma e mjeteve monetare përbëhet nga gjendjet në bankë dhe disponibilitetet në Thesar, si më poshtë:

Emërtimi	2025	2024
Teprica në fillim të vitit ushtrimor	359,856,912	108,450,511
Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor	154,257,811	359,856,912

Nga auditimi, konstatohet se në lidhje me këtë llogari gjatë fazës së auditimit në terren nuk është kryer ende rakordimi me degën e thesarit me degën e Thesarit, **veprim në kundërshtim** me pikën 50 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së*

përgjithshme, ku përcaktohet se: "*Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar*" *dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me aktrakordime me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).*"

2. Gjendje Inventari qarkullues (Klasa 3)

Në fund të vitit 2025, kjo klasë llogarie paraqitet në shumën 19,299,389 lekë krahasuar me vitin 2024, ky zë është rritur në vlerën 992,381 lekë.

Llogaritë analitike përbëhen nga:

- Zëri "*Materiale"* (llog. 31) paraqitet në shumën 2,045,162 lekë, kundrejt 1,664,465 lekë në vitin 2024, e cila përbëhet nga materiale kancelarie, zyre, IT-je, pajisje ndihmëse (tonerë, kabllo, pajisje rrjeti), materiale pastrimi dhe mirëmbajtjeje, materiale dhe pjesë për automjete (karburant, filtra), si dhe materiale të tjera konsumi dhe ndihmëse, të destinuara për t'u përdorur në funksion të aktivitetit administrativ dhe operacional të njësisë.
- Zëri "*Inventar i imët"* (llog. 32), më 31.12.20254 paraqitet në shumën 17,254,227 lekë, kundrejt 16,642,543 lekë në vitin 2024, në mënyrë analitike kjo llogari paraqitet në Aneksin "Auditimi i llogarive vjetore".

Shumat e raportuara janë konfirmuar me Relacionin nr. 278, datë 12.01.2026, të komisionit të inventarizimit "*Relacion mbi inventarizimin e aktiveve dhe materialeve qarkulluese në Shërbimin Social Shtetëror, Tiranë për vitin 2025*".

Nga verifikimi i listës analitike të llogarisë "*Inventar i imët"* (llog. 32), konstatohet se për 5 nga shtesat e vitit 2025, në vlerën totale 641,264 lekë, konkretisht *Server, Raft metalik, UPS, swîtch dhe Aparat elektrik*, janë evidentuar si inventar i imët, ndërkohë që për shkak të natyrës, funksionit dhe vlerës së tyre, duhet të ishin klasifikuar si inventar ekonomik (llog. 218).

Për rrjedhojë, zëri "*Inventar i imët*" është mbivlerësuar dhe zëri "*Inventar ekonomik*" është nënvlerësuar në shumën 641,264 lekë. Nëse këto aktive do të trajtoheshin në mënyrë të saktë dhe do të amortizoheshin me normën 20%, shpenzimi i amortizimit për vitin 2025 do të ishte në shumën 128,253 lekë[3], ndërsa nga trajtimi aktual është njohur si shpenzim e gjithë vlera prej 641,264 lekë. Si pasojë, në Pasqyrën e Performancës (PASH) shpenzimet janë mbivlerësuar në shumën 513,011 lekë, ndërsa rezultati financiar është nënvlerësuar në të njëjtën vlerë, duke sjellë shtrembërim në paraqitjen e drejtë të shpenzimeve sipas periudhës ushtrimore.

Nga verifikimi i këtij relacioni dhe procesit të inventarizimit fizik të aktiveve rezultoi se gjendja kontabël përputhet me gjendjen fizike, pa evidencuar diferenca për këto klasa llogarie.

3. Llogari të arkëtueshme (Klasa 4)

Ky zë paraqitet në shumën 84,112,337 lekë në vitin 2025, kundrejt shumës 73,705,951 lekë në vitin 2024, duke reflektuar një rritje në vlerën 10,406,386 lekë.

Ky zë përbëhet nga:

- "*Operacione me shtetin (të drejta)"* (llog. 4342) në shumën 84,112,337 lekë, që përfaqëson detyrime të arkëtueshme nga buxheti i shtetit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, të cilat likuidohen në vitin pasardhës, përbërja analitike e kësaj llogarie paraqitet si në vijim:

Tabela nr. 3: "Llogaria analitike 4342"

Llog.	Emërtimi	Shuma (lekë)
42	Detyrime ndaj personelit	4,887,935

[3] Maksimalisht, nëse amortizimi do të ishte bërë për 12 muaj (viti i plotë ushtrimor).

431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	570,150
435	Sigurime Shoqërore	78,061,844
436	Sigurime shëndetësore	209,758
467	Kreditore te ndryshëm	382,650
Totali		**84,112,337**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga verifikimi i dokumentacionit mbështetës dhe regjistrimeve kontabël rezultoi se kjo llogari është paraqitur në përputhje me natyrën e saj si e drejtë e institucionit ndaj buxhetit të shtetit dhe pasqyron detyrimet e papaguara në fund të periudhës ushtrimore.

4. Të tjera aktive afatshkurtra

Kjo klasë llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2025 paraqitet me vlerë 0 lekë, njëjtë me vitin 2024, duke treguar mungesë të lëvizjeve në këto llogari gjatë periudhës ushtrimore.

II. Aktivet Afatgjata

Në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2025, aktivet afatgjata paraqiten në shumën 26,585,488 lekë, kundrejt shumës 29,846,457 lekë në vitin 2024, duke reflektuar një ulje në vlerën 3,260,969 lekë krahasuar me vitin paraardhës.

1. Aktive Afatgjata Jomateriale (llog. 20)

Ky zë paraqitet në shumën 3,204,000 lekë në vitin 2025, kundrejt 5,975,061 lekë në vitin 2024, krahasuar me një vit më parë është ulur në shumën 2,771,061 lekë.

- "*Studime dhe kërkime*" (llog. 202) paraqitet në shumën 3,204,000 lekë, dhe është ulur në shumën 2,771,061 lekë krahasuar me vitin paraardhës. Kjo llogari paraqet analiza te thelluara në lidhje me zhvillimin e projekteve të investimeve të reja në lidhje me institucionet e varësisë së SHSSH. Grupi i auditimit kreu verifikimet mbi saktësinë e paraqitjes së kësaj llogarie, nga ku rezultoi situata si në tabelën më poshtë

Konkretisht, llogaria paraqitet si më poshtë:

Përshkrimi	Kosto	Amortizim i akumuluar	Vlera kontabël neto
Teprica në fillim (31.12.2024)	5,975,061	-	5,975,061
Shtesat gjatë vitit	3,204,000	-	-
Pakësimet gjatë vitit	5,975,061	-	-
Teprica në fund (31.12.2025)	**3,204,000**	**-**	**3,204,000**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Konkretisht, nga analiza e lëvizjeve të kësaj llogarie rezulton se gjatë vitit ushtrimor janë evidentuar shtesa në shumën 3,204,000 lekë, ndërsa pakësimi në shumën 5,975,061 lekë, ka të bëjë më projektin e qendrës së Zhvillimit Tiranë-Golem, që është dorëzuar, kësaj të fundit, duke çuar në një vlerë përfundimtare prej 3,204,000. Shtesat e kësaj llogarie janë bërë bazuar në dokumentacionin si më poshtë:

- Përforcimi, sipas kontratës nr. 1011/2 mes SHSSH dhe U.P.T , datë 16.04.2025, hyrja bazuar në fletë-hyrjen nr. 2, datë 30.04.2025, sipas faturës nr. 118/2025, datë 30.04.2025, në shumën 720,000 lekë;
- Akt ekspertize, amendim i kontratës nr. 110/5, mes SHSSH dhe U.P.T, hyrja bazuar në fletë-hyrjen nr. 1, datë 07.03.2025, sipas faturës nr. 62/2025, datë 07.03.2025, në shumën 2,484,000 lekë

2. Aktive Afatgjata Materiale (llog. 21) paraqiten në shumën 23,381,488 lekë në vitin 2025, kundrejt 23,871,396 lekë në vitin 2024, krahasuar me një vit më parë ka pësuar një rënie në shumën 489,908 lekë.

Ky zë përbëhet nga:

- "*Ndërtesa dhe konstruksione"* (llog. 212) në shumën 20,539,610 lekë, në shumën 20,539,610 lekë, krahasuar me një vit më parë është pakësuar në shumën 1,081,033 lekë dhe përfaqëson

godinën e Drejtorisë së SHSSH, e cila për vitin ushtrimor 2025 është amortizuar me normën 5%, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi për amortizimin e aktiveve afatgjata materiale, *si dhe në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30/2018, ku përcaktohet se amortizimi i aktiveve në sektorin publik llogaritet sipas normave të legjislacionit fiskal përkatës*; ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 212 është paraqitur me vlerën kontabël neto, *në përputhje me pikën 30 të Udhëzimit nr. 30/2018, ku përcaktohet se aktivet afatgjata materiale paraqiten në pasqyrat financiare me koston historike minus amortizimin e akumuluar*; në lidhje me këtë aktiv konstatohet se SHSSH nuk disponon formatin e regjistrit të aktiveve, as pasqyrë amortizimi, por aplikon për efekt të llogaritjes së amortizimit dhe paraqitjes së postit përkatës në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe pasqyrat 7/a dhe 7/b, si dhe nuk disponon kartelë për këtë aktiv, *në kundërshtim me pikën 30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* ku përcaktohet se: "*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës se aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia".*

Formati i mbajtjes së evidencës për këtë kategori paraqitet si më poshtë:

Kartela	Përshkrimi	Njësia	Çmimi	Sasia	Vlera
N01	Ndërtesa	leke	48,508,094	1	48,508,094
Totali				1	**48,508,094**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

- "*Instalime teknike, makineri dhe pajisje*" (llog. 214) paraqiten në shumën 550,812 lekë, krahasuar me një vit më parë është pakësuar në shumën 166,153 lekë. Nga auditimi rezultoi se për vitin ushtrimor 2025 nuk ka pasur shtesa në këtë kategori të aktiveve, ndërsa është evidentuar pakësim në shumën 22,760 lekë, që ka të bëjë me daljen e 2 printerave të tipit HP 1018 Jet, sipas fletë-daljes nr. 2, datë 23.07.2025, me vlerë 11,380 lekë/printer, sipas Urdhrit nr. 287, datë 23.07.2025 *"Për kalim kapital*", të Drejtorit të përgjithshëm të SHSSH, për të kaluar dy printera tek Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit Tiranë. Referuar pasqyrave statistikore 7/a dhe 7/b për vitin 2025 "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)/(vlera bruto)",* rezulton se aktivet e dala janë çregjistruar vetëm me koston historike, duke reflektuar pakësim vetëm në vlerën fillestare, pa u pasqyruar ulja përkatëse e amortizimit të akumuluar.

Ky trajtim nuk është në përputhje me kërkesat e *SKK 5 "Aktivet afatgjata materiale"*, ku përcaktohet se në momentin e daljes, aktivet duhet të çregjistrohen me vlerën kontabël neto, duke pakësuar njëkohësisht si koston historike ashtu edhe amortizimin e akumuluar përkatës. Në këtë rast, SHSSH duhet të kishte pakësuar amortizimin e akumuluar me vlerën e amortizimit të krijuar për këto printera dhe koston historike me vlerën e tyre fillestare, duke reflektuar saktë VKN në momentin e daljes.

Gjithashtu, konstatohet se amortizimi është llogaritur pa marrë në konsideratë faktin që këta printera kanë qenë në përdorim jo për 12 muaj, por për 7 muaj gjatë vitit 2025, duke mos reflektuar saktë amortizimin deri në momentin e çregjistrimit.

Si pasojë, pasqyra e pozicionit financiar nuk paraqet në mënyrë të saktë aktivet afatgjata dhe amortizimin të akumuluar, ndërsa në pasqyrën e performancës (PASH) është evidentuar pasaktësi në njohjen e shpenzimit të amortizimit për periudhën, duke mos respektuar parimin e përputhjes së shpenzimeve me periudhën ushtrimore.

Efekti i këtij veprimi paraqitet si më poshtë:

<u>Në pasqyrën e pozicionit Financiar:</u>

- Amortizimi i akumuluar rezulton i mbivlerësuar, pasi nuk është pakësuar në momentin e çregjistrimit të aktivit;
- Vlera neto e aktiveve afatgjata rezulton e nënvlerësuar, pasi amortizimi i mbetur vazhdon të qëndrojë në bilanc pa aktivin përkatës;
- krijohet një mospërputhje midis kostos dhe amortizimit të akumuluar për këto aktive.

Në pasqyrën e performancës financiare:

- duke qenë se amortizimi është llogaritur mbi VKN dhe jo mbi koston historike, si dhe pa marrë në konsideratë periudhën reale të përdorimit (7 muaj), shpenzimi i amortizimit është i nënvlerësuar

Veprimi i kryer gjithashtu është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme""*, në pikën ku përcaktohet se: *"Në rastet e daljeve të aktiveve afatgjata, funksionimi kontabël është si më poshtë: d) Për daljet nga dhëniet falas (dhurimet e aktiveve afatgjata), funksionimi i vlerës historike dhe amortizimit është: • Kreditohen 20, 21 (analizat shtatëshifrore përkatëse); • Debitohet 1016 'Pakësim fondi nga transfertat brenda e jashtë sistemit të AAGJ'."*

Në rastin konkret, njësia ka kryer çregjistrimin vetëm të kostos historike, pa reflektuar pakësimin përkatës të amortizimit të akumuluar, duke mos zbatuar plotësisht funksionimin kontabël të përcaktuar më sipër dhe duke mos reflektuar daljen e aktivit me vlerën kontabël neto.

Për pasojë dhe paraqitjet në pasqyrat 7/a dhe 7/b janë të pasakta, në vlerat si më sipër.

Në lidhje me amortizimin, rezultoi se nuk disponohet pasqyrë e veçantë për llogaritjen e tij sipas aktiveve individuale, por amortizimi llogaritet në grup për të gjitha aktivet, çka cënon gjurmueshmërinë dhe saktësinë e informacionit kontabël, për pasojë dhe reflektimi i amortizimit të aktiveve të dalë nuk është evidentuar me saktësi, për periudhën përkatëse të përdorimit në SHSSH.

Nga analiza e të dhënave rezulton se norma e amortizimit e aplikuar është 20%,

Kosto historike e aktiveve konfirmohet nga procesverbali i komisionit të inventarizimit, nga ku rezulton përputhje ndërmjet të dhënave kontabël dhe evidencave të inventarizimit fizik.

- "*Mjete transporti"* (llog. 215) në shumën 373,635 lekë, krahasuar me vitin 2024 është rritur në vlerën 116,424 lekë, ndryshimet gjatë 2025 paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4:"Ndryshimet e llogarisë 215 përgjatë 2025"

Përshkrimi	Kosto	Amortizim i akumuluar	Vlera kontabël neto
Teprica në fillim (31.12.2024)	8,410,464	8,153,253	257,211
Shtesat gjatë vitit	1,156,820	1,032,445	-
Pakësimet gjatë vitit	260,001	252,050	-
Teprica në fund (31.12.2025)	**9,307,283**	**8,933,648**	**373,635**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analiza e të dhënave të paraqitura rezulton se gjatë vitit 2025 janë evidentuar shtesa në shumën 1,156,820 lekë, të cilat kanë ndikuar në rritjen e kostos historike të aktivit, ndërkohë që janë evidentuar edhe pakësime në shumën 260,001 lekë, si dhe amortizim i periudhës në shumën 1,032,445 lekë. Shtesa lidhet me marrjen e një automjeti të tipit Volksŵagen, ndërsa pakësimi lidhet me daljen nga përdorimi të një automjeti të tipit Nissan. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, me Urdhrin nr. 429, datë 25.11.2025 *"Kalim kapital për automjetet"* të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH janë urdhëruar dy kalime pa pagesë, konkretisht kalimi i automjetit tip Nissan nga Shërbimi Social Shtetëror tek Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, si dhe marrja në përdorim nga SHSSH e automjetit tip Volksŵagen. Me procesverbalin e marrjes në dorëzim nr. 9652/1, datë 25.11.2025 është marrë në dorëzim automjeti tip Volksŵagen nga komisioni i pritjes së mallit me 3 anëtarë, nga përgjegjësi i sektorit të financës dhe shoferët. Sipas fletë-hyrjes nr. 2, datë 25.11.2025 të SHSSH, automjeti tip Volksŵagen është regjistruar me kosto historike 1,156,820

lekë dhe amortizim të akumuluar 938,036 lekë, vlera të cilat paraqiten po kështu edhe në fletë-daljen e QKTVDHF nr. 1, datë 25.11.2025. Nga ana tjetër, me fletë-daljen nr. 3, datë 25.11.2025, SHSSH ka bërë dalje automjetin tip Nissan me vlerë kontabël neto 260,001 lekë.
Në këto kushte konstatohet se aktivi i dhënë është nxjerrë nga përdorimi me VKN 260,001 lekë, ndërsa aktivi i marrë është regjistruar duke reflektuar vlerat e tij historike dhe amortizimin e akumuluar, duke rezultuar me VKN 124,375 lekë, dhe jo me vlerën kontabël neto të aktivit të dhënë. Në këto kushte konstatohet se aktivi i dhënë është nxjerrë nga përdorimi me VKN 260,001 lekë, ndërsa aktivi i marrë është regjistruar duke reflektuar vlerat e tij historike dhe amortizimin e akumuluar, duke rezultuar me VKN 124,375 lekë, dhe jo me vlerën kontabël neto të aktivit të dhënë.
Ky trajtim është në kundërshtim me paragrafin 16/b, të SKK 5 ku përcaktohet se: *"Nëse aktivi përfitohet në këmbim të një aktivi tjetër jomonetar, ose grup aktivesh, ose të një kombinimi aktivesh monetare me aktive jomonetare, kosto e aktivit të marrë matet me vlerën e drejtë, përveç rasteve kur: (a) vlera e drejtë e aktiveve të marra dhe atyre të dhëna nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme; (b) veprimi i këmbimit nuk ka përmbajtje tregtare (për shembull, kur aktivet e shkëmbyer janë të ngjashëm). Në të dyja rastet e lartpërmendura, (a) dhe (b), kostoja e aktivit të marrë është vlera kontabël e aktivit të dhënë".*
Për rrjedhojë, aktivi i marrë duhet të ishte regjistruar në vlerën 260,001 lekë, ndërsa regjistrimi me vlerë kontabël neto 124,375 lekë ka sjellë nënvlerësim të aktivit në pasqyrat financiare në shumën 135,626 lekë.
Gjithashtu nga auditimi konstatohet se për muajin dhjetor 2025 nuk është përllogaritur amortizimi për aktivin e marrë, ndërkohë që amortizimi për aktivin e dhënë duhet të ishte llogaritur për 11 muaj, duke qenë se çregjistrimi është kryer në datën 25.11.2025. Edhe pse, në kushtet kur baza e amortizueshme do të ishte e njëjtë, ky veprim nuk ka efekt financiar në rezultatin e periudhës, por përbën pasaktësi në trajtimin kontabël, duke mos reflektuar saktë shpërndarjen kohore të shpenzimit të amortizimit dhe duke cenuar paraqitjen e drejtë të tij në pasqyrat financiare.
Në mënyrë të detajuar, zërat analitikë të kësaj llogarie paraqiten si në tabelën më poshtë.":

Emërtimi	C Historike	2024			2025		
		Amortizim akumuluar	Teprica Neto	% amortizimi	Amortizimi 2025	Amortizimi I Akumuluar 2025	Vlera mbetur - Teprica Neto 2025
Subaru TR 93** R	2,083,303	2,019,591	63,712	20%	12,742	2,032,333	50,970
Galloper TR 05** S	4,428,160	4,292,737	135,423	20%	27,085	4,319,821	108,339
Mercedes Benc TR 62**H	1,639,000	1,588,876	50,124	20%	10,025	1,598,900	40,100
Volksëagen AA 3** FB	1,156,820	939,036	217,784	20%	43,557	982,593	174,227
Totali	**9,307,283**	**8,840,239**	**467,044**		**93,409**	**8,933,648**	**373,635**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga krahasimi i vlerës së amortizimit me vlerën e kostos rezulton se norma e amortizimit e aplikuar rreth 20%, e cila është në përputhje me normat e përcaktuara në legjislacionin fiskal në fuqi, *si dhe në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018*, ku përcaktohet se aktivet afatgjata materiale paraqiten në pasqyrat financiare me koston historike minus amortizimin e akumuluar.
Në lidhje me shtesat dhe pakësimet e kësaj llogarie **nuk paraqitet informacion sqarues** në pasqyrat financiare, çka cënon transparencën dhe plotësinë e informacionit financiar dhe sjell risk për pasaktësi në evidentimin dhe monitorimin e tyre

- *"Inventar ekonomik*" (llog. 218) paraqitet në shumën 1,917,431 lekë, krahasuar me vitin paraardhës është rritur në shumën 640,854 lekë. Nga verifikimi i Fletës së Inventarizimit për llogarinë 218 rezulton se inventari ekonomik është evidentuar në mënyrë të detajuar sipas

përshkrimit, njësisë dhe vlerës përkatëse, si dhe është konfirmuar nga procesi i inventarizimit fizik.

Për vitin 2025 lëvizja e kësaj llogarie paraqitet si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 5: "Lëvizja e llogarisë 218"

Përshkrimi	Kosto	Amortizim i akumuluar	VKN 31.12.25
Teprica në fillim (31.12.2024)	1,276,577	0	1,276,577
Shtesat gjatë vitit	4,864,874	278,541	4,586,333
Pakësimet gjatë vitit	3,945,480	0	3,945,480
Teprica në fund (31.12.2025)	**1,917,431**	**0**	1,917,431

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela nr. 6: Shtesat dhe pakësimet e llogarisë 218

HYRJET							
Nr	**Data FH**	**Nr. FH**	**Përshkrimi**	**Njësia**	**Çmimi**	**Sasia**	**Total hyrje (lekë)**
1	17.04.2025	1	Laptop	copë	123,032	6	738,192
2	17.12.2025	11	Televizor 43"	copë	25,200	3	75,600
3	17.12.2025	11	Kondicioner 12000 BTU	copë	28,800	3	86,400
4	17.12.2025	11	Frigorifer i vogël	copë	19,200	1	19,200
5	-	-	Blerje pajisje për IPSH	copë	3,888,000	1	3,888,000
6	17.12.2025	11	Sobë gatimi me gaz	copë	33,480	1	33,480
7	17.12.2025	11	Bolier uji	copë	12,000	2	24,000
Totali hyrje:							**4,864,872**
DALJET							
Nr	**Data FD**	**Nr. FD**	**Përshkrimi**	**Njësia**	**Çmimi**	**Sasia**	**Total dalje (lekë)**
1	-	-	Blerje pajisje për IPSH	copë	3,888,000	1	3,888,000
2	18.12.2025	5	Sobë gatimi me gaz	copë	33,480	1	33,480
3	18.12.2025	5	Bolier uji	copë	12,000	2	24,000
Totali dalje:							**3,945,480**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Shtesat dhe pakësimet janë bërë bazuar në dokumentacion mbështetës (fletëhyrje, fletëdalje, autorizim nga titullari).

Nga krahasimi i vlerës së amortizimit me vlerën e kostos rezulton se norma e amortizimit e aplikuar rreth 20%, e cila është në përputhje me normat e përcaktuara në legjislacionin fiskal në fuqi, *si dhe në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018*. Në lidhje me daljet konstatohet se nuk është reflektuar ulja e amortizimit të akumuluar të aktiveve të dala, por vetëm ulja e kostos fillestare, veprim në kundërshtim me kërkesat e *Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare"*, si dhe me kërkesat e *SKK 5*, ku përcaktohet se aktivet afatgjata materiale në momentin e daljes çregjistrohen me vlerën kontabël neto, duke reflektuar njëkohësisht si koston historike ashtu edhe amortizimin e akumuluar.

II. Pasivet (Detyrimet)

Seksioni i pasivit në pasqyrën e pozicionit Financiar më datë 31.12.2025 paraqitën si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 7: "Paraqitja e seksionit detyrime, më 31.12.2025"

Në lekë

Llog	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
B	**PASIVET(DETYRIMET)**	**238,370,148**	**433,562,862**
	I. Pasivet Afat shkurtra	**238,370,148**	**433,562,862**
	1. Llogari te Pagueshme	**238,370,148**	**433,562,862**
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to		
42	Detyrime ndaj personelit	4,887,935	5,262,871
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	570,150	583,842
435	Sigurime Shoqërore	78,061,844	67,349,478
436	Sigurime Shëndetësore	209,758	221,008
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore		
466	Kreditore për mjete ne ruajtje	154,257,811	359,856,911
467	Kreditore te ndryshëm	382,650	288,752
4341	Operacione me shtetin(detyrime		
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	-	-
	II.Pasivet Afat Gjata	-	-
C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**45,884,878**	**48,153,465**

D	**FONDI I KONSOLIDUAR:**	**45,884,878**	**48,153,465**
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	45,884,878	48,153,465
E	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**284,255,026**	**481,716,327**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

1. Pasivet Afatshkurtra

-"*Detyrime ndaj personelit*" (llog. 42) në vlerën 4,887,936 lekë, përfaqëson pagat e papaguara të SHSSH, konkretisht për muajin dhjetor të cilat paguhen në janar të vitit 2026. Nga grupi i auditimit në lidhje me pagat e muajit dhjetor 2025, u bë verifikimi i pagave me formularin esig 025 të dorëzuar në sistemin efilling, nga ku rezultoi si më poshtë:

Tabela nr. 8: "Verifikimi i pagave të pagueshme nga esig 025"

Në lekë

Paga Bruto	Kontribute Shoq		Kontribute Shënd		TAP	Neto
	PDH	PM	PDH	PM		
6,146,082	906,489	576,733	104,879	104,879	570,150	4,894,320

Burimi: MF, përpunim nga grupi i auditimit.

Nga krahasimi me të dhënat me pasqyrën e pozicionit financiar rezultoi si më poshtë:

Tabela nr. 9: "Krahasimi i posteve të llogarive në PF vs Esig 025"

Në lekë

Përshkrimi	42	431	435	436
I. Në PF	4,887,935	570,150	78,061,844	209,758
II. Sipas llog te KLSH	4,894,320	570,150	1,483,222	209,758
Diferenca (I-II)	**-6,385**	**0**	**76,578,622**	**0**
Test	*Nënvlerësuar*	*Njëjtë*	*Mbivlerësuar*	*Njëjtë*

Nga krahasimi i të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me të dhënat e deklaruara në formularin e-sig 025, rezulton se llogaria "*Detyrime ndaj personelit*" (llog. 42) është nënvlerësuar në shumën 6,385 lekë, ndërsa llogaritë përkatëse për kontributet dhe TAP paraqiten në përputhje, me përjashtim të llogarisë 435 "*Sigurime Shoqërore*", e cila rezulton e mbivlerësuar në shumën 76,578,622 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se kjo shumë paraqet detyrimin për "*Sigurimet gratë e papuna dhjetor 2025*", i cili do të paguhet në muajin Janar 2026 dhe përfaqëson transfertë 606.

-"*Detyrim ndaj shtetit për tatim taksa*" (llog. 431) në vlerën 570,150 lekë përfaqëson tatimin e të ardhurave nga punësimi të muajit dhjetor 2025, sipas përllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit, kjo llogari është paraqitur saktë në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2025.

-"*Sigurimet shoqërore*" (llog. 435) paraqitet në shumën 78,061,844 lekë dhe përfaqëson sigurimet shoqërore për pagat e muajit dhjetor 2025 në shumën 1,331,734 lekë dhe 76,578,622 sigurimet për gatë e papuna, që paguan SHSSH.

-"*Sigurime Shëndetësore*" (llog. 436) në shumën 209,758 lekë paraqet detyrimin e SHSSH për kontributet e papaguara të kontributeve të sigurimeve shëndetësore (Punëdhënës + punëmarrës) sipas përllogaritjeve konstatohet të jetë paraqitur saktë në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2025.

-"*Kreditorë për mjete në ruajtje*" (llog. 466) - në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2025 paraqitet në shumën 154,257,811 lekë. Kjo llogari pasqyron fondet e alokuara për programin "*Bonusi i bebes",* të cilat do të shpërndahen gjatë muajit janar 2026. Shuma e kësaj llogarie korrespondon me vlerën e mjeteve monetare të paraqitura në aktiv, konkretisht me gjendjen në "*Mjete monetare në bankë"* dhe "*Disponibilitete në Thesar*", duke reflektuar fonde të papërdorura në fund të periudhës ushtrimore.

Fondet e disponueshme në Thesar janë evidentuar sipas Urdhër shpenzimit nr. 347, datë 30.12.2025, të SHSSH, në llogarinë ekonomike 606, për kodin e projektit 19307AD, me objekt "*Bonus për nënat dhe fëmijët e porsalindur*", në zbatim të kërkesës për paradhënie nr. 10711,

datë 30.12.2025, si dhe në përputhje me VKM nr. 740 "*Për dhënien e bonusit për foshnjën*", datë 12.12.2018, të ndryshuar me VKM nr. 824, datë 28.12.2023.
-"*Kreditorë të ndryshëm*" (llog. 467) paraqitet në shumën 382,650 lekë, llogari e cila paraqet detyrimet e periudhës dhjetor 2025, të papaguara deri më 31.12.2025, të cilat në mënyrë analitike paraqite si në tabelën më poshtë:
Tabela nr. 10: ":Llogaria analitike 467"

Në lekë

Emërtimi	**Shuma**
Tatim ne burim Honorare 2025	133,500
Shërbim postar dhjetor 2025	56,375
Energjia dhjetor 2025	99,035
Uji dhjetor 2025	240
Këshilltar i Jashtëm	93,500
Totali	**382,650**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH

III. Aktivet neto/ fondet:

Seksioni i aktiveve neto, në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2025 paraqitet si në tabelën më poshtë:
Tabela nr. 11: "Aktivet neto sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiare 31.12.2025

Në lekë

Llog.	**Emërtimi**	**31.12.2025**	**31.12.2024**
C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**45,884,878**	**48,153,465**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR:**	**45,884,878**	**48,153,465**
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	45,884,878	48,153,465
12	**Rezultatet e mbartura**		
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore		0
111	Rezerva		

Burimi: PF e SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH.

Nga verifikimi i fondeve neto në "*Pasqyrën e pozicionit financiar*", u konstatua se diferenca ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve është llogaritur saktë, rezultati financiar paraqitet në vlerën 0 lekë, duke qenë në përputhje dhe duke rakorduar me të dhënat e pasqyrës së performancës financiare.

Formati nr. 2 "*Pasqyra e Performancës Financiare*"

Pasqyra e Performancës Financiare, për vitin 2025 nga SHSSH është përgatitur bazuar në klasifikimin sipas natyrës ekonomike.
Për vitin 2025 kjo pasqyrë paraqitet nw Aneksin "Auditimi i llogarive vjetore".

A. Të ardhurat

- "*Grant korrent i brendshëm nga Buxheti për NJQP (qendrore)"* (llog. 7200) paraqitet në shumën 2,365,825,213 lekë dhe përfaqëson shumën e transfertave nga Buxheti i Shtetit për vitin ushtrimor 2025, në përputhje me financimin buxhetor të akorduar për këtë institucion.
- "*Grant korrent i brendshëm – Financim i pritshëm nga buxheti*" (llog. 7206) paraqitet në shumën 84,112,337 lekë dhe përfaqëson të drejtat e institucionit në marrëdhënie me shtetin për shpenzime të konstatuara, por të papaguara në fund të periudhës ushtrimore, *në përputhje me pikën 30 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme"*, ku përcaktohet se këto zëra paraqesin të drejtat e njësisë ndaj buxhetit të shtetit. Kjo shumë rakordon me llogarinë 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)*", duke paraqitur në mënyrë të saktë marrëdhëniet financiare ndërmjet SHSSH dhe buxhetit të shtetit.

B. Shpenzimet

I. Pagat dhe përfitimet e punonjësve (klasa 600)

-"*Paga personel i përhershëm*" (llog. 6001) për periudhën 2025 paraqitet në shumën 69,511,414 lekë, e cila përfaqëson shpenzimet për pagat bruto të punonjësve. Nga grupi i

auditimit, për të vlerësuar plotësinë, saktësinë dhe dokumentimin e këtyre shpenzimeve u përzgjodhën 4 muaj (janar. mars, korrik, dhjetor 2025) nga ku rezultoi se praktikat ishin të shoqëruara me: listë pagesat mujore, listë prezencat dhe transfertat bankare.
Nga verifikimi i tyre praktikave rezultoi se dokumentacioni shoqërues dhe autorizues ishte i plotë, çdo pagesë ishte e miratuar nga personat përgjegjës.
-"*Paga personel i përkohshëm*" (llog. 6001) për periudhën 2025 paraqitet në shumën 3,763,961, e cila përfaqëson shpenzimet për pagat bruto të punonjësve të angazhuar me kontrata të përkohshme të punës, shumë që konfirmohet dhe nga ditari analitik i vitit 2025 Këta punonjës janë marrë në punë bazuar në Urdhrin nr. 13, datë 16.01.2025 "*Për përcaktimin dhe shpërndarjen e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2025, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtoritë Rajonale në varësi*", sipas të cilit për Drejtorinë e Përgjithshme janë miratuar:

- 3 specialistë (6 orë/ditë);
- 2 operatorë (6 orë/ditë);
- 1 punonjës informacioni (6 orë/ditë);
- 1 punonjës arkivi (6 orë/ditë);
- 1 punëtor mirëmbajtjeje (6 orë/ditë);

Në total: 8 punonjës me kohë të pjesshme (6 orë/ditë).
- "*Shpenzime të tjera për personelin*" (llog. 6009) paraqet, shpërblimin e marrë nga një punonjëse e larguar për vitin 2025, që nuk ka kryer lejen vjetore, pikës 8 dhe 9 të VKM nr. 568, datë 06.10.2021dhe paraqitet në shumën 123,695 lekë.

II. Blerje Mallra e Shërbime (klasa 602)
- "*Materiale zyre e te përgjithshme*"-për vitin 2025 paraqiten në shumën 918,768 lekë;
- "*Materiale dhe shërbime speciale*" (llog. 6021)- për vitin 2025 paraqitët në shumën 415,460 lekë;
- "*Shërbime nga te tretë*" (llog. 6022)- për vitin 2025 paraqitet në shumën 6,261,533 lekë;
- "*Shpenzime transporti*" (llog. 6023) – për vitin 2025 paraqitet në shumën 1,905,660 lekë;
- "*Shpenzime udhëtimi*" (llog. 6024) – për vitin 2025 paraqitet në shumën 4,192,503 lekë
- "*Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme*" (llog. 6025) për vitin 2025 paraqitet në shumën 399,978 lekë
- "*Shpenzime për qiramarrje*" (llog. 6026) për vitin 2025 paraqitet në shumën 252,998 lekë
- "*Shpenzime për detyrime për kompensime legale"* (llog. 6027) për vitin 2025 paraqitet në shumën 128,659 lekë

"*Shpenzime te lidhura me huamarrjen për hua*" (llog. 6029) për vitin 2025 paraqitet në shumën 12,550,487 lekë
Në total shpenzimet për blerje mallrash e shërbimesh (të renditura më sipër) paraqiten në shumën 27,026,046, të konfirmuara dhe me Ditarin analitik vjetor të SHSSH.

73	*VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE*	Shpenz faktike	Detyrimet e vitit paraardhës	Detyrimet viti pasardhës	viti 2025
B	**SHPENZIMET**	**112,857,667**	**7,927,711**	**7,541,777**	112,471,733
600	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**73,726,077**	**6,474,766**	**6,147,759**	73,399,070
6001	Paga, personel I perhershem	69,838,421	6,474,766	6,147,759	69,511,414
6002	Paga personel I Perkohshem	3,763,961			3,763,961
6003	Shperblime				-
6009	Shpenzime te tjera per personelin	123,695			123,695
601	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**12,100,442**	**1,065,193**	**1,011,368**	12,046,617
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	10,845,879	954,689	906,489	10,797,679
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	1,254,563	110,504	104,879	1,248,938
602	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**27,031,148**	**387,752**	**382,650**	27,026,046
602	Mallra dhe sherbime te tjera				-
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	918,768			918,768
6021	Materiale dhe sherbime speciale	415,460			415,460
6022	Sherbime nga te trete	6,198,730	164,197	227,000	6,261,533

6023	Shpenzime transporti	1,905,660			1,905,660
6024	Shpenzime udhetimi	4,291,503	99,000		4,192,503
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	399,978			399,978
6026	Shpenzime per qeramarrje	252,998			252,998
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	128,659			128,659
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua				-
6029	Shpenzime te tjera operative	12,519,392	124,555	155,650	12,550,487

Tabela më sipër paraqet veprimet për llogaritjen e shpenzimeve faktike, të bazuara në kontabilitetin rrjedhës. Shpenzimet e evidentuara konfirmohen gjithashtu nga ditari analitik.

Transferime korrente

- *"Transferime korrente tek organizata jo fitimprurëse"* (llog. 6042) paraqet, dhe për vitin 2025 rezulton në shumën 13,583,848 lekë, konfirmuar dhe nga rakordimi me degën e thesarit.
- "*Transferta paguara nga ISSH dhe ISKSH*" (llog. 6060) – paraqitet në shumën 2,323,881,969 lekë,

Në lidhje me shpenzimet e SHSSH konstatohet se ditari analitik vjetor nuk përmban të dhëna mbi datat e faturave dhe elementë të tjerë identifikues të dokumenteve justifikuese, duke pamundësuar evidentimin dhe verifikimin e respektimit të afatit 30-ditor të pagesës, në kundërshtim me germën "a" të nenit 6 të ligjit nr. 48, datë 24.04.2014, "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"*, të ndryshuar. Si rrjedhojë, krijohet rrezik për gjenerimin e detyrimeve të prapambetura, aplikimin e penaliteteve për vonesa në pagesa, si dhe cenimin e disiplinës financiare dhe të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi

Rakordimi e pasqyrat e tjera

Nga verifikimi i rakordimit ndërmjet pasqyrave financiare rezultoi se:

- Pasqyra e Flukseve Monetare (F3) rakordon me Pasqyrën e Pozicionit Financiar, ku teprica në fund të vitit ushtrimor në shumën 154,257,811 lekë përputhet me shumën e paraqitur në zërat *"Mjete monetare në bankë*" dhe "*Disponibilitete në Thesar*", në PF;
- Pasqyra e Performancës Financiare rakordon me Pasqyrën e Pozicionit Financiar, ku rezultati financiar në shumën 0 lekë përputhet me diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve në PF;
- Llogaria 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)"* në shumën 84,112,337 lekë në PF rakordon me llogarinë 7206 "*Grant korrent i brendshëm – financim i pritshëm*" në të njëjtën shumë në Pasqyrën e Performancës Financiare.
- Llogaria 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" në shumën 154,257,811 lekë rakordon me gjendjen e mjeteve monetare (bankë + thesar), duke reflektuar fonde të paekzekutuara në fund të periudhës ushtrimore.
- Pasqyra 7/a "*Lëvizja e aktiveve afatgjata"* rakordon me Pasqyrën e Pozicionit Financiar, ku:
  - Kolona 10 (Teprica në fund) përputhet me vlerën e aktiveve afatgjata në PF në shumën 26,585,488 lekë;
  - për llogarinë 212 "*Ndërtesa dhe konstruksione*" në shumën 20,539,610 lekë,
  - për llogarinë 214 "*Instalime teknike*" në shumën 550,812 lekë,
  - për llogarinë 215 "*Mjete transporti*" në shumën 373,635 lekë,
  - për llogarinë 218 "*Inventar ekonomik*" në shumën 1,917,431 lekë.
- Pasqyra 7/b "*Amortizimi i aktiveve afatgjata"* rakordon me PF, ku amortizimi i akumuluar për këto llogari përputhet me vlerat përkatëse të reflektuara në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Nga auditimi i rakordimit ndërmjet pasqyrave financiare rezultoi se pasqyrat rakordojnë mes tyre dhe paraqesin informacion koherent, si në nivel total ashtu edhe në nivel zërash, duke reflektuar në mënyrë të njëtrajtshme gjendjen financiare dhe lëvizjet e periudhës ushtrimore, në përputhje me kërkesat e *Udhëzimit nr. 5 dhe nr. 8 të Ministrisë së Financave.*

Inventarizimi i pronës shtetërore

Me urdhrin nr. 430/5, datë 25.11.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", kreu IV.

Grupi i punës përbëhet nga 3 anëtarë: zj. R. D (kryetar), zj. L. R dhe zj. F. D (anëtarë). Sipas këtij urdhri, pika 4 e tij përcakton se Kryetari i grupit, nëpërmjet një relacioni që lidhet me inventarizimin, njofton titullarin e institucionit (NA) brenda datës 15.01.2026.

Komisioni i inventarizimit ka paraqitur me shkresën nr. 278 prot., datë 15.01.2026, "*Relacionin mbi inventarizimin e aktiveve dhe materialeve qarkulluese në Shërbimin Social Shtetëror*", në përfundim të procesit të inventarizimit për vitin ushtrimor 2025, në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 4 të Urdhrit nr. 430/5, datë 25.11.2025.

Sipas këtij relacioni, procesi i inventarizimit është kryer mbi bazën e verifikimit fizik të aktiveve dhe materialeve qarkulluese, duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës dhe të dhënat kontabël të institucionit. Nga krahasimi i gjendjes fizike me atë kontabël, komisioni ka konstatuar se nuk ka diferenca ndërmjet tyre dhe ka hartuar fletët e inventarizimit dhe pasqyrat përmbledhëse përkatëse sipas zërave të inventarit.

Në vijim të këtij procesi, komisioni i vlerësimit të aktiveve, i përbërë nga F. S. (kryetar)**,** A. M. (anëtar) dhe M. K. (anëtar)**,** ngritur me Urdhrin nr. 431 prot., datë 25.11.2025**,** ka hartuar më datë 15.01.2026 **"***Proces-verbalin mbi vlerësimin e aktiveve*", sipas të cilit vlerësimi është kryer duke u mbështetur në përfundimin e kohës së shfrytëzimit, gjendjen fizike dhe mundësinë e riparimit të tyre, duke arritur në përfundimin se nuk ka diferenca ndërmjet gjendjes fizike dhe asaj kontabël.

Nga auditimi rezultoi se ngritja e komisionit për vlerësimin e aktiveve nuk ka sjellë vlerë të shtuar në proces, pasi vlerësimi cilësor dhe sasior i aktiveve është kompetencë e komisionit të inventarizimit.

Në referim të Udhëzimit nr. 30, komisioni për vlerësimin e aktiveve ngrihet në rastet kur nga komisioni i inventarizimit evidentohen aktive të dëmtuara, jashtë përdorimit apo për t'u nxjerrë nga përdorimi.

Nga verifikimi rezultoi se komisioni i inventarizimit nuk ka evidentuar aktive për t'u nxjerrë jashtë përdorimit, ndërkohë që është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve, i cili në këto kushte nuk ka pasur objekte për vlerësim.

Për rrjedhojë, ngritja e këtij komisioni paraqitet si një veprim formal, pa efekt konkret në procesin e administrimit të aktiveve.

Lidhur me sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, Drejtoria e Financës pranë Shërbimit Social Shtetëror ka paraqitur observacionet, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: "*Duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga KLSH lidhur me marrjen e masave për hartimin dhe paraqitjen e plotë të paketës së pasqyrave financiare vjetore, përfshirë edhe Shënimet Shpjeguese sipas formatit dhe kërkesave të përcaktuara, sqarojmë se gjatë periudhës së auditimit nuk kishte përfunduar ende procesi i kuadrimit me Degën e Thesarit, për arsye procedurale dhe teknike. Dokumentacioni përkatës është dorëzuar pranë Thesarit dhe aktualisht është finalizuar, duke u vulosur dhe konfirmuar edhe nga Thesari. Dokumentacioni i plotë gjendet bashkëlidhur*".

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me observacionin e paraqitur, Grupi i Auditimit vlerëson faktin se rekomandimi i lënë nga KLSH ka filluar të zbatohet menjëherë nga subjekti dhe se aktualisht Shënimet Shpjeguese janë hartuar, administruar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit. Megjithatë, Shënimet Shpjeguese përbëjnë pjesë integrale të paketës së pasqyrave financiare vjetore dhe, për rrjedhojë, duhej të ishin përgatitur dhe paraqitur njëkohësisht me pasqyrat e tjera financiare në momentin e dorëzimit të tyre pranë Degës së Thesarit, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur bashkëlidhur provon marrjen e masave korrigjuese pas konstatimit të auditimit, por nuk ndryshon faktin e konstatuar nga grupi i auditimit për periudhën objekt auditimi. Për rrjedhojë, observacioni nuk sjell fakte apo rrethana të reja që të ndryshojnë përmbajtjen e gjetjes dhe, si i tillë, nuk pranohet.

2.2. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe veprimtaria e njësisë së auditit të brendshëm

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit nr. 17/1 prot., datë 13.01.2026, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Struktura organizative e SHSSH-së dhe institucioneve të varësisë;
- Rregullore e brendshme e SHSSH-së dhe institucioneve të varësisë;
- Dokumentacion lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Regjistrat e riskut;
- Publikime në faqen zyrtare të institucionit;
- Të dhëna lidhur me veprimtarinë e NJAB;
- Dokumentacion i vënë në dispozicion nga SHSSH.

Ngritja dhe funksionimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe Grupit të Menaxhimit të Riskut

Nga auditimi u konstatua se, në asnjë rast për vitet periudhë auditimi 2020 - 2025, nuk është krijuar dhe rrjedhimisht nuk ka qenë funksional Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Grupi i Menaxhimit të Riskut, në kundërshtim me pikat 2.2 dhe 3.2 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 (i shfuqizuar në vitin 2024) dhe me nenet 4 dhe 10 të Udhëzimit nr. 16, datë 13.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike*".

Mjedisi i kontrollit

Struktura dhe organika e Shërbimit Social Shtetëror, drejtorive rajonale dhe institucioneve të varësisë është rregulluar dhe ndryshuar përgjatë periudhës së auditimit nga aktet, si më poshtë:

- Urdhri i Kryeministrit nr. 88, datë 25.10.2011 dhe ndryshimet në vite;
- VKM nr. 23, datë 13.01.2022 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 135, datë 07.03.2018 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror*". Nëpërmjet kësaj VKM-je, punonjësit e SHSSH kaluan nga shërbimi civil në marrëdhënie pune në bazë të Kodit të Punës.
- Urdhri i Kryeministrit nr. 168, datë 29.09.2025 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror*".

Struktura plan – fakt për vitet periudhë auditimi paraqitet, si më poshtë:

	2020		2021		2022		2023		2024		2025	
	Plan	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**
DP SHSSH	50	49	50	49	50	51	53	53	53	53	53	52
Inst. Varësie	319	304	358	339	358	337	382	366	382	368	382	370
TOTAL	**369**	**353**	**408**	**388**	**408**	**338**	**435**	**419**	**435**	**421**	**435**	**422**

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, përpunuar nga grupi i auditimit

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se për SHSSH-në, drejtoritë rajonale dhe institucionet e varësisë, vazhdimisht është miratuar nëpërmjet VKM-ve "*Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme...*", për vitet përkatëse, ku rezulton, si më poshtë:

	2020		2021		2022		2023		2024		2025	
	Plan	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**
DP SHSSH	8	8	11	11	11	11	12	12	11	11	8	7
Inst. Varësie	41	39	68	49	110	89	117	105	112	111	122	115
TOTAL	**49**	**47**	**79**	**60**	**121**	**100**	**129**	**117**	**123**	**122**	**130**	**122**

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, përpunuar nga grupi i auditimit

Gjatë periudhës së auditimit, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme në SHSSH dhe institucionet e varësisë ka ardhur në rritje, nga rreth 13% e strukturës në vitin 2020 në rreth 30% në vitin 2025, duke reflektuar nevojën e vazhdueshme për staf shtesë për përmbushjen e

detyrimeve institucionale. Përdorimi i vazhdueshëm i këtyre kontratave krijon gjithashtu risk në raport me nenin 151 të Kodit të Punës, sipas të cilit kontratat e njëpasnjëshme me afat të caktuar për më shumë se 3 vjet mund të trajtohen si kontrata me afat të pacaktuar.
Në pikën 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, përcaktohet se titullari i çdo njësie publike duhet të ngrejë një strukturë organizative që të bëjë të mundur arritjen e objektivave dhe të jetë në pajtim me funksionet e ngarkuara sipas kuadrit ligjor. Struktura duhet të jetë në harmoni me përmasat dhe me natyrën specifike të njësisë dhe misionin e saj, duhet të vlerësohet kohë pas kohe dhe të modifikohet në rast se gjykohet e nevojshme.
Nëpërmjet shkresës nr. 10123 prot., datë 20.12.2025, drejtuar MSHMS-së, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së ka kërkuar punonjës me kontratë të përkohshme për vitin 2026, duke cituar se "*kërkesa është hartuar mbi nevojat e deklaruara nga strukturat vartëse dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror,* ***me qëllim garantimin e vijueshmërisë së shërbimeve dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore të institucionit***", duke kërkuar një numër total prej 231 punonjësish shtesë me kontratë mbi strukturën organizative të miratuar, nga të cilët 9 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH-së, 57 punonjës për Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social dhe 174 punonjës për IPSH-të në varësi dhe bashkëvarësi të SHSSH-së.
Nga SHSSH është bërë me dije se përgjatë vitit 2025 është realizuar një studim i mirëfilltë në bashkëpunim ndërinstitucional ndërmjet UNICEF, IDRA, MSHMS-së dhe SHSSH-së, lidhur me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH-së. Në këtë dokument[4] citohet se *një nga detyrat kryesore ka qenë realizimi i një rishikimi funksional të SHSSH-së, duke ofruar rekomandime mbi strukturën dhe funksionet aktuale*.
Studimi i realizuar identifikon nevojën për forcimin e kapaciteteve organizative të SHSSH-së, si në nivel qendror ashtu edhe rajonal, përmes krijimit të funksioneve të reja koordinuese, riorganizimit të drejtorive ekzistuese dhe ngritjes së strukturave të specializuara për skemat e ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe monitorimit të shërbimeve sociale. Analiza evidenton mungesën e një koordinimi të dedikuar me Drejtoritë Rajonale, kapacitete të pamjaftueshme për trajtimin e ankesave, monitorimin dhe kontrollin e skemave, si dhe mangësi në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të nevojshme për planifikim dhe kontroll të bazuar në risk. Në këtë kuadër, propozohet forcimi i funksioneve të trajnimit, statistikave, analizës, monitorimit dhe kontrollit, si dhe krijimi i ekipeve të dedikuara në Drejtoritë Rajonale për kontrollin e veçantë të skemave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, bazuar në analizën e ngarkesës së punës dhe nevojave operacionale.

Në strukturën e SHSSH-së janë 15 specialistë IT, përfshirë 3 në Drejtorinë e Përgjithshme dhe nga 1 në secilën Drejtori Rajonale. Megjithëse VKM nr. 673, datë 22.11.2017"*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*" parashikonte kalimin e specialistëve IT tek AKSHI brenda datës 31.12.2017, ky proces nuk është realizuar për specialistët IT të SHSSH-së. Aktualisht, problematikat teknike raportohen nga Drejtoritë Rajonale te specialistët IT të SHSSH-së, të cilët më pas i përcjellin pranë strukturave IT të AKSHI-t pranë MSHMS-së, duke krijuar hallka shtesë koordinimi dhe risk për vonesa në trajtimin e problematikave teknike.

Procedura e rekrutimit
Nëpërmjet VKM-së nr. 23, datë 13.01.2022, punonjësit e SHSSH kanë kaluar nga shërbimi civil në marrëdhënie pune në bazë të Kodit të Punës. Që nga ky moment, nuk rezulton që SHSSH-ja të ketë miratuar një procedurë të shkruar për rekrutimin e punonjësve, në kundërshtim me nenin 20 dhe 22 të Ligjit "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i

[4] "*Skenarë: Rishikimi funksional i Shërbimit Social Shtetëror*", UNICEF, IDRA, MSHMS, SHSSH, mars 2025, fq. 3.

ndryshuar, dhe pikat 3.1 dhe 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Njësitë publike duhet të organizojnë veprimtarinë jo vetëm bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, por edhe në procedura të shkruara dhe miratuara nga vetë titullarët e tyre. Miratimi i një procedure të shkruar do të garantonte uniformitetin në kryerjen e procesit të rekrutimit dhe gjurmën e auditimit për këtë proces.

Procese gjyqësore mbi marrëdhëniet e punës dhe shpenzimet nga vendimet gjyqësore
Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezulton që SHSSH aktualisht ka në proces 14 procese gjyqësore të lidhura me marrëdhëniet e punës, nga të cilat 8 të iniciuara nga ndërprerje të marrëdhënies së punës gjatë periudhës së auditimit 2020 – 2025 dhe 6 procese të iniciuara nga ndërprerje të marrëdhënies së punës përpara kësaj periudhe.
Gjatë periudhës së auditimit, vendimet gjyqësore të formës së prerë (dhe 1 rast vendim me ekzekutim të përkohshëm) të lidhura me marrëdhëniet e punës janë sipas rasteve të listuara më poshtë:

Nr.	Punonjësi	Pozicioni	Akti i lirimit (nr. akti/ datë)	Vlera (në lekë)
1	A. H.	Specialist (Mjek) pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Vlorë	2072/2, 3.12.2018	**4,060,301** *Në proces ekzekutimi i këstit të fundit 1,000,000 lekë*
2	B. D.	Specialist pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier	56/3, 20.01.2014 56/4, 27.02.2014	**444,900**
3	M. L.	Specialist Drejtoria Rajonale e SHSSH Lezhë		**452,000**
4	S. K.	Specialist IT pranë Sektorit të Kontrollit të NE në Drejtorinë e Kontrollit të Pagesës së NE & PAK	493, 26.10.2023	**1,727,813** *Vendim me ekzekutim të përkohshëm*
5	L. Ç.	Specialiste (Mjeke) DRSHSSH Durres dhe transferuar si specialiste fizioterapiste në Qendrën e Zhvillimit Durrës.	28/1, 18.02.2013	**1,423,243.64**
TOTALI				**8,108,258.64**

Vlera prej **8,108,258 lekë** konsiderohet shpenzim pa efektivitet, vlerë e cila ka risk të rritet për shkak të proceseve gjyqësore që janë ende në gjykim, të lidhura me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për të cilët nuk ka ende një vendim të formës së prerë.

Rregullorja e brendshme
Sipas përcaktimit në pikën 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, struktura e njësisë duhet të përfshijë rregulla të qarta që përcaktojnë ndarjen e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësive, e cila duhet të reflektohet në një dokument të shkruar ose rregullore të brendshme.
Rregullorja e brendshme e SHSSH-së, e miratuar nëpërmjet Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 856 prot., datë 30.05.2020, ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorive përkatëse, por nuk ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorëve pjesë të tyre, si dhe të punonjësve specifikë (drejtori i drejtorisë, përgjegjësit e sektorit dhe specialistët).
SHSSH ka miratuar Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorive Rajonale të SHSSH nr. 353 prot., datë 13.02.2017. Në Kreun X të kësaj rregullore përcaktohet struktura organizative e DR SHSSH, si dhe detyrat për punonjësit e Sektorit të Shërbimeve Shoqërore dhe Sektorit të Pranueshmërisë në DR SHSSH, por nuk ka asnjë përcaktim mbi Sektorët për vlerësimin Biopsikosocial ose Sektorët për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar (sipas rastit pasi DRSHSSH të ndryshme kanë sektorë të ndryshëm), të përcaktuar në strukturat organizative të Drejtorive Rajonale sipas Urdhrave përkatës të Kryeministrit. Kjo rregullore nuk rezulton të ketë pësuar ndryshime që nga miratimi fillestar, pavarësisht hyrjes në fuqi të akteve ligjore/ nënligjore të reja dhe/ ose përditësimit të akteve ekzistuese. P.sh, nëpërmjet VKM-së nr. 855, datë 26.12.2024 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 597, datë*

04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave...të përfitimit të ndihmës ekonomike...", në Kreun II, është shtuar pika 2.1 me përmbajtje "*Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, për familjet që aplikojnë për herë të parë, kryen verifikimin në terren pas vlerësimit social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror*". Pavarësisht sa më sipër, ky detyrim nuk rezulton të jetë pasqyruar si dhe të jetë detajuar në rregulloren e brendshme të Drejtorive Rajonale.
Një problematikë tjetër evidentohet lidhur me IPSH-të në bashkëvarësi të SHSSH-së dhe NJVV-ve, në total 17 IPSH sipas të dhënave të vëna në dispozicion, ku përfshihen institucione rezidenciale, kjo pasi:
Në nenin 64, gërma j, të Ligjit nr. 135/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë të miratojë strukturën, organikën e kategoritë/ klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive të institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë. Paralelisht, në Kreun II, pika 2, gërma gj, të VKM-së nr. 135, datë 07.03.2018 "*Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror*", përcaktohet se Shërbimi Social Shtetëror miraton rregulloret e institucioneve kombëtare të përkujdesjes shoqërore në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Pra, të dyja këto dispozita përcaktojnë kompetencë të secilës prej palëve (SHSSH, NJVV) për hartimin dhe miratimin e rregulloreve për IPSH-të e varësisë, por nuk ka asnjë përcaktim lidhur me *IPSH-të në bashkëvarësi*. Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të rregulloreve të brendshme të miratuara për funksionimin e SHMFF Vlorë dhe SHMFF Korçë (*ish-Shtëpitë e Fëmijës, ndryshuar emërtimi në vitin 2025*), por nga SHSSH është bërë me dije se për këto institucione është përgjegjësi e njësive të vetëqeverisjes vendore të nxjerrë aktet përkatëse rregullative. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se:

- Rregullorja e brendshme për Shtëpinë e Foshnjës "Lulet e Vogla" Korçë është miratuar nga vetë Drejtuesi i IPSH-së me nr. 2, datë 05.01.2015, pra as nga Kryetari i Bashkisë Korçë dhe as nga SHSSH.
- Rregullorja e brendshme për Shtëpinë e Foshnjës 0-5 vjeç Vlorë mban nr. 119 prot., datë 05.06.2019, por nuk rezulton të jetë miratuar as nga Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe as nga SHSSH.

Menaxhimi i riskut
SHSSH ka hartuar dhe miratuar regjistrat e riskut për periudhën objekt auditimi, si më poshtë: Për vitin 2020-2024, administrohen regjistrat përkatës të riskut për secilën prej drejtorive. Për vitin 2025, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së ka miratuar regjistrin e riskut për të gjitha Drejtoritë e SHSSH me nr. 6371 prot., datë 28.08.2025, si dhe administrohen regjistrat përkatës të riskut për secilën prej drejtorive.
Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 335, datë 22.10.2024 është ngritur grupi i punës për hartimin e treguesve kryesor të riskut të sistemeve elektronike të NE, PAK dhe SHKSH. Grupi i punës është angazhuar në evidentimin e risqeve dhe indikatorëve që lidhen me veprimtarinë e SHSSH-së dhe që kryhen nëpërmjet sistemeve elektronike të sipërcituara. Në këtë dokument, janë identifikuar risqet që burojnë nga sistemet elektronike, por nuk pasqyrohet sipas formatit të përcaktuar në Aneksin II të Udhëzimit të MF nr. 16, datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*" (i shfuqizuar nga Udhëzimi i MF nr. 16, datë 31.12.2024, por në fuqi në momentin e miratimit), pasi në asnjë rast nuk janë përcaktuar niveli i riskut para kontrollit, kontrollet ekzistuese, risqet pas kontrolleve ekzistuese, nevoja për kontrolle të mëtejshme, veprime për të adresuar boshllëqet, zotëruesit e risqeve, komponentë të domosdoshëm për të përcaktuar hapat e ndërmarra nga njësia publike jo vetëm për identifikimin e risqeve, por edhe menaxhimin dhe mitigimin e tyre.

Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në drejtimet përkatëse janë trajtuar problematikat e konstatuara lidhur me aktivitetet e kontrollit në skemën e ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat paraqesin risk në arritjen e objektivave dhe përmbushjen e plotë të detyrimeve ligjore institucionale të SHSSH-së.

Shërbimi Social Shtetëror nuk rezulton të ketë miratuar gjurmët e auditimit, sipas Aneksit 3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për proceset kryesore të lidhura me skemën e ndihmës ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kundërshtim me nenin 16, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, dhe pikën 3.3.2 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Gjurma e auditimit shërben si instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së proceseve nga fillimi në fund dhe në anën tjetër ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë apo ndërmjet njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Drejtoria e Komisionimit të PAK-ut nuk administronte të dhëna mbi aplikimet në KMCAP niveli i parë dhe KMCAP epror, si dhe në KSHA për skemën biopsikosociale, lidhur me paraqitjen e kërkesës/ aplikimit dhe datën e komisionimit, duke pamundësuar gjurmën e auditimit për të kryer testimet e nevojshme mbi respektimin e afateve të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse. Kryerja e këtij testimi të përputhshmërisë u realizua nëpërmjet nxjerrjes manuale të të dhënave nga kryqëzimi i regjistrave përkatës për disa muaj specifikë. Përpos mungesës së gjurmës së auditimit, kjo situatë pamundëson edhe për vetë SHSSH-në kryerjen e aktiviteteve të kontrollit përkatëse lidhur me arritjen e objektivave (në këtë rast respektimin e afateve procedurale për trajtimin e aplikimeve/ kërkesave/ ankesave), për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e situatës.

Lidhur me procedurat për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, nga auditimi u konstatua se të gjitha procedurat e prokurimeve të përzgjedhura për auditim ishin të painventarizuara dhe të paarkivuara, duke përbërë risk për dëmtimin apo humbjen e dokumentacionit me ndërrimin e stafit të angazhuar në procedurat e prokurimit publik, në mospërputhje me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Informacioni dhe komunikimi

Lidhur me këtë komponent, rezulton se SHSSH-ja ka përditësuar vazhdimisht faqen zyrtare të institucionit me të dhëna e publikime, të cilat orientojnë dhe informojnë publikun mbi aktivitetin institucional. Informacioni dhe dokumentacioni i komunikuar nëpërmjet faqes zyrtare të SHSSH-së përfshin, pa u kufizuar, programin e transparencës, informacion rreth ndihmës ekonomike, skemës PAK dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror, publikime të ndryshme si raporte, buletine, projekte e bashkëpunime, si dhe të dhëna të hapura lidhur me aktivitetin kryesor brenda fushëveprimit të institucionit. Në faqen zyrtare ka dhe seksionin "Kontakt" për të mundësuar komunikim nga publiku, si dhe adresën zyrtare të institucionit.

Monitorimi

Nëpërmjet vetëvlerësimit, përdoruesit e buxhetit kanë nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive. Çdo NA duhet të përgatisë Deklaratën e Cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm, në të cilën ai/ ajo merr përsipër përgjegjësinë për menaxhimin efikas të burimeve financiare dhe jofinanciare në dispozicion të njësisë dhe pranon se sistemi i kontrollit të

brendshëm siguron përdorimin e ligjshëm dhe efikas të burimeve. Çdo vit, NA duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te NPA në MFE, kërkesë e nenit 18, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010. Përmes këtij raporti, subjektet e raportimit raportojnë pranë DH/MFKK për funksionimin e sistemit të MFK-së sipas komponentëve të tij.
Nga auditimi u konstatua se Shërbimi Social Shtetëror nuk ka hartuar, miratuar dhe paraqitur (i) pyetësorët e vetëdeklarimit, (ii) deklaratën e cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe (iii) raportin vjetor të cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, sipas udhëzimeve përkatëse të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në kundërshtim me nenin 18 dhe 24, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, pikën 3.5 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe Udhëzimet e Ministrit të Financave (i) nr. 28, datë 15.12.2011 (i shfuqizuar në 2024) dhe (ii) nr. 2, datë 26.01.2024 "*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike*".

Lidhur me sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme pranë Shërbimit Social Shtetëror ka paraqitur observacionet, si më poshtë:
Pretendimet e subjektit:
1.Pika 5 e VKM-së nr. 23, datë 13.01.2022 përcakton se procedura e rekrutimit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve kryhet sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale. Për sa më sipër, kompetenca i është atribuuar ministrit dhe jo SHSSH-së. Deri në momentin e auditimit, udhëzimi përkatës nuk rezulton i miratuar nga ministria, megjithëse SHSSH ka paraqitur propozimet përkatëse. Për rrjedhojë, mungesa e një procedure të veçantë të miratuar nga SHSSH nuk mund të konsiderohet mospërmbushje e detyrimeve ligjore të institucioneve.
2. Vlerat e paguara në zbatim të vendimeve gjyqësore nuk mund të konsiderohen si shpenzime pa efektivitet, pasi ekzekutimi i tyre përbën detyrim ligjor të pashmangshëm dhe moszbatimi do të sillte kosto shtesë për buxhetin e shtetit në formën e kamatëvonesave dhe tarifave përmbarimore. SHSSH ka ushtruar të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e interesave financiare të shtetit, ndërsa për dy raste proceset gjyqësore vijojnë ende dhe nuk ekziston një vendim përfundimtar i formës së prerë. Katër nga pesë rastet e trajtuara lidhen me vendimmarrje të viteve 2013, 2014 dhe 2018, ndaj administrata aktuale nuk ka pasur mundësi të ndikojë në shkaqet që kanë sjellë pasojat financiare, por vetëm ka administruar detyrimet e krijuara. SHSSH ka ndërmarrë masa për unifikimin e kontratave individuale të punës dhe forcimin e procedurave të dokumentimit të dosjeve të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, me qëllim reduktimin e riskut të humbjes së proceseve gjyqësore dhe minimizimin e kostove financiare në të ardhmen.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
1.Grupit të auditimit nuk i janë vendosur në dispozicion, sikurse nuk janë bashkëlidhur në këtë observacion, propozimet konkrete të kryera për procedurën e rekrutimit të punonjësve. Pavarësisht përcaktimit në VKM-në nr. 23/2022, neni 20 i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, përcakton se titullarët e njësive janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit, duke përfshirë politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore. Në pikën 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, përcaktohet se politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve. Në nenin 22 të këtij ligji përcaktohet gjithashtu se titullarët e njësive të sektorit publik miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme se risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, ndër të tjera sa i përket rregullave për menaxhimin e burimeve njerëzore.
Mungesa e miratimit të një udhëzimi nga ministria përgjegjëse nuk përjashton përgjegjësinë e titullarit të SHSSH-së për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm, përfshirë miratimin e politikave dhe procedurave të nevojshme për menaxhimin e burimeve njerëzore, në zbatim të kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Për sa më sipër, observacioni nuk merret parasysh.
2. Konstatimi dhe rekomandimi i adresuar nuk lidhen me mosndjekjen e mjeteve ligjore nga institucioni për mbrojtjen e interesave financiare të shtetit apo me detyrimin për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por me nevojën për forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e procedurave të dokumentimit të procesit të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Këto masa synojnë krijimin e një pozite më të favorshme për institucionin në proceset gjyqësore, minimizimin e riskut të humbjes së tyre dhe reduktimin e kostove financiare që burojnë nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Duke vlerësuar masat e ndërmarra për unifikimin e kontratave individuale të punës dhe forcimin e dokumentimit të dosjeve përkatëse, mbetet e nevojshme vijimi i përpjekjeve për forcimin e kontrolleve parandaluese, me qëllim që fondet buxhetore të

akorduara për SHSSH të përdoren në mënyrë sa më efektive për realizimin e misionit dhe objektivave të institucionit, dhe jo për mbulimin e kostove të proceseve gjyqësore të lidhura me marrëdhëniet e punës.

Veprimtaria e Njësisë së Auditit të Brendshëm

Sektori i Auditimit të Brendshëm (SAB) është ngritur dhe funksionon në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, si dhe kërkesat e standardit 1100 "Pavarësia dhe Objektiviteti" të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.

Referuar Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të SHSSH-së nr. 856 prot., datë 30.05.2020, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka ndër të tjera përgjegjësinë për hartimin e planeve strategjike dhe vjetore të auditimit, vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, formulimin e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së institucionit, si dhe kryerjen e funksioneve të njësisë përgjegjëse për sinjalizimin.

Struktura e Sektorit të Auditimit të Brendshëm përbëhet nga 3 punonjës, të cilët gjatë gjithë periudhës së auditimit rezultojnë me mbi 5 vite eksperiencë pune. Gjatë vitit 2025, dy prej punonjësve kanë qenë në proces certifikimi si audituesë të brendshëm në sektorin publik. Lidhur me zhvillimin profesional të vazhdueshëm, u konstatua se gjatë viteve 2022 dhe 2023 dy punonjës të sektorit nuk kanë marrë pjesë në trajnimet e planifikuara, ndërsa për vitet e tjera ky detyrim rezulton i përmbushur.

Planifikimi dhe miratimi i planeve strategjike të auditimeve

Karta e Auditimit të Brendshëm është miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 224, nr. 1940 prot., datë 03.12.2019, duke përcaktuar statusin organizativ, misionin, objektivat, kompetencat dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në SHSSH mbulon me auditim grup - subjektet si më poshtë: i. Drejtori brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror (5 drejtori); ii. Drejtori Rajonale të SHSSH (12 drejtori); iii. Shtëpi Fëmije (3); iv. Qendra Zhvillimi (2); v. Shtëpi për të Moshuar (3); vi. Qendër Ditore për të Moshuarit (1); vii. Qendra për persona të dhunuar, të trafikuar dhe tranzitore (3). Shërbimi Social Shtetëror monitoron dhe veprimtarinë e 17 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të pushtetit lokal. Totali i subjekteve për auditim është gjithsej 46.

Plani strategjik dhe vjetor i auditimit hartohet mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publike dhe përcakton veprimtarinë audituese për një periudhë trevjeçare. Nga verifikimi i planeve strategjike rezulton se është përdorur matrica e riskut, ku janë identifikuar fushat me risk, probabiliteti i ndodhjes dhe ndikimi i pritshëm, si dhe është respektuar parimi që subjektet të auditohen jo më rrallë se një herë në pesë vjet. Megjithatë, nga auditimi i planeve vjetore konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi nuk janë planifikuar dhe realizuar auditime në fushën e teknologjisë së informacionit, pavarësisht se SHSSH administron tre sisteme informatike kryesore: NE, PAK dhe SHKSH.

Gjatë periudhës 2020–2025, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka realizuar auditimet e planifikuara sipas planeve vjetore të miratuara dhe të rishikuara, me një volum prej 5 deri në 9 auditime në vit. Auditimet kanë evidentuar problematika kryesisht në fushat e buxhetit, prokurimeve, administrimit të pronës dhe pasurisë, si dhe në sistemet e kontrollit të brendshëm. Numri i rekomandimeve të adresuara ka varuar nga 51 në 82 në vit, me një mesatare prej rreth 10 rekomandimesh për auditim.

Megjithëse rekomandimet janë pranuar gjerësisht nga strukturat e audituara, niveli i zbatimit të tyre paraqet tendencë rënëse, nga 70–76.5% në vitet 2020–2021 në 55.6% gjatë vitit 2024 dhe 35.3% në vitin 2025. Paralelisht, planifikimi i auditimeve është ndikuar edhe nga kufizimet

në burimet njerëzore të njësisë së auditimit të brendshëm, duke sjellë në disa raste reduktim të numrit të auditimeve të planifikuara fillimisht.

Viti	Auditime të realizuara	Rekomandime të adresuara	Niveli i zbatimit të rekomandimeve (%)	Problematikat kryesore të konstatuara (%)
2020	6	57	70.0	Buxheti (42%), Kontrolli i brendshëm (26%), Prokurimet (14%), Administrimi i pasurisë (12%)
2021	7	51	76.5	Administrimi i pasurisë (41%), Kontrolli i brendshëm (23%), Prokurimet (13.7%), Sistemi i pagave (13.7%)
2022	7	75	62.6	Kontrolli i brendshëm (48%), Administrimi i pasurisë (28%), Prokurimet (16%)
2023	7	79	65.8	Administrimi i pasurisë (26.5%), Buxheti (25.3%), Kontrolli i brendshëm (21.5%), Prokurimet (17.7%)
2024	5	63	55.6	Prokurimet (36.5%), Administrimi i pasurisë (28.6%), Buxheti (22.2%)
2025	9	82	35.3	Prokurimet (42.6%), Buxheti (23.1%), Raportimi financiar dhe kontabiliteti (15.8%), Aktivet e qëndrueshme (12.1%)

Nga auditimi u konstatua se:

- Sa i përket strukturave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social, aktiviteti i Drejtorisë së Financës dhe Statistikës është audituar për herë të fundit në vitin 2021. Pavarësisht se është planifikuar për t'u audituar edhe në vitet 2022, 2023 dhe 2025, me rishikimin e planit gjatë vitit Drejtoria e Financës dhe Statistikës është hequr nga plani. Auditimi i (i) Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe (ii) Drejtorisë së Pagesave NE & PAK është planifikuar dhe realizuar për herë të fundit në vitin 2020, ndërkohë që nuk është planifikuar asnjëherë nga viti 2021 e në vijim. Drejtoria e Komisionimit të PAK është planifikuar për t'u audituar në vitin 2020, por me rishikimin e planit gjatë vitit është hequr, duke mos u planifikuar më asnjëherë përgjatë viteve periudhë auditimi. Auditimi i aktivitetit të Drejtorisë së Shërbimit Social nuk rezulton të jetë planifikuar dhe realizuar asnjëherë përgjatë periudhës së auditimit.
- Njësia e Auditit të Brendshëm pranë SHSSH-së nuk ka identifikuar si fusha me risk, nuk ka planifikuar dhe nuk ka kryer *asnjëherë* përgjatë periudhës së auditimit 2020 – 2025 një angazhim auditimi mbi përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit për ndihmën ekonomike dhe veprimtarinë e zbatimit të legjislacionit në njësitë dhe institucionet në varësi të SHSSH-së dhe pranë pushtetit vendor sa i përket ndihmës ekonomike, në mospërputhje me pikën 1 të *Metodologjisë së Kontrollit të Pagesave të Ndihmës Ekonomike*, të miratuar nëpërmjet VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021.

2.3. Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit

Viti 2025

Programimi i PBA-së 2025–2027 dhe programimi i buxhetit vjetor 2025

Shërbimi Social Shtetëror është një nga programet buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe, si i tillë, në kuadër të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, ka paraqitur kërkesat buxhetore për fazën e dytë të PBA-së, në përputhje me tavanet orientuese të miratuara dhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave.

Kërkesat buxhetore janë hartuar mbi bazën e analizës së nevojave për përmbushjen e misionit institucional, realizimin e objektivave strategjikë dhe garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve sociale, duke reflektuar:

- strukturën organizative të institucionit (administrata qendrore, zyrat rajonale dhe institucionet e përkujdesit shoqëror);
- mbështetjen financiare për individët dhe familjet në nevojë;
- kostot operative dhe administrative për funksionimin normal të institucionit;
- prioritetet e politikave sociale të përcaktuara nga ministria përgjegjëse.

Programimi i PBA-së 2025-2027 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2025

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* të ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 7 datë 28.02.2018, *"Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm".*

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për "*Fondin e pagave & sigurimeve shoqërore"* (llog 600 dhe 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve dhe strukturës së miratuar për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja për shpenzime të tjera korrente (llog 602-606) është bazuar në kërkesat e institucioneve të varësisë së këtij institucioni, tavaneve të miratuara nga Ministria e Financave dhe limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse si dhe realizimin e pritshëm të vitit.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2025-2027

Nga auditimi u evidentua se, në fazën e parë strategjike të përgatitjes së PBA-së 2025–2027, Shërbimi Social Shtetëror nuk ka paraqitur kërkesa buxhetore, por ato janë përfshirë dhe paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni prej të cilit varet.

Për rrjedhojë, grupi i auditimit mori në analizë kërkesat buxhetore të fazës së parë të PBA-së 2025 – 2027, të paraqitura nga MSHMS në nivel llogarish për programin buxhetor 10430 "*Përkujdesje Sociale*", të cilat në fund të fazës së I-rë, rezultojnë si në tabelën e më poshtë:

Tabela nr. 12 "Fondet buxhetore të parashikuara për Përkujdesjen Sociale në fund të fazës së I-rë të PBA 25-27, në nivel llogarish

Në mijë lekë

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	Shpenzimet e parashikuara		
	2025	2026	2027
Totali shpenzimeve të Programit	**30,198,550,000**	**30,496,770,000**	**30,946,770,000**
600 - Paga	**721,190,000**	**721,190,000**	**721,190,000**
601 - Sigurime Shoqërore	**119,740,000**	**119,740,000**	**119,740,000**
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	**355,600,000**	**355,600,000**	**355,600,000**
606 - Trans per Buxh. Fam. & Individ	**28,850,000,000**	**29,200,000,000**	**29,650,000,000**
230 - Kapitale të Patrupëzuara	**10,000,000**	**0**	**0**
01 - Nga Buxheti	10,000,000	0	0
02 - Financim i huaj - Grant	0	0	0
231 - Kapitale të Trupëzuara	**142,020,000**	**100,240,000**	**100,240,000**
01 - Nga Buxheti	92,020,000	50,240,000	50,240,000
02 - Financim i huaj - Grant	50,000,000	50,000,000	50,000,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të VKM nr.184/2024 dhe të dhënave të publikuara në faqen e MF.[5]

Nga tabela më sipër rezulton se, në përfundim të fazës së parë të planifikimit buxhetor afatmesëm, për vitin 2025 rreth 99.5% e shpenzimeve totale përbëhet nga shpenzime korrente, nga këto, rreth 3% përfaqësojnë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (llogaritë 600 dhe 601).

Transfertat (llogaria 606) zënë rreth 96% të totalit të shpenzimeve, duke zënë peshën kryesore të shpenzimeve të programit buxhetor. Ndërkohë, shpenzimet kapitale paraqiten në nivel, rreth 0.5% të totalit të shpenzimeve.

[5] Aneksi-nr.1-13_Ministria-e-Shendetesise-dhe-Mbrojtjes-Sociale-PBA-2025-2027-Faza-I.xlsx

Sipas VKM nr. 184, datë 27.03.2024 "*Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027*", tavanet përgatitore për programin 10430 "*Përkujdesje Sociale*", në nivel shpenzimesh korrente dhe kapitale paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 13 "Fondet buxhetore të Përkujdesjes Sociale të miratuara për fazën e I-të të PBA 25-27"

Në lekë

Programi	Emri i prog.	Shpenzimet 2025			Shpenzimet 2026		
		Korrente	Kapitale	Totali	Korrente	Kapitale	Totali
10430	**Përkujdesi Social**	30,046,530	152,020	30,198,550	30,396,530	100,240	30,496,770

Burimi: VKM nr. 184/2024, Përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga dy tabelat më sipër, konstatohet se në paraqitjen e shpenzimeve nga MSHMS për programin 10431, janë respektuar tavanet përgatitore të PBA 2025-2027.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II-të të PBA 2025-2025

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 janë miratuar me VKM nr. 535 datë 12.08.2024 *"Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027"*, të cilat në nivel programi për Përkujdesjen Sociale (10430) paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 14 "Fondet buxhetore të Përkujdesjes Sociale të miratuara për fazën e II-të të PBA 25-27"

Në lekë

Programi	Shpenzimet 2025			Shpenzimet 2026			Shpenzimet 2027		
	Korrente	Kapitale	Totali	Korrente	Kapitale	Totali	Korrente	Kapitale	Totali
10430	30,046,530	152,020	30,198,550	30,396,530	100,240	30,496,770	30,846,530	100,240	**30,946,770**

Burimi: VKM nr. 535/2024, Përpunuar nga grupi i auditimit.

Me shkresën nr. 5893 prot., datë 31.07.2024, Drejtoresha e Shërbimit Social Shtetëror zj. R.Xh. ka përcjellë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS, këtu e në vijim) kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, brenda afatit të parashikuar në VKM nr. 22, datë 17.01.2024 *"Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2024",* të cilat në nivel produkti, krahasuar me tavanet përgatitore, paraqiten sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga auditimi konstatohet se SHSHS, për vitin 2025, ka paraqitur kërkesa buxhetore vetëm për shpenzimet korrente (llogaritë 600, 601, 602 dhe 606), në total prej 29,207,100 lekë, ose 749,430,000 lekë më pak se totali i shpenzimeve korrente të parashikuara sipas tavaneve përfundimtare të miratuara me VKM nr. 22/2024.

Për shpenzimet kapitale (investime) janë paraqitur kërkesa konkretisht në relacionin nr. 5893/1, datë 31.07.2024, me objekt *Mbi hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025–2027 (Faza II)*, është përcaktuar se nevojat për investime për shtrirjen e pilotimit të skemës së vlerësimit bio-psiko-social të PAK dhe për përmirësimin e kushteve në IPSH-të në varësi të SHSHS, parashikohen në shumën 157,883,581 mijë lekë, të ndara si më poshtë:

- Blerje pajisje zyre për IPSH 9,731 mijë lekë;
- Blerje automjeti për Drejtoritë Rajonale 5,100 mijë lekë;
- Blerje pajisje zyre për Drejtoritë Rajonale 9,590 mijë lekë;
- Blerje ambiente për zyra për Drejtoritë Rajonale 9,860 mijë lekë;
- Kamera dhe sistem alarmi për institucionin 16–18 vjeç, Shkodër 300 mijë lekë;
- Rikonstruksion godine për IPSH 49,000 mijë lekë;
- Rikonstruksion i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollore, Tiranë 157,800,000 mijë lekë.

Në nivel llogarish, krahasimi ndërmjet kërkesave buxhetore të paraqitura në fazën teknike dhe tavaneve përfundimtare paraqitet si vijon:

- Llogaria 600 *"Paga*" paraqitur më tepër në shumën 129,932,000 lekë;
- Llogaria 601 "*Sigurime shoqërore*" paraqitur më tepër në shumën 20,997,000 lekë;
- Llogaria 602 "*Blerje mallrash dhe shërbime*" paraqitur më tepër në shumën 6,332,000 lekë;

- Llogaria 606 "*Transferta Ndihma ekonomike"* paraqitur më pak në shumën 445,761,000 lekë;
- Llogaria 606 "*Pagesa e PAK*" paraqitur më pak në shumën 147,248,000 lekë;
- Llogaria 606 "*Bonusi i bebes*" paraqitur më pak në shumën 301,000,000 lekë;
- Llogaria 606 "*Gratë e papuna"* paraqitur më pak në shumën 6,000,000 lekë;
- Llogaria 606 "*Transferta të individëve SHSHS"* paraqitur më pak në shumën 100,000 lekë.

Sa më sipër, konstatohet një rishpërndarje brenda kategorisë së shpenzimeve korrente, ku tejkalimet në llogaritë e personelit (600 dhe 601) si dhe në mallra e shërbime (602) shoqërohen me ulje të kërkesave/ parashikimeve në transfertat sociale (606).

Duke qenë se kërkesat buxhetore të paraqitura nga SHSHS nuk ishin në përputhje me tavanet përfundimtare të miratuara nga Ministria e Financave (MF), është dërguar shkresa nr. 5397/2, datë 29.08.2024, me objekt: "*Dërgohet rishikimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027 (Faza II), sipas tavaneve të MFE-së",* ku kërkesat e paraqitura janë në respektim të tavaneve buxhetore.

Në lidhje me investimet kapitale, pavarësisht se nga SHSSH nuk janë paraqitur kërkesa e detajim ne lidhje me llogarinë 231, në PBA faza I-rë dhe e II-të nga MSHMS, rezultojnë te parashikuara shumet për produktet si në vijim:

Kodi	Emri produktit	Shuma
18BC009	Rikonstruksion i godines shtepia e femijes "Zyber Hallulli" Tirane	90,000,000
18BC010	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e godines shtepia e femijes "Zyber Hallulli" Tirane	800,000
18BC205	TVSH e asistences teknike per projektin "Perfshirja sociale" IPA II	1,220,000
18BC207	Projekti IPA per mbeshtjetje per te permiresuar organizimin dhe qeverisjen e institutit	50,000,000
Totali		**142,020,000**

Burimi: MF, PBA faza I dhe II, përpunuar nga grupi i auditimit.

Faza e III-të e PBA 2025-2027

Me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 44, datë 28.02.2025, është miratuar PBA 2025–2027 i rishikuar (Faza III), në përputhje me tavaneve buxhetore të përcaktuara në Ligji nr. 115/2024n"*Për Buxhetin e vitit 2025"*.

Për programin buxhetor 10430 "*Përkujdesi Social*" paraqitjet në nivel llogarish rezultojnë si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 15: "Shpenzime buxhetore të programit 10430, PBA 2025-2027, Faza III-të"

Llogaria Ekonomike	Parashikimi buxhetor		
	2025	2026	2027
Totali shpenzimeve të Programit	**27,502,528,000**	**27,605,240,000**	**28,150,240,000**
600 - Paga	804,450,000	804,450,000	804,450,000
601 - Sigurime Shoqërore	136,540,000	136,540,000	136,540,000
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	355,600,000	259,010,000	259,010,000
603 - Subvencione	0	0	0
606 - Trans per Buxh. Fam. & Individ	25,950,000,000	26,200,000,000	26,850,000,000
231 - Kapitale të Trupëzuara	**255,938,000**	**205,240,000**	**100,240,000**
01 - Nga Buxheti	*204,718,000*	*155,240,000*	*50,240,000*
02 - Financim i huaj - Grant	*50,000,000*	*50,000,000*	*50,000,000*
04 - TVSH, Detyrim Doganor	*1,220,000*	*0*	*0*

Burimi: MF. Përpunuar nga grupi i auditimit.[6]

Nga tabela më sipër rezulton se totali i shpenzimeve korrente paraqitet në shumën 27,246,592,000 lekë, ndërsa shpenzimet për investime paraqiten në shumën 255,938,000 lekë. Në fazën e tretë të PBA, dhe në kërkesat buxhetore të paraqitura nga MSHMS, për programin 10430, nuk rezulton të jenë bërë parashikime në lidhje me shpenzimet për investime, pavarësisht paraqitjes së parashikimit në dy fazat e para te PBA-së.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2025

[6] Ministria-e-Shendetesise-dhe-Mbrojtjes-Sociale-PBA-2025-2027-Faza-III.xlsx

Me Ligjin nr. 115/2024, datë 19.12.2024, *Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*, shpenzimet buxhetore për programin 10430 *Përkujdesi Social*, sipas Tabelës nr. 1 të tij, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Programi	Emri I prog.	Shpenzimet 2025		
		Korrente	Kapitale	Totali
10430	**Përkujdesi Social**	27,246,590	255,938	27,502,528

Burimi: Ligji nr. 115/2024 "*Për buxhetin e vitit 2025*"

Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente të SHSSH është bërë me shkresën nr. 337 prot., datë 21.01.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, "*Dërgohet plani i buxhetit për vitin 2025*", ku në nivel produkti paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga auditimi konstatohet se detajimi fillestar i shpenzimeve korrente për vitin 2025 është bërë në përputhje me tabelën nr. 1 të Ligjit të Buxhetit për vitin 2025, "*Buxheti 2025 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore*".

Buxheti i vitit 2025 i parashikuar për shpenzimet totale buxhetore (shpenzime korrente dhe kapitale) ka pësuar ndryshime, që prej fazës së Projekt Buxhetit të vitit 2025 deri në ligjin nr. 115/2024 "*Për buxhetin e vitit 2025",* i cili ka ndryshuar më pas me 4 akte normative (AN) të cilat paraqiten si më poshtë:

- Akti normativ nr. 3, datë 29.04.2025;
- Akti Normativ nr. 6, datë 11.06.2025;
- Akti Normativ nr. 10, datë 08.10.2025 dhe
- Akti Normativ nr. 11, datë 19.12.2025.

Ndryshimet e shpenzimeve buxhetore, nga Ligji nr. 115/2024 deri në planin përfundimtar sipas akteve normative apo transfertave të ndryshme, paraqiten në tabelën nr. 1 të Aneksit nr. 1. Në mënyrë analitike, ndryshimet kanë ardhur nga:

1. Më datë 06.01.2025, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është dërguar email drejt SHSHS, ku është kërkuar përgatitja e formularit F3 "*Formulari i Konceptimit të Projektit të Investimit*" (FKPI), sipas detajimit të përcaktuar nga MSHMS, si institucion varësie, si më poshtë:

Institucioni	Llog	Kodi projektit	Emërtim I projektit	Vlera totale e projektit	2025	2026	2027
Admin Qendrore SHSSH	231	19AB001	Pajisje të ndryshme për godinat e SHSHS	4,362,014	4,362,014		

Bazuar në sa më sipër, SHSHS ka përgatitur Formularin F3 *"Formulari i Konceptimit të Projektit të Investimit" (FKPI)*, nga ku rezulton se formulari i konceptimit është hartuar në muajin janar, ndërkohë që sipas përmbajtjes së tij, koha e parashikuar për fillimin e projektit është muaji shkurt 2025. Ky afat i shkurtër ndërmjet hartimit dhe fillimit të projektit nuk garanton kohën e nevojshme për kryerjen e analizave të plota teknike, ekonomike dhe të fizibilitetit, si dhe për ndjekjen e procedurave të miratimit në kuadër të planifikimit buxhetor afatmesëm, duke treguar mangësi në fazën e konceptimit dhe planifikimit fillestar të investimit.

Nga verifikimi mbi këtë kod investimi rezultoi se:

- Në fazën e parë të PBA 2025–2027, për vitin 2025 shuma e parashikuar është 0 lekë;
- Gjithashtu ne fazën e II-të të PBA 2025–2027, për vitin 2025 shuma e parashikuar është 0 lekë;
- Në Fazën e III-të të PBA, projekti me kod 19AB001 "*Pajisje të ndryshme për qendrat SHSHS*" paraqitet në shumën 4,362,014 lekë.
- Ndërkohë, në listën e investimeve publike me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit, përkatësisht në Listën e Projekteve të Investimeve Publike 2025–2027 [7]të Projekt Buxhetit të Vitit 2025, në lidhje me administratën e SHSHS paraqiten dy projekte të reja, konkretisht:

[7] Lista-e-Projekteve-te-Investimeve-Publike-2025-2027.xlsx

◎ “Projektim dhe preventiva për ndërhyrje në godina të SHSHS-ve”, me vit fillimi 2025 dhe vit përfundimi 2026, në shumën totale 10,000 mijë lekë, e parashikuar për vitin 2025;
◎ “Pajisje të ndryshme për godinat e SHSHS”, projekt i ri me vit fillimi 2026 dhe përfundimi 2027, në shumën totale 70,240 mijë lekë, për të cilin për vitin 2025 janë parashikuar 0 lekë.

Sa më sipër, konstatohet mungesë koherence dhe harmonizimi ndërmjet fazave të PBA-së, formularit të konceptimit të projektit dhe listës së investimeve publike, si në aspektin kohor të planifikimit, ashtu edhe në vlerat financiare dhe programimin ndër vite. Veprime këto në kundërshtim me pikën 26/f të Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”*, ku përcaktohet se *“projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së 2025–2027 dhe të jenë të reflektuara në mënyrë të qëndrueshme në dokumentet buxhetore”*, si dhe me VKM nr. 887, datë 27.12.2017, *“Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”*, e ndryshuar, e cila kërkon që projektet e investimeve publike të planifikohen mbi bazën e analizave të plota dhe të jenë të integruara në mënyrë konsistente në të gjitha fazat e ciklit buxhetor. Gjithashtu, këto veprime nuk janë në përputhje me nenin 4 dhe nenin 9 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, të cilat përcaktojnë parimet e qëndrueshmërisë, koherencës dhe disiplinës në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Për rrjedhojë, ndryshimi i mësipërm në planifikimin buxhetor ka sjellë reflektimin e vlerës 4,362,044 lekë në llogarinë 231 *“Blerje pajisje SHSHS për IPSH”*, pa një bazë të plotë dhe të konsoliduar në fazat paraprake të planifikimit.

Konklузion: Konstatohet se procesi i planifikimit dhe programimit të investimeve publike për SHSHS nuk është kryer në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke paraqitur mospërputhje ndërmjet dokumenteve të PBA-së, formularit të konceptimit të projektit dhe listës së investimeve publike. Mungesa e koherencës në planifikimin kohor dhe financiar, si dhe ndryshimet e pajustifikuara ndërmjet fazave të programimit, cenojnë besueshmërinë e planifikimit buxhetor dhe rrisin riskun për alokim jo efektiv dhe jo transparent të fondeve publike.

2. Me shkresën e MSHMS nr. 630/2, datë 14.02.2025, protokolluar në SHSSH me nr. 1702, datë 19.02.2025, është përcjellë alokimi i fondit të veçantë për shpërblimin e punonjësve, për pensione mbështetje në rast fatkeqësie, i miratuar me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave nr. 2460/1, datë 01.02.2025. Ky alokim konsiston në shumën 800,000 lekë, në llogarinë 606 “Transferta te individët SHSSH”, në produktin 91307AC.

3. Me shkresën e SHSSH nr. 1243/1, datë 13.02.2025, është kërkuar nga MSHMS transferimi i fondeve për financimin e ofrimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për periudhën shkurt–dhjetor 2025. Konkretisht, është kërkuar transferimi i Fondit Social në shumën 63,038,587 lekë, për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, i ndarë në: 23,662,366 lekë nga administrata e SHSSH dhe 39,376,221 lekë nga ndërmarrjet sociale. Ky veprim është iniciuar mbi bazën e kërkesave të bashkive për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe paraqitet në kolonën nr. 3 të tabelës nr. 1 të Aneksit nr. 1.

4. Me shkresën e MSHMS nr. 1282/3, datë 09.04.2025, protokolluar në SHSSH me nr. 3133, datë 10.04.2025, është përcjellë transferimi i fondeve për vitin 2025, bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave nr. 5460/1, datë 04.04.2025. Ky transferim konsiston në uljen e shumës 19,097,000 lekë nga llogaria 606 e ndërmarrjeve sociale dhe shtimin e kësaj shume në llogarinë 604 të ndërmarrjeve sociale. Në lidhje me këtë transferim konstatohet se mungon relacioni arsyetues që duhet të shoqërojë ndryshimet në alokimin e fondeve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, i cili përcakton se çdo rishpërndarje fondesh duhet të jetë e argumentuar dhe e mbështetur me relacion shpjegues nga njësia propozuese.

5. Me shkresën nr. 2331/1, datë 04.06.2025 të MSHMS, protokolluar në SHSSH me nr. 4679, datë 05.06.2025, është përcjellë miratimi për transferimin e fondeve për pagesën e vendimeve gjyqësore që lidhen me indeksimin e pagesave për personat me aftësi të kufizuar (PAK) për vite të mëparshme. Konkretisht, është shtuar fondi në llogarinë 606 "*Vendime gjyqësore MSHMS*" dhe është pakësuar në të njëjtën shumë llogaria 606 "*Ndihmë ekonomike".* Në lidhje me këtë transferim konstatohet se mungon argumentimi përkatës që duhet të shoqërojë këtë rishpërndarje fondesh, si dhe kjo shumë nuk ka qenë pjesë e planifikimit fillestar buxhetor. Për më tepër, detyrimet që burojnë nga vendimet gjyqësore përbëjnë detyrime të njohura ose të parashikueshme për institucionin dhe, në këtë kuadër, duhet të reflektohen në fazat e planifikimit buxhetor. Mungesa e planifikimit dhe e një relacioni shpjegues për këtë transferim bie në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili parashikon që çdo ndryshim në alokimin e fondeve buxhetore duhet të jetë i argumentuar dhe i mbështetur në analiza të plota financiare, si dhe të respektojë parimet e menaxhimit të kujdesshëm dhe të parashikueshëm të fondeve publike.

6. Në vijim të ndryshimeve buxhetore, me shkresën e MSHMS nr. 2697/5, datë 22.07.2025, protokolluar në SHSSH me nr. 6055, datë 23.07.2025, është përcjellë detajimi fillestar në lidhje me investimet, në zbatim të Aktit Normativ nr. 6, datë 11.06.2025. Nga ky detajim rezulton se janë kryer ndryshimet si më poshtë: është pakësuar në shumën 99,500,000 lekë produkti 18BC009 "Rikonstruksion i godinës Shtëpia e Fëmijës Z. Hallulli", si dhe është pakësuar në shumën 2,040,000 lekë produkti 18BC010 "Supervizim dhe kolaudim për rikonstruksionin Shtëpia e Fëmijës Z. Hallulli". Në lidhje me këtë projekt, konstatohet se në transferimin nr. 1 është kërkuar detajimi i tij dhe përgatitja e Formularit F3 për projektin e investimit, çka tregon se projekti nuk ka qenë i shoqëruar me dokumentacion të plotë dhe të miratuar në fazat e planifikimit fillestar.

7. Me shkresën nr. 6251, datë 30.07.2025 të MSHMS është përcjellë transferimi i fondeve për shpenzime korrente, bazuar në kërkesat e paraqitura nga institucionet vartëse. Nga përmbajtja e shkresës rezulton se disa institucione kanë paraqitur teprica në zërat buxhetorë 600 dhe 601, ndërsa institucione të tjera kanë pasur nevojë për fonde shtesë në këta artikuj. Këto shtesa janë argumentuar si pasojë e rritjes së numrit të punonjësve me kontrata të përkohshme për vitin 2025 në njësitë e qeverisjes qendrore. Gjithashtu, mbi bazën e analizës së situatës së grupeve të pafavorizuara të punësuara në ndërmarrjet sociale të miratuara për vitin 2025, është konstatuar ekzistenca e tepricave të fondeve. Në këtë kuadër, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, veçanërisht për viktimat e trafikimit, SHSSH ka kërkuar shtesë fondesh në llogaritë korrente për qarqet Elbasan dhe Tiranë. Nga analiza e këtij transferimi konstatohet se ai është mbështetur në nevoja të krijuara gjatë zbatimit të buxhetit, por evidentohet se ndryshimet në strukturën e shpenzimeve korrente, të lidhura me rritjen e punonjësve me kontrata të përkohshme dhe rishpërndarjen e fondeve ndërmjet institucioneve, tregojnë mangësi në fazën e planifikimit fillestar buxhetor. Në të njëjtën kohë, nevoja për rialokime të shpeshta ndërmjet zërave 600 dhe 601, si dhe përdorimi i tepricave nga ndërmarrjet sociale, kërkon një argumentim më të plotë financiar dhe një dokumentim më të detajuar mbi mënyrën e identifikimit të tepricave dhe kritereve të shpërndarjes së tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

8. SHSSH, me shkresën nr. 9397, datë 20.10.2025, ka kërkuar shtesë fondi për financimin e Ndihmës Ekonomike (NE), Pagesave për Aftësinë e Kufizuar (PAK) për periudhën Nëntor–Dhjetor 2025, si dhe për mbështetjen e grave të papuna me tre ose më shumë fëmijë. Në arsyetimin e paraqitur nga subjekti evidentohet se kërkesa për transferim fondesh është mbështetur në analizën e nevojave faktike të konstatuara gjatë zbatimit të buxhetit, si rezultat i rakordimeve me Drejtoritë Rajonale, nga të cilat kanë rezultuar diferenca ndërmjet fondeve të

planifikuara dhe nevojave reale për përfituesit. Konkretisht, një pjesë e njësive paraqesin teprica në fondet e Ndihmës Ekonomike, ndërsa një pjesë tjetër mungesa, duke imponuar rishpërndarjen e tyre. Gjithashtu, është evidentuar nevojë shtesë fondi për skemën e PAK, si dhe për mbështetjen e grave të papuna, për shkak të rritjes së numrit të përfituesve dhe pamjaftueshmërisë së fondeve të planifikuara. Në këtë kuadër, është propozuar pakësimi i fondit në shumën 1,969,703,000 lekë nga llogaria 606 "Ndihmë ekonomike" dhe shtimi në të njëjtën shumë në llogarinë 606 për pagesat e PAK, si dhe pakësimi i shumës 10,000,000 lekë nga llogaria 606 "Ndërmarrje sociale" dhe shtimi i kësaj shume për mbështetjen e grave të papuna. Kjo transferte është miratuar nga MSHMS me shkresën nr. 4101/1, datë 24.10.2025. Nga auditimi konstatohet se, ndonëse transferimi është bazuar në nevoja faktike për mbulimin e detyrimeve dhe garantimin e vazhdimësisë së skemave sociale, evidentimi i këtyre nevojave gjatë fazës së zbatimit të buxhetit dhe jo në fazën e planifikimit fillestar tregon mangësi në procesin e planifikimit dhe projeksionit buxhetor. MSHMS e ka miratuar transfertën me shkresën nr. 4101/1, datë24.10.2025. SHSSH, me shkresën nr. 9397, datë 20.10.2025, ka kërkuar transferimin e fondeve për financimin e Ndihmës Ekonomike (NE), Pagesave për Aftësinë e Kufizuar (PAK) për periudhën Nëntor–Dhjetor 2025, si dhe për mbështetjen e grave të papuna me tre ose më shumë fëmijë. Kërkesa është bazuar në zbatim të kuadrit ligjor për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe është mbështetur në rakordimet e kryera me 12 Drejtoritë Rajonale, nga të cilat kanë rezultuar diferenca të theksuara ndërmjet fondeve të planifikuara dhe nevojave faktike për përfituesit.

9. Nga analiza e paraqitur nga subjekti rezulton se për fondet e Ndihmës Ekonomike disa bashki paraqesin teprica në shumën 8,758,000 lekë, ndërsa bashkitë e tjera kanë nevojë për fonde në shumën 539,311,000 lekë. Gjithashtu, për skemën e PAK rezulton një nevojë totale për fonde në shumën 2,882,247,000 lekë, kundrejt një gjendjeje në buxhet prej 912,544,000 lekë, duke krijuar një mungesë të konsiderueshme financiare. Në këto kushte është kërkuar plotësimi i nevojave për PAK në shumën 1,969,703,000 lekë, duke u financuar përmes pakësimit të fondeve të Ndihmës Ekonomike në të njëjtën shumë. Po ashtu, në zbatim të politikës së miratuar për mbështetjen e grave të papuna me tre ose më shumë fëmijë nën 18 vjeç, është evidentuar se fondi i planifikuar fillimisht nuk ka qenë i mjaftueshëm për mbulimin e pagesave të sigurimeve shoqërore deri në fund të vitit, për shkak të rritjes së numrit të përfituesve, duke sjellë nevojën për një shtesë fondi në shumën 10,000,000 lekë, e cila është propozuar të mbulohet nga tepricat e krijuara në fondet e ndërmarrjeve sociale. Në total, kërkesa për transferim fondesh arrin në shumën 3,440,316,000 lekë, e ndarë në: 548,039,000 lekë për Ndihmën Ekonomike, 2,882,247,000 lekë për pagesat e PAK dhe 10,000,000 lekë për gratë e papuna. Kjo kërkesë është miratuar nga MSHMS me shkresën nr. 4101/1, datë 24.10.2025, duke formalizuar rishpërndarjen e fondeve për mbulimin e nevojave të konstatuara.

10. Shërbimi Social Shtetëror, me shkresën nr. 4172/1, datë 14.11.2025, ka kërkuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale transferimin e një fondi shtesë në shumën 2,196,000 lekë, në kuadër të Fondit Social, për vijimin e ofrimit të shërbimit rezidencial për viktimat e trafikimit në Qarkun Vlorë. Kërkesa është argumentuar me nevojën për mbulimin e shpenzimeve ushqimore për 10 përfitues shtesë për një periudhë 12-mujore, si dhe me pamjaftueshmërinë e fondeve të planifikuara fillimisht. Nga dokumentacioni bashkëlidhur rezulton se transferimi është realizuar nëpërmjet rishpërndarjes së brendshme të fondeve, konkretisht me shtesë fondi për Këshillin e Qarkut Vlorë në shumën 2,196,000 lekë (kodi i projektit 91307AH) dhe pakësim në të njëjtën shumë nga Administrata e Shërbimit Social Shtetëror (kodi i projektit 91307AG), në zërin përkatës të shpenzimeve, duke ruajtur ekuilibrin buxhetor. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit të Kërkesave për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në

kuadër të Fondit Social, me Vendimin nr. 06, datë 24.10.2025, si dhe me shkresën nr. 4172 prot., datë 14.11.2025, ka miratuar akordimin dhe transferimin e fondit të mësipërm.

11. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 2331/40 prot., datë 14.11.2025, ka përcjellë pranë Shërbimit Social Shtetëror transferimin e fondeve për pagesën e vendimeve gjyqësore për indeksimin e pagesës së PAK në vite, në zbatim të kuadrit ligjor për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe procedurave standarde të zbatimit të buxhetit. Nga dokumentacioni bashkëlidhur rezulton se është realizuar rishpërndarja e fondeve në nivel njësish vendore (bashki), me shtesë fondesh për secilën njësi përfituese sipas vlerave përkatëse, ndërsa në total është evidentuar një pakësim nga fondet e Shërbimit Social Shtetëror në shumën 281,580,000 lekë, duke ruajtur balancën buxhetore. Transferimi është reflektuar në nivel thesari dhe buxheti, duke evidentuar shpërndarjen sipas kodeve përkatëse të programit dhe produktit (91307AL), në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.

12. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 3622/4, datë 04.12.2025, ka përcjellë pranë institucioneve përkatëse, ndër të cilat edhe Shërbimi Social Shtetëror, akordimin e fondit të veçantë te pensioneve për vitin 2025, në zbatim të kuadrit ligjor për zbatimin e buxhetit të shtetit. Nga dokumentacioni bashkëlidhur rezulton se fondi është shpërndarë sipas institucioneve dhe produkteve përkatëse, duke përfshirë zëra për mbulimin e detyrimeve të ndryshme buxhetore, përfshirë edhe ato që lidhen me politikat sociale dhe përfitimet për kategori të veçanta. Akordimi i fondit është realizuar në përputhje me strukturën buxhetore dhe kodet përkatëse të programit dhe produkteve, pa paraqitur kërkesë apo argumentim nga ana e Shërbimit Social Shtetëror, duke qenë një vendimmarrje e centralizuar e Ministrisë.

13. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 7063 prot., datë 30.12.2025, në zbatim të Aktit Normativ nr. 11, datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 '*Për buxhetin e vitit 2025'",* ka përcjellë pranë institucioneve përkatëse, ndër të cilat edhe Shërbimi Social Shtetëror, alokimin e fondeve për shpenzime korrente. Nga dokumentacioni bashkëlidhur rezulton se është realizuar rishpërndarja e fondeve nëpërmjet pakësimeve dhe shtesave në nivel institucionesh dhe programesh buxhetore. Konkretisht, janë evidentuar pakësime fondesh në disa njësi shpenzuese të sistemit shëndetësor dhe strukturave të varësisë, ndërkohë që janë parashikuar shtesa fondesh për institucione dhe produkte të caktuara, përfshirë edhe strukturat e Shërbimit Social Shtetëror. Në total, rishpërndarja është kryer duke ruajtur balancën buxhetore, në përputhje me klasifikimin ekonomik dhe funksional të shpenzimeve, si dhe kodet përkatëse të programeve dhe produkteve buxhetore, në funksion të përmbushjes së nevojave të fundvitit buxhetor**.**

14. Shërbimi Social Shtetëror, me shkresën nr. 5063/1, datë 30.12.2025, ka kërkuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale transferimin e fondeve për mbështetje financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2025, në zbatim të VKM nr. 835, datë 30.12.2025. Kërkesa është argumentuar me nevojën për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga mbështetja financiare për kategoritë përfituese, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Sipas dokumentacionit fondi i kërkuar për transferim është në shumën 2,227,500,000 lekë, i ndarë në: 738,255,000 lekë për ndihmën ekonomike dhe 1,489,245,000 lekë për pagesat e aftësisë së kufizuar. Nga tabelat bashkëlidhur rezulton se është realizuar shpërndarja e fondeve në nivel njësish vendore (bashki), sipas përfituesve dhe produkteve përkatëse (NE dhe PAK), si dhe reflektimi i tyre në nivel thesari. Transferimi është kryer në përputhje me klasifikimin buxhetor dhe kodet përkatëse të programeve dhe produkteve, në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me VKM. Në vijim, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën përkatëse të datës 31.12.2025, ka miratuar dhe përcjellë transferimin e fondeve përkatëse.

Realizimi i buxhetit të vitit 2025

Fondet e rishikuara të buxhetit për vitin 2025 përfshijnë alokimet e miratuara fillimisht me Ligjin nr. 115/2024 "*Për buxhetin e vitit 2025*", i ndryshuar, si dhe fondet shtesë të përfituara gjatë vitit buxhetor, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit për shpenzimet korrente paraqiten në mënyrë të detajuar sipas programeve në tabelën nr.1 të Aneksit nr.1.

Nga auditimi rezulton se realizimi faktik i buxhetit për vitin 2025, në mënyrë të detajuar sipas klasave të llogarive paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit". Nga auditimi i realizimit të buxhetit për vitin 2025 rezultoi se, megjithëse niveli i përgjithshëm i ekzekutimit paraqitet i lartë rreth 99% e planit operativ, evidentohet mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe realizimit në disa zëra të shpenzimeve, si dhe rishikim i ndjeshëm i planit operativ gjatë vitit buxhetor në raport me parashikimet fillestare. Nga analiza e të dhënave sipas produkteve dhe zërave buxhetorë konstatohet se për skemën e Ndihmës Ekonomike (91307AA) fondi i planifikuar është pakësuar ndjeshëm dhe paraqet nënrealizim në raport me planin operativ (mbetje rreth 83,455 mijë lekë), ndërkohë që për skemën e Pagesave për Aftësinë e Kufizuar (91307AB) evidentohet rritje e konsiderueshme e fondit dhe njëkohësisht mosrealizim rreth 93,023 mijë lekë, duke reflektuar rishpërndarje të konsiderueshme ndërmjet këtyre zërave gjatë vitit. Gjithashtu, në nivel institucioni dhe produkti (91307AC, 91307AJ, 91307AK, 91307AM, etj.) evidentohen devijime të ndryshme ndërmjet planit dhe realizimit, me mbetje fondesh në një numër të konsiderueshëm njësish. Projekti me kod 19AB001 *"Blerje pajisjesh për IPSH*" paraqet realizim më të ulët se plani operativ rreth 235 mijë lekë, ndërkohë që janë evidentuar edhe projekte të tjera me devijime në realizim dhe ndryshime gjatë vitit.

Ndryshimet ndërmjet planit fillestar dhe planit operativ, si dhe devijimet ndërmjet planit operativ dhe realizimit faktik tregojnë për parashikim jo të qëndrueshëm të nevojave buxhetore dhe mangësi në monitorimin e zbatimit të buxhetit. Veprime këto në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 9 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar, ku përcaktohet se planifikimi dhe zbatimi i buxhetit duhet të bazohet në parimet e realizmit, qëndrueshmërisë dhe disiplinës fiskale. Si pasojë, krijohen devijime në strukturën dhe realizimin e buxhetit, të cilat ndikojnë në besueshmërinë e planifikimit dhe në efikasitetin e përdorimit të fondeve publike.

Procesi i planifikimit dhe administrimit të fondeve për PAK dhe Ndihmën Ekonomike

Planifikimi i fondeve për pagesat e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) dhe Ndihmës Ekonomike (NE) përbën një proces të strukturuar dhe ciklik, i cili zhvillohet në disa nivele administrative dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Në kuadër të planifikimit Buxhetor Afatmesëm në lidhje me Fondet e NE dhe PAK, procesi fillon në nivel vendor, ku administratori shoqëror në bashki/komunë, në përputhje me kriteret dhe treguesit përkatës identifikon dhe përllogarit nevojat për fonde për çdo kategori përfituese. Për skemën e PAK, përllogaritja mbështetet në Udhëzimin nr. 3, datë 10.03.2014 "*Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar*", i ndryshuar, konkretisht merr në konsideratë numrin e përfituesve sipas grupeve (paraplegjikë, tetraplegjikë, të verbër, invalidë pune etj.) dhe masën e përfitimit për secilën kategori, duke marrë në konsideratë edhe pagesat shtesë si kompensimi për energjinë elektrike, telefoninë apo përfitime të tjera të diferencuara. Ndërsa për ndihmën ekonomike, programimi i fondeve bëhet sipas Udhëzimit nr. 620, datë 27.12.2017, "*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 10.03.2014, 'Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizua*r" dhe bazohet në tregues socio-ekonomikë, si numri i familjeve, struktura familjare, niveli i varfërisë dhe faktorë të tjerë të përcaktuar në udhëzim. Nga verifikimi i udhëzimeve të sipërcituara **konstatohet se ato rezultojnë të paazhornuara,** pasi në referencë mbështeten në ligjin për zbatimin e buxhetit të vitit 2014, në kundërshtim me kërkesat për përditësim dhe përshtatje të vazhdueshme të kuadrit rregullator në funksion të një

planifikimi realist dhe të qëndrueshëm, në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar. Si shkak vlerësohet mungesa e rishikimit periodik të këtyre udhëzimeve nga institucionet përgjegjëse, duke mos reflektuar ndryshimet ligjore dhe nënligjore të viteve në vijim. Si pasojë, krijohet risk për planifikim jo të saktë të fondeve për skemat NE dhe PAK, pasi nuk sigurohet një pasqyrim i plotë dhe aktual i të gjithë faktorëve dhe hallkave përkatëse që ndikojnë në përllogaritjen e nevojave buxhetore.

Këto të dhëna përpunohen dhe pasqyrohen në formularët standardë (Mod. 1), të cilët dërgohen nga njësitë vendore në Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH), zakonisht në fund të muajit qershor.

Në vijim, në nivel rajonal, DRSHSSH verifikojnë dhe vlerësojnë kërkesat e paraqitura nga bashkitë, duke analizuar përputhshmërinë me kriteret ligjore dhe numrin faktik të përfituesve, bazuar në statistikat faktike. Pas këtij procesi, hartohen nevojat për fonde në nivel qarku dhe, së bashku me dokumentacionin përkatës për çdo njësi vendore, i përcillen Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror (DP SHSSH) brenda datës 10 korrik.

Në nivel qendror, DP SHSSH kryen konsolidimin e të dhënave në shkallë kombëtare dhe përllogarit fondin total të nevojshëm për të dyja skemat (PAK dhe NE). Këto të dhëna përfshihen në procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), konkretisht në fazën e dytë të tij, dhe i përcillen për shqyrtim dhe miratim MSHMS-së, si institucion epror.

Pas miratimit të buxhetit vjetor, këto tavane i buxhetore, sipas Ligjit të buxhetit vjetor i dërgohen SHSSH për zbatim.

Në fund të vitit buxhetor, procesi hyn në fazën e përditësimit të të dhënave, ku njësitë vendore rishikojnë dhe përditësojnë kërkesat për fonde bazuar në situatën aktuale të përfituesve. Këto kërkesa dërgohen në DRSHSSH në fund të muajit nëntor dhe më pas përcillen në DP SHSSH brenda datës 10 dhjetor.


Mbi këtë bazë, DP SHSSH kryen detajimin e fondeve sipas bashkive/komunave, në përputhje me ligjin e buxhetit të vitit pasardhës, dhe i përcjell për miratim dhe financim ministrisë përkatëse. Financimi realizohet përmes transfertave si grante të kushtëzuara, të cilat fillimisht çelen për dymujorin e parë (janar–shkurt), dhe më pas vijojnë në mënyrë periodike për çdo dymujor gjatë vitit.

Gjatë vitit buxhetor, procesi i financimit mbështetet në një mekanizëm dinamik monitorimi. DP SHSSH dërgon periodikisht (çdo dy muaj) pranë ministrisë të dhënat statistikore mbi numrin e përfituesve dhe fondin faktik të shpenzuar për çdo bashki/komunë. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për çeljen e fondeve për dymujorët pasardhës, duke siguruar një lidhje të drejtpërdrejtë midis planifikimit dhe realizimit faktik, transferimi i fondeve për dymujorin, bëhet bazuar në statistikat faktike për dy mujorin paraardhës.

Në rastet kur evidentohet se nevojat reale tejkalojnë parashikimet fillestare, drejtoritë rajonale paraqesin kërkesa shtesë për fonde, të cilat shqyrtohen nga SHSSH dhe, nëse vlerësohen të justifikuara, reflektohen në çeljet përkatëse.

Në përmbyllje të ciklit vjetor, në muajin tetor realizohet rakordimi përfundimtar buxhetor ndërmjet SHSSH dhe drejtorive rajonale, i cili shërben për rregullimin përfundimtar të fondeve dhe për përcaktimin e nivelit të financimit për periudhën nëntor–dhjetor.

Konkretisht për PAK planifikimi deri në çeljen e fondeve buxhetore sipas Udhëzimin nr. 3, datë 10.03.2014 "*Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar*" paraqitet si në skemën më poshtë:



Për verifikimin e saktësisë dhe besueshmërisë së planifikimit të fondeve për skemat e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuara, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin e Fazës II të Programit Buxhetor Afatmesëm, në të cilin paraqiten treguesit jo-financiarë (numri i përfituesve) dhe treguesit financiarë përkatës.

Në këtë kuadër, u analizua lidhja midis numrit të përfituesve dhe fondit të planifikuar, duke verifikuar nëse përllogaritjet janë kryer në përputhje me masat e përfitimit dhe kategoritë përkatëse.

Gjithashtu, u krye krahasimi ndërmjet të dhënave të planifikuara dhe realizimit faktik, si në terma të numrit të përfituesve ashtu edhe të vlerës së fondeve të disbursuara, si dhe u analizuan ndryshimet e konstatuara ndër vite dhe ndërmjet fazave të planifikimit.

Në vijim, u shqyrtua përputhshmëria e transfertave buxhetore me treguesit e planifikuar dhe u vlerësua nëse planifikimi është mbështetur në të dhëna të plota, të sakta dhe të verifikueshme, në përputhje "*Formulimi i produkteve në kuadër të PBA*", sipas udhëzimit standard

Në përputhje me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm"*, formulimi i produkteve përbën një element thelbësor në ndërtimin e programeve buxhetore, duke siguruar lidhjen midis objektivave, aktiviteteve dhe burimeve financiare.

Sipas Hapit 3: *"Formulimi i produkteve*", produktet përkufizohen si mallrat dhe shërbimet e prodhuara nga institucionet publike për arritjen e objektivave të përcaktuara, të cilat rezultojnë nga kryerja e aktiviteteve përkatëse. Në këtë kuadër, udhëzimi përcakton se çdo produkt duhet të jetë i shoqëruar me një sasi të planifikuar dhe me koston përkatëse për realizimin e tij.

Më tej, në zbatim të pikës 3.1 të udhëzimit, kërkohet që për çdo produkt të përcaktohet qartë emërtimi dhe njësia e matjes, duke theksuar se emërtimi nuk duhet të përfaqësojë aktivitetin, por rezultatin e arritur prej tij. Njësia e matjes duhet të jetë e natyrës sasiore dhe e matshme, duke mundësuar vlerësimin e volumit të shërbimit të ofruar.

Grupi i auditimit shqyrtoi mënyrën e formulimit të produkteve për programet buxhetore që lidhen me skemat e ndihmës ekonomike (NE) dhe personave me aftësi të kufizuara (PAK), duke analizuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat standarde të PBA.

Nga auditimi konstatohet se për produktet e lidhura me NE dhe PAK formulimi i tyre mbështetet në kuadrin ligjor përkatës, konkretisht:

***** për produktin 91307AA "*Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE*", konstatohet se përshkrimi i produktit përfshin elementë të procesit (aplikimi në skemë) dhe të

rezultatit (përfitimi), duke mos qenë plotësisht në përputhje me kërkesat e pikës 3.1 të Udhëzimit nr. 7/2018, sipas së cilës produkti duhet të përfaqësojë rezultatin final. Megjithatë, treguesi jo-financiar i përdorur (numri i përfituesve) është i mbështetur në Udhëzimin nr. 8, datë 25.02.2015 (pikat 2 dhe 3), ku programimi i fondeve bazohet në numrin e familjeve dhe individëve përfitues dhe në tregues socio-ekonomikë, duke siguruar një lidhje ndërmjet volumit të përfituesve dhe fondit të planifikuar;

***** për produktin 91307AB *"PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa*", konstatohet se formulimi është i qartë dhe në përputhje me kërkesat e pikës 3.1 të Udhëzimit nr. 7/2018, pasi paraqet në mënyrë të drejtpërdrejtë rezultatin (numrin e përfituesve). Ky produkt është i mbështetur në Udhëzimin nr. 3, datë 10.03.2014, i ndryshuar me nr. 620, datë 27.12.2017, i cili përcakton se programimi i fondeve bazohet në numrin e personave me aftësi të kufizuara dhe kujdestarëve sipas kategorive dhe masës së përfitimit, duke krijuar një lidhje të qartë dhe të qëndrueshme ndërmjet treguesve jo-financiarë dhe fondeve buxhetore.

Dinamika e Fondeve të NE dhe PAK për 2025

Në mijë lekë

	Fakti 2024		PBA F II-të(sipas SHSSH)		PBA F III-të (LB)		Mb. financ.	Fondi transf.	Fakti 2025	
	Nr. Për.	Fondi	Nr. Për.	Fondi	Nr. Për.	Fondi			Shuma	Nr. përfit
NE	53,599	5,763,983,902	58,682	5,983,239,000	62,000	7,232,000	738,255	5,392,220	5,309,265	50,631
PAK	164,104	19,612,354,218	170,634	18,807,753,000	92,000	15,238,000	1,489,245	18,696,948	18,603,925	76,586

Nga tabela e mësipërme konstatohet se për vitin 2024, numri faktik i përfituesve të PAK është 164,104, prej të cilëve:

- 73,559 përfitues PAK;
- 18,572 kujdestarë;
- 71,973 invalidë pune.

Në fazën e dytë të PBA janë planifikuar 170,634 përfitues, të ndarë si më poshtë:

- 76,388 përfitues PAK;
- 20,391 kujdestarë;
- 73,855 invalidë pune.

Në fazën e tretë të PBA 2025–2027 evidentohet rënie në numrin e përfituesve dhe në shumën e fondit. Kjo lidhet me ndryshimet në kuadrin rregullator, ku invalidët e punës, të cilët përfitonin pagesa nga sistemi i përkujdesit social në bazë të VKM nr. 869, datë 18.06.2008, në zbatim të VKM nr. 772, datë 13.12.2024, janë transferuar pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Për rrjedhojë, kjo kategori nuk është më pjesë e skemës së pagesave që administrohen nga SHSSH, duke sjellë ulje të parashikimit si në numrin e përfituesve, ashtu edhe në fondet e planifikuara për skemën PAK.

Nga analiza e transfertave dymujore rezulton se fondet janë çelur bazuar në të dhënat statistikore të periudhave pararendëse, duke paraqitur luhatje të vazhdueshme në numrin e përfituesve dhe në fondin përkatës, konkretisht:

- për periudhën janar–shkurt, fondi i çelur është 2,908,195,000 lekë, bazuar në programimin e njësive vendore.
- për mars–prill, fondi i çelur 2,821,438,519 lekë, kundrejt fondit statistikor 2,797,414,129 lekë;
- për maj–qershor, fondi 2,914,075,000 lekë, kundrejt 2,828,716,842 lekë;
- për korrik–gusht, fondi 2,830,127,000 lekë, kundrejt 2,850,397,803 lekë;
- për shtator–tetor, fondi 2,851,620,000 lekë, kundrejt 2,785,047,887 lekë;
- për nëntor–dhjetor, fondi 2,882,247,000 lekë, bazuar në rakordim me njësitë administrative nëpërmjet drejtorive rajonale

Gjithashtu, në fund të vitit është akorduar mbështetje financiare shtesë në zbatim të VKM nr. 385, datë 30.12.2025, në vlerën 1,489,245,000 lekë, e cila ka ndikuar në rritjen e fondit total të

çelur, si dhe në paraqitjen e një niveli më të lartë realizimi për vitin 2025. Megjithatë, kjo mbështetje financiare nuk ka qenë pjesë e hallkave të mëparshme të ciklit të planifikimit buxhetor.
Në total, fondi i çelur për periudhën janar–dhjetor 2025 rezulton 18,696,948,000 lekë, ndërsa realizimi faktik paraqitet në vlerën 18,603,924,791 [8]lekë.
- Në lidhej me NE Nga analiza e transfertave dymujore rezulton se fondet janë çelur mbi bazën e të dhënave statistikore, duke reflektuar një trend në rënie të numrit të përfituesve gjatë vitit, konkretisht:
* *për periudhën janar–shkurt*, fondi i çelur është 955,132,000 lekë, bazuar në programimin e njësive vendore.
* *për mars–prill*, fondi 790,425,659 lekë, kundrejt fondit statistikor 799,041,931 lekë me 52,886 përfitues;
* *për maj–qershor*, fondi 806,198,000 lekë, kundrejt 790,644,180 lekë me 52,303 përfitues;
* *për korrik–gusht*, fondi 788,805,000 lekë, kundrejt 775,816,842 lekë me 51,081 përfitues;
* *për shtator–tetor*, fondi 774,093,000 lekë, kundrejt 733,987,853 lekë me 49,905 përfitues;
* *për nëntor–dhjetor*, fondi 539,311,000 lekë, me 49,217 përfitues.
Gjithashtu, në fund të vitit është akorduar mbështetje financiare shtesë në zbatim të VKM nr. 385, datë 30.12.2025, në vlerën 738,255,000 lekë, e cila ka ndikuar në rritjen e fondit total të financuar.
Në total, fondi i çelur për periudhën janar–dhjetor 2025 rezulton 5,392,720,000 lekë, ndërsa realizimi faktik paraqitet në vlerën 5,309,265,379 lekë, përfshirë dhe mbështetjen financiare, të paplanifikuar në hallkat e para të planifikimit buxhetor.

Nga krahasimi plan fillestar, plan operativ e realizim në lidheje me fondet e NE dhe PAK situata paraqitet si në vijim:

Përshkrimi	Fakti 2024		Celja	Plani Operativ	Fakti	Fakti pa mbështetje	Diferenca	Diferenca
	Nr. Për.	Fondi	Fondi	Fondi	Fondi	Fondi	Fakt I korrekt-PO	Fakt-PO
NE	53,599	5,763,983,902	7,232,000	5,392,720	5,309,265	4,571,010	(821,710)	(83,455)
PAK	164,104	19,612,354,218	15,238,000	18,696,948	18,603,925	17,114,680	(1,582,268)	(93,023)

Grupi i auditimit, me qëllim verifikimin e saktësisë së nivelit të realizimit të fondeve për NE dhe PAK, analizoi të dhënat mbi realizimin dhe korrektoi realizimin sipas SHSSH për mbështetjen financiare, duke e këtë të fundit, pasi kjo nuk ka qenë pjesë e planifikimit fillestar në fazat e PBA-së. Ky veprim u krye për të siguruar krahasueshmëri reale ndërmjet planifikimit dhe realizimit. Nga kjo analizë rezultoi se diferencat e mosrealizimit janë më të larta se ato të raportuara, duke evidentuar devijime më të theksuara nga planifikimi fillestar.
Kjo situatë vjen si pasojë e mosplanifikimit të plotë të nevojave buxhetore dhe përjashtimit në planifikimit të mbështetjes financiare në fazat fillestare dhe mungesës së një metodologjie të unifikuar për trajtimin e fondeve shtesë gjatë analizës së realizimit. Për rrjedhojë, paraqitet një nivel jo i saktë i realizimit të fondeve, duke paraqitur një realizim jo real dhe duke vështirësuar vlerësimin e performancës buxhetore dhe të nevojave efektive për financim.
Nga auditimi konstatohet se nga ana e Shërbimi Social Shtetëror **nuk janë hartuar dhe paraqitur raporte monitorimi mbi zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi**, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimi nr. 14, datë 30.05.2023, sipas të cilit njësitë e qeverisjes qendrore kanë detyrimin për monitorimin dhe raportimin periodik të realizimit të buxhetit dhe treguesve të performancës.

[8] Përfshirë dhe mbështetjen financiare.

Mungesa e raporteve të monitorimit cenon ndjekjen e ecurisë së realizimit të fondeve, analizën e devijimeve plan–fakt, si dhe vlerësimin e performancës së programeve buxhetore, duke ndikuar në dobësimin e mekanizmave të kontrollit dhe vendimmarrjes menaxheriale.

Shpërndarja e fondeve të NE sipas Qarqeve paraqitet si në vijim:

Shpërndarja e fondeve të NE sipas qarqeve paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 16: "Fondet e NE në nivel qarku për vitin 2025"

Në lekë

Qarku	Mbështetje financiare	Shuma vjetore transfertave	Fakti Total
Elbasan	155,310,000	1,092,777,000	1,064,160,081
Dibër	138,855,000	1,028,005,000	1,011,893,755
Kukës	118,110,000	891,299,000	886,387,734
Korçë	97,905,000	675,086,000	669,403,258
Shkodër	58,080,000	430,372,000	420,828,786
Tiranë	46,845,000	384,412,659	381,605,419
Lezhë	36,765,000	270,912,000	267,969,565
Fier	22,890,000	182,468,000	176,649,954
Vlorë	23,205,000	138,133,000	136,721,804
Berat	16,500,000	116,697,000	114,186,113
Durrës	13,455,000	107,539,000	106,894,452
Gjirokastër	10,335,000	74,519,000	72,564,458
Totali	**738,255,000**	**5,392,219,659**	**5,309,265,379**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga tabela e mësipërme konstatohet se fondet e ndihmës ekonomike për vitin 2025 në nivelet më të larta të transfertave vjetore dhe realizimit faktik paraqiten në qarkun Elbasan, Dibër dhe Kukës, ndërsa më të ulëta në qarkun Gjirokastër, Durrës dhe Berat.

Gjithashtu konstatohet se në të gjitha qarqet, shumat faktike janë më të ulëta se transfertat e miratuara, duke evidentuar një nënrealizim të fondeve. Në nivel total, nga 5,392,219,659 lekë të transferuara, janë realizuar 5,309,265,379 lekë

Shpërndarja e fondeve të PAK sipas Qarqeve paraqitet si në vijim:

Tabela nr. 17: "Fondet e PAK në nivel qarku për vitin 2025"

Në lekë

Qarku	Transferta Mbështetje Financiare VKM 385 -30.12.2025	Shuma Totale e çelur Janar -Dhjetor 2025	Fakti total
Tiranë	297,375,000	3,616,048,000	3,607,504,807
Elbasan	255,330,000	3,206,567,519	3,195,248,714
Fier	183,210,000	2,240,847,000	2,228,264,977
Durrës	132,405,000	1,698,614,000	1,679,184,300
Korçë	110,910,000	1,403,183,000	1,391,206,654
Shkodër	89,175,000	1,288,505,000	1,279,015,886
Lezhë	91,710,000	1,211,071,000	1,203,143,495
Vlorë	89,220,000	1,137,850,000	1,136,379,294
Dibër	76,980,000	931,276,000	927,478,328
Berat	72,945,000	855,907,000	854,438,615
Kukës	51,585,000	610,853,000	609,856,815
Gjirokastër	38,400,000	496,226,000	492,202,906
Totali	**1,489,245,000**	18,696,947,519	18,603,924,791

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga tabela më sipër konstatohet se:

- Fondi total i çelur për PAK, për vitin 2025 rezulton 18,696,947,519 lekë, ndërsa shpenzimet faktike janë 18,603,924,791 lekë, çka paraqet një nivel të lartë realizimi të fondeve dhe transferim të fondeve, bazuar në numrin real të përfituesve.
- Diferenca ndërmjet fondit të çelur dhe faktit është relativisht e ulët, rreth 93 milionë lekë.
- Qarku me peshën më të madhe të fondeve është Tirana, e ndjekur nga Elbasani dhe Fieri, të cilat janë gjithashtu dhe qarqet me numrin më të lartë të përfituesve dhe nevojave për mbështetje.

Në të dy tabelat më sipër konstatohet se ka pasur mbështetje financiare për të dy kategoritë, konkretisht në shumat:

- Për NE- 738,255,000 lekë dhe
- Për PAK në shumën 1,489,245,000 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës mbi këtë mbështetje u konstatua se:
Bazuar në VKM nr. 835, datë 30.12.2025 "*Për mbështetjen Financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2025*" ku sipas së cilës, është përcaktuar dhënia e një mbështetjeje financiare në masën 15,000 lekë për kategori të veçanta për vitin 2025, ku përfshihen:

- familjet dhe individët përfitues të ndihmës ekonomike;
- fëmijët pa kujdes prindëror në familje kujdestare;
- personat me aftësi të kufizuara;
- përfituesit e statusit të paraplegjikëve/tetraplegjikëve dhe të të verbërve;
- si dhe ndihmësit personalë të tyre.

Efekti financiar total i këtij vendimi llogaritet në 2,227,500,000 lekë, i cili përballohet nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2025.
Me shkresën nr. 10713/1, datë 30.12.2025 të Drejtorit ë Përgjithshëm të SHSSH është bërë kërkesa për transferimin e fondeve për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2025 në zbatim të VKM nr. 835/2025 e ndarë:

- Ndihmë ekonomike në shumën 738,255,000 lekë dhe
- Pagesë për aftësinë e Kufizuar në shumën 1,489,245,000 lekë.

Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se VKM nr. 835, datë 30.12.2025 për mbështetjen financiare është miratuar pas afatit ligjor për rishpërndarjen e fondeve buxhetore, në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 9936/2008, sipas të cilit kjo e drejtë ushtrohet deri më 15 nëntor të vitit buxhetor, si dhe me përcaktimet e udhëzimit për zbatimin e buxhetit të vitit 2025**.**
Ky veprim përbën angazhim fondesh jashtë afateve ligjore, duke cenuar disiplinën buxhetore, transparencën dhe parashikueshmërinë e përdorimit të fondeve publike.

Viti 2024

Programimi i PBA-së 2024-2026 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2024

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *"Fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore"* (llogaritë 600 dhe 601) është kryer mbi bazën e numrit faktik të punonjësve dhe strukturës organizative të miratuar për secilin program buxhetor, në përputhje me kategoritë dhe nivelet e pagave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
Ndërkohë, planifikimi i shpenzimeve të tjera korrente (llogaritë 602–606) është mbështetur në kërkesat e paraqitura nga institucionet e varësisë, në tavaneve buxhetore të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në limitet e shpenzimeve të periudhave paraardhëse, si dhe në parashikimet për realizimin e vitit buxhetor në vijim.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2025-2027

Nga auditimi u evidentua se, në fazën e parë strategjike të përgatitjes së PBA-së 2024–2026, Shërbimi Social Shtetëror nuk ka paraqitur kërkesa buxhetore në mënyrë të drejtpërdrejtë, por këto janë përfshirë dhe paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni nga i cili varet.

Për rrjedhojë, grupi i auditimit mori në analizë kërkesat buxhetore të fazës së parë të PBA-së 2024–2026, të paraqitura nga MSHMS në nivel llogarish për programin buxhetor 10430 "*Përkujdesje Sociale*", të cilat, në fund të fazës së parë, paraqiten sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 18 "Fondet buxhetore të parashikuara për Përkujdesjen Sociale në fund të fazës së I-rë të PBA 24-26, në nivel llogarish *(në lekë)*

Totali shpenzimeve të Programit	2024	2025	2026
	29,864,730,000	**30,264,730,000**	**30,614,730,000**
600 - Paga	**623,817,000**	**623,817,000**	**623,817,000**
01 - Nga Buxheti	623,817,000	623,817,000	623,817,000

601 - Sigurime Shoqërore	**105,313,000**	**105,313,000**	**105,313,000**
01 - Nga Buxheti	105,313,000	105,313,000	105,313,000
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	**365,600,000**	**365,600,000**	**365,600,000**
01 - Nga Buxheti	365,600,000	365,600,000	365,600,000
606 - Trans per Buxh. Fam. & Individ	**28,450,000,000**	**28,850,000,000**	**29,200,000,000**
01 - Nga Buxheti	28,450,000,000	28,850,000,000	29,200,000,000
231 - Kapitale të Trupëzuara	**320,000,000**	**320,000,000**	**320,000,000**
01 - Nga Buxheti	16,350,000	18,780,000	20,000,000
02 - Financim i huaj - Grant	31,000,000	31,000,000	31,000,000
22 - Financim i huaj - Kredi	269,000,000	269,000,000	269,000,000
04 - TVSH, Detyrim Doganor	3,650,000	1,220,000	0

***Burimi**:* Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të VKM nr.195/2023 dhe të dhënave të publikuara në faqen e MF.[9]

Nga tabela më sipër rezulton se, në përfundim të fazës së parë të planifikimit buxhetor afatmesëm, për vitin 2024, rreth 98.9% e shpenzimeve totale përbëhet nga shpenzime korrente; nga këto, rreth 2.4% përfaqësojnë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (llogaritë 600 dhe 601).

Transfertat (llogaria 606) zënë rreth 95.3% të totalit të shpenzimeve, duke përbërë peshën kryesore të shpenzimeve të programit buxhetor. Ndërkohë, shpenzimet kapitale (investimet) paraqiten në nivel minimal, rreth 1.1% të totalit të shpenzimeve.

Me anë të VKM nr. 195, datë 05.04.2023 "*Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025–2027*", sipas së cilës tavanet për programin 10430 "*Përkujdesje Sociale",* në nivel shpenzimesh korrente dhe kapitale, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 19 "Fondet buxhetore të Përkujdesjes Sociale të miratuara për fazën e I-rë të PBA 24-26"

(në mijë lekë)

Programi	Shpenzimet 2024			Shpenzimet 2025			Shpenzimet 2026		
	Korrente	Kapitale	Totali	Korrente	Kapitale	Totali	Korrente	Kapitale	Totali
10430	29,544,730	320,000	29,864,730	29,944,730	320,000	30,264,730	30,294,730	320,000	**30,614,730**

Burimi: VKM nr. 195/2023, përpunuar nga grupi i auditimit.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II-të të PBA 2024-2026

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026 janë miratuar me VKM nr. 436, datë 19.07.2023 "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026", të cilat, në nivel programi për "*Përkujdesje Sociale*" (10430), paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 20 "Fondet buxhetore të Përkujdesjes Sociale të miratuara për fazën e II-të të PBA 24-26" *(në lekë)*

Përshkrimi	2024	2025	2026
Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore	729,130	729,130	729,130
Shpenzime të tjera korrente	28,815,600	29,215,600	29,565,600
I.Totali i shpenzimeve korrente	**29,544,730**	**29,944,730**	**30,294,730**
Financim i brendshëm	41,710	102,020	50,240
Financim i huaj	50,000	50,000	50,000
II.Totali i shpenzimeve kapitale	**91,710**	**152,020**	**100,240**
III.Totali i shpenzimeve buxhetore	**29,636,440**	**30,096,750**	**30,394,970**

Burimi: VKM nr. 436/2023, Përpunuar nga grupi i auditimit.

Drejtoresha e Shërbimit Social Shtetëror zj. R.Xh. ka përcjellë pranë MSHMS kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026, brenda afatit të parashikuar në VKM nr. 22, datë 17.01.2024 *"Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2024",* të cilat në nivel produkti, krahasuar me tavanet përgatitore, paraqiten sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Për vlerësimin e respektimit të tavaneve përfundimtare të shpenzimeve buxhetore, grupi i auditimit krahasoi kërkesat buxhetore të paraqitura nga Shërbimi Social Shtetëror në fazën e

[9] Aneksi-nr.1.-13_Ministria-e-Shendetesise-dhe-Mbrojtjes-Sociale-Faza-I-PBA-2024-2026.xlsx

dytë të PBA 2024–2026 me tavanet përfundimtare të miratuara me VKM nr. 436, datë 19.07.2023.
Në vijim paraqitet krahasimi i kërkesave buxhetore me tavanet përfundimtare, në nivel të shpenzimeve korrente dhe kapital

Tabela nr. 21: *"Kërkesat e paraqitura nga SHSSH në Fazën e II-te të PBA vs Tavanet përfundimtare"*

Emërtimi llogarisë	I.Shuma (lekë)	II.Tavanet	Diferenca I-II
600	754,871,000		
601	126,059,800		
602	413,142,000		
606	29,996,375,000		
Toatli shp. Korrente	**31,290,447,800**	29,544,730	31,260,903,070
230	**0**	91,710	(91,710)
Totali I shpenzimeve buxhetore 2024	**31,290,447,800**	29,636,440	31,260,811,360

***Burimi**: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të SHSSH dhe VKM nr. 436/2023.*

Nga tabela e mësipërme rezulton se, nga SHSSH në paraqitjen e kërkesave buxhetore për fazën e dytë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026, **nuk janë respektuar tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore, të miratuara me VKM nr. 436, datë 19.07.2023.** Konkretisht:
- nuk janë paraqitur kërkesa për shpenzime kapitale (llogaria 230), ndërkohë që në tavanet përfundimtare është parashikuar fond prej 91,710,000 lekë;
- shpenzimet korrente të kërkuara rezultojnë në vlerën 31,290,447,800 lekë, kundrejt tavanit të miratuar prej 29,544,730,000 lekë, duke rezultuar në tejkalim prej 1,745,717,800 lekë;
- për rrjedhojë, edhe totali i shpenzimeve buxhetore është paraqitur mbi nivelin e miratuar.

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit plotësues nr. 22 "*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026"*, ku citohet se: "*Objektivi i fazës teknike të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026 është përpunimi i detajeve teknike të buxhetit brenda tavaneve përfundimtare të miratuara. Në këtë kuptim, njësitë e qeverisjes qendrore nuk mund të rishqyrtojnë kërkesa për financimin e politikave të reja dhe kërkesa për mangësi në financim të politikave ekzistuese.*"

Faza e III-të e PBA 2024-2026

Me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 28.02.2024, është miratuar Programi Buxhetor Afatmesëm 2024–2026 i rishikuar (Faza III), në përputhje me tavanet buxhetore të përcaktuara në Ligjin nr. 97/2023 "*Për Buxhetin e vitit 2024*".
Për programin buxhetor 10430 "*Përkujdesi Social*", paraqitjet në nivel llogarish rezultojnë si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 22 "Shpenzime buxhetore të programit 10430, PBA 2024-2026, Faza III-të"

Totali shpenzimeve të Programit	2024	2025	2026
	29,724,310,000	**30,209,951,000**	**30,508,171,000**
600 - Paga	**700,000,000**	**721,000,000**	**721,000,000**
01 - Nga Buxheti	700,000,000	721,000,000	721,000,000
601 - Sigurime Shoqërore	**117,000,000**	**121,000,000**	**121,000,000**
01 - Nga Buxheti	117,000,000	121,000,000	121,000,000
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	**365,600,000**	**365,931,000**	**365,931,000**
01 - Nga Buxheti	365,600,000	365,931,000	365,931,000
606 - Trans për Buxh. Fam. & Individ	**28,450,000,000**	**28,850,000,000**	**29,200,000,000**
01 - Nga Buxheti	28,450,000,000	28,850,000,000	29,200,000,000
230 - Kapitale të Patrupëzuara	**6,000,000**	**0**	**0**
01 - Nga Buxheti	6,000,000	0	0
231 - Kapitale të Trupëzuara	**85,710,000**	**152,020,000**	**100,240,000**
01 - Nga Buxheti	30,260,000	100,800,000	50,240,000
02 - Financim i huaj - Grant	50,000,000	50,000,000	50,000,000
04 - TVSH, Detyrim Doganor	5,450,000	1,220,000	0

Burimi: MF[10], përpunuar nga grupi i auditimit

[10] Ministria-e-Shendetesise-dhe-Mbrojtjes-Sociale-PBA-2025-2027-Faza-III.xlsx

Nga tabela më sipër rezulton se, për vitin 2024, totali i shpenzimeve korrente paraqitet në shumën 29,632,600,000 lekë, duke përbërë rreth 99.7% të totalit të shpenzimeve buxhetore, ndërsa shpenzimet kapitale paraqiten në shumën 91,710,000 lekë, ose rreth 0.3% të totalit. Në strukturën e shpenzimeve korrente, peshën kryesore e zënë transfertat për buxhetet familjare dhe individët (llogaria 606), të cilat përbëjnë mbi 95% të totalit të shpenzimeve, ndërsa shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore zënë një peshë shumë më të ulët.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2024

Sipas Ligjit nr. 97/2023, datë 07.12.2023 "*Për buxhetin e vitit 2024*", shpenzimet buxhetore për programin 10430 "*Përkujdesi Social",* sipas Tabelës nr. 1 të tij, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 23: "Shpenzimet korrente e kapitale sipas Ligjit nr. 97/2023" *(në mijë lekë)*

Programi	Emri i programit	Shpenzimet 2024		
		Korrente	Kapitale	Totali
10430	Perkujdesi Social	29,544,730	91,710	29,636,440

***Burimi*:** Ligji nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024"

Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente të SHSSH është bërë me shkresën nr. 418 prot., datë 24.01.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, "*Dërgohet plani i buxhetit për vitin 2024*", ku në nivel produkti paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga auditimi konstatohet se detajimi fillestar i shpenzimeve korrente për vitin 2024 është bërë në përputhje me tabelën nr. 1 të Ligjit nr. 97/2023 të Buxhetit për vitin 2024, "*Buxheti 2024 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore*".

Buxheti i vitit 2024 i parashikuar për shpenzimet totale buxhetore (shpenzime korrente dhe kapitale) ka pësuar ndryshime, që prej fazës së Projekt Buxhetit të vitit 2024 deri në ligjin nr. 97/2023 "*Për buxhetin e vitit 2024",* i cili ka ndryshuar më pas me 4 akte normative (AN) të cilat paraqiten si më poshtë:

- Akti normativ nr. 1, datë 21.02.2024;
- Akti Normativ nr. 3 datë 28.08.2024 dhe
- Akti Normativ nr. 5, datë 19.12.2024.

Ndryshimet e shpenzimeve buxhetore, nga Ligji nr. 115/2024 deri në planin përfundimtar sipas akteve normative apo transfertave të ndryshme, paraqiten në tabelën nr. 2 Aneksit nr. 1

- Bazuar në shkresën nr. 5200/5 prot., datë 30.12.2024 të MSHMS, është akorduar alokimi i fondeve në zbatim të VKM nr. 854, datë 26.12.2024, "Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për vitin 2024".

Ky alokim është bërë sipas kërkesës së SHSSH nr. 10043/2 prot., datë 30.12.2024, me arsyetimin se, në kuadër të zbatimit të VKM-së përkatëse, kërkohet shpërndarja e fondeve për përfituesit sipas kategorive të përcaktuara.

Sipas kësaj, fondet janë alokuar për njësitë përfituese në përputhje me tabelën shoqëruese, duke siguruar shpërndarjen e tyre sipas strukturës buxhetore dhe destinacionit të miratuar.

- Bazuar në shkresën nr. 5200/5 prot., datë 30.12.2024 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, protokolluar në SHSSH me nr. 10043/1 prot., datë 30.12.2024, është kryer alokimi i fondeve në zbatim të VKM nr. 854, datë 26.12.2024, "Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për vitin 2024".

Sipas VKM-së së sipërcituar, kërkesa për transferimin e fondeve rezulton në shumën 2,214,765,000 lekë, e ndarë sipas skemave përkatëse si më poshtë:

- 783,255,000 lekë për skemën e Ndihmës Ekonomike (NE);
- 1,431,510,000 lekë për skemën e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK).

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe tabelës bashkëlidhur shkresës së MSHMS, rezulton se fondet janë alokuar në vlerën totale prej 2,215,235,000 lekë, të shpërndara për njësitë përfituese sipas klasifikimit buxhetor dhe destinacionit të miratuar.

Nga kjo shumë, rezulton se:

* 2,214,765,000 lekë janë alokuar për Shërbimin Social Shtetëror (SHSSH), në përputhje me ndarjen sipas VKM-së;
* ndërsa 470,000 lekë përbëjnë diferencë të evidentuar në tabelën përmbledhëse, sipas shpërndarjes së fondeve.

Alokimi i fondeve është kryer në përputhje me kuadrin ligjor për menaxhimin e sistemit buxhetor, konkretisht me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar, ligjin nr. 97/2023 "*Për buxhetin e vitit 2024*", si dhe udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".*

- Bazuar në shkresën nr. 1749/2 prot., datë 30.04.2024 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, protokolluar në Ministrinë e Financave me nr. përkatës, si dhe në vijim të miratimit me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 5309/1 prot., datë 02.04.2024, është kryer rialokimi i fondeve për vitin 2024.

Në zbatim të kuadrit ligjor për menaxhimin e sistemit buxhetor, konkretisht ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 97/2023 "*Për buxhetin e vitit 2024*", si dhe udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", është miratuar dhe realizuar rialokimi i fondeve sipas tabelës bashkëlidhur.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se fondet janë rialokuar ndërmjet institucioneve përfituese, konkretisht nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore drejt SHSSH sipas klasifikimit buxhetor përkatës (programi, artikulli dhe kodi i thesarit), me qëllim mbulimin e nevojave buxhetore për vitin 2024.

Sa më sipër, efekti i këtij rialokimi konsiston në shtimin e fondeve në dispozicion të SHSSH, duke mundësuar përmbushjen e nevojave të identifikuara për shpenzime në kuadër të programeve përkatëse.

Realizimi i buxhetit të vitit 2024

Fondet e rishikuara të buxhetit për vitin 2024 përfshijnë alokimet e miratuara fillimisht me Ligjin nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", i ndryshuar, si dhe fondet shtesë të përfituara gjatë vitit buxhetor. Ndryshimet e ndodhura gjatë vitit për shpenzimet korrente paraqiten në mënyrë të detajuar sipas programeve në tabelën nr. 1 të Aneksit nr. 1.

Nga auditimi rezulton se realizimi faktik i buxhetit për vitin 2024, në mënyrë të detajuar sipas klasave të llogarive, paraqitet si në vijim:

Tabela nr. 24: "Realizimi i buxhetit të vitit 204" *(në mijë lekë)*

Kod Produkti	Llog	Emertimi Produktit	LB të vitit 2024	Plani Operativ	Realizimi	Dif Realizim - plan fillestar
	600	Paga 600	700,000	789,450	787,064	(2,386)
	601	Sigurime 601	117,000	132,731	131,270	(1,461)
	602	Shpenzime Operative 602	365,600	365,600	363,943	(1,657)
91307AA	606	NE	7,132,000	5,838,388	5,763,984	(74,404)
91307AB	606	PAK	17,918,000	19,735,492	19,612,354	(123,138)
91307AD	606	Bonusi i Bebes	2,200,000	2,200,000	2,200,000	0
91307AH	606	Fondi Social	320,000	324,042	275,366	(48,676)
91307AG	606	Nderrmarjet sociale	80,000	19,207	0	(19,207)
91307AG	604	Nderrmarjet sociale	0	9,333	3,677	(5,656)
91307AN	606	Gratë e Papuna	800,000	865,000	862,710	(2,290)
91307AC	606	Transferta tek individët, Pensione SHSSH	0	1,810	7,584	5,774
91307AL	606	Pagesa gjyqi indeksimi MSHMS	0	324,463	318,595	(5,868)
	606	Mbeshtetje finaceare	0	5,775	0	(5,775)
TOTALI 1			**29,632,600**	**30,611,291**	**30,326,546**	**(284,745)**
18BC008	230	SHSSH Investime Q.Zhvillimit Golem	0	6,000		(6,000)
18BC009	231	SHSSH Investime Z.Hallulli	0	0	5,975	5,975
18BC010	231	SHSHS Investime Z.Hallulli Supervizim	0	0	0	0
18BC205	231	MSHMS Financim i huaj - Grant	0	3,650	0	(3,650)
18BC011	231	MSHMS TVSH, Detyrim Doganor	0	3,520	0	(3,520)

TOTALI 2	**0**	**13,170**	**5,975**	**(7,195)**
TOTALI 1+2	**29,632,600**	**30,624,461**	**30,332,521**	**(291,940)**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi i realizimit të buxhetit për vitin 2024 rezultoi se, megjithëse niveli i përgjithshëm i ekzekutimit paraqitet i lartë, konstatohet mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe realizimit në disa zëra të rëndësishëm të shpenzimeve, si dhe rishikim i planit operativ gjatë vitit buxhetor në raport me parashikimet fillestare.

Nga krahasimi ndërmjet planit fillestar dhe planit operativ konstatohet se për zërin paga fondi është shtuar në vlerën 89,450,000 lekë, për sigurime është shtuar në vlerën 15,731,000 lekë, ndërsa për shpenzime operative nuk evidentohet ndryshim. Në të kundërt, për zërin e ndihmës ekonomike fondi është pakësuar në vlerën 1,293,612,000 lekë, ndërsa për zërin e pagesave për personat me aftësi të kufizuara fondi është shtuar në vlerën 1,817,492,000 lekë, duke reflektuar ndryshim të strukturës së buxhetit gjatë vitit.

Nga krahasimi ndërmjet planit operativ dhe realizimit faktik rezulton se disa zëra paraqesin nënrealizim, konkretisht për paga në vlerën 2,386,000 lekë, për sigurime në vlerën 1,461,000 lekë, për shpenzime operative në vlerën 1,657,000 lekë, për ndihmën ekonomike në vlerën 74,404,000 lekë, për pagesat për personat me aftësi të kufizuara në vlerën 123,138,000 lekë dhe për fondin social në vlerën 48,676,000 lekë. Gjithashtu, fondet për ndërmarrjet sociale nuk janë realizuar sipas planit operativ, ndërsa për transfertat për individët evidentohet realizim mbi planin operativ.

Në komponentin e investimeve, realizimi paraqitet më i ulët se plani operativ, duke reflektuar nënrealizim të fondeve të parashikuara për këtë kategori shpenzimesh.

Këto ndryshime ndërmjet planit fillestar dhe planit operativ, si dhe devijimet ndërmjet planit operativ dhe realizimit, tregojnë për parashikim jo të qëndrueshëm të nevojave buxhetore dhe mangësi në monitorimin e zbatimit të buxhetit, në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 9 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Menaxhimi i financave publike bazohet në parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, si dhe në disiplinën fiskale", si dhe se "planifikimi dhe zbatimi i buxhetit duhet të sigurojnë përdorim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të fondeve publike."*

Si pasojë, krijohen devijime në strukturën dhe realizimin e buxhetit, të cilat ndikojnë në besueshmërinë e planifikimit dhe në efikasitetin e përdorimit të fondeve publike.

Viti 2023

Programimi i PBA-së 2023–2025 dhe programimi i buxhetit vjetor 2023

Në kuadër të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023–2025, Shërbimi Social Shtetëror ka paraqitur kërkesat buxhetore për fazën e dytë të PBA-së, në përputhje me tavanet orientuese të miratuara dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave.

Këto kërkesa janë hartuar mbi bazën e analizës së nevojave për përmbushjen e misionit institucional, realizimin e objektivave strategjikë dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve sociale, duke reflektuar:

- strukturën organizative (administrata qendrore, zyrat rajonale dhe institucionet e përkujdesit shoqëror);
- mbështetjen financiare për individët dhe familjet në nevojë;
- kostot operative dhe administrative;
- prioritetet e politikave sociale të përcaktuara nga ministria përgjegjëse.

Programimi i PBA-së 2023-2025dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2023

Në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023–2025, kërkesat buxhetore janë hartuar në përputhje me tavanet orientuese dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe

Ekonomisë, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018.
Planifikimi i shpenzimeve për "Fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore" (llogaritë 600 dhe 601) është bazuar në numrin aktual të punonjësve dhe strukturën e miratuar për çdo program buxhetor, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
Ndërsa planifikimi i shpenzimeve të tjera korrente (llogaritë 602–606) është mbështetur në kërkesat e institucioneve të varësisë, tavaneve të miratuara, si dhe në analizën e realizimit të periudhave paraardhëse dhe pritshmëritë për vitin 2023.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2023-2025

Nga auditimi u evidentua se, në fazën e parë strategjike të përgatitjes së PBA-së 2023–2025, Shërbimi Social Shtetëror nuk ka paraqitur kërkesa buxhetore, por ato janë përfshirë dhe paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni nga i cili varet.
Për rrjedhojë, grupi i auditimit mori në analizë kërkesat buxhetore të fazës së parë të PBA-së 2023–2025, të paraqitura nga MSHMS në nivel llogarish për programin buxhetor 10430 "*Përkujdesje Sociale*", të cilat në fund të kësaj faze rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 25 "Fondet buxhetore të parashikuara për Përkujdesjen Sociale në fund të fazës së parë të PBA 2023–2025, në nivel llogarish." *(në mijë lekë)*

Totali i shpenzimeve te programit	2023	2024	2025
	27,280,000,000	**27,680,000,000**	**28,180,000,000**
600 - Paga	**528,817,000**	**528,817,000**	**528,817,000**
01 - Nga Buxheti	528,817,000	528,817,000	528,817,000
601 - Sigurime Shoqërore	**88,313,000**	**88,313,000**	**88,313,000**
01 - Nga Buxheti	88,313,000	88,313,000	88,313,000
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	**332,870,000**	**332,870,000**	**332,870,000**
01 - Nga Buxheti	332,870,000	332,870,000	332,870,000
606 - Trans per Buxh. Fam. & Individ	**26,050,000,000**	**26,450,000,000**	**26,950,000,000**
01 - Nga Buxheti	26,050,000,000	26,450,000,000	26,950,000,000
230 - Kapitale të Patrupëzuara	**2,500,000**	**0**	**0**
01 - Nga Buxheti	2,500,000	0	0
231 - Kapitale të Trupëzuara	**277,500,000**	**280,000,000**	**280,000,000**
01 - Nga Buxheti	170,200,000	176,350,000	178,780,000
02 - Financim i huaj - Grant	31,000,000	31,000,000	31,000,000
22 - Financim i huaj - Kredi	69,000,000	69,000,000	69,000,000
04 - TVSH, Detyrim Doganor	7,300,000	3,650,000	1,220,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të VKM nr.130/2022 dhe të dhënave të publikuara në faqen e MF[11]

Nga tabela më sipër rezulton se, në përfundim të fazës së parë të planifikimit buxhetor afatmesëm, për vitin 2023 rreth 99% e shpenzimeve totale përbëhet nga shpenzime korrente. Nga këto, rreth 2.3% përfaqësojnë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (llogaritë 600 dhe 601).
Transfertat (llogaria 606) zënë rreth 95.5% të totalit të shpenzimeve, duke përbërë peshën kryesore të shpenzimeve të programit buxhetor dhe duke reflektuar karakterin social të tij, të fokusuar në mbështetjen financiare për familjet dhe individët në nevojë.
Ndërkohë, shpenzimet kapitale (investimet), përfshirë llogaritë 230 dhe 231, paraqiten në nivele minimale, rreth 1% të totalit të shpenzimeve, çka tregon një fokus të kufizuar në investime krahasuar me shpenzimet korrente.
Me anë të VKM nr. 130 datë 02.03.2022 "*Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025*", ku sipas së cilës tavanet për programin 10430 "*Përkujdesje Sociale*", në nivel shpenzimesh korrente dhe kapitale paraqiten si në tabelën më poshtë:

[11] https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Farkiva.financa.gov.al%2Fwp-content%2Fuploads%2F2022%2F08%2F13-Ministria-e-Shendetesise-dhe-Mbrojtjes-Sociale-1.xlsx&wdOrigin=BROWSELINK

Tabela nr. 26 "Fondet buxhetore të Përkujdesjes Sociale të miratuara për Fazën e I-të të PBA 23-25"

Në mijë lekë

Shpenzimet 2025			Shpenzimet 2026			Shpenzimet 2025		
Korr.	**Kapitale**	**Totali**	**Korrente**	**Kapitale**	**Totali**	**Korrente**	**Kapitale**	**Totali**
27,000,000	280,000	27,280,000	27,400,000	280,000	27,680,000	27,900,000	280,000	28,180,000

Burimi: VKM nr. 130/2022 Përpunuar nga grupi i auditimit.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II-të të PBA 2023-2025

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023–2025 janë miratuar me VKM nr. 535, datë 29.07.2022, "*Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023–2025*", të cilat, në nivel programi për "*Përkujdesje Sociale*" (10430), paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 27 "Fondet buxhetore të Përkujdesjes Sociale të miratuara për fazën e II-të të PBA 23-25"

Në mijë lekë

Përshkrimi	2023	2024	2025
Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore	617,130	617,130	617,130
Shpenzime të tjera korrente	26,382,870	26,782,870	27,282,870
I. Totali i shpenzimeve korrente	**27,000,000**	**27,400,000**	**27,900,000**
Financim i brendshëm	180,000	180,000	180,000
Financim i huaj	100,000	100,000	100,000
II. Totali i shpenzimeve kapitale	**280,000**	**280,000**	**280,000**
III. Totali i shpenzimeve buxhetore	**27,280,000**	**27,680,000**	**28,180,000**

Burimi: VKM nr. 535/2022, Përpunuar nga grupi i auditimit.

Drejtoresha e Shërbimit Social Shtetëror zj. R.Xh. ka përcjellë pranë MSHMS kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026, brenda afatit të parashikuar në VKM nr. 22, datë 17.01.2024 *"Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2023",* të cilat në nivel produkti, krahasuar me tavanet përgatitore, paraqiten sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Për vlerësimin e respektimit të tavaneve përfundimtare të shpenzimeve buxhetore, grupi i auditimit krahasoi kërkesat buxhetore të paraqitura nga Shërbimi Social Shtetëror në fazën e dytë të PBA 2023–2025 me tavanet përfundimtare të miratuara me VKM nr. 535 datë 29.07.2022.

Në vijim paraqitet krahasimi i kërkesave buxhetore me tavanet përfundimtare, në nivel të shpenzimeve korrente dhe kapital

Tabela nr. 28: *"Kërkesat e paraqitura nga SHSSH në Fazën e II-te të PBA vs Tavanet përfundimtare"*

Në mijë lekë

Emërtimi llogarisë	I.Shuma (lekë)	II.Tavanet	Diferenca I-II
600	544,230	528,817	15,413
601	90,886	88,313	2,573
602	387,435	332,870	54,565
606	26,851,012	26,050,000	801,012
Toatli shp. Korrente	**27,873,563**	**27,000,000**	873,563
230	**57,199**	280,000	- 222,801
Totali I shpenzimeve buxhetore 2023	**27,930,762**	**27,280,000**	650,762

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të SHSSH dhe VKM nr. 535/2022.

Nga tabela e mësipër rezulton se, nga SHSSH në paraqitjen e kërkesave buxhetore për fazën e dytë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023–2025, nuk janë respektuar tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore, të miratuara me VKM nr. 535, datë 29.07.2022. Konkretisht:

- shpenzimet korrente të kërkuara rezultojnë në vlerën 27,873,563 mijë lekë, kundrejt tavanit të miratuar prej 27,000,000 mijë lekë, duke rezultuar në tejkalim prej 873,563 mijë lekë;
- në nivel të zërave përbërës të shpenzimeve korrente evidentohet tejkalim në llogaritë:

◎ 600 "*Paga"* në shumën 15,413 mijë lekë;
◎ 601 "*Sigurime shoqërore*" në shumën 2,573 mijë lekë;
◎ 602 "Mallra dhe shërbime" në shumën 54,565 mijë lekë;

◎ 606 “Transferta” në shumën 801,012 mijë lekë.
- shpenzimet kapitale (llogaria 230) rezultojnë në vlerën 57,199 mijë lekë, kundrejt tavanit të miratuar prej 280,000 mijë lekë, duke reflektuar nënplanifikim në shumën 222,801 mijë lekë;
- për rrjedhojë, edhe totali i shpenzimeve buxhetore është paraqitur mbi nivelin e miratuar, në vlerën 27,930,762 mijë lekë, kundrejt tavanit 27,280,000 mijë lekë, duke rezultuar në tejkalim prej 650,762 mijë lekë.
Tejkalimi i tavaneve përfundimtare në fazën teknike të PBA-së Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit Plotësues nr. 22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023–2025”, ku përcaktohet se: *“Objektivi i fazës teknike të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 është përpunimi i detajeve teknike të buxhetit brenda tavaneve përfundimtare të miratuara. Në këtë kuptim, Njësitë e Qeverisjes Qendrore nuk mund të ri-sjellin kërkesa për financimin e politikave të reja dhe kërkesa për mangësitë në financim të politikave ekzistuese.”*

Faza e III-të e PBA 2023-2025

Me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomise nr. 44, datë 28.02.2023, është miratuar Programi Buxhetor Afatmesëm 2023–2025 i rishikuar (Faza III), në përputhje me tavanet buxhetore të përcaktuara në Ligjin nr. 84/2022 “*Për Buxhetin e vitit 2022*”.
Për programin buxhetor 10430 “*Përkujdesi Social*”, paraqitjet në nivel llogarish rezultojnë si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 29 “Shpenzime buxhetore të programit 10430, PBA 2023-2025, Faza III-të”

Në lekë

Llogaria	2023	2024	2025
Totali shpenzimeve të Programit	**29,589,778,000**	**29,832,000,000**	**30,232,000,000**
600 - Paga	**623,817,000**	**623,817,000**	**623,817,000**
01 - Nga Buxheti	623,817,000	623,817,000	623,817,000
601 - Sigurime Shoqërore	**105,313,000**	**105,313,000**	**105,313,000**
01 - Nga Buxheti	105,313,000	105,313,000	105,313,000
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	**332,870,000**	**332,870,000**	**332,870,000**
01 - Nga Buxheti	332,870,000	332,870,000	332,870,000
606 - Trans per Buxh. Fam. & Individ	**28,150,000,000**	**28,450,000,000**	**28,850,000,000**
01 - Nga Buxheti	28,150,000,000	28,450,000,000	28,850,000,000
230 - Kapitale të Patrupëzuara	**2,500,000**	**0**	**0**
01 - Nga Buxheti	2,500,000	0	0
231 - Kapitale të Trupëzuara	**375,278,000**	**320,000,000**	**320,000,000**
01 - Nga Buxheti	60,178,000	16,350,000	18,780,000
02 - Financim i huaj - Grant	31,000,000	31,000,000	31,000,000
22 - Financim i huaj - Kredi	269,000,000	269,000,000	269,000,000
04 - TVSH, Detyrim Doganor	15,100,000	3,650,000	1,220,000

Burimi: MF. Përpunuar nga grupi i auditimit.[12]

Nga tabela më sipër rezulton se, për vitin 2023, totali i shpenzimeve të programit paraqitet në shumën 29,589,778,000 lekë. Shpenzimet korrente rezultojnë në shumën 29,212,000,000 lekë, duke zënë rreth 98.7% të totalit, ndërsa shpenzimet kapitale në shumën 377,778,000 lekë, ose rreth 1.3%.
Në strukturën e shpenzimeve korrente, llogaria 606 “*Transferta për buxhetet familjare dhe individët*” paraqitet në shumën 28,150,000,000 lekë, duke zënë rreth 95.1% të totalit të shpenzimeve të programit dhe rreth 96.4% të shpenzimeve korrente. Llogaria 600 “Paga” paraqitet në shumën 623,817,000 lekë ose rreth 2.1%, llogaria 601 “*Sigurime shoqërore*” në shumën 105,313,000 lekë ose rreth 0.4% dhe llogaria 602 “*Mallra dhe shërbime*” në shumën 332,870,000 lekë (rreth 1.1%).
Shpenzimet kapitale paraqiten në nivel të ulët, në shumën 377,778,000 lekë, nga të cilat pjesën kryesore e zë llogaria 231 “*Kapitale të trupëzuara*”, ndërsa llogaria 230 paraqitet në vlerë minimale

Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2023

[12] 13-Ministria-e-Shendetesise-dhe-Mbrojtjes-Sociale-Faza-III-2023-2025.xlsx

Sipas Ligjit nr. 84/2022, datë 24.11.2022 "*Për buxhetin e vitit 2023*", shpenzimet buxhetore për programin 10430 "*Përkujdesi Social",* sipas Tabelës nr. 1 të tij, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 30: "Shpenzimet korrente e kapitale sipas Ligjit nr. 84/2022"

Në mijë lekë

Programi	Emri i programit	Shpenzimet 2023		
		Korrente	Kapitale	Totali
10430	Perkujdesi Social	29,212,000	377,778	29,589,778

Burimi: Ligji nr. 84/2022"Për buxhetin e vitit 2023"

Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente të SHSSH është bërë me shkresën nr. 337 prot., datë 21.01.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, "*Dërgohet plani i buxhetit për vitin 2025*", ku në nivel produkti paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga auditimi konstatohet se detajimi fillestar i shpenzimeve korrente për vitin 2023 është bërë në përputhje me tabelën nr. 1 të Ligjit nr. 84/2022 të Buxhetit për vitin 2023, "*Buxheti 2023 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore*".

Buxheti i vitit 2023 i parashikuar për shpenzimet totale buxhetore (shpenzime korrente dhe kapitale) ka pësuar ndryshime, që prej fazës së Projekt Buxhetit të vitit 2023 deri në ligjin nr. 84/2022 "*Për buxhetin e vitit 2023",* i cili ka ndryshuar me pas me 2 akte normative të cilat janë si më poshtë:

◎ Akti normativ nr. 5, datë 18.10.2023;

◎ Akti Normativ nr. 6 datë 14.12.2023.

Ndryshimet e shpenzimeve buxhetore, nga Ligji nr. 84/2022 deri në planin përfundimtar sipas akteve normative apo transfertave të ndryshme, paraqiten në tabelën nr. 3 Aneksit nr. 1.

Realizimi i buxhetit të vitit 2023

Fondet e rishikuara të buxhetit për vitin 2023 përfshijnë alokimet e miratuara fillimisht me Ligjin nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", i ndryshuar, si dhe fondet shtesë të përfituara gjatë vitit buxhetor. Ndryshimet e ndodhura gjatë vitit për shpenzimet korrente paraqiten në mënyrë të detajuar sipas programeve në tabelën nr. 3 të Aneksit nr. 1.

Nga auditimi rezulton se realizimi faktik i buxhetit për vitin 2023, në mënyrë të detajuar sipas klasave të llogarive, paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga auditimi i realizimit të buxhetit për vitin 2023 rezultoi se, megjithëse niveli i përgjithshëm i ekzekutimit paraqitet i lartë, evidentohet mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe realizimit në disa zëra të rëndësishëm të shpenzimeve.

Nga krahasimi ndërmjet planit total dhe realizimit faktik, konstatohet se në total buxheti paraqet një mosrealizim në vlerën 501,691 mijë lekë, duke reflektuar devijime në disa programe kryesore.

Konkretisht:

- për zërin Ndihma Ekonomike (NE) konstatohet mosrealizim në vlerën 247,971 mijë lekë;
- për zërin Pagesa për PAK konstatohet mosrealizim në vlerën 219,062 mijë lekë;
- për Fondin Social në vlerën 22,784 mijë lekë;
- për Vendime gjyqësore MSHMS në vlerën 5,101 mijë lekë;
- si dhe për disa zëra të tjerë me vlera më të vogla.

Në nivel institucionesh, pothuajse të gjitha njësitë paraqesin diferenca negative ndërmjet planit dhe realizimit, çka tregon për një tendencë të përgjithshme të mbivlerësimit të nevojave buxhetore në fazën e planifikimit ose për mosrealizim të plotë të aktiviteteve të planifikuara.

Në tërësi, edhe pse realizimi i buxhetit paraqitet në nivele të larta, devijimet e konstatuara në zërat kryesorë, veçanërisht në skemat sociale si NE dhe PAK, tregojnë për parashikim jo

plotësisht realist të nevojave buxhetore dhe mangësi në monitorimin e zbatimit të buxhetit, në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 9 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, ku përcaktohet se planifikimi dhe zbatimi i buxhetit duhet të mbështeten në parimet e realizmit, qëndrueshmërisë dhe disiplinës fiskale.
Si pasojë, krijohen devijime ndërmjet planifikimit dhe realizimit faktik, të cilat ndikojnë në besueshmërinë e planifikimit buxhetor dhe në eficiencën e përdorimit të fondeve publike.

Viti 2022

Programimi i PBA-së 2022–2024 dhe programimi i buxhetit vjetor 2022

Në kuadër të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2022–2024, Shërbimi Social Shtetëror ka paraqitur kërkesat buxhetore për fazën e dytë të PBA-së, në përputhje me tavanet orientuese të miratuara dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave.
Këto kërkesa janë hartuar mbi bazën e analizës së nevojave për përmbushjen e misionit institucional, realizimin e objektivave strategjikë dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve sociale, duke reflektuar:

- strukturën organizative (administrata qendrore, zyrat rajonale dhe institucionet e përkujdesit shoqëror);
- mbështetjen financiare për individët dhe familjet në nevojë;
- kostot operative dhe administrative;
- prioritetet e politikave sociale të përcaktuara nga ministria përgjegjëse.

Programimi i PBA-së 2022-2024 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2022

Në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2022–2024, kërkesat buxhetore janë hartuar në përputhje me tavanet orientuese dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018.
Planifikimi i shpenzimeve për "Fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore" (llogaritë 600 dhe 601) është bazuar në numrin aktual të punonjësve dhe strukturën e miratuar për çdo program buxhetor, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
Ndërsa planifikimi i shpenzimeve të tjera korrente (llogaritë 602–606) është mbështetur në kërkesat e institucioneve të varësisë, tavaneve të miratuara, si dhe në analizën e realizimit të periudhave paraardhëse dhe pritshmëritë për vitin 2022.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2022-2024

Nga auditimi u evidentua se, në fazën e parë strategjike të përgatitjes së PBA-së 2022–2024, Shërbimi Social Shtetëror nuk ka paraqitur kërkesa buxhetore, por ato janë përfshirë dhe paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni nga i cili varet.
Për rrjedhojë, grupi i auditimit mori në analizë kërkesat buxhetore të fazës së parë të PBA-së 2022–2024, të paraqitura nga MSHMS në nivel llogarish për programin buxhetor 10430 "*Përkujdesje Sociale*", të cilat në fund të kësaj faze rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 31 "Fondet buxhetore të parashikuara për Përkujdesjen Sociale në fund të fazës së parë të PBA 2022–2024, në nivel llogarish."

Në mijë lekë

Përshkrimi	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi
Totali shpenzimeve të Programit	**25,299,260,000**	**26,159,260,000**	**26,759,260,000**
600 - Paga	546,260,000	546,260,000	546,260,000
01 - Nga Buxheti	546,260,000	546,260,000	546,260,000
601 - Sigurime Shoqërore	102,000,000	102,000,000	102,000,000
01 - Nga Buxheti	102,000,000	102,000,000	102,000,000
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	331,000,000	331,000,000	331,000,000
01 - Nga Buxheti	331,000,000	331,000,000	331,000,000
606 - Trans per Buxh. Fam. & Individ	24,200,000,000	24,900,000,000	25,500,000,000

01 - Nga Buxheti	24,200,000,000	24,900,000,000	25,500,000,000
231 - Kapitale të Trupëzuara	120,000,000	280,000,000	280,000,000
01 - Nga Buxheti	20,000,000	180,000,000	180,000,000
22 - Financim i huaj - Kredi	100,000,000	100,000,000	100,000,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të VKM nr.119/2021 dhe të dhënave të publikuara në faqen e MF.[13]

Nga tabela më sipër rezulton se, në përfundim të fazës së parë të planifikimit buxhetor afatmesëm, për vitin 2022, rreth 99% e shpenzimeve totale përbëhet nga shpenzime korrente. Nga këto, rreth 2.6% përfaqësojnë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (llogaritë 600 dhe 601), konkretisht:

- paga në vlerën 546,260,000 lekë;
- sigurime shoqërore në vlerën 102,000,000 lekë.

Transfertat (llogaria 606) zënë rreth 95.6% të totalit të shpenzimeve (24,200,000,000 lekë), duke përbërë peshën kryesore të programit buxhetor dhe duke reflektuar karakterin e tij social, të orientuar drejt mbështetjes financiare për familjet dhe individët në nevojë.

Ndërkohë, shpenzimet për mallra dhe shërbime (llogaria 602) përbëjnë rreth 1.3% të totalit (331,000,000 lekë), duke mbuluar funksionimin administrativ të strukturave përkatëse.

Shpenzimet kapitale (investimet), përfshirë llogarinë 231, paraqiten në nivele minimale, rreth 0.5% të totalit (120,000,000 lekë), nga të cilat:

- 20,000,000 lekë financim nga buxheti;
- 100,000,000 lekë financim i huaj (kredi).

Kjo strukturë e shpenzimeve paraqet raport të lartë të transfertave sociale ndaj shpenzimeve të tjera, duke evidencuar fokusin e programit buxhetor në përmbushjen e funksionit të tij social, ndërkohë që investimet mbeten në nivele të kufizuara krahasuar me shpenzimet korrente.

Tabela nr. 29 "Fondet buxhetore të Përkujdesjes Sociale të miratuara për Fazën e I-të të PBA 23-25"

Në mijë lekë

Shpenzimet 2022			Shpenzimet 2023			Shpenzimet 2024		
Korr.	**Kapitale**	**Totali**	**Korrente**	**Kapitale**	**Totali**	**Korrente**	**Kapitale**	**Totali**
25,049,260	120,000	25,169,260	25,749,260	280,000	26,029,260	26,349,260	280,000	26,629,260

Burimi: VKM nr. 119/2021 Përpunuar nga grupi i auditimit.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II-të të PBA 2022-2024

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022–2024 janë miratuar me VKM nr. 440, datë 22.07.2021, "*Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022–2024*", të cilat, në nivel programi për "*Përkujdesje Sociale*" (10430), paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 32 "Fondet buxhetore të Përkujdesjes Sociale të miratuara për fazën e II-të të PBA 23-25"

Në mijë lekë

Përshkrimi	2022	2023	2024
Shpenzime të tjera korrente	25,179,260	25,879,260	25,979,260
I. Totali i shpenzimeve korrente	**120,000**	**280,000**	**280,000**
III. Totali i shpenzimeve buxhetore	**25,299,260**	**26,159,260**	**26,259,260**

Burimi: VKM nr. 440/2021, Përpunuar nga grupi i auditimit.

Kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026, të dërguara nga Shërbimi Social Shtetëror pranë MSHMS, në nivel produkti, krahasuar me tavanet përfundimtare, paraqiten sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga auditimi rezulton se, nga SHSSH, në paraqitjen e kërkesave buxhetore në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2022–2024 (PBA 2022–2026 në fazën teknike), nuk janë respektuar tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore të miratuara.

Konkretisht, në nivel total:

[13] Ministria e Financave dhe Ekonomise

- kërkesat buxhetore rezultojnë në vlerën 26,298,000 mijë lekë, kundrejt tavaneve të miratuara në vlerën 25,199,260 mijë lekë, duke rezultuar në tejkalim prej 1,098,740 mijë lekë;

Në nivel të shpenzimeve korrente, evidentohet tejkalim si më poshtë:

- llogaria 600 "Paga" në shumën 26,404 mijë lekë (554,499 kundrejt 528,095);
- llogaria 601 "Sigurime shoqërore" në shumën 27 mijë lekë (88,192 kundrejt 88,165);
- llogaria 602 "Mallra dhe shërbime" në shumën 64,101 mijë lekë (427,101 kundrejt 363,000);

Ndërkohë, në komponentin kryesor të programit:

- llogaria 606 "Transferta" paraqitet me tejkalim të konsiderueshëm, konkretisht:

***** për Ndihmën Ekonomike (NE) në shumën 174,516 mijë lekë (4,964,516 kundrejt 4,790,000);

***** për Pagesat e PAK në shumën 635,797 mijë lekë (17,745,797 kundrejt 17,110,000);

Nga ana tjetër:

- shpenzimet kapitale (llogaria 231) rezultojnë në vlerën 217,895 mijë lekë, kundrejt tavanit prej 20,000 mijë lekë, duke reflektuar tejkalim të konsiderueshëm prej 197,895 mijë lekë, që tregon devijim nga struktura e miratuar e buxhetit.

Për rrjedhojë, edhe totali i shpenzimeve buxhetore është paraqitur mbi nivelin e miratuar, duke reflektuar një mosrespektim të kufijve të vendosur në fazën përfundimtare të PBA-së.

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit Plotësues "*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022–2024*", ku përcaktohet se: *"Objektivi i fazës teknike të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm është përpunimi i detajeve teknike të buxhetit brenda tavaneve përfundimtare të miratuara, dhe njësitë e qeverisjes qendrore nuk mund të paraqesin kërkesa që tejkalojnë këto tavane."*

Faza e III-të e PBA 2022-2024

Programi Buxhetor Afatmesëm 2022–2024 i rishikuar (Faza III), në përputhje me tavanet buxhetore të përcaktuara në Ligjin nr. 115/2021 "*Për Buxhetin e vitit 2022*".

Për programin buxhetor 10430 "*Përkujdesi Social*", paraqitjet në nivel llogarish rezultojnë si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 33: "Shpenzime buxhetore të programit 10430, PBA 2023-2025, Faza III-të"

Në lekë

Përshkrimi	2022	2023	2024
Totali shpenzimev	**26,818,130,000**	**27,168,000,000**	**27,668,000,000**
600 - Paga	528,817,000	528,817,000	528,817,000
01 - Nga Buxheti	528,817,000	528,817,000	528,817,000
601 - Sigurime Shoqërore	88,313,000	88,313,000	88,313,000
01 - Nga Buxheti	88,313,000	88,313,000	88,313,000
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	331,000,000	220,870,000	320,870,000
01 - Nga Buxheti	331,000,000	220,870,000	320,870,000
606 - Trans per Buxh. Fam. & Individ	25,750,000,000	26,050,000,000	26,450,000,000
01 - Nga Buxheti	25,750,000,000	26,050,000,000	26,450,000,000
231 - Kapitale të Trupëzuara	120,000,000	280,000,000	280,000,000
01 - Nga Buxheti	20,000,000	180,000,000	180,000,000
22 - Financim i huaj - Kredi	100,000,000	100,000,000	100,000,000

Burimi: MF. Përpunuar nga grupi i auditimit.[14]

Nga tabela më sipër rezulton se, për vitin 2022, totali i shpenzimeve të programit paraqitet në shumën 26,818,130,000 lekë.

Shpenzimet korrente rezultojnë në shumën 26,698,130,000 lekë, duke zënë rreth 99.6% të totalit, ndërsa shpenzimet kapitale në shumën 120,000,000 lekë, ose rreth 0.4%.

Në strukturën e shpenzimeve korrente, llogaria 606 "*Transferta për buxhetet familjare dhe individët*" paraqitet në shumën 25,750,000,000 lekë, duke zënë rreth 96.0% të totalit të shpenzimeve të programit dhe rreth 96.5% të shpenzimeve korrente.

[14] 13-Ministria-e-Shendetesise-dhe-Mbrojtjes-Sociale-Faza-III-2023-2025.xlsx

Llogaria 600 "*Paga"* paraqitet në shumën 528,817,000 lekë ose rreth 2.0%, llogaria 601 *"Sigurime shoqërore*" në shumën 88,313,000 lekë ose rreth 0.3%, ndërsa llogaria 602 "*Mallra dhe shërbime*" në shumën 331,000,000 lekë (rreth 1.2%).
Shpenzimet kapitale paraqiten në nivel shumë të ulët, në shumën 120,000,000 lekë, nga të cilat pjesën kryesore e zë llogaria 231 "*Kapitale të trupëzuara*", ndërsa komponenti i financimit nga buxheti mbetet minimal në raport me totalin e programit.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2023

Sipas Ligjit nr. 115/2021 "*Për buxhetin e vitit 2022*", shpenzimet buxhetore për programin 10430 "*Përkujdesi Social",* sipas Tabelës nr. 1 të tij, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 34: "Shpenzimet korrente e kapitale sipas Ligjit nr. 115/2021"

Në mijë lekë

Programi	Emri i programit	Shpenzimet 2023		
		Korrente	Kapitale	Totali
10430	Perkujdesi Social	26,698,130	120,000	26,818,130

Burimi: Ligji nr. 115/2021"Për buxhetin e vitit 2022"

Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente të SHSSH është bërë me shkrësën e MSHMS nr. 64, datë 13.01.2022 në nivel produkti paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".
Nga auditimi konstatohet se detajimi fillestar i shpenzimeve korrente për vitin 2022 është bërë në përputhje me tabelën nr. 1 të Ligjit nr. 115/2021 të Buxhetit për vitin 2023, "*Buxheti 2023 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore*".
Buxheti i vitit 2022 i parashikuar për shpenzimet totale buxhetore (shpenzime korrente dhe kapitale) ka pësuar ndryshime, që prej fazës së Projekt Buxhetit të vitit 2022 deri në ligjin nr. 115/2021 "*Për buxhetin e vitit 2022",* i cili ka ndryshuar me pas me 4 akte normative të cilat janë si më poshtë:

- Akti normativ nr. 3, datë 12.03.2022;
- Akti Normativ nr. 12 datë 29.07.2022;
- Akti Normativ nr. 17 datë 01.12.2022;
- Akti Normativ nr. 19 datë 29.12.2022.

Ndryshimet e shpenzimeve buxhetore, nga Ligji nr. 115/2021 deri në planin përfundimtar sipas akteve normative apo transfertave të ndryshme, paraqiten në tabelën nr. 4 Aneksit nr. 1.

Realizimi i buxhetit të vitit 2022

Nga auditimi rezulton se realizimi faktik i buxhetit për vitin 2022, në mënyrë të detajuar sipas klasave të llogarive, paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga auditimi i realizimit të buxhetit për vitin 2022 rezultoi se, megjithëse niveli i përgjithshëm i ekzekutimit paraqitet relativisht i lartë, evidentohet mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe realizimit në disa zëra të rëndësishëm të shpenzimeve.
Nga krahasimi ndërmjet planit total dhe realizimit faktik, konstatohet se në total buxheti paraqet një mosrealizim në vlerën 204,979 mijë lekë, duke reflektuar devijime kryesisht në zërat e transfertave sociale dhe fondeve mbështetëse.
Konkretisht:

- për zërin Pagesa për PAK konstatohet mosrealizim në vlerën 105,811 mijë lekë;
- për zërin Ndihma Ekonomike (NE) konstatohet mosrealizim në vlerën 49,825 mijë lekë;
- për Fondin Social në vlerën 36,550 mijë lekë;
- për Vendime gjyqësore në vlerën 2,998 mijë lekë;
- si dhe për zëra të tjerë me ndikim më të kufizuar, përfshirë transfertat për individë dhe programe të veçanta.

Në nivel institucionesh, pothuajse të gjitha njësitë paraqesin diferenca negative ndërmjet planit dhe realizimit, me përjashtim të Administratës Qendrore të SHSSH, e cila rezulton me tejkalim në vlerën 2,033 mijë lekë. Diferencat më të theksuara negative evidentohen në njësi si:

* Shtëpia e Foshnjës Vlorë (−993 mijë lekë);
* Shtëpia e Foshnjës Korçë (−705 mijë lekë);
* Shtëpia e Fëmijës Shkollor Sarandë (−481 mijë lekë);
* Zyra Rajonale Berat dhe Korçë, si dhe disa qendra zhvillimi dhe shërbimesh komunitare.

Në tërësi, edhe pse realizimi i buxhetit paraqitet i lartë, devijimet e konstatuara, veçanërisht në skemat kryesore sociale si NE dhe PAK, tregojnë për parashikim jo plotësisht realist të nevojave buxhetore dhe për mangësi në monitorimin e zbatimit të buxhetit.

Kjo situatë është në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 9 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", ku përcaktohet se planifikimi dhe zbatimi i buxhetit duhet të mbështeten në parimet e realizmit, qëndrueshmërisë dhe disiplinës fiskale.

Si pasojë, krijohen devijime ndërmjet planifikimit dhe realizimit faktik, të cilat ndikojnë në besueshmërinë e planifikimit buxhetor dhe në eficiencën e përdorimit të fondeve publike.

Viti 2021

Programimi i PBA-së 2021–2023 dhe programimi i buxhetit vjetor 2021

Në kuadër të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2021–2023, Shërbimi Social Shtetëror ka paraqitur kërkesat buxhetore për fazën e dytë të PBA-së, në përputhje me tavanet orientuese të miratuara dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave.

Këto kërkesa janë hartuar mbi bazën e analizës së nevojave për përmbushjen e misionit institucional, realizimin e objektivave strategjikë dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve sociale, duke reflektuar:

- strukturën organizative (administrata qendrore, zyrat rajonale dhe institucionet e përkujdesit shoqëror);
- mbështetjen financiare për individët dhe familjet në nevojë;
- kostot operative dhe administrative;
- prioritetet e politikave sociale të përcaktuara nga ministria përgjegjëse.

Programimi i PBA-së 2021-2023 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2021

Në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2021–2023, kërkesat buxhetore janë hartuar në përputhje me tavanet orientuese dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018.

Planifikimi i shpenzimeve për "Fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore" (llogaritë 600 dhe 601) është bazuar në numrin aktual të punonjësve dhe strukturën e miratuar për çdo program buxhetor, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Ndërsa planifikimi i shpenzimeve të tjera korrente (llogaritë 602–606) është mbështetur në kërkesat e institucioneve të varësisë, tavaneve të miratuara, si dhe në analizën e realizimit të periudhave paraardhëse dhe pritshmëritë për vitin 2021.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2021-2023

Për vitin 2021 (PBA 2021–2023), faza strategjike nuk është kryer, pasi nuk janë hartuar dhe miratuar tavanet përgatitore të shpenzimeve brenda afateve të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 9936/2008.

Si arsyetim, nga ana e MFE është referuar Akti Normativ nr. 17, datë 22.04.2020, sipas të cilit, përjashtimisht për vitin 2020, si pasojë e situatës epidemike të shkaktuar nga COVID-19, procedurat dhe afatet për përgatitjen e projektdokumentit të PBA-së nuk zbatohen.

Megjithatë, ky arsyetim nuk qëndron plotësisht, pasi:
- afati ligjor për përfundimin e fazës strategjike ka qenë brenda muajit shkurt 2020 (deri më 25.02.2020);
- ndërkohë, akti normativ është miratuar më 22.04.2020, pra pas përfundimit të këtij afati.

Pavarësisht kësaj, procesi ka vijuar me nxjerrjen e tavaneve përfundimtare me VKM nr. 577, datë 22.07.2020, duke anashkaluar fazën strategjike.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II-të të PBA 2021-2023

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021–2023 janë miratuar me VKM nr. 577 datë 22.07.2020, "*Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021–2023*", të cilat, në nivel programi për "*Përkujdesje Sociale*" (10430), paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 35 "Fondet buxhetore të Përkujdesjes Sociale të miratuara për fazën e II-të të PBA 23-25"

Në mijë lekë

Përshkrimi	2021	2022	2023
Shpenzime të tjera korrente	24,549,260	24,749,260	25,549,260
I. Totali i shpenzimeve kapitale	**120,000**	**120,000**	**380,000**
III. Totali i shpenzimeve buxhetore	**24,669,260**	**24,869,260**	**25,929,260**

Burimi: VKM nr. 577/2020, Përpunuar nga grupi i auditimit.

Kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2021–2023, të dërguara nga Shërbimi Social Shtetëror pranë MSHMS, në nivel produkti, krahasuar me tavanet përfundimtare, paraqiten sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga auditimi rezulton se, nga SHSSH, në paraqitjen e kërkesave buxhetore në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2021–2023, nuk janë respektuar plotësisht tavanet e shpenzimeve buxhetore të miratuara.

Konkretisht, në nivel total:
- kërkesat buxhetore rezultojnë në vlerën 26,054,310 mijë lekë, kundrejt tavaneve të miratuara në vlerën 23,456,095 mijë lekë, duke rezultuar në një tejkalim prej 2,598,215 mijë lekë.

Në nivel të shpenzimeve korrente evidentohet tejkalim si më poshtë:
- llogaria 600 "Paga" nuk paraqet tejkalim në nivel total, pasi kërkesat janë në përputhje me tavanin (523,305 mijë lekë);
- llogaria 601 "Sigurime shoqërore" paraqet tejkalim në shumën 610,697 mijë lekë, kundrejt tavaneve të miratuara;
- llogaria 602 "Mallra dhe shërbime" nuk paraqet tejkalim në nivel total, pasi kërkesat janë në përputhje me tavanin (443,530 mijë lekë).

Ndërkohë, në komponentin kryesor të programit:
- llogaria 606 "Transferta" paraqet tejkalim të konsiderueshëm, konkretisht:

***** për Ndihmën Ekonomike (NE) në shumën 336,003 mijë lekë (4,970,463 kundrejt 4,634,460);

***** për pagesat e PAK në shumën 1,207,985 mijë lekë (18,029,620 kundrejt 16,821,635).

Nga analiza në nivel institucioni, evidentohet se tejkalimet kryesore lidhen kryesisht me:
- llogarinë 601 "Sigurime shoqërore", ku shumica e institucioneve paraqesin kërkesa mbi tavanet;
- disa institucione specifike në llogarinë 600 dhe 601 (si Shtëpia e Fëmijëve, Administrata Qendrore SHSSH, etj.), të cilat kanë tejkaluar tavanet e miratuara.

Për rrjedhojë, totali i shpenzimeve buxhetore është paraqitur mbi nivelin e miratuar, duke reflektuar mosrespektim të kufijve të vendosur në fazën përfundimtare të PBA-së.

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën përkatëse të Udhëzimit Plotësues për përgatitjen e PBA-së, ku përcaktohet se njësitë e qeverisjes nuk mund të paraqesin kërkesa që tejkalojnë tavanet e miratuara.

Faza e III-të e PBA 2021-2023

Programi Buxhetor Afatmesëm 2021–2023 i rishikuar (Faza III), në përputhje me tavanet buxhetore të përcaktuara në Ligjin nr. 137/2020 "*Për Buxhetin e vitit 2021*".

Për programin buxhetor 10430 "*Përkujdesi Social*", paraqitjet në nivel llogarish rezultojnë si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 36: "Shpenzime buxhetore të programit 10430, PBA 2023-2025, Faza III-të"

Në lekë

Përshkrimi	2021	2022	2023
Totali shpenzimeve të Programit	**27,979,260,000**	**25,289,000,000**	**26,149,000,000**
600 - Paga	546,260,000	546,260,000	546,260,000
01 - Nga Buxheti	546,260,000	546,260,000	546,260,000
601 - Sigurime Shoqërore	102,000,000	102,000,000	102,000,000
01 - Nga Buxheti	102,000,000	102,000,000	102,000,000
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	321,000,000	320,740,000	320,740,000
01 - Nga Buxheti	321,000,000	320,740,000	320,740,000
606 - Trans per Buxh. Fam. & Individ	26,900,000,000	24,200,000,000	24,900,000,000
01 - Nga Buxheti	26,900,000,000	24,200,000,000	24,900,000,000
231 - Kapitale të Trupëzuara	110,000,000	120,000,000	280,000,000
01 - Nga Buxheti	0	20,000,000	180,000,000
22 - Financim i huaj - Kredi	100,000,000	100,000,000	100,000,000
04 - TVSH, Detyrim Doganor	10,000,000	0	0

Burimi: MFE, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga tabela më sipër rezulton se, për vitin 2022, totali i shpenzimeve të programit paraqitet në shumën 25,289,000,000 lekë.

Shpenzimet korrente rezultojnë në shumën 25,169,000,000 lekë, duke zënë rreth 99.5% të totalit, ndërsa shpenzimet kapitale paraqiten në shumën 120,000,000 lekë, ose rreth 0.5%.

Në strukturën e shpenzimeve korrente:

- llogaria 606 "Transferta për buxhetet familjare dhe individët" paraqitet në shumën 24,200,000,000 lekë, duke zënë rreth 95.7% të totalit të shpenzimeve të programit dhe rreth 96.1% të shpenzimeve korrente;
- llogaria 600 "Paga" paraqitet në shumën 546,260,000 lekë, ose rreth 2.2%;
- llogaria 601 "Sigurime shoqërore" në shumën 102,000,000 lekë, ose rreth 0.4%;
- llogaria 602 "Mallra dhe shërbime" në shumën 320,740,000 lekë, ose rreth 1.3%.

Shpenzimet kapitale paraqiten në nivel të ulët, në shumën 120,000,000 lekë, ku pjesën kryesore e zë llogaria 231 "*Kapitale të trupëzuara*", e cila rezulton e financuar kryesisht nga burime të huaja në vlerën 100,000,000 lekë, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit mbetet i kufizuar në shumën 20,000,000 lekë.

Në tërësi, struktura e shpenzimeve për vitin 2022 dominohet nga transfertat sociale ndaj individëve, ndërsa pesha e shpenzimeve kapitale mbetet minimale, duke reflektuar orientimin e programit drejt mbështetjes sociale dhe jo drejt investimeve.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2021

Sipas Ligjit nr. 137/2020 "*Për buxhetin e vitit 2021*", shpenzimet buxhetore për programin 10430 "*Përkujdesi Social",* sipas Tabelës nr. 1 të tij, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 37: "Shpenzimet korrente e kapitale sipas Ligjit nr. 115/2021"

Në mijë lekë

Programi	Emri i programit	Shpenzimet 2021		
		Korrente	**Kapitale**	**Totali**
10430	Perkujdesi Social	27,869,260	110,000	27,979,260

Burimi: Ligji nr. 115/2021"Për buxhetin e vitit 2022"

Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente të SHSSH është bërë me shkresën e MSHMS nr. 125, datë 21.01.2021 në nivel produkti paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".Nga auditimi konstatohet se detajimi fillestar

i shpenzimeve korrente për vitin 2022 është bërë në përputhje me tabelën nr. 1 të Ligjit nr. 115/2021 të Buxhetit për vitin 2023, "*Buxheti 2023 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore*".

Buxheti i vitit 2022 i parashikuar për shpenzimet totale buxhetore (shpenzime korrente dhe kapitale) ka pësuar ndryshime, që prej fazës së Projekt Buxhetit të vitit 2022 deri në ligjin nr. 115/2021 "*Për buxhetin e vitit 2022",* i cili ka ndryshuar me pas me 6 akte normative të cilat janë si më poshtë:

- Akti normativ nr. 4, datë 05.02.2021;
- Akti Normativ nr. 8, datë 22.03.2021;
- Akti Normativ nr. 18, datë 16.04.2021;
- Akti Normativ nr. 26, datë 22.06.2021;
- Akti Normativ nr. 31, datë 27.10.2021;
- Akti Normativ nr. 34, datë 03.12.2021

Ndryshimet e shpenzimeve buxhetore, nga Ligji nr. 137/2020 deri në planin përfundimtar sipas akteve normative apo transfertave të ndryshme, paraqiten në tabelën nr. 5 Aneksit nr. 1.

Realizimi i buxhetit të vitit 2021

Nga auditimi rezulton se realizimi faktik i buxhetit për vitin 2021, në mënyrë të detajuar sipas klasave të llogarive, paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga auditimi i realizimit të buxhetit për vitin 2021 rezultoi se, megjithëse niveli i përgjithshëm i ekzekutimit paraqitet i lartë, evidentohet mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe realizimit në disa zëra të rëndësishëm të shpenzimeve.

Nga krahasimi ndërmjet planit total dhe realizimit faktik, konstatohet se në total buxheti paraqet një mosrealizim në vlerën 408,866 mijë lekë, duke reflektuar devijime të konsiderueshme, kryesisht në zërat e transfertave sociale dhe fondeve mbështetëse.

Konkretisht:

- për zërin Pagesa për PAK konstatohet mosrealizim në vlerën 194,351 mijë lekë;
- për zërin Ndihma Ekonomike (NE) konstatohet mosrealizim në vlerën 87,827 mijë lekë;
- për Fondin Social në vlerën 37,135 mijë lekë;
- për Vendime gjyqësore MSHMS në vlerën 8,883 mijë lekë;
- si dhe për zëra të tjerë me ndikim më të kufizuar, përfshirë transfertat për individë dhe financime kapitale.

Në nivel institucionesh, të gjitha njësitë paraqesin diferenca negative ndërmjet planit dhe realizimit, çka tregon për një tendencë të përgjithshme të mbivlerësimit të nevojave buxhetore ose për mosrealizim të plotë të aktiviteteve të planifikuara. Diferencat më të theksuara negative evidentohen në njësi si:

- Shërbimi Shoqëror për Akomodimin e Fëmijëve (−11,569 mijë lekë);
- Administrata Qendrore SHSSH (−4,169 mijë lekë);
- Zyra Rajonale Elbasan (−2,954 mijë lekë);
- Shtëpia e Foshnjës Vlorë (−2,499 mijë lekë);
- si dhe një sërë zyrash rajonale dhe qendrash shërbimi me diferenca të konsiderueshme negative.

Në tërësi, edhe pse realizimi i buxhetit paraqitet në nivele të larta, devijimet e konstatuara, veçanërisht në skemat kryesore sociale si NE dhe PAK, tregojnë për parashikim jo plotësisht realist të nevojave buxhetore dhe për mangësi në monitorimin e zbatimit të buxhetit.

Kjo situatë është në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 9 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", ku përcaktohet se planifikimi dhe zbatimi i buxhetit duhet të mbështeten në parimet e realizmit, qëndrueshmërisë dhe disiplinës fiskale.

Si pasojë, krijohen devijime ndërmjet planifikimit dhe realizimit faktik, të cilat ndikojnë në

besueshmërinë e planifikimit buxhetor dhe në eficiencën e përdorimit të fondeve publike.

Viti 2020

Programimi i PBA-së 2020-2022 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2020

Në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2020–2022, kërkesat buxhetore janë hartuar në përputhje me tavanet orientuese dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018.
Planifikimi i shpenzimeve për "Fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore" (llogaritë 600 dhe 601) është bazuar në numrin aktual të punonjësve dhe strukturën e miratuar për çdo program buxhetor, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2020-2022

Nga auditimi u evidentua se, në fazën e parë strategjike të përgatitjes së PBA-së 2020–2022, Shërbimi Social Shtetëror nuk ka paraqitur kërkesa buxhetore, por ato janë përfshirë dhe paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni nga i cili varet.
Për rrjedhojë, grupi i auditimit mori në analizë kërkesat buxhetore të fazës së parë të PBA-së 2020–2022, të paraqitura nga MSHMS në nivel llogarish për programin buxhetor 10430 "*Përkujdesje Sociale*", të cilat në fund të kësaj faze rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 38 "Fondet buxhetore të parashikuara për Përkujdesjen Sociale në fund të fazës së parë të PBA 2020–2022, në nivel llogarish."

Në mijë lekë

Përshkrimi	2020	2021	2022
Totali i shpenzimeve	**24,060,000**	**24,726,000**	**26,120,000**
600. Pagat	**488,860**	**488,860**	**488,860**
Kapitulli 01	*488,860*	*488,860*	*488,860*
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shendetësore	**82,000**	**82,000**	**82,000**
Kapitulli 01	82,000	82,000	82,000
602. Mallrat dhe shërbimet	**459,140**	**535,140**	**279,140**
Kapitulli 01	459,140	535,140	279,140
606. Transferta për familjet dhe individët	**22,900,000**	**23,500,000**	**25,150,000**
Kapitulli 01	**22,900,000**	**23,500,000**	**25,150,000**
231. Aktive të trupëzuara	**130,000**	**120,000**	**120,000**
Kapitulli 01	20,000	20,000	20,000
Kapitulli 02	100,000	100,000	100,000
Kapitulli 04	10,000	0	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të VKM nr.117/2019 dhe të dhënave të publikuara në faqen e MF.[15]

Nga tabela më sipër rezulton se, gjatë periudhës 2020–2022, pjesën më të madhe të strukturës së shpenzimeve të programit buxhetor e zënë shpenzimet korrente, të cilat përbëjnë pothuajse të gjithë totalin e shpenzimeve.
Transfertat për familjet dhe individët (llogaria 606) zënë peshën kryesore, duke variuar nga rreth 95.2% në vitin 2020, në 95.0% në vitin 2021 dhe rreth 96.3% në vitin 2022, çka konfirmon karakterin social të programit dhe orientimin e tij drejt mbështetjes financiare për shtresat në nevojë.
Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (llogaritë 600 dhe 601) paraqiten në nivele të ulëta dhe relativisht konstante ndër vite, duke zënë rreth 2.4% në vitin 2020, 2.3% në vitin 2021 dhe rreth 2.2% në vitin 2022 të totalit të shpenzimeve.
Ndërkohë, shpenzimet për mallra dhe shërbime (llogaria 602) kanë një peshë të kufizuar dhe në rënie, veçanërisht në vitin 2022, ku përbëjnë rreth 1.1% të totalit.
Shpenzimet kapitale (llogaria 231) paraqiten në nivele minimale, duke zënë rreth 0.5% në vitin

[15] Ministria e Financave dhe Ekonomise

2020, 0.5% në vitin 2021 dhe rreth 0.46% në vitin 2022, çka tregon një fokus shumë të kufizuar në investime krahasuar me shpenzimet korrente.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II-të të PBA 2020-2022

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020–2022 janë miratuar me VKM nr. 523 datë 25.07.2019, "*Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020–2022*", të cilat, në nivel programi për "*Përkujdesje Sociale*" (10430), paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 39 "Fondet buxhetore të Përkujdesjes Sociale të miratuara për fazën e II-të të PBA 20-22"

Në mijë lekë

Përshkrimi	2020	2021	2022
Shpenzime të tjera korrente	23,830,000	24,506,000	25,900,000
I. Totali i shpenzimeve kapitale	**170,000**	**380,000**	**380,000**
III. Totali i shpenzimeve buxhetore	**24,000,000**	**24,886,000**	**26,280,000**

Burimi: VKM nr. 523/2019, Përpunuar nga grupi i auditimit.

Kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2020–2022, të dërguara nga Shërbimi Social Shtetëror pranë MSHMS, në nivel produkti, krahasuar me tavanet përfundimtare, paraqiten sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga krahasimi me tavanet përfundimtare të PBA 2020-2022, rezulton se SHSSH, ka paraqitur kërkesa buxhetore më të ulta se tavante si më poshtë:

Përshkrimi	600	601	602	606
Kërkesat e SHSSH	520,512,000	86,925,000	452,361,000	25,338,798,000
Tavan Buxhetore	721,190,000	119,740,000	355,600,000	28,850,000,000
Diferenca	(200,678,000)	(32,815,000)	96,761,000	(3,511,202,000)

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi rezulton se kërkesat e Shërbimi Social Shtetëror nuk janë në përputhje të plotë me tavanet buxhetore, duke evidentuar si nënkërkime ashtu edhe tejkalime sipas zërave:

- Për pagat (600) dhe sigurimet shoqërore (601), kërkesat janë më të ulëta se tavanet, përkatësisht me 200.7 milion lekë dhe 32.8 milion lekë, çka tregon një planifikim më konservator ose mosshfrytëzim të plotë të hapësirës buxhetore në këto zëra.
- Në mallra dhe shërbime (602) konstatohet e kundërta, ku kërkesat tejkalojnë tavanin me rreth 96.7 milion lekë, duke reflektuar një nevojë më të lartë operative nga sa është parashikuar në kufijtë buxhetorë.
- Diferenca më e madhe evidentohet në transfertat (606), ku kërkesat janë më të ulëta se tavani me rreth 3.5 miliard lekë, duke treguar se fondet e programuara në nivel tavanesh janë më të larta se nevojat e paraqitura nga SHSSH.

Në tërësi, situata tregon një mospërputhje midis planifikimit nga poshtë-lart (kërkesat e SHSSH) dhe kufijve nga lart-poshtë (tavanet buxhetore), veçanërisht në zërin kryesor të programit (transfertat), çka mund të ndikojë në eficiencën e planifikimit buxhetor dhe në shpërndarjen optimale të fondeve.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2020

Sipas Ligjit nr. 88/2019 "*Për buxhetin e vitit 2020*", shpenzimet buxhetore për programin 10430 "*Përkujdesi Social",* sipas Tabelës nr. 1 të tij, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 40: "Shpenzimet korrente e kapitale sipas Ligjit nr. 115/2021"

Në mijë lekë

Programi	Emri i programit	Shpenzimet 2020		
		Korrente	Kapitale	Totali
10430	Perkujdesi Social	23,849,260	137,700	23,986,960

Burimi: Ligji nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020"

Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente të SHSSH është bërë me shkrësën e MSHMS nr. 185/1, datë 10.02.2020 në nivel produkti paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".

Nga auditimi konstatohet se detajimi fillestar i shpenzimeve korrente për vitin 2020 është bërë në përputhje me tabelën nr. 1 të Ligjit nr. 88/2019 të Buxhetit për vitin 2020, "*Buxheti 2020 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore*".
Buxheti i vitit 2020 i parashikuar për shpenzimet totale buxhetore (shpenzime korrente dhe kapitale) ka pësuar ndryshime, që prej fazës së Projekt Buxhetit të vitit 2020 deri në ligjin nr. 88/2019 "*Për buxhetin e vitit 2020",* i cili ka ndryshuar me pas me 3 akte normative të cilat janë si më poshtë:

- Akti normativ nr. 6, datë 21.03.2020;
- Akti Normativ nr. 15, datë 15.04.2020;
- Akti Normativ nr. 28, datë 02.07.2020.

Ndryshimet e shpenzimeve buxhetore, nga Ligji nr. 88/2019 deri në planin përfundimtar sipas akteve normative apo transfertave të ndryshme, paraqiten në tabelën nr. 6 Aneksit nr. 1.

Realizimi i buxhetit të vitit 2020

Nga auditimi rezulton se realizimi faktik i buxhetit për vitin 2020, në mënyrë të detajuar sipas klasave të llogarive, paraqitet sipas tabelës në Aneksin "Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit".Nga auditimi i realizimit të buxhetit për vitin 2020, rezulton se, megjithëse niveli i përgjithshëm i ekzekutimit paraqitet i lartë, evidentohet mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe realizimit në nivel produkti dhe institucioni.
Nga krahasimi i Planit Operativ me realizimin faktik, konstatohet një mosrealizim total në vlerën 220,109 mijë lekë, çka tregon për devijime në disa zëra kryesorë të shpenzimeve, veçanërisht në transfertat sociale dhe investimet.
Konkretisht:

- për zërin Pagesa për PAK konstatohet mosrealizim në vlerën 156,463 mijë lekë;
- për zërin Ndihma Ekonomike (NE) në vlerën 19,265 mijë lekë;
- për Fondin Social në vlerën 41,428 mijë lekë;
- për investimet (231) evidentohen diferenca të konsiderueshme negative, ku spikat mosrealizimi në disa projekte specifike;
- ndërsa zëra të tjerë si bonusi i bebes rezultojnë të realizuar sipas planit.

Në nivel institucional, pothuaj të gjitha njësitë paraqesin diferenca negative ndërmjet Planit Operativ dhe realizimit, çka tregon për një tendencë të përgjithshme të mbivlerësimit të nevojave buxhetore ose mosrealizim të plotë të aktiviteteve të planifikuara.
Diferencat më të theksuara evidentohen në njësi si:

- Administrata Qendrore SHSSH (−11,042 mijë lekë);
- Qendra e Zhvillimit Shkodër (−3,537 mijë lekë);
- Qendra e Zhvillimit Korçë (−1,604 mijë lekë);
- Qendra e Zhvillimit Ditor Korçë (−1,179 mijë lekë);
- Zyra Rajonale Tiranë (−1,119 mijë lekë);

Në tërësi, edhe pse realizimi paraqitet në nivele të kënaqshme, devijimet e konstatuara, sidomos në skemat kryesore sociale (PAK dhe NE), tregojnë për parashikim jo plotësisht realist të nevojave si dhe mangësi në ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit.
Këto devijime lidhen kryesisht me:

- luhatjet në numrin e përfituesve (hyrje/dalje nga skema);
- ndryshime në masën e përfitimit;
- si dhe mosrealizim të plotë të investimeve të planifikuara.

Kjo situatë është në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 9 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", ku kërkohet që planifikimi dhe zbatimi i buxhetit të mbështeten në parimet e realizmit dhe disiplinës fiskale.
Si pasojë, krijohen diferenca ndërmjet planifikimit dhe realizimit faktik, të cilat ndikojnë në besueshmërinë e planifikimit buxhetor dhe në eficiencën e përdorimit të fondeve publike.

2.4. Vlerësimi i veprimtarisë në kuadër të pagesave të ndihmës ekonomike (NE) dhe personave me aftësi të kufizuara (PAK)


Kuadri ligjor mbi asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë dhe roli i Shërbimit Social Shtetëror

Kuadri ligjor i asistencës sociale në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga Ligji nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton përfitimet dhe mekanizmat e mbështetjes për familjet dhe individët në nevojë, personat me aftësi të kufizuara dhe kategori të tjera përfituese, me synim zbutjen e varfërisë, përfshirjen sociale dhe garantimin e një niveli minimal jetese. Asistenca sociale përfshin ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, ndihmën financiare për foshnjat e porsalindura dhe përfitime të tjera të përcaktuara me ligj.
Sipas nenit 20 të këtij ligji, Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), në nivel qendror dhe rajonal, është institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave të asistencës sociale, duke ushtruar funksione që lidhen me programimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve, administrimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të përfituesve, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit, grumbullimin dhe përpunimin e statistikave, si dhe bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për riintegrimin social dhe ekonomik të përfituesve.

A. Ndihma ekonomike

Ndihma ekonomike përfitohet nga familjet në nevojë me të ardhura të pamjaftueshme ose pa të ardhura, jetimët jashtë institucioneve të përkujdesjes shoqërore, prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh që i përkasin familjeve në nevojë, viktimat e trafikimit pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në punësimin e tyre, si dhe viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare gjatë periudhës së mbrojtjes ligjore, kur nuk trajtohen në institucione të përkujdesjes shoqërore.

Procedura, dokumentacioni dhe masa mujore e përfitimit të NE janë përcaktuar nëpërmjet VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 "*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike*", i ndryshuar. Procedura e përfshirjes në skemën e Ndihmës ekonomik paraqitet sipas skemës më poshtë:



Burimi: Kreu II i VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, përpunuar nga grupi i auditimit

Në zbatim të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar, SHSSH, në nivel qendror dhe rajonal, luan rol kyç në monitorimin, verifikimin dhe garantimin e zbatimit të legjislacionit të ndihmës ekonomike. Drejtoritë Rajonale përbëjnë hallkën vendimmarrëse të skemës, duke trajtuar mospërputhjet e identifikuara nga verifikimi automatik i të dhënave përmes ndërlidhjes me databaza shtetërore. Me ndryshimet e vitit 2024, ato kanë marrë gjithashtu detyrimin për të kryer verifikime në terren për aplikimet për herë të parë, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së situatës reale me të dhënat e deklaruara.
Në nivel qendror, SHSSH mbikqyr funksionimin e skemës dhe mekanizmave të kontrollit, ndërsa verifikimet automatike, trajtimi manual i mospërputhjeve, vizitat në terren dhe rivlerësimet periodike synojnë të sigurojnë saktësinë e përfituesve, të minimizojnë gabimet e përfshirjes dhe përjashtimit, si dhe të parandalojnë deklarimet e rreme dhe abuzimet. Njëkohësisht, masat e përjashtimit me afat 6-mujor ose 1-vjeçar shërbejnë për ruajtjen e integritetit të skemës dhe nxitjen e aktivizimit të përfituesve në tregun e punës.

Funksionimi i Sistemit të Ndihmës Ekonomike
Në zbatim të Ligjit nr. 57/2019 neni 20 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*, pika 3b, Shërbimi Social Shtetëror administron dhe përdor të dhënat e Regjistrit Elektronik Kombëtar, i cili përfshin aplikantët dhe përdorimin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar. Nga përgjigjet e pyetësorëve, SHSSH bën me dije se, në praktikë, nuk ushtron rolin e administratorit të sistemeve, edhe pse në Ligjin nr. 57/2019 është cituar i tillë. Administrimi teknik i sistemeve realizohet nga strukturat përkatëse të IT-së pranë MSHMS dhe AKSHIT, të cilat kanë akses në komponentët back-end të sistemit, përfshirë log-et, kodin, konfigurimet teknike dhe backup-et. Nga ana tjetër, SHSSH disponon akses vetëm në pjesën front-end të sistemit, konkretisht në krijimin, shtimin dhe ndryshimin e roleve funksionale. Për krijimin e aksesit fillestar në sistem (mailbox, VPN dhe kredenciale të tjera), SHSSH paraqet kërkesë pranë MSHMS/AKSHI-t, ndërsa më pas merret vetëm me krijimin dhe menaxhimin e roleve funksionale të përdoruesve në sistem.
Kontrata e mirëmbajtjes për sistemin e NE-së ka përfunduar në datën 18.05.2025, duke bërë që nga ajo datë sistemi të jetë pa mirëmbajtje, në kundërshtim me pikën 2 të VKM-së nr. 710, datë 21.08.2013 "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*", i ndryshuar. Mungesa e mirëmbajtjes së sistemeve paraqet risk për vazhdimësinë e punës dhe funksionimin normal të tyre, duke rritur mundësinë e ndërprerjeve të shërbimit dhe mosadresimit e zgjidhjes në kohë të problemeve teknike. Referuar përgjigjeve të pyetësorëve, SHSSH nuk ka qenë në asnjë rast e përfshirë si përfaqësuese në grupet e punës për ndjekjen e kontratave të mirëmbajtjes së sistemeve. Ndjekja dhe monitorimi i kontratave të mirëmbajtjes janë realizuar nga përfaqësues të AKSHI-t dhe MSHMS-së.
Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së nr. 335, datë 22.10.2024, është ngritur grupi i punës për hartimin e treguesve kryesorë të riskut të sistemeve elektronike të ndihmës ekonomike, personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror. Nga analiza e kryer nga vetë institucioni u evidentuan një sërë problematikash që ndikojnë në funksionalitetin dhe efektivitetin e sistemit të ndihmës ekonomike, si kufizime në administrimin e sistemit dhe varësi nga struktura të tjera institucionale për kryerjen e ndryshimeve dhe menaxhimin e aksesit të përdoruesve, vështirësi në aksesimin dhe përpunimin e të dhënave për shkak të kufizimeve teknike të sistemit, si dhe problematika në ndërveprimin me databaza shtetërore. Ndër risqet kryesore të evidentuara përfshihen mungesa e një verifikimi efektiv të pasurive të paluajtshme për shkak të kufizimeve në aksesin ndaj të dhënave të ASHK-së, vonesat në marrjen e të dhënave nga administrata tatimore për të ardhurat nga punësimi, si dhe problematika në përditësimin e të dhënave të gjendjes civile lidhur me lindjet dhe vdekjet..Problematikat që evidentohen nga përdorimi i sistemeve, përcillen në rrugë

elektronike nga ana e IT-së së SHSSH pranë strukturës IT të AKSHI-t pranë ministrisë. Pas përfundimit të kontratave të mirëmbajtjes janë konstatuar problematika të përsëritura të raportuara nga ana e SHSSH-së që konsistojnë në: mosfunksionim të plotë të sistemeve NE, PAK dhe SHKSH dhe probleme log in-i nga ana e përdoruesve fundorë të sistemit në Drejtori të Përgjithshme, Drejtori Rajonale, Njësitë Vendore, etj., duke cënuar disponibilitetin e sistemeve dhe vijueshmërinë e punës. Me qëllim ruajtjen e integritetit të të dhënave grupi i auditimit mori informacion nëpërmjet pyetësorëve mbi procedurat e ndjekura për realizimin e back-up të sistemeve, ku nga SHSSH-ja është vënë në dispozicion përgjigja e AKSHI-t ku citohet se back-up realizohet në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 31.07.2023 "*Për zbatimin e dokumentit të përditësuar të politikave të vazhdimësisë së punës dhe planit për ruajtjen e informacionit*".
Lidhur me pjesën funksionale të sistemit, grupi i auditimit kërkoi informacion mbi modulet e parashikuara në termat e referencës për secili sistem, modulet aktualisht të implementuara dhe ndryshimet që janë bërë që prekin funksionalitetet e sistemit.
Për sistemin e NE, janë aktualisht të implementuara moduli i raporteve, moduli i integrimeve dhe verifikimeve me sisteme e tjera nëpërmjet ESB, moduli i gjurmimit të auditimeve, moduli i administrimit të sistemit, moduli i administrimit të ankimimit, moduli i vlerësimit të analizës së riskut (i cili është i inkorporuar në NE, por nuk është funksional). Gjithashtu, me qëllim përmirësimin e proceseve të punës është identifikuar për implementim dhe moduli i vlerësimit të analizës së riskut. Për sa i përket ndërveprimeve me sistemet e tjera aktualisht janë të implementuar ndërveprimet me: Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, Regjistrin Kombëtar të Bizneseve, Regjistrin e Tatimpaguesve (DPT), Sistemin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Regjistrin Kombëtar të Mjeteve (sistemi eDPSHTRR), Sistemin e AKPA, Sistemin e SMIP, Portalin qeveritar e-Albania, Sistemin e PAK. Për sa i përket ndërveprimit me sistemin e ASHK-së, ndërlidhja është e konfiguruar por nuk kryhet ndërveprimi.

Sistemi i Unifikuar i Pikëzimit
Në nenin 16, pika 3, të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, përcaktohet se pranueshmëria në skemën e NE bëhet nëpërmjet formulës së pikëzuar, treguesit e së cilës mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë. Neni 32 i këtij ligji ngarkon Këshillin e Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim, ndër të tjera të nenit të sipërcituar, pra formulës së pikëzuar.
Nëpërmjet VKM-së nr. 956, datë 07.12.2016 "*Për përcaktimin e kritereve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike*" është përcaktuar formula e unifikuar e pikëzimit, që përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia, blegtoria, trashëgimia dhe dhuratat. Ky akt mbështetet në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, i shfuqizuar nga Ligji nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Në këtë akt janë specifikuar vetëm treguesit e formulës së pikëzimit, por koeficientët e tyre nuk janë të aksesueshëm publikisht. Në raporte të organizmave ndërkombëtarë vlerësohet se "*moszbulimi i koeficientëve pengon kryerjen e vlerësimit të duhur të efektshmërisë së shënjestrimit të formulës së pikëzimit. Mungesa e informacionit të qartë në lidhje me kriteret e kualifikueshmërisë mund të minojë edhe besimin e publikut në lidhje me procesin e vendimmarrjes për të drejtën e kandidatëve për t'u bërë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike*"[16].

[16] "*Reforma e Programit të Ndihmës Ekonomike në Shqipëri*", Zyra Ndërkombëtare e Punës ILO, 2022, "Përmbledhje", fq. *vii*.

Sistemi i pikëzimit është hartuar dhe prezantuar në kuadër të Projektit për Modernizimin e Asistencës Sociale në Shqipëri (SAMP), i implementuar nga Banka Botërore[17]. Në pikën 3 të VKM-së nr. 956, datë 07.12.2016 përcaktohet se përditësimi i formulës së unifikuar të pikëzimit propozohet nga ministria përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, në varësi të ndryshimeve të nivelit të varfërisë në vend, të publikuar nga INSTAT-i, dhe miratohet me VKM. Kriteret e pranueshmërisë së Formulës së Unifikuar të Pikëzimit dhe pesha e tyre në pikëzimin total janë vlerësuar duke u bazuar në të dhëna Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare 2014, e kryer nga INSTAT[18]. Grupi i auditimit ka aksesuar të dhënat e Anketimit të Buxhetit të NJEF 2024 të kryer nga INSTAT, krahasimi me vitin 2014 i të cilave paraqitet, si më poshtë:

Tabela nr. 41: Të dhënat e Anketimit të Buxhetit të NJEF 2014 dhe 2024

Grupet kryesore të konsumit	Për vitin 2014	Për vitin 2024
Ushqim dhe pije joalkoolike	44,3%	39,6%
Pije alkoolike dhe duhan	3,6%	4,2%
Veshje dhe këpucë	5,1%	5,1%
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	10,2%	9,6%
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	5,4%	6,8%
Shëndet	4,8%	3,8%
Transport	6,8%	7,1%
Komunikim	3,3%	3,8%
Argëtim dhe kulturë	3,1%	2,6%
Arsim	4,2%	3,3%
Restorante dhe hotele	3,2%	7,6%
Të tjera mallra dhe shërbime	6,0%	6,4%
Njësia Ekonomike Familjare mesatare	3,8 persona	3,1 persona
Shpenzime mesatare gjithsej	**69.442**	**93.042**

Burimi: Anketat e Buxhetit të NJEF 2014 dhe 2024, INSTAT

Ndryshimet e mësipërme që evidentohen edhe në rritjen e shpenzimeve mesatare të njësive ekonomike familjare, të cilat reflektohen në ndryshime edhe në vlera (pavarësisht se në përqindje janë të përafërta), pasqyrojnë nevojën për rishikim të strukturës së pikëzimit.

Në Shtojcën 1 të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 "*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike*", i ndryshuar, pasqyrohet Formulari i aplikimit për ndihmë ekonomike. Në faqen 6 të formularit janë listuar asetet familjare, për të cilat aplikanti duhet të tregojë nëse familja e tij i zotëron apo jo. Në formularin e aplikimit vijojnë të përfshihen pajisje bazike dhe pajisje që thuajse nuk përdoren më, të cilat jo detyrimisht korrelacionojnë me mirëqenien, si:

- pajisje praktikisht të dala nga përdorimi, si TV pa ngjyra, video/ DVD player, magnetofon/ CD player, kamera/ videokamera.
- pajisje që praktikisht janë kthyer në bazike, si TV me ngjyra, frigorifer, makinë larëse (lavatriçe), sobë për ngrohje, etj.

Sistemi aktual i pikëzimit, i ndërtuar mbi koeficientë të përcaktuar para më shumë se një dekade, paraqet shenja vjetërsimi metodologjik. Disa indikatorë nuk arrijnë më të dallojnë në mënyrë efektive familjet realisht në nevojë, duke rritur rrezikun si për përfshirje të padrejtë në skemë, ashtu edhe për përjashtim të familjeve që duhet të përfitojnë. Edhe nga Banka Botërore, që ka qenë vetë implementuesi i Sistemit të Unifikuar të Pikëzimit, është vlerësuar se "*kriteret e pranueshmërisë dhe pesha e tyre janë vlerësuar mbi bazën e një ankete që tashmë janë të vjetra. Gjatë kësaj periudhe, profili i popullsisë më të cënueshme dhe karakteristikat që parashikojnë varfërinë e tyre ka gjasa të ketë ndryshuar. Korrigjimi i formulës do të kishte dy efekte të mundshme: (i) uljen e gabimeve të përjashtimit (familje që janë realisht të varfra, por*

[17] https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2018/05/04/world-bank-supports-improved-equity-and-efficiency-of-social-assistance-programs-in-albania

[18] "*Analiza Situacionale e Mbrojtjes Sociale për Shqipërinë*", Banka Botërore, fq. 11.

përjashtohen për shkak të karakteristikave që nuk janë më relevante) dhe (ii) uljen e gabimeve të përfshirjes (familje që nuk janë të varfra, por përfshihen në program për shkak se kriteret e pranueshmërisë ua lejojnë këtë)", ku ka vlerësuar si rekomandim kryesor përditësimin bazuar në të dhëna aktuale të Formulës së Unifikuar të Pikëzimit[19].
Në përfundim të Task Forcës së vitit 2024, nëpërmjet shkresës nr. 6616 prot., datë 02.09.2024, Shërbimi Social Shtetëror i ka dërguar MSHMS-së Raportin mbi gjetjet e konstatuara, ku është përfshirë edhe rekomandimi "*Rishikimi i vlerësimit dhe pranueshmërisë në skemë, duke marrë në konsideratë të ardhurat, pasi skema e NE-së ka si kriter jo vetëm pa të ardhura, por edhe ato me të ardhura të pamjaftueshme. Duhet të gjendet një mekanizëm për të mbështetur familjet të cilat jetojnë në varfëri ekstreme dhe të ketë një masë të diferencuar për këto familje*".
Në kushtet kur profili i varfërisë, struktura e shpenzimeve familjare dhe karakteristikat e popullsisë së cënueshme kanë evoluar, do të duhej të ishte ndërmarrë një rishikim i plotë metodologjik i formulës, i mbështetur në të dhëna të përditësuara nga INSTAT, si dhe të ishte garantuar transparencë mbi koeficientët dhe peshat reale të indikatorëve. Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht (i) kalimit të një periudhe thuajse 10-vjeçare nga miratimi i formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike nëpërmjet VKM-së nr. 956, datë 07.12.2016, (ii) shfuqizimit të aktit ligjor mbi të cilin ajo ishte bazuar dhe (iii) nevojës për përditësim metodologjik të formulës së pikëzimit mbi baza të dhënash të përditësuara, si dhe (iv) evidentimit në Raportin final të Task-Forcës së vitit 2024 nga ana e SHSSH-së për nevojën për rishikimin e vlerësimit dhe pranueshmërisë në skemë, këto indikatorë nuk rezulton të jenë rishikuar, duke krijuar risk për cenimin e efektivitetit të shënjestrimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe për rritjen e gabimeve të përfshirjes dhe përjashtimit nga skema.

Verifikimi automatik në sistem nëpërmjet ndërlidhjes me sisteme të tjera
Verifikimi automatik përbën një hallkë të procesit që kryhet menjëherë pas ngarkimit të aplikimeve nga administratori shoqëror në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike. Në këtë fazë, sistemi i Ndihmës Ekonomike ndërvepron me databaza të tjera shtetërore, si Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, Regjistri i Bizneseve, sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sistemi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, sistemi i mjeteve rrugore (DPSHTRR), SIMP, platforma "*e-Albania*" dhe sistemi i PAK.
Gjithashtu, në sistem është konfiguruar edhe ndërlidhja me sistemin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila nuk është funksionale, pasi bazuar në VKM-në nr. 389, datë 13.05.2020 "*Për miratimin e listës dhe të shërbimeve kadastrale*", i ndryshuar, ky shërbim ofrohet me pagesë nga ASHK-ja. Lloji i banesës dhe pronësia është një nga pesë kategoritë kryesore të variablave që përcakton parametrat e lidhur me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, sipas Shtojcës 1 të VKM-së nr. 956, datë 07.12.2026 "*Për përcaktimin e kritereve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike*". Mungesa e ndërveprimit funksional ndërmjet sistemit të NE-së dhe sistemit të ASHK-së pamundëson verifikimin automatik të të dhënave mbi llojin e banesës dhe pronësinë, si dhe mbi pasuri të tjera të paluajtshme në pronësi të individëve apo familjarëve aplikues. Për rrjedhojë, ky informacion mbetet i bazuar vetëm në vetëdeklarim, ndonëse përbën një komponent me koeficient të përcaktuar në formulën e pikëzimit dhe ndikon drejtpërdrejt në rezultatin e vlerësimit të aplikantit, duke rritur rrezikun e përfshirjes në skemë të individëve që disponojnë pasuri të padeklaruara gjatë aplikimit.
Ndërlidhjet aktuale të sistemit të NE-së, si dhe kontrollet e kryera nga SHSSH para dhe pas faktit, nuk mundësojnë parandalimin, evidentimin dhe marrjen e masave për rastet kur anëtarë të familjeve përfituese punojnë jashtë vendit, duke përfshirë punët sezonale apo punët informale, dhe gjenerojnë të ardhura që nuk deklarohen në formularin e aplikimit, si dhe

[19] "*Analiza Situacionale e Mbrojtjes Sociale për Shqipërinë*", Banka Botërore, fq. 3, 11, 27.

individët që jetojnë jashtë vendit dhe përfitojnë ndihmë ekonomike në kundërshtim me ligjin. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në rezultatin e pikëzimit dhe është evidentuar në mënyrë të përsëritur edhe në raportet vjetore të Shërbimit Social Shtetëror.
Gjithashtu, në pikën 20 të formularit të aplikimit, ku deklarohen asetet familjare, në rreshtat 22–24 pasqyrohen kategoritë e automjeteve "*makinë/veturë*", "*kamion*" dhe "*makinë dumdum*", duke kërkuar nga aplikanti të deklarojë nëse familja i zotëron ose jo këto mjete. Formulari parashikon vetëm deklarim me përgjigje "po/jo" për secilin lloj mjeti dhe nuk mundëson deklarimin e numrit të tyre. Si pasojë, familjet që disponojnë disa automjete trajtohen njësoj në pikëzim me familjet që disponojnë vetëm një mjet të të njëjtit lloj, duke kufizuar saktësinë e vlerësimit të nivelit ekonomik të familjes.

Trajtimi manual i mospërputhjeve
Pasi përfundon procesi i verifikimit automatik, i cili kryhet nëpërmjet sistemit të Ndihmës Ekonomike (NE) përmes ndërveprimit me sisteme të tjera, procesi kalon në fazën e trajtimit të "mospërputhjeve". Megjithatë, pavarësisht këtij emërtimi, sistemi nuk evidenton realisht mospërputhjet, por vetëm pasqyron rezultatet e kërkimit të gjeneruara nga ndërveprimi me sistemet e tjera. Në praktikë, të gjitha të dhënat e marra nga këto ndërveprime shfaqen si "mospërputhje", ndërkohë që është verifikuesi (punonjës i Drejtorisë Rajonale të SHSSH-së) ai që manualisht duhet të krahasojë, për çdo aplikim, rezultatin e shfaqur me të dhënat e deklaruara në formularin e aplikimit për çdo aplikim. Pra edhe nëse realisht ka mospërputhje, manualisht verifikuesi mund të pranojë një aplikim, për miratim nga Drejtori Rajonal. Ky kontroll do të ofronte garanci nëse kryhej automatikisht nga sistemi e më tej verifikuesi të trajtonte manualisht *vetëm rastet e mospërputhjeve* (ku (i) mund të kishte lëvizje të vogla jomateriale dhe të vendosej pranimi apo (ii) të konstatohej mosdeklarim ose ndryshime materiale dhe të vendosej refuzimi i aplikimit). Ndikimi i kësaj problematike nuk kufizohet vetëm në fazën paraprake të verifikimit, por shtrihet edhe në kontrollet pas fakti që ushtrohen nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE&PAK. Kjo pasi gjatë aplikimit të filtrave që përdoren për kampionimin e rasteve që do të kontrollohen, kur aplikohen filtra që lidhen me mospërputhje, do të paraqiten rezultate nga të gjitha rastet ku ka të dhëna nga ndërveprimi, duke bërë që shpeshherë rastet e kampionuara të jenë vetëm një verifikim/ krahasim me formularin e aplikimit dhe mos të ketë realisht mospërputhje.
Sistemi evidenton automatikisht si mospërputhje vetëm rezultatet e ndërveprimit me sistemin e DPSHTRR-së për automjetet, duke reflektuar rastet kur të dhënat e rezultuara nuk përputhen me vetëdeklarimin. Megjithatë, për shkak se formulari i aplikimit parashikon vetëm deklarim me përgjigje "po/jo" mbi disponimin e automjetit dhe jo numrin e tyre, procesi i verifikimit mbetet i paplotë në mënyrë automatike dhe kërkon trajtim manual nga verifikuesi.

Përfitimet nga skema e ndihmës ekonomike
Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna mbi përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike të ndara në rang qarku dhe në total, për vitet periudhë auditimi 2020 – 2025. Në numrin e përfituesve janë përfshirë aplikantët fitues nga sistemi i pikëzimit dhe familjet në nevojë që kanë përfituar nga fondi 6%[20].

Tabela nr. 42: Përfituesit në numër dhe vlerë nga ndihma ekonomike sipas qarqeve 20-25

[20] Familjet në nevojë të cilat kanë aplikuar nëpërmjet REK brenda 3 muajve dhe nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit. Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për NE, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, Kreu IV, VKM nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar.

(në milionë lekë)

QARKU	2020		2021		2022		2023		2024		2025	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Berat	1,935	149.91	1,880	165.55	1,544	145.80	1,380	126.71	1,271	128.84	1,148	114.15
Dibër	11,056	987.41	11,386	1,164.24	11,172	1,221.70	11,049	1,093.91	9,568	1,072.76	9,395	1,009.90
Durrës	888	67.41	946	82.12	888	95.95	910	98.05	838	101.13	862	106.89
Elbasan	16,497	1,393.54	17,065	1,597.65	15,068	1,536.76	15,028	1,310.99	11,987	1,268.86	10,972	1,064.16
Fier	2,592	202.79	2,859	254.12	2,445	260.07	2,259	229.96	1,653	181.00	1,589	176.65
Gjirokastër	1,049	86.73	1,063	95.86	1,036	103.03	978	90.09	829	84.55	699	72.56
Korçë	9,826	706.30	9,551	885.84	9,170	905.76	8,974	805.66	7,567	742.68	6,937	669.40
Kukës	9,065	767.63	8,967	916.26	8,979	1,007.64	8,708	943.47	7,962	920.59	7,790	883.90
Lezhë	3,092	246.83	3,281	309.38	3,044	317.84	3,028	296.71	2,668	285.71	2,493	267.97
Shkodër	4,973	378.14	5,103	456.29	4,668	473.19	4,546	443.23	4,393	464.74	4,035	420.68
Tiranë	4,127	316.31	4,087	362.02	3,804	430.63	3,728	408.70	3,228	376.07	3,126	382.08
Vlorë	2,146	131.60	2,327	174.96	1,883	165.05	1,788	139.62	1,573	137.05	1,556	136.72
TOTALI	**66,346**	**5,434.64**	**68,515**	**6,464.30**	**63,701**	**6,663.41**	**62,376**	**5,987.10**	**53,537**	**5,763.98**	**50,602**	**5,305.07**

Burimi: SHSSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Në vitin 2020, nga skema e Ndihmës Ekonomike përfituan mesatarisht 66,346 familje në nivel kombëtar. Shpërndarja territoriale e përfituesve paraqiste një përqendrim të lartë në qarqet Elbasan, Dibër, Kukës dhe Korçë, të cilat së bashku përfaqësonin rreth 68.8% të totalit të përfituesve. Krahasimi me strukturën territoriale të popullsisë evidenton diferenca të dukshme, ku qarqet Dibër dhe Kukës rezultojnë të mbipërfaqësuara në skemë, ndërsa Tirana dhe Durrësi të nënpërfaqësuara në raport me peshën e tyre demografike.
Gjatë viteve 2021–2023, numri i përfituesve luhatet nga 68,515 familje në vitin 2021 në 62,376 familje në vitin 2023, ndërsa struktura territoriale e skemës mbetet pothuajse e pandryshuar. Në të gjitha vitet, qarqet Elbasan, Dibër, Kukës dhe Korçë përfaqësojnë rreth dy të tretat e totalit të përfituesve në nivel kombëtar.
Në vitin 2024, numri i përfituesve ra në 53,537 familje, ose rreth 14.2% më pak krahasuar me vitin 2023, duke shënuar reduktimin më të ndjeshëm gjatë gjithë periudhës së analizuar. Kjo rënie përkon me verifikimet fizike në terren të kryera në kuadër të task-forcës për kontrollin e përfituesve, ku u evidentuan raste të konsiderueshme familjesh që nuk duhet të trajtoheshin me ndihmë ekonomike, veçanërisht në qarqet Elbasan, Korçë dhe Dibër.
Në vitin 2025, numri i përfituesve vijoi të ulet në 50,602 familje, ndërsa shpërndarja territoriale mbeti e ngjashme me vitet paraardhëse, me qarqet Elbasan, Dibër, Korçë dhe Kukës që përfaqësonin rreth 69.3% të totalit të përfituesve.

Analiza e periudhës 2020–2025 tregon se, megjithëse numri i familjeve përfituese është reduktuar me rreth 23.7% (nga 66,346 në 50,602 familje), profili territorial i skemës ka mbetur pothuajse i pandryshuar. Në mënyrë të vazhdueshme, rreth dy të tretat e përfituesve janë përqendruar në qarqet Elbasan, Dibër, Kukës dhe Korçë, ndërsa Tirana dhe Durrësi, megjithëse përfaqësojnë mbi 40% të popullsisë së vendit, kanë përfshirë më pak se 10% të përfituesve të skemës. Reduktimi i ndjeshëm i numrit të përfituesve gjatë viteve 2024 dhe 2025, veçanërisht në qarqet Elbasan, Korçë dhe Dibër, përkon në kohë me procesin e verifikimeve fizike në terren të ndërmarra në kuadër të kontrollit të përfituesve të skemës. Ky zhvillim sugjeron se një pjesë e ndryshimeve të evidentuara në periudhën e fundit të analizës mund të lidhet jo vetëm me

ndryshime në kushtet socio-ekonomike të familjeve përfituese, por edhe me forcimin e proceseve të verifikimit të përfituesve.

Masa e ndihmës ekonomike

Neni 12, pika 9, i Ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ngarkon ministrin përgjegjës për çështjet sociale të miratojë me udhëzim mënyrën e përllogaritjes së masës së ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjes, ndërsa neni 32, pika 2, përcakton se ky udhëzim duhej të ishte nxjerrë brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Nga auditimi rezultoi se deri më 31.12.2025 nuk është përgatitur nga SHSSH asnjë propozim apo draft përkatës dhe, për rrjedhojë, nuk është miratuar asnjë udhëzim nga ministri përgjegjës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Për përcaktimin e masës së përfitimit, SHSSH ka vijuar të mbështetet në Udhëzimin nr. 4, datë 17.02.2017, të bazuar në Ligjin nr. 9355/2005, i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 57/2019.

Nëpërmjet VKM-ve (i) nr. 868, datë 29.12.2021 dhe (ii) nr. 617, datë 22.09.2022 "*Për ndryshimin e VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019...*", janë aplikuar rritje të masave të përfitimit të ndihmës ekonomike sipas kategorive përkatëse.

Ndërkohë, në Kreun III, pika 2, të VKM-së nr. 598, datë 04.09.2019, i ndryshuar, përcaktohet se masa e ndihmës ekonomike indeksohet nga SHSSH sa herë indeksohet pensioni social. Nga auditimi u konstatua se SHSSH ka realizuar indeksimin e masës së ndihmës ekonomike deri në vitin 2022, ndërsa për periudhën 2023–2025 indeksimi nuk është kryer, pavarësisht indeksimit të pensionit social, në kundërshtim me kërkesat e aktit nënligjor në fuqi.

Masat e pagesave të ndihmës ekonomike janë rritur ndër vite, si më poshtë:

Kategoria (Grupi)	Kategoria / Anëtari	2019 (VKM 597/2019)	2021 (VKM 868/2021)	2022 (VKM 617/2022)
Kategoria: të ndryshme / grupe të veçanta	Kryefamiljari	1,800	1,980	2,178
	Anëtari i familjes mbi 18 vjeç	1,260	1,386	1,525
	Anëtari i familjes nën 18 vjeç	900	990	1,089
	Anëtari mbi moshën e pensionit, pa pension pleqërie/social (kryefamiljar i vetëm)	2,600	2,860	5,720
	Anëtari mbi moshën e pensionit, pa pension plegërie/social (anëtar i familjes)	1,260	1,386	2,772
	Kategoria: "Viktimat e trafikuit"	3,000	9,000	9,900
	Kategoria: "Jetimë që nuk janë në institucione, deri në çastin e punësimit"	3,000	9,000	9,900
	Kategoria: "Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare"	3,000	9,000	9,900
	Kategoria: "Fëmijë të vendosur në shërbim kujdestarie"	9,000	9,000	9,000
	Kategoria: "Fëmijë PAK të vendosur në shërbim kujdestarie"	10,000	10,000	10,000
Kategoria: familje me 3+ fëmijë nën 18 vjeç	1) Kryefamiljari	1,800	3,600	3,960
	2) Anëtari madhor	1,260	2,520	2,772
	3) Anëtari nën 18 vjeç	900	1,800	1,980
Gratë kryefamiljare (deri në 2 fëmijë 0–18 vjeç)	1) Gruaja kryefamiljare	1,800	1,980	3,960
	2) Fëmijë nën 18 vjeç	900	990	1,980
	3) Anëtar madhor (nëse ka)	–	–	2,772
Kategoria: trenjakë/katërnjakë/ sënjakë	Trinjakë (për secilin fëmijë)	300	300	300
	Katërnjakë (për secilin fëmijë)	400	400	400
Kompensime shtesë	Për fëmijët e familjeve në nevojë/ status jetimi/ 3-,4-,5-njakë që ndjekin arsimin e detyruar	300	300	300
	Kompensimi i energjisë elektrike për familjet përfituese të NE-së (VKM nr. 565/2006 + VKM nr. 8/2015).	1,288	1,288	1,288
	Pagesa ekstra në fillim të vitit shkollor për fëmijë të vendosur në shërbim kujdestarie (veshmbathje + arsim).	25,000	25,000	25,000

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, përpunuar nga grupi i auditimit

Që nga viti 2022 kur është rritur për herë të fundit masa e ndihmës ekonomike, pensioni social, që duhej të përdorej si referencë për indeksimin e masës së ndihmës ekonomike, është indeksuar, si më poshtë:

Nëpërmjet VKM-së nr. 553, datë 28.09.2023, në masën 8.6%;
Nëpërmjet VKM-së nr. 582, datë 18.09.2024, në masën 4.1%;
Nëpërmjet VKM-së nr. 540, datë 29.09.2025, në masën 2.5%.

Mungesa e përditësimit të masave me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 57/2019, si dhe të indeksimit të masës së përfitimit nga ndihma ekonomike, sipas përcaktimeve ligjore, sjell në terma realë uljen e fuqisë blerëse të përfitimit, duke dobësuar efektivitetin social të skemës. Kjo situatë

krijon risk për humbjen e funksionit mbrojtës të skemës së ndihmës ekonomike, rritjen e ekspozimit të familjeve në nevojë ndaj varfërisë dhe cënimin e koherencës së politikës sociale, pasi mekanizmi i indeksimit është parashikuar pikërisht për të ruajtur vlerën reale të përfitimit në kohë.

Planet vjetore të kontrolleve nga DKP NE&PAK dhe krahasimi me faktin
VKM-ja nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*" përcakton procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale, duke përfshirë kontrollin e programit të ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar, që kryhet nga struktura përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror, në nivel qendror dhe rajonal.
Kontrolli i strukturave rajonale dhe me përzgjedhje në njësitë e vetëqeverisjes vendore bëhet nga struktura përgjegjëse e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror, bazuar në planin vjetor të kontrollit, i cili miratohet nga titullari i institucionit. DKP NE&PAK kryen kontrolle të plota të paktën një herë në dy vjet në të gjitha DRSHSSH-të. Realizimi i planeve vjetore të kontrollit nga ana e DKP NR&PAK në SHSSH paraqitet, si më poshtë:

Viti	Plani i kontrollit	Të realizuara sipas planit	% realizimit të planit	DRSHSSH të parealizuara	Bashki të parealizuara	Kontrolle jashtë planit	Shpjegime kryesore
2020	6	4	**66.7%**	Berat, Tiranë	–	0	Periudha e pandemisë Covid-19; ndryshime strukturore në sektor
2021	8	8	**100%**	–	–	0	Plani i kontrollit u realizua plotësisht
2022	10	7	**70.0%**	–	Klos, Vau i Dejës, Skrapar	0	Problematika me sistemin e Ndihmës Ekonomike
2023	8	6	**75.0%**	Lezhë, Kukës	–	2	Kontrollet u shtynë për t'u fokusuar në Task-Forcën për verifikimin e përfituesve të skemës së NE
2024	*Task-Forcë (kombëtare)*	*Task-Forcë (kombëtare)*	–	–	–	–	Urdhri nr.46, datë 30.01.2024 "Për ngritjen e Task-Forcës për verifikimin në terren të përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike"
2025	8	7	**87.5%**	Elbasan	–	2	Kontrolli i DRSHSSH Elbasan u shty për vitin 2026; u realizuan kontrolle shtesë jashtë planit

Burimi: DKP NE&PAK, Shërbimi Social Shtetëror

Nga shqyrtimi i 36 raporteve përfundimtare të kontrolleve të ushtruara nga DKP NE & PAK rezulton se problematikat më të shpeshta lidhen me mospërputhjet ndërmjet vetëdeklarimit të përfituesve dhe të dhënave të verifikuara nëpërmjet sistemeve shtetërore. Në mënyrë të përsëritur janë evidentuar raste të mosdeklarimit ose deklarimit të pasaktë të pensioneve, pagave dhe mjeteve motorike, si dhe raste kur familje me anëtarë të punësuar ose me të ardhura të konsiderueshme kanë vijuar të trajtohen me ndihmë ekonomike. Gjithashtu, është konstatuar se mospërputhjet e identifikuara nga verifikimet automatike nuk trajtohen gjithmonë brenda afateve dhe në shumë raste mungon dokumentimi dhe argumentimi i plotë i vendimeve për moskonsiderimin e tyre si shkelje.
Një tjetër grup problematikash lidhet me dobësitë në procesin e verifikimit social-ekonomik dhe kontrollit në terren. Janë evidentuar raste të moskryerjes së vizitave fillestare dhe periodike në familje, plotësimit të paplotë të formularëve të vizitës në banesë, si dhe mospërputhje ndërmjet gjendjes së deklaruar dhe asaj të konstatuar gjatë verifikimeve në terren. Kontrolli ka evidentuar gjithashtu zbatim jo të njëtrajtshëm të kritereve për kategori të veçanta përfituesish, si jetimët apo prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh, si dhe mangësi në

administrimin e pagesave dhe dokumentacionit mbështetës, përfshirë rastet e pagesave të parregullta, mungesën e dokumentacionit për kompensimin e energjisë elektrike dhe mosdisponimin e informacionit të nevojshëm mbi tërheqjen e përfitimeve brenda afateve ligjore.

Rezultatet e verifikimit në terren nga Task-Forca e ngritur nëpërmjet Urdhrit të MSHMS nr. 46, datë 30.01.2024

Nëpërmjet Urdhrit nr. 46, datë 30.01.2024, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ngriti Task-Forcën për verifikimin në terren të përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike. Task-Forca kryesohej nga Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përbëhej nga përfaqësues të MSHMS-së, SHSSH-së, njësive vendore të kujdesit shëndetësor, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror, si dhe studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale. Sipas urdhrit, Task-Forca kishte për detyrë kryerjen, për një periudhë 6-mujore, të verifikimeve në terren të përfituesve të ndihmës ekonomike, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

Task-Forca konstatoi mangësi të konsiderueshme në procesin e verifikimit social-ekonomik nga administratorët shoqërorë, përfshirë mungesën ose vonesat në kryerjen e vizitave në banesë, mosplotësimin e saktë të formularëve të verifikimit dhe mospërditësimin e të dhënave të deklaruara nga familjet përfituese. Gjithashtu, u evidentuan raste të trajtimit me ndihmë ekonomike nga fondi deri në 6% pa përmbushjen e kritereve ligjore, si dhe mangësi në administrimin e deklaratave periodike të familjeve. Në nivel kombëtar, Task-Forca realizoi verifikime në 91% të familjeve përfituese, nga të cilat 95% u vlerësuan si familje në nevojë, përfshirë 22% të klasifikuara si ekstremisht të varfra. Nga ana tjetër, 5% e familjeve rezultuan të mos përmbushnin kriteret ligjore për përfitim, ndërsa 7.5% e familjeve që nuk u gjetën në banesë gjatë verifikimit nuk u paraqitën pranë njësive administrative për konfirmimin e situatës së tyre.

Rezultatet e Task-Forcës evidentuan problematika më të theksuara në qarqet Korçë, Elbasan dhe Dibër. Në Qarkun Korçë, rreth 9% e familjeve të verifikuara rezultuan të mos përmbushnin kushtet për përfitimin e ndihmës ekonomike, ku Bashkia Pogradec u identifikua si njësia me numrin më të lartë të problematikave dhe gjetjeve. Në Qarkun Elbasan, 8% e familjeve të verifikuara u vlerësuan si përfitues të parregullt, kryesisht për shkak të kushteve të mira të jetesës dhe ekzistencës së të ardhurave të padeklaruara nga emigracioni ose puna sezonale, me përqendrim më të lartë të rasteve në njësitë administrative Rrajcë, Qukës, Gjocaj, Polis dhe Shushicë. Ndërsa në Qarkun Dibër, 5% e familjeve të verifikuara rezultuan të mos përmbushnin kriteret ligjore të përfitimit për të njëjtat arsye, ku njësitë administrative Maqellarë, Kastriot, Tomin dhe Gjoricë u identifikuan si zonat me riskun më të lartë. Nivelet e verifikimit të realizuara nga Task-Forca ishin 96% në Qarkun Korçë, 92% në Qarkun Elbasan dhe 95% në Qarkun Dibër, duke siguruar një mbulim pothuajse të plotë të familjeve përfituese në këto qarqe.

Raporti ndërmjet familjeve të verifikuara dhe familjeve përfituese, si dhe përqindja e familjeve që nuk duhet të jenë përfituese të skemës së NE-së sipas konstatimeve nga task-forca ka rezultuar, si më poshtë:

Qarku	Përqindja e familjeve të verifikuara	Përqindja e familjeve të verifikuara që nuk duhet të jenë përfituese të skemës së NE-së
Korçë	96%	9%
Elbasan	92%	8%
Dibër	95%	5%
Kukës	91%	3%
Shkodër	80%	4%
Tiranë	93%	6%

Lezhë	83%	1%
Fier	80%	4%
Vlorë	100%	1%
Berat	93%	3%
Durrës	100%	2%
Gjirokastër	80%	4%

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Sipas analizës së rezultateve të Task-Forcës nga Shërbimi Social Shtetëror, një pjesë e konsiderueshme e problematikave lidhen me mosdeklarimin e të ardhurave nga emigracioni dhe puna sezonale, veçanërisht në zonat pranë kufirit, ku anëtarë të familjeve përfituese punojnë jashtë vendit pa deklaruar të ardhurat përkatëse. Gjithashtu, janë evidentuar raste të ndarjeve formale nga trungu familjar dhe transferimit të pasurive në emër të prindërve, me qëllim ruajtjen e statusit të përfituesit të ndihmës ekonomike. Verifikimet në terren kanë treguar se në disa raste familjet ndodheshin në kushte reale të vështira ekonomike, por nuk u gjet asnjë anëtar madhor gjatë vizitës për shkak të emigrimit ose angazhimit në punë sezonale.
Task-Forca evidentoi dobësi në procesin e administrimit të skemës nga njësitë vendore. Verifikimet social-ekonomike dhe deklarimet periodike rezultuan në shumë raste formale ose fiktive, ndërsa të dhënat e pasqyruara në formularët e aplikimit nuk përputheshin me gjendjen reale të familjeve përfituese. Analiza territoriale tregoi se familjet më të varfra përqendrohen kryesisht në zonat urbane, ku mungojnë burimet alternative të të ardhurave, ndërsa në zonat rurale familjet disponojnë të ardhura nga aktivitetet bujqësore dhe blegtorale.
Task-Forca evidentoi gjithashtu një numër të konsiderueshëm individësh në moshë aktive pune që nuk rezultojnë të regjistruar pranë zyrave të punës, si dhe raste kur familjet aplikojnë për ndihmë ekonomike jo vetëm për përfitimin e pagesës monetare, por edhe për të përfituar nga lehtësitë dhe përfitimet e tjera të lidhura me statusin e përfituesit, përfshirë përjashtimin nga tarifat shkollore dhe bursat për studentët. Këto problematika kanë ndikuar në përfshirjen në skemë të familjeve që nuk plotësojnë kriteret ligjore të përfitimit, duke rritur riskun e gabimeve të përfshirjes dhe duke cenuar saktësinë e targetimit të skemës së ndihmës ekonomike.

Verifikimet në terren përbëjnë një mekanizëm kyç për garantimin e integritetit të skemës së Ndihmës Ekonomike, si mënyra më efektive për të vlerësuar gjendjen social-ekonomike të familjeve, që është edhe qëllimi thelbësor i skemës së ndihmës ekonomike. Gjetjet e Task-Forcës për vitin 2024 dëshmojnë qartë se, pavarësisht ekzistencës së një sistemi të digjitalizuar dhe ndërveprimeve me databaza të ndryshme shtetërore, përfitimet e padrejta mbeten të pranishme kur mungon ose vonohet verifikimi fizik në banesë. Fenomene të tilla si mospasqyrimi real i situatës faktike në formularët e aplikimit për ndihmë ekonomike, mosdeklarimi i të ardhurave nga puna informale, emigrimi apo puna sezonale, ndarjet fiktive nga trungu familjar, transferimi formal i pasurisë për efekt përfitimi, si dhe mosprezenca e anëtarëve madhorë në familje, nuk mund të identifikohen në mënyrë të plotë vetëm përmes kontrolleve automatike dhe/ ose dokumentare.

Verifikimet në terren nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së

a. *Mbi verifikimet social-ekonomike me përzgjedhje*

Në pikën 9, gërma d, të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*" përcaktohet se grupet e kontrollit të strukturave rajonale ushtrojnë kontroll për zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike, për përputhshmërinë e deklarimit të familjes përfituese me vizitën në shtëpi, të pasqyruar nga administrator shoqëror në sistem, nëpërmjet realizimit të verifikimeve social-ekonomike me përzgjedhje.
Verifikimi i situatës social ekonomike të familjeve në nevojë nga ana e administratorit shoqëror, brenda 20 ditëve të muajit të aplikimit për herë të parë dhe 2 herë në vit për familjet që trajtohen

me NE është detyrim të hidhet në Regjistrin Elektronik Kombëtar, sipas përcaktimit në Kreun II, pika 2, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, ndërkohë që ngarkimi në sistem i formularit të vizitës në shtëpi nga DR SHSSH nuk mundësohej, deri pas ndryshimeve ligjore të vitit 2024 që detyrojnë strukturat rajonale të SHSSH-së për kryerjen e vizitave në shtëpi për të gjithë përfituesit e rinj në skemën e NE.
Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Shërbimi Social Shtetëror ka rezultuar se:
- ***Për vitin 2020***, nga 66,346 përfitues, Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së kanë realizuar gjithsej 1,029 verifikime në banesë (rreth 1.55% të totalit). Drejtoria Rajonale SHSSH Durrës ka realizuar numrin më të lartë të verifikimeve në banesë në raport me totalin, duke mbuluar rreth 16.7% të përfituesve, ndërsa Drejtoritë Rajonale që kanë realizuar numrin më të ulët në raport me totalin janë DRSHSSH Kukës (0.39%), Shkodër (0.62%) dhe Tiranë (0.87%).
- ***Për vitin 2021***, nga 68,514 përfitues, Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së kanë realizuar gjithsej 1,410 verifikime në banesë (rreth 2% të totalit). DR SHSSH Durrës ka realizuar numrin më të lartë të verifikimeve në banesë në raport me totalin, duke mbuluar rreth 32% të përfituesve, ndërsa Drejtoritë Rajonale që kanë realizuar numrin më të ulët në raport me totalin janë DR SHSSH Gjirokastër (nga të dhënat 0%), Tiranë (nga të dhënat 0%) dhe Kukës (0.1%).
- ***Për vitin 2022***, nga 63,700 përfitues, Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së kanë realizuar 1,477 verifikime në banesë (rreth 2.15% të totalit). DR SHSSH Durrës ka realizuar numrin më të lartë të verifikimeve në banesë në raport me totalin, duke mbuluar rreth 13.6% të përfituesve, ndërsa Drejtoritë Rajonale që kanë realizuar numrin më të ulët në raport me totalin janë DR SHSSH Gjirokastër (nga të dhënat 0%), Tiranë (nga të dhënat 0%) dhe Kukës (1%).
- ***Për vitin 2023***, nga 62,376 përfitues, Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së kanë realizuar 3,398 verifikime në banesë (rreth 5.45% të totalit). DR SHSSH Durrës ka realizuar numrin më të lartë të verifikimeve në banesë (rreth 34.3% të totalit), ndërsa DR SHSSH që kanë realizuar numrin më të ulët të në raport me totalin janë DR SHSSH Tiranë (rreth 2.5%), Korçë (2.65%) dhe Elbasan (2.7%).
- ***Për vitin 2024***, nga 53,536 përfitues, janë kryer në total 47,246 verifikime në banesë (rreth 88% të totalit), nga angazhimi me Task-Forcën e ngritur me Urdhrin e MSHMS-së nr. 46, datë 30.01.2024, ku janë konstatuar problematikat e trajtuara më sipër.
- ***Për vitin 2025***, nga 50,600 përfitues, Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së kanë realizuar 3,377 verifikime në banesë (rreth 6.7% të totalit). DR SHSSH Durrës ka realizuar numrin më të lartë të verifikimeve në banesë (rreth 41.5% të totalit), ndërsa DR SHSSH me numrin më të ulët në raport me totalin janë DR SHSSH Kukës (rreth 1.5%), Elbasan (2.2%) dhe Dibër (3.4%).

b. Mbi familjet që aplikojnë për herë të parë

Pas rezultateve të Task-Forcës së vitit 2024, ku u konstatua në mënyrë të shpeshtë se gjendja e pasqyruar në formularët e aplikimit nga administratorët shoqërorë nuk përkon me gjendjen reale social ekonomike të familjeve përfituese, nëpërmjet VKM-së nr. 855, datë 26.12.2024 u ndryshua VKM-ja nr. 597, datë 04.09.2019, duke shtuar në kreun II, pika 2.1 detyrimin e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të kryejnë verifikimin në terren për familjet që aplikojnë për herë të parë, pas vlerësimit social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Pavarësisht sa më sipër, ky detyrim i ri nuk rezulton të jetë pasqyruar në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorive Rajonale të SHSSH nr. 353 prot., datë 13.02.2017, si dhe nuk rezulton të ketë dalë asnjë akt tjetër udhëzues ku të përcaktohet një afat për kryerjen e verifikimit social-ekonomik për familjet që aplikojnë për herë të parë nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së.
Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave për NE & PAK u konstatua se, për vitin 2025, vizitat në terren për familjet që kanë aplikuar për herë të parë nuk janë kryer plotësisht nga disa prej Drejtorive Rajonale të SHSSH-së, në mospërputhje me Kreun II, pika 2.1, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 "*Për përcaktimin e procedurave, të*

dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar, si më poshtë:

Drejtoria Rajonale SHSSH	Përfitues për herë të parë	Numri i verifikimeve
Elbasan	140	4
Korçë	125	11
Kukës	112	32
Shkodër	59	7
Tiranë	41	12

Burimi: DKP NE & PAK, Shërbimi Social Shtetëror

Nga intervistat e zhvilluara në Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së u evidentua si problematikë mungesa e automjeteve për realizimin e kontrolleve në terren/ vizitave në shtëpi. Nga auditimi u konstatua se vetëm Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së Vlorë, Shkodër dhe Durrës disponojnë automjet, nga të cilat DRSHSSH Vlorë dhe Durrës i kanë në gjendje jofunksionale, ndërsa DRSHSSH Durrës e ka në gjendje pune por për shkak të vjetërsisë të amortizuar. Mungesa e automjeteve pamundëson përmbushjen e këtyre detyrave, sidomos sa i përket verifikimeve në terren për NE dhe PAK, të cilat shpeshherë ndodhen edhe në zona rurale që nuk mbulohen me shërbim transporti publik. Përgjatë muajit shtator 2025, Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së Gjirokastër, Shkodër, Dibër, Vlorë, Elbasan, Kukës, Durrës dhe Lezhë i janë drejtuar Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, duke kërkuar marrjen me qira të automjeteve, për mbarëvajtjen optimale të veprimtarisë së punës së përditshme të Drejtorive Rajonale.

Planet vjetore të kontrolleve nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së dhe krahasimi me faktin
Sipas përcaktimit në pikën 5, gërma b, të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*", struktura përgjegjëse për pagesat e NE dhe PAK në nivel rajonal kryen kontroll të plotë një herë në dy vjet në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Nga auditimi u konstatua se Drejtoritë Rajonale *përgjithësisht* i planifikojnë dhe kryejnë kontrollet e plotë jo drejtpërdrejt në njësi të vetëqeverisjes vendore, por sipas njësive administrative, nga ku rezultoi, si më poshtë:

Drejtoria Rajonale e SHSSH-së	Kontrollet e planifikuara dhe realizuara
Durrës	Për vitin 2020 janë planifikuar 16 kontrolle, prej të cilave 2 nuk janë realizuar. Për vitin 2021 janë planifikuar 22 kontrolle dhe të gjitha janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 14 kontrolle dhe të gjitha janë realizuar. Për vitin 2023 janë planifikuar 22 kontrolle dhe 1 prej tyre nuk është realizuar. Për vitin 2024 janë planifikuar 19 kontrolle dhe 6 prej tyre nuk janë realizuar, kjo për shkak të pjesëmarrës së 4 specialistëve në grupe inspektimi në Bashki të tjera si dhe Task Force-n e organizuar në qarkun Durrës. Në vitin 2025 janë planifikuar 23 kontrolle dhe të gjitha janë realizuar.
Kukës	Për vitin 2020 janë planifikuar 20 kontrolle, prej të cilave 15 nuk janë realizuar për shkak të Covid-19. Për vitin 2021 janë planifikuar 27 kontrolle, prej të cilave 17 nuk janë realizuar për shkak të Covid-19. Për vitin 2022 janë planifikuar 13 kontrolle prej të cilave 10 nuk janë realizuar, ku nga SHSSH citohet se "*nuk janë hedhur në sistem për shkak të hakerimit korrik 2022-janar 2023*". Për vitin 2023 janë planifikuar 20 kontrolle dhe 4 prej tyre nuk janë realizuar, ku nga SHSSH citohet "*për shkak të mbingarkesës së kontrollit*". Për vitin 2024 janë parashikuar 26 kontrolle dhe 21 prej tyre nuk janë realizuar për shkak të Task Forcës. Për vitin 2025 janë parashikuar 25 kontrolle dhe 3 prej tyre nuk janë realizuar. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Kukës*** rezulton se: -NJ.A. Tërthore nuk është kontrolluar për periudhën 2020-2023 dhe për vitin 2023 nuk ka patur asnjë kontroll të parashikuar, -NJ.A. Kukës, Kolsh, Surroj, Bicaj, Ujmisht, nuk janë kontrolluar për periudhën 2020-2022, -NJ.A. Zapod nuk është kontrolluar për periudhën 2020-2022, dhe për vitin 2020 dhe 2021 nuk ka patur kontrolle të parashikuara, -NJ.A. Bushtricë nuk është kontrolluar për periudhën 2020-2022 dhe për vitin 2022 nuk ka patur asnjë kontroll të parashikuar. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Tropojë*** rezulton se NJ.A. Llugaj, Fierzë, Bytyç, Lekbibaj nuk janë kontrolluar për periudhën 2020-2022.
Gjirokastër	Për vitin 2020 janë planifikuar 15 kontrolle, prej të cilave 4 nuk janë realizuar për shkak të Covid 19. Për vitin 2021 janë planifikuar 16 kontrolle dhe të gjitha janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 12 kontrolle dhe të gjitha janë realizuar. Për vitin 2023 janë planifikuar 16 kontrolle dhe të gjitha janë realizuar. Për vitin 2024 janë planifikuar 16 kontrolle dhe 3 prej tyre nuk janë realizuar për shkak të Task Forcës. Në vitin 2025 janë planifikuar 14 kontrolle dhe 3 prej tyre nuk janë realizuar për shkak të realizimit të tyre në vitin paraardhës dhe mosfunksionimit të sistemit të NE për kryerjen e procedurave të njoftimit dhe të nxjerrjes së raporteve paraprake.

	Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Dropull*** rezulton se NJ.A. Dropull i sipërm nuk është kontrolluar për periudhën 2021-2023.
Berat	Për vitin 2020 janë planifikuar 13 kontrolle, prej të cilave 11 nuk janë realizuar për shkak të Covid 19. Për vitin 2021 janë planifikuar 23 kontrolle dhe të gjitha janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 12 kontrolle dhe të gjitha janë realizuar. Për vitin 2023 janë planifikuar 23 kontrolle dhe të gjitha janë realizuar. Për vitin 2024 janë planifikuar 25 kontrolle dhe 15prej tyre nuk janë realizuar për shkak të Task Forcës. Në vitin 2025 janë planifikuar 24 kontrolle dhe 2 prej tyre nuk janë realizuar për shkak ndryshimit të Administratorit Shoqëror në një prej njësive dhe raportit "leje lindje" të administratorit shoqëror në njësinë tjetër. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Berat*** rezulton se NJ.A. Roshnik nuk është kontrolluar për vitet 2022 dhe 2023.
Shkodër	Për vitin 2020 janë planifikuar 16 kontrolle të plota dhe 4 kontrolle tematika për NE, gjithashtu 17 kontrolle të plota dhe 1 kontroll tematik për PAK prej të cilave 7 kontrolle të plota dhe 3 kontrolle tematike për NE si dhe 9 kontrolle të plota për PAK nuk janë realizuar për shkak të Covid 19. Për vitin 2021 janë planifikuar 19 kontrolle të plota për NE, gjithashtu 18 kontrolle të plota për PAK prej të cilave të gjitha janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 17 kontrolle të plota për NE, gjithashtu 18 kontrolle të plota për PAK të cilat janë realizuar plotësisht. Për vitin 2023 janë planifikuar 18 kontrolle të plota për NE, gjithashtu 17 kontrolle të plota për PAK të cilat janë realizuar plotësisht. Për vitin 2024 janë planifikuar 18 kontrolle të plota dhe 2 kontrolle tematika për NE, gjithashtu 20 kontrolle të plota për PAK prej të cilave 9 kontrolle të plota për NE si dhe 4 kontrolle të plota për PAK nuk janë realizuar për shkak të Task Forcës. Në vitin 2025 janë planifikuar 18 kontrolle të plota për NE, gjithashtu 16 kontrolle të plota për PAK të cilat janë realizuar plotësisht. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Shkodër*** rezulton se NJ.A. Shkodër, Postribë, Pult, Rrethina nuk janë kontrolluar për vitet 2020 dhe 2021. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Malësi e Madhe*** rezulton se NJ.A. Koplik nuk është kontrolluar për vitet 2020 dhe 2021.
Fier	Për vitin 2020 janë planifikuar 24 kontrolle prej të cilave 16 kontrolle nuk janë realizuar për shkak të Covid 19. Për vitin 2021 janë planifikuar 22 kontrolle të plota prej të cilave të gjitha janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 19 kontrolle prej të cilave 8 nuk janë realizuar për shkak të mungesës së stafit. Për vitin 2023 janë planifikuar 22 kontrolle të cilat janë realizuar plotësisht. Për vitin 2024 janë planifikuar 18 kontrolle prej të cilave 15 kontrolle nuk janë realizuar për shkak të Task Forcës. Në vitin 2025 janë planifikuar 12 kontrolle të cilat janë realizuar plotësisht. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Patos*** rezulton se: -NJ.A. Patos, Ruzhdie nuk janë kontrolluar për vitet 2020-2022, -NJ.A. Zharëz nuk është kontrolluar për vitet 2022 dhe 2023. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Divjakë*** rezulton se: -NJ.A. Divjakë nuk është kontrolluar për vitet 2020-2023, -NJ.A. Tërbuf nuk është kontrolluar për vitet 2020 dhe 2021, -NJ.A. Gradishtë nuk është kontrolluar për vitet 2020-2022, -NJ.A. Remas nuk është kontrolluar për vitet 2022 dhe 2023. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Roskovec*** rezulton se: -NJ.A. Roskovec nuk është kontrolluar për vitet 2022 dhe 2023, -NJ.A. Kurjan, Strum nuk janë kontrolluar për vitet 2020 dhe 2021. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Mallakastër*** rezulton se: -NJ.A. Ballsh, Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Gracan nuk janë kontrolluar për vitet 2022 dhe 2023, -NJ.A. Kutë, Selitë nuk janë kontrolluar për vitet 2020-2022.
Elbasan	Për vitin 2020 janë planifikuar 16 kontrolle për NE dhe PAK të cilat janë realizuar plotësisht. Për vitin 2021 janë planifikuar 30 kontrolle për NE dhe PAK prej të cilave të gjitha janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 24 kontrolle për NE dhe PAK të cilat janë realizuar plotësisht. Për vitin 2023 janë planifikuar 26 kontrolle për NE dhe PAK të cilat janë realizuar plotësisht. Për vitin 2024 janë planifikuar 33 kontrolle për NE dhe PAK prej të cilave 22 nuk janë realizuar për shkak të Task Forcës. Në vitin 2025 janë planifikuar 19 kontrolle për NE dhe PAK të cilat janë realizuar plotësisht. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Elbasan*** rezulton se NJ.A. Elbasan, Gjergjan, Gjinar, Funar, nuk janë kontrolluar për vitet 2020 dhe 2021.
Korçë	Për vitin 2020 janë planifikuar 28 kontrolle prej të cilave 13 kontrolle nuk janë realizuar për shkak të Covid 19. Për vitin 2021 janë planifikuar 26 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 27 kontrolle prej të cilave 6 nuk janë realizuar, ku nga SHSSH citohet "*për shkak të situatës me hakerimin e të dhënave në Korrik 2022*". Për vitin 2023 janë planifikuar 22 kontrolle prej të cilave 2 nuk janë realizuar për shkak të angazhimit të specialisteve në Task Force si dhe në detyra të tjera funksionale. Për vitin 2024 nuk është planifikuar asnjë kontroll për shkak të Task Forcës. Në vitin 2025 janë planifikuar 32 kontrolle të cilat janë realizuar plotësisht. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Korçë*** rezulton se: -NJ.A. Voskopojë dhe NJ.A. Lekas nuk janë kontrolluar për vitet 2022 dhe 2023. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Kolonjë*** rezulton se: -NJ.A. Leskovik, Qendër Leskovik, Bramsh, Mollas, Clirim. nuk janë kontrolluar për vitet 2022 dhe 2023, -NJ.A. Novoselë nuk është kontrolluar për vitet 2021 dhe 2022. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Pogradec*** rezulton se: -NJ.A. Udenisht, Bucimas, Cerrave, Velcan, nuk janë kontrolluar për vitet 2022 dhe 2023, -NJ.A. Dardhas, Proptisht nuk janë kontrolluar për vitet 2020 dhe 2021, -NJ.A. Udenisht nuk është kontrolluar për vitet 2020 - 2023. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Devoll*** rezulton se: -NJ.A. Bilisht, Qendër Bilisht, Hocisht, nuk janë kontrolluar për vitet 2021 -2023, -NJ.A. Miras nuk është kontrolluar për vitet 2020 -2023. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Maliq*** rezulton se: -NJ.A. Vreshtas nuk është kontrolluar për vitet 2020 -2023, -NJ.A. Pirg, Pojan nuk janë kontrolluar për vitet 2020 dhe 2021. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Pustec*** rezulton se:

	-NJ.A. Pustec nuk është kontrolluar për vitet 2022 dhe 2023.
Tiranë	Për vitin 2020, sipas tabelës së dorëzuar nga SHSSH rezulton se janë planifikuar 25 kontrolle prej të cilave 16 kontrolle nuk janë realizuar për shkak të Covid 19. Ndërkohë që me kontrollin manual të kryer nga grupi i auditimit rezulton se 20 prej këtyre kontrolleve nuk janë realizuar. Për vitin 2021 janë planifikuar 23 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 16 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2023 janë planifikuar 19 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2024 janë planifikuar 21 kontrolle prej të cilave janë realizuar 18 kontrolle për shkak të Task Forcës. Në vitin 2025 janë planifikuar 18 kontrolle të cilat janë realizuar plotësisht. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Tiranë*** rezulton se: -NJ.A. Farkë, Kashar, Ndroq, Petrelë, Pezë, NJ.A. nr. 11, nuk janë kontrolluar për vitet 2020 dhe 2021, -NJ.A. nr.8, nr. 9 nuk janë kontrolluar për vitet 2021 dhe 2022, -NJ.A. nr.3, nr.7 dhe Bërzhitë nuk janë kontrolluar për vitet 2022 dhe 2023. Nga auditimi i kontrolleve për ***Bashkinë Rrogozhinë*** rezulton se NJ.A. Gosë nuk është kontrolluar për vitet 2020 dhe 2021.
Vlorë	Për vitin 2020 janë planifikuar 22 kontrolle, 10 prej të cilave nuk janë realizuar për shkak të Covid-19. Për vitin 2021 janë planifikuar 23 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 18 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2023 janë planifikuar 23 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2024 janë planifikuar 24 kontrolle të cilat janë realizuar. Në vitin 2025 janë planifikuar 20 kontrolle të cilat janë realizuar plotësisht.
Lezhë	Për vitin 2020 janë planifikuar 16 kontrolle, 10 prej të cilave 6 nuk janë realizuar për shkak të Covid-19. Për vitin 2021 janë planifikuar 13 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 10 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2023 janë planifikuar 21 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2024 janë planifikuar 21 kontrolle, 10 prej të cilave nuk janë realizuar për shkak të Task Forcës. Në vitin 2025 janë planifikuar 21 kontrolle të cilat janë realizuar plotësisht.
Dibër	Për vitin 2020 janë planifikuar 33 kontrolle, 29 prej të cilave 6 nuk janë realizuar për shkak të Covid-19. Për vitin 2021 janë planifikuar 33 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2022 janë planifikuar 34 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2023 janë planifikuar 32 kontrolle të cilat janë realizuar. Për vitin 2024 janë planifikuar 40 kontrolle, 35 prej të cilave nuk janë realizuar për shkak të Task Forcës. Në vitin 2025 janë planifikuar 27 kontrolle të cilat janë realizuar plotësisht. Nga auditimi rezulton se NJ.A. Komsi nuk është kontrolluar për vitin 2020 dhe 2021.

Kontrolli i tërheqjes së pagesave brenda afatit 10-ditor dhe nga personat e autorizuar

Në pikën 9, gërmat f dhe g, të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*" përcaktohet se grupet e kontrollit të strukturave rajonale ushtrojnë kontroll për zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike, për (i) *procedurën e ndjekur ndërmjet bashkisë dhe postës/ bankës për rakordimin dhe marrjen e informacionit për listën emërore e informacionit për listën emërore të familjeve që nuk kanë tërhequr ndihmën ekonomike brenda afatit, si dhe ndjekjen e procesit të largimit të familjes nga përfitimi i ndihmës ekonomike* dhe (ii) *përputhjen ndërmjet borderosë dhe thesarit, numrit të familjeve përfituese dhe shumave të përfitimit të ndihmës ekonomike*.

Neni 11, gërma b, i VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, përcakton se përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë gjashtëmujore, familjet që nuk tërheqin ndihmën ekonomike brenda 10 ditëve pune nga dita e depozitimit në llogarinë bankare/ kryerjes së pagesave nga Posta Shqiptare sh.a, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si ato shëndetësore apo fatkeqësi. Nga ana e SHSSH-së bëhet me dije se rakordimi bëhet **vetëm me postën, pasi banka nuk e ofron si informacion duke e konsideruar si ruajtje të konfidencialitetit të klientit**. Mungesa e aksesit në informacion nga bankat e bën praktikisht inekzistente hallkën e kontrollit për identifikimin e familjeve që nuk tërheqin ndihmën ekonomike brenda afatit, duke pamundësuar aplikimin efektiv të filtrit përkatës të përjashtimit, i cili në thelb synon të evidentojë rastet kur mungesa e tërheqjes së pagesës mund të reflektojë mungesë të nevojës reale për përfitimin.

Në Kreun III, pika 14, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, përcaktohet se të drejtën për ta tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike për familjet në nevojë e ka bashkëshortja e kryefamiljarit, ndërsa për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon, të drejtën e tërheqjes e ka kryetari i familjes. Grupi i auditimit ka kërkuar informacion mbi procedurën e ndjekur për kontrollin e rakordimit periodik të SHSSH-së ose NJVV-ve me bankën/ postën për tërheqjet e ndihmës ekonomike nga SHSSH në nivel qendror/ rajonal, dhe nga ana e SHSSH-së është bërë me dije se strukturat përgjegjëse pranë bashkisë për çdo muaj kryejnë rakordime me postën nëpërmjet borderove të pagesës së NE, sipas vendimit të gjeneruar nga DR SHSSH

me borderotë e firmosura nga personat e autorizuar me ligj për tërheqjen ose dhe fatura tatimore elektronike.
Për të verifikuar dhe shqyrtuar procedurat e ndjekura nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së lidhur me kontrollet e kryera për (i) tërheqjen e NE brenda afatit 10-ditor dhe (ii) tërheqjen e pagesave të NE-së nga personat e autorizuar, grupi i auditimit ka administruar nga 1 Raport kontrolli nga secila prej Drejtorive Rajonale të SHSSH-së, nga ku ka rezultuar se:

- **Drejtoria Rajonale SHSSH Berat** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në NJ.A Leshnje, Bashkia Skrapar, nr. 618/5 prot., datë 02.09.2025. Në pikën 5 "*kontrolli i procedurës për tërheqjen e NE-së brenda afatit*", citohet se "*nga verifikimi i borderove të marra nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Skrapar, rezultoi se pagesa kalonte në emër të grave. Nga ana e grupit të kontrollit* ***nuk mund të verifikohet nëse pagesa është tërhequr brenda 10 ditëve****, pasi nga ana e subjektit të kontrolluar nuk është marrë informacion*".
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Dibër** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në NJ.V Burrel, Bashkia Mat, nr. 117/3 prot., datë 03.07.2025. Në pikën 6 "*kontrolli i procedurës për tërheqjen e NE-së brenda afatit*", citohet se "*borderotë e pagesës së NE u verifikuan në zyrën e financës së Bashkisë Mat nëse ishin të sigluara nga personat e autorizuar me ligj për tërheqjen e NE, pasi kopja e borderosë nuk disponohej pranë NJ.A Burrel, por pranë Drejtorisë së Financës në Bashkinë Mat... pranë NJ.A Burrel nuk ishin kopje të sigluara nga personat përfitues në sistemin e ndihmës ekonomike*". **Për sa më sipër, në raport nuk paraqitet asnjë e dhënë mbi verifikimet e kryera nga ana e DRSHSSH Dibër, si dhe rezultatet e verifikimeve, nëse ishte në përputhje me kuadrin ligjor ose jo**.
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Durrës** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në NJ.V Xhafzotaj, Bashkia Shijak, nr. 1427/6 prot., datë 12.12.2025. Në pikën 5 "*kontrolli i procedurës për tërheqjen e NE-së brenda afatit*", citohet se "*nga kontrolli i borderove origjinale rezultoi se tërheqja e masës së përfitimit ishte bërë nga personi që kishte emrin në bordero... ishin mbajtur akt-rakordime midis punonjësve të postës dhe administratores shoqërore brenda afatit 10-ditor*".
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Elbasan** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në NJ.V Polis, Bashkia Librazhd, nr. 489/6 prot., datë 23.09.2025. Në pikën 6 citohet se "*janë mbajtur rregullisht procesverbale mbi akt rakordimet me Postën Shqiptare për tërheqjen e pagesave të NE nga familjet përkatëse. Nuk rezultoi që për këtë periudhë të ketë pasur familje përfituese që nuk e kanë tërhequr NE brenda afatit ligjor në fuqi, verifikuar kjo përmes procesverbaleve për akt-rakordimet për periudhën e kontrollit*".
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Fier** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në NJV Selitë, Bashkia Mallakastër, nr. 1054/3 prot., datë 17.12.2025. Në pikën 5 "*kontrolli i procedurës për tërheqjen e NE-së brenda afatit*" citohet se "*Nga kontrolli rezulton tërheqja e ndihmës ekonomike ne Bashkinë Mallakastër, Njësia Administrative Selitë, bëhej me anë të filialit të Postës Shqiptare sipas marrëveshjes me nr.17/1 prot, datë 04/01/2023. Nga kontrolli pranë zyrave të Financës pranë Bashkisë Mallakastër rezulton se janë mbajtur aktrakordime me postën për tërheqjen e ndihmës ekonomike. Për komisionimin e pagesave te NE zbatohet rregulli i mos komisionimit të pagesës të qytetarëve, sipas pikës 5 te Kreut III të marrëveshjes me nr.17/1 prot, datë 04/01/2023. komisioni 0.6% paguhet nga të ardhurat e Bashkisë Mallakastër*". **Nga ana e DR SHSSH Fier nuk citohet asnjë aktivitet kontrolli i kryer, për të kontrolluar tërheqjen e pagesave nga personat e autorizuar dhe tërheqjen e NE-së brenda afatit**.
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Gjirokastër** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në Bashkinë Përmet, nr. 524/6 prot., datë 29.07.2025. Në pikën 5 "*kontrolli i procedurës për tërheqjen e NE-së brenda afatit*" citohet se "*Zyra e NE e Bashkisë Përmet dispononte kopje të borderove të pagesës së NE dhe të sigluara në kuponin tatimor nga personat e autorizuar me ligj për tërheqjen e pagesës... në Bashkinë Përmet nuk rezultoi ndonjë rast i mostërheqjes së*

pagesës brenda afatit 10-ditor për periudhën e kontrolluar dhe nuk ka pasur asnjë rast të ankimimit për këto pagesa. Gjithashtu, edhe pranë DR SHSSH Gjirokastër nuk ka pasur asnjë rast të ankimimit për mostërheqje të pagesës së NE".

➢ **Drejtoria Rajonale SHSSH Korçë** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në NJ.V Gore, Bashkia Maliq, nr. 876/4 prot., datë 13.11.2025. Në pikën 5 "*kontrolli i procedurës për tërheqjen e NE-së brenda afatit*", citohet se "*sipas informacionit nga Drejtoria e Financës së Bashkisë Maliq rezulton se nuk ka asnjë rast për mostërheqje të masës mujore të ndihmës ekonomike. Nuk rezultoi asnjë rast i kthimit të shumës. Pranë DRSHSSH Korçë nuk ka pasur asnjë rast të ankimimit për mostërheqje të masës së ndihmës ekonomike. Nuk rezultoi ndonjë rast kthim shume, pasi nuk rezultojnë familje të larguara për mostërheqje pagese brenda afatit 10-ditor nga momenti i fillimit të kryerjes së pagesave nga ana e postës*". **Nga ana e DR SHSSH Korçë nuk citohet asnjë aktivitet kontrolli i kryer, për të kontrolluar tërheqjen e pagesave nga personat e autorizuar dhe tërheqjen e NE-së brenda afatit**.

➢ **Drejtoria Rajonale SHSSH Kukës** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në NJ.V Arren, Bashkia Kukës, nr. 128/3 prot., datë 31.07.2025. Në pikën 8 "*kontrolli i procedurës për tërheqjen e NE-së brenda afatit*" citohet se "*Zyra e NE pranë NJ.A Arren nuk ishte plotësuar me kopje të listëpagesave të postës. Listëpagesat e postës të firmosura nga përfituesit e NE-së mbahen në Drejtorinë e Financës pranë Bashkisë Kukës. Por këto listëpagesa nuk na janë vendosur në dispozicion për arsye se Auditi i Brendshëm i Bashkisë Kukës i kishte marrë për kontroll*". **Nga ana e DR SHSSH Kukës nuk citohet asnjë aktivitet kontrolli i kryer, për të kontrolluar tërheqjen e pagesave nga personat e autorizuar dhe tërheqjen e NE-së brenda afatit**.

➢ **Drejtoria Rajonale SHSSH Lezhë** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në NJ.V Zejmen, Bashkia Lezhë, nr. 150/4 prot., datë 30.09.2025. Në pikën 6 citohet se "*u kontrolluan borderotë origjinale dhe u konstatua se ishte bërë tërheqja brenda afateve kohore*".

➢ **Drejtoria Rajonale SHSSH Shkodër** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në NJ.V Shosh, Bashkia Shkodër, nr. 1447/3 prot., datë 03.02.2026.

Në pikën 6 "*kontrolli i procedurës për tërheqjen e NE-së brenda afatit*", listohen aktrakordimet me postën, si dhe citohet "*për NJ.A nuk ka shuma të patërhequra...Listëpagesat e postës të firmosura nga përfituesit e NE mbahen në Drejtorinë e NE pranë Bashkisë Shkodër, ndërsa në zyrën e NE në NJ.A mbahen listëpagesa origjinale të pafirmosura nga përfituesit*". **Nga ana e DR SHSSH Shkodër nuk citohet asnjë aktivitet kontrolli i kryer, për të kontrolluar tërheqjen e pagesave nga personat e autorizuar dhe tërheqjen e NE-së brenda afatit**.

➢ **Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në Bashkinë Kamëz, nr. 925/4 prot., datë 13.01.2026. Në pikën 2 "*kontrolli i procedurës për tërheqjen e NE-së brenda afatit*" citohet se "*zyra e financës dhe administratorët në njësi disponojnë listëpagesat origjinale dhe kopjet e tyre të kthyera nga posta të firmosura nga përfituesit, si rrjedhojë është ndjekur ecuria e tërheqjes së pagesave nga përfituesit e ndihmës ekonomike*". **Nga ana e DR SHSSH Tiranë nuk citohet asnjë aktivitet kontrolli i kryer, për të kontrolluar tërheqjen e pagesave nga personat e autorizuar dhe tërheqjen e NE-së brenda afatit**.

➢ **Drejtoria Rajonale SHSSH Vlorë** ka paraqitur Raportin përfundimtar të kontrollit në NJ.V Kotë, Bashkia Vlorë, nr. 1379 prot., datë 10.07.2025. Në pikën 1 "*kontrolli i procedurës për tërheqjen e NE-së brenda afatit*" citohet se "*nuk u arrit të bëhej verifikimi për borderotë e pagesës së Ndihmës Ekonomike nëse ishin të sigluara nga personat e autorizuar me ligj për tërheqjen e pagesës së NE...shpërndarja e pagesave të NE bëhet me mandate elektronike, si rrjedhojë nuk bëhet pajisja me bordero mujore të sigluara nga përfituesit*".

Sipas kërkesave të legjislacionit të asistencës sociale dhe procedurave të kontrollit në fuqi, Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së duhet të ushtrojnë kontrolle të plota dhe të dokumentuara për

të verifikuar që pagesat e ndihmës ekonomike tërhiqen nga personat e autorizuar me ligj dhe brenda afatit 10-ditor të përcaktuar, në funksion të ushtrimit efektiv të kontrollit mbi rregullsinë e përfitimit. Nga shqyrtimi i raporteve të kontrollit të administruara rezulton se këto kërkesa nuk janë përmbushur në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme, pasi në një pjesë të konsiderueshme të rasteve mungon evidencë mbi kryerjen e verifikimeve konkrete, ndërsa në raste të tjera dokumentacioni mbështetës nuk është vënë në dispozicion ose nuk disponohet në strukturat përgjegjëse për kontroll, duke kufizuar efektivitetin e funksionit mbikëqyrës dhe duke paraqitur risk (i) që të mos përjashtohen nga skema persona që nuk tërheqin ndihmën brenda afatit ligjor pa shkaqe të arsyeshme, si dhe (ii) që pagesat të mos tërhiqen nga personat e autorizuar me ligj.

Akt marrëveshjet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore me Postën Shqiptare dhe tarifa e shërbimit postar

Në pikën 8, gërma a dhe b, dhe pikën 9, gërma a, të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*", përcaktohet se grupi i kontrollit në nivel qendror dhe rajonal ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, ndër të tjera mbi veprimtarinë e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të NE.

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka kërkuar nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së vënien në dispozicion të marrëveshjeve mes disa njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Postës Shqiptare sh.a, për ekzekutimin e pagesave lidhur me ndihmën ekonomike, si objekt i kontrolleve që DR SHSSH kryejnë, ku janë administruar marrëveshjet e lidhura nga 22 njësi të vetëqeverisjes vendore[21], nga ku ka rezultuar se:

- Vetëm 2 prej NJVV-ve, përkatësisht Bashkia Fier dhe Bashkia Mallakastër i kanë lidhur marrëveshjet bazuar në kuadrin ligjor aktualisht në fuqi; Bashkia Skrapar dhe Bashkia Skrapar nuk citojnë kuadrin ligjor mbi asistencën sociale, ndërsa 19 NJVV e kanë bazuar marrëveshjen në akte ligjore/ nënligjore të shfuqizuara, si Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 "*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*" dhe/ ose VKM-në nr. 787, datë 14.12.2005 "*Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike*";
- 3 NJVV kanë përcaktuar dispozitë në kundërshtim me Kreun II, pika 13, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", ku citohet se "*Pagesat e NE paguhen nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë bashkive/ njësive administrative ku ka vendbanimin përfituesi.* ***Bashkia merr masa që këto pagesa të merren të plota nga përfituesit dhe të mos tarifohen/ komisionohen***".

Përkatësisht:

a. Në nenin 4.1 të Akt-marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Pustec dhe Degës së Postës Shqiptare Korçë nr. 555, datë 10.10.2022, përcaktohet se "*Komisioni për arkëtimin e faturave të detyrimeve të taksave të bashkisë do të paguhet nga klienti sipas tarifave... konkretisht tarifa që do të aplikohet për çdo subjekt do të jetë* ***100 lek për të gjitha arkëtimet me vlerë deri në 20,000 lekë*** *dhe* ***0.5% e vlerës për të gjitha arkëtimet mbi 20,000 lekë***".

b. Në nenin 4.1.9 të Akt marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Korçë dhe Degës së Postës Shqiptare Korçë nr. 7015, datë 16.08.2022, përcaktohet se "*Posta përfiton të ardhurën prej* ***100 lek për pagesat e paaftësisë për invalidin, aftësisë së kufizuar dhe pagesës shtesë për paketë të veçantë higjieno-sanitare për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë*** *dhe* ***50 lek për pagesat e përfitimit të ndihmës ekonomike*** *për çdo pagesë të kryer e cila do të arkëtohet nga klienti*";

[21] Bashkitë: Dibër, Mat, Bulqizë, Klos, Divjakë, Fier, Lushnje, Mallakastër, Patos, Roskovec, Pustec, Maliq, Korçë, Kolonjë, Devoll, Pogradec, Delvinë, Sarandë, Himarë, Konispol, Selenicë, Skrapar.

c. Në nenin 2.3.e të Akt marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Kolonjë dhe Degës së Postës Shqiptare Ersekë (pa nr. prot., pa datë, citohet vetëm viti 2022), përcaktohet se "*Filiali Korçë Dega Posta Ersekë do të përfitojë nga kryerja e këtij shërbimi një komision në masën* ***50 lekë për çdo përfitues sipas listës***".

Në Akt marrëveshjet e tjera të administruara, përcaktohet se "*pas akt rakordimit, bashkia kryen xhirimin e shumës ____ (në përqindje në varësi të bashkive), të shumës së pagesave të kryera*", ku përqindja e përcaktuar që paguhet nga bashkia varion nga 0.4% (Bashkia Mat, Bashkia Devoll), deri në 1.5% (Bashkia Skrapar).

Pas konstatimit të këtyre rasteve, grupi i auditimit ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK, lidhur me konstatimet e kryera nga kontrollet në nivel qendror dhe rajonal për zbatimin e legjislacionit të pagesave për NE dhe PAK. Nga ana e SHSSH-së bëhet me dije se, për bashkitë Korçë, Pustec, Ersekë, Krujë, Kamëz, Rrogozhinë, Kavajë, Fushë Arrëz, Këlcyrë, Tepelenë, Gjirokastër, Memaliaj, Përmet, pra 13 nga 61 njësi të vetëqeverisjes vendore, **tarifa postare i është ngarkuar përfituesit të ndihmës ekonomike**, duke bërë që pagesat të mos merren të plota, ne kundërshtim me Kreun II, pika 13, të VKM-së nr. 597/2019, i ndryshuar.

Lidhur me aktivitetin kontrollues të Drejtorive Rajonale të SHSSH-së për këtë problematikë, nga ana e SHSSH-së është bërë me dije se:

- **Drejtoria Rajonale e SHSSH-së Durrës** e ka trajtuar këtë problematikë, ku nga ana e SHSSH-së është vënë në dispozicion raporti i kontrollit në Njësinë Nikël, Bashkia Krujë. Në Raportin e Kontrollit nr. 330/6 prot., datë 18.04.2025, është lënë detyra nr. 3 "*...Nga ana e Bashkisë Krujë të merren masa që pagesat e ndihmës ekonomike të merren të plota nga përfituesit dhe të mos tarifohen/ komisionohen*", detyrë e cila ishte lënë dhe më parë dhe ka rezultuar me status "*Pa përfunduar*".
- **Drejtoria Rajonale e SHSSH-së Shkodër** e ka trajtuar këtë problematikë, ku nga ana e SHSSH-së është vënë në dispozicion raportin e kontrollit në Njësinë Blerim, Bashkia Fushë-Arrëz. Në Raportin e Kontrollit nr. 383/2 prot., datë 23.06.2025 citohet se "*Nga ana e zyrës së financës në Nj.A. Blerim është proceduar në kundërshtim me VKM-në nr. 597, datë 04.04.2019, pasi në listëpagesa përfituesve të NE u mbahet tarifa postare nga 50 lekë*", duke lënë detyrat nr. 6 dhe 7 ku kërkohet lidhja e një Akt-marrëveshje nga Bashkia Fushë-Arrëz me Postën, si dhe mosmbajtja e tarifave postare nga përfituesit e NE por të paguhen nga fondet e njësisë, detyrë e cila ishte lënë dhe më parë dhe ka rezultuar me status "*Pa përfunduar*".
- **Drejtoria Rajonale e SHSSH-së Tiranë** e ka trajtuar këtë problematikë, duke vënë në dispozicion raportin e kontrollit në Bashkinë Kamëz. Në këtë material është përcaktuar te konkluzionet "*Akt-marrëveshja me Postën Shqiptare e vendosur në vitin 2014, nuk është përditësuar me ligjet dhe aktet nënligjore të miratuara pas këtij viti, e cila saktëson të gjitha detyrimet e lindura prej saj nga ana e të dyja palëve Bashki dhe Postës Shqiptare*". Në këtë raport nuk përmendet se aktualisht bashkia nuk po mbulon komisionet e pagesave për ndihmën ekonomike dhe se këto komisione po u faturohen përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike, në kundërshtim me Kreun II, pika 13, të VKM-së nr. 597/2019, i ndryshuar.
- **Drejtoria Rajonale e SHSSH-së Korçë**, për të cilën është vënë në dispozicion Raporti i Kontrollit nr. 1090/3 prot., datë 04.11.2022, në Njësinë Vendore Ersekë, rezulton të ketë konstatuar mungesën e një akt – marrëveshje të Bashkisë Kolonjë me Postën Shqiptare, por nuk rezulton të ketë lënë detyrë lidhjen e një akt – marrëveshjeje. Gjithashtu, në Raportin e Kontrollit nr. 205/4 prot., datë 26.09.2022, të kryer në Bashkinë Korçë, sërish nuk rezulton të jetë trajtuar problematika lidhur me ngarkimin e tarifave te përfituesit e NE dhe PAK. Në pikën 6.1 të këtij raporti "Kontratat me bankën/ postën", citohet "*nga ana e Bashkisë Korçë nuk disponohej akt marrëveshje me bankë*", por nuk përmendet asgjë në lidhje me marrëdhënien e Bashkisë Korçë me Postën. Përpos sa më sipër, nga ana e SHSSH-së nuk është vënë në dispozicion asnjë kontroll nga kjo Drejtori Rajonale në secilën prej NJVV-ve nën juridiksion,

ku të konstatohet e të trajtohet kjo problematikë, si dhe të lihen detyrat përkatëse për zbatimin e legjislacionit. As në Raportin e Kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës NE & PAK nr. 7064/4 prot., datë 26.11.2025, në DRSHSSH Korçë (të fundit të ushtruar në DRSHSSH Korçë), nuk rezulton të jetë evidentuar kjo parregullsi.

- **Drejtoria Rajonale e SHSSH-së Gjirokastër** nuk e ka trajtuar këtë çështje në raportet e kontrollit. As në Raportin e Kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës NE & PAK nr. 1573/3 prot., datë 31.03.2023 (të fundit të ushtruar në DRSHSSH Gjirokastër), nuk rezulton të jetë evidentuar kjo parregullsi.

Vërtetimi i hyrje-daljeve në Republikën e Shqipërisë

Pas rezultateve të Task-Forcës së vitit 2024, ku u konstatua se "*në njësitë afër zonave kufitare, shumë prej anëtarëve të familjeve në skemën e NE punojnë jashtë shtetit dhe nuk i deklarojnë të ardhurat nga puna informale dhe nga emigracioni*", nëpërmjet VKM-së nr. 855, datë 26.12.2024 u ndryshua VKM-ja nr. 597, datë 04.09.2019, duke shtuar në kreun I, pika 4.1, gërma f, detyrimin për familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë anëtarë madhorë, të paraqesin dy herë në vit vërtetimin për hyrje-dalje nga territori shqiptar, të lëshuar nga "*e-albania*". Duke qenë se ky dokumentacion administrohet vetëm fizikisht në bashkinë/ njësinë administrative ku kanë vendbanimin, administrimi i dokumentacionit kontrollohet vetëm nëpërmjet kontrolleve fizike nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së (ose DKP NE&PAK në kontrolle të ushtruara në NJVV).

Për të testuar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale lidhur me këtë detyrim të shtuar, grupi i auditimit i është referuar sërish 12 Raporteve të kontrollit të sipërcituara, të kryera nga DR SHSSH gjatë vitit 2025 (nga 1 për secilën DR SHSSH), ku u konstatua se:

- **Drejtoria Rajonale SHSSH Berat** - Në fq. 14 të Raportit janë pasqyruar rezultatet e verifikimit të dokumentacionit të administruar, ku nga 24 dosje të kontrolluara, vetëm në 7 prej tyre administrohej vërtetimi i lëshuar nga "*e-albania*" për hyrje-daljet nga territori shqiptar për të gjithë anëtarët madhorë të familjeve përfituese.
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Dibër** - Në pikën 2 "*kontrolli i dokumentacionit të administratorit të familjeve në nevojë dhe kategorive të veçanta*", rezulton se grupi i kontrollit ka verifikuar dokumentacionin fizik në dosje, si ID, certifikata familjare, formular aplikimi, vlerësim social-ekonomik dhe deklaratat 3-mujore, por nuk ka verifikuar administrimin fizik të vërtetimit të lëshuar nga portali "*e-albania*" për hyrje-daljet nga territori shqiptar të të gjithë personave madhorë në familje, sipas përcaktimit në Kreun I, pika 4.1, gërma f, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar.
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Durrës** - Në fq. 3 të Raportit citohet se "*ndodheshin vërtetimet për hyrje-daljet nga territori shqiptar të të gjithë anëtarëve madhorë, të lëshuar nga portali "e-albania"*".
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Elbasan** - Nga fq. 6-8 të Raportit pasqyrohet se nga 13 dosje të verifikuara, vetëm në 1 dosje administrohej vërtetimi i lëshuar nga portali "*e-albania*" për hyrje-daljet nga territori shqiptar të të gjithë personave madhorë në familje, sipas përcaktimit në Kreun I, pika 4.1, gërma f, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar.
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Fier** - Nga 15 dosje të kontrolluara, në asnjë prej tyre nuk administrohej vërtetimi i lëshuar nga portali "*e-albania*" për hyrje-daljet nga territori shqiptar të të gjithë personave madhorë në familje, sipas përcaktimit në Kreun I, pika 4.1, gërma f, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar.
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Gjirokastër** - Nga 8 dosje të familjeve përfituese nga skema e NE, citohet se "*ka përgjigje dhe dokumentacion për 2 familje, nuk rezultoi me dokumentacion 1 familje. Nga përgjigja e datës 19.03.2025 për familjen M.D. anëtari figuron i larguar jashtë vendit në datën 17.03.2025. Nuk rezulton të jetë marrë një përgjigje e dytë për anëtarin nëse ka hyrje ose dalje të reja*".

- **Drejtoria Rajonale SHSSH Korçë** - Në fq. 4 të raportit citohet se "*Dosjet e aplikuesve nuk ishin plotësuar me vërtetim të hyrje-daljeve nga territori shqiptar*", në kundërshtim me Kreun I, pika 4.1, gërma f, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar.
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Kukës** - Në pikën 2 "*kontrolli i dokumentacionit të administratorit të familjeve në nevojë dhe kategorive të veçanta*", citohet se janë kontrolluar me përzgjedhje 25% e dosjeve të familjeve përfituese të NE, ku është verifikuar administrimi i certifikatës familjare, deklaratave 3-mujore, ID dhe vizitave në shtëpi, por nuk është kontrolluar administrimi i vërtetimit të lëshuar nga portali "*e-albania*" për hyrje-daljet nga territori shqiptar të të gjithë personave madhorë në familje, sipas përcaktimit në Kreun I, pika 4.1, gërma f, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar.
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Lezhë** - Në pikën 2 "*kontrolli i dokumentacionit të administratorit të familjeve në nevojë dhe kategorive të veçanta*", trajtohen verifikimet e kryera sa i përket dokumentacionit të përfituesve të NE, por në asnjë rast nuk citohen verifikimet e kryera mbi administrimin e vërtetimit të lëshuar nga portali "*e-albania*" për hyrje-daljet nga territori shqiptar të të gjithë personave madhorë në familje, sipas përcaktimit në Kreun I, pika 4.1, gërma f, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar.
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Shkodër** - Në pikën 2 "*kontrolli i dokumentacionit të administratorit të familjeve në nevojë dhe kategorive të veçanta*", në Raport citohet se pasi u krye kontrolli i dokumentacionit për 44 aplikues, rezultoi se "*disa nga dosjet e familjeve përfituese në skemën e NE ishin plotësuar me vërtetimin e hyrje-daljeve nga territori shqiptar, të lëshuar nga portali "e-albania". Nga verifikimi i këtij dokumentacioni rezultojnë problematika që e bëjnë të pamundur kontrollin e lëvizjeve. Ka raste që ka vetëm hyrje ose vetëm dalje, raste me një dalje dhe disa hyrje, ose anasjelltas*".
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë** - Në pikën "*kontroll i dokumentacionit të administratorit të familjeve në nevojë dhe kategorive të veçanta*" nuk është dokumentuar kontrolli i administrimit të vërtetimit të lëshuar nga portali "*e-albania*" për hyrje-daljet nga territori shqiptar të të gjithë personave madhorë në familje, sipas përcaktimit në Kreun I, pika 4.1, gërma f, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar.
- **Drejtoria Rajonale SHSSH Vlorë** – Në pikën "*kontroll i dokumentacionit të administratorit të familjeve në nevojë dhe kategorive të veçanta*" citohet se "*në dosje nuk u gjetën vërtetimet nga e-albania për hyrje-daljet nga territori i Shqipërisë për anëtarët e familjeve*".

Nga shqyrtimi i raporteve të kontrollit të Drejtorive Rajonale të SHSSH-së rezulton se, megjithëse detyrimi për administrimin periodik të vërtetimit të hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë është shtuar në kuadrin nënligjor me ndryshimet e VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, si masë korrigjuese pas problematikave të evidentuara nga Task-Forca e vitit 2024, me qëllim minimizimin e riskut të përfshirjes në skemën e ndihmës ekonomike të personave që gjenerojnë të ardhura të padeklaruara jashtë vendit, në praktikë ky detyrim nuk rezulton të jetë zbatuar në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme. Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve dokumentacioni nuk është administruar i plotë nga administratorët shoqërorë, ndërsa në raste të tjera nuk rezulton të jetë përfshirë në objektin e kontrolleve të ushtruara nga Drejtoritë Rajonale, duke kufizuar efektivitetin e verifikimeve mbi deklarimet e përfituesve. Gjithashtu, janë konstatuar raste kur vetë dokumentacioni i administruar nuk ka qenë i mjaftueshëm për të mundësuar një kontroll të plotë të lëvizjeve (si në DR SHSSH Shkodër), çka tregon edhe mungesë qartësie në mënyrën e trajtimit dhe interpretimit të këtij detyrimi në praktikë. Në këto kushte, shtimi i kërkesës në aktin nënligjor nuk rezulton të jetë shoqëruar me mekanizma kontrolli efektivë për të garantuar zbatimin e saj në praktikë.

Verifikimi i pagesave për kompensimin e energjisë elektrike

Në nenin 9, gërma j, të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*", përcaktohet se Drejtoritë Rajonale ushtrojnë kontroll për zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike, ndër të tjera mbi dokumentacionin dhe pagesat e kompensimit të energjisë elektrike për familjet përfituese të skemës së ndihmës ekonomike. Nga Raportet e paraqitura, rezulton se grupet e kontrollit e konsiderojnë të kryer kontrollin duke verifikuar në dosjet e administruara nga bashkitë/ njësitë administrative të (i) kontratave të furnizimit me energji elektrike dhe (ii) kopje të librezave të vulosura, për të konkluduar se është realizuar trajtimi me kompensim energjie elektrike. Sistemet e SHSSH-së nuk kanë ndërlidhje me sistemin e OSHEE dhe nga ana e SHSSH-së nuk ka asnjë korrespondencë me OSHEE për të verifikuar se pagesat e kryera për kompensimin e energjisë elektrike për përfituesit janë administruar nga OSHEE dhe pasqyrohen në sistemin e tyre.
Në këto kushte, mbështetja e kontrollit vetëm në verifikimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike dhe të kopjeve të librezave të vulosura nuk ofron një nivel të mjaftueshëm sigurie mbi realizimin efektiv të pagesave të kompensimit të energjisë elektrike, pasi këto përbëjnë evidencë dokumentare mbështetëse dhe jo burim primar verifikimi, duke reduktuar efektivitetin e kontrollit të ushtruar nga SHSSH-ja për garantimin e zbatimit të plotë të kërkesave të legjislacionit të asistencës sociale në këtë drejtim.

Aktiviteti lidhur me nxitjen e punësimit dhe daljen nga skema e NE
Nëpërmjet VKM-së nr. 882, datë 24.12.2019, është miratuar mekanizmi i bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, veprimtaria e të cilit koordinohet e realizohet në nivel qendror dhe përmes autoriteteve përgjegjëse për çështjet e aftësimit, punësimit dhe ato sociale në nivel rajonal e vendor.
Në Kreun II, pika 1, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 "*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike*", përcaktohet se administratori shoqëror ndër të tjera i informon familjet dhe individët e identifikuar në nevojë për regjistrimin si punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës, si dhe anëtarët madhorë në moshë aktive pune të familjeve në nevojë, që jetojnë në fshat, të cilët kanë firmosur vetëdeklarimin se janë të gatshëm për punë pranë zyrave përkatëse të punës. Në pikën 11 të këtij Kreu përcaktohet se përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë 6-mujore, familjet të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:
"*dh. Refuzojnë përfshirjen në kushtet e formimit profesional për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së NE, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;*
e. kanë anëtarë në moshë aktive pune të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/ përdorim dhe banojnë në fshat.
ë. Anëtarët në moshë aktive pune, të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të familjeve që kanë anëtarë, që ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë, por jo më shumë se deri në moshën 25 vjeç".
Mekanizmi i referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune, përfitues të skemës së NE dhe aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar strukturat e ngarkuara për zbatimin e aktiviteteve të mekanizmit, është miratuar ndër vite me Urdhrat e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë përgjegjëse për ekonominë, si më poshtë:
Nëpërmjet Urdhrit të përbashkët të MSHMS-së dhe MFE-së nr. 52, datë 26.01.2022;

Nëpërmjet Urdhrit të përbashkët të MSHMS-së dhe MFE-së nr. 85, datë 15.02.2023;
Nëpërmjet Urdhrit të përbashkët të MSHMS-së dhe MEKI-t nr. 130, datë 05.03.2024.
Për vitin 2023, është realizuar ndërveprimi i sistemeve me sistemin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), për të marrë të dhëna në çdo verifikim automatik mbi regjistrimin e individëve si punëkërkues të papunë në sistemin e AKPA-s. Gjatë kësaj periudhe, janë punësuar/ në proces ndërmjetësimi 3,313 individë të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike dhe janë adresuar për formim profesional 842 anëtarë në moshë aktive pune. Për personat me aftësi të kufizuar janë punësuar/ proces ndërmjetësimi 306 individë dhe janë adresuar për formim profesional 119 individë.
Për vitin 2024, rezulton se janë referuar te zyrat e punës 5,844 anëtarë në moshë aktive pune, nga të ilët janë punësuar 2,211 individë të familjeve përfituese, 609 të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit dhe adresuar për formim profesional 609 anëtarë në moshë aktive pune. Janë larguar nga skema e NE-së 271 familje, anëtarët e të cilëve kanë refuzuar 3 oferta për punësim. Për 1,257 familje, komisionet kanë marrë vendim se duhet të vijojnë të qëndrojnë në skemë bazuar në kushtet social-ekonomike ose shëndetësore dhe problematika të ndryshme të cilat nuk i lejojnë të punësohen, si dhe 656 familje në shqyrtim të dhënies së ofertave për punësim. Për personat me aftësi të kufizuar janë referuar te zyrat e punës 5,901 individë si kategori PAK në moshë aktive pune, nga të cilët janë punësuar/ proces ndërmjetësimi 328 individë dhe adresuar për formim profesional 143 individë.
Për vitin 2025, rezulton se janë referuar në zyrat e punës 1,569 anëtarë në moshë aktive pune, nga të cilët janë punësuar 409 individë të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike dhe janë adresuar për formim profesional 214 anëtarë në moshë aktive pune. Gjatë vitit 2025, për personat me aftësi të kufizuar janë referuar te zyrat e punës 177 individë si kategori PAK në moshë aktive pune, nga të cilët janë punësuar 51 individë dhe janë adresuar për formim profesional 13 individë.

Në Kreun I, pika 3, përcaktohet se ndihma ekonomike për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, e cila kufizohet në kohë **për një periudhë jo më shumë se 5 vjet**. Nga auditimi u konstatua se periudha 5-vjeçare e përcaktuar në këtë dispozitë duhet të jetë e pandërprerë për t'u aplikuar, pra në rast se individi ka dalë nga skema e NE-së dhe riaplikon, sistemi e identifikon si aplikim të ri/ përfitues i ri dhe numërimi fillon nga fillimi, duke mos mundësuar verifikimin nga SHSSH-ja të rasteve që kanë ezauruar periudhën 5-vjeçare të përfitimit dhe duke shmangur në këtë mënyrë aplikimin e këtij filtri.

Masat e lëna në përfundim të kontrolleve të kryera dhe zbatimi i tyre
Në pikën 17 të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021, përcaktohet se në raportin përfundimtar të kontrollit evidentohen propozimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe masat për personat përgjegjës, ku ndër të tjera përfshihen (i) masat disiplinore për shkelje të evidentuara, (ii) masa administrative gjobë nga 50,000 lekë deri në 100,000 lekë, në rastet kur vërehet që shkeljet janë kryer në mënyrë të përsëritur, (iii) shpërblimi i dëmit nga administratori shoqëror dhe/ ose familja dhe/ ose punonjësi i strukturës rajonale të SHSSH-së dhe/ ose mjeku i familjes/ specialist, nëse konstatohet se është shkaktuar dëm ekonomik.
Masat disiplinore, masat administrative gjobë dhe masat shpërblim dëmi të lëna nga kontrollet e DKP NE&PAK dhe Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së, si dhe ecuria e zbatimit të tyre, paraqiten, si më poshtë:

Drejtoritë Rajonale	Numri i masave shpërblim dëmi	Vlera	Struktura e ngarkuar	Arkëtuar	M. disipl. të propozuara	Ekzek.	M. adm. gjobë	Ekzek.

DKNE	16	7,103,904	Admin. shoq, familje, specialistë, strukturë rajonale	341,984	10	0	6	1
DKPAK	13	6,965,000	Mjekë, pun. socialë, specialistë, përgjegjës	1,784,891	26	0	0	0
Tiranë	12	2,192,316	Admin. shoq	117,034	4	0	0	0
Elbasan	128	9,152,887	Admin. shoq, familje, individë	3,848,180	15	2	4	0
Fier	21	1,691,926	Admin. shoq	429,312	2	1	0	0
Lezhë	44	3,709,141	Familje, individë	2,648,138	3	0	1	0
Dibër	74	1,564,175	Familje	67,248	47	0	6	0
Korçë	45	3,246,262	Admin. shoq, familje, individë	1,719,098	5	1	0	0
Vlorë	59	5,058,200	Admin. shoq	2,098,988	18	1	0	0
Shkodër	123	41,464,551	Admin. shoq, familje, financë	7,180,140	63	1	40	0
Berat	13	4,141,293	Familje, Admin. shoq	3,273,669	9	2	5	0
Kukës	64	8,754,836	Admin. shoq, familje, individë	2,728,648	5	0	0	0
Gjirokastër	74	11,259,095	Admin. shoq, financë	1,634,306	17	0	1	0
Durrës	60	13,626,936	Admin. shoq, familje, individë	7,449,888	8	0	1	0
Totali	**746**	**119,930,022**		**35,321,524**	**232**	**8**	**64**	**1**

Për sa më sipër, pavarësisht aktivitetit kontrollues të ushtruar nga SHSSH-ja, rezultatet në drejtim të zbatimit të masave korrektuese rezultojnë të kufizuara. Niveli i arkëtimit të dëmit ekonomik të konstatuar mbetet rreth 30% në total, ndërsa zbatimi i masave disiplinore nga NJVV-të ndaj administratorëve shoqërorë paraqitet shumë i ulët, nga 232 masa disiplinore të propozuara, vetëm 8 masa disiplinore janë ekzekutuar (rreth 3.4%). Edhe në drejtim të zbatimit të masave administrative me gjobë evidentohet një nivel minimal ekzekutimi, ku nga 64 masa të vendosura, vetëm 1 masë rezulton e zbatuar. Këta tregues sugjerojnë se, pavarësisht identifikimit të parregullsive gjatë kontrolleve të ushtruara, efektiviteti i masave të ndërmarra për adresimin dhe korrigjimin e tyre paraqitet i kufizuar.

Në lidhje me dëmet ekonomike të konstatuara nga kontrollet e ushtruara nga SHSSH, në pikën 3.3.6, gërma d, të Shtojcës 1 të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*" përcaktohet se, nëse dëmi i shkaktuar i përket vitit aktual, atëherë zhdëmtimi i dëmit bëhet nëpërmjet kthimit të tij në llogarinë nr. 606 (financa e njësisë së kontrolluar nëpërmjet një memo-kredie i kërkon thesarit të rikthejë shumën në llogarinë 606). Nëse dëmi i shkaktuar u përket viteve të mëparshme, atëherë shuma e zhdëmtuar kthehet në llogarinë "Të ardhura nga buxheti i shtetit" (financa e njësisë së kontrolluar nëpërmjet urdhërpagesës i kërkon thesarit të kalojë te "Të ardhura në buxhetin e shtetit" shumën e përfituar padrejtësisht në vitet e mëparshme).

Këto detyrime nuk pasqyrohen në librat kontabël të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, duke mos mundësuar evidentimin analitik të tyre, ndjekjen sistematike të detyrimeve, si dhe verifikimin në çdo kohë të shumës së mbetur për arkëtim. Sipas informacionit të marrë gjatë auditimit, kontabilizimet përkatëse për këto masa kryhen nga vetë bashkitë, por këto praktika kanë qenë jashtë fushës së objektit të auditimit. Në mungesë të një evidence të plotë dhe të unifikuar kontabël, nuk mund të sigurohet gjurmueshmëria e plotë e detyrimeve, duke pamundësuar ofrimin e garancisë së arsyeshme mbi kthimin e shumave të konstatuara si dëm ekonomik.

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara dhe të referuara në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit ngarkohen me përgjegjësi:
1. *Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror*, për mosmarrjen e masave për indeksimin e masës së ndihmës ekonomike për vitet 2023-2025, si dhe për parregullsitë e konstatuara në veprimet dhe mosveprimet e strukturave qendrore dhe rajonale në varësi.
2. *Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave NE & PAK*, për (i) mosevidentimin e problematikave në formularin e aplikimit sa i përket deklarimit të automjeteve, (ii) mosevidentimin e problematikave në sistem lidhur me rezultatet e mospërputhjeve për t'u trajtuar manualisht, (iii) mungesën e raportimit të problematikave për të gjetur zgjidhje lidhur me pamundësinë e kontrollit të plotë nga Drejtoritë Rajonale për tërheqjen e pagesave nga personat e autorizuar me ligj dhe brenda afateve.
3. *Drejtorët e Drejtorive Rajonale të SHSSH*-së (sipas rasteve të konstatimeve përkatëse të trajtuara), për (i) mosrealizimin të plotë të kontrolleve të planifikuara dhe të verifikimeve social-ekonomike për përfituesit për herë të parë, (ii) mungesën e evidentimit të aplikimit të komisioneve/ tarifave postare te përfituesit e ndihmës ekonomike në disa bashki, (iii) moskryerjen e plotë të kontrolleve për tërheqjen e pagesave për të garantuar se janë tërhequr nga personat e autorizuar me ligj dhe brenda afatit (me përjashtim të rasteve kur pamundësia për të kryer këtë kontroll dhe shkaku i pamundësisë është referuar në Raportet e kontrollit), (iv) mospërfshirjen e kontrollit të dokumentacionit vërtetim hyrje-dalje në kontrollet e ushtruara përgjatë vitit 2025.

Lidhur me sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK pranë Shërbimit Social Shtetëror ka paraqitur observacionet, si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: 1. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Shërbimi Social Shtetëror ka paraqitur pranë MSHMS propozime për përmirësimin e procedurave të aplikimit për ndihmën ekonomike, të reflektuara në VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019, përfshirë edhe përmirësime në Formularin e Aplikimit të evidentuara gjatë fazës së pilotimit. Sa i përket seksionit "Asete familjare", elementët përbërës të këtij seksioni ndikojnë drejtpërdrejt në koeficientët dhe ndryshoret e përdorura nga formula e unifikuar e pikëzimit për vlerësimin e pranueshmërisë dhe gjendjes ekonomike të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, ndaj ndryshimi i tyre kërkon një vlerësim që nuk mund të kryhet nga Shërbimi Social Shtetëror. Gjithashtu, plotësimi i formularit me elementë që mundësojnë deklarimin e numrit të mjeteve motorike në pronësi të anëtarëve të familjes nuk vlerësohet i nevojshëm, pasi formulari aktual parashikon deklarimin e ekzistencës së mjetit motorik dhe jo numrin e tyre. Sipas subjektit, posedimi i më shumë se një mjeti motorik përbën element që ndikon në vlerësimin e statusit të familjes në nevojë dhe identifikohet nëpërmjet proceseve të verifikimit automatik me bazat shtetërore të të dhënave. Për rrjedhojë, familjet që rezultojnë me më shumë se një mjet motorik në pronësi refuzohen nga skema e ndihmës ekonomike jo për shkak të mosdeklarimit të numrit të mjeteve, por për shkak se nuk plotësojnë kriterin e familjes në nevojë.
2. Lidhur me indeksimin e masës së ndihmës ekonomike, mungesa e një vlere standarde referuese dhe e një metodologjie të miratuar për përcaktimin e indeksimit sipas strukturës së familjes ka krijuar vështirësi në zbatimin e një formule të unifikuar indeksimi. Kjo problematikë është adresuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që në vitin 2022, përmes shkresës nr. 88 prot., datë 14.01.2022. Gjithashtu, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 ka parashikuar ndërtimin e një mekanizmi të qëndrueshëm për rishikimin periodik dhe indeksimin e masës së ndihmës ekonomike si një nga aktivitetet prioritare të ministrisë përgjegjëse. Megjithëse legjislacioni parashikon që indeksimi kryhet nga Shërbimi Social Shtetëror, ky përcaktim lidhet vetëm me kompetencat zbatuese dhe administrative të institucionit, ndërsa kompetenca për përcaktimin dhe miratimin e mënyrës së indeksimit, masës së përfitimit, efekteve financiare dhe fondit përkatës buxhetor i përket organeve përgjegjëse për hartimin e politikave dhe akteve përkatëse. Për rrjedhojë, subjekti pretendon se realizimi i indeksimit kushtëzohet nga miratimi paraprak i një akti, metodologjie ose mekanizmi përkatës nga autoritetet kompetente, pas të cilit SHSSH do të vijojë me zbatimin dhe llogaritjen e masës së ndihmës ekonomike për familjet përfituese.
3. Procedura e kryerjes së verifikimeve social-ekonomike në banesë, si dhe numri minimal dhe afatet e vizitave, janë të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi. Konkretisht, sipas VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, kryhen vizita fillestare dhe vizita periodike çdo 6 muaj për familjet përfituese të ndihmës ekonomike. Gjithashtu, sipas VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021, strukturat e kontrollit duhet të verifikojnë jo më pak se 25% të familjeve përfituese nëpërmjet kontrollit të dosjeve dhe vizitave në banesë e terren, duke përfshirë në mënyrë prioritare familjet e

larguara për deklarim të rremë dhe të ripranuara në skemë, familjet ndaj të cilave nuk janë kryer vizita në banesë, si dhe raste të tjera të vlerësuara me risk. Subjekti argumenton se, krahas këtyre kërkesave ligjore, janë dhënë udhëzime të vazhdueshme për rritjen e numrit të verifikimeve në terren dhe për orientimin e tyre sipas analizës së riskut, ndërsa mangësitë e konstatuara lidhen kryesisht me faktorë objektivë, si numri i lartë i përfituesve, mungesa e logjistikës dhe terreni i vështirë.

4. Detyrimi për kryerjen e verifikimeve social-ekonomike në banesë për familjet që aplikojnë për herë të parë është tashmë i parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht në VKM-në nr. 855, datë 26.12.2024, e cila ka përcaktuar Drejtoritë Rajonale si strukturat përgjegjëse për kryerjen e këtyre verifikimeve. Risia e këtij akti lidhet vetëm me subjektin që kryen verifikimin, ndërsa procedura, dokumentacioni dhe koncepti i kryerjes së vizitave në banesë kanë qenë të përcaktuara më parë në VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019. Afatet për kryerjen e verifikimeve mund të nxirren nga interpretimi i integruar i dispozitave të VKM-së nr. 597/2019, sipas të cilave administratori shoqëror kryen verifikimet brenda 20 ditëve të muajit të aplikimit, ndërsa Drejtoria Rajonale duhet të realizojë verifikimin dhe të marrë vendimin përfundimtar brenda të njëjtit muaj. Lidhur me mekanizmat e monitorimit, ekzistojnë mekanizma të konsoliduar kontrolli dhe raportimi, pasi Drejtoritë Rajonale raportojnë periodikisht pranë Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave për NE&PAK mbi numrin e kontrolleve dhe verifikimeve të kryera, përfshirë verifikimet për familjet që aplikojnë për herë të parë, si dhe mbi rastet e evidentuara me shkelje apo mospërputhje me kriteret e përfitimit. Gjithashtu, monitorimi realizohet edhe nëpërmjet kontrolleve tematike dhe të plota të ushtruara nga Drejtoritë Rajonale, ku verifikimet në banesë dhe dokumentimi i tyre përbëjnë një nga elementët kryesorë të kontrollit.

5. Përfshirja e vërtetimit të hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë në kuadrin nënligjor ka ardhur si rezultat i problematikave të evidentuara nga Task Forca gjatë vitit 2024 dhe përbën një mekanizëm konkret kontrolli për verifikimin e përmbushjes së kritereve të përfitimit të ndihmës ekonomike. Ky mekanizëm është zbatuar në praktikë nëpërmjet administrimit të dokumentacionit përkatës në dosjet e përfituesve dhe verifikimeve rast pas rasti nga strukturat përgjegjëse. Mosadministrimi i vërtetimit të hyrje-daljeve në raste të veçanta lidhet me faktorë objektivë, si pamundësia teknike për aksesimin e dokumentit, mungesa e mjeteve teknologjike nga qytetarët dhe vështirësi të tjera administrative dhe jo me mungesën e mekanizmave kontrollues nga ana e SHSSH-së. Gjithashtu, mungesa e këtij dokumenti në dosje nuk përbën automatikisht shkak për përjashtim nga skema e ndihmës ekonomike, ndërsa problematikat e evidentuara gjatë kontrolleve janë adresuar përmes lënies së detyrave dhe masave konkrete në raportet e kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave për NE&PAK. Vërtetimi i hyrje-daljeve përbën një mekanizëm të ri për legjislacionin dhe praktikën administrative shqiptare, i cili kërkon kohë për t'u konsoliduar dhe zbatuar plotësisht. Për rrjedhojë, pengesat e konstatuara në zbatimin e tij lidhen me faktorë të jashtëm dhe jo me mangësi të mekanizmave të kontrollit të ngritur nga Shërbimi Social Shtetëror.

6. Lidhur me planifikimin dhe realizimin e kontrolleve periodike në njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjekti argumenton se Drejtoritë Rajonale veprojnë në përputhje me VKM-në nr. 257, datë 05.05.2021, sipas së cilës kontrollet bazohen në plane vjetore dhe programe mujore kontrolli, ndërsa kontrollet e plota duhet të kryhen një herë në dy vjet në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Sipas subjektit, mosrealizimi i plotë i kontrolleve brenda afateve të planifikuara ka ardhur për arsye objektive, si pandemia COVID-19, angazhimi në task-forca apo kontrolle të paplanifikuara të bazuara në risk, ndërsa kontrollet e papërfunduara janë planifikuar dhe realizuar në periudhat pasuese. Gjithashtu, në raste të veçanta, mungesa e kontrolleve lidhet me faktin se në disa njësi administrative nuk ka pasur familje apo individë përfitues nga skema e ndihmës ekonomike gjatë periudhës objekt auditimi.

7. Ndërveprimi i sistemit të ndihmës ekonomike me Regjistrin e Gjendjes Civile është funksional dhe mundëson identifikimin në kohë reale të ndryshimeve në përbërjen familjare. Aplikimet në emër të personave që kanë ndërruar jetë nuk mund të ndodhin në praktikë, pasi legjislacioni kërkon praninë fizike të anëtarëve madhorë të familjes gjatë aplikimit. Mospërputhjet e evidentuara me të dhënat e gjendjes civile lidhen kryesisht me diferencat kohore ndërmjet regjistrimit të ndryshimeve dhe deklarimeve periodike të familjeve dhe nuk përbëjnë domosdoshmërisht deklarime të rreme. Gjithashtu, sistemi bazohet në parimin e vetëdeklarimit, ndaj administratorët shoqërorë kanë detyrimin të regjistrojnë çdo aplikim të paraqitur, ndërsa saktësia e të dhënave verifikohet më pas nëpërmjet mekanizmave automatikë dhe manualë të kontrollit. Për rrjedhojë, aplikimet nuk mund të refuzohen paraprakisht për shkak të dyshimeve mbi pasaktësinë e të dhënave të deklaruara.

Qëndrimi i grupit të auditimit: 1. Rekomandimi synon që Shërbimi Social Shtetëror, në përputhje me rolin dhe eksperiencën e tij institucionale, të analizojë problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të skemës dhe të propozojë pranë ministrisë përgjegjëse ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e formularit dhe mekanizmave të vlerësimit të përfitueshmërisë. Indikatorët që ndikojnë në formulën e pikëzimit dhe që pasqyrohen në formularin e aplikimit duhet t'i nënshtrohen rishikimeve periodike, me qëllim përshtatjen e tyre me zhvillimet socio-ekonomike dhe realitetin aktual të familjeve shqiptare, duke mbledhur informacion mbi asetet që përbëjnë tregues realë të gjendjes social-ekonomike të familjeve dhe jo mbi elementë që praktikisht kanë dalë nga përdorimi ose kanë humbur vlerën e tyre në vlerësimin e mirëqenies, si televizorët pa ngjyra, magnetofonët, CD-player-at dhe pajisje të tjera të ngjashme. Grupi i auditimit vlerëson se, për shkak të rolit të tij zbatues, monitorues dhe

kontrollues, si dhe për shkak të kontaktit të vazhdueshëm që strukturat qendrore dhe rajonale të SHSSH kanë me përfituesit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të skemës, ky institucion nuk ka vetëm rol ekzekutiv, por edhe detyrimin për të propozuar përmirësime të sistemit. Kjo përgjegjësi gjen mbështetje edhe në Statutin e Shërbimit Social Shtetëror, ku përcaktohet se SHSSH "*propozon përmirësimin e programeve dhe të politikave në fushën e ndihmës ekonomike për vlerësim pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale*". Lidhur me trajtimin e mjeteve motorike, grupi i auditimit konstaton se formulari i aplikimit aktual mbështetet në një përgjigje të tipit "po/jo" për disponimin e mjetit motorik, ndërkohë që numri i mjeteve në pronësi identifikohet në një fazë të mëvonshme përmes verifikimeve automatike dhe trajtohet manualisht nga Drejtoritë Rajonale. Në kushtet kur formula e pikëzimit dhe pesha e indikatorëve të përdorur nuk janë publike, nuk mund të verifikohet nëse vlerësimi i përfitueshmërisë kryhet bazuar vetëm në deklarimin e ekzistencës së një mjeti motorik apo në numrin real të mjeteve të identifikuara gjatë verifikimeve. Për këtë arsye, rekomandimi për pasurimin e informacionit të mbledhur në formular mbetet i vlefshëm dhe synon rritjen e saktësisë së vlerësimit të gjendjes ekonomike të familjeve dhe efektivitetit të shënjestrimit të skemës së ndihmës ekonomike.

2. Grupi i auditimit ka evidentuar gjithashtu mosnxjerrjen nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të një udhëzimi të ri në zbatim të Ligjit nr. 57/2019 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Korrespondencat e bashkëlidhura i përkasin vitit 2022 dhe nuk mbështesin pretendimin se Shërbimi Social Shtetëror është përjashtuar nga detyrimi për kryerjen e indeksimit. Përkundrazi, nga komunikimi elektronik i zhvilluar në atë periudhë, ku kanë qenë pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rezulton se SHSSH është orientuar të vijojë t'i referohet Udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017 "Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike", i ndryshuar. Në këtë komunikim nuk rezulton që SHSSH të jetë instruktuar të mos kryejë indeksimin e masës së ndihmës ekonomike, si dhe nuk është vënë në dispozicion asnjë korrespondencë e mëtejshme që të qartësojë ose ndryshojë këtë qëndrim. Referimi në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 për ndërtimin e një mekanizmi të qëndrueshëm të rishikimit periodik dhe indeksimit të masës së ndihmës ekonomike përbën një objektiv strategjik për përmirësimin e kuadrit ekzistues dhe nuk mund të interpretohet si pezullim apo moszbatim i detyrimeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Deri në momentin e ndryshimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor, mbetet në fuqi përcaktimi ligjor sipas të cilit **masa e ndihmës ekonomike indeksohet në përputhje me masën e indeksimit të pensionit social**. Nga auditimi rezultoi se ky indeksim nuk është kryer, pavarësisht ndryshimeve të njëpasnjëshme të pensionit social gjatë periudhës së auditimit. Për rrjedhojë, argumentet e paraqitura nga subjekti nuk ndryshojnë thelbin e konstatimit të grupit të auditimit. *Pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë.*

3. Përcaktimi i referuar nga subjekti lidhur me kryerjen e vizitave fillestare dhe vizitave periodike çdo 6 muaj për familjet përfituese të ndihmës ekonomike përbën detyrim të administratorëve shoqërorë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore dhe jo një mekanizëm kontrolli të ushtruar nga strukturat e Shërbimit Social Shtetëror. Për më tepër, si nga raportet e vetë Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave për NE&PAK, ashtu edhe nga testimet e kryera nga grupi i auditimit, është konstatuar se ky periodicitet nuk zbatohet në mënyrë të qëndrueshme nga administratorët shoqërorë. Gjithashtu, përcaktimi i VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021, sipas të cilit strukturat e kontrollit duhet të verifikojnë jo më pak se 25% të familjeve përfituese nëpërmjet kontrollit të dosjeve dhe vizitave në shtëpi e terren, nuk përcakton një nivel minimal të verifikimeve që duhet të kryhen domosdo fizikisht në terren. Në këto kushte, kërkesa formalisht mund të konsiderohet e përmbushur edhe në rastet kur verifikimet realizohen kryesisht ose tërësisht nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit, pa garantuar verifikimin faktik të gjendjes social-ekonomike të familjeve. Nga analiza e të dhënave të administruara nga grupi i auditimit rezulton gjithashtu një diferencim i ndjeshëm ndërmjet rajoneve sa i përket numrit dhe mbulimit të vizitave në terren, çka tregon mungesën e një qasjeje të unifikuar dhe të orientuar nga risku në nivel kombëtar. Në këtë drejtim, Task Forca e vitit 2024 përbën një shembull konkret të rëndësisë së verifikimeve në terren si mekanizmi më efektiv për vlerësimin e gjendjes reale social-ekonomike të familjeve përfituese dhe identifikimin e rasteve të përfshirjes në skemë të individëve ose familjeve që nuk plotësojnë kushtet e nevojshme për përfitim. **Task Forca nuk ka ushtruar kompetenca apo procedura jashtë kuadrit ligjor në fuqi, por ka kryer verifikime dhe kontrolle që janë pjesë e funksioneve të kontrollit të ngarkuara ligjërisht strukturave të Shërbimit Social Shtetëror**. Rezultatet e saj nuk duhet të vlerësohen vetëm për efektin pozitiv të identifikimit të rasteve të përfitimit të padrejtë, **por edhe si një tregues i cedimit të mekanizmave ekzistues të kontrollit, nga Shërbimi Social Shtetëror, nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK dhe Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së, deri në momentin e ndërhyrjes së saj**. Fakti që gjatë këtyre verifikimeve u evidentuan nivele të konsiderueshme të përfitimit të padrejtë në skemë, që në disa qarqe arritën pothuajse 10% të rasteve të kontrolluara, tregon se mekanizmat e zakonshëm të kontrollit nuk kishin garantuar në mënyrë efektive kontrollin dhe identifikimin në kohë të rasteve të mospërputhjes me kriteret ligjore të përfitimit. Pikërisht për këtë arsye, rekomandimi synon hartimin e një plani vjetor të strukturuar verifikimesh, të bazuar në analizë risku, me objektiva minimale të qarta për mbulimin në terren dhe shpërndarje të njëtrajtshme ndërmjet rajoneve, me qëllim forcimin e kontrollit dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike. *Pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë*.

4. Pavarësisht ndryshimeve të fundit në kuadrin ligjor, aktiviteteve trajnuese të organizuara për njohjen e strukturave me kërkesat e reja ligjore, si dhe mekanizmave të raportimit dhe monitorimit të referuar nga subjekti, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga vetë Shërbimi Social Shtetëror rezulton se disa Drejtori Rajonale nuk kanë përmbushur detyrimin për kryerjen e verifikimeve social-ekonomike në terren për familjet që aplikojnë për herë të parë në skemën e ndihmës ekonomike. Kjo tregon se masat e ndërmarra deri në momentin e auditimit nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të garantuar zbatimin e njëtrajtshëm dhe efektiv të kërkesave ligjore nga të gjitha strukturat përgjegjëse. Fakti që afatet e verifikimit mbështeten në një interpretim të integruar të dispozitave ligjore dhe jo në përcaktime të qarta operacionale në aktet e brendshme rregullatore, rrit riskun e zbatimit të ndryshëm të procedurave nga strukturat rajonale dhe vështirëson monitorimin e përputhshmërisë së tyre. Grupi i auditimit vlerëson se përgjegjësia për garantimin e zbatimit të kërkesave ligjore nuk kufizohet vetëm tek Drejtoritë Rajonale që kryejnë verifikimet, por shtrihet edhe tek strukturat qendrore të Shërbimit Social Shtetëror, të cilat kanë detyrimin të mbikqyrin, monitorojnë dhe sigurojnë funksionimin efektiv dhe të njëtrajtshëm të të gjitha strukturave në varësi. Pikërisht për këtë arsye, rekomandimi synon forcimin e mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të monitorimit, në mënyrë që detyrimi për kryerjen e verifikimeve në terren për hyrjet e reja në skemë të jetë i qartë, i matshëm dhe i zbatueshëm në mënyrë të njëtrajtshme nga të gjitha strukturat përgjegjëse. *Pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë*.

5. Në asnjë moment grupi i auditimit nuk ka pretenduar se mungesa e vërtetimit të hyrje-daljeve në dosjen e përfituesit duhet të përbëjë automatikisht shkak për përjashtimin e tij nga skema e ndihmës ekonomike. Problematika e konstatuar lidhet me rastet kur ky element kontrolli nuk është përfshirë fare në kontrollet e ushtruara përgjatë vitit 2025 nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, pavarësisht se administrimi i këtij dokumentacioni është parashikuar tashmë në kuadrin nënligjor në fuqi. Për këtë arsye, rekomandimi synon analizimin e shkaqeve që kanë sjellë mosrealizimin e këtyre kontrolleve dhe marrjen e masave për përfshirjen sistematike të verifikimit të vërtetimit të hyrje-daljeve në objektin e kontrolleve të ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Nga ana tjetër, vetë rezultatet e kontrolleve të kryera nga Drejtoritë Rajonale, në rastet kur ky element është verifikuar, kanë evidentuar mospërmbushje të detyrimeve nga përfitues të skemës, duke dëshmuar efektivitetin dhe vlerën e kësaj hallke shtesë kontrolli. Grupi i auditimit vlerëson se qëllimi për të cilin është parashikuar administrimi i këtij dokumentacioni mund të arrihet vetëm nëse funksionojnë në mënyrë efektive të dy hallkat e procesit: së pari, administrimi i dokumentacionit në dosjet e përfituesve dhe, së dyti, kontrolli sistematik i tij nga strukturat përgjegjëse. Mosfunksionimi i njërës prej këtyre hallkave e bën kontrollin e parashikuar në aktin nënligjor joefektiv dhe nuk garanton arritjen e objektivit për të cilin është vendosur, konkretisht forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe minimizimin e riskut të përfitimeve të padrejta nga skema e ndihmës ekonomike. *Pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë*.

6. Grupi i auditimit vlerëson se shpjegimet e paraqitura nga subjekti auditees sqaron kuadrin ligjor mbi planifikimin e kontrolleve periodike nga DRSHSSH dhe evidenton disa faktorë objektivë që kanë ndikuar në mosrealizimin e plotë të kontrolleve. Megjithatë argumentet e paraqitura nuk e ndryshojnë konstatimin e auditimit, pasi nuk paraqesin fakt të ri. Faktorë si angazhimi në kontrolle të paplanifikuara, task forca etj., nuk përjashtojnë nevojën që institucioni të disponojë mekanizma efektivë riplanifikimi dhe monitorimi. Sa i takon argumentit se në disa njësi administrative nuk ka pasur përfitues të skemës së ndihmës ekonomike gjatë periudhës objekt-auditimit, grupi i auditimit e konsideron këtë një rrethanë që duhet të dokumentohet dhe evidentohet në procesin e planifikimit të kontrolleve. Ky observacion pranohet pjesërisht, për pjesën e Drejtorisë Rajonale Gjirokastër.

7. Pavarësisht ekzistencës së procedurave të verifikimit të parashikuara në kuadrin ligjor, auditimi evidentoi një rast konkret ku, pas konstatimit të ndërrimit të jetës së kryefamiljarit dhe refuzimit të aplikimit, rezulton i regjistruar në sistem një aplikim i ri në emër të të njëjtit person. Gjithashtu, verifikimet automatike nuk kanë evidentuar në kohë reale ndryshimin e gjendjes civile. Ky rast tregon se kontrollet ekzistuese nuk kanë penguar regjistrimin e të dhënave jo të sakta në sistem, pavarësisht se aplikimi ka mbetur në status "Draft". Për rrjedhojë, observacioni nuk paraqet fakte apo rrethana të reja që ndryshojnë konstatimet dhe rekomandimet e grupit të auditimit.

Lidhur me sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastër ka paraqitur observacionet, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: DRSHSSH Gjirokastër, me shkresën nr. 298-6 prot., datë 31.03.2026, u është drejtuar të gjitha bashkive të Qarkut Gjirokastër duke kërkuar lidhjen ose përditësimin e akt-marrëveshjeve me Postën Shqiptare, si dhe marrjen e masave për eliminimin e tarifimit të përfituesve të ndihmës ekonomike. Në vijim të kësaj shkrese, Bashkitë Libohovë, Dropull, Përmet, Gjirokastër dhe Tepelenë kanë konfirmuar lidhjen ose përditësimin e akt-marrëveshjeve dhe mbulimin e tarifave apo komisioneve nga fondet e tyre, ndërsa Bashkitë Këlcyrë dhe Memaliaj kanë konfirmuar se janë në proces të lidhjes së marrëveshjeve përkatëse me Postën Shqiptare. Nga analiza e praktikave të ndjekura ndër vite rezulton se DRSHSSH Gjirokastër ka ushtruar kontroll të vazhdueshëm ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore, duke evidentuar dhe rekomanduar në mënyrë të përsëritur nevojën për lidhjen dhe përditësimin e akt-marrëveshjeve me Postën Shqiptare. Mosadresimi në mënyrë të veçantë i elementit të tarifimit ndaj përfituesve të ndihmës ekonomike lidhet me faktin se ky element ka qenë pjesë e

marrëveshjeve të papërditësuara dhe është trajtuar në mënyrë të tërthortë nëpërmjet kërkesave për rilidhjen dhe përditësimin e tyre. Pas evidentimit të kësaj çështjeje, janë ndërmarrë masa konkrete dhe të dokumentuara për rilidhjen dhe përditësimin e akt-marrëveshjeve, eliminimin e praktikës së tarifimit të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe mbulimin e tarifave e komisioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Objektivi i kontrolleve të ushtruara nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror është garantimi i zbatimit të kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e asistencës sociale. Kuadri rregullativ përcakton shprehimisht se tarifat dhe komisionet postare për pagesën e ndihmës ekonomike nuk duhet t'u ngarkohen përfituesve, por duhet të mbulohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ekzistenca, rishikimi apo përditësimi i akt-marrëveshjeve të bashkive me Postën Shqiptare nuk përbën një qëllim në vetvete, por një mjet për të reflektuar në marrëveshjet konkrete detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Për këtë arsye, kontrollet e ushtruara nga DRSHSSH duhet të ishin fokusuar në verifikimin nëse bashkitë po respektojnë ose jo këtë detyrim ligjor ndaj përfituesve të ndihmës ekonomike dhe jo vetëm në ekzistencën apo përditësimin e akt-marrëveshjeve. Duke vlerësuar masat e menjëhershme të ndërmarra për përmirësimin e situatës, shkresat e dërguara nga DRSHSSH Gjirokastër drejtuar bashkive në datën 31.03.2026 (pas kërkesës për informacion nga grupi i auditimit dhe administrimit të përgjigjes nga DKP NE&PAK lidhur me këtë çështje në email të datës 30.03.2026) dhe konfirmimet e marra nga bashkitë për eliminimin e tarifimit të përfituesve dhe mbulimin e komisioneve nga fondet vendore, dëshmojnë ndikimin e drejtpërdrejtë të auditimit të KLSH-së në përmirësimin e zbatimit të kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e asistencës sociale dhe në mbrojtjen e të drejtave financiare të përfituesve të ndihmës ekonomike.

Verifikime në lidhje me sistemin e Ndihmës Ekonomike (NE)

Grupi i auditimit mori akses në sistemin e NE dhe në vijim të verifikimit të disa aplikimeve, vendosi të kryejë testimet, si më poshtë:

1. **Riaplikimet para afatit 6-mujor të përjashtimit**

Në fokus të këtij testimi janë aplikantët që janë përjashtuar nga skema pasi kanë kryer fshehje informacioni/ deklarim të rremë, të cilët, sipas kuadrit ligjor në fuqi, e kanë të ndaluar të riaplikojnë për një periudhë 6-mujore nga data e refuzimit për shkak të "*deklarimit të rremë*". Nuk janë përfshirë rastet e refuzimeve për mosarritje të pikëve të mjaftueshme, pasi këto nuk konsiderohen deklarime të rreme.

2. **Kryerja e vizitave në shtëpi nga administratori shoqëror**

Synohet evidentimi i respektimit të periodicitetit të vizitave në familje nga administratori shoqëror, si një nga detyrimet e përcaktuara në nenin 13, pika "c", të Ligji nr. 57/2019, ku përcaktohet se: Administratori shoqëror "*Të verifikojnë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren gjendjen social-ekonomike për familjet që aplikojnë për herë të parë dhe, dy herë në vit, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike. Verifikimi për familjet që aplikojnë për herë të parë kryhet brenda muajit të aplikimit. Të dhënat e verifikuara nëpërmjet vizitave në familje hidhen në Regjistrin Elektronik Kombëtar*".

3. **Deklarimet 3-mujore**

Ky testim ka për qëllim evidentimin e rasteve kur aplikantët nuk kanë respektuar periodicitetin e deklarimit çdo 3 muaj, sipas pikës 4, Kreu II, të VKM nr. 597/2019 *"Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmë ekonomike*" ku përcaktohet se: "*Anëtarët madhorë të familjes/individët përfitues paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjendjen social-ekonomike të familjes. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet e situatës social-ekonomike të familjes, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përfitimin e ndihmës ekonomike*".

Në vijim, grupi i auditimit analizoi kategorinë e parë të testimit, të lidhur me identifikimin e rasteve të riaplikimit përpara përfundimit të afatit 6-mujor të penalizimit. Për këtë qëllim, në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike u aplikuan filtra sipas rajonit përkatës, për të gjitha bashkitë dhe njësitë administrative, për kategorinë "Familje në nevojë" me status aplikimi të refuzuar, si dhe për periudhën e riaplikimit 01.01.2023–31.12.2025. Nga përpunimi i të

dhënave rezultuan raste familjesh që kishin riaplikuar përpara përfundimit të afatit 6-mujor të përjashtimit nga skema.
Grupi i auditimit shqyrtoi rastet e refuzuara për arsye që lidhen me fshehjen e informacionit/ deklarimin e rremë, konkretisht mosdeklarimin ose deklarimin e pasaktë të pagës, pensionit apo mjeteve motorike, si dhe rastet kur përbërja familjare e regjistruar në sistemin e ndihmës ekonomike nuk përputhej me të dhënat e DPGJC-së. Këto raste klasifikohen si deklarime të rreme dhe, në përputhje me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", sjellin përjashtimin e familjes nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore. Gjithashtu, sipas nenit 15, pika 2, shkronja "c", të të njëjtit ligj, rastet kur konstatohet më shumë se një deklarim i rremë ndëshkohen me përjashtim nga skema për një periudhë 1-vjeçare.

Qarku Lezhë
Viti 2023
1.Aplikimi nr. NE-2023-003412 aplikanti: A. D.
Nga auditimi konstatohet se aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të mosdeklarimit saktë të pagës së zj. J. D. dhe L. D. është refuzuar, më datë 30.01.2023.".
Pas 127 ditësh, nga ky aplikim është riaplikuar, konkretisht aplikimi nr. NE-2023-021532, datë 06.06.2023. Pranimi i aplikimit pas 127 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", ku përcaktohet përjashtimi 6-mujor në rast fshehjeje informacioni apo deklarimi të rremë.
Sipas përllogaritjeve të kryera nga grupi i auditimit afati i "penalizimit" duhet të përfundonte më datë 29.07.2023.
Në lidhje me aplikimin e dytë është gjeneruar një nr. aplikimi NE-2023-021532 statusi i të cilit nuk është i qartë nëse është përfituar ose jo pasi përshkruhet si "*Draft*" dhe nuk rezulton si aplikim në sistem për aplikuesin.
2.Aplikimi nr. NE-2023-005103, aplikanti: E. N. D.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi fillestar i familjes është refuzuar më datë 30.01.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit, nëpërmjet modulit "*Verifikimi i Vendbanimit*", është evidentuar deklarim i pasaktë i vendbanimit nga kryefamiljari, z. E. D. Pavarësisht refuzimit për shkak të deklarimit të rremë, më datë 01.02.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-005103, vetëm 2 ditë pas refuzimit të aplikimit të mëparshëm, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Nga llogaritja e afatit 6-mujor, referuar datës së refuzimit 30.01.2023, rezulton se periudha e përjashtimit përfundonte më datë 29.07.2023, ndaj aplikimi nr. NE-2023-005103 nuk duhej të ishte pranuar dhe familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara përfundimit të këtij afati. Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **52,272 lekë**.
Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Verifikime"* në Regjistrin Elektronik Kombëtar nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, përfshirë vizitën e parë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, e cila përcakton detyrimin e administratorit shoqëror për kryerjen e verifikimit në terren të gjendjes social-ekonomike të familjes aplikuese.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. F. L.

Viti 2024

1.Aplikimi nr. NE-2024-028525, aplikanti: A.Ll.N.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi fillestar i familjes është refuzuar më datë 27.08.2024 për shkak të mospërputhjes së strukturës së familjes, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se znj. D. N. nuk gjendej në sistemin e DPGJC-së. Pavarësisht refuzimit, më datë 06.11.2024 është regjistruar aplikimi nr. NE-2024-028525, vetëm 71 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/*2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*. Referuar datës së refuzimit, 27.08.2024, afati i përjashtimit përfundonte më datë 09.02.2025, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.

Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "Verifikime" nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, përfshirë vizitën e parë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **13,685 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. E. S.

2.Aplikimi nr. NE-2024-025881, aplikanti: F. M. Sh.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi fillestar i familjes është refuzuar më datë 24.05.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. F. Sh. ishte i punësuar dhe të ardhurat nga paga nuk ishin deklaruar. Pavarësisht refuzimit, më datë 07.10.2024 është regjistruar aplikimi nr. NE-2024-025881, vetëm 136 ditë pas refuzimit.

Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*. Referuar datës së refuzimit, 24.05.2024, afati i përjashtimit përfundonte më datë 20.11.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date. Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **14,162 lekë.**

Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës *"Verifikime*" nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, përfshirë vizitën e parë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj. E. K.

Viti 2025

1.Aplikimi nr. NE-2025-022388, aplikanti: K. Z. L.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi fillestar i familjes është refuzuar më datë 26.08.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarim i saktë i pagës nga z. K. L. Pavarësisht refuzimit, më datë 10.09.2025 është regjistruar aplikimi nr. NE-2025-022388, vetëm 15 ditë pas refuzimit në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Referuar datës së refuzimit, 26.08.2025, afati i përjashtimit përfundonte më datë 23.02.2026, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **110,544 lekë.**

Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Verifikime"* rezulton se gjatë vitit 2025 është kryer vetëm një vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj. A. Ll.

2.Aplikimi nr. NE-2025-015778, aplikanti: I. I. S.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi fillestar i familjes është refuzuar më datë 27.05.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i pagës nga znj. M. S. Pavarësisht

refuzimit, më datë 09.06.2025 është regjistruar aplikimi nr. NE-2025-015778, vetëm 13 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Referuar datës së refuzimit, 27.05.2025, afati i përjashtimit përfundonte më datë 23.11.2025, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **9,150 lekë.**
Githashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Verifikime*" nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj. E. S.

Qarku Dibër
Viti 2023
1.Aplikimi nr. NE-2023-017042, aplikanti: M. R. A.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi fillestar i familjes është refuzuar më datë 27.03.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i saktë i pagës nga znj. O. A, e cila rezultonte e punësuar gjatë periudhës janar 2023. Pavarësisht refuzimit, më datë 02.05.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023017042, vetëm 36 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i cili parashikon përjashtimin 6-mujor nga përfitimi në rast fshehjeje informacioni ose deklarimi të rremë. Referuar datës së refuzimit, 27.03.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 29.10.2023, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **40,764 lekë**.
Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës *"Verifikime"* nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, përfshirë vizitën e parë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj.E. C.
2.Aplikimi nr. NE-2023-033046, aplikanti: M. R. K.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 30.10.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i saktë i pagës nga znj. A. K., e cila rezultonte e punësuar gjatë periudhës tetor 2022–gusht 2023. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit rezultoi se edhe pjesëtarja e familjes A. K. rezultonte e punësuar gjatë periudhës korrik–gusht 2023. Pavarësisht sinjalizimeve të sistemit mbi statusin e punësimit dhe të ardhurat reale të familjarëve, në deklaratat periodike nuk janë deklaruar të ardhurat nga paga, duke sjellë përfitimin e padrejtë të ndihmës ekonomike për periudhën tetor 2022–gusht 2023 në shumën 147,826 lekë.
Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës *"Verifikime*" rezultoi se vizita e fundit në banesë është kryer më datë 12.07.2022, ndërsa gjatë periudhës së përfitimit nuk janë kryer vizitat e detyrueshme në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar. Më datë 02.11.2023, vetëm 3 ditë pas refuzimit, është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-033046. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Referuar datës së refuzimit, 30.10.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 30.04.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për më tepër, pas vizitës së kryer më datë 02.11.2023 nuk rezulton të jenë kryer vizitat periodike të detyrueshme në banesë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **52,848 lekë pas** riaplikimit, ndërsa përfitimi i padrejtë i konstatuar për shkak të mosdeklarimit të të ardhurave nga paga për periudhën tetor 2022–gusht 2023 rezulton në shumën **147,826 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj.A. R. tek riaplikimi dhe znj. H. T. tek aplikimi fillestar.

3.Aplikimi nr. NE-2023-033703, aplikanti: S. R. K.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 02.10.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se kryefamiljari, z. S. K., kishte të ardhura të mjaftueshme nga punësimi për periudhën korrik 2022–maj 2023, duke mos plotësuar kushtet për përfitimin e ndihmës ekonomike. Pavarësisht refuzimit, më datë 06.11.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-033703, vetëm 35 ditë pas refuzimit.

Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".* Referuar datës së refuzimit, 02.10.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 04.05.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date. Megjithëse në sistem rezulton shënimi i administratorit shoqëror se familja ndodhej në kushte të vështira ekonomike dhe kryefamiljari ishte invalid, ky vlerësim nuk përbënte bazë për shmangien e kufizimit ligjor 6-mujor të përcaktuar nga neni 15 i Ligjit nr. 57/2019.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **35,172 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. M. L.

4.Aplikimi nr. NE-2023-013056, aplikanti: Sh. F. Xh.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 03.10.2022, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i të ardhurave nga paga të z. E. Xh., anëtar i familjes, i cili rezultonte i punësuar gjatë periudhës korrik–gusht 2022. Për këtë aplikim nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Pavarësisht refuzimit, më datë 10.03.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-013056, vetëm 158 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Referuar datës së refuzimit, 03.10.2022, afati i përjashtimit përfundonte më datë 06.09.2023, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.

Gjithashtu, edhe për aplikimin nr. NE-2023-013056 nuk rezulton të jenë kryer vizitat e detyrueshme në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **42,992 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. Z. G. (e para), znj. N. Ll. (e dyta).

5.Aplikimi nr. NE-2023-034663, aplikanti: V. H. H.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 30.10.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i të ardhurave nga paga të znj. A. H., e cila rezultonte e punësuar gjatë periudhës nëntor–dhjetor 2022, shkurt–mars 2023 dhe qershor–shtator 2023, si dhe të znj. A. H., e cila rezultonte e punësuar gjatë periudhës korrik–gusht 2023. Pavarësisht refuzimit, më datë 06.11.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-034663, vetëm 9 ditë pas refuzimit. Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".* Referuar datës së refuzimit, 30.10.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 27.04.2024, ndaj aplikimi i ri nuk duhej të pranohej përpara kësaj date.

Gjithashtu, rezulton se aplikimi nr. NE-2023-034663 është refuzuar më datë 24.11.2023 për shkak të mosdeklarimit të pagës, duke konfirmuar vijimësinë e mospërmbushjes së kritereve ligjore për përfitimin e ndihmës ekonomike.

6.Aplikimi nr. NE-2023-036654 , aplikanti: V. H. H.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 24.11.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i të ardhurave nga paga të anëtarëve të familjes, të cilët rezultonin të punësuar gjatë periudhave tetor–dhjetor 2022, shkurt–mars 2023, qershor–shtator 2023 dhe korrik–gusht 2023.

Pavarësisht refuzimit, më datë 06.12.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-036654, vetëm 12 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*

Referuar datës së refuzimit, 24.11.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 03.06.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **40,812 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z. K. Sh.

7.Aplikimi nr. NE-2023-009068, aplikanti: G. I. Ll.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 31.01.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i saktë i të ardhurave nga paga të znj. M. Ll., e cila rezultonte e punësuar gjatë periudhës nëntor–dhjetor 2022. Për këtë aplikim nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar. Pavarësisht refuzimit, më datë 10.02.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-009068, vetëm 10 ditë pas refuzimit. Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Referuar datës së refuzimit, 31.01.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 09.08.2023, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.

Gjithashtu, edhe për aplikimin nr. NE-2023-009068 nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, përfshirë vizitën e parë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **35,937 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.S. Gj. (e dyta), A. R. (e para)

8.Aplikimi nr. NE-2023-025608 aplikanti: S. Sh. P.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.07.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i të ardhurave nga paga të bashkëshortes, znj. S. P, e cila rezultonte e punësuar gjatë periudhës janar–qershor 2023. Për këtë aplikim nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Pavarësisht refuzimit, më datë 02.08.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-025608, vetëm 5 ditë pas refuzimit. Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*. Referuar datës së refuzimit, 28.07.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 29.01.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.

Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "Verifikim" rezulton se është kryer vetëm një vizitë në banesë më datë 02.08.2023, ndërkohë që nuk rezultojnë vizitat periodike të kërkuara, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **78,432 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.S. Gj. (e dyta), A. K. (e para).

9.Aplikimi nr. NE-2023-006345, aplikanti: N. R. M.


Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 07.09.2022, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i saktë i të ardhurave nga paga të znj. H. M. Pavarësisht refuzimit, më datë 03.02.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-006345, vetëm 149 ditë pas refuzimit.

Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Referuar datës së refuzimit, 07.09.2022, afati i përjashtimit përfundonte më datë 07.03.2023. Duke qenë se aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10 ditëshit të parë të muajit, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara përfundimit të afatit ligjor të përjashtimit, rrjedhimisht jo më herët se muaji mars 2023, me efekt financiar sipas procedurave në fuqi nga muaji pasardhës.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **14,465 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. T. M.

Nga verifikimi në sistem rezulton, gjithashtu se aplikuesi ka kryer një aplikim më datë 06.01.2023 me nr. aplikimi NE-2023-001427[22], i cili figuron me statusin "*Draft"*. Megjithatë, gjatë kërkimit në sistem me këtë numër aplikimi, shfaqet shënimi: "*Nuk ka të dhëna sipas kërkimit të kryer*", konkretisht si më poshtë:



Pra, sa më sipër, ekziston risk për shkak të mospërputhjes së të dhënave në sistem (aplikim i regjistruar në status "*Draft*", por i pakonfirmuar në kërkim), çka mund të ndikojë në: saktësinë e historikut të aplikimeve dhe verifikimin e riaplikimeve brenda afatit të penalizimit.

10.Aplikimi nr. NE-2023-007081, aplikanti: N. Gj. N.

Nga të dhënat sipas raportit të aplikimeve para afatit 6-mujor rezulton se aplikanti ka aplikuar me nr. NE-2022-033020 më datë 10.10.2022 dhe aplikimi i është refuzuar më datë 21.10.2022 me arsyetimin: "*Mosdeklarim i mjetit motorik N. N."*. Pas 108 ditësh nga data e refuzimit, aplikuesi ka riaplikuar pa u përmbushur afati 6-mujor i penalizimit, konkretisht më datë 06.02.2023 me nr. aplikimi NE-2023-007081, i cili sipas raportit rezulton me statusin "*Draft*". Megjithatë, nga kërkimi i aplikimeve sipas NID-it të aplikuesit nuk rezulton të shfaqet aplikimi me nr. NE-2023-007081. Po ashtu, nga kërkimi në menunë "Aplikime" me këtë numër aplikimi, sistemi shfaq mesazhin: "*Nuk ka të dhëna sipas kërkimit të kryer*".

11.Aplikimi nr. NE-2023-016563, aplikanti: Gj. P. P.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 22.02.2023, për shkak të mosdeklarimit të statusit të punësimit, pasi rezultoi se znj. A. P. nuk figuronte e regjistruar

[22] Paraqitur në rreshtin 14 të tabelës "*Riaplikime të evidentuara para 6 mujorit"*

në zyrën e punës. Pavarësisht refuzimit, më datë 08.04.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-016563, vetëm 45 ditë pas refuzimit.
Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me pikën 1, shkronja "ç", të nenit 15 të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Gjithashtu, nga verifikimi i aplikimit nr. NE-2023-016563 rezulton se nuk është kryer asnjë vizitë në banesë deri në datën e auditimit, pasi në sistem shfaqet mesazhi "*Nuk janë kryer akoma vizita*", në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar. Në lidhje me aplikimin nr. NE-2023-016563, rezulton se me vendimin nr. 4/2023, datë 26.04.2023, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01.04.2023–30.04.2023", familja është përfshirë në listën e përfituesve në masën 6,732 lekë në muaj.
Referuar datës së refuzimit 22.02.2023 dhe afatit 6-mujor të përcaktuar në pikën 1, shkronja "ç", të nenit 15 të Ligjit nr. 57/2019, aplikimi nuk duhej të pranohej përpara datës 21.08.2023. Duke qenë se aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10 ditëve të para të muajit, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, aplikimi duhej të regjistrohej jo më herët se 10-ditëshi i parë i muajit shtator 2023, me efekt përfitimi pas përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për rrjedhojë, përfitimet e ndihmës ekonomike të marra për periudhën prill–gusht 2023 rezultojnë të përfituara pa të drejtë.
Shuma e përfituar padrejtësisht rezulton **33,660 lekë** (6,732 lekë × 5 muaj).
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. D. S. (D. S 2).[23]

Viti 2024

1.Aplikimi nr. NE-2024-014450, aplikanti: G. G. Xh.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.12.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i të ardhurave nga paga të kryefamiljarit, z. G. Xh., i cili rezultonte i punësuar gjatë periudhës dhjetor 2022–nëntor 2023. Pavarësisht refuzimit, më datë 10.05.2024 është regjistruar aplikimi nr. NE-2024-014450, vetëm 136 ditë pas refuzimit.
Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i cili parashikon përjashtimin 6-mujor nga përfitimi në rast fshehjeje informacioni ose deklarimi të rremë. Referuar datës së refuzimit, 28.12.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 25.06.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Gjithashtu, nga verifikimi në sistem, në modulin "*Vizita në shtëpi*", rezulton vetëm një vizitë e kryer më datë 05.02.2026, e regjistruar në sistem në të njëjtën datë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **18,031 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.. E. C.

2.Aplikimi nr. NE-2024-001675, aplikanti: R. S. Ll.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.12.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i të ardhurave nga paga të kryefamiljarit, z. R. S. Ll., i cili rezultonte i punësuar gjatë periudhës dhjetor 2022–mars 2023 dhe gusht 2023–tetor 2023. Pavarësisht refuzimit, më datë 08.01.2024 është regjistruar aplikimi nr. NE-2024-001675, vetëm 11 ditë pas refuzimit.

[23] Sipas të dhënave të krijuesit në sistem.

Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".* Referuar datës së refuzimit, 28.12.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 25.06.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Gjithashtu, nga verifikimi në sistem, në modulin "*Vizita në shtëpi*", nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **30,798 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.E. C.

3.Aplikimi nr. NE-2024-000186, aplikanti: L. F. M.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.12.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i një mjeti motorik në pronësi të znj. S. M. Gjithashtu, nga verifikimi në sistem rezultoi se nuk është kryer vizita e parë në banesë, ndërsa gjatë viteve 2022 dhe 2023 është kryer vetëm nga një vizitë në vit, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Pavarësisht refuzimit, më datë 04.01.2024 është regjistruar aplikimi nr. NE-2024-000186, vetëm 8 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*. Referuar datës së refuzimit, 28.12.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 25.06.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Gjithashtu, për aplikimin nr. NE-2024-000186 rezulton vetëm një vizitë në banesë e kryer më datë 03.01.2024 dhe e regjistruar në sistem më datë 15.01.2024, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **28,752 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.A. R.

4.Aplikimi nr. NE-2024-002636, aplikanti: M. L. D.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 30.10.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i pensionit nga z. M. D. Për këtë aplikim nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Pavarësisht refuzimit, më datë 10.01.2024 është regjistruar aplikimi nr. NE-2024-002636, vetëm 72 ditë pas refuzimit. Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/*2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*. Referuar datës së refuzimit, 30.10.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 27.04.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Gjithashtu, edhe për aplikimin nr. NE-2024-002636 nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **24,552 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.G. J. (aplikimi 1) E. C.(aplikimi 2)

5.Aplikimi nr. NE-2024-031066, aplikanti: A. R. P.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 26.11.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mospërputhje e strukturës së familjes ndërmjet sistemit të ndihmës ekonomike dhe sistemit të DPGJC-së, ku konkretisht personat E. D. dhe O. P. nuk rezultonin të regjistruar në sistemin e DPGJC-së. Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Vizita në shtëpi*" rezulton se është kryer vetëm një vizitë më datë 06.06.2022, ndërsa për vitet pasuese nuk rezultojnë vizita, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Pavarësisht refuzimit, më datë 06.12.2024 është regjistruar aplikimi nr. NE-2024-031066, vetëm 10 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Referuar datës së refuzimit, 26.11.2024, afati i përjashtimit përfundonte më datë 25.05.2025, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Gjithashtu, për aplikimin nr. NE-2024-031066 rezulton të jetë kryer vetëm vizita fillestare më datë 06.12.2024, ndërsa gjatë vitit 2025 është kryer vetëm një vizitë më datë 26.11.2025, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **49,797 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.M. K.

Viti 2025
1.Aplikimi nr. NE-2025-026538, aplikanti: Sh. I. C.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 30.10.2025 me arsyetimin "*Mosdeklarim mjeti i Sh. I. C.*". Megjithatë, nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit në sistemin elektronik, në modulin "Verifikimi i mjeteve motorike", nuk rezulton asnjë mjet motorik në pronësi të z. Sh. I. C., ndaj nuk u evidentuan prova materiale që mbështesin arsyen e refuzimit të aplikimit.
Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Vizita në shtëpi"* rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2023 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë, ndërsa për vitet 2022 dhe 2024 rezulton vetëm nga një vizitë, respektivisht më datë 20.10.2022 dhe 28.11.2024, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Pavarësisht refuzimit, më datë 12.11.2025 është regjistruar aplikimi nr. NE-2025-026538, vetëm 13 ditë pas refuzimit. Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".
Referuar datës së refuzimit, 30.10.2025, afati i përjashtimit përfundonte më datë 28.04.2026, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **42,596 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror M. Q.
Në sistem ky aplikim është me statusin "Në Proces" duke qenë se verifikimet për muajin Mars janë në proces.
2.Aplikimi nr. NE-2025-024400, aplikanti: A. B. E.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.07.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i të ardhurave nga paga të kryefamiljarit, z. A. E., i cili rezultonte i punësuar gjatë muajit maj 2025. Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Vizita në shtëpi"* rezultoi se për vitet 2023–2025 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Pavarësisht refuzimit, më datë 09.10.2025 është regjistruar aplikimi nr. NE-2025-024400, vetëm 73 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".
Referuar datës së refuzimit, 28.07.2025, afati i përjashtimit përfundonte më datë 24.01.2026, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **31,504 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj. P. D.
3.Aplikimi nr. NE-2025-006238, aplikanti: E. S. K.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 30.01.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi deklarim i pasaktë i të ardhurave nga paga të kryefamiljarit, z. E. K., për muajin dhjetor 2024. Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Vizita në shtëpi*" rezultoi se për vitet 2021, 2023 dhe 2024 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë, ndërsa për vitin 2022 rezulton vetëm një vizitë e kryer më datë 22.07.2022, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Pavarësisht refuzimit, më datë 07.02.2025 është regjistruar aplikimi nr. NE-2025-006238, vetëm 8 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".
Gjithashtu, për aplikimin nr. NE-2025-006238 nuk rezulton të jetë kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Referuar datës së refuzimit, 30.01.2025, afati i përjashtimit përfundonte më datë 29.07.2025, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **41,489 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj. G. Sh.

4.Aplikimi nr. NE-2025-025809, aplikanti: Gj. H. M.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 30.09.2025, pasi nga verifikimet e kryera në terren rezultoi se nga 8 anëtarë të certifikatës familjare, vetëm 3 jetonin në Shqipëri, ndërsa 5 anëtarë jetonin në Greqi, ku njëri prej tyre vijonte edhe studimet. Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Vizita në shtëpi*" rezultoi se për vitin 2020 nuk është kryer asnjë vizitë, për vitin 2021 është kryer vetëm një vizitë, për vitet 2022–2024 nuk rezulton asnjë vizitë, ndërsa për vitin 2025 rezulton vetëm një vizitë e kryer më datë 15.09.2025, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Pavarësisht refuzimit, më datë 10.11.2025 është regjistruar aplikimi nr. NE-2025-025809, vetëm 41 ditë pas refuzimit. Pranimi i aplikimit brenda afatit ndalues është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*.Referuar datës së refuzimit, 30.09.2025, afati i përjashtimit përfundonte më datë 29.03.2026, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **18,873 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.S. Q.(tek të dyja).

Qarku Durrës
Viti 2023

1.Aplikimi nr. NE-2023-005985 aplikanti: F. B. M.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 16.12.2022, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i punësimit të z. N. M., anëtar i familjes, i cili rezultonte i punësuar gjatë periudhës tetor–nëntor 2022. Pavarësisht refuzimit, më datë 03.02.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-005985, vetëm 49 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/*2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Referuar datës së refuzimit, 16.12.2022, afati i përjashtimit përfundonte më datë 14.06.2023, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date. Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës *"Verifikime*" rezulton se vizita e fundit në banesë është kryer më datë 18.07.2025, çka tregon mosrespektim të kërkesave të pikës 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, lidhur me kryerjen periodike të vizitave në banesë.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **18,515 lekë.**
Në lidhje me këtë rast, nga Drejtoria Rajonale Durrës janë paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, nga të cilat rezulton se përfitimi i padrejtë dhe dëmi ekonomik janë konstatuar dhe trajtuar administrativisht nga vetë Drejtoria Rajonale Durrës.

2.Aplikimi nr. NE-2023-012391 aplikanti: A. S. H.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 17.02.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mospërputhje e strukturës familjare ndërmjet sistemit të ndihmës ekonomike dhe sistemit të DPGJC-së, ku konkretisht personi N. A. H.nuk rezultonte në strukturën familjare sipas të dhënave të DPGJC-së. Pavarësisht refuzimit, më datë 09.03.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-012391, vetëm 20 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Referuar datës së refuzimit, 17.02.2023, afati i përjashtimit përfundonte më datë 16.08.2023, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Verifikime*" rezulton se vizita e parë në banesë është kryer më datë 19.07.2023, rreth katër muaj pas riaplikimit, duke qenë njëkohësisht edhe vizita e vetme për vitin 2023. Po ashtu, për vitin 2025 rezulton vetëm një vizitë në banesë. Moskryerja e vizitave në banesë sipas frekuencës së përcaktuar është në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **18,515 lekë.**
Në lidhje me këtë rast, nga Drejtoria Rajonale Durrës janë paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, nga të cilat rezulton se dëmi ekonomik është konstatuar dhe trajtuar administrativisht nga vetë Drejtoria Rajonale Durrës.
3.Aplikimi nr. NE-2023-022472, aplikanti: A. M. T.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes me nr. NE-2022-037964 është refuzuar më datë 27.03.2023 për shkak të mospërputhjes së strukturës së familjes ndërmjet sistemit të Ndihmës Ekonomike (NE) dhe sistemit të DPGJC-së, pasi anëtari i familjes A. T. nuk rezultonte i regjistruar në sistemin e NE-së. Më datë 09.06.2023 është regjistruar një aplikim i ri, 74 ditë pas refuzimit të aplikimit të mëparshëm. Referuar nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", aplikimi nuk duhej të paraqitej përpara përfundimit të afatit 6-mujor të përjashtimit. Megjithatë, nga verifikimi i dokumentacionit dhe të dhënave në sistem rezulton se aplikimi i datës 09.06.2023 paraqitet me status *"Draft",* pa dokumentacion të bashkëlidhur dhe pa marrë status përfundimtar. Për rrjedhojë, aplikimi nuk rezulton të jetë shqyrtuar nga strukturat përgjegjëse dhe familja nuk ka përfituar ndihmë ekonomike mbi bazën e tij. Gjithashtu, nga verifikimi i deklarimit të fundit 3-mujor, datë 09.03.2023, rezulton se nuk është deklaruar anëtari i familjes A. T., fakt i cili konfirmon vijimësinë e mospërputhjes së strukturës familjare të evidentuar nga sistemi.
4.Aplikimi me nr. NE-2023-032280, aplikanti: I. V. K.
Nga auditimi konstatohet se sipas raportit të aplikimeve të paraqitura brenda afatit 6-mujor të penalizimit, aplikimi nr. NE-2023-029434 është refuzuar më datë 21.09.2023 me arsyetimin "*Mosdeklarim automjeti*". Më tej, në raport evidentohet se pas 19 ditësh është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-032280 me status "*Draft".*
Megjithatë, nga verifikimet e kryera në sistem nuk u arrit të konfirmohej ekzistenca e këtij aplikimi, pasi ai nuk rezulton në kërkimin sipas NID-it të aplikuesit dhe as në menunë "*Aplikime*" sipas numrit të aplikimit, ku sistemi shfaq mesazhin "*Nuk ka të dhëna sipas kërkimit të kryer".* Për rrjedhojë, konstatohet mospërputhje ndërmjet informacionit të gjeneruar nga raporti dhe të dhënave të disponueshme në sistem, duke krijuar risk për integritetin dhe besueshmërinë e të dhënave, si dhe për saktësinë e historikut të aplikimeve dhe verifikimin e rasteve të riaplikimit brenda afatit ligjor të penalizimit.
5.Aplikimi me nr. NE-2023-001162, Aplikanti: F. E. Ç.
Nga moduli i raporteve të riaplikimeve pa kaluar afati 6-mujor rezulton se për aplikanten F. Ç. shfaqen aplikimet gjatë vitit 2023, si në vijim:

Aplikimit të refuzuar	Dt Aplikimit	Dt Refuzimit	Arsyeja Refuzimit	Aplikimet brenda 6 muajve	Dt. Aplikimeve brenda 6 muajve	Statusi Aplikimeve
NE-2021-046687	02/12/2021	30/09/2022	Refuzuar automatikisht nga sistemi. Nuk është paraqitur për te bere deklarimin tre mujor	NE-2023-001162	06/01/2023	Refuzuar
NE-2021-046687	02/12/2021	30/09/2022	Refuzuar automatikisht nga sistemi. Nuk është paraqitur për te bere deklarimin tre mujor	NE-2023-001146	06/01/2023	Draft
NE-2021-046687	02/12/2021	30/09/2022	Refuzuar automatikisht nga sistemi. Nuk është paraqitur për te bere deklarimin tre mujor	NE-2023-006894	06/02/2023	Refuzuar

Nga tabela rezulton se aplikanti, brenda të njëjtës datë, konkretisht më 06.01.2023, ka kryer dy aplikime me numra aplikimi të ndryshëm, ku njëri rezulton me status "*Refuzuar*" dhe tjetri me status "*Draft*". Kjo situatë paraqet risk, pasi tregon tentativë për aplikim të shumëfishtë në të njëjtën ditë, çka mund të ngrejë dyshime mbi saktësinë dhe integritetin e deklarimeve.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. H. V.

Viti 2024

1.Aplikimi nr. NE-2024-005791 aplikanti: F. G. T.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 24.01.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mosdeklarimi i automjetit në pronësi të znj. S. T. Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "Verifikim" rezultoi se për vitet 2020 dhe 2022 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë, ndërsa për vitin 2023 është kryer vetëm një vizitë.

Pavarësisht refuzimit, më datë 08.02.2024 është regjistruar aplikimi nr. NE-2024-005791, vetëm 15 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".

Gjithashtu, moskryerja e vizitave në banesë sipas frekuencës së përcaktuar është në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Referuar datës së refuzimit, 24.01.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 22.07.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **66,552 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.E. R. për aplikimin e parë dhe znj.A. N. për riaplikimin.

***2.*Aplikimi nr. NE-2024-023922 aplikanti: H. B. M.**

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 24.08.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mospërputhje e strukturës së familjes ndërmjet sistemit të Ndihmës Ekonomike dhe sistemit të DPGJC-së. Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Verifikime"* rezultoi se gjatë vitit 2023 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Pavarësisht refuzimit, më datë 10.09.2024 është regjistruar aplikimi nr. NE-2024-023922, vetëm 17 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*

Gjithashtu, nga auditimi i rubrikës "Verifikim" rezultoi se për vitin 2024 është kryer vetëm një vizitë në banesë më datë 11.12.2024, e regjistruar në sistem më datë 17.03.2026, ndërsa për vitin 2025 është kryer vetëm një vizitë më datë 04.07.2025, e regjistruar në sistem më datë 17.03.2026, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar. Referuar datës së refuzimit, 24.08.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 20.02.2025, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **94,512 lekë.**

Në lidhje me këtë rast, Drejtoria Rajonale Durrës ka paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, sipas të cilave trungu familjar është shtuar me një anëtar 3 ditë pas deklarimit 3-mujor, ndaj ky ndryshim nuk rezultonte i pasqyruar në deklarimin e kryer nga aplikuesi.

Viti 2025

1.Aplikimi nr. NE-2025-000555 aplikanti: K. F. Gj.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 19.09.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se znj. D. Gj. ishte e punësuar dhe nuk kishte deklaruar statusin e punësimit. Nga verifikimet e mëtejshme të kryera nga grupi i auditimit rezultoi se znj. D. Gj. figuronte e punësuar edhe në verifikimet e datave 14.11.2023 dhe 13.02.2024, ndërsa znj. S. Gj. rezultonte e punësuar që në verifikimin fillestar të datës 13.06.2022. Për rrjedhojë, familja nuk plotësonte kushtet për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe aplikimi duhej të ishte refuzuar që në momentin e konstatimit të parë të mosdeklarimit të punësimit. Si pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike për periudhën 06.06.2022–19.09.2024 në shumën 440,664 lekë.

Gjithashtu, nga verifikimi i rubrikës "*Verifikime*" rezultoi se për vitin 2022 është kryer vetëm një vizitë në banesë, ndërsa për vitet 2023 dhe 2024 nuk është kryer asnjë vizitë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Pavarësisht refuzimit, më datë 07.01.2025 është regjistruar aplikimi nr. NE-2025-000555, vetëm 110 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".

Nga auditimi i rubrikës "*Verifikime"* rezultoi se për vitin 2025 është kryer vetëm një vizitë në banesë më datë 05.12.2025 dhe nuk rezulton të jetë kryer vizita fillestare, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Referuar datës së refuzimit, 19.09.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 18.03.2025, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën 57,672 lekë pas riaplikimit, ndërsa vlera totale e përfituar padrejtësisht rezulton **498,336 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.M. D.

2.Aplikimi nr. NE-2025-011952 aplikanti: L. R. O.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 19.03.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. L. O. kishte në pronësi një automjet të padeklaruar. Nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit rezultoi se automjeti figuronte në pronësi të aplikuesit që në verifikimin e parë të kryer më datë 11.12.2024. Për rrjedhojë, aplikimi duhej të ishte refuzuar që në momentin e konstatimit të kësaj mospërputhjeje, pasi automjeti nuk është deklaruar as në aplikimin fillestar dhe as në deklarimet periodike 3-mujore. Si pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike për periudhën 02.12.2024–19.03.2025 në shumën 18,498 lekë.

Pavarësisht refuzimit, më datë 10.04.2025 është regjistruar aplikimi nr. NE-2025-011952, vetëm 22 ditë pas refuzimit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".

Referuar datës së refuzimit, 19.03.2025, afati 6-mujor përfundonte më datë 15.09.2025, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën 25,484 lekë pas riaplikimit. Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja rezulton **43,982 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.A. D.

Qarku Elbasan

Viti 2023

1.Aplikimi nr. NE-2023-032498, aplikanti: M. T. Xh.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 29.09.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. M. Xh., kryefamiljari, dhe z. G. Xh., anëtar i

familjes, nuk kishin deklaruar saktë statusin e punësimit. Gjithashtu, nga auditimi i rubrikës "*Verifikime"* rezultoi se për vitet 2020 dhe 2022 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë, ndërsa për vitin 2021 është kryer vetëm një vizitë më datë 26.07.2021, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Pavarësisht refuzimit, më datë 10.10.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-032498, vetëm 11 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".
Gjithashtu, nga auditimi i rubrikës "*Verifikime*" rezultoi se për vitin 2024 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Referuar datës së refuzimit, 29.09.2023, afati 6-mujor përfundonte më datë 27.03.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **45,645 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.G. L. (aplikimi 2), B. B. (aplikimi 1).
2.Aplikimi nr NE-2023-017631, aplikanti: A. H. Ç.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 30.03.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. S. Ç. nuk kishte deklaruar statusin e punësimit dhe rezultonte i punësuar gjatë periudhës tetor 2022–janar 2023.
Pavarësisht refuzimit, më datë 03.05.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-017631, vetëm 34 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".
Referuar datës së refuzimit, 30.03.2023, afati 6-mujor përfundonte më datë 26.09.2023, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **43,465 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.G. P.
3.Aplikimi nr NE-2023-018312, aplikanti: A.T. B.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 31.03.2023, pasi nga verifikimet e kryera nëpërmjet vizitës në banesë, datë 15.03.2023, rezultoi se vendbanimi i deklaruar nuk përputhej me vendqëndrimin faktik të familjes. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar me arsyetimin "*Deklarim i rremë, nuk banon në territorin e njësisë".*
Pavarësisht refuzimit, më datë 04.05.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-018312, vetëm 34 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Referuar datës së refuzimit, 31.03.2023, afati 6-mujor përfundonte më datë 27.09.2023, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **37,025 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.E. K.
4. Aplikimi nr NE-2023-010814, aplikanti:A. I. H.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.12.2022, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. A. H., anëtar i familjes, ishte i punësuar gjatë periudhës dhjetor 2021–nëntor 2022 dhe ky fakt nuk ishte deklaruar nga aplikuesi. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar me arsyetimin "*Deklarim i rremë, ka anëtarë të familjes të punësuar".*
Pavarësisht refuzimit, më datë 06.03.2023 është regjistruar aplikimi nr. NE-2023-010814, vetëm 68 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".

Referuar datës së refuzimit, 28.12.2022, afati 6-mujor përfundonte më datë 26.06.2023, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **25,116 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.K. Z.

5.Aplikimi nr. NE-2023-035731, aplikanti: Sh. H. K.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar me Vendimin e DRSSH Elbasan nr. 10, datë 03.11.2023 "*Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01–31.10.2023*", pasi nga vizita në familje e kryer më datë 30.10.2023 është konstatuar se aplikanti ndodhej në gjendje shumë të mirë ekonomike. Në sistem, aplikimi rezulton i refuzuar më datë 01.11.2023.
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar pas 33 ditësh dhe është shpallur përfitues me Vendimin e DRSSH Elbasan nr. 12, datë 04.01.2024 *"Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01–31.12.2023"*. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".
Referuar datës së refuzimit, afati 6-mujor përfundonte më datë 29.04.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, aplikimi duhej të regjistrohej jo më herët se 10-ditëshi i parë i muajit maj 2024.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **86,072 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi:Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.R. P.

6.Aplikimi nr. NE-2023-022930, aplikanti: A. H. K.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar me vendimin e Drejtorisë Rajonale, datë 31.05.2023, pasi nga verifikimi automatik i pensioneve, datë 17.05.2023, rezultoi se familjarja S. K. përfitonte pension pleqërie në shumën 16,105 lekë, të cilin nuk e kishte deklaruar. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë.
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar më datë 09.06.2023 me aplikimin nr. NE-2023-022930, vetëm 10 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*. Me riaplikimin e kryer, familja është shpallur përfituese me Vendimin e Drejtorisë Rajonale nr. 6, datë 30.06.2023, duke përfituar ndihmë ekonomike në shumën 8,276 lekë në muaj.
Referuar datës së refuzimit, afati 6-mujor përfundonte më datë 26.11.2023, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, aplikimi duhej të regjistrohej jo më herët se 10-ditëshi i parë i muajit dhjetor 2023.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike për periudhën qershor–nëntor 2023 në shumën totale **62,536 lekë.**
Gjithashtu, nga verifikimi në sistem rezultoi se gjatë vitit 2023 është kryer vetëm një vizitë në banesë, ndërsa gjatë vitit 2024 nuk është kryer asnjë vizitë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z. G. L.

7.Aplikimi nr. NE-2023-026313, aplikanti: J. A. A.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes me nr. NE-2023-022929 është refuzuar pasi nga verifikimi automatik i pensioneve, datë 21.06.2023, rezultoi se z. J. A. dhe znj. L. A. përfitonin pension pleqërie, të ardhura të cilat nuk ishin deklaruar në formularin e aplikimit të datës 09.06.2023. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë dhe familja nuk ka përfituar ndihmë ekonomike mbi bazën e këtij aplikimi.

Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar më datë 07.08.2023 me aplikimin nr. NE-2023-026313, vetëm 76 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Referuar datës së refuzimit, afati 6-mujor përfundonte më datë 26.12.2023, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, aplikimi mund të regjistrohej vetëm brenda 10-ditëshit të parë të muajit janar 2024, me fillim përfitimi pas përfundimit të afatit të përjashtimit.
Nga verifikimi rezulton se familja është shpallur përfituese nga muaji shtator 2023. Për pasojë, përfitimet e marra për periudhën shtator–dhjetor 2023 rezultojnë të përfituara pa të drejtë në shumën totale **29,584 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z. G. L.

Viti 2024
1.Aplikimi nr NE-2024-012911, aplikanti:A. L.V.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 02.04.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. A. V. përfitonte pension të padeklaruar. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar me arsyetimin "*Deklarim i rremë, merr pension të padeklaruar".*
Pavarësisht refuzimit, më datë 07.05.2024 është regjistruar aplikimi nr. NE-2024-012911, vetëm 35 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Referuar datës së refuzimit, 02.04.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 29.09.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën totale **26,135 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj. V. C.
***2.*Aplikimi nr. NE-2024-013111 aplikanti: M. Z. A.**
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 01.12.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. M. A. ishte përfitues pensioni të padeklaruar. Nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit rezultoi se përfitimi i pensionit evidentohej që në verifikimin automatik të datës 17.04.2021. Për rrjedhojë, aplikimi duhej të ishte refuzuar që në momentin e konstatimit të kësaj mospërputhjeje, pasi pensioni nuk është deklaruar as në aplikimin fillestar dhe as në deklarimet periodike 3-mujore. Si pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike për periudhën 17.04.2021–01.12.2023 në shumën 189,373 lekë.
Pavarësisht refuzimit, familja ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-013111. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Referuar datës së refuzimit, 01.12.2023, afati 6-mujor përfundonte më datë 29.05.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën 6,279 lekë pas riaplikimit. Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja rezulton **195,652 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj. M. S.
3.Aplikimi nr. NE-2024-008749, aplikanti: E. Q. Ll.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes me nr. NE-2016-026392 është refuzuar më datë 04.03.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se familjarja E. Ll. përfitonte pension familjar në masën 50%, i cili nuk ishte deklaruar. Nga shqyrtimi i deklarimeve të kryera nga familja rezultoi se ky përfitim nuk është pasqyruar në deklarimin fillestar dhe as në

deklarimet periodike. Gjithashtu, nga verifikimi i modulit *"Verifikimi i pensioneve"* rezulton se ky fakt ishte evidentuar që më datë 16.11.2023. Për rrjedhojë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror duhej të kishte ndërprerë përfitimin dhe të refuzonte aplikimin që në momentin e evidentimit të mospërputhjes. Si pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike për periudhën nëntor 2023 – mars 2024 në shumën 23,904 lekë.
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar pas 3 ditësh nga data e refuzimit. Pranimi i aplikimit të ri është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*.
Referuar datës së refuzimit, 04.03.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 31.08.2024, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara kësaj date. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, përfitimi mund të fillonte vetëm pas përfundimit të afatit ndalues, pra nga muaji shtator 2024.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike për periudhën mars–gusht 2024 në shumën 40,856 lekë.
Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja rezulton **64,760 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj. R. P.
4.Aplikimi nr. NE-2024-020601, aplikanti: A. Xh. Xh.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi nr. NE-2024-018889 është refuzuar më datë 31.07.2024, pasi nga verifikimi automatik i pagave i datës 16.07.2024 rezultoi se z. A. Xh. kishte qenë i punësuar gjatë periudhës prill–qershor 2024, fakt i padeklaruar në aplikim, duke përbërë deklarim të rremë. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Për këtë aplikim nuk rezulton përfitim i ndihmës ekonomike.
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-020601 vetëm 6 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për 6 muaj në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.
Referuar datës së refuzimit, 31.07.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 27.01.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji shkurt 2025. Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit gusht 2024. Për pasojë, për periudhën gusht 2024 – janar 2025 është përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **73,152 lekë.**
Në lidhje me këtë rast, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Elbasan ka paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, sipas të cilave aplikanti ka qenë i angazhuar në punë në komunitet, në zbatim të VKM nr. 535, datë 08.07.2020. Megjithatë, ky fakt nuk ndryshon konstatimin mbi mosrespektimin e afatit 6-mujor të përjashtimit të parashikuar nga neni 15, pika 1, shkronja "ç", i Ligjit nr. 57/2019.

Viti 2025
1.Aplikimi nr. NE-2025-016777 aplikanti: L. A. M.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.03.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. O. M. ishte përfitues i një pensioni të padeklaruar. Nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit rezultoi se përfitimi i pensionit evidentohej që në verifikimin automatik të datës 11.02.2022. Për rrjedhojë, aplikimi duhej të ishte refuzuar që në momentin e konstatimit të kësaj mospërputhjeje, pasi pensioni nuk është deklaruar as në aplikimin fillestar dhe as në deklarimet periodike 3-mujore. Si pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike për periudhën 11.02.2022–28.03.2025 në shumën 261,359 lekë.

Pavarësisht refuzimit, familja ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2025-016777, datë 02.07.2025, vetëm 96 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Referuar datës së refuzimit, 28.03.2025, afati 6-mujor përfundonte më datë 24.09.2025, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara muajit tetor 2025. Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën 15,681 lekë pas riaplikimit.
Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja rezulton **277,040 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.E. Z. për riaplikimin dhe znj.L. H. për aplikimin fillestar.
2.Aplikimi nr. NE-2025-017627, aplikanti: Xh. I. B.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi nr. NE-2025-004414 është refuzuar më datë 28.03.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se anëtarë të familjes përfitonin pension pleqërie të padeklaruar. Konkretisht, nga verifikimi automatik i pensioneve, datë 25.03.2025, u evidentua se familjarët G. Sh. dhe J. B. përfitonin pension pleqërie, fakt i cili nuk ishte deklaruar në aplikim, duke përbërë deklarim të rremë sipas nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Për këtë aplikim nuk rezulton përfitim i ndihmës ekonomike.
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2025-017627 pas 102 ditësh nga data e refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.
Referuar datës së refuzimit, 28.03.2025, afati 6-mujor përfundonte më datë 24.09.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji tetor 2025. Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit korrik 2025.
Për pasojë, për periudhën korrik–shtator 2025 familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **46,320 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.A. Y.
3.Aplikimi nr. NE-2025-013160 aplikanti: M. S. T.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi nr. NE-2015-007158 është refuzuar më datë 28.03.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se familjari K. B. përfitonte pension familjar të padeklaruar. Konkretisht, nga verifikimi automatik i pensioneve, datë 25.03.2025, u evidentua se ky përfitim nuk ishte deklaruar as në aplikimin fillestar dhe as në deklarimet e mëpasshme, duke përbërë deklarim të rremë sipas nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Për këtë aplikim nuk rezulton përfitim i ndihmës ekonomike.
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2025-013160 pas 40 ditësh nga data e refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.
Referuar datës së refuzimit, 28.03.2025, afati 6-mujor përfundonte më datë 24.09.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji tetor 2025. Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit maj 2025.

Për pasojë, për periudhën maj–shtator 2025 familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **53,088 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.E. Zh.

Qarku Fier:

Viti 2023

1.Aplikimi nr NE-2023-035581, aplikanti: A. T. B.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 03.07.2023, pasi nga vizita në banesë e kryer më datë 12.06.2023 rezultoi se familja dispononte më shumë bagëti sesa kishte deklaruar në aplikim, duke përbërë deklarim të rremë sipas nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*

Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2023-035581, datë 04.12.2023, pa përfunduar afati 6-mujor i përjashtimit nga përfitimi i ndihmës ekonomike. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019. Referuar datës së refuzimit, 03.07.2023, afati 6-mujor përfundonte më datë 30.12.2023. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji janar 2024.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **4,792 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.B. L.

Viti 2024

1.Aplikimi nr. NE-2024-022316 aplikanti: P. I. D.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 22.08.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. P. D. ishte i punësuar dhe kjo e dhënë nuk ishte deklaruar në aplikim. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit rezultoi se z. P. D. evidentohej si përfitues pensioni që në verifikimin automatik të datës 16.05.2024, fakt i cili nuk ishte deklaruar në aplikimin fillestar dhe në deklarimet periodike 3-mujore. Për rrjedhojë, aplikimi duhej të ishte refuzuar që në momentin e evidentimit të kësaj mospërputhjeje. Si pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike për periudhën maj 2024 – korrik 2024 në shumën 40,416 lekë.

Pavarësisht refuzimit, familja ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-022316, datë 03.09.2024, vetëm 12 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/*2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".* Referuar datës së refuzimit, 22.08.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 18.02.2025, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara muajit mars 2025.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën 85,032 lekë pas riaplikimit. Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja rezulton **125,448 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.O. M.

***2.*Aplikimi nr. NE-2024-028800, aplikanti: A. S. K.**

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 25.09.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se familjarja I. K. kishte punësim të padeklaruar. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".

Pavarësisht refuzimit, familja ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-028800, datë 07.11.2024, vetëm 43 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i

ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.
Referuar datës së refuzimit, 25.09.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 24.03.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji prill 2025. Nga verifikimi në sistem rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **29,667 lekë.**
Gjithashtu, nga auditimi i rubrikës "*Verifikime*" rezultoi se për vitet 2021 dhe 2022 është kryer vetëm një vizitë në banesë për secilin vit, ndërsa për vitet 2023 dhe 2025 nuk rezulton asnjë vizitë. Për vitin 2024 rezulton vetëm një vizitë e kryer më datë 27.11.2024 dhe e hedhur në sistem më datë 01.07.2025. Moskryerja e vizitave në banesë sipas frekuencës së përcaktuar është në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.A. A.

Viti 2025
1.Aplikimi nr. NE-2025-021675 aplikanti: R. P. J.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 21.07.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. R. J. kishte punësim të padeklaruar. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Pavarësisht refuzimit, familja ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2025-021675, datë 08.09.2025, vetëm 49 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.
Referuar datës së refuzimit, 21.07.2025, afati 6-mujor përfundonte më datë 17.01.2026. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji shkurt 2026.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **33,760 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.D. T.
2.Aplikimi nr. NE-2025-026420 aplikanti: D. Xh. M.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 27.06.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. D. M. ishte përfitues i një pensioni të padeklaruar. Nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit rezultoi se ky përfitim evidentohej që në verifikimin automatik të datës 25.03.2025, ndërsa pensioni rezultonte i përfituar që prej vitit 2022. Për rrjedhojë, aplikimi duhej të ishte refuzuar që në momentin e evidentimit të kësaj mospërputhjeje, pasi pensioni nuk është deklaruar as në aplikimin fillestar dhe as në deklarimet periodike 3-mujore. Si pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike për periudhën shkurt–maj 2025 në shumën 84,528 lekë. Pavarësisht refuzimit, familja ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2025-026420, datë 12.11.2025, vetëm 138 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Referuar datës së refuzimit, 27.06.2025, afati 6-mujor përfundonte më datë 24.12.2025, ndaj familja nuk duhej të trajtohej si përfituese përpara muajit janar 2026.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën 38,832 lekë pas riaplikimit. Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja rezulton **123,360 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.A. A.

Qarku Gjirokastër
1.Aplikimi nr. NE-2024-019185, aplikanti: S. D. I.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 25.06.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se familjarja D. I. kishte punësim të padeklaruar për periudhën mars–maj 2024. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*". Pavarësisht refuzimit, familja ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-019185, datë 10.07.2024, vetëm 15 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.
Referuar datës së refuzimit, 25.06.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 22.12.2024. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji janar 2025. Nga verifikimi në sistem rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **40,086 lekë.**
Gjithashtu, nga auditimi i rubrikës "Verifikim" rezultoi se për vitin 2020 është kryer vetëm një vizitë në banesë, për vitin 2022 nuk rezulton asnjë vizitë, për vitin 2023 është kryer vetëm një vizitë, për vitin 2024 nuk rezulton asnjë vizitë, përfshirë vizitën fillestare, ndërsa për vitin 2025 është kryer vetëm një vizitë. Moskryerja e vizitave në banesë sipas frekuencës së përcaktuar është në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Në lidhje me këtë rast, Drejtoria Rajonale Gjirokastër ka paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, sipas të cilave familjarja ka qenë e angazhuar në programet e nxitjes së punësimit në zbatim të VKM nr. 535, datë 08.07.2020. Megjithatë, ky fakt nuk ndryshon konstatimin mbi mosrespektimin e afatit 6-mujor të përjashtimit të parashikuar nga neni 15, pika 1, shkronja "ç", i Ligjit nr. 57/2019.

Qarku Tiranë
Viti 2023
1.Aplikimi nr. NE-2023-034017, aplikanti: N. Xh.M.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 27.06.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi mospërputhje ndërmjet strukturës së familjes në sistemin e Ndihmës Ekonomike dhe asaj në sistemin e DPGJC-së, ku një prej anëtarëve të familjes nuk rezultonte i regjistruar në sistemin e DPGJC-së. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*".
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2023-034017, datë 07.11.2023, vetëm 133 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 27.06.2023, afati 6-mujor përfundonte më datë 24.12.2023. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji janar 2024. Nga verifikimi në sistem rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **7,406 lekë.**
Gjithashtu, nga auditimi i rubrikës "*Verifikime"* rezultoi se për periudhën 2020–2023 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë. Po ashtu, për aplikimin e ri nuk rezulton vizitë fillestare për vitin 2023, ndërsa për vitet 2024 dhe 2025 është kryer vetëm nga një vizitë. Moskryerja e vizitave në banesë sipas frekuencës së përcaktuar është në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM

nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar. Në lidhje me këtë rast, Drejtoria Rajonale Tiranë ka paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, sipas të cilave djali i aplikantit është larguar nga trungu familjar për shkak të kushteve të vështira ekonomike. Megjithatë, ky fakt nuk ndryshon konstatimin mbi mosrespektimin e afatit 6-mujor të përjashtimit të parashikuar nga neni 15, pika 1, shkronja "ç", i Ligjit nr. 57/2019.

2.Aplikimi nr. NE-2023-030160, aplikanti: A. H. D.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 21.07.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. A. D. ishte përfitues pensioni, të ardhur e cila nuk ishte deklaruar në formularin e aplikimit. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*

Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2023-030160, datë 03.10.2023, vetëm 74 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 21.07.2023, afati 6-mujor përfundonte më datë 17.01.2024. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji shkurt 2024. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **23,524 lekë.**

Gjithashtu, nga verifikimi në sistem rezulton se nuk është kryer vizita fillestare në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.S. K.

3.Aplikimi nr. NE-2023-019746, aplikanti: U. H. K.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 03.04.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se znj. R. K. ishte e punësuar dhe përfituese page, të ardhur e cila nuk ishte deklaruar në formularin e aplikimit. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*

Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2023-019746, datë 10.05.2023, vetëm 37 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 03.04.2023, afati 6-mujor përfundonte më datë 30.09.2023. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji tetor 2023. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **65,160 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.G. M.

4.Aplikimi nr. NE-2023-033506, aplikanti: A. H. C.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.09.2023, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. A. C. kishte në pronësi një mjet motorik, i cili nuk ishte deklaruar në formularin e aplikimit. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*

Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2023-033506, datë 06.11.2023, vetëm 39 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i

ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 28.09.2023, afati 6-mujor përfundonte më datë 26.03.2024. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji prill 2024. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **65,160 lekë.**
Gjithashtu, nga auditimi i rubrikës "Verifikim" rezultoi se për vitin 2023 dhe për vitin 2025 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Në lidhje me këtë rast, Drejtoria Rajonale Tiranë ka paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, sipas të cilave mjeti rezulton jashtë përdorimit dhe është paraqitur kërkesë pranë DPSHTRR-së për çregjistrimin e tij. Megjithatë, këto rrethana nuk janë pasqyruar në sistem dhe aplikanti nuk ka deklaruar ekzistencën e mjetit në formularin e aplikimit, ndaj qëndron konstatimi për deklarim të rremë dhe mosrespektim të afatit 6-mujor të përjashtimit.

Viti 2024

1.Aplikimi nr. NE-2024-023170, aplikanti: E. S. M.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 25.07.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se struktura e familjes në sistemin e Ndihmës Ekonomike nuk përputhej me strukturën e familjes në sistemin e DPGJC-së. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*.
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-023170, datë 09.09.2024, vetëm 46 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 25.07.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 21.01.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji shkurt 2025. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **70,560 lekë.**
Në lidhje me këtë rast, Drejtoria Rajonale Tiranë ka paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, sipas të cilave djali i kryefamiljarit ishte larguar nga banesa për shkak të kushteve të vështira ekonomike, por ky ndryshim nuk ishte reflektuar në strukturën familjare të regjistruar në DPGJC. Megjithatë, për sa kohë mospërputhja e strukturës familjare ka rezultuar e evidentuar nga verifikimet automatike të sistemit dhe ka sjellë refuzimin e aplikimit, qëndron konstatimi mbi mosrespektimin e afatit 6-mujor të përjashtimit të parashikuar nga neni 15, pika 1, shkronja "ç", i Ligjit nr. 57/2019.

2.Aplikimi nr. NE-2024-012939, aplikanti: A. C.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.03.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. A. C. kishte në pronësi një mjet motorik, i cili nuk ishte deklaruar në formularin e aplikimit. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*.
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-012939, datë 07.05.2024, vetëm 40 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 28.03.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë

24.09.2024. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji tetor 2024. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **46,800 lekë.**
Gjithashtu, nga auditimi i rubrikës "Verifikim" rezultoi se për vitin 2022 është kryer vetëm një vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për aplikimin e parë znj.V. B. dhe për riaplikimin znj.L. B.
3.Aplikimi nr. NE-2024-030561, aplikanti: Zh. P. N.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 31.10.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se struktura e familjes në sistemin e Ndihmës Ekonomike nuk përputhej me strukturën e familjes në sistemin e DPGJC-së, konkretisht anëtari A. J. nuk rezultonte pjesë e strukturës familjare. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-030561, datë 04.12.2024, vetëm 34 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.
Referuar datës së refuzimit, 31.10.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 29.04.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji maj 2025. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **27,880 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për aplikimin e parë znj.N. H.
4.Aplikimi nr. NE-2024-015352, aplikanti: F. I. K.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.03.2024, pasi nga verifikimi i kryer nëpërmjet vizitës në banesë rezultoi se kryefamiljari ndodhej jashtë shtetit, duke sjellë refuzimin e aplikimit për deklarim të rremë. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-015352, datë 05.06.2024, vetëm 69 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 28.03.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 24.09.2024. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji tetor 2024. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **20,908 lekë.**
Gjithashtu, nga auditimi i rubrikës "*Verifikime*" rezultoi se për periudhën 2018–2024 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë, me përjashtim të vizitës së datës 28.03.2024, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për aplikimin e parë z.S. P. dhe për riaplikimin z. K. S.

5.Aplikimi nr. E-2024-031184, aplikanti: A. M. B.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 31.10.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se znj. S. B. kishte qenë e punësuar, fakt i cili nuk ishte deklaruar në formularin e aplikimit. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-031184, datë 06.12.2024, vetëm 36 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 31.10.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 04.06.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji qershor 2025. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **49,560 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për riaplikimin znj.D. H.

Viti 2025
1.Aplikimi nr. NE-2025-006501, aplikanti: B. Z. M.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 27.09.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se znj. Xh. M. përfitonte pension në shumën 9,327 lekë, të ardhur e cila nuk ishte deklaruar në formularin e aplikimit. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2025-006501, datë 10.02.2025, vetëm 136 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 27.09.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 26.03.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji prill 2025. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në **shumën 4,356 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për riaplikimin znj.M. R.
2.Aplikimi nr. NE-2025-003768, aplikanti: L. O. A.
Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 23.12.2024, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se z. L. A. zotëronte një automjet, i cili nuk ishte deklaruar në formularin e aplikimit. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2025-003768, datë 14.01.2025, vetëm 22 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 23.12.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 21.06.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji korrik 2025. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.

Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **95,112 lekë.**
Në lidhje me këtë rast, Drejtoria Rajonale Tiranë ka paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, sipas të cilave automjeti nuk është në gjendje pune dhe nuk është kryer çregjistrimi i tij nga aplikanti. Megjithatë, për sa kohë automjeti rezultonte i regjistruar në pronësi të aplikantit dhe nuk ishte deklaruar në formularin e aplikimit, qëndron konstatimi për deklarim të rremë dhe mosrespektim të afatit 6-mujor të përjashtimit të parashikuar nga neni 15, pika 1, shkronja "ç", i Ligjit nr. 57/2019.

3.Aplikimi nr. NE-2025-026541, aplikanti: A. Q. B.

Nga auditimi konstatohet se aplikimi i familjes është refuzuar më datë 28.08.2025, pasi nga verifikimet automatike të sistemit rezultoi se struktura e familjes në sistemin e Ndihmës Ekonomike nuk përputhej me strukturën e familjes në sistemin e DPGJC-së. Për rrjedhojë, aplikimi është refuzuar për deklarim të rremë, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".*
Pavarësisht refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2025-026541, datë 12.11.2025, vetëm 76 ditë pas refuzimit. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Referuar datës së refuzimit, 28.08.2025, afati 6-mujor përfundonte më datë 24.02.2026. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji mars 2026. Nga verifikimi rezulton se familja është trajtuar si përfituese përpara përfundimit të afatit të përjashtimit.
Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë ndihmë ekonomike në shumën **37,460 lekë.**
Gjithashtu, nga auditimi i rubrikës "*Verifikime*" rezultoi se për vitin 2025 nuk është kryer asnjë vizitë në banesë, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për aplikimin fillestar dhe riaplikimin znj.S. S.

4.Aplikimi nr. NE-2025-027988, aplikanti: A. Z. B.

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "*Mosdeklarimit të pagës*" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 26.09.2025, përmes modulit "*Verifikim i punësimit"* rezulton se Sh. B. është e punësuar. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 30.09.2025.
Pas 65 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, me aplikimin nr. NE-2025-027988, datë 04.12.2025. Pranimi i aplikimit pas 65 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç". Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm. Nuk ka asnjë vizitë në shtëpi, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 30.09.2025, ku afati përfundonte më datë 28.03.2026. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 28.03.2026, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Prill 2026 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **25,924 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për riaplikimin znj.B. K.

***5*.Aplikimi nr. NE-2025-019171, aplikanti: G. I. J.**

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "*mosdeklarimit të pagës"* është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 19.09.2025, përmes modulit "Verifikim i punësimit" rezulton se G. J. është i punësuar. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 25.06.2025.

Pas 41 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, me aplikimin nr. NE-2025-019171, datë 05.08.2025. Pranimi i aplikimit pas 41 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç". Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm. Nuk ka asnjë vizitë në shtëpi, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 25.06.2025, ku afati përfundonte më datë 22.12.2025. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 22.12.2025, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Janar 2026 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **44,064 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për riaplikimin znj.A. M.

Qarku Shkodër
Viti 2023
1.Aplikimi nr. NE-2023-012075, aplikanti: M. Gj. H.
Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "mosdeklarim page" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 17.02.2023, përmes modulit "Verifikim i punësimit" rezulton se M. H nuk ka deklaruar pagën për 3 muaj. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 27.02.2023. Nga data 10.11.2022 deri më datën 27.02.2023 nuk ka asnjë vizitë në shtëpi, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Pas 10 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, me aplikimin nr. NE-2023-012075, datë 08.03.2023. Pranimi i aplikimit pas 10 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", ku përcaktohet përjashtimi 6-mujor në rast fshehjeje informacioni apo deklarimi të rremë. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 27.02.2023, ku afati përfundonte më datë 26.09.2023. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 26.09.2023, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Shtator 2023 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **22,218 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.K. K. (për aplikimin fillestar) dhe z.J. N. (për riaplikimin).
2.Aplikimi nr. NE-2023-032680, aplikanti: L. P. G.
Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "mosdeklarim page" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 21.09.2023, përmes modulit "Verifikim i pagave" rezulton se E. G.nuk ka deklaruar pagën për 3 muaj. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 02.10.2023.
Pas 30 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, me aplikimin nr. NE-2023-032680, datë 01.11.2023. Pranimi i aplikimit pas 30 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", ku përcaktohet përjashtimi 6-mujor në rast fshehjeje informacioni apo deklarimi të rremë.
Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Gjithashtu për vitin 2024 nuk ka asnjë vizitë në shtëpi, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.

Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 02.10.2023, ku afati përfundonte më datë 30.03.2024. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 30.03.2024, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Prill 2024 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **37,025 lekë**.
Në sistemin elektronik të NE, konstatohet nga grupi i auditimit se kontrolluesi në modulin "Dëmi Ekonomik" ka konstatuar dëm për këtë aplikant në vlerën 29,620 për periudhën 01.11.2023-29.02.2024. Në këtë vlerë nuk është përfshirë dhe muaji Mars 2024, duke qenë se riaplikimi nuk duhet të ishte kryer përpara datës 30.03.2024.
Në lidhje me këtë aplikim, nga ana e Drejtorisë Rajonale Shkodër janë paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, nga të cilat rezulton se dëmi është konstatuar dhe nga ana e Drejtorisë Rajonale paraprakisht.

3.Aplikimi nr. NE-2023-037433, aplikanti: V. Gj. V.

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "mosdeklarim vendbanimi" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 17.11.2023, përmes modulit "Verifikim i vendbanimit" rezulton se V. V. nuk ka deklaruar vendbanimin. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 01.12.2023. Nga periudha 09.10.2023-01.12.2023 nuk ka patur vizitë fillestare, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Pas 11 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, me aplikimin nr. NE-2023-037433, datë 12.12.2023. Pranimi i aplikimit pas 11 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", ku përcaktohet përjashtimi 6-mujor në rast fshehjeje informacioni apo deklarimi të rremë. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Gjithashtu nuk ka asnjë vizitë në shtëpi, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 01.12.2023, ku afati përfundonte më datë 29.05.2024. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 29.05.2024, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Prill 2024 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **53,579 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për të dyja aplikimet z.F. V.

Viti 2024

1.Aplikimi nr. NE-2024-009650, aplikanti: Y. I. K.

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "mosdeklarim page" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 20.12.2023, përmes modulit "Verifikim i pagave" rezulton se Y. K. nuk ka deklaruar pagën. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 28.12.2023. Për vitin 2020 nuk ka asnjë vizitë, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Pas 96 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, me aplikimin nr. NE-2024-009650, datë 02.04.2024. Pranimi i aplikimit pas 96 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", pasi aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Për vitin 2024 ka 1 vizitë, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 28.12.2023, ku afati përfundonte më datë 26.06.2025. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 26/06/2024,

familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Korrik 2024 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **26,544 lekë**.
Në lidhje me këtë aplikim, nga ana e Drejtorisë Rajonale Shkodër janë paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, nga të cilat rezulton se dëmi është konstatuar dhe nga ana e Drejtorisë Rajonale paraprakisht.

2.Aplikimi nr. NE-2024-009157, aplikanti: N. P. M.

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "mosdeklarim i vizitës në familje, kryefamiljari ndodhet jashtë vendit" është refuzuar. Nga vizitat në shtëpi që ndodhen në sistem rezulton se: në vitin 2021 ka patur 1 vizitë datë 12.03.2021 hedhur në sistem në të njëjtën datë. Në vitin 2022 ka patur një vizitë datë 17.05.2022, hedhur në sistem në të njëjtën datë. Në vitin 2023 ka patur 2 vizita. Vizita e kryer datë 31.01.2023 hedhur në sistem në të njëjtën datë, vizita e dytë 19.09.2023 hedhur në sistem në të njëjtën datë. Nga vizita e fundit rezulton se kryefamiljari ndodhet jashtë vendit. Për këtë arsye më 02.10.2023 ky aplikim është refuzuar. Moskryerja e vizitave në shtëpi 2 herë në vit është në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Pas 158 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-009157, datë 08.03.2024. Pranimi i aplikimit pas 158 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", pasi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 02.10.2023, ku afati përfundonte më datë 30.03.2024. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 30.03.2024, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Prill 2024 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **5,881 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për aplikimin e parë z.B. P. dhe për riaplikimin znj.L.N.

3.Aplikimi nr. NE-2024-006358, aplikanti: M. Gj. K.

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "mosdeklarim mjeti" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 17.11.2023, përmes modulit "Verifikim i mjeteve motorrike" rezulton se A. K., anëtar i familjes, nuk ka deklaruar mjetin motorik. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 01.12.2023.
Pas 70 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2024-006358, datë 09.02.2024. Pranimi i aplikimit është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", ku përcaktohet përjashtimi 6-mujor në rast fshehjeje informacioni apo deklarimi të rremë. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 01.12.2023, ku afati përfundonte më datë 29.05.2024. Në rastin konkret, duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 29.05.2024, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Korrik 2024 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **16,552 lekë**.
Në lidhje me këtë aplikim, nga ana e Drejtorisë Rajonale Shkodër janë paraqitur objeksione dhe dokumentacion mbështetës, nga të cilat rezulton se dëmi është konstatuar dhe nga ana e Drejtorisë Rajonale paraprakisht.

Viti 2025

1.Aplikimi nr. NE-2025-026293, aplikanti: Z. H. R.

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "mosdeklarim page" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 26.09.2025, përmes modulit "Verifikim i pagave" rezulton se M. R. nuk ka deklaruar pagën. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 01.10.2025. Për vitin 2025 nuk ka asnjë vizitë, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.

Pas 41 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, konkretisht me aplikimin nr. NE-2025-026293, datë 11.11.2025, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", ku përcaktohet përjashtimi 6-mujor në rast fshehjeje informacioni apo deklarimi të rremë. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.

Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 01.10.2025, ku afati përfundonte më datë 30.03.2026. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 30.03.2026, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Prill 2026 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **8,712 lekë**.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për të dyja aplikimet znj.F. H.

2.Aplikimi nr. NE-2025-028717, **aplikanti:** D. H. Zh.

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "mosdeklarim biznesi, nuk deklaron pagë/të ardhura" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 22.07.2025, përmes modulit *"Verifikim i pagave"* rezulton se G. Zh. nuk ka deklaruar pagën. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 31.07.2025.

Pas 134 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, konkretisht me aplikimin nr. NE-2025-028717, datë 12.12.2025, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", ku përcaktohet përjashtimi 6-mujor në rast fshehjeje informacioni apo deklarimi të rremë. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.

Nuk ka vizita në shtëpi, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.

Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 31.07.2025, ku afati përfundonte më datë 27.01.2026. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 27.01.2026, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Shkurt 2026 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **11,762 lekë**.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për riaplikimin znj.E. L.

3.Aplikimi nr. NE-2025-027411, aplikanti: Gj. K. N.

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të "mosdeklarim i strukturës së familjes" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 15.10.2025, përmes modulit "Verifikim i strukturës së familjes" rezulton se struktura e familjes në sistemin e NE nuk është e njëjtë me sistemin e familjes në DPGJC. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 30.10.2025. Në sistem është shënimi: N. N. fëmija i lindur me 29.07.2025.

Për vitin 2020 dhe 2021 nuk ka vizita. Për vitin 2022-2024 vetëm një vizitë në vit. Në vitin 2025 nuk ka asnjë vizitë. Moskryerja e vizitave në shtëpi 2 herë në vit është në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.

Pas 33 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2025-027411, datë 02.12.2025. Pranimi i aplikimit pas 33 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu

IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", ku përcaktohet përjashtimi 6-mujor në rast fshehjeje informacioni apo deklarimi të rremë. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Nuk ka vizitë fillestare, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit 30.10.2025, ku afati përfundonte më datë 28.04.2026. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 28.04.2026, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Maj 2026 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **61,236 lekë**.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për aplikimin e parë z.E. P. dhe për riaplikimin z.A. P.

4.Aplikimi nr. NE-2025-022373, aplikanti: A. T. V.

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak "mosdeklarim page" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 21.04.2025, përmes modulit "Verifikim i pagave" rezulton se M. V.është e punësuar. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 30.04.2025
Pas 133 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, konkretisht me aplikimin nr. NE-2025-022373, datë 10.09.2025, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", ku përcaktohet përjashtimi 6-mujor në rast fshehjeje informacioni apo deklarimi të rremë. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Nuk ka vizitë fillestare, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 30.04.2025, ku afati përfundonte më datë 27.10.2025. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 27.10.2025, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Nëntor 2025 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **12,962 lekë**.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi:
Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për të dyja aplikimet z.F. V.

5.Aplikimi nr. NE-2025-027934, aplikanti: G. N. D.

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkakun "*mosdeklarim i saktë page*" është refuzuar. Nga verifikimet automatike të sistemit datë 26.09.2025, përmes modulit "Verifikim i pagave" rezulton se V. D. nuk ka deklaruar pagën e saktë. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 01.10.2025. Nuk ka vizita nga periudha 10.06.2022-01.10.2025, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Pas 64 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, konkretisht me **aplikimin nr. NE-2025-027934,** datë 04.12.2025. Pranimi i aplikimit pas 64 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç", ku përcaktohet përjashtimi 6-mujor në rast fshehjeje informacioni apo deklarimi të rremë. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Nuk është kryer vizita fillestare, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 04.12.2025, ku afati përfundonte më datë 29.03.2026. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 29.03.2026, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Prill 2026 (efekti financiar nga muaji

pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **14,376 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për të dyja aplikimet znj. A. K.

Qarku Vlorë
Viti 2023

1. **Aplikimi nr. NE-2023-035027, aplikanti: F. T. G.**

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të mosdeklarimit të pagës refuzohet nga ndihma ekonomike. Nga verifikimet automatike të sistemit grupi i auditimit konstaton se më datë 11.10.2023 znj. M. G. përmes modulit "Verifikimi i pagave", rezulton e punësuar, për këtë arsye është refuzuar nga sistemi datë 23.10.2023.
Pas 18 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, me aplikimin nr. NE-2023-035027, datë 10.11.2023. Pranimi i aplikimit pas 18 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç". Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 23.10.2023, ku afati përfundonte më datë 20.04.2024. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 20.04.2024, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Maj 2024 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **22,218 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.R. Xh.

Viti 2024

1. **Aplikimi nr. NE-2024-031662, aplikanti: N. R. B.**

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të mosdeklarimit të pagës refuzohet nga ndihma ekonomike. Nga verifikimet automatike të sistemit grupi i auditimit konstaton se më datë 11.10.2024 znj. M. G. përmes modulit "Verifikimi i pagave", rezulton e punësuar, për këtë arsye është refuzuar nga sistemi datë 28.10.2024.
Pas 43 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, me aplikimin nr. NE-2024-031662, datë 10.12.2024. Pranimi i aplikimit pas 43 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç". Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 28.10.2024, ku afati përfundonte më datë 26.04.2025. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 26.04.2025, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Maj 2025 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **36,640 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.R. Xh..

Viti 2025

1. **Aplikimi nr. NE-2025-017934, aplikanti: L. H. L.**

Aplikanti ka pasur një aplikim, i cili për shkak të mosdeklarimit të pensionit refuzohet nga ndihma ekonomike. Nga verifikimet automatike të sistemit grupi i auditimit konstaton se më

datë 20.06.2025 z.L. L. përmes modulit "*Verifikimi i pensionit*", rezulton i punësuar, për këtë arsye është refuzuar nga sistemi datë 30.06.2025.
Pas 9 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, me aplikimin nr. NE-2025-017934, datë 09.07.2025. Pranimi i aplikimit pas 9 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç". Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 30.06.2025, ku afati përfundonte më datë 27.12.2025. Duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 27.12.2025, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji Janar 2026 (efekti financiar nga muaji pasardhës sipas procedurës së miratimit). Për pasojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **18,294 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.E. F.

Qarku Berat
1.Aplikimi nr. NE-2023-010160, aplikanti: V. Q. S.
Aplikanti ka pasur një aplikim të mëparshëm, i cili është refuzuar për shkak të mosdeklarimit të saktë të pagës. Nga verifikimet automatike të sistemit rezulton se, në deklarimin fillestar me nr. NE-2022-034785-2022110, z. V. S. ka deklaruar pagë në shumën 12,000 lekë. Ndërkohë, nga verifikimi automatik i pagave rezulton se paga mbi të cilën janë llogaritur kontributet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet si më poshtë:

- Periudha 22/10 – 34,000 lekë;
- Periudha 22/09 – 34,000 lekë;
- Periudha 22/08 – 32,000 lekë;
- Periudha 22/07 – 8,727 lekë.

Për sa më sipër, konstatohet se të ardhurat nga punësimi nuk janë deklaruar saktë nga aplikanti, duke përbërë deklarim të rremë të të dhënave. Për këtë arsye, më datë 30.11.2022 aplikimi është evidentuar në sistem me statusin "*i refuzuar",* në zbatim të pikës 1, shkronja "ç", të nenit 15 të ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar.
Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se aplikanti ka riaplikuar pas 92 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm, konkretisht me aplikimin nr. NE-2023-010160, datë 02.03.2023. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e pikës 1, shkronja "ç", të nenit 15 të ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 30.11.2022, ku afati përfundonte më datë 29.05.2023. Duke qenë se aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10 ditëve të para të muajit, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, rezulton se përfitimi duhej të fillonte vetëm pas përfundimit të afatit ndalues 6-mujor.
Në rastin konkret, duke qenë se afati 6-mujor përfundonte më datë 29.05.2023, familja duhej të trajtohej për përfitim jo më herët se muaji qershor 2023. Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është trajtuar si përfitues para përfundimit të afatit ligjor të penalizimit. Për pasojë, përfitimet e marra në kundërshtim me këtë afat konsiderohen të përfituara padrejtësisht.
Për rrjedhojë, familja ka përfituar pa të drejtë pagesën e ndihmës ekonomike në shumën totale **16,952 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z. E. F.
2.Aplikimi nr. NE-2023-018801, aplikanti: A. R. H.

Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. A. H. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2021-024015, i cili është refuzuar më datë 27.04.2023 për shkak se kryefamiljari ka ndërruar jetë. Në aplikimin e refuzuar, në menunë *"Verifikime*" rezulton se nga vizita në shtëpi më datë 12.04.2023 është evidentuar se kryefamiljari ka ndërruar jetë. Gjithashtu konstatohet se në deklarimin e fundit të datës 01.03.2023 familjarët nuk kanë deklaruar këtë ndryshim. Nga verifikimet automatike në sistem, konkretisht në atë të datës 18.04.2023, është shfaqur "Nuk ka lidhje me DPGJC", duke mos mundësuar konfirmimin e plotësisë së strukturës familjare, çka ka çuar në refuzimin e aplikimit më datë 27.04.2023. Ndërkohë, nga verifikimi automatik i datës 20.03.2023 rezulton se "*Struktura e familjes në sistemin e NE është e njëjtë me strukturën e familjes në sistemin e DPGJC*". Sa më sipër, konstatohet se verifikimet automatike nuk kanë evidentuar në kohë faktin e ndryshimit të gjendjes civile (ndërrimi jetë i kryefamiljarit). Në deklarimin e ri me nr. NE-2023-018801, datë 08.05.2023, aplikimi është kryer në emër të kryefamiljarit, ndërkohë që ky i fundit është evidentuar se ka ndërruar jetë, që në vizitën në shtëpi të datës 12.04.2023. Pavarësisht se statusi i aplikimit rezulton "Draft", ky aplikim nuk duhej të ishte pranuar në sistem, duke paraqitur risk për regjistrim dhe trajtim të të dhënave jo të sakta mbi përfituesin.
Nga verifikimi i aplikimit të ri në status "*Draft",* në *menunë "Kompensimi i energjisë elektrike"* evidentohet se është kryer kompensim për muajin korrik 2024 në shumën 1,288 lekë, për kontratën nr. C50780, në emër të zj. B. H. (bashkëshortja e të ndjerit), duke e bërë të paqartë bazën mbi të cilën është përfituar ky kompensim. Konstatohet se nuk rezultojnë përfitime të tjera nga ndihma ekonomike, përveç këtij kompensimi të energjisë elektrike, çka përbën një risk në drejtim të saktësisë dhe ligjshmërisë së trajtimit të këtij përfitimi.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.N. D.

Qarku Kukës
Viti 2023
1.Aplikimi nr. NE-2023-02488, aplikanti: A. M. I.
Aplikanti ka pasur një aplikim të mëparshëm, i cili është refuzuar për shkak të mosdeklarimit të pagës së z. A. M. I., i cili ka qenë i punësuar pranë subjektit "*A"*, për periudhën shkurt–maj 2023, me pagë mujore 40,000 lekë, mbi të cilën janë llogaritur kontribute shoqërore dhe shëndetësore në shumën 11,160 lekë.
Nga verifikimi në sistem i aplikimit të refuzuar me nr. NE-2017-041812 rezulton se, në bazë të verifikimeve automatike të kryera më datë 22.06.2023, është evidentuar se z. A. M. I. ka qenë i punësuar për periudhën shkurt–maj 2023. Gjithashtu, nga verifikimi automatik i pagave i datës 20.03.2023 rezulton se i njëjti shtetas ka qenë i punësuar që në muajin shkurt 2023. Pavarësisht evidentimit të këtij fakti nga sistemi, nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Kukës nuk janë marrë masa për ndërprerjen e përfitimit të ndihmës ekonomike që në momentin e evidentimit të parë të punësimit, në kundërshtim me pikën 4, shkronjat "a" dhe "b", të nenit 20 të ligjit nr. 57/2019, i ndryshuar.
Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti ka qenë i punësuar dhe ka përfituar të ardhura nga punësimi, të cilat nuk janë deklaruar as në deklarimin fillestar dhe as në deklarimet periodike 3-mujore. Për rrjedhojë, aplikimi duhej të refuzohej që në muajin mars 2023, si pasojë e deklarimit të rremë të të dhënave, bazuar në pikën 1, shkronja "ç", të nenit 15 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
Në këto kushte, familja nuk duhej të përfitonte ndihmë ekonomike për periudhën mars–prill 2023. Për pasojë, përfitimet e marra gjatë kësaj periudhe, së bashku me pagesat shtesë përkatëse, në shumën totale 35,664 lekë, konsiderohen të përfituara padrejtësisht.

Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se aplikanti ka riaplikuar pas 7 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm, konkretisht me aplikimin nr. NE-2023-02488. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e pikës 1, shkronja "ç", të nenit 15 të ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.

Duke qenë se refuzimi është dhënë më datë 03.07.2023, aplikimi i ri mund të kryhej vetëm pas përfundimit të këtij afati, pra pas datës 30.12.2023. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, ku përcaktohet se administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat përkatëse brenda 10 ditëve të para të muajit, rezulton se aplikimi mund të regjistrohej vetëm gjatë 10-ditëshit të parë të muajit janar 2024, me fillim përfitimi nga ky muaj.

Nga verifikimi në sistem rezulton se me Vendimin e DRSSH Kukës nr. 129, datë 27.07.2023, "*Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01.07.2023–31.07.2023*", aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit korrik 2023. Duke qenë se nuk është respektuar afati 6-mujor i penalizimit, përfitimet e marra për periudhën korrik 2023 – dhjetor 2023 konsiderohen të përfituara padrejtësisht, në shumën 104,592 lekë.

Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja është **140,256 lekë**, e përbërë nga:

- 35,664 lekë përfitim i padrejtë për shkak të mosndërprerjes së përfitimit pas evidentimit të punësimit;
- 104,592 lekë përfitim i padrejtë si pasojë e pranimit të aplikimit të ri pa përfunduar afati 6-mujor i penalizimit.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror për aplikimin fillestar z.B. B. dhe për riaplikimin z.B.S.

***2.*Aplikimi nr. NE-2023-013129, aplikanti: E. L. M.**

Aplikanti ka pasur një aplikim të mëparshëm, i cili është refuzuar për shkak të mosdeklarimit të pagës së z. E. M., i cili rezulton i punësuar pranë Bashkisë Kukës për periudhën shkurt 2022 – janar 2023. Nga verifikimi në sistem i aplikimit të refuzuar me nr. NE-2022-037281 rezulton se arsyeja e përfundimit të përfitimit lidhet me mosdeklarimin e pagës. Në dokumentacionin e aplikimit evidentohet emri A.M., ndërkohë që nga verifikimet në sistem dhe në menunë "Verifikime" rezulton se personi i evidentuar nga sistemi është z. E. M. Nga verifikimi në rubrikën *"Anëtarët e familjes*" konstatohet se për të gjithë anëtarët e familjes mbi 16 vjeç është deklaruar se nuk kanë qenë të punësuar gjatë 4 javëve të fundit. Ndërkohë, nga verifikimi automatik i pagave rezulton se z. E. M. ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Kukës për periudhën shkurt 2022 – janar 2023, me pagë mbi të cilën janë llogaritur kontributet në shumën 35,360 lekë dhe me kontribute shoqërore e shëndetësore në shumën 9,865 lekë. Më tej, nga verifikimi automatik i datës 15.02.2023 rezulton se punësimi i z. E. M. ishte evidentuar nga sistemi që në datën 15.11.2022. Pavarësisht këtij evidentimi, nuk rezulton të jenë marrë masa për ndërprerjen e përfitimit të ndihmës ekonomike. Për rrjedhojë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror duhej të kishte ndërprerë përfitimin që në momentin e evidentimit të parë të punësimit, konkretisht në datën 15.11.2022, dhe jo më datë 28.02.2023.

Për sa më sipër, konstatohet se aplikanti ka deklaruar në mënyrë të rreme të dhënat mbi punësimin e anëtarëve të familjes, në kundërshtim me pikën 1, shkronja "ç", të nenit 15 të ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar. Si pasojë, familja ka përfituar ndihmë ekonomike në mënyrë të padrejtë për periudhën nëntor 2022 – janar 2023, në shumën 43,956 lekë. Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se aplikanti ka riaplikuar pas 10 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm, konkretisht me aplikimin nr. NE-2023-013129. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e pikës 1, shkronja "ç", të nenit 15 të ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale*

në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm.
Duke qenë se refuzimi është dhënë më datë 28.02.2023, aplikimi i ri mund të kryhej vetëm pas përfundimit të këtij afati, pra pas datës 27.08.2023. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, ku përcaktohet se administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat përkatëse brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit, rezulton se aplikimi mund të regjistrohej vetëm në 10-ditëshin e parë të muajit shtator 2023, me fillim përfitimi nga ky muaj.
Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues përpara përfundimit të afatit ligjor të penalizimit. Për pasojë, përfitimet e marra për periudhën mars – gusht 2023 konsiderohen të përfituara padrejtësisht, në shumën 88,704 lekë.
Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja është **132,660 lekë** (43,956 lekë + 88,704 lekë).
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi:Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. E. Z.
3.Aplikimi nr. NE-2023-001554, aplikanti: S. H. P.
Aplikanti ka pasur një aplikim të mëparshëm, i cili është refuzuar për shkak të mosdeklarimit të pagës së znj. E. P., e cila ka qenë e punësuar pranë subjektit "*Sh.*" për periudhën mars–tetor 2022. Nga verifikimi në sistem i aplikimit të refuzuar me nr. NE-2021-008962 rezulton se, në bazë të verifikimeve automatike të pagave të datave 18.05.2022, 28.09.2022 dhe 16.12.2022, është evidentuar se znj. E. P. ka qenë e punësuar dhe ka përfituar të ardhura nga punësimi, të cilat nuk janë deklaruar as në deklarimin fillestar dhe as në deklarimet periodike 3-mujore. Pavarësisht evidentimit të përsëritur të këtij informacioni nga sistemi, nuk rezulton të jenë marrë masa në kohë për ndërprerjen e përfitimit të ndihmës ekonomike. Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Kukës duhej të ishte bërë ndërprerja e përfitimit që në evidentimin e parë të punësimit, konkretisht në muajin maj 2022, në zbatim të pikës 4, shkronjat "a" dhe "b", të nenit 20 të ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar.
Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti ka qenë i punësuar dhe ka përfituar të ardhura nga punësimi, të cilat nuk janë deklaruar. Për rrjedhojë, aplikimi duhej të refuzohej që në muajin maj 2022, si pasojë e deklarimit të rremë të të dhënave, bazuar në pikën 1, shkronja "ç", të nenit 15 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në këto kushte, familja nuk duhej të përfitonte ndihmë ekonomike për periudhën maj 2022 – nëntor 2022. Për pasojë, përfitimet e marra në këtë periudhë, në shumën 56,642 lekë, konsiderohen të përfituara padrejtësisht.
Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se aplikanti ka riaplikuar pas 14 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm, konkretisht me aplikimin nr. NE-2023-001554. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e pikës 1, shkronja "ç", të nenit 15 të ligjit nr. 57/2019. Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm. Duke qenë se refuzimi është dhënë më datë 23.12.2022, aplikimi i ri mund të kryhej vetëm pas përfundimit të këtij afati, pra pas datës 21.06.2023. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, ku përcaktohet se administratori shoqëror hedh të dhënat në Regjistrin Elektronik Kombëtar brenda 10 ditëve të para të muajit, rezulton se aplikimi mund të regjistrohej vetëm gjatë 10-ditëshit të parë të muajit korrik 2023, me fillim përfitimi nga ky muaj. Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues për periudhën janar–qershor 2023, në kundërshtim me afatin ligjor të penalizimit. Për pasojë, përfitimet e marra gjatë kësaj periudhe, në shumën 55,848 lekë, konsiderohen të përfituara padrejtësisht.
Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja është **112,490 lekë** (56,642 lekë + 55,848 lekë).

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.F. B.

4.Aplikimi nr. NE-2023-003296, aplikanti: I. B. K.

Aplikanti ka pasur një aplikim të mëparshëm, i cili është refuzuar për shkak të mosdeklarimit të pensionit të znj. S. K., përfituese e pensionit të pleqërisë së pjesshme, me vlerë përfitimi 8,588 lekë dhe me status "*Dosje e konfirmuar".*

Nga verifikimi në sistem i aplikimit të refuzuar me nr. NE-2017-038636 rezulton se arsyeja e përfundimit të përfitimit lidhet me mosdeklarimin e pensionit. Nga shqyrtimi i deklarimit fillestar dhe deklarimeve të mëpasshme të ngarkuara në sistem evidentohet se pensioni i pleqërisë nuk është deklaruar në asnjë rast nga familja përfituese.

Në menunë "*Verifikime"* konstatohet se nga verifikimet automatike të pensioneve, përfitimi i pensionit nga znj. S. K. është evidentuar në mënyrë të përsëritur nga sistemi, konkretisht në datat 19.01.2021, 19.04.2021, 21.07.2021, 13.10.2021, 18.01.2022, 19.04.2022, 22.09.2022 dhe 17.12.2022. Pavarësisht evidentimit të përsëritur të këtij informacioni nga sistemi, nuk rezulton të jenë marrë masa në kohë për ndërprerjen e përfitimit të ndihmës ekonomike, duke mos reflektuar të dhënat e verifikimeve automatike dhe duke lejuar vijimin e përfitimit në kundërshtim me kushtet ligjore. Për rrjedhojë, përfitimi duhej të ishte ndërprerë që në evidentimin e parë të pensionit, konkretisht në datën 19.01.2021. Mosmarrja e masave për ndërprerjen e përfitimit është në kundërshtim me nenin 20, pika 4, shkronjat "a" dhe "b", të ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

Gjithashtu, duke qenë se pensioni nuk është deklaruar në deklarimin fillestar dhe në deklarimet periodike 3-mujore, familja ka bërë deklarim të rremë të të dhënave, çka përbën shkak për përjashtim nga skema e ndihmës ekonomike sipas nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i* ndryshuar.

Për sa më sipër, familja ka përfituar padrejtësisht ndihmë ekonomike për periudhën janar 2021 – nëntor 2022, në shumën 193,766 lekë.

Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se aplikanti ka riaplikuar pas 19 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm, konkretisht me aplikimin nr. NE-2023-003296. Pranimi i aplikimit pas 19 ditësh nga data e refuzimit për shkak të deklarimit të rremë është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 "Për *asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili parashikon përjashtimin nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast fshehjeje informacioni ose deklarimi të rremë.

Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm. Duke qenë se refuzimi është dhënë më datë 22.12.2022, aplikimi i ri mund të kryhej vetëm pas përfundimit të këtij afati, pra pas datës 20.06.2023. Duke qenë se aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10-ditëshit të parë të muajit, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, rezulton se aplikimi mund të regjistrohej vetëm brenda 10-ditëshit të parë të muajit korrik 2023, me fillim përfitimi nga kjo periudhë.

Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur sërish përfitues që në muajin janar 2023. Duke qenë se aplikimi nuk duhej të ishte pranuar përpara muajit korrik 2023, përfitimet e marra për periudhën janar – qershor 2023 konsiderohen të përfituara padrejtësisht, në shumën 50,806 lekë.

Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja rezulton në shumën **244,572 lekë**, nga të cilat 193,766 lekë për periudhën janar 2021 – nëntor 2022 si pasojë e mosndërprerjes së përfitimit pas evidentimit të pensionit të padeklaruar dhe 50,806 lekë për periudhën janar – qershor 2023 si pasojë e pranimit të aplikimit pa respektuar afatin 6-mujor të penalizimit.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. E. Z.

Viti 2024

1.Aplikimi nr. NE-2024-022765 aplikanti: F. Z. Sh.

Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. F. Z.Sh. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2016-059725, i cili është refuzuar më datë 02.09.2024 për shkak të mosdeklarimit të pensionit të pleqërisë nga anëtarja e familjes, zj. B. Sh. Nga shqyrtimi i aplikimit të refuzuar, grupi i auditimit verifikoi deklarimin fillestar dhe deklarimet e mëpasshme të ngarkuara në sistem mbi të dhënat e familjes, nga ku evidentohet se të ardhurat e deklaruara janë vetëm ato nga ndihma ekonomike dhe nuk është pasqyruar përfitimi i pensionit të pleqërisë. Gjithashtu, në deklarimet periodike 3-mujore rezulton se është konfirmuar se nuk ka pasur ndryshime nga deklarimi fillestar.

Më tej, në menunë "*Verifikime*", për këtë aplikim rezulton se nga verifikimet automatike të pensioneve, fakti që zj. B. Sh. është përfituese e pensionit të pleqërisë së pjesshme me status "Kartelë e konfirmuar" është evidentuar në mënyrë të përsëritur që prej datës 19.01.2021. Konkretisht, ky fakt është evidentuar në datat 19.01.2021, 19.04.2021, 21.07.2021, 13.10.2021, 18.01.2022, 19.04.2022, 24.09.2022, 13.12.2022, 20.03.2023, 22.06.2023 dhe 18.09.2023, me vlera që variojnë nga 13,222 lekë deri në 14,896 lekë.

Për sa më sipër, konstatohet se nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror duhej të ishte bërë ndërprerja e përfitimit për deklarim të rremë që në evidentimin për herë të parë të faktit se zj. B. Sh. ishte përfituese e pensionit të pleqërisë, konkretisht në datën 19.01.2021 dhe jo në vitin 2024. Mosdeklarimi i pensionit përbën deklarim të rremë dhe, në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, aplikimi duhej të refuzohej dhe përfitimi të ndërpritej. Për rrjedhojë, përfitimet e marra për periudhën janar 2021 – shtator 2024, në shumën 662,688 lekë, konsiderohen të përfituara në mënyrë të padrejtë. Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se aplikanti ka riaplikuar pas 4 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.

Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm. Duke qenë se refuzimi është dhënë më datë 02.09.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 01.03.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, përfitimi mund të fillonte vetëm pas përfundimit të afatit ndalues, pra nga muaji mars 2025. Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit shtator 2024. Duke qenë se nuk është respektuar afati 6-mujor i penalizimit, periudha shtator 2024 – shkurt 2025 përbën përfitim të padrejtë dhe shuma e përfituar në mënyrë të padrejtë rezulton 121,176 lekë.

Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja rezulton në shumën **783,864 lekë.**

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.B. H.

2.Aplikimi nr. NE-2024-028504 aplikanti: S. D. K.

Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. F. Sh. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2024-028504, i cili është refuzuar më datë 31.10.2024 për shkak të mosdeklarimit të punësimit nga anëtari i familjes, z. S. K. Nga shqyrtimi i aplikimit të refuzuar, grupi i auditimit verifikoi deklarimin fillestar dhe deklarimet e mëpasshme të ngarkuara në sistem, nga ku evidentohet se nuk janë deklaruar të ardhura nga punësimi për asnjë prej anëtarëve të familjes. Më tej, në menunë *"Verifikime*" rezulton se nga verifikimi automatik i pagave është evidentuar se z. S. K. ka qenë i punësuar për periudhën tetor 2023 – shtator 2024 dhe ka përfituar pagë për muajin shtator 2024 në shumën 45,000 lekë. Mosdeklarimi i këtij punësimi përbën deklarim të rremë dhe për këtë arsye

aplikimi është refuzuar në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Për këtë aplikim nuk është përfituar ndihmë ekonomike.
Pas 6 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm është kryer riaplikimi. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.
Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm. Duke qenë se refuzimi është dhënë më datë 31.10.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 29.04.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, përfitimi mund të fillonte vetëm pas përfundimit të afatit ndalues, pra nga muaji maj 2025.
Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit nëntor 2024. Duke qenë se nuk është respektuar afati 6-mujor i penalizimit, periudha nëntor 2024 – prill 2025 përbën përfitim të padrejtë dhe shuma e përfituar në mënyrë të padrejtë rezulton **52,446 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. E. Z.
3.Aplikimi nr. NE-2024-020072 aplikanti: H. B. A.
Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. H. B. A. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2024-017195, i cili është refuzuar më datë 30.07.2024 për shkak të mosdeklarimit të punësimit. Nga shqyrtimi i aplikimit të refuzuar, grupi i auditimit verifikoi deklarimin fillestar dhe deklarimet e mëpasshme të ngarkuara në sistem, nga ku evidentohet se asnjë prej anëtarëve të familjes nuk është deklaruar si i punësuar, ndërkohë që familja ka deklaruar të ardhura në shumën 35,500 lekë me burim "*Të tjera*", pa specifikuar natyrën e tyre. Më tej, në menunë "*Verifikime*" rezulton se nga verifikimi automatik i punësimit, datë 16.07.2024, është evidentuar se z. H. A. ka qenë i punësuar për periudhën korrik 2023 – qershor 2024. Mosdeklarimi i këtij punësimi përbën deklarim të rremë dhe, për këtë arsye, aplikimi është refuzuar në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Për këtë aplikim nuk është përfituar ndihmë ekonomike. Pas 6 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm është kryer riaplikimi me nr. NE-2024-020072. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.
Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm. Duke qenë se refuzimi është dhënë më datë 30.07.2024, afati 6-mujor përfundonte më datë 26.01.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, përfitimi mund të fillonte vetëm pas përfundimit të afatit ndalues, pra nga muaji shkurt 2025.
Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit nëntor 2024. Duke qenë se nuk është respektuar afati 6-mujor i penalizimit, periudha nëntor 2024 – janar 2025 përbën përfitim të padrejtë dhe shuma e përfituar në mënyrë të padrejtë rezulton **28,752 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj. Gj. O.

Viti 2025

1.Aplikimi nr. NE-2025-014459 aplikanti: S. H. A.

Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. S. H. A. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2025-013898, i cili është refuzuar më datë 29.05.2025 për shkak të mosdeklarimit të punësimit nga anëtarja e familjes, zj. D.A. Nga shqyrtimi i aplikimit të refuzuar, grupi i auditimit verifikoi deklarimin fillestar dhe deklarimet e mëpasshme të ngarkuara në sistem, nga ku evidentohet se zj. D. A. nuk ka deklaruar punësimin. Gjithashtu, në deklarimet periodike është konfirmuar se nuk ka pasur ndryshime nga deklarimi fillestar. Më tej, nga verifikimi automatik i pagave, datë 14.05.2025, rezulton se zj. D. A. ka qenë e punësuar dhe ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën maj 2024 – mars 2025. Mosdeklarimi i këtij punësimi përbën deklarim të rremë dhe për këtë arsye aplikimi është refuzuar në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Pas 4 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm është kryer riaplikimi me nr. NE-2025-014459. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.

Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm. Duke qenë se refuzimi është dhënë më datë 29.05.2025, afati 6-mujor përfundonte më datë 25.11.2025. Në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, sipas së cilës aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10-ditëshit të parë të muajit, përfitimi mund të fillonte vetëm nga muaji dhjetor 2025.

Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit qershor 2025. Për rrjedhojë, përfitimet e marra për periudhën qershor – nëntor 2025, në shumën **58,656 lekë,** përbëjnë përfitim të padrejtë të ndihmës ekonomike.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z. Q.M.

2.Aplikimi nr. NE-2025-027510 aplikanti: I. A. B.

Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. I. A.B. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2016-055714, i cili është refuzuar më datë 29.09.2025 për shkak të mosdeklarimit të punësimit. Nga shqyrtimi i aplikimit të refuzuar, grupi i auditimit verifikoi deklarimin fillestar dhe deklarimet e mëpasshme të ngarkuara në sistem, nga ku evidentohet se z. I. B. nuk ka deklaruar punësimin. Më tej, në menunë "*Verifikime"* rezulton se nga verifikimi automatik i pagave, datë 29.09.2025, është evidentuar se z. I. B. ka qenë i punësuar për periudhën korrik–gusht 2025 dhe ka përfituar pagë në shumën 40,000 lekë. Mosdeklarimi i këtij punësimi përbën deklarim të rremë dhe, për këtë arsye, aplikimi është refuzuar për muajin shtator 2025.

Pas 64 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm, është kryer riaplikimi me nr. NE-2025-027510. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.

Për rrjedhojë, aplikimi nuk duhej të ishte pranuar pa kaluar afati 6-mujor nga data e refuzimit të mëparshëm. Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 29.09.2025, ku afati përfundonte më datë 28.03.2026. Përfitimi i ndihmës ekonomike mund të fillonte vetëm pas përfundimit të këtij afati, pra jo më herët se muaji prill 2026.

Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit dhjetor 2025. Duke qenë se nuk është respektuar afati 6-mujor i penalizimit, periudha dhjetor 2025 –

mars 2026 përbën përfitim të padrejtë dhe shuma e përfituar në mënyrë të padrejtë rezulton 6,100 lekë.
Megjithatë, duke qenë se periudha objekt auditimi shtrihet deri më datë 31.12.2025, efekti financiar që konsiderohet për qëllime auditimi kufizohet vetëm në përfitimin e muajit dhjetor 2025, në shumën **1,525 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror zj.Gj. O.

Qarku Korçë
Viti 2023
1.Aplikimi nr. NE-2023-032650 aplikanti: E. N.A.
Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. E. N. A. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2019-049534, i cili është refuzuar më datë 31.10.2023 për shkak të mosdeklarimit të punësimit. Nga shqyrtimi i aplikimit të refuzuar, grupi i auditimit verifikoi deklarimin fillestar dhe deklarimet e mëpasshme të ngarkuara në sistem, nga ku evidentohet se z. E. A. nuk ka deklaruar punësimin. Gjithashtu, nga verifikimi i deklarimeve rezulton se të ardhurat e deklaruara kanë qenë vetëm ato nga ndihma ekonomike dhe nuk është deklaruar as përfitimi i pensionit të pleqërisë, ndërsa në deklarimet periodike 3-mujore është konfirmuar se nuk ka pasur ndryshime nga deklarimi fillestar. Në menunë "*Verifikime"* rezulton se nga verifikimet automatike të pagave është evidentuar në mënyrë të përsëritur fakti që z. E. A. ka qenë i punësuar, konkretisht në datat 23.09.2022, 15.12.2022, 16.03.2023, 19.06.2023 dhe 13.09.2023. Për rrjedhojë, aplikimi duhej të ishte refuzuar që në momentin e evidentimit të parë të këtij fakti, konkretisht në muajin shtator 2022, pasi mosdeklarimi i punësimit përbën deklarim të rremë. Si pasojë, familja ka përfituar në mënyrë të padrejtë ndihmë ekonomike për periudhën shtator 2022 – shtator 2023 në shumën 81,534 lekë.
Gjithashtu, nga verifikimi i aplikimit për periudhën 09.08.2019 – 31.10.2023 rezulton se në sistem janë evidentuar vetëm dy vizita në banesë, konkretisht në datat 24.12.2019 dhe 19.10.2023, në kundërshtim me pikën 2, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, e cila përcakton kryerjen e verifikimeve periodike në terren të kushteve socio-ekonomike të familjeve përfituese.
Aplikanti ka riaplikuar 1 ditë pas refuzimit të aplikimit të mësipërm, konkretisht më datë 01.11.2023, me aplikimin nr. NE-2023-032650. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 31.10.2023, ku afati përfundonte më datë 28.04.2024. Duke qenë se aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10 ditëve të para të muajit, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji maj 2024.
Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit nëntor 2023. Për rrjedhojë, përfitimet e marra për periudhën nëntor 2023 – prill 2024 janë përfituar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi dhe përbëjnë përfitim të padrejtë në shumën 37,896 lekë.
Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga familja rezulton në shumën **119,430 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror.E. T.
***2.*Aplikimi nr. NE-2023-030733 aplikanti: G. Sh. H.**

Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. G. Sh. H. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2023-028057, i cili është refuzuar më datë 04.09.2023 për shkak të mosdeklarimit të pensionit. Nga shqyrtimi i aplikimit të refuzuar, grupi i auditimit verifikoi deklarimin fillestar dhe deklarimet e mëpasshme të ngarkuara në sistem, nga ku evidentohet se pensioni nuk është deklaruar. Më tej, në menunë "*Verifikime",* rezulton se nga verifikimi automatik i pensioneve është evidentuar se z. G. Sh. H. përfiton pension pleqërie të plotë në shumën 8,588 lekë. Mosdeklarimi i kësaj të ardhure përbën deklarim të rremë dhe për këtë arsye aplikimi është refuzuar në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
Pas 32 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm, është kryer riaplikimi me aplikimin nr. NE-2023-030733. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 04.09.2023, ku afati përfundonte më datë 04.03.2024. Duke qenë se aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10 ditëve të para të muajit, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji mars 2024.
Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit tetor 2023. Për rrjedhojë, përfitimet e marra për periudhën tetor 2023 – mars 2024 janë përfituar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi dhe përbëjnë përfitim të padrejtë në shumën **74,396 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.V. J.

Viti 2024

1.Aplikimi nr. NE-2024-024718, aplikanti: P. I. Ç.

Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti zj. P. Ç. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2019-050184, i cili është refuzuar më datë 30.09.2024 për shkak të mosdeklarimit të punësimit nga anëtarja e familjes, zj. N. M. Nga shqyrtimi i aplikimit të refuzuar, grupi i auditimit verifikoi deklarimin fillestar dhe deklarimet e mëpasshme të ngarkuara në sistem, nga ku evidentohet se zj. N. M. nuk ka deklaruar punësimin. Më tej, në menunë "Verifikime" rezulton se nga verifikimi automatik i pagave, datë 13.09.2024, është evidentuar se zj. N. M. ka qenë e punësuar për periudhën qershor–gusht 2024, ndërsa për muajin gusht 2024 ka përfituar pagë në shumën 40,000 lekë. Mosdeklarimi i këtij punësimi përbën deklarim të rremë dhe për këtë arsye aplikimi është refuzuar në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
Pas 2 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm, është kryer riaplikimi, konkretisht me aplikimin nr. NE-2024-024718. Pranimi i këtij aplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë.
Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 30.09.2024, ku afati përfundonte më datë 29.03.2025. Duke qenë se aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10 ditëve të para të muajit, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji prill 2025.

Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit tetor 2024. Për rrjedhojë, përfitimet e marra për periudhën tetor 2024 – mars 2025 janë përfituar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi dhe përbëjnë përfitim të padrejtë në shumën **25,948 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.D. H.

2.Aplikimi nr. NE-2024-022166, aplikanti: A.I. D.

Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. A. D. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2024-019706, i cili është refuzuar më datë 27.08.2024 për shkak të mosdeklarimit të pagës nga anëtarja e familjes, zj. M. D. Në aplikimin e refuzuar, në menunë "Verifikime" rezulton se nga verifikimi automatik i pagave, datë 13.08.2024, është evidentuar se zj. M. D. ka qenë e punësuar për periudhën maj–qershor 2024, fakt i cili nuk është deklaruar në aplikim dhe përbën deklarim të rremë. Për këtë arsye aplikimi është refuzuar në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 *"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Pas 7 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm, është kryer riaplikimi me aplikimin nr. NE-2024-022166. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 27.08.2024, ku afati përfundonte më datë 23.03.2025. Duke qenë se aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10 ditëve të para të muajit, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji prill 2025.
Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit shtator 2024. Për rrjedhojë, përfitimet e marra për periudhën shtator 2024 – mars 2025 janë përfituar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi dhe përbëjnë përfitim të padrejtë në **shumën 77,103 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror z.E. Sh.

Viti 2025:

1.Aplikimi nr. NE-2025-015792, aplikanti: M. Z. L.

Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. M. L. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2022-000545, i cili është refuzuar më datë 29.04.2025 për shkak të mosdeklarimit të punësimit. Në aplikimin e refuzuar, në menunë "*Verifikime*" rezulton se nga verifikimi automatik i pagave, datë 11.04.2025, është evidentuar se z. M. L. ka qenë i punësuar për periudhën shkurt–mars 2025, fakt i cili nuk është deklaruar në aplikim dhe përbën deklarim të rremë. Për këtë arsye aplikimi është refuzuar në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar.
Pas 41 ditësh nga data e refuzimit të aplikimit të mësipërm, është kryer riaplikimi me aplikimin nr. NE-2025-015792. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 29.04.2025, ku afati përfundonte më datë 26.10.2025. Duke qenë se aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10 ditëve të para të muajit, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji nëntor 2025.

Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit qershor 2025. Për rrjedhojë, përfitimet e marra për periudhën qershor–tetor 2025 janë përfituar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi dhe përbëjnë përfitim të padrejtë në shumën **60,600 lekë**.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.V. H.1.

2.Aplikimi nr. NE-2025-006074, aplikanti: A.R. Ç.

Nga verifikimi i raportit të aplikimeve pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit konstatohet se aplikanti z. A. Ç. ka pasur një aplikim të mëparshëm me nr. NE-2025-002131, i cili është refuzuar më datë 31.01.2025 për shkak të mosdeklarimit të punësimit të anëtares së familjes, zj. A. Ç. Në menunë "Verifikime" rezulton se nga verifikimi automatik i pagave, datë 17.01.2025, është evidentuar se zj. A. Ç. ka qenë e punësuar për periudhën janar–nëntor 2024, fakt i cili nuk është deklaruar në aplikim dhe përbën deklarim të rremë. Për këtë arsye aplikimi është refuzuar në zbatim të nenit 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
Pas 7 ditësh nga data e refuzimit, aplikanti ka riaplikuar me aplikimin nr. NE-2025-006074. Pranimi i këtij aplikimi është në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit nr. 57/2019, sipas të cilit familja përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore në rast të fshehjes së informacionit ose deklarimit të rremë. Grupi i auditimit llogariti periudhën 6-mujore nga data e refuzimit, 31.01.2025, ku afati përfundonte më datë 30.07.2025. Duke qenë se aplikimet regjistrohen nga administratori shoqëror brenda 10 ditëve të para të muajit, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, familja mund të trajtohej si përfituese jo më herët se muaji gusht 2025.
Nga verifikimi në sistem rezulton se aplikanti është shpallur përfitues që prej muajit shkurt 2025. Për rrjedhojë, përfitimet e marra për periudhën shkurt–korrik 2025 janë përfituar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi dhe përbëjnë përfitim të padrejtë në shumën **53,776 lekë.**
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Specialisti i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Administratori Shoqëror znj.A. B.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi edhe Drejtorët e Drejtorive Rajonale të SHSSH-së, sipas periudhës dhe rasteve përkatëse të trajtuara, për parregullsitë e konstatuara lidhur me respektimin e afatit 6-mujor të përjashtimit, trajtimin e mospërputhjeve të sinjalizuara nga verifikimi automatik i sistemit, mbikqyrjen e veprimtarisë së verifikuesve dhe dokumentimin e verifikimeve administrative.

Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK pranë SHSSH ka paraqitur observacionet, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me përllogaritjen e afatit të penalitetit për riaplikimet para afatit 6-mujor, afati fillon nga muaji në të cilin familja është refuzuar dhe nuk ka përfituar masën e ndihmës ekonomike, dhe përfundon në muajin e gjashtë duke filluar nga muaji i refuzimit. Për rrjedhojë, e drejta e riaplikimit lind në muajin e shtatë pas muajit të refuzimit. Sipas subjektit, grupi i auditimit e ka llogaritur afatin e penalitetit duke filluar nga muaji pasardhës i refuzimit dhe jo nga vetë muaji i refuzimit, çka nuk përputhet me mënyrën e funksionimit të sistemit të ndihmës ekonomike dhe me përcaktimet e VKM-së nr. 597/2019. Gjithashtu, afati i penalitetit llogaritet me muaj dhe jo me ditë, në përputhje me natyrën mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike. Pra, e drejta e riaplikimit për familjet e refuzuara lind në muajin e shtatë pas muajit të refuzimit. P.sh, në rastin kur një familje eshtë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike në muajin Janar 2026 dhe nga verifikimi rezulton se për muajin Janar kur dhe eshtë refuzuar, nuk ka perfituar masën e ndihmës ekonomike, afati i penalitetit 6 mujor fillon nga muaji Janar (pasi nga ky muaj nuk ka përfituar masën e NE-së). Ky afat penalizimi do vijojë për 6 muaj duke perfunduar ne muajin Qershor dhe familja gëzon të drejtën e riaplikimit në muajin Korrik 2026. Nga ana e grupit të auditimit llogaritja e afatit të penalitetit fillon një muaj me vonesë pra, llogaritja e afeteve të penalitetit nuk fillon nga muaji i refuzimit të familjes nga sistemi por nga muaji pasardhës. Kjo mënyrë përllogaritje e përdorur nga grupi i auditimit nuk eshte e njejtë me afatet e perllogaritura nga sistemi i ndihmës ekonomike dhe percaktimet e VKM-

së Nr.597/2019, Kreu II, pika 11 ku percaktohet afati 6 mujor i penalitetit si më poshtë: "Perjashtohen nga perfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë gjashtëmujore, familjet të cilat kanë në përbërje te tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme...".
Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi lexoi me vëmendje parashtrimet tuaja, arsyeton dhe sqaron se përllogaritja është kryer duke marrë në konsideratë datën në të cilën familja ose individi rezulton i skualifikuar nga skema e ndihmës ekonomike në sistem dhe nuk përfiton më masën e ndihmës ekonomike. Referimi i datave në analizën e grupit të auditimit është bërë vetëm për efekt të përcaktimit të momentit kur përfundon periudha e përjashtimit dhe kur familja ose individi fiton të drejtën për të riaplikuar. Përllogaritja e kryer me ditë, nxjerr të njëjtin rezultat si përllogaritja e kryer me muaj. Në rastet kur periudha 6-mujore e përjashtimit përfundon në fund të një muaji kalendarik, e drejta për riaplikim lind në muajin pasardhës. Pretendimi i subjektit se grupi i auditimit ka filluar përllogaritjen e afatit një muaj pas skualifikimit nuk qëndron, pasi nga verifikimet e kryera rezulton se përllogaritja është bazuar në momentin e daljes së familjes nga skema e përfitimit, në përputhje me të dhënat e sistemit dhe me qëllimin e dispozitës që përcakton periudhën 6-mujore të përjashtimit. Ligji Nr.57/2019 përcakton në mënyrë eksplicite se përjashtimi është 6 mujor, periudhë gjatë së cilës nuk i lejohet familjes/individit të riaplikojë, pra aplikimi mund të kryhet muajin pasi ka përfunduar përjashtimi 6 mujor dhe jo në muajin e gjashtë. Gjithashtu sipas Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", kreu V, neni 56, pika 3 *afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati*. Për sa më sipër, observacioni nuk paraqet fakt të ri ndaj nuk do të merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me konceptin "Deklarim i rremë" sqarojme se, jo ne te gjitha rastet e konstatuara nga grupi i auditimit mosperputhjet e ardhura nga institucionet me te cilat kryhet shkembimi i informacionit perbëjnë deklarim të rreme.
1. Nuk vlerësohen si deklarim i remë rastet e mosperputhjeve që vijnë nga DPGJC lidhur me përbërjen e struktures familjare, kur gjate verifikimeve konstatohen lindje te anëtarëve te familjes. Kjo per arsye se verifikimi i të dhenave me Drejtorinë e Pergjithshme te Gendjes Civile kryhet çdo muaj, nderkohë që aplikuesi ka detyrimin ligjor per deklarimin e ndryshimeve social ekonomike çdo 3 muaj. Gjithashtu, fakti që një anëtar i familjes rezulton i shtuar ne te dhenat e DPGJC-se, por nuk pasqyrohet ende në formularin e aplikimit, nuk sjell automatikisht efekte negative ne perfitim dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet në vetvete si deklarim i rremë.
2. Nuk konsiderohet deklarim i remë, rastet e familjeve që rezultojnë me mosperputhje gjate verifikimeve automatike, per te cilat eshte bere shenimi se nuk janë refuzuar per shkak të problematikave të ndërveprimit të sistemit të ndihmës ekonomike me sistemet e tjera shteterore. Për këto raste ka pasur udhëzim nga Sherbimi Social Shteteror që familjet te mos refuzohen në muajin aktual të evidentimit të mosperputhjes, pikërisht per te shmangur penalizimin e aplikuesve për problematika teknike apo mungese sinkronizimi ndërmjet sistemeve elektronike. Per rrjedhoje, këto raste nuk mund të klasifikohen si deklarime te rreme.
3. Nuk perbëjnë deklarim te remë, rastet kur familjet janë refuzuar gabimisht nga Drejtoria Rajonale per shkak të vizitave te hedhura gabim në sistem nga administrator shoqëror apo si pasoj e gabimeve të tjera administrative të vetë Drejtorise Rajonale. Në keto raste, shkeljet e konstatuara nuk lidhen me mungesë deklarimi/fshehje informacioni nga ana e familjes aplikuese, por me pasaktesi apo veprime administrative te strukturave pergjegjese. Per sa kohe familja ka permbushur detyrimet e saj ligjore per deklarim dhe paragitje te dokumentacionit, ajo nuk mund te penalizohet 6 muaj nga e drejta e perfitimit per shkak të nje gabimi të kryer nga administratori shogeror apo Drejtoria Rajonale. Per këtë arsye, eshte lejuar riaplikimi i këtyre familjeve perpara perfundimit te afatit 6 mujor, pa u konsideruar shkelje e
dispozitave ligjore, pasi nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit te rremë. Gjithashtu, gabimi administrativ rezulton i provuar permes dokumentacionit perkates, i cili
administrohet në dosjen fizike të aplikantit, ne perputhje me detyrimet ligjore dhe procedurale ne fuqi.
4. Nuk përbëjnë deklarim të remë, rastet kur familjet janë refuzuar që ne momentin e parë te shfaqjes së mosperputhjes së ardhur nga DT per arsye te punësimit nga Programet e nxitjes së punësimit/puna ne Komunitet. Referuar VKM-se Nr.535, date 08.07.2020 "Per procedurat, kriteret dhe rregullat per zbatimin e programit të punëve publike ne komunitet" si dhe Protokollit të punës "Per referimin per punësim per anëtaret në moshe aktive pune të skemes së ndihmës ekonomike*, Mars 2022 percaktohet se: "Drejtorite Rajonale të SHSSH-s gjate procesit te vendimmarrjes, duhet të mos refuzojë rastet, te cilat kanë pranuar ofertat per punësim dhe nuk janë deklaruar ndryshimet gjate periudhes tre mujore të proves,. Per sa më sipër, Drejtorite Rajonale kanë lejuar riaplikimin pasi familjet nuk janë refuzuar per deklarim të remë dhe nuk mund ti nënshtrohen afatit te penalitetit 6 mujor. Lidhur me argumentin e paragitur nga grupi i auditimit për mungesën e gjurmimit në sistem te rasteve per te cilat familjet jane lejuar te riaplikojne (hedhje dokumentacioni/shenime/komente) sqarojmë se, Sistemi i ndihmes ekonomike nuk eshte formatuar ne mënyre te tillë që te mund te ngarkohet i gjithe dokumentacioni fizik i paraqitur nga aplikuesit/perfituesit dhe per kete arsye sipas legislacionit në fuqi administratori shoqëror mban dosje fizike per çdo aplikues/perfitues te ndihmës ekonomike në perputhje kjo me piken 4.1, shkronja (f) të VKM-

se Nr.597/2019. Lidhur me kete percaktim ligjor, Drejtorite Rajonale perveç kontrollit ne sistem, kryejne edhe kontroll fizik në njësite vendore mbi dosjet dhe dokumentacion perkates. Lidhur me gjurmimin e rasteve në sistem sqarojmë se, administratoret shoqëror por edhe Drejtorite Rajonale (DRDiber) kanë proceduar permes vendosjes së shenimeve perkatese dhe lenies se gjurmëve ne sistem në disa seksione:
-Në seksionin "Vlerësime" ku jepen vlerësimet e administratorit shoqeror per gjendjen e familjes;
-Në seksionin e "Vizitave në banese" ku bëhen komente mbi situaten social ekonomike të familjes;
-Në formularin e aplikimit në seksionin "Te ardhura të tjera" ", pika 30 Tjetër (dicka që aplikanti dëshiron të thotë);
-Tek verifikimet manuale të Biznesit (shenime te vendosura nga DR Dibër).
Per sa më sipër Drejtorite Rajonale kanë bere observacion duke pasqyruar te gjitha
shenimet/gjurmët e lëna në sistem per rastet e konstatuara me shkelje.
Lidhur me gjetjet e grupit te auditimit per mangësite e evidentuara në procesin e verifikimit automatik ku mosperputhjet e ardhura nuk janë marrë në konsideratë nga strukturat perkatese që prej shfaqjes per herë te parë në sistem (Tabela Nr.8 e aneksit nr. 2 të Projekt Raportit të Auditimit) sqarojmë se: Te gjitha mosperputhjet e evidentuara trajtohen nga Drejtoritë Rajonale që në muajin e parë të shfaqjes se tyre. Për secilin rast kryhen verifikimet përkatëse dhe dokumentohen ne sistem shenimet administrative mbi vleresimin e mosperputhjes, duke percaktuar nëse ajo perbën ose jo shkelje dhe mbi bazën e këtij vleresimi vijon procesi i vendimmarrjes nga struktura pergiegjese. Rastet per të cilat verifikuesit kanë lënë shenime se do te monitorohen ne uajt vijues ose kanë vlerësuar se nuk perbëjne shkelje, lidhen kryesisht me ndryshime te gjendjes social-ekonomike, si fillimi i marrëdhenieve te punësimit ose perfitimi i një pensioni te ri. Per këto raste, legjislacioni në fuqi për ndihmën ekonomike ka parashikuar afatin 3-mujor per deklarimin e ndryshimeve nga familjet perfituese. Për rjedhojë, një mosperputhje e evidentuar për herë të parë nga sistemi, e lidhur me një muaj punësimi ose me një pension të ri, nuk mund të çojë automatikisht në refuzimin e aplikimit me arsyetimin "deklarim i rremë" apo "fshehje informacioni", pa iu dhënë më parë familjes mundësia për të deklaruar ndryshimin në deklaratën periodike të radhës. Shënimet e vendosura në sistem për monitorimin e aplikimit në vijim kanë si gëllim shmangien e refuzimeve të padrejta të familjeve përfituese dhe garantimin e një procesi administrativ të drejtë e proporcional. Në këtë kuptim, dispozitat ligjore duhet të interpretohen në tërësinë e tyre, në harmoni me njëra-tjetrën dhe në perputhje me frymën dhe qëllimin e ligjit. Gjatë konstatimeve të grupit të auditimit janë evidentuar raste kur aplikuesve u është shfaqur nga institucionet ndërvepruese një periudhë punësimi ose pensioni një muaj perpara aplikimit, ndërkohë që në momentin e aplikimit ata nuk kanë genë më në marrëdhënie pune ose nuk kanë vijuar më perfitimin e pensionit. Këto raste kërkojnë rivlerësim individual, pasi ekzistenca e një mosperputhjeje për një periudhë të mëparshme nuk perbën në vetvete provë të deklarimit të rremë. Për pasojë, familja nuk mund të refuzohet për deklarim të remë vetëm për shkak të ekzistencës së një mospörputhjeje të ardhurash, kur provohet se në momentin e aplikimit nuk ishte më në marrëdhënie pune ose nuk përfitonte më pension. Po kështu, edhe në rastet kur familja është refuzuar gabimisht nga Drejtoria Rajonale për këto mospërputhje, ajo nuk mund t'i nënshtrohet penalitetit 6-mujor të parashikuar për deklarimin e remë. Në këto rrethana nuk ndodhemi perpara kushteve të deklarimit të rremë, por perpara rasteve që kërkojnë verifikim dhe vlerësim të plotë të situatës faktike të familjes. Për sa më sipër, Drejtoritë Rajonale nuk i kanë konsideruar shkelje mospërputhjet qe në momentin e parë të shfaqjes së tyre ose në rastet kur i kanë refuzuar, kanë lejuar riaplikimin pasi familjet nuk janë refuzuar për deklarim të rremë dhe nuk mund ti nënshtrohen afatit të penalitetit 6 mujor. Lidhur me perllogaritjen nga ana e grupit të auditimit te pagesave/efektit negativ per familjet që kanë riaplikuar para afatit te penalizimit rezulton se ka mosperputhje me perllogaritjen e bërë nga sistemi. Problematika qëndron në faktin se gjate përllogaritjes së kryer nga grupi i auditimit krahas vleres totale te mases se ndihmës ekonomike që ka llogarit vetë sistemi janë shtuar edhe pagesat extra, të cilat sistemi i perllogarit automatikisht në vlerën totale. Per ato raste për të cilat edhe pse nuk janë paraqitur argumente justifikuese nga Drejtorite Rajonale per raplikimet para afatit, nga ana jone janë perllogaritur efektet negative dhe gjykojme se pjesae perllogaritjes së masës duhet të merret në konsideratë.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi lexoi me vëmendje parashtrimet tuaja, arsyeton se në të gjitha rastet e konsideruara si “deklarim i rremë” nga ana e grupit të auditimit, janë raste të aplikimeve të përjashtuara nga skema nga SHSSH, për të cilat nuk është pritur deklarimi 3-mujor si është cituar më lartë nga ju. Në lidhje me strukturën e familjes nga DPGJC, nëse rasti është që pritet deklarimi 3-mujor, atëherë kjo duhet të reflektohet nga ana e strukturave përgjegjëse të SHSSH dhe Drejtorive Rajonale dhe në mos përjashtimin e familjes nga skema, për sa kohë prisni për një vërtetim të tillë.
Në lidhje me familjet që rezultojnë me mospërputhje për shkak të problematikave të ndërveprimit të sistemit, mbetet përsëri përgjegjësia e SHSSH dhe strukturave përkatëse për skualifikimin padrejtësisht të përfituesve të ndihmës ekonomike, duke u hequr mundësinë për të marrë ndihmën ekonomike deri në riaplikimin e rradhës. Udhëzimi i SHSSH për rastet e sipërpërmendura nuk është vendosur në dispozicion gjatë periudhës së auditimit në terren dhe në dijeninë tonë nuk ka një Urdhër zyrtar që i përjashton këto raste. Gjithashtu si do të reflektohet në rastet e mëposhtme, nuk ka shënime në sistem për shumicën prej tyre.
Në lidhje me gabimet e kryera nga administratorët shoqërorë për sistemin, pavarësisht se nuk quhet deklarim i rremë, përgjegjësia i takon SHSSH, administratorëve shoqërore dhe strukturave përkatëse të cilët u kanë hequr

mundësinë individëve për të përfituar ndihmën ekonomike deri në fazën e riaplikimit. Në sistem, për shumicën e rasteve nuk gjenden shënimet përkatëse për të justifikuar situatën.
Në lidhje me skualifikimin për shkak të mospërputhjes së ardhur nga DT për Programin e Nxitjes së Punësimit, raste të tilla pavarësisht evidentuar ose jo nuk janë më pjesë e këtij Raporti. Pavarësisht se Sistemi i Ndihmës Ekonomike nuk është formatuar në mënyrë që të ngarkohet i gjithë dokumentacioni fizik i paraqitur, ekziston mundësia, si dhe ju e përmendni, për vendosjen e shënimeve nga administratori dhe kontrolluesit. Gjithashtu nga ana e SHSSH dhe strukturave përkatëse duhet të merren masa për t'u shmangur gabime të tilla dhe për të identifikuar rastet ku bëhet fjalë për individë që janë pjesë e Programit të Punësimit.
Në lidhje me trajtimet e mospërputhjeve nga Drejtoritë Rajonale që në muajin e parë të konstatimit, rikthejmë në vëmendjen tuaj rastet e sipërpërmenduara të cilat shfaqin problematika që në aplikimin e parë.
Në lidhje me arsyetimin nëse një veprim është deklarim i rremë apo fshehje informacioni, ndarja që ju përmendni nuk ndodhet në legjislacionin përkatës, ose në rregullore të brendshme të institucionit, për këtë arsye arsyetimi juaj mbetet institucional por jo ligjor. Përsa i përket përllogaritjes së vlerave, grupi i auditimit ka proceduar në bazë të të dhënave të sistemit ku është përllogaritur totali i ndihmës ekonomike dhe pagesave të energjisë elektrike në rastet ku kishte.

Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, Drejtoritë Rajonale SHSSH kanë paraqitur observacionet, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit DRSHSSH Dibër: Nisur nga Akt-Konstatimi nr. 5 i Kontrollit të Lartë të Shtetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Dibër parashtron si më poshtë observacionin në lidhje me aplikimet e lejuara në sistem, me arsyet përkatëse të justifikuara me dokumentacion, si më poshtë: Sqarojmë se verifikuesit e sistemit të ndihmës ekonomike monitorojnë çdo muaj raportin e riaplikimeve të gjeneruar nga sistemi dhe, në rastet kur konstatohen riaplikime para afatit të penalizimit, ato refuzohen në verifikimin e "biznesit manual". Kjo është një procedurë e zgjedhur nga ana jonë, me qëllim që të lërë gjurmë në sistem, e vërtetuar sipas dokumentacionit bashkëlidhur. Më pas, nga ana e vendimmarrësit të Drejtorisë bëhet verifikimi për çdo familje të refuzuar, sipas dokumenteve të dërguara nga administratori shoqëror.Për të gjitha rastet e cituara më poshtë, nga nr. 1 deri në nr. 15, është ndjekur procedura e saktë, duke lënë gjurmë në sistem dhe, pas konfirmimit të vendimmarrësit të Drejtorisë Rajonale, është lejuar aplikimi i familjes me dokumentacionin përkatës që ju bashkëlidhet.Lidhur me familjen që i korrespondon nr. 16, është vijuar me procedurën mbi kushtet e vështira social-ekonomike.
1-M. R.A., me numër aplikimi NE-2023-017042 në sistemin e ndihmës ekonomike, është verifikuar nga verifikuesit më datë 29.05.2023, duke u refuzuar për shkak të mospërputhjes me përgjigjen: "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit". Nga ana e vendimmarrësit është lejuar riaplikimi, për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike, bazuar në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Shupenzë, me datë 10.05.2023.
2-M. R.K., me numër aplikimi NE-2023-033046, është trajtuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit" nga ana e verifikuesit me datë 23.11.2023 dhe më pas me dokumentin justifikues të lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, ku vërtetohet që zj. A. K. nuk është më në marrëdhënie pune nga data 02.11.2023, nga ana e vendimmarrësit në ditën e marrjes së vendimit të ndihmës ekonomike. Theksojmë se në formularin e ndihmës ekonomike zj. A. ka deklaruar pagën 30.000 lekë, ndërsa muajin e rritjes nuk e ka deklaruar, por nga verifikimi në sistemin e pagave rezulton se kjo pagë ka qenë më e lartë vetëm për dy muaj, në korrik 2023 dhe gusht 2023, ndërsa në muajt e tjerë paga ka qenë minimale dhe e tillë ka vijuar edhe për muajt në vazhdim. Dokumentet janë sjellë nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Suç.
3- S. R. K., me numër aplikimi NE-2023-033703, është trajtuar nga raporti si riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit nga ana e verifikuesit me datë 23.11.2023. Më pas, nga ana e vendimmarrësit, me justifikimin që familja është në kushte shumë të vështira ekonomike, pasi kryefamiljari i sëmurë punon në fabrikën e kromit në Bulqizë në kushte jo të favorshme pune, duke rrezikuar jetën çdo ditë, është lejuar si riaplikim. Kjo është bazuar në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Bulqizë me datë 20.11.2023, ku konstatohet se familja është në kushte ekstreme varfërie dhe kryefamiljari ka probleme shëndetësore.
4-Sh. F. Xh., me numër aplikimi NE-2023-013056, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 23.03.2023, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Gjoricë me datë 10.03.2023.
5-V. H. H., me numër aplikimi NE-2023-036654, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 27.12.2023, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit" me datë 28.12.2023, dhe është lejuar si riaplikim nga ana e vendimmarrësit për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Gurrë me datë 19.12.2023.

6-G. I. Ll., me numër aplikimi NE-2023-009068, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 20.02.2023, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Gurrë me datë 16.02.2023.
7-S. Sh. P., me numër aplikimi NE-2023-025608, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 17.08.2023, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Gurrë me datë 14.08.2023.
8-G.G. Xh., me numër aplikimi NE-2024-014450, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 27.05.2024, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Shupenzë me datë 10.05.2024.
9-L. F. M., me numër aplikimi NE-2024-000186, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 23.01.2024, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror në ditën e marrjes së vendimit nga vendimmarrësi dhe në shkresën e dërguar nga Njësia Administrative Suç me numër 42 protokolli, datë 24.01.2024.
10-M. L. D., me numër aplikimi NE-2024-002636, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 23.01.2024, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike dhe me probleme shëndetësore. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Shupenzë me datë 10.01.2024.
11-A. R. P., me numër aplikimi NE-2024-031066, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 19.12.2024, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike dhe me probleme shëndetësore. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Rukaj me datë 12.12.2024.
12-A. B. E., me numër aplikimi NE-2025-024400, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 23.10.2025, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Klos me datë 12.10.2025.
13-E. S. K., me numër aplikimi NE-2025-006238, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 18.02.2025, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim pasi, bazuar në vërtetimin e dërguar nga kompania E. P. AL, i cili gjendet bashkëlidhur, rezulton se ka qenë një shpërblim i marrë nga punonjësi z. E. K. me datë 24.01.2025. Dokumentet janë sjellë nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Klos.
14-Sh. I. C., me numër aplikimi NE-2025-026538, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 20.11.2025, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Gurrë me datë 19.11.2025.
15-Gj. H. M., me numër aplikimi NE-2025-025809, është verifikuar nga verifikuesit në sistemin e ndihmës ekonomike me datë 20.11.2025, duke u refuzuar si mospërputhje me përgjigjen "Riaplikim pa përfunduar periudha e refuzimit", ndërsa nga ana e vendimmarrësit është lejuar si riaplikim për arsye se familja është në kushte të vështira ekonomike dhe është bërë ndarja nga trungu familjar e anëtarëve të familjes të cilët jetojnë jashtë shtetit. Kjo bazohet në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Muhurr me datë 10.11.2025 dhe në certifikatën familjare të familjes.
16-R. S. Ll., me numër aplikimi NE-2024-001675, është lejuar si riaplikim bazuar në vlerësimin e dërguar nga administratori shoqëror i Njësisë Administrative Shupenzë me datë 10.02.2024, pasi është në kushte shumë të vështira ekonomike dhe me të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar jetesën. Në lidhje me procedurën që kemi ndjekur për emrat e mësipërm, për këtë rast, për shkak të ngarkesës së madhe gjatë muajit të verifikimeve manuale në sistem, si edhe të kontrolleve që realizohen nga grupi i kontrollit, nuk është bërë e mundur të ndiqet kjo procedurë.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me aplikimet për të cilat keni përcjellë observimet tuaja, theksojmë se rifutja në skemë brenda periudhës 6 mujore nga shkëputja për deklarim të rreme, është e pabazuar në ligj dhe në

kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet se: "Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmujore familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm, që fsheh informacionin apo kryen deklarim të rremë." Për rrjedhojë, observacionet e paraqitura nga subjekti nuk paraqesin fakt të ri ndaj nuk do të merren në konsideratë.

Pretendimi i subjektit DRSHSSH Korçë: Në vijim të observacionit Nr. 478/1, datë 20.04.2026, për Qarkun Korçë ju sqarojmë si më poshtë: Për 6 aplikimet është lejuar riaplikimi para periudhës së refuzimit 6-mujor, duke pasur parasysh dokumentacionet justifikuese (sipas procesverbaleve), gjendjen social-ekonomike të familjeve, këto të bazuara në Ligjin Nr. 57/2019, datë 18.07.2019, të ndryshuar, neni 2 "Qëllimi si dhe në nenin 5 "Parime të përgjithshme. Gjithashtu sqarojmë se llogaritja e përfitimit sipas Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019, i ndryshuar, neni 12, pika 1, përcaktohet se: "Ndihma ekonomike është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike bëhet sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave". Po kështu, edhe në nenin 15, pika 1, të ligjit të sipërcituar përcaktohet se: "Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmujore familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm, që plotëson kushtet e mëposhtme...". Pra, llogaritja e masës përfituese dhe koha e refuzimit janë mujore dhe jo sipas datave, duke filluar nga muaji i refuzimit. Për 6 aplikimet sqarojmë si më poshtë:
1-Aplikimi nr. NE-2023-032650, aplikanti E. N. A. Në datë 29.09.2023 është kryer refuzimi nga ndihma ekonomike i familjes E. N. A. për mosdeklarim page të kryefamiljarit në muajin shtator 2023. Nga ana e aplikuesit janë kryer të gjitha veprimet ligjore për deklarimin e situatës ekonomike të familjes, por nga ana e ish-administratorit shoqëror është kryer ndërhyrje e gabuar në formularin e aplikimit, pa zbatuar periudhën 3-mujore të deklarimit ose minimalisht 2 muaj pas ndryshimit të të ardhurave nga punësimi. Në datë 01.11.2023 është kryer riaplikim, pa plotësuar periudhën e refuzimit 6-mujor nga ndihma ekonomike, pasi ish-administratori shoqëror E. T. ishte punësuar në mars 2023 dhe nuk kishte eksperiencë në procedurat e aplikimeve, kjo edhe sipas shënimeve në sistem dhe sipas procesverbalit të mbajtur në datë 01.11.2023 pranë zyrës së ndihmës ekonomike ku ka vendbanimin aplikuesi. Administratori shoqëror ka lënë gjurmë në rubrikën "Vlerësimet", në pikën 6, si dhe në rubrikën "Tjetër" (pika 26) të aplikimit. Familja përbëhet nga 3 anëtarë, ku kryefamiljari është person me status invalid pune. Familja jeton në banesë të vjetër, në kushte minimale jetese. Për sa më sipër, për shkak të plotësimit të rubrikës së gabuar në formularin e pagës, nuk mund të quhet deklarim i rremë nga ana e familjes. Pra, familja e ka përmbushur detyrimin ligjor dhe e ka deklaruar pagën, por administratori gabimisht ka plotësuar rubrikën e punësimit të 12 muajve të fundit. Nisur nga fakti që familja përbëhet nga 3 anëtarë, nga të cilët aplikuesi është person me aftësi të kufizuar (invalid pune), familja jeton në banesë të vjetër në kushte minimale jetese (plotësim i kushteve të Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019, të ndryshuar, neni 2, germa b dhe neni 5, germa c), sipas procesverbalit datë 01.11.2023 është lejuar riaplikimi i familjes pa kaluar afati i penalizimit 6-mujor.
2-Aplikimi nr. NE-2023-030733, aplikanti G. Sh. H. Në datë 29.09.2023 është kryer refuzimi nga ndihma ekonomike i familjes G. Sh. H. për mosdeklarim pensioni të kryefamiljarit. Në datë 04.10.2023 është kryer riaplikim, pasi në të njëjtën datë të aplikimit të refuzuar (NE-2023-028057, datë 04.09.2023) është kryer edhe miratimi i pensionit (pa pasur dijeni për deklarimin përkatës), sipas kartelës së pensionit. Në riaplikimin NE-2023-030733, nga ana e verifikuesit është pasqyruar shënimi përkatës në faqen 52 të verifikimeve, në hapin e verifikimit "Vizitë në shtëpi", përkatësisht me datë 18.10.2023. Aplikuesi është i ve me 6 vajza, të cilat jetojnë në banesë 1-katëshe në kushte të papërshtatshme jetese. Vetë aplikuesi është paraqitur pranë Drejtorisë Rajonale Korçë në gjendje të rënduar shëndetësore dhe psikologjike për shkak të refuzimit të ndihmës ekonomike. Duke pasur për bazë gjendjen social-ekonomike të familjes, verifikimin e të dhënave dhe relacionin nga administratori shoqëror, është lejuar riaplikimi në datë 04.10.2023 me nr. aplikimi NE-2023-030733. Edhe nga verifikimi i kryer nga Taks-Forca në vitin 2024 rezultoi se familja jetonte në kushte shumë të vështira jetese. Për sa më sipër, duke marrë parasysh që familja është refuzuar në muajin e parë të ardhur të mospërputhjes, aplikanti ende nuk ka qenë në dijeni për përfitimin e pensionit, ndonëse lidhja e afateve nga ISSH është kryer sipas afateve ligjore, duke rezultuar përfitues që prej datës 30.08.2023 dhe qytetari ka aplikuar në skemën e ndihmës ekonomike në datën 04.09.2023, në të njëjtën datë të aplikimit të refuzuar. Në këtë rast nuk është deklarim i rremë nga ana e qytetarit, por mungesë dijenieje për përfitimin e pensionit. Gjurma në sistem lidhur me riaplikimin është lënë në rubrikën e vizitës në banesë (faqe 52, datë 18.10.2023, e rubrikës "Verifikime").
3-Aplikimi nr. NE-2024-024718, aplikantja P. I. Ç. Në datë 30.09.2024 është kryer refuzimi nga ndihma ekonomike i familjes P. I. Ç. për mosdeklarim page të anëtares N. M. Për aplikanten P. I. Ç. është paraqitur informacion i plotë në lidhje me anëtaren N. M.(nusja e djalit), pasi kjo e fundit ka qenë e deklaruar AK, trajtohej me urdhër mbrojtjeje, ishte në proces divorci, si dhe ishte larguar nga banesa e aplikueses prej janarit 2024. Edhe në përfitimet mujore, aplikuesja ka përfituar ndihmë ekonomike vetëm për veten e saj, pasi edhe djali i saj, R. M., është person me aftësi të kufizuara, sipas aplikimeve AK-2024-015571 me periudhë përfitimi 01.06.2024–01.06.2025 dhe AK-2025-019831 me periudhë përfitimi 01.06.2025–01.06.2026. Në bazë të informacionit të mësipërm, të gjendjes së vështirë social-ekonomike të familjes dhe të relacionit nga administratori shoqëror, është

lejuar që aplikuesja P. I. Ç. të riaplikojë në datë 02.10.2024 me nr. aplikimi NE-2024-024718. Pra, lidhur me anëtaren N.M. (nusja e djalit), ajo ka qenë e deklaruar AK, pasi trajtohej me urdhër mbrojtjeje, ishte në proces divorci, si dhe ishte larguar nga banesa e aplikueses prej janarit 2024. Në këtë rast nuk jemi në kushtet e deklarimit të rremë, sepse familja nuk ka pasur dijeni për punësimin e Nafies. Ndaj është lejuar riaplikimi, duke marrë në konsideratë Ligjin Nr. 57/2019, datë 18.07.2019, të ndryshuar, neni 2, germa b dhe neni 5, germa c, relacionin e administratorit shoqëror me datë 16.10.2024, si dhe vendimet e gjykatës.

4-Aplikimi nr. NE-2024-022166, aplikanti A. I. D. Në datë 27.08.2024 është kryer refuzimi nga ndihma ekonomike i familjes A. I. D. për mosdeklarim page të anëtares M. D. Në bazë të gjendjes së vështirë social-ekonomike (familje me probleme sociale; 3 fëmijë deri në moshën 6-vjeçare janë rritur në qendër rezidenciale – Shtëpia e Foshnjës Korçë; aplikuesi ka probleme shëndetësore dhe është e pamundur që të punësohet), është lejuar që aplikuesi A. I. D. të riaplikojë në datë 03.09.2024 me nr. aplikimi NE-2024-022166. Nga ana e verifikuesit, në datë 25.09.2024, në faqen 24 të verifikimeve është plotësuar shënimi përkatës. Bazuar në Ligjin Nr. 57/2019, datë 18.07.2019, të ndryshuar, neni 2, germa b dhe neni 5, germa c, në informacionin e DRSHSSH-së, në gjendjen e vështirë social-ekonomike të familjes dhe në relacionin nga administratori shoqëror, është lejuar që aplikuesi A. I.D.të riaplikojë në datë 03.09.2024 me nr. aplikimi NE-2024-022166. Në këtë rast nuk është deklarim i rremë nga ana e qytetarit, por gabim nga ana e administratorit shoqëror, duke e shënuar në rubrikën e gabuar të formularit të aplikimit. Gjurma në sistem mbi riaplikimin është lënë në rubrikën e vizitës në banesë (faqe 24 e rubrikës "Verifikime"), nga ana e verifikuesit të Drejtorisë Rajonale.

5-Aplikimi nr. NE-2025-015792, aplikanti M. Z. L. Në datë 29.04.2025 është kryer refuzimi nga ndihma ekonomike i familjes M. Z. L. për mosdeklarim page të kryefamiljarit. Aplikuesi nuk ishte i punësuar për muajt shkurt dhe mars 2025 (sipas listës së kontributeve për punëmarrësin nga e-Albania dhe sipas listëpagesës së subjektit punëdhënës), kjo për shkak të deklarimit të gabuar në tatime nga subjekti punëdhënës, veprim i korrigjuar më vonë. Fakti është vërtetuar edhe nga verifikimi automatik me DPT në muajin qershor 2025 (faqe 13 e verifikimeve). Familja përbëhet nga 6 anëtarë (2 bashkëshortë dhe 4 fëmijë nën 18 vjeç). Bashkëshortja A. L. është person me aftësi të kufizuara, si dhe përfituese nga mbrojtja e veçantë (sipas VKM nr. 751, datë 01.12.2022). Familja jeton në banesë 1-katëshe të vjetër, në kushte të papërshtatshme jetese. Bazuar në Ligjin Nr. 57/2019, datë 18.07.2019, të ndryshuar, neni 2, germa b dhe neni 5, germa c, në informacionin nga DPT, në gjendjen e vështirë social-ekonomike të familjes (familje në kushte ekstreme jetese me probleme sociale dhe 4 fëmijë nën moshën 18-vjeçare), si dhe në relacionin e administratorit shoqëror, është lejuar që aplikuesi M. Z. L. të riaplikojë në datë 09.06.2025 me nr. aplikimi NE-2025-015792. Në këtë rast nuk është deklarim i rremë nga ana e qytetarit, por gabim nga ana e subjektit punëdhënës, i cili ka kryer deklarim të gabuar në DPT. Gjurma në sistem mbi riaplikimin është lënë nga administratori shoqëror në rubrikën "Vlerësimet", pika 3.

6-Aplikimi nr. NE-2025-006074, aplikanti A. R. Ç. Në datë 31.01.2025 është kryer refuzimi nga ndihma ekonomike i familjes A. R. Ç. për mosdeklarim page (deklarim i rremë) të anëtares A. Ç.. Sipas procesverbalit, datë 07.02.2025, të mbajtur nga administratori shoqëror, rezulton se familja përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët anëtarja Dh.Ç. (bashkëshortja e aplikuesit) është person me aftësi të kufizuara. Familja jeton në zonë shumë të thellë malore, me kushte të vështira jetese (banesë 1-katëshe shumë e vjetër me orendi të vjetra), si dhe vajza A.Ç.është e punësuar larg familjes. Gjithashtu, sipas procesverbalit deklarohet se anëtarja A.Ç. nuk ishte në dijeni të rritjes së pagës, pasi sipas të dhënave nga DPT, deri në muajin tetor 2025 ka qenë e punësuar me pagë bruto prej 50.000 lekësh.Për shkak të diferencës së pagës (5.000 lekë), nuk mund të quhet deklarim i rremë nga ana e familjes, pasi vjen si pasojë e rritjes së pagës minimale. Pra, familja e ka përmbushur detyrimin ligjor dhe e ka deklaruar pagën, ndërsa Drejtoria Rajonale e ka refuzuar familjen për një diferencë të vogël page. Nisur nga fakti që familja plotëson kushtet e Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019, të ndryshuar, neni 2, germa b dhe neni 5, germa c, për rrjedhojë është lejuar riaplikimi i familjes pa kaluar afati i penalizimit 6-mujor. Riaplikimi para afatit 6-mujor të refuzimit nga ndihma ekonomike është lejuar duke pasur parasysh gjendjen social-ekonomike të aplikuesve (sipas procesverbaleve përkatëse), dokumentacionet justifikuese lidhur me pagat nga DPT, pensionet nga ISSH etj. Gjithashtu, nga verifikuesit dhe vendimmarrësit e DRSHSSH Korçë sqarojmë se rastet e sipërpërmendura nuk janë vlerësuar si deklarim i rremë, por si mospërputhje e të ardhurave dhe si të tilla janë trajtuar rast pas rasti, duke lejuar riaplikimin, bazuar në Ligjin Nr. 57/2019, datë 18.07.2019, të ndryshuar, neni 2 "Qëllimi", ku përcaktohet se: "Ky ligj ka për qëllim: ...", germa (b), "të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre", si dhe në nenin 5 "Parime të përgjithshme", ku përcaktohet se: "Parimet bazë, në bazë të të cilave funksionojnë programet e asistencës sociale janë: ...", germa (c), "mbështetja sociale është parimi që përcakton se individët/familjet, të cilët përmbushin kushtet për të përfituar, kanë të drejtën e përfitimit në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë".

7-Lidhur me rastin e Z. V. S. me nr aplikimi NE-2022-034785, ju sqarojmë se riaplikimi brenda afatit të penalitetit është kryer me aprovimin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Berat, pasi z. S.ishte punësuar në programin "Punë në Komunitet". Bazuar në Urdhrin nr.148, dt. 28.02.2022 të 2 ministrive, MSHMS dhe MF, "Për personat që do të përfitojnë nga Programet e Nxitjes së Punësimit, individët që do të punësohen apo

ndërmjetësohen për punësim nga ZP, nuk do të largohen nga skema e NE deri në punësim të qëndrueshëm". Në këtë rast z. V. ka filluar punën në komunitet dhe ai ka deklaruar pagën reale të cilën përfiton prej 12.000 lekë në muaj, pasi puna në komunitet është një punë 4 orarëshe, ndonëse mospërputhja në sistemin elektronik të NE nga DPT vjen sa masa e pagës minimale. Duke qenë se deklarimi 3 nujor nuk ishte kryer ende, DRSHSSH nuk kishte dijeni mbi origjinën e të ardhurave dhe e ka refuzuar familjen. Pas komunimit të DRSHSSH Berat me njësinë administrative është lejuar riaplikimi. Përsa më sipër nuk konsiderohet deklarim i rremë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi lexoi me vëmendje parashtrimet tuaja, arsyeton se në lidhje me rastet e E. N. A. dhe A. I. D., ku si ju citoni ka qenë gabim nga ana e administratorit shoqëror., ky gabim mbetet përgjegjësi e SHSSH dhe strukturave përkatëse, pasi në të dyja rastet individët/familjet nuk kanë marrë ndihmën që u takon deri në riaplikim dhe gjithashtu nuk ka një shënim në sistem që pasqyron këto gabime.

Në lidhje me rastet e tjera theksojmë se rifutja në skemë brenda periudhës 6 mujore nga shkëputja për deklarim të rreme, është e pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet se:"Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmujore familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm, që fsheh informacionin apo kryen deklarim të rremë". Për rrjedhojë, observacionet e paraqitura nga subjekti nuk paraqesin fakt të ri ndaj nuk do të merren në konsideratë.

Pretendimi i subjektit DRSHSSH Durrës:

1-F. G. T. (NE-2017-014107) Në lidhje me rastin e familjes T., pas një komunikimi me Administratorin Shoqëror, është sqaruar se automjeti ka qenë në pronësi të babait të znj. S. T., i cili ka ndërruar jetë. Si pasojë, automjeti ka kaluar në pronësi të gjashtë fëmijëve të tij. Duke marrë parasysh se kjo pasuri është e përbashkët dhe e shpërndarë midis trashëgimtarëve, si dhe duke vlerësuar situatën socio-ekonomike të familjes, është kryer riaplikimi përkatës, ku automjeti është deklaruar, edhe pse znj. S. T. nuk është pronare e plotë (100%) e tij por 1/6 e automjetit. Riaplikimi para afatit të penalitet nuk përbën shkelje, kjo pasi nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit të rremë kjo për arsye të situatës ligjore të familjes T. (çelje trashëgimie) vërtetuar kjo me dokumentacionin përkatës. Bashkëlidhur po ju dërgojmë komunikimin me Administratorin Shoqëror dhe dokumentacioni që provon kalimin e pronësisë së automjetit te të gjithë trashëgimtarët/fëmijët dhe më pas dhurimin e saj në favor të një anëtari të vetëm.

2-K. F. Gj. (NE-2022-021211): Lidhur me rastin e familjes Gj. për të cilin observacioni i paraqitur nga ana jonë nuk është trajtuar nga grupi i auditimit sqarojmë se. nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit rezulton se në verifikimin automatik të kryer me DPT-në, në datë 14.11.2023, Znj.D. Gj. është e punësuar për një periudhë dymujore konkretisht muajt Gusht - Shtator 2023. Nisur nga fakti që deklarimi tre mujor është kryer përpara muajit të punësimit (Shtator 2024), në mospërputhjen e ardhur në muajin Nëntor 2023 familja nuk është refuzuar dhe i është lënë e drejta për ta deklaruar punësimin në deklarimin 3 mujor, konkretisht në muajin Dhjetor 2023, duke respektuar këtu edhe periudhën tre mujore të provës. Duke iu referuar të dhënave që vijnë nga DPT, znj. Gj. ka qenë në mardhënie pune vetëm dy muaj (Gusht-Shtator 2023) dhe nuk ka vijuar, e konfirmuar kjo edhe nga verifikimi automatik i ardhur në muajin Dhjetor 2023, ku përsëri rezulton e punësuar vetëm për ata dy muaj dhe nuk ka rezultuar asnjë rekord i ri punësimi, si rrjedhojë i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës. Për sa më sipër familja Gj. nuk është refuzuar në muajin Nëntor 2023 kur ka ardhur mospërputhja nga DPT, pasi nuk ndodhet në kushtet e deklarimit të rremë apo fshehjes së informacionit. Lidhur me pretendimin e grupit të auditimit se familja Gj. duhej të ishtë refuzuar që nga momenti i aplikimit sqarojmë se, nga verifikimi me DPT Znj. D. Gj. nga nuk rezulton e punësuar që nga momenti i aplikimit. Nga verifikimet fillestare të kryera më datë 13.06.2022, nga verifikimi i pagave rezulton se nuk ka asnjë listëpagesë për këtë anëtare. Në lidhje me aplikimin e datës 07.01.2025, pas refuzimit të aplikimit të datës 19.09.2024, sqarojmë se ky aplikim është bërë pas fushatës së zhvilluar nga Shërbimi Social Shtetëror në muajin Dhjetor të vitit 2024, gjatë së cilës janë përzgjedhur 20 familje për t'u mbështetur me bazë materiale (TV, frigorifer, sobë etj.). Grupi i Drejtorisë Rajonale dhe Administratori Shoqëror, pas vlerësimit të kushteve social- ekonomike dhe kushteve të banesës së familjes, kanë referuar familjen për riaplikim në muajin janar. Ky riaplikim është kryer me qëllim fuqizimin dhe mbështetjen e kësaj familjeje me shumë anëtarë, përfshirë 4 fëmijë nën moshën 18 vjeç.

3-L. R. O. (NE-2024-029891): Lidhur me rastin e familjes O. sqarojmë se, familja ka aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike në muajin Dhjetor 2024 dhe nuk e ka deklaruar mjetin motorrik në formularin e aplikimit. Mospërputhja e ardhur në muajin Dhjetor 2024 për mjetim motorrik është trajtuar nga verifikuesi por nuk është konsideruar shkelje për arsye të emailit të datës 18.12.2024 të SHSSH- së ku është kërkuar të mos skualifikohen familjet të cilat vijnë me mospërputhje nga DPSHTRR në muajin Dhjetor 2024, për arsye të problematikave që ka pasur sistemi i tyre. Në vijim, mospërputhja e ardhur nga DPSHTRR në muajin Mars 2025, është trajtuar nga verifikuesi dhe është konsideruar shkelje pasi nuk ishte deklaruar në formularin e aplikimit dhe familja është refuzuar po në muajin Mars 2025 sipas procedurave ligjore. Për sa më sipër qëndrimi i grupit të auditimit se familja duhet të ishte refuzuar që në mospërputhjen e ardhur në muajin Dhjetor 2024 nuk qëndron pasi Drejtoria Rajonale ka vepruar sipas udhëzimeve dhe nuk e ka refuzuar familjen për arsye të problematikave të sistemit në muajin Dhjetor, muaj ku familja ka aplikuar, ndërsa në muajin Mars 2025 ka vijuar sipas përcaktimeve ligjore

duke e refuzuar familjen për mosdeklarim mjeti motorrik. Për sa i përket riaplikimit në muajin prill 2025, ju sqarojmë se ky aplikim është kryer pas kërkesës së administratorit shoqëror, pasi familja jeton në kushte tejet të vështira ekonomike.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi lexoi me vëmendje parashtrimet tuaja, arsyeton se: Për rastin e aplikimit NE-2017-014107 fakti që automjeti ishte në bashkëpronësi si pasojë e trashëgimisë nuk e përjashton detyrimin për deklarimin e tij në formularin e aplikimit. Mosdeklarimi i pasurisë përbën mospërputhje me kërkesat ligjore dhe nuk justifikon lejimin e riaplikimit përpara përfundimit të periudhës së refuzimit. Për rastin e aplikimit NE-2022-021211 argumentet e paraqitura lidhur me periudhën e punësimit dhe gjendjen social-ekonomike të familjes nuk ndryshojnë faktin se aplikimi është trajtuar në kundërshtim me rregullat e skemës së ndihmës ekonomike. Gjithashtu, riaplikimi i kryer pas refuzimit, me qëllim përfshirjen në një program mbështetës, nuk përbën bazë ligjore për shmangien e periudhës së penalizimit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Për rastin e aplikimit NE-2024-029891 pretendimi se mospërputhja e muajit dhjetor 2024 nuk është konsideruar shkelje për shkak të problematikave të sistemit të DPSHTRR-së nuk përjashton detyrimin e aplikuesit për deklarimin e mjetit motorik në formularin e aplikimit. Për më tepër, familja është refuzuar në muajin mars 2025 pikërisht për mosdeklarim të këtij mjeti, çka konfirmon ekzistencën e shkeljes. Riaplikimi i lejuar përpara përfundimit të afatit të penalizimit, bazuar vetëm në gjendjen e vështirë ekonomike, nuk mbështetet në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për sa më sipër, shpjegimet dhe argumentet e paraqitura nga subjekti i audituar nuk sjellin fakte apo rrethana të reja që ndryshojnë gjetjen e auditimit, ndaj pretendimet e ngritura nuk pranohen.

Pretendimi i subjektit DRSHSSH Elbasan: 1-Aplikimi nr. NE-2023-018312 Familja është refuzuar në muajin mars 2023, pasi nga vizita e hedhur gabimisht në sistem nga administratori shoqëror ka rezultuar se nuk përputhej vendbanimi me vendqëndrimin. Familja është refuzuar bazuar në komentin e hedhur në sistem në rubrikën "Vizita në shtëpi", në datën 15.03.2023, nga administratori shoqëror, vizitë e cila më pas ka rezultuar se është hedhur gabimisht. Për sa më sipër, pas njoftimit të Drejtorisë Rajonale nga administratori shoqëror lidhur me vizitën e hedhur gabimisht, familjes i është lejuar riaplikimi para afatit të penalitetit. Riaplikimi para afatit të penalitetit nuk përbën shkelje, pasi në këtë rast nuk kemi deklarim të rremë dhe, veçanërisht, nuk kemi të bëjmë me përfitime të padrejta. Gjithashtu, bazuar në VKM nr. 597/2019, Kreu II, pika 6, përcaktohet se: "Ndryshimi i vendbanimit të përfituesve të ndihmës ekonomike shoqërohet me transferimin e dokumentacionit pranë bashkisë/njësisë administrative të vendbanimit të ri". Për sa më sipër, familja nuk ka arsye ligjore për t'u penalizuar nga e drejta e përfitimit të ndihmës ekonomike. Hedhja e vizitës gabimisht nga ana e administratorit shoqëror ka sjellë refuzimin e padrejtë të kësaj familjeje nga ana e Drejtorisë Rajonale, ndërkohë që rezulton e provuar se familja banon rregullisht në të njëjtën njësi administrative. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se nga sistemi i gjendjes civile nuk ka ardhur asnjëherë mospërputhje për ndryshim vendbanimi për këtë familje, si dhe vetë administratori shoqëror në dokumentacionin shoqërues të riaplikimit deklaron të njëjtën gjë. Nga ana e administratores shoqërore znj. E. K. është vënë në dispozicion relacioni nr. 244 Prot., datë 17.04.2026. Nga sistemi i Ndihmës Ekonomike rezulton se refuzimi i familjes është bërë në muajin mars 2023 për arsye se nuk përputhej vendbanimi me vendqëndrimin, bazuar në verifikimin e hedhur nga administratori shoqëror në rubrikën "Vizita në shtëpi". Ndërkohë argumentohet se ky shënim është hedhur gabimisht nga ana e saj. Bashkëlidhur paraqitet verifikimi i kryer me DPGJC-në, ku vërtetohet se, si në muajin mars 2023, kur familja është refuzuar, ashtu edhe në muajin maj 2023, kur ka riaplikuar, ajo vijon të jetë banuese e Njësisë Administrative Qendër, fshati Dragostunjë, Librazhd. Është vërtetuar gjithashtu se kjo familje ndodhet në kushte të vështira social-ekonomike.
2-Aplikimi nr. NE-2023-010814 Kjo familje ka aplikuar në muajin dhjetor 2022 dhe është refuzuar po në këtë muaj për arsye "Mosdeklarim page", pasi nga sistemi i verifikimit të pagave kanë rezultuar të dhëna se aplikanti ka qenë i siguruar për muajin paraardhës (nëntor 2022). Mbi këtë verifikim të ardhur nga sistemi i pagave është bërë edhe shënimi nga verifikuesi i Drejtorisë Rajonale dhe, si rrjedhojë, familja është refuzuar nga vendimmarrësi me argumentin "deklarim i rremë, ka anëtarë të punësuar". Në muajin mars 2023 është bërë riaplikim nga administratori shoqëror z. K. Z., i cili, përmes relacionit datë 06.03.2023, argumenton se marrëdhëniet e punës së z. H. kanë përfunduar në muajin nëntor 2022 (një muaj para aplikimit), fakt i vërtetuar nga vërtetimi për pagesën e kontributeve mujore. Ndërkohë, edhe nga verifikimi i sistemit për këtë muaj nuk rezultoi që ai të ishte në vijim të marrëdhënieve të punës. Për sa më sipër, familja ka riaplikuar para afatit të penalitetit dhe ky riaplikim nuk përbën shkelje, pasi nuk kemi të bëjmë me deklarim të rremë, duke qenë se anëtari nuk ka qenë në marrëdhënie pune në momentin e aplikimit dhe, veçanërisht, nuk kemi të bëjmë me përfitime të padrejta. Argumenti i grupit të auditimit se z. H. duhej të ishte refuzuar më parë për shkak se ka qenë i punësuar gjatë periudhës dhjetor 2021 – nëntor 2022 nuk qëndron, pasi gjatë kësaj periudhe ai nuk ka pasur aplikim aktiv në sistem dhe nuk ka qenë përfitues i ndihmës ekonomike. Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht pagesën e ndihmës ekonomike, pasi nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit të rremë. Gjithashtu, lidhur me argumentin e grupit të auditimit se administratori nuk ka bërë koment apo shënim në sistem, sqarojmë se administratori shoqëror, pas paraqitjes së dokumentacionit të DPT-së në Drejtorinë Rajonale, ka marrë miratimin për riaplikim dhe ka vijuar procedurat përkatëse, ndërsa dokumentacionin e ka administruar në dosjen fizike të aplikuesit, në përputhje me pikën 4.1, shkronja "f", të VKM-së nr. 597/2019. Sqarojmë gjithashtu se në sistemin e ndihmës ekonomike nuk

mund të ngarkohet i gjithë dokumentacioni fizik i paraqitur nga aplikuesi dhe, për këtë arsye, administratori shoqëror mban dosje fizike për çdo aplikues/përfitues.
3-Aplikimi nr. NE-2023-035731 Familja është refuzuar për muajin nëntor 2023 me arsyetimin "Deklarim i rremë, gjendje e mirë ekonomike", bazuar në një vizitë të hedhur gabimisht në sistem, në rubrikën "Vizita në shtëpi", nga administratoria shoqërore znj. R. P., në datë 30.10.2023. Në muajin pasardhës është bërë riaplikimi para afatit, pasi administratoria ka konstatuar se vizita e mëparshme ishte hedhur gabimisht dhe ka vënë në dispozicion të Drejtorisë Rajonale relacionin nr. 05 Prot., datë 07.01.2026. Riaplikimi është kryer pasi është vërtetuar se vizita ishte hedhur gabimisht dhe familja nuk ndodhet në gjendje të mirë ekonomike, por në kushte të vështira social-ekonomike. Kryefamiljari është i papunë dhe familja jeton në një banesë në kushte të papërshtatshme, e cila nuk është në pronësinë e saj. Për këtë familje nuk rezulton të ketë pasur ndonjë rekord refuzimi për arsye të tjera. Pra, familja nuk është refuzuar për deklarim të rremë, por për një gabim të administratorit shoqëror. Shënimet përkatëse janë bërë në formularin e aplikimit, në seksionin "Të ardhura të tjera", pika 30 "Tjetër (diçka që aplikanti dëshiron të thotë)". Sa më sipër, nuk jemi në kushtet e deklarimit të rremë, pasi është provuar se familja nuk është në gjendje të mirë social-ekonomike, është pa të ardhura dhe jeton në kushte vështirësie e pamundësie. Për rrjedhojë, nuk mund të penalizohet nga e drejta e aplikimit për shkak të një gabimi të administratorit shoqëror.
4-Aplikimi nr. NE-2024-013111 Për pjesën e dëmit në masën 189,373 lekë, për periudhën 17.04.2021 – 01.12.2023, pas verifikimit tonë nëpërmjet sistemit të Ndihmës Ekonomike rezulton se familja A. ka kryer deklarimin e masës së pensionit brenda muajit të parë të përfitimit, në momentin kur kryefamiljari ka dalë në pension. Ky deklarim është hedhur në sistemin e Ndihmës Ekonomike në datën 17.03.2021 nga administratorja shoqërore znj. M. S., në rubrikën "Vizita në shtëpi". Duke qenë se kryefamiljari është paraqitur për deklarimin e këtij ndryshimi pas datës 10 të muajit, deklarimi përmes vizitës në shtëpi ka qenë i vetmi opsion që administratori shoqëror ka pasur për të modifikuar formularin e aplikimit. Kjo rezulton e pasqyruar dhe është ende e verifikueshme nëpërmjet rubrikës "Printo", ku shfaqet formulari i përditësuar për këtë numër aplikimi. Nga ana e specialistit të Drejtorisë Rajonale, në cilësinë e verifikuesit, kjo situatë është konstatuar dhe, për rrjedhojë, nuk është konsideruar shkelje për refuzimin e aplikimit. Ndërkohë, sqarojmë se refuzimi nga skema e Ndihmës Ekonomike në muajin dhjetor 2023 nuk është kryer për mosdeklarim pensioni, pasi familja e ka deklaruar pensionin dhe ky fakt vërtetohet nga formulari bashkëlidhur. Refuzimi është bërë për shkak të mospërputhjes së masës së pensionit, pasi gjatë verifikimit është konstatuar se masa e pensionit të përfituar nga shtetasi M. A., sipas verifikimit automatik të ardhur nga ISSH, ka pësuar rritje me kalimin e kohës për efekt indeksimi ose shtese të masës së pensionit dhe ky ndryshim nuk është pasqyruar në sistem nga përfituesi ose administratori shoqëror. Për këtë arsye, verifikuesi i Drejtorisë Rajonale ka lënë shënimin përkatës në sistem, me qëllim që vendimmarrësi të merrte masat për largimin e familjes nga skema, në përputhje me VKM nr. 597/2019, Kreu II, pika 11, shkronja "ç". Ky fakt dokumentohet nga të dhënat përkatëse që rezultojnë në sistem, konkretisht në rubrikën e verifikimeve të pensionit për muajin nëntor 2023.
5-Aplikimi nr. NE-2024-008749 Për pjesën e dëmit në masën 23,904 lekë, për periudhën nëntor 2023 – 04.03.2024, pas verifikimit tonë nëpërmjet sistemit të Ndihmës Ekonomike rezulton se dosja e pensionit familjar për përfituesen E. Ll. është konfirmuar në muajin nëntor 2023. Në të njëjtin muaj, specialisti i Drejtorisë Rajonale, në cilësinë e verifikuesit, ka pasqyruar në sistemin e Ndihmës Ekonomike një shënim në rubrikën e komenteve: "Do të monitorohet në vijim", pa e konsideruar menjëherë shkelje. Kjo pasi pensioni familjar sapo ishte konfirmuar dhe familjarët kishin marrë dijeni për të vetëm pasi pagesa kishte kaluar në Postën Shqiptare, rreth dy muaj më vonë. Ky shënim është lënë me qëllim që familjes t'i jepej mundësia të deklaronte ndryshimin në deklarimin e radhës tremujor, në përputhje me VKM nr. 597/2019, Kreu II, pika 11. Në verifikimin automatik pasardhës, konkretisht në muajin shkurt 2024, është konstatuar se në deklarimin tremujor të muajit janar 2024 ky ndryshim në të ardhura nuk ishte pasqyruar. Për këtë arsye, situata është konsideruar shkelje dhe familja është refuzuar në muajin shkurt 2024. Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht, pasi nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit të rremë apo të fshehjes së informacionit, për aq kohë sa familja nuk kishte informacion mbi afatin e lidhjes së pensionit dhe masën e tij.
6-Aplikimi nr. NE-2025-016777 Për pjesën e dëmit në masën 261,359 lekë, për periudhën 11.02.2022 – 28.03.2025, pas verifikimit tonë nëpërmjet sistemit të Ndihmës Ekonomike rezulton se deklarimi i masës së pensionit është bërë brenda muajit të parë të përfitimit, në momentin kur personi ka dalë në pension. Ky deklarim është hedhur në sistemin e Ndihmës Ekonomike në datën 16.02.2022 nga administratorja shoqërore znj. L. H., në rubrikën "Vizita në shtëpi". Duke qenë se kryefamiljari është paraqitur për deklarimin e këtij ndryshimi pas datës 10 të muajit, deklarimi përmes vizitës në shtëpi ka qenë i vetmi opsion që administratori shoqëror ka pasur për të modifikuar formularin e aplikimit. Ky veprim rezulton i pasqyruar dhe është ende i verifikueshëm nëpërmjet rubrikës "Printo", ku paraqitet formulari i përditësuar për këtë numër aplikimi. Nga ana e specialistit të Drejtorisë Rajonale, në cilësinë e verifikuesit, kjo situatë është konstatuar dhe nuk është konsideruar shkelje për refuzimin e aplikimit. Ndërkohë, sqarojmë se refuzimi nga skema e Ndihmës Ekonomike në muajin mars 2025 është bërë për shkak të mospërputhjes së masës së pensionit, pasi gjatë verifikimit është konstatuar se masa e pensionit që përfiton shtetasi O. M.i ka pësuar rritje me kalimin e kohës dhe ky ndryshim nuk është pasqyruar në sistem nga përfituesi ose administratori shoqëror. Për këtë arsye, verifikuesi i Drejtorisë Rajonale ka lënë shënimin përkatës

në sistem, me qëllim që vendimmarrësi të merrte masat për largimin e familjes nga skema, në përputhje me VKM nr. 597/2019, Kreu II, pika 11, shkronja "g". Ky fakt dokumentohet nga të dhënat përkatëse që rezultojnë në sistem, konkretisht në rubrikën e verifikimeve të pensionit për muajin mars 2025.
Nga ana jonë u verifikua përllogaritja e shumave, nga ku rezultuan disa raste me mospërputhje me përllogaritjen e kryer nga sistemi. Problematika qëndron në llogaritjen e muajve dhe në faktin se janë shtuar pagesa ekstra mbi totalin e llogaritur nga vetë sistemi, duke përfshirë edhe pagesën ekstra. Rastet e mëposhtme janë rillogaritur nga ana jonë bazuar në të dhënat e sistemit. Për këto raste, edhe pse nuk kemi argumente lidhur me riaplikimet para afatit, gjykojmë se masa e efektit financiar duhet të rishqyrtohet dhe të merret në konsideratë:
1. Aplikimi nr. NE-2023-032498, aplikanti M.T. Xh. Efekti financiar i pasqyruar në aktkonstatim është në masën 45,645 lekë, ndërsa nga sistemi rezulton të jetë 36,516 lekë. Rasti lidhet me riaplikim para afatit dhe është në ngarkim të administratorit shoqëror z. G. L., Njësia Administrative Orenjë.
2. Aplikimi nr. NE-2023-017631, aplikanti A. H. Ç. Efekti financiar i pasqyruar në aktkonstatim është në masën 43,465 lekë, ndërsa nga sistemi rezulton të jetë 34,772 lekë. Rasti lidhet me riaplikim para afatit dhe është në ngarkim të administratorit shoqëror z. G. P., Njësia Administrative Poroçan.
3. Aplikimi nr. NE-2023-022930, aplikanti A. H. K. Efekti financiar i pasqyruar në aktkonstatim është në masën 62,536 lekë, ndërsa nga sistemi rezulton të jetë 46,532 lekë. Rasti lidhet me riaplikim para afatit dhe është në ngarkim të administratorit shoqëror z. G. L., Njësia Administrative Orenjë.
4. Aplikimi nr. NE-2023-026313, aplikanti J.A. A. Efekti financiar i pasqyruar në aktkonstatim është në masën 29,584 lekë, ndërsa nga sistemi rezulton të jetë 21,544 lekë. Rasti lidhet me riaplikim para afatit dhe është në ngarkim të administratorit shoqëror z. G. L., Njësia Administrative Orenjë.
5. Aplikimi nr. NE-2024-012911, aplikanti A. L. V. Efekti financiar i pasqyruar në aktkonstatim është në masën 26,135 lekë, ndërsa nga sistemi rezulton të jetë 20,908 lekë. Rasti lidhet me riaplikim para afatit dhe është në ngarkim të administratores shoqërore znj. V. Ç., Bashkia Elbasan.
6. Aplikimi nr. NE-2025-017627, aplikanti Xh. I. B. Efekti financiar i pasqyruar në aktkonstatim është në masën 46,320 lekë, ndërsa nga sistemi rezulton të jetë 30,888 lekë. Rasti lidhet me riaplikim para afatit dhe është në ngarkim të administratores shoqërore znj. A. Y., Njësia Administrative Kushovë.
7. Aplikimi nr. NE-2025-013160, aplikanti M. S. T. Efekti financiar i pasqyruar në aktkonstatim është në masën 53,088 lekë, ndërsa nga sistemi rezulton të jetë 38,024 lekë. Rasti lidhet me riaplikim para afatit dhe është në ngarkim të administratorit shoqëror z. E. Zh., Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Elbasan.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi lexoi me vëmendje parashtrimet tuaja arsyeton se në lidhje me aplikimet nr. NE-2023-018312 dhe NE-2023-035731 ku si ju citoni ka pasur gabime nga ana e administratorit shoqëror. Ky gabim mbetet përgjegjësi e SHSSH dhe strukturave përkatëse, pasi në të dyja rastet individët/familjet nuk kanë marrë ndihmën që u takon deri në riaplikim dhe gjithashtu nuk ka një shënim në sistem që pasqyron këto gabime. Në lidhje me aplikimin e A.I.H. në sistem nuk është lënë nga ana e administratorit asnjë koment/shënim argumentues për këtë rast. Në lidhje me aplikimin e Sh. H. K., dokumentacioni shoqërues (relacioni) që keni paraqitur është mbajtur më datë 07.01.2026, pra afërsisht 3 vite pas shkëputjes nga skema dhe riaplikimit te z.K., ndërkohë që aplikanti është rifutur në skemë dhe rezulton përfitues. Gjithashtu, ky relacion nuk është ngarkuar në sistem dhe nga ana e administratorit nuk ka asnjë shënim/koment sqarues. Në lidhje me aplikimin e E.Q.Ll., dokumentacioni shoqërues (relacioni) që keni paraqitur është mbajtur më datë 03.02.2026, pra afërsisht 2 vite pas shkëputjes nga skema dhe riaplikimit te z.Ll., ndërkohë që aplikanti është siç ju citoni në qendrimin tuaj, verifikimi automatik e ka nxjerrë familjaren si përfituese të penisionit që më datë 16.11.2023. Komenti i monitorimit të mëpasshem, nuk e përjashton nga përgjegjësia verifikuesin përkatës. Në lidhje me përllogaritjen e pagesave nga sistemi NE, argumentojmë se sistemi pasqyron përfitimin mujor që merr përfituesi (në rubrikën "Përfitime"), totali përllogaritet në bazë të shumatores së këtyre vlerave. Rastet e sipërpermendura janë perllogaritur nga grupi i auditimit bazuar në ndihmën mujore që vetë sistemi nxjerr për periudhën 6 mujore të penalizimit. Sa më sipër, observacioni i paraqitur nga subjekti nuk merret në konsideratë. Sa më sipër, observacioni i paraqitur nga subjekti nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit DRSHSSH Tiranë: 1-NE-2023-030160 Lidhur me rastin e familjes D., sqarojmë se familja është refuzuar në muajin korrik 2023 për arsyen "Mosdeklarim pensioni", pasi nga verifikimi me ISSH-në rezultoi se përfitonte pension invaliditeti. Nga komunikimi me administratorin shoqëror dhe verifikimi me ISSH-në rezulton se z. A. D. është rivlerësuar nga ISSH-ja (gjë e verifikueshme përmes verifikimeve automatike të kryera me ISSH-në), ku për periudhën tetor 2023 – janar 2025, nga verifikimet automatike rezulton se pensioni i invaliditetit ka qenë i bllokuar përkohësisht, ndërsa në mars 2025 rezulton se nuk ka pasur rinovim të pensionit. Pra, z. D. ka përfituar pension vetëm deri në muajin korrik 2023 dhe më pas nuk ka vijuar të jetë përfitues. Për sa më sipër, z. D. nuk ka kryer deklarim të rremë dhe i është lejuar riaplikimi. Riaplikimi para afatit të penalitetit nuk përbën shkelje, pasi nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit të rremë, duke qenë se z. D. nuk ka qenë përfitues i pensionit pas muajit korrik 2023. Për rrjedhojë, familja nuk ka përfituar padrejtësisht pagesën e ndihmës ekonomike.

2- NE-2023-019746 Lidhur me rastin e familjes K., sqarojmë se familja është refuzuar në vendimmarrjen e muajit prill 2023 me arsyen "Mosdeklarim page". Nga verifikimi i kryer në sistem, në formularin e aplikimit rezulton se familja e ka deklaruar punësimin dhe masën e pagës në vlerën 59,933 lekë (e vërtetueshme në seksionin "Print" të formularit të aplikimit). Pra, familja e ka përmbushur detyrimin ligjor dhe e ka deklaruar pagën. Nisur nga fakti se familja e ka përmbushur detyrimin e saj ligjor, nuk kemi të bëjmë me deklarim të rremë dhe, për rrjedhojë, është lejuar riaplikimi pa kaluar afati 6-mujor i penalizimit. Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht shumën prej 23,524 lekësh, pasi nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit të rremë. Familja ka kryer detyrimin e saj ligjor dhe ka deklaruar saktë masën e pagës, ndërsa refuzimi ka ardhur si rezultat i një vlerësimi të gabuar nga Drejtoria Rajonale. Për rrjedhojë, familja nuk mund t'i nënshtrohet afatit 6-mujor të penalitetit.
3-Zh. P. N. Lidhur me rastin e familjes N., sqarojmë se familja është refuzuar nga sistemi i ndihmës ekonomike në vendimmarrjen e muajit tetor 2024 me arsyen "Mospërputhje strukture". Familja rezulton në kushte shumë të vështira social-ekonomike. Është familje rome, me dy anëtarë që trajtohen me pagesë për aftësi të kufizuar në kategoritë PTP dhe PAK. Familja jeton në një banesë të improvizuar dhe të përshtatur nga bashkia. Kryefamiljarja ka qenë e pajisur me urdhër mbrojtjeje ndaj ish-bashkëshortit, ndërsa djali i saj ka probleme të shëndetit mendor dhe është larguar nga trungu familjar. Lidhur me pretendimin e grupit të auditimit se nuk ka shënime nga administratori në sistem, sqarojmë se administratori shoqëror ka bërë shënim në formularin e aplikimit, në seksionin "Të ardhura të tjera", pika 30 "Tjetër (diçka që aplikanti dëshiron të thotë)", ku ka cituar: "Është kryefamiljare, me dy vajza me aftësi të kufizuara, janë 6 anëtarë. Jeton në kushte të vështira social-ekonomike. Djali A.J. ka bërë ndarje nga familja, është me probleme të shëndetit mendor." Referuar faktit se familja ka deklaruar ndarjen nga trungu familjar të djalit, nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit të rremë dhe familja është lejuar të riaplikojë përmes komunikimit me e-mail nga Drejtoria Rajonale. Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht pagesën e ndihmës ekonomike.
4. F. I. K. Lidhur me rastin e familjes K., sqarojmë se familja është refuzuar nga sistemi i ndihmës ekonomike në vendimmarrjen e muajit mars 2024 me arsyen: "Nga vizita në banesë rezulton se kryefamiljari është emigrant". Duke qenë se familja K. ka paraqitur epikrizën e lëshuar nga mjeku i familjes, ku rekomandohen vizita mjekësore nga z. K. në Kosovë gjatë muajit mars 2024, është lejuar riaplikimi. Pra, familja është lejuar të riaplikojë para afatit të penalitetit, pasi, bazuar në dokumentacionin shëndetësor të paraqitur, nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit të rremë. Lidhur me pretendimin e grupit të auditimit për mungesën e shënimeve në sistem, sqarojmë se administratori shoqëror ka bërë shënim në formularin e aplikimit, në seksionin "Të ardhura të tjera", pika 30 "Tjetër", ku është cituar: "Familje e varfër, ka aplikuar para afatit të penalizimit." Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht pagesën e ndihmës ekonomike, pasi qëndrimi jashtë territorit ka qenë për arsye shëndetësore, fakt i provuar me dokumentacionin përkatës.
5-A. M. B. Lidhur me rastin e familjes B, sqarojmë se familja është refuzuar nga sistemi i ndihmës ekonomike në vendimmarrjen e muajit tetor 2024 me arsyen "Mosdeklarim page". Nga verifikimi me DPT në muajin tetor 2024 rezulton se znj. B. ka qenë e punësuar vetëm për periudhën korrik–gusht 2024, periudhë për të cilën është refuzuar gabimisht nga Drejtoria Rajonale, pasi punësimi ka qenë para aplikimit në skemën e ndihmës ekonomike. Pas riaplikimit dhe verifikimit të kryer në muajin dhjetor 2024, rezulton se znj. B. nuk vijon të jetë e punësuar. Muaji i fundit i punësimit mbetet gushti 2024. Bazuar në Udhëzimin nr. 670, datë 13.12.2022, "Për procedurën e përfitimit nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre ose më shumë fëmijë deri në moshën 18 vjeç", qytetarja përfiton nga ky program. Për rrjedhojë, familja është lejuar të riaplikojë para afatit të penalitetit, pasi nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit të rremë. Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht pagesën e ndihmës ekonomike.
6-A. Q. B. Lidhur me rastin e familjes B., sqarojmë se familja është refuzuar në muajin gusht 2025 me arsyen "Struktura e familjes në sistemin e NE-së nuk është e njëjtë me atë në sistemin e DPGJC-së". Nga komunikimi me administratorin shoqëror dhe verifikimi në DPGJC rezulton se në familjen B. është krijuar një kurorë e re, fakt i vërtetuar me certifikatën familjare. Për këtë arsye, edhe pse familja është refuzuar nga Drejtoria Rajonale, i është lejuar riaplikimi, pasi nuk kemi të bëjmë me deklarim të rremë. Riaplikimi para afatit të penalitetit nuk përbën shkelje, pasi mospërputhja e strukturës familjare në këtë rast lidhet me krijimin e një kurore të re, rast i përjashtuar nga penalizimi sipas VKM-së nr. 597/2019. Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht pagesën e ndihmës ekonomike.
Nga ana jonë u verifikua përllogaritja e shumave, nga ku rezultuan disa raste me mospërputhje me përllogaritjen e bërë nga sistemi. Problematika qëndron në llogaritjen e muajve dhe në faktin se janë shtuar pagesat ekstra mbi totalin e llogaritur nga vetë sistemi (duke përfshirë edhe vetë pagesën ekstra). Rastet në vijim janë rillogaritur nga ana jonë, bazuar në të dhënat e sistemit. Edhe pse nuk kemi argumente për riaplikimet para afatit, gjykojmë se pjesa e masës financiare duhet të merret në konsideratë.
1. G. I. J. (NE-2025-019171) Lidhur me pretendimin e grupit të auditimit se nuk ka shënime nga administratori në sistem, sqarojmë se është bërë shënimi në formularin e aplikimit, në seksionin "Të ardhura të tjera", pika 30 "Tjetër (diçka që aplikanti dëshiron të thotë)", ku specifikisht citohet:
"Familjes së F.J. po i ribëhet aplikimi pasi ka dalë nga skema e ndihmës ekonomike. Familja është në kushte ekstremisht të varfra dhe konsiderohet familje në nevojë. Nga komunikimi me e-mail u vendos që aplikimi të

ribëhej nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social. Kryefamiljari dhe V. merren me grumbullimin e materialeve të riciklueshme. Znj. F. ka probleme shëndetësore dhe trajtohet me ilaçe në mënyrë të vazhdueshme. Z. G. deklaron se djali, I., është në masën e sigurisë 'Arrest në shtëpi', me nr. akti 1259, datë 16.05.2025." Lidhur me afatin e penalitetit për riaplikimin e kryer nga administratori shoqëror, sqarojmë se afati fillon nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji qershor 2025, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, pra në muajin nëntor 2025. Në muajin dhjetor 2025 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Nisur nga fakti se familja nuk duhej të aplikonte para muajit dhjetor 2025, efekti financiar llogaritet për periudhën gusht–nëntor 2025, në masën 30,872 lekë.
2. A. Ç. Ç. (NE-2024-012939) Lidhur me afatin e penalitetit për riaplikimin e kryer nga administratori shoqëror, sqarojmë se afati fillon nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji mars 2024, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, pra në muajin gusht 2024. Në muajin shtator 2024 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Nisur nga fakti se familja nuk duhej të aplikonte para muajit shtator 2024, efekti financiar llogaritet për periudhën maj–gusht 2024, në masën 36,900 lekë.
3. B. Z.M. (NE-2025-006501) Lidhur me rastin e familjes M, sqarojmë se familja është refuzuar nga sistemi i ndihmës ekonomike në vendimmarrjen e muajit shtator 2024 me arsyen "Mosdeklarim pensioni".
Nga verifikimi në sistem rezulton se në muajin shtator 2024, znj. Xh. ka dalë për herë të parë përfituese e pensionit të pleqërisë. Lidhur me afatin e penalitetit për riaplikimin e kryer nga administratori shoqëror, sqarojmë se afati fillon nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji shtator 2024, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, pra në muajin shkurt 2025. Në muajin mars 2025 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Nisur nga fakti se familja nuk duhej të aplikonte para muajit mars 2025, efekti financiar llogaritet për muajin shkurt 2025 në masën 2,178 lekë.
4. A. Z. B. (NE-2025-027988) Lidhur me afatin e penalitetit për riaplikimin e kryer nga administratori shoqëror, sqarojmë se afati fillon nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji shtator 2025, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, pra në muajin shkurt 2026. Në muajin mars 2026 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Nisur nga fakti se familja nuk duhej të aplikonte para muajit mars 2026, efekti financiar llogaritet për periudhën dhjetor 2025 – shkurt 2026, në masën 18,543 lekë.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me aplikimin e A.D., rifutja në skemë brenda periudhës 6 mujore nga shkëputja për deklarim të rreme (mosdeklarim pensioni), është e pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me nenin 15, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë. Në lidhje me aplikimin e U. K., si dhe ju e përmendët, theksojmë se gabimi është kryer nga ana e administratorit, nga i cili nuk është lënë asnjë koment shpjegues në sistem. Në lidhje me aplikimin e F. K., nga ana juaj nuk janë paraqitur dokumenta justifikues/sqarues, që mbështesin observacionin. Sa më sipër, observacioni i paraqitur nga subjekti nuk merret në konsideratë. Në lidhje me aplikimin e Zh. P. N., nga ana e administratorit shoqëror nuk ka pasur asnjë sqarim në sistem në lidhje me situatën, e cila duhet të ishte kontrolluar nga administratori e më pas nga strukturat përkatëse të SHSSH paraprarakisht në mënyrë që familja të mos humbiste mundësinë e të qenit përfitues e ndihmës ekonomike. Në lidhje me aplikimin e F. I. K. fillimisht ka një mospërputhje mes observacionit të dërguar nga SHSSH datë 21.04.2026 nr.80/11 prot., ku përcaktohet se individi do të marrë ndihmë mjekësore në Mal të Zi, ndërsa në këtë observacion thuhet se rekomandimi mjekësor është në Kosovë. Gjithashtu ky është një konstatim që duhet të ishte kryer nga strukturat përkatëse që në momentin e vizitës në shtëpi ku kryefamiljari nuk është gjetur. Në lidhje me aplikimin e A. B. si dhe ju e përmendët, theksojmë se gabimi është kryer nga ana e administratorit, nga i cili nuk është lënë asnjë koment shpjegues në sistem. Në lidhje me aplikimin e A. Q. B. ndërkohë që rifutja në skemën e ndihmës ekonomike është e drejtë, nga ana e administratorit dhe strukturave përkatëse nuk ka pasur një kontroll paraprak, përpara se individi të përjashtohej nga skema e njëkohësisht asnjë shënim në sistem mbi lejimin e riaplikimit. Gjithashtu grupi i auditimit thekson se procedurat e përdorura me anë të komunikimit me E-mail duke lejuar individët të riaplikojnë pa kaluar periudha 6 mujore që nga skualifikimi (qoftë ky i fundit për gabim të strukturave të SHSSH/administratorit ose vetë individit) është një praktikë që nuk gjendet në asnjë parashikim ligjor. Për sa kohë nuk ka mbështetje ligjore, nuk mund të merret parasysh.
Në lidhje me përllogaritjen e pagesave nga sistemi NE, argumentojmë se sistemi pasqyron përfitimin mujor që merr përfituesi (në rubrikën "Përfitime"), totali përllogaritet në bazë të shumatores së këtyre vlerave. Rastet e sipërpermendura janë perllogaritur nga grupi i auditimit bazuar në ndihmën mujore që vetë sistemi nxjerr për periudhën 6 mujore të penalizimit.
Për sa më sipër, ky observacion merret parasysh pjesërisht për aplikimi e A. B. Ndërsa për rastet e tjera nuk paraqet fakt të ri ndaj nuk do të merret parasysh.

Pretendimi i subjektit DRSHSSH Shkodër: Në konstatimin e tërheqjeve të masës së NE-së brenda afateve ligjore në fuqi (faqe 23 – akt-konstatimi nr. 3), sqarojmë se në rastet kur ka qenë e mundur (ka pasur shënime me datat e tërheqjeve), ato janë reflektuar në raportet e kontrollit dhe është llogaritur dëmi ekonomik. Në rastet kur në listëpagesa nuk ka shënime për kohën e tërheqjes, është i pamundur evidentimi dhe, si rezultat, zbatimi i legjislacionit. Sqarojmë se në rastin e Njësisë Administrative Shosh (cilësuar në projekt-raport, faqe 114) dhe të gjitha njësive të bashkive të Qarkut Shkodër, listëpagesat origjinale me firma janë kontrolluar në zyrën e NE-së

dhe PAK-ut pranë bashkisë (në rastet kur dokumentacioni nuk mbahet në njësi), pavarësisht se në raportet e kontrollit është cilësuar mënyra e administrimit të dokumentacionit. Lidhur me rastet e poshtëshënuara paraqesim kundërshti lidhur me masën e dëmit ekonomik. Bazuar në ligjin "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", konkretisht nenin 12, pika 1, përcaktohet, citojmë: "Ndihma ekonomike është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji...". Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton qartë se ndihma ekonomike ka natyrë mujore dhe nuk lidhet me momentin apo datën e marrjes së vendimit nga Drejtoria Rajonale. Për rrjedhojë, edhe përllogaritja e çdo penaliteti apo dëmi ekonomik nuk mund të bazohet mbi ditë të veçanta, por duhet të kryhet mbi bazë mujore. Procedura administrative, nga momenti i aplikimit deri në marrjen e vendimit përfundimtar, ka për funksion të përcaktojë nëse familja/personi përfiton apo jo ndihmë ekonomike për muajin përkatës.
1-Rasti i aplikantit V.Gj.V. – Aplikim i datës 09.10.2023, refuzuar më datë 01.12.2023 për mosdeklarim vendbanimi. Penalizim 6-mujor për periudhën nëntor 2023 – prill 2024. Riaplikim më datë 12.12.2023. Dëmi ekonomik për periudhën dhjetor 2023 – prill 2024 është 37,897 lekë. Kontrolli i planifikuar për Njësinë Administrative Shkrel është parashikuar në muajin maj 2026, ku do të reflektohet dëmi i konstatuar.
2-Rasti i aplikantit N.P.M. – Aplikim i datës 03.10.2018, refuzuar më datë 02.10.2023 për largim jashtë shtetit. Penalizim 6-mujor për periudhën shtator 2023 – shkurt 2024. Riaplikim më datë 08.03.2024. Familja nuk ka dëm ekonomik.
3-Rasti i aplikantit D.H. Zh. – Aplikim i datës 10.07.2025, refuzuar më datë 31.07.2025 për mosdeklarim biznesi. Penalizim 6-mujor për periudhën korrik 2025 – dhjetor 2025. Riaplikim më datë 12.12.2025. Dëmi ekonomik për muajin dhjetor 2025 është 5,881 lekë, dëm që do të reflektohet në kontrollin e radhës së Njësisë Administrative Shllak.
4-Rasti i aplikantit A. T. V. – Aplikim i datës 09.04.2025, refuzuar më datë 30.04.2025 për mosdeklarim page. Penalizim 6-mujor për periudhën prill 2025 – shtator 2025. Riaplikim më datë 10.09.2025. Dëmi ekonomik për muajin shtator 2025 është 6,181 lekë. Kontrolli i planifikuar për Njësinë Administrative Shkrel është parashikuar në muajin maj 2026, ku do të reflektohet dëmi i konstatuar.
5-Rasti i aplikantit Z. H. R. – Aplikim i datës 10.06.2020, refuzuar më datë 01.10.2025 për mosdeklarim page. Riaplikim më datë 11.11.2025, lejuar me e-mail datë 07.11.2025 nga vendimmarrësi pas ankesës së përfituesit. Lidhur me rastin e sipërcituar, ju sqarojmë se vendimmarrësi ka lejuar riaplikimin para përfundimit të afatit të penalizimit për familjen R., nisur nga situata ekstreme ekonomiko-sociale e familjes, me kryefamiljare 88-vjeçare, dy anëtarë PAK dhe përfshirjen e anëtares së vetme të aftë për punë në programet e nxitjes së punësimit nga Zyra e Punës. Në "Protokollin e Punës për Referimin për Punësim për Anëtarët në Moshë Aktive Pune të Skemës së Ndihmës Ekonomike", faqe 13, theksohet, citojmë: "DRSHSSH gjatë procesit të vendimmarrjes duhet të mos refuzojë rastet, të cilat kanë pranuar ofertat për punësim dhe nuk janë deklaruar ndryshimet gjatë periudhës tremujore të provës". Zonja M. R, në momentin e penalizimit, ka pasur 2 muaj punësim dhe nga ana e administratorit të njësisë nuk është dhënë asnjë informacion në sistemin e NE-së lidhur me llojin e punësimit të aplikantes. Pra, nuk kemi të bëjmë me deklarim të rremë, por me gabim të administratorit.
6-Rasti i aplikantit G. N. D. – Aplikim i datës 10.06.2022, refuzuar më datë 01.10.2025 për mosdeklarim page. Riaplikim më datë 04.12.2025, lejuar me e-mail datë 27.11.2025 nga vendimmarrësi pas kërkesës së Njësisë Administrative. Lidhur me rastin e sipërcituar, ju sqarojmë se vendimmarrësi ka lejuar riaplikimin para përfundimit të afatit të penalizimit për familjen D., nisur nga situata ekstreme ekonomiko-sociale e familjes, e cila ka në përbërje edhe një anëtar PAK. Në mjaft raste, edhe kapacitetet intelektuale të anëtarëve të familjeve aplikuese/përfituese në skemën e NE-së, të ndikuara nga problematikat e jetesës, ndikojnë në saktësinë e të dhënave gjatë vetëdeklarimeve.
7-Rasti i aplikantit Gj. K. N. – Aplikim i datës 06.03.2019, refuzuar më datë 30.10.2025 për mosdeklarim strukture. Në vlerësimin e datës 25.08.2025 është deklaruar lindja e fëmijës N. N. Pra, në këtë rast është përgjegjësi e administratorit për mosreflektimin e ndryshimeve në formularin e aplikimit në sistemin e NE-së dhe jo deklarim i rremë i familjes.
8-Rasti i aplikantit M. Gj. H. – Aplikim i datës 10.11.2022, refuzuar më datë 27.02.2023 për mosdeklarim page. Penalizimi është bërë gabimisht nga ana e Drejtorisë Rajonale, pasi në deklaratën 3-mujore, datë 09.01.2023, nga familja është deklaruar paga, e reflektuar në sistemin e NE-së (34,000 lekë). Pra, nuk kemi të bëjmë me deklarim të rremë; si rezultat, është lejuar riaplikimi.
Gjithashtu, lidhur me ngarkimin e përgjegjësisë për rastet e konstatuara me aplikime para përfundimit të periudhës së penalizimit specialistëve të Drejtorisë Rajonale, ju sqarojmë se në zbatim të ligjit "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", konkretisht neni 23, pikat a dhe b. Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton qartë se përgjegjësia e drejtpërdrejtë dhe e vetme në rastet e cituara në akt-konstatim qëndron tek administratorët shoqërorë. Sqarojmë gjithashtu se në procedurën e verifikimit automatik nuk është përfshirë verifikimi i rasteve të aplikimit para përfundimit të periudhës së penalizimit. Lidhur me verifikimin e situatës social-ekonomike të familjeve që aplikojnë/trajtohen me NE, theksojmë se DRSHSSH Shkodër, gjatë kontrolleve të dokumentacionit, ka evidentuar realizimin ose jo të kësaj detyre. Në varësi të gjetjeve, janë lënë detyra për realizimin e vizitave në familje sipas përcaktimeve ligjore, si dhe janë propozuar masa administrative në rastet kur ky fenomen është

masiv. Ndërsa lidhur me ndryshimet e fundit ligjore, VKM nr. 855, datë 26.12.2024, Kreu II, pika 2.1, ku Drejtoria Rajonale ngarkohet me detyrën e verifikimit në terren për familjet që aplikojnë për herë të parë, theksojmë se realizimi i kësaj detyre është praktikisht i pamundur në shumicën e rasteve për shkak të mungesës së infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe shtrirjes territoriale të Qarkut Shkodër.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me aplikimin e N. M., penalizimi nuk është për periudhën shtator 2023, sepse ky aplikim është refuzuar nga sistemi me datë 02.10.2023.
-Në lidhje me aplikimin e Z. H. R., rifutja në skemë brenda periudhës 6 mujore nga shkëputja për deklarim të rreme, e iniciuar me kërkesë me email nga administratori shoqëror është e pabazuar në ligj gjithashtu si dhe ju e përmendët, theksojmë se gabimi është kryer nga ana e administratorit, nga i cili nuk është lënë asnjë koment shpjegues në sistem.
-Në lidhje me aplikimin G. N. D., Nga verifikimet automatike të sistemit datë 26.09.2025, përmes modulit "Verifikim i pagave" rezulton se V. D. nuk ka deklaruar pagën e saktë. Ky aplikim është refuzuar në sistem datë 01.10.2025. Nuk ka vizita nga periudha 10.06.2022-01.10.2025, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II të VKM nr. Nr.597, datë 4.9.2019. Pas 64 ditësh nga refuzimi i aplikimit të sipërcituar, aplikuesi ka riaplikuar, dhe ky pranim është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 57/2019, Kreu IV, neni 15, pika 1, shkronja "ç",
- Në lidhje me aplikimet e Gj. K. N. dhe M. Gj. H. si dhe ju e përmendët, gabimi është kryer nga ana e administratorit, nga i cili nuk është lënë asnjë koment shpjegues në sistem dhe gjithashtu nuk është kontrolluar nga strukturat përkatëse të SHSSH.

Pretendimi i subjektit DRSHSSH Lezhë: 1-Gj. P. me nr. aplikimi NE-2023-008447 është penalizuar në dt. 22.02.2023 me arsyen "Mosdeklarim Punësimi". Referuar procesverbalit dt. 08.04.2023, ku sqarohet se administratori shoqëror gabimisht nuk ka hedhur në sistemin elektronik dokumentin e pronësisë së tokës. Për të mos penalizuar padrejtësisht familjen, DRSHSSH ka lejuar riaplikimin. Gjithashtu, në informacionin e ardhur nga DPGJC në sistemin elektronik për familjen, specifikohet adresa në fshatin Zhejë, ndaj në këtë rast nuk quhet deklarim i rremë nga ana e familjes, por gabim nga ana e administratorit shoqëror lidhur me hedhjen e dokumentacionit në sistem. Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht pagesën e ndihmës ekonomike.
2- E. D me nr. aplikimi NE-2023-001520 është penalizuar në dt. 30.01.2023 me arsyen "Mosdeklarim i saktë i vendbanimit". Në muajin shkurt 2023 është bërë riaplikimi. Sipas VKM-së nr. 597/2019 dhe VKM-së nr. 257/2021, si dhe sistemit elektronik lidhur me penalizimin 6-mujor, afati i penalitetit fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji janar 2023, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muajin qershor 2023. Në muajin korrik 2023 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Nisur nga fakti se familja nuk duhej të aplikonte para muajit korrik 2023, efekti financiar llogaritet për periudhën shkurt–qershor. Pra, llogaritja e përfitimit të padrejtë për muajt shkurt–qershor 2023 (5 muaj) është 43.560 lekë.
3-A.N. me nr. aplikimi NE-2024-007516 është penalizuar në dt. 27.08.2024 me arsyen "Mospërputhje e strukturës së familjes". Në muajin nëntor është kryer riaplikim pa mbaruar periudha e penalizimit, ku administratorja nuk ka sjellë dokumentacion justifikues. Sipas VKM-së nr. 597/2019 dhe VKM-së nr. 257/2021, si dhe sistemit elektronik lidhur me penalizimin 6-mujor, afati i penalitetit fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji gusht 2024, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, janar 2025. Pra, llogaritja e përfitimit të padrejtë për muajt nëntor–janar (3 muaj) është 12.397 lekë.
4-F. Sh.me nr. aplikimi NE-2024-014542 është penalizuar në dt. 24.05.2024 me arsyen "Mosdeklarim Page". Në muajin tetor 2024 është bërë riaplikim për shkak të kushteve social-ekonomike të familjes. Sipas VKM-së nr. 597/2019 dhe VKM-së nr. 257/2021, si dhe sistemit elektronik lidhur me penalizimin 6-mujor, familja mund të aplikojë nga muaji nëntor e në vazhdim, pra efekti financiar është vetëm për muajin tetor 2024, në masën 6.481 lekë.
5-K. L. me nr. aplikimi NE-2022-023491 është penalizuar në dt. 26.08.2025 me arsyen "Mosdeklarim i saktë i pagës". Nga vërtetimi bankar i z. K. rezulton që firma ku ai punon i hedh në llogari shumën 40.000 lekë. Ndërkohë që në sistemin e tatimeve rezulton që është i siguruar me pagë 60.000 lekë. Duhet theksuar që familja është në kushte tepër të vështira ekonomike. Qytetari ka deklaruar pagën 40.000 lekë në muaj dhe nga vërtetimi i bankës rezulton po e njëjta pagë, ndaj në këtë rast nga ana e qytetarit nuk konsiderohet deklarim i rremë. Në momentin e vënies në dispozicion të vërtetimit përkatës, DRSHSSH ka lejuar riaplikimin e familjes. Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht pagesën e ndihmës ekonomike.
6-E. Ç. me nr. aplikimi NE-2016-046507 është penalizuar në dt. 29.09.2023 me arsyen "Mosdeklarim Automjeti", familje e cila është e izoluar për shkak të "Gjakmarrjes", fakt i vërtetuar me dokumentacionin justifikues. Familja e ka kryer deklaratën në muajin gusht 2023, ndërkohë informacioni nga DPSHTRR për herë të parë ka ardhur në muajin shtator 2023. Bazuar në VKM-në nr. 597/2019, Kreu II, pika 4, anëtarët madhorë paraqiten çdo 3 muaj për të deklaruar lidhur me ndryshimet social-ekonomike të familjes. Në këtë rast nuk ka një deklarim të rremë nga ana e familjes, përpos faktit që për shkak të gjendjes sociale familja e ka të kufizuar lirinë, vërtetuar me dokumentacion nga shoqata "Misioni i Pajtimeve Mbarëkombëtare" dhe njësia administrative. Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht pagesën e ndihmës ekonomike.

7-L. D. me nr. aplikimi NE-2016-050070 është penalizuar në dt. 29.09.2023 me arsyen “Mosdeklarim Automjeti”. Familja i përket komunitetit rom dhe për shkak të kushteve të vështira të jetesës administratori social i ka kryer riaplikimin në sistem ende pa mbaruar periudha e penalizimit. Lidhur me afatet e riaplikimit, familja është penalizuar në muajin shtator 2023 dhe e drejta e riaplikimit i lind në muajin mars 2024, duke llogaritur efektin financiar për 3 muaj, pra në masën 23.803 lekë.
8-N. M. me nr. aplikimi NE-2022-024428 është penalizuar në dt. 07.09.2022 me arsyen “Mosdeklarim i saktë i pagës”. Për shkak të sulmit kibernetik, vendimi final i NE-së për muajin gusht ka përfunduar në javën e parë të muajit shtator 2022. Si rrjedhojë, familja është penalizuar për muajin gusht dhe nuk ka përfituar pagesë për këtë muaj. Riaplikimi është kryer në muajin shkurt 2023 duke respektuar periudhën e penalizimit. Gjithashtu, në sistemin elektronik, në rubrikën “Shënime”, është kryer komenti: “Kaluar për verifikim automatik sipas kërkesës së klientit për vendimmarrjen e gushtit”. Për sa më sipër, familja nuk ka përfituar padrejtësisht pagesën e ndihmës ekonomike.
9-I. S. me nr. aplikimi NE-2025-013710 është penalizuar në muajin maj 2025 me arsyen “Mosdeklarim Page”. Gabimisht nga ana e DRSHSSH-së është penalizuar, pasi bashkëshortja ka qenë e punësuar në muajin maj 2024. Në muajin qershor është rishikuar rasti dhe është lejuar të aplikojë, ndaj në këtë rast nuk quhet deklarim i rremë nga qytetari, por procedurë e gabuar nga DRSHSSH mbi refuzimin për shkak të informacionit të ardhur.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me përllogaritjen e pagesave nga sistemi NE, argumentojmë se sistemi pasqyron përfitimin mujor që merr përfituesi (në rubrikën “Përfitime”), totali përllogaritet në bazë të shumatores së këtyre vlerave. Rastet e sipërpermendura janë perllogaritur nga grupi i auditimit bazuar në ndihmën mujore që vetë sistemi nxjerr për periudhën 6 mujore të penalizimit.
Në lidhje me aplikimin e Gj. P. P., A. Ll. N., K. Z. L., I. I.S. si dhe ju e përmendët, gabimi është kryer nga ana e administratorit dhe/ose DRSHSSH, nga i cili nuk është lënë asnjë koment shpjegues në sistem dhe gjithashtu nuk është kontrolluar nga strukturat përkatëse të SHSSH në vijim. Në rastin e E. Gj. C. nuk ka asnjë dokumentacion justifikues në sistem dhe situata nuk është e sqaruar.
Për sa më sipër, pretendimi i subjektit për N. R. M. do të merret parasysh, ndërsa për aplikantët e tjërë nuk do të merret parasysh.

Pretendimi i subjektit DRSHSSH Fier: 1- Aplikimi nr. NE-2024-022316, P. I. D. Familja është refuzuar në muajin gusht 2024 me arsyen "Mosdeklarim page", pasi z. P. rezulton i punësuar nga programi i Nxitjes së Punës në Komunitet, i ofruar nga Zyrat e Punës, bazuar në VKM nr. 535, datë 08.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet" dhe Protokollit për Punësimin e Anëtarëve Madhorë. Pjesëmarrësit kanë të drejtë ta deklarojnë pagesën brenda një afati 3-mujor. Nisur nga fakti se anëtari i familjes rezulton i punësuar për një periudhë dymujore dhe deklarimi 3-mujor i radhës ishte në muajin pasardhës, familja nuk duhej të ishte penalizuar nga ana e Drejtorisë Rajonale. Gjithashtu, sipas emailit të dërguar nga administratori shoqëror, konfirmohet se familja ka përmbushur detyrimin e saj lidhur me deklarimin e punësimit, por për shkak të një gabimi nga ana e tij nuk është reflektuar në sistem. Riaplikimi para afatit të penalitetit nuk përbën shkelje, kjo pasi në këtë rast nuk kemi deklarim të rremë ose fshehje të të ardhurave.
2- Aplikimi nr. NE-2024-028800, A. S. K. Familja është refuzuar në muajin gusht 2024, pasi nga verifikimi i kryer me DPT ka rezultuar e punësuar për muajt paraardhës (qershor dhe korrik 2024). Nga ana e verifikuesit të DR-së, mospërputhja e ardhur është konsideruar shkelje dhe si rrjedhim është refuzuar nga vendimmarrësi me arsyen "deklarim i rremë, ka anëtarë të punësuar". Në muajin nëntor 2024 është bërë riaplikim nga administratori shoqëror z. A. A., i cili nëpërmjet emailit, datë 07.11.2024 (dërguar pranë Drejtorisë Rajonale), ka kërkuar miratim për riaplikim, pasi znj. I. nuk ka qenë e punësuar, por në periudhë prove pranë një kompanie fasonerie, e vërtetuar kjo edhe në verifikimin e kryer nga DPT, ku konstatohet se paga minimale rezulton 40.000 lekë, por kontributet janë përllogaritur në masën 12.000 lekë, çka vërteton se I. ka qenë në periudhë prove. Për sa më sipër, familja është lejuar të riaplikojë në muajin nëntor 2024, pasi ky riaplikim nuk përbën shkelje, kjo pasi në këtë rast familja nuk ka kryer deklarim të rremë; anëtari nuk ka qenë në marrëdhënie pune, por në periudhë prove, dhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me përfitime të padrejta.
Ndërsa për 3 (tre) familjet e mëposhtme, masa e përllogaritur për riaplikim para afatit të penalizimit është:
3- Aplikimi nr. NE-2023-035581, A. T. B. Lidhur me rastin e familjes B., sqarojmë se familja është penalizuar në muajin qershor 2023, pavarësisht se vendimmarrja e muajit qershor 2023 është marrë në datën 03.07.2023. Lidhur me afatin e penalitetit për riaplikimin e kryer nga administratori shoqëror, sqarojmë se afati fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht muaji qershor 2023, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muajin nëntor 2023. Në muajin dhjetor 2023 familja gëzon të drejtën e riaplikimit dhe nuk llogaritet dëm ekonomik për muajin dhjetor 2023. Nuk ka efekt financiar.
4- Aplikimi nr. NE-2025-026420, D. Xh. M. Për familjen M. sqarojmë se, për periudhën shkurt–maj 2025, masa e përfituar padrejtësisht për mosdeklarim pensioni shkon në vlerën 80.928 lekë, shumë në të cilën është e përfshirë edhe pagesa nga SMIP. Lidhur me riaplikimin, sqarojmë se afati i penalitetit për riaplikimin e kryer nga administratori shoqëror fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht muaji qershor 2025, dhe vijon deri në muajin e gjashtë që është muaji nëntor 2025. Në muajin dhjetor 2025 familja

gëzon të drejtën e riaplikimit. Nisur nga fakti se familja nuk duhej të aplikonte para muajit dhjetor 2025, efekti financiar duhet llogaritur për 1 muaj (nëntor 2025) dhe shkon në 18.816 lekë. Në total, për të dyja periudhat, shuma shkon në 99.744 lekë.
5- Aplikimi nr. NE-2025-021675, R. P. J. Lidhur me familjen J., sqarojmë se afati i penalitetit për riaplikimin e kryer nga administratori shoqëror fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht muaji korrik 2025, dhe vijon deri në muajin e gjashtë që është muaji dhjetor 2025. Në muajin janar 2025 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Efekti financiar duhet llogaritur për 4 muaj dhe shkon në total 27.008 lekë.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me aplikimin e P. I. D. dhe A. S. K., si dhe ju e keni përmendur, familja nuk duhet të ishte përjashtuar nga skema dhe ky gabim ka ardhur nga DRSHSSH. Në lidhje me aplikimin e A. T. B., si dhe ju e përmendni, vendimmarrja për penalizim është marrë me vonesë nga DRSHSSH. Ky përvecse gabim institucional rezikon dhe marrjen e të drejtës për aplikim të individit me 1 muaj.
Për aplikimin e D. M., argumentojmë se sistemi pasqyron përfitimin mujor që merr përfituesi (në rubrikën "Përfitime"), totali përllogaritet në bazë të shumatores së këtyre vlerave. Rastet e sipërpermendura janë perllogaritur nga grupi i auditimit bazuar në ndihmën mujore që vetë sistemi nxjerr për periudhën 6 mujore të penalizimit.
Për aplikimin e R. P. J., argumentojmë se duhet respektuar afati 6 mujor nga data e penalizimit, që në këtë rast është muaji janar.

Pretendimi i subjektit DRSHSSH Vlorë: Për familjet aplikuese të z. F. T. G., znj. N. R.B. dhe znj. L. H. L., nga verifikimet në Skemën e Ndihmës Ekonomike janë trajtuar me korrektësi mospërputhjet përkatëse dhe në vendimmarrjet e marra janë refuzuar për mosdeklarim të të ardhurave nga paga dhe pensioni. Mbi refuzimin nga Skema e Ndihmës Ekonomike për këto familje, administratorët shoqërorë kanë kërkuar riaplikimin para afatit gjashtëmujor të refuzimit nëpërmjet emailit zyrtar, duke na pasqyruar situatën tejet të vështirë në të cilën ndodhen familjet, pasi kanë probleme të shumta shëndetësore, ekonomike dhe sociale. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë ka shqyrtuar kërkesat e administratorëve shoqërorë dhe ka lejuar riaplikimin e familjeve të lartpërmendura, pavarësisht problematikave që lidhen me mosdeklarimin e saktë të të ardhurave. Bashkëlidhur po ju dërgojmë email-et e dërguara nga administratorët shoqërorë dhe përgjigjet e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Vlorë për familjet e refuzuara nga Skema e Ndihmës Ekonomike, të cilat kanë kërkuar lejimin e riaplikimit të këtyre familjeve para afatit gjashtëmujor të refuzimit. Për llogaritjen e dëmit financiar, ju bëjmë me dije se:
1-F. T. G. ka aplikuar në Skemën e Ndihmës Ekonomike më datë 11.10.2018 dhe ka përfituar deri në muajin shtator 2023 pagesën prej 3.703 lekësh. Në vendimmarrjen e muajit tetor 2023, kjo familje është refuzuar nga Skema e Ndihmës Ekonomike për mosdeklarimin e punësimit të motrës së tyre, znj. M. G. Të drejtën e riaplikimit e kishte në muajin prill 2024. Llogaritja e dëmit ekonomik e konstatuar nga KLSH për këtë familje nuk është 22.218 lekë, por 18.515 lekë, pasi familja ka aplikuar një muaj pas refuzimit nga Skema e Ndihmës Ekonomike.
2. N. R. B. ka aplikuar në Skemën e Ndihmës Ekonomike më datë 11.01.2018 dhe ka përfituar pagesë deri në muajin shtator 2024 prej 6.040 lekësh, së bashku me kompensimin e energjisë elektrike. Në vendimmarrjen e muajit tetor 2024, kjo familje është refuzuar nga Skema e Ndihmës Ekonomike për mosdeklarimin e punësimit të vajzës, znj. M.G. Të drejtën e riaplikimit e kishte në muajin prill 2025. Llogaritja e dëmit ekonomik e konstatuar nga KLSH për këtë familje nuk është 36.640 lekë, por 24.160 lekë, pasi familja ka aplikuar dy muaj pas refuzimit nga Skema e Ndihmës Ekonomike.
3. L. H. L. ka aplikuar në Skemën e Ndihmës Ekonomike më datë 08.08.2024 dhe ka përfituar pagesë deri në muajin maj 2025, me masë përfitimi 3.049 lekë. Në vendimmarrjen e muajit qershor 2025, kjo familje është refuzuar nga Skema e Ndihmës Ekonomike për mosdeklarim pranë administratores shoqërore të pensionit familjar që znj. L.L. përfiton nga bashkëshorti i saj. Të drejtën e riaplikimit e kishte në muajin dhjetor 2025. Llogaritja e dëmit ekonomik e konstatuar nga KLSH për këtë familje nuk është 18.294 lekë, por 15.245 lekë, pasi familja ka aplikuar një muaj pas refuzimit nga Skema e Ndihmës Ekonomike.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi lexoi parashtrimet tuaja argumenton se sistemi pasqyron përfitimin mujor që merr përfituesi (në rubrikën "Përfitime"), totali përllogaritet në bazë të shumatores së këtyre vlerave. Rastet e sipërpermendura janë perllogaritur nga grupi i auditimit bazuar në ndihmën mujore që vetë sistemi nxjerr për periudhën 6 mujore të penalizimit. Për sa më sipër, argumentet nuk paraqesin fakt të ri ndaj observacioni nuk do të pranohet.

Pretendimi i subjektit DRSHSSH Kukës: Bazuar në ligjin "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", konkretisht nenin 12, pika 1, përcaktohet se: "Ndihma ekonomike është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji..." Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton qartë se ndihma ekonomike ka natyrë mujore dhe nuk lidhet me momentin apo datën e marrjes së vendimit nga Drejtoria Rajonale. Për rrjedhojë, edhe përllogaritja e çdo penaliteti apo dëmi ekonomik nuk mund të bazohet mbi ditë të veçanta, por duhet të kryhet mbi bazë mujore. Afati 6-mujor sipas përcaktimeve në VKM-

në nr. 597/2019, VKM-në nr. 257/2021 dhe Metodologjinë e Ndihmës Ekonomike është për një periudhë 6-mujore. Sipas këtij përcaktimi, afati i penalitetit fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë. Rastet e konstatuara si më poshtë vijojnë:
-Rasti i aplikantit A. I. - me nr. aplikimi NE-2017-041812, refuzuar me datë 03.07.2023 - Mosdeklarim Page - Riaplikim datë 10.07.2023. Lidhur me afatin e penalitetit sqarojmë se, afati fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji Qershor 2023, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muaji Nëntor 2023. Në muajin Dhjetor 2023 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Efekti financiar llogaritet për periudhën Korrik-Nëntor 2023, në masën 84.960 lekë (16.632 × 2 + 17.232 × 3).
-Rasti i aplikantit E. M. - me nr. aplikimi NE-2022-037281, refuzuar me datë 28.02.2023 - Mosdeklarim Page - Riaplikim datë 10.03.2023. Lidhur me afatin e penalitetit sqarojmë se, afati fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji Shkurt 2023, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muaji Korrik 2023. Në muajin Gusht 2023 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Efekti financiar llogaritet për periudhën Mars-Korrik 2023, në masën 73.260 lekë (14.652 × 5).
-Rasti i aplikantit S. P. - me nr. aplikimi NE-2021-008962, refuzuar me datë 23.12.2022 - Mosdeklarim Page - Riaplikim datë 06.01.2023. Lidhur me afatin e penalitetit sqarojmë se, afati fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji Dhjetor 2022, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muaji Maj 2023. Në muajin Qershor 2023 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Efekti financiar llogaritet për periudhën Janar-Maj 2023, në masën 40.100 lekë (8.020 × 5).
-Rasti i aplikantit I. K. - me nr. aplikimi NE-2017-038636, refuzuar me datë 22.12.2022 - Mosdeklarim Pensioni - Riaplikim datë 10.01.2023. Lidhur me afatin e penalitetit sqarojmë se, afati fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji Dhjetor 2022, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muaji Maj 2023. Në muajin Qershor 2023 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Efekti financiar llogaritet për periudhën Janar-Maj 2023, në masën 36.970 lekë (6.752 × 2 + 8.040 × 2 + 7.392).
-Rasti i aplikantit F. Sh. - me nr. aplikimi NE-2016-059725, refuzuar me datë 02.09.2024 - Mosdeklarim Pensioni - Riaplikim datë 06.09.2024. Lidhur me afatin e penalitetit sqarojmë se, afati fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji Gusht 2024, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muaji Janar 2025. Në muajin Shkurt 2025 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Efekti financiar llogaritet për periudhën Shtator 2024 - Janar 2025, në masën 100.980 lekë (20.196 × 5).
-Rasti i aplikantit S. K. - me nr. aplikimi NE-2024-026943, refuzuar me datë 31.10.2024 - Mosdeklarim Page - Riaplikim datë 06.11.2024. Lidhur me afatin e penalitetit sqarojmë se, afati fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji Tetor 2024, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muaji Mars 2025. Në muajin Prill 2025 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Efekti financiar llogaritet për periudhën Nëntor 2024 - Mars 2025, në masën 40.705 lekë (8.141 × 5).
-Rasti i aplikantit H. A. - me nr. aplikimi NE-2024-017195, refuzuar me datë 30.07.2024 - Mosdeklarim Page - Riaplikim datë 05.08.2024.
Lidhur me afatin e penalitetit sqarojmë se, afati fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji Korrik 2024, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muaji Dhjetor 2024. Në muajin Janar 2025 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Efekti financiar llogaritet për periudhën Gusht-Dhjetor 2024, në masën 23.960 lekë (4.792 × 5).
-Rasti i aplikantit S. A. - me nr. aplikimi NE-2025-013898, refuzuar me datë 29.05.2025 - Mosdeklarim Page - Riaplikim datë 02.06.2025. Lidhur me afatin e penalitetit sqarojmë se, afati fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji Maj 2025, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muaji Tetor 2025. Në muajin Nëntor 2025 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Efekti financiar llogaritet për periudhën Qershor-Tetor 2025, në masën 37.108 lekë (8.276 × 2 + 6.752 × 2 + 7.052).
-Rasti i aplikantit I. B. - me nr. aplikimi NE-2016-055714, refuzuar me datë 29.09.2025 - Mosdeklarim Page - Riaplikim datë 02.12.2025. Lidhur me afatin e penalitetit sqarojmë se, afati fillon që nga muaji i refuzimit, muaj në të cilin familja nuk ka përfituar pagesë, konkretisht nga muaji Shtator 2025, dhe vijon deri në muajin e gjashtë, muaji Shkurt 2026. Në muajin Mars 2026 familja gëzon të drejtën e riaplikimit. Efekti financiar llogaritet për periudhën Dhjetor 2025 - Shkurt 2026, në masën 4.575 lekë (1.525 × 3).
Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi lexoi me vëmendje parashtrimet tuaja, arsyeton se përllogaritja është kryer duke marrë në konsideratë datën në të cilën familja ose individi rezulton i skualifikuar nga skema e ndihmës ekonomike në sistem (jo në shkresa të brendshme të institucionit në rast se ka, por në datën e shënuar aty) dhe nuk përfiton më masën e ndihmës ekonomike. Në rastet kur periudha 6-mujore e përjashtimit përfundon në fund të një muaji kalendarik, e drejta për riaplikim lind në muajin pasardhës. Pretendimi i subjektit se grupi i auditimit ka filluar përllogaritjen e afatit një muaj pas skualifikimit nuk qëndron, pasi nga verifikimet e kryera rezulton se përllogaritja është bazuar në momentin e daljes së familjes nga skema e përfitimit, në përputhje me të dhënat e sistemit dhe me qëllimin e dispozitës që përcakton periudhën 6-mujore të përjashtimit. Ligji Nr.57/2019 përcakton në mënyrë eksplicite se përjashtimi është 6 mujor, periudhë gjatë së cilës nuk i lejohet familjes/individit të riaplikojë, pra aplikimi mund të kryhet muajin pasi ka përfunduar përjashtimi 6 mujor dhe jo në muajin e gjashtë. Gjithashtu sipas Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së

Shqipërisë", kreu V, neni 56, pika 3 afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Për sa më sipër, observacioni nuk paraqet fakt të ri ndaj nuk do të merret në konsideratë.

B. Skemat e aftësisë së kufizuar

(*) Të dhëna lidhur me përfituesit ndër vite sipas skemës biopsikosociale të aftësisë së kufizuar, të paratetraplegjisë dhe verbërisë, për periudhën e auditimit, të ndarë sipas rajoneve, pasqyrohen në Aneksin nr. III: "Pagesat e aftësisë së kufizuar" bashkëlidhur.

Në vitin 2020, nga skemat e pagesave për personat me aftësi të kufizuar përfituan 73,718 persona, ku skema PAK përbënte rreth 74% të totalit të përfituesve. Numri më i lartë i përfituesve u regjistrua në qarqet Elbasan, Tiranë, Fier dhe Korçë, të cilat së bashku përfaqësonin rreth 54% të totalit kombëtar.

Gjatë viteve 2021–2022, numri i përfituesve pësoi një rënie graduale, duke zbritur nga 71,281 në 70,209 persona. Rënia lidhet kryesisht me reduktimin e përfituesve në kategorinë PAK, ndërsa struktura sipas kategorive dhe shpërndarja territoriale mbetën pothuajse të pandryshuara.

Në vitin 2023, numri i përfituesve u rrit në 72,475 persona, duke përmbysur trendin rënës të dy viteve paraardhëse. Rritja lidhet kryesisht me shtimin e përfituesve në kategorinë PAK dhe përkon me përmbylljen e shtrirjes së modelit të vlerësimit biopsikosocial në të gjithë territorin e vendit.

Gjatë viteve 2024–2025, trendi rritës vijoi, duke arritur në 75,441 përfitues në vitin 2024 dhe 76,587 përfitues në vitin 2025. Rritja është mbështetur kryesisht nga zgjerimi i numrit të përfituesve në kategorinë PAK, ndërsa skemat e verbërisë dhe paratetraplegjisë paraqesin ndryshime të kufizuara.

Analiza e periudhës 2020–2025 tregon se numri i përfituesve nga skemat e pagesave për personat me aftësi të kufizuar është rritur me rreth 3.9%, nga 73,718 në 76,587 persona. Ndryshe nga skema e ndihmës ekonomike, e cila ka shfaqur një tendencë rënëse gjatë së njëjtës periudhë, skemat e aftësisë së kufizuar paraqesin një trend të lehtë rritës pas vitit 2022. Rritja e moderuar e numrit të përfituesve nga skema PAK (që përbëhet nga skema e vjetër dhe skema biopsikosociale) gjatë viteve 2023–2025 përkon në kohë me përmbylljen e shtrirjes territoriale të modelit të vlerësimit biopsikosocial në të gjithë vendin në fillim të vitit 2023 dhe konsolidimin gradual të funksionimit të komisioneve biopsikosociale në nivel kombëtar. Skema PAK vijon të përbëjë komponentin dominues të sistemit, duke përfaqësuar në mënyrë të qëndrueshme rreth 74–75% të totalit të përfituesve. Në aspektin territorial, përfituesit përqendrohen kryesisht në qarqet Tiranë, Elbasan, Fier dhe Korçë, të cilat së bashku përfaqësojnë rreth 51–55% të totalit kombëtar gjatë gjithë periudhës në analizë. Rritja e numrit të përfituesve pas vitit 2022 përkon me përfundimin e shtrirjes kombëtare të modelit biopsikosocial dhe konsolidimin gradual të komisioneve të vlerësimit biopsikosocial në të gjithë vendin.

Masa e përfitimit për personat me aftësi të kufizuara

Në Kreun IV, pika 2, të VKM-së nr. 431, datë 08.06.2016, i ndryshuar, përcaktohet se pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar indeksohet sa herë indeksohet pensioni social. Nga auditimi u konstatua se çdo vit Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së ka nxjerrë Urdhrat përkatës për indeksimin e masës së pagesave për PAK çdo vit gjatë periudhës së auditimit, sipas tabelës në Aneksin nr. III: "Pagesat e aftësisë së kufizuar".

Kontrolli i pagesave të aftësisë së kufizuar

Në nenin 20, pika 3, gërma c, të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, përcaktohet se SHSSH kontrollon dhe monitoron veprimtarinë dhe

zbatimin e legjislacionit të asistencës sociale, në strukturat dhe institucionet në varësi të tij dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore. Nëpërmjet VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*" janë përcaktuar detyrat dhe rolet e SHSSH-së në nivel qendror dhe rajonal në kuadër të kontrollit të zbatimit të legjislacionit për NE dhe PAK, duke miratuar bashkëlidhur metodologjinë për kontrollin e vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar (shtojca nr. 2). Në kreun 2 "*llojet e kontrollit*", pika 2.1, të Shtojcës 2 të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021, përcaktohet se kontrolli i plotë bëhet çdo vit për zyrën e administrimit të procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të Shërbimit Social Shtetëror dhe 1 herë në 2 vjet për njësitë e vetëqeverisjes vendore të zonave pilot. Kontrolli i plotë përfshin ndër të tjera vlerësimin nëse veprimtaritë e njësive të kontrolluara janë në pajtim me kuadrin ligjor që rregullon vlerësimin e aftësisë së kufizuar, sipas modelit biopsikosocial dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Funksionimi i sistemit elektronik PAK

Në zbatim të Ligjit nr. 57/2019 neni 20 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", pika 3b, Shërbimi Social Shtetëror administron dhe përdor të dhënat e Regjistrit Elektronik Kombëtar, i cili përfshin aplikantët dhe përdorimin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar. Nga përgjigjet e pyetësorëve, SHSSH bën me dije se, në praktikë, nuk ushtron rolin e administratorit të sistemeve, edhe pse në Ligjin nr. 57/2019 është cituar i tillë. Administrimi teknik i sistemeve realizohet nga strukturat përkatëse të IT-së pranë MSHMS dhe AKSHIT, të cilat kanë akses në komponentët back-end të sistemit, përfshirë log-et, kodin, konfigurimet teknike dhe backup-et. Nga ana tjetër, SHSSH disponon akses vetëm në pjesën front-end të sistemit, konkretisht në krijimin, shtimin dhe ndryshimin e roleve funksionale. Për krijimin e aksesit fillestar në sistem (mailbox, VPN dhe kredenciale të tjera), SHSSH paraqet kërkesë pranë MSHMS/AKSHI-t, ndërsa më pas merret vetëm me krijimin dhe menaxhimin e roleve funksionale të përdoruesve në sistem.

Kontrata e mirëmbajtjes për sistemin e PAK ka përfunduar në datën 04.04.2024, duke bërë që nga ajo datë sistemi të jetë pa mirëmbajtje, në kundërshtim me pikën 2 të VKM-së nr. 710, datë 21.08.2013 "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*", i ndryshuar. Mungesa e mirëmbajtjes së sistemeve paraqet risk për vazhdimësinë e punës dhe funksionimin normal të tyre, duke rritur mundësinë e ndërprerjeve të shërbimit dhe mosadresimit e zgjidhjes në kohë të problemeve teknike. Referuar përgjigjeve të pyetësorëve, SHSSH nuk ka qenë në asnjë rast e përfshirë si përfaqësuese në grupet e punës për ndjekjen e kontratave të mirëmbajtjes së sistemeve. Ndjekja dhe monitorimi i kontratave të mirëmbajtjes janë realizuar nga përfaqësues të AKSHI-t dhe MSHMS-së.

Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së nr. 335, datë 22.10.2024, është ngritur grupi i punës për hartimin e treguesve kryesorë të riskut të sistemeve elektronike të ndihmës ekonomike, personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror. Risqet e identifikuara nga vetë SHSSH lidhen kryesisht me kufizimet në administrimin e sistemit, pasi administratori nuk disponon të drejta të plota për menaxhimin e tij dhe varet nga strukturat e MSHMS-së dhe AKSHI-t për realizimin e ndryshimeve apo konfigurimeve të nevojshme. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi funksionale të sistemit, përfshirë mosgjenerimin automatik të borderove përmbledhëse, pasaktësi në raportim, pamundësinë e eksportimit të raporteve në format Excel dhe kufizime në aksesin ndaj të dhënave historike nga sistemet e ndërlidhura. SHSSH ka identifikuar problematika në funksionimin e verifikimeve automatike me databazat shtetërore, përfshirë raste të pasaktësive në të dhënat e ardhura nga DPGJC, mungesën e informacionit të plotë historik nga DPT dhe ISSH. .Problematikat që evidentohen nga përdorimi i sistemeve, përcillen në rrugë elektronike nga ana e IT-së së SHSSH pranë strukturës IT të AKSHI-t pranë ministrisë. Pas përfundimit të kontratave të

mirëmbajtjes janë konstatuar problematika të përsëritura të raportuara nga ana e SHSSH-së që konsistojnë në: mosfunksionim të plotë të sistemeve NE, PAK dhe SHKSH dhe probleme log in-i nga ana e përdoruesve fundorë të sistemit në Drejtori të Përgjithshme, Drejtori Rajonale, Njësitë Vendore, etj., duke cënuar disponibilitetin e sistemeve dhe vijueshmërinë e punës. Me qëllim ruajtjen e integritetit të të dhënave grupi i auditimit mori informacion nëpërmjet pyetësorëve mbi procedurat e ndjekura për realizimin e back-up të sistemeve, ku nga SHSSH-ja është vënë në dispozicion përgjigja e AKSHI-t ku citohet se back-up realizohet në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 31.07.2023 "*Për zbatimin e dokumentit të përditësuar të politikave të vazhdimësisë së punës dhe planit për ruajtjen e informacionit*".
Lidhur me pjesën funksionale të sistemit, grupi i auditimit kërkoi informacion mbi modulet e parashikuara në termat e referencës për secili sistem, modulet aktualisht të implementuara dhe ndryshimet që janë bërë që prekin funksionalitetet e sistemit.
Për sistemin e PAK, janë aktualisht të implementuara modulet: arkiva historike, administrimi i aplikimeve, raportim, administrim teknik. Me qëllim përmirësimin e proceseve të punës, nga ana e SHSSH-së është identifikuar nevoja për implementim të modulit të pagesave dhe modulit të gjurmimit te auditimeve. Pavarësisht se mungesa e këtyre moduleve është evidentuar nga SHSSH-ja në përgjigjet e pyetësorit të hartuar nga grupi i auditimit, nuk është vënë në dispozicion asnjë korrespondencë e SHSSH-së me MSHMS-në apo AKSHI-n, ku SHSSH-ja të ketë relatuar të gjitha mangësitë në modulet e implementuara në sistemin e PAK-ut. Për sa i përket ndërveprimeve me sistemet e tjera aktualisht janë të implementuar ndërveprimet me: Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, Regjistrin e Tatimpaguesve (DPT), Sistemin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Portalin qeveritar e-Albania.
Raportet dhe të dhënat statistikore që sistemi i PAK gjeneron janë të kufizuara, sidomos në raport me treguesit statistikorë që kërkohen nga Udhëzimi i ri i hyrë në fuqi i MSHMS-së nr. 122, datë 06.02.2026, duke bërë që nxjerrja dhe përpunimi i të dhënave të kryhen manualisht nga punonjësit e Drejtorive Rajonale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH-së.

A. Skema e Vlerësimit Biopsikosocial (BPS)
Vlerësimi biopsikosocial kryhet në bazë të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019, i ndryshuar, dhe mbështetet në vlerësimin e ndërthurur të gjendjes shëndetësore, kufizimeve funksionale dhe faktorëve mjedisorë që ndikojnë në pjesëmarrjen e individit në jetën e përditshme. Për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar sipas modelit biopsikosocial kërkohet që personi të ketë një dëmtim fizik, mendor, intelektual ose ndijor të vërtetuar, i cili shkakton kufizime funksionale në kryerjen e aktiviteteve të jetës së përditshme dhe në pjesëmarrjen sociale, si dhe të përballet me barriera mjedisore që ndikojnë në funksionimin e tij. Personi duhet të jetë i paaftë për punë, pa plotësuar kushtet për përfitimin e pensionit të invaliditetit apo pensionit të pleqërisë/social sipas legjislacionit të sigurimeve shoqërore.
Për aplikimin në skemën e vlerësimit biopsikosocial, qytetari paraqet pranë Zyrës së KVSHAK dokumentacionin përkatës, i cili përfshin formularin e Mjekut të Familjes, formularin e Mjekut Specialist (ose të QKSHM-së për rastet e shëndetit mendor), ekzaminimet mbështetëse sipas diagnozës, dokumentin e identifikimit dhe certifikatën familjare. Sipas Kreut III, pika 4, gërma "a", të VKM-së nr. 722/2019, stafi i zyrës regjistron në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat dhe dokumentacionin e aplikuesit. Nga verifikimi në sistem rezultoi se dokumentacioni i ngarkuar për aplikimet e periudhës 2020–2022 nuk mund të shkarkohet. Sipas informacionit të SHSSH-së, të përcjellë me e-mail të datës 09.03.2026, kjo situatë lidhet me pasojat e sulmit kibernetik të vitit 2022, pasi pas rivënies në funksion të sistemit nuk është bërë i mundur aksesimi i dokumentacionit të skanuar para sulmit.
Pas regjistrimit të aplikimit, mjeku i komisionit shqyrton dokumentacionin për përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në udhëzuesit e vlerësimit. Në rastet kur dokumentacioni paraqet mangësi ose diagnoza nuk përfshihet në kriteret përfituese, qytetari

njoftohet përmes njësisë administrative për arsyet e moskomisionimit. Kur dokumentacioni plotëson kriteret, zhvillohet intervista brenda 30 ditëve nga aplikimi, me fokus në vlerësimin e kufizimeve funksionale në aktivitetet e jetës së përditshme dhe pjesëmarrjen sociale. Kundër vendimit të komisionit, individi ka të drejtë ankimi brenda 20 ditëve kalendarike pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Organizimi dhe funksionimi i KSHVAK-ve rregullohet nga Rregullorja e miratuar me Urdhrin nr. 225, datë 06.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së.

Sa më sipër, në kuadrin rregullativ nuk parashikohet që Shërbimi Social Shtetëror të luajë rol aktiv në identifikimin e rasteve potenciale të individëve me aftësi të kufizuar për të siguruar përfshirjen e tyre në skemë.

Në Kreun III të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019, përcaktohet se procesi i vlerësimit biopsikosocial përfshin edhe kryerjen e kontrollit vjetor mjekësor, mbi bazën e të cilit stafi i zyrës së vlerësimit shqyrton dokumentacionin periodik të përfituesve. Nga informacioni i administruar gjatë auditimit rezulton se vetë SHSSH ka evidentuar një sërë vështirësish në zbatimin e këtij detyrimi[24], përfshirë vonesa në kryerjen e ekzaminimeve të nevojshme, mungesë të mjekëve specialistë në disa qarqe, vështirësi në realizimin e vlerësimeve nga strukturat terciare, mosplotësim të formularëve të kontrollit vjetor, veçanërisht për rastet e shëndetit mendor, si dhe mungesë të kapaciteteve të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor. Si pasojë, në disa raste përfituesit hasin vështirësi në sigurimin e dokumentacionit të kërkuar brenda afateve, duke rrezikuar ndërprerjen e përfitimit.

Pavarësisht se legjislacioni parashikon afate të diferencuara vlefshmërie të vendimeve (1, 3, 5 apo 10 vjet), në varësi të karakterit dhe ecurisë së gjendjes shëndetësore, kontrolli vjetor mjekësor kërkohet për të gjithë përfituesit. Në rastet kur ekspertiza mjekësore ka përcaktuar se diagnoza është e përhershme ose nuk paraqet potencial përmirësimi në afat të parashikueshëm, detyrimi për kryerjen çdo vit të ekzaminimeve dhe dokumentacionit mbështetës paraqet karakter formal dhe ngarkesë administrative shtesë për përfituesit dhe institucionet. Në këto kushte, kërkesa për kontroll vjetor në të gjitha rastet nuk rezulton plotësisht e orientuar nga risku dhe proporcionaliteti, duke krijuar barriera administrative për ruajtjen e aksesit në skemë, veçanërisht për përfituesit që kanë akses të kufizuar në shërbimet e specializuara shëndetësore.

Kriteret për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar

Në Kreun III, pika 2, të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019 "*Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre*", përcaktohet se vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar dhe i nivelit të kufizimeve funksionale bëhet në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar mbi Funksionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin, të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ky vlerësim përfshin faktorët që dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët, në përputhje me udhëzuesit për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar për të rriturit dhe fëmijët, të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe për shëndetësinë.

Kriteret e vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar për fëmijët dhe të rriturit janë miratuar fillimisht në vitin 2016. Në funksion të rishikimit dhe përditësimit të tyre, me Urdhrin nr. 638, datë 12.10.2023, MSHMS ngriti grupet drejtuese dhe teknike të punës me përfaqësues nga MSHMS, SHSSH dhe OSHKSH. Ndër detyrat kryesore të SHSSH janë identifikimi i diagnozave të rralla dhe diagnozave të shpeshta të papërfshira në udhëzuesit aktualë, analizimi i ankesave të qytetarëve për diagnozat jopërfituese, si dhe vlerësimi i nevojave për mbështetje

[24] në raportin përmbledhës të turit "PAK më afër", dërguar MSHMS-së nëpërmjet shkresës nr. 4860 prot., datë 24.06.2024

shtesë, përfshirë paketat higjieno-sanitare. Vetë ngritja e këtyre grupeve të punës tregon se institucionet përgjegjëse kanë identifikuar nevojën për rishikimin dhe përditësimin e kritereve ekzistuese të vlerësimit biopsikosocial, me qëllim adresimin e boshllëqeve dhe problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të skemës.
Nëpërmjet e-mailit të datës 26.10.2023, SHSSH i ka përcjellë MSHMS-së propozimet për rishikimin e udhëzuesve të vlerësimit biopsikosocial, duke kërkuar përfshirjen e diagnozave të reja, si atrezia anale, osteomieliti, akondroplazia, nanizmi, transplanti renal, agjenezia e gjymtyrëve dhe sëmundje të ndryshme gjenetike, si dhe rishikimin e trajtimit të disa diagnozave ekzistuese. Gjithashtu, janë propozuar ndryshime lidhur me përcaktimin e afateve të përfitimit për sëmundje që mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, diferencimin e kërkesave për kontrollet periodike sipas diagnozës, si dhe rishikimin e kritereve të vlerësimit për diagnozat e shëndetit mendor.
Gjithashtu, gjatë turit "PAK më afër", të zhvilluar nga SHSSH gjatë muajve mars–prill 2024, u evidentuan problematika lidhur me mbulimin e diagnozave nga udhëzuesit e vlerësimit biopsikosocial. Konkretisht, u raportuan raste të diagnozave që trajtoheshin në skemën e mëparshme, por nuk janë përfshirë në kriteret aktuale të vlerësimit, si dhe diagnoza gjenetike të rralla që nuk mbulohen nga udhëzuesit ekzistues. Gjithashtu, u evidentuan raste kur diagnoza të caktuara parashikohen në kriteret e vlerësimit për fëmijët, por nuk trajtohen në të njëjtën mënyrë pas kalimit në moshë madhore, pavarësisht se gjendja shëndetësore mbetet e pandryshuar.
Nëpërmjet Udhëzimit të MSHMS-së nr. 20, datë 17.01.2025, janë miratuar Kriteret për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar te të rriturit dhe fëmijët dhe metodologjinë e rishikimit të tyre, të përgatitur në bashkëpunim me specialistë të fushave të ndryshme në MSHMS, QSUNT, SHSSH, OSHKSH. Nga SHSSH-ja bëhet me dije se, nga propozimet e bëra nga SHSSH nëpërmjet e-mail të datës 26.10.2023, janë përfshirë në manualin e përditësuar vetëm diagnozat "*atrezia anale*", "*kolostomitë*", "*PCSI tek fëmijët*" dhe "*agenesia gjymtyrët e sipërme dhe të poshtme tek të rriturit*". Gjithashtu, problematikat e evidentuara përgjatë turit "PAK më afër", lidhur me mospërfshirjen e diagnozave, të përcjella në MSHMS nëpërmjet shkresës nr. 4860 prot., datë 24.06.2024, për diagnoza si epilepsia, prapambetjet mendore të lehta me çrregullime të sjelljes apo diagnozat gjenetike nuk rezulton të jenë përfshirë në manualet e përditësuara.

Në raportin dërguar nëpërmjet shkresës nr. 4860 prot., datë 24.06.2024, citohet se "*ka një numër të madh dosjesh që kthehen për moskomisionim për shkak të mospërfshirjes së diagnozës në udhëzues apo mungesë ekzaminimesh,* ***vetëm për vitin 2023 janë kthyer 736 dosje***". Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga SHSSH-ja ka rezultuar se **për vitin 2024 janë kthyer 1302 dosje** dhe **për vitin 2025 janë kthyer 995 dosje**, për shkak të mospërfshirjes së diagnozës në udhëzues apo mungesë ekzaminimesh.

Mbi veprimtarinë e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KSHVAK)
Çdo komision biopsikosocial është i përbërë nga 1 mjek, 1 punonjës social dhe një operator, për të gjitha komisionet biopsikosociale në çdo qark është dhe një përgjegjës. Operatori dhe komisioni janë në zyra të veçanta dhe të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Në të gjithë qarqet e vendit janë ngritur 37 komisione përkatësisht: 6 komisione në Tiranë, 3 në Durrës, 6 në Elbasan, 3 në Shkodër, 2 në Lezhë, 3 në Korçë, 3 në Vlorë, 4 në Fier, 2 në Berat, 1 në Gjirokastër, 2 në Dibër dhe 2 në Kukës.
Në pikën 2 të Rregullores nr. 225, datë 06.12.2019 "*Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KSHVAK-ve*" përcaktohen kriteret, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KSHVAK dhe stafit mbështetës.

Në pikën 2.3 përcaktohet se mjeku i KVSHAK duhet të ketë përfunduar arsimin e lartë në mjekësi (mjek). Nga auditimi u konstatua se:

- Në mungesë të një përcaktimi mbi profilin e mjekut në përbërje të KSHVAK, mjekët kanë profile të ndryshme, si mjekësi e përgjithshme, pneumologji, dermatologji, kirurgji, epidemiologji, gastro-hepatologji, alergologji, transfuzionist, pediatri, psikiatri, reumatologji, anatomi-patologji, etj.
- Në KVSHAK – QSH nr. 10, punonjësi që kryen shërbimin e mjekut është me profesion teknik imazherie dhe jo mjek, në kundërshtim me dispozitën e sipërcituar.

Në pikat 2.7 dhe 2.8 përcaktohen kriteret, detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit të administrimit dhe regjistrimit të të dhënave, i cili ka rol kyç në administrimin e procesit të vlerësimit biopsikosocial, përfshirë regjistrimin e aplikimeve, verifikimin e të dhënave, administrimin e dokumentacionit dhe koordinimin e procesit të komisionimit. Për këtë pozicion kërkohet vetëm përfundimi i arsimit të lartë, pa përcaktuar profilin profesional përkatës. Si rezultat, gjatë auditimit u konstatua se këto funksione ushtrohen nga punonjës me formime akademike shumë të ndryshme, duke përfshirë profile juridike, ekonomike, administrative, shëndetësore, pedagogjike, sociale dhe të teknologjisë së informacionit.

Kontrollet e kryera nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK pranë SHSSH përgjatë periudhës së auditimit dhe rezultatet përkatëse pasqyrohen, si më poshtë:

Viti	Kontrolli DRSHSSH/ KSHVAK	Dëmi ekonomik i konstatuar		Masa administrative
		Nr. i dosjeve	Vlera	
2020	2 KSHVAK Tiranë	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
2021	4 KSHVAK Tiranë	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
2022	5 KSHVAK (1 Durrës, 2 Elbasan, 1 Vlorë, 1 Fier, dhe 1 njësi vendore Cakran)	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
2023	18 KSHVAK (Berat, Dibër, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër, Vlorë)	75	3,219,412	20 vërejtje me shkrim, 6 vërejtje me paralajmërim dhe 1 masë shpërblim dëmi
2024	17 KSHVAK (Durrës, Elbasan, Gjirokastër, Kukës, Tiranë)	45	3,301,548	4 masa shpërblim dëmi
2025	17 KSHVAK (Berat, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër, Vlorë)	11	444,040	3 masa shpërblim dëmi. (në proces 4 KSHVAK Fier)
Totali		**131**	**6,965,000**	

Burimi: DKP NE&PAK, SHSSH

Rezultatet kryesore të kontrolleve të ushtruara nga DKP NE&PAK lidhur me aktivitetin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KSHVAK), rezultojnë, si më poshtë:

Gjatë vitit 2020, për shkak të vakancave në Sektorin e PAK dhe rishikimit të metodologjisë së kontrollit, në KSHVAK Tiranë u kryen kontrolle tematike në dy komisione. Nga verifikimet u konstatua se në një numër të konsiderueshëm rastesh niveli i dëmtimit i përcaktuar nga KSHVAK rezultonte më i ulët se niveli i vlerësuar nga mjeku specialist, fakt i evidentuar edhe në Regjistrin Elektronik të PAK. Në vijim, SHSSH rekomandoi forcimin e cilësisë së dokumentimit mjekësor, duke kërkuar që mjekët specialistë dhe mjekët e familjes të argumentojnë nivelin e dëmtimit mbi bazën e ekzaminimeve, konsultave dhe kartelës së ndjekjes, si dhe të sigurojnë përputhshmërinë e diagnozës dhe dokumentacionit mbështetës me kriteret e përcaktuara në udhëzuesit biopsikosocialë.

Për vitin 2021, gjatë kontrolleve të ushtruara në 4 KSHVAK të DRSHSSH Tiranë, u konstatuan mangësi në administrimin dhe verifikimin e dokumentacionit mbështetës të aplikuesve. Konkretisht, në një numër dosjesh mungonte pjesë e dokumentacionit mjekësor të kërkuar sipas

udhëzuesve të vlerësimit biopsikosocial, ndërsa nga verifikimet në REK rezultoi se 42 aplikantë nuk kishin dorëzuar formularin e kontrollit vjetor mjekësor, në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019. Gjithashtu, nga kontrolli i 143 praktikave u evidentua mungesa e kartelave mjekësore në 19 raste.
Gjatë vitit 2022, kontrollet e ushtruara në 6 KSHVAK pranë DRSHSSH-ve Durrës, Elbasan dhe Vlorë evidentuan mangësi të konsiderueshme në administrimin e dokumentacionit mjekësor dhe zbatimin e kritereve të vlerësimit biopsikosocial. Konkretisht, në 99 nga 243 dosje të kontrolluara mungonte pjesë e dokumentacionit mjekësor të kërkuar sipas udhëzuesve të vlerësimit, ndërsa në 7 raste procedura e komisionimit ishte kryer për diagnoza që nuk përfshiheshin në kriteret përfituese. Gjithashtu, nga kontrolli i praktikave u konstatua mungesa e kartelave mjekësore në 16 raste, duke evidencuar dobësi në administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit mbështetës të procesit të vlerësimit.
Kontrollet e ushtruara gjatë viteve 2023–2025 evidentuan problematika në respektimin e afatit 30-ditor të komisionimit të aplikimeve për vlerësimin biopsikosocial. Në vitin 2023, nga verifikimi i 3,382 dosjeve në 19 KSHVAK, u konstatuan 126 raste me tejkalim afati, të përqendruara kryesisht në qarqet Dibër (67 raste) dhe Shkodër (48 raste). Në vitin 2024, nga kontrolli i 3,076 dosjeve në 18 KSHVAK, u evidentuan 114 raste me vonesa, ku numrin më të lartë e paraqiti Qarku Durrës me 76 raste, i ndjekur nga Elbasani me 23 raste dhe Kukësi me 15 raste. Ndërsa në vitin 2025, nga kontrolli me përzgjedhje i 2,440 dosjeve, u identifikuan 18 raste me tejkalim të afatit ligjor, pothuajse të gjitha të përqendruara në Qarkun Vlorë (17 raste).

Mbi veprimtarinë e Komisioneve të Shqyrtimit të Ankesave
Në Kreun V, pika 1, përcaktohet se aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar. Ankimimi bëhet me shkrim, brenda 20 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit të vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, e cila shqyrton dokumentacionin e ankimuesit, kryen intervistën dhe merr vendimin përfundimtar. Në rastet kur kërkesa pranohet, personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës, nga data e marrjes së vendimit për refuzim nga komisioni. Pranë Drejtorisë të Përgjithshme me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm funksionojnë 3 komisione të shqyrtimit të ankesave. Komisioni i shqyrtimit të ankesave përbehet nga 1 mjek dhe 2 punonjës social, të cilët funksionojnë si komisione ad-hoc të formuar nga punonjës që aktualisht mbajnë funksione të tjera administrative në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH, Drejtori Rajonale apo Institucione Rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror. Detyrat e KSHA-së për secilin ankimim janë shqyrtimi i dokumentacionit dhe realizimi i intervistave.

Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së nr. 212, datë 18.04.2024, janë ngritur KSHA-të, me përbërje, si më poshtë:
Komisioni nr. 1: V. S. (*Specialist, Drejtoria e Komisionimit të PAK*), A. P. (*Specialist, Drejtoria e Shërbimeve Sociale*), A. R. (*punonjës social, Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë*). Nëpërmjet Urdhrit nr. 356, datë 20.11.2024, A. R. zëvendësohet me E. S.(*specialist 6 orë, Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë*).
Komisioni nr. 2: Sh. A. (*Specialist mjek, Drejtoria e Komisionimit të PAK)*, Xh. M. (*Përgjegjës Sektori, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme*), Xh. Sh. (*Specialist, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme*). Nëpërmjet Urdhrit nr. 303, datë 16.09.2024, Sh. A. zëvendësohet me A. K. (*Specialist, Drejtoria e Komisionimit të PAK*). Nëpërmjet Urdhrit nr. 145, datë 30.01.2025, Xh. M. zëvendësohet me V. T.j (*Specialist, Drejtoria e Shërbimeve Sociale*).
Komisioni nr. 3: R. K. (*Specialist mjek, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE&PAK*), B. U. (*punonjës social, Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë*), D. Sh. (*punonjës social, Shtëpia e*

Foshnjës Tiranë). Nëpërmjet Urdhrit nr. 145, datë 30.01.2025, B. U. zëvendësohet me A. Gj. (*punonjës social, QKTE*).

Nga të dhënat e pasqyruara në Raportet vjetore të SHSSH-së rezulton se KSHA ka trajtuar:
Për vitin 2024, KSHA ka rivlerësuar 3,852 individë të cilët kanë ankimuar vendimet e KSHVAK-ve. Përllogaritur sipas ditëve punë (rreth 247 ditë pune në vitin 2024, pa llogaritur ditët e lejes vjetore të punonjësve, angazhimin në detyrat e tjera funksionale, etj.), rezulton se fluksi i ankesave të trajtuara mesatarisht nga secila prej 3 KSHA-ve është *rreth 5.2 ankesa në ditë për çdo ditë pune*.
Për vitin 2025, KSHA ka rivlerësuar 2,163 individë, nga të cilët 1,977 kanë ankimuar vendimet e KSHVAK-ve dhe 186 janë sjellë për rivlerësim nga kontrollet e ushtruara nga DKP. Përllogaritur sipas ditëve punë (rreth 248 ditë pune në vitin 2025, pa llogaritur ditët e lejes vjetore të punonjësve, angazhimin në detyrat e tjera funksionale, etj.), rezulton që fluksi i ankesave të trajtuara mesatarisht nga secila prej 3 KSHA-ve është *rreth 2.9 ankesa për çdo ditë pune*.
Në një kampionim me përzgjedhje rastësore lidhur me rezultatet e shqyrtimit të ankesave nga KSHA-të përgjatë vitit 2025, ka rezultuar, si më poshtë:

Rajoni	Raste të kampionuara	Vendimi i KSHVAK i pandryshuar	Ndryshuar nga refuzim në pranim	Ndryshuar kategori	% vendime të ndryshuara
Gjirokastër	16	3	8	5	81.3%
Dibër	15	3	3	9	80.0%
Kukës	5	1	4	-	80.0%
Tiranë	20	7	9	4	65.0%
Durrës	17	6	1	10	64.7%
Fier	16	6	4	6	62.5%
Berat	19	8	8	3	57.9%
Vlorë	11	5	2	4	54.5%
Elbasan	15	7	2	6	53.3%
Shkodër	15	7	2	6	53.3%
Korçë	19	10	9	-	47.4%
Lezhë	17	10	3	4	41.2%
TOTAL	**185**	**73**	**55**	**57**	**60.5%**

Për sa më sipër, nga 185 praktika ankesash të shqyrtuara, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka ndryshuar vendimin e KSHVAK në 112 raste, ose rreth 60% të ankimimeve.
Në pikën 4 të Rregullores nr. 225, datë 06.12.2019, përcaktohet se KSHA shqyrton rastet brenda 60 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes zyrtarisht të ankesës në DP SHSSH. ***Nga 185 praktikat e mësipërme, ka rezultuar se 57 prej tyre (rreth 30% e rasteve) janë trajtuar në tejkalim të afatit 60-ditor të përcaktuar në Rregulloren nr. 225, datë 06.12.2019***.
Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të një databaze ku të pasqyrohet aktiviteti i Komisioneve të Shqyrtimit të Ankesave, me qëllim testimin e respektimit të afateve të përcaktuara. SHSSH-ja nuk administron një databazë ku të pasqyrohet për çdo ankimim data e hyrjes së ankesës dhe data e trajtimit të ankesës, me qëllim që vetë SHSSH-ja të aplikojë kontrollet e brendshme të nevojshme lidhur me respektimin e afateve të përcaktuara, për ofrimin në kohë të shërbimit, duke mos garantuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Me qëllim realizimin e këtij testimi nga grupi i auditimi, Shërbimi Social Shtetëror ka marrë masat për nxjerrjen manuale të të dhënave nga regjistri i protokollit

dhe vendimet e KSHA-ve për ankesat e administruara gjatë muajit mars dhe shtator 2025, nga ku rezultoi se:

- **Për muajin mars 2025**, nga 156 ankesa të administruara, 28 prej tyre janë shqyrtuar dhe trajtuar në tejkalim të afatit 60-ditor të përcaktuar në pikën 4 të Rregullores nr. 225, datë 06.12.2025. ***Periudha maksimale për shqyrtimin dhe trajtimin e një ankese është 320 ditë, ndërkohë që koha mesatare e trajtimit dhe shqyrtimit të 156 ankesave të muajit mars 2025 është 54.2 ditë/ ankesë***.
- **Për muajin shtator 2025**, nga 153 ankesa të administruara, 27 prej tyre janë shqyrtuar dhe trajtuar në tejkalim të afatit 60-ditor të përcaktuar në pikën 4 të Rregullores nr. 225, datë 06.12.2019. ***Periudha maksimale për shqyrtimin dhe trajtimin e një ankese është 177 ditë, ndërkohë që koha mesatare e trajtimit dhe shqyrtimit të 153 ankesave të muajit shtator 2025 është 47.8 ditë/ ankesë***.

Nga auditimi ka rezultuar se, për periudhën e auditimit, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE&PAK nuk ka kryer asnjë kontroll në Komisionet e Shqyrtimit të Ankesave, në kundërshtim me kreun 2 "*llojet e kontrollit*", pika 2.1, të Shtojcës 2 të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021, ku përcaktohet se *kontrolli i plotë bëhet çdo vit për zyrën e administrimit të procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të Shërbimit Social Shtetëror*.

Mbi akordimin e paketës higjieno-sanitare

Sipas VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019, përfituesit e aftësisë së kufizuar që vlerësohen se kanë nevojë për paketë higjieno-sanitare duhet të përfitojnë një pagesë shtesë për mbulimin e këtyre shpenzimeve, në masën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Nga auditimi rezultoi se nuk është nxjerrë asnjë akt nënligjor që të përcaktojë masën e këtij përfitimi, ndërsa SHSSH nuk vuri në dispozicion dokumentacion që të vërtetojë se ka propozuar apo kërkuar miratimin e tij. Si pasojë, dispozita përkatëse ka mbetur e pazbatueshme në praktikë dhe asnjë përfitues i skemës biopsikosociale nuk ka përfituar mbështetjen për paketën higjieno-sanitare gjatë periudhës 2020–2025..

Personat që nuk përfitojnë nga pensioni i invaliditetit

Sipas Ligjit nr. 57/2019, pagesa e aftësisë së kufizuar përfshin edhe personat e paaftë për punë që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e pensionit të invaliditetit sipas legjislacionit të sigurimeve shoqërore. Në praktikë, këta individë kalojnë fillimisht procesin e vlerësimit pranë KMCAP-it, mbi bazën e "Fletë-Drejtimit për në KMCAP", dokument i lëshuar nga institucionet spitalore me shtretër, pas vlerësimit të gjendjes shëndetësore. Në rastet kur, pas vlerësimit, konstatohet se personi nuk plotëson kriterin ligjor të 12 muajve sigurim në 5 vitet e fundit, KMCAP merr vendim "pa grup" për shkak të mosplotësimit të kriterit ligjor dhe jo për shkak të mungesës së paaftësisë për punë.

Megjithatë, për të përfituar nga skema e vlerësimit biopsikosocial, këta individë duhet të nisin një procedurë të re aplikimi, duke plotësuar formularët dhe dokumentacionin e përcaktuar në VKM-në nr. 722, datë 11.11.2019, përmes mjekut të familjes ose mjekut specialist. Si rrjedhojë, pavarësisht ekzistencës së dokumentacionit mjekësor të administruar dhe vlerësuar më parë në procesin e KMCAP-it, aplikuesit i nënshtrohen një procesi të dytë administrativ dhe dokumentar për të provuar të njëjtën gjendje shëndetësore në kuadër të skemës biopsikosociale.

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka administruar praktika nga KSHVAK nr. 10 Tiranë për raste të personave që kanë aplikuar për t'u përfshirë në skemën biopsikosociale të aftësisë së kufizuar, pasi janë refuzuar nga skema e pensionit të invaliditetit për mosplotësim të kriterit ligjor, nga ku u konstatua se:

1. Në rastin e S.G., "Fletë-Drejtimi për në KMCAP" është lëshuar më datë 22.04.2025, mbi bazën e diagnozave të rënda që lidhen me cirrozën hepatike të dekompensuar dhe

komplikacionet e saj. Më datë 28.07.2025, KMCAP e ISSH-së e vlerësoi personin si "*të paaftë për punë*", por pa të drejtë për pension invaliditeti për shkak të mosplotësimit të kriterit ligjor të sigurimit. Në vijim, aplikuesi iu nënshtrua procedurës së vlerësimit biopsikosocial pranë SHSSH-së, duke plotësuar formularët dhe dokumentacionin e kërkuar deri në komisionimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar. Njoftimi i vendimit të DRSHSSH Tiranë, me përcaktimin e përfitimit "aftësi e kufizuar niveli 1", është kryer më datë 01.02.2026.
Nga data e lëshimit të Fletë-Drejtimit për në KMCAP deri në njoftimin përfundimtar të përfitimit në skemën biopsikosociale, procesi ka zgjatur **285 ditë kalendarike**.
2. Në rastin e A.B., në dosje administrohet "Përmbledhja e daljes" nga Spitali Universitar i Traumës, datë 22.08.2025, ku është pasqyruar diagnoza coxarthrosis bilaterale. Më datë 10.12.2025, KMCAP e ISSH-së e vlerësoi personin si "*të paaftë për punë*", por pa të drejtë për pension invaliditeti për shkak të mosplotësimit të kriterit ligjor të sigurimit. Në vijim, aplikuesi iu nënshtrua procedurës së vlerësimit biopsikosocial pranë SHSSH-së, duke plotësuar dokumentacionin dhe formularët përkatës deri në shqyrtimin nga KSHVAK.
Më datë 01.02.2026, DRSHSSH Tiranë njoftoi vendimin përfundimtar, sipas të cilit **nuk përfitohej pagesa e aftësisë së kufizuar**, pasi niveli i dëmtimit dhe kufizimeve nuk vlerësohej se pengonte kryerjen e aktiviteteve bazë të jetës në përputhje me moshën. Si rrjedhojë, nga data e dokumentit fillestar mjekësor të administruar në dosje (22.08.2025) deri në njoftimin e vendimit përfundimtar (01.02.2026), procesi ka zgjatur **163 ditë kalendarike**.
3. Në rastin e H.T., aplikimi fillestar për vlerësim biopsikosocial, i paraqitur gjatë muajve prill–maj 2024, nuk u mor në shqyrtim për shkak të mungesës së Fletë-Drejtimit për në KMCAP dhe, sipas verifikimeve të kryera nga SHSSH, ekzistencës së listëpagesave në sistemin e DPT-së. Në vijim, me Fletë-Drejtimin për në KMCAP të datës 29.07.2024, aplikuesi u referua për vlerësim me diagnozën Morbus Parkinson, stadi III. Më datë 05.11.2024, KMCAP e ISSH-së e vlerësoi si "të paaftë për punë", por pa të drejtë për pension invaliditeti për shkak të mosplotësimit të kriterit ligjor të sigurimit. Pas përfundimit të procedurave të vlerësimit biopsikosocial pranë SHSSH-së dhe shqyrtimit nga KSHVAK, më datë 01.01.2025 u njoftua vendimi për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar në nivelin 2, me vlefshmëri deri më 01.01.2026.
Nga data e Fletë-Drejtimit për në KMCAP (29.07.2024) deri në njoftimin e vendimit përfundimtar (01.01.2025), procesi ka zgjatur **156 ditë kalendarike**.
4. Në rastin e SH.D., aplikuesi ishte njoftuar fillimisht nga SHSSH se kërkesa nuk mund të merrej në shqyrtim për shkak të evidentimit të listëpagesave në sistemin e DPT-së. Në vijim, me Fletë-Drejtimin për në KMCAP të datës 11.08.2025, ai u referua për vlerësim me diagnozën hematuria makroskopike. Më datë 20.11.2025, KMCAP e ISSH-së e vlerësoi si "të paaftë për punë", por pa të drejtë për pension invaliditeti për shkak të mosplotësimit të kriterit ligjor të sigurimit. Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit biopsikosocial pranë SHSSH-së dhe shqyrtimit nga KSHVAK, më datë 01.01.2026 u njoftua vendimi për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar në nivelin 3, me vlefshmëri deri më 01.01.2027.
Nga data e Fletë-Drejtimit për në KMCAP (11.08.2025) deri në njoftimin e vendimit përfundimtar (01.01.2026), procesi ka zgjatur **143 ditë kalendarike**.
5. Në rastin e H.C., me Fletë-Drejtimin për në KMCAP të datës 20.03.2024, aplikuesja u referua për vlerësim me diagnozat çrregullim depresiv madhor dhe PTSD. Më datë 16.05.2024, KMCAP e ISSH-së e vlerësoi si "*të paaftë për punë*", por pa të drejtë për pension invaliditeti për shkak të mosplotësimit të kriterit ligjor të sigurimit. Pas procedurës së vlerësimit biopsikosocial pranë SHSSH-së, aplikuesja ushtroi të drejtën e ankimit ndaj vendimit të KSHVAK-së. Më datë 01.12.2024, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave njoftoi vendimin përfundimtar, sipas të cilit nuk përfitohej pagesa e aftësisë së kufizuar, pasi niveli i dëmtimit dhe kufizimeve nuk vlerësohej se pengonte kryerjen e aktiviteteve bazë të jetës në përputhje me moshën.

Nga data e Fletë-Drejtimit për në KMCAP (20.03.2024) deri në njoftimin e vendimit përfundimtar (01.12.2024), procesi ka zgjatur **256 ditë kalendarike**, ndërkohë që aplikuesja **nuk rezultoi përfituese** e skemës biopsikosociale, pavarësisht vlerësimit të KMCAP-it të ISSH-së si person i paaftë për punë.

6. Në rastin e R.GJ., aplikimi fillestar për vlerësim biopsikosocial, i paraqitur gjatë muajve tetor–nëntor 2025, nuk u mor në shqyrtim nga KSHVAK për shkak se nga verifikimet në sistemin e DPT-së rezultonin listëpagesa aktive. Në vijim, me Fletë-Drejtimin për në KMCAP të datës 22.09.2025, aplikuesi u referua për vlerësim me diagnoza të rënda, përfshirë sëmundje renale kronike stadi V, diabet mellitus tip 2 me komplikacione, hiperplazi beninje të prostatës dhe status post AVC ishemik. Më datë 12.01.2026, KMCAP e ISSH-së e vlerësoi si "të paaftë për punë", pas së cilës aplikuesi iu nënshtrua procedurës së vlerësimit biopsikosocial pranë SHSSH-së. Më datë 01.03.2026, DRSHSSH Tiranë njoftoi vendimin përfundimtar, duke e klasifikuar si përfitues me aftësi të kufizuar niveli 3, me vlefshmëri deri më 01.03.2027.

Nga data e Fletë-Drejtimit për në KMCAP (22.09.2025) deri në njoftimin e vendimit përfundimtar (01.03.2026), procesi ka zgjatur **160 ditë kalendarike**.

7. Në rastin e T.XH., me Fletë-Drejtimin për në KMCAP të datës 28.02.2023, aplikuesi u referua për vlerësim me diagnozat cirrozë hepatike etilike dhe varice ezofageale gradë I. Më datë 21.06.2023, KMCAP e ISSH-së e vlerësoi si "*të paaftë për punë*", por pa të drejtë për pension invaliditeti për shkak të mosplotësimit të kriterit ligjor të sigurimit. Në vijim, aplikuesi paraqiti dokumentacionin për vlerësim biopsikosocial pranë SHSSH-së, por me shkresën nr. 428 prot., datë 22.08.2023, u njoftua se kërkesa nuk mund të merrej në shqyrtim nga KSHVAK, pasi diagnoza nuk përfshihej në Udhëzuesin e Vlerësimit Biopsikosocial të Aftësisë së Kufizuar për të Rriturit.

Nga data e Fletë-Drejtimit për në KMCAP (28.02.2023) deri në njoftimin përfundimtar të SHSSH-së (22.08.2023), procesi ka zgjatur **175 ditë kalendarike**, ndërkohë që aplikuesi **nuk rezultoi përfitues** i skemës biopsikosociale, pavarësisht vlerësimit të KMCAP-it të ISSH-së si person i paaftë për punë.

8. Në rastin e SH.K., me Fletë-Drejtimin për në KMCAP të datës 29.09.2022, aplikuesi u referua për vlerësim me diagnozën cirrozë hepatike e kompensuar virale B. Më datë 25.01.2023, KMCAP e ISSH-së e vlerësoi si "*pjesërisht i aftë për punë*", por pa të drejtë për pension invaliditeti për shkak të mosplotësimit të kriterit ligjor të sigurimit. Në vijim, aplikuesi paraqiti dokumentacionin për vlerësim biopsikosocial pranë SHSSH-së, por me shkresën nr. 262 prot., datë 29.05.2023, u njoftua se kërkesa nuk mund të merrej në shqyrtim nga KSHVAK, pasi sipas vendimit të KMCAP rezultonte i aftë për punë.

Nga data e Fletë-Drejtimit për në KMCAP (29.09.2022) deri në njoftimin përfundimtar të SHSSH-së (29.05.2023), procesi ka zgjatur **242 ditë kalendarike**, ndërkohë që aplikuesi **nuk rezultoi përfitues** i skemës biopsikosociale.

Për sa më sipër, përveç procedurës së dublikuar të drejtimit të individëve, fillimisht nëpërmjet plotësimit të fletë-drejtimit nga institucionet spitalore me shtretër për përfitim nga skema e pensionit të invaliditetit dhe vlerësimit të aftësisë për punë nga KMCAP e ISSH-së, e më pas nëpërmjet plotësimit të formularëve të aplikimit nga mjeku i familjes/mjeku specialist për përfshirje në skemën biopsikosociale të aftësisë së kufizuar, konstatohet mungesa e një procedure të qartë dhe të harmonizuar ndërmjet kuadrit ligjor dhe atij nënligjor që rregullon kalimin e kësaj kategorie nga njëra skemë në tjetrën. Kjo situatë sjell zvarritje në trajtimin e rasteve dhe në fillimin e përfitimeve, si dhe krijon risk për mospërfshirjen në kohë në skemën biopsikosociale të personave që nuk përfitojnë nga pensioni i invaliditetit për shkak të mosplotësimit të kriterit ligjor të periudhës së sigurimit. Në të njëjtën kohë, diferencat ndërmjet kritereve të vlerësimit të aftësisë për punë në skemën e sigurimeve shoqërore dhe kritereve të vlerësimit funksional në modelin biopsikosocial krijojnë paqartësi dhe trajtime jo të unifikuara

të rasteve, duke evidentuar nevojën për sinkronizimin e akteve ligjore dhe përcaktimin e një procedure të integruar referimi, me qëllim garantimin e trajtimit të shpejtë dhe efektiv të kësaj kategorie përfituesish.

B. Skema e aftësisë së kufizuar (Paratetraplegjia dhe verbëria)

Në Kreun II, pika 1, të VKM-së nr. 182, datë 26.02.2020 "*Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal*", i ndryshuar, përcaktohet se pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror funksionojnë komisionet e nivelit të parë dhe epror të vlerësimit të paratetraplegjisë dhe verbërisë. Kategoritë e statusit të të verbërit dhe të paratetraplegjisë vlerësohen nga KMCAP-et në përbërje të të cilëve janë mjekë specialistë të fushave përkatëse, neurologjisë dhe okulistikës.

Në kreun II, pika 1.1, të VKM-së nr. 182/2020 përcaktohet se personi që vlerësohet për herë të parë për aftësi të kufizuara, përveç vlerësimit të dosjes paraqitet edhe personalisht para KMCAP-së së nivelit të parë, ndërkohë që pika 1.2 përcakton se rivlerësimi bëhet pa praninë fizike të personit me aftësi të kufizuara. Bazuar në Urdhrin nr. 577, datë 14.10.2020 "*Për një ndryshim dhe shtesë në Urdhrin nr. 266/1, datë 01.09.2020, për marrjen e masave të veçanta nga komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19*", përjashtohet paraqitja e personave në këto komisione, duke u realizuar komisionimi nëpërmjet platformave online, për vlerësimin e statusit të të verbërit vlerësimi bëhet vetëm nëpërmjet dokumentacionit në dosje, ndërsa në KMCAP-et eprore është detyrim paraqitja në komision. Urdhri i referuar është bazuar ndër të tjera në Udhëzimin e ISHP-së me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19, akt i cili nuk rezulton të jetë shfuqizuar dhe vijon të aplikohet nga SHSSH-ja, pavarësisht se situata e Covid-19 nuk është më aktuale. Në pikën 7.1 dhe 7.2 të Urdhrit të MSHMS-së nr. 266/1, datë 01.09.2020, i ndryshuar, përcaktohet se:

"*7.1. Përjashtimisht gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19 paraqitja e personave në komisionin e nivelit të parë... realizohet me komisionin, personalisht përmes platformave online dhe në prani të përfaqësuesit të SHSSH (mjek) në vendbanimin e personit.*

7.2. Paraqitja në KMCAP epror bëhet me prezencën fizike të personit. Vetëm në raste të veçanta kur gjendja e rënduar është e argumentuar nga mjeku specialist përkatës, së bashku me arsyen e pamundësisë së paraqitjes në komision, si edhe kur KMCAP epror vlerëson se paraqitja fizike është e pamundur, procedura e vlerësimit bëhet përmes platformave online, në prezencë të përfaqësuesit të DRSHSSH (mjek) ose me prezencën e anëtarit/ anëtarëve të KMCAP epror, në vendbanimin e personit".

Aplikimi bëhet pranë administratorit shoqëror, i cili e dërgon zyrtarisht me shkresë përcjellëse pranë KMCAP/ Drejtorisë Rajonale të SHSSH. Pas komisionimit në KMCAP dosja shkon zyrtarisht në Drejtorinë Rajonale ku skanohet dhe më pas dërgohet pranë Njësisë Administrative. Nëse individi nuk është dakord me vendimin e KMCAP-it të nivelit të parë bën ankesën pranë administratorit shoqëror i cili më pas dërgon dosjen zyrtarisht në KMCAP Epror.

Në VKM-në nr. 182, datë 26.02.2020 janë përcaktuar kriteret e pagesës së aftësisë së kufizuar, veprimtaria e KMCAP-ve të nivelit të parë dhe eprore, masat e përfitimit, për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat me aftësi të kufizuar që deklarohen të paaftë për punë nga KMCAP, si dhe personat sipas KMCAP të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore të përfitimit të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.

Pavarësisht se në nenin 20, pika 3, gërma c, të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, përcaktohet se SHSSH kontrollon dhe monitoron veprimtarinë dhe zbatimin e legjislacionit të asistencës sociale, në VKM-së nr. 257, datë

05.05.2021 nuk ka asnjë përcaktim për kontrollin e zbatimit të legjislacionit në kuadër të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, sa i përket aktivitetit të KMCAP-ve të nivelit të parë dhe KMCAP-ve eprore, duke mos aplikuar asnjë hallkë kontrolli mbi zbatimin e legjislacionit në këtë kategori, në kundërshtim me nenin 20, pika 3, gërma c, të Ligjit nr. 57/2019. **Për rrjedhojë, asnjë mekanizëm kontrolli nuk është aplikuar nga SHSSH mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore që përcaktojnë aktivitetin e KMCAP-ve të nivelit të parë dhe epror**, në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, dhe pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Mbi veprimtarinë e KMCAP-ve të nivelit të parë

Pranë Shërbimit Social Shtetëror janë ngritur dhe funksionojnë 2 komisione të nivelit të parë, përkatësisht KMCAP (për paratetraplegjinë) dhe KMPV (për verbërinë). Si rregull, KMCAP-et e nivelit të parë mblidhen jo më pak se 3 herë në muaj. Sipas përcaktimit në Kreun II/I, pika 5, gërma ë, të VKM-së nr. 182, datë 26.02.2020, i ndryshuar, KMCAP-ja e nivelit të parë shqyrton rastin brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasi është marrë me procesverbal prej protokollit nga mjeku i Shërbimit Social Shtetëror dhe pasi ky i fundit ka kryer verifikimet e nevojshme të dokumentacionit mjekësor, për rastet që vlerësohen për herë të parë.

Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të një databaze ku të pasqyrohet aktiviteti i KMCAP-ve të nivelit të parë, me qëllim testimin e respektimit të afateve të përcaktuara. SHSSH-ja nuk administron një databazë ku të pasqyrohet për çdo aplikim data e hyrjes së dhe data e vendimmarrjes, me qëllim që vetë SHSSH-ja të aplikojë kontrollet e brendshme të nevojshme lidhur me respektimin e afateve të përcaktuara, për ofrimin në kohë të shërbimit, duke mos garantuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar. Me qëllim realizimin e këtij testimi nga grupi i auditimi, Shërbimi Social Shtetëror ka marrë masat për nxjerrjen manuale të të dhënave nga regjistri i protokollit dhe vendimet e KMCAP-ve të nivelit të parë për aplikimet e administruara, si më poshtë:

- Lidhur me veprimtarinë e *KMCAP të nivelit të parë për paratetraplegjinë* për **muajin mars 2025**, u konstatua se nga 200 kërkesa për komisionim, vetëm 1 rast është trajtuar në tejkalim të afatit 30 ditor të përcaktuar, ndërkohë që koha mesatare për komisionim është rreth 6.7 ditë/ komisionim.
- Lidhur me veprimtarinë e *KMCAP të nivelit të parë për paratetraplegjinë* për **muajin tetor 2025**, u konstatua se nga 189 kërkesa për komisionim, vetëm 2 raste janë trajtuar në tejkalim të afatit 30 ditor të përcaktuar, ndërkohë që koha mesatare për komisionim është rreth 8.4 ditë/ komisionim.
- Lidhur me veprimtarinë e *KMPV të nivelit të parë për verbërinë* për **muajin shtator 2025**, u konstatua se nga 269 kërkesa për rikomisionim, për 7 raste ka gabim në të dhëna (nuk pasqyrohet data e hyrjes së aplikimit ose është hedhur gabim data e komisionimit). U konstatuan 220 raste të trajtuar në tejkalim të afatit 30 ditor të përcaktuar (84% e aplikimeve), ndërkohë që koha mesatare për komisionim është rreth 40 ditë/ komisionim dhe trajtimi më i vonuar është 97 ditë nga dita e aplikimit (67 ditë me vonesë).
- Lidhur me veprimtarinë e *KMPV të nivelit të parë për verbërinë* për **muajin shtator 2025**, u konstatua se nga 159 aplikime për herë të parë, për 8 raste ka gabim në të dhëna (nuk pasqyrohet data e hyrjes së aplikimit ose është hedhur gabim data e komisionimit). U konstatuan 130 raste të trajtuar në tejkalim të afatit 30 ditor të përcaktuar (86% e aplikimeve), ndërkohë që koha mesatare për komisionim është rreth 44 ditë/ komisionim dhe trajtimi më i vonuar është 97 ditë nga dita e aplikimit (67 ditë me vonesë).

Numri i lartë i aplikimeve që trajtohen në tejkalim të afatit 30-ditor të përcaktuar në Komisionin e nivelit të parë të verbërisë, në kundërshtim me Kreun II/I, pika 5, gërma ë, të VKM-së nr.

182, datë 26.02.2020, në kushtet që përfituesit sa i përket verbërisë janë në numër thuajse 3-fish më të lartë se ata nga tetraplegjia, pasqyron një nevojë për rishikim të menjëhershëm të nevojës për shtim të një Komisioni të nivelit të parë për verbërinë, me qëllim ndarjen e fluksit për respektimin e afateve dhe ofrimin e shërbimit në kohë të përshtatshme për qytetarët që u drejtohen KMCAP-ve të nivelit të parë për verbërinë.

Mbi veprimtarinë e KMCAP-ve eprore

Pranë Shërbimit Social Shtetëror janë ngritur dhe funksionojnë 2 komisione eprore, përkatësisht KMCAP epror për paratetraplegjinë dhe për verbërinë. Kryetari dhe tre prej anëtarëve të komisionit janë mjekë me përvojë profesionale në fushën e ekspertizës. Në përbërje të çdo komisioni merr pjesë, si anëtar me të drejtë vote, një mjek, punonjës i Shërbimit Social Shtetëror dhe një jurist me përvojë në fushën e aftësisë së kufizuar, përfaqësues i ministrisë që ka në fushën e përgjegjësisë shtetërore çështjet e aftësisë së kufizuar.

Në Kreun II/I, pika 2, përcaktohet se KMCAP-et e eprore mblidhen jo më pak se një herë në muaj, ndërsa në Kreun V, pika 3, përcaktohet se KMCAP epror mblidhet jo më pak se dy herë në muaj, duke krijuar konfuzion në të njëjtin akt për periodicitetin e mbledhjeve të KMCAP epror. Në Kreun V, pika 3, gjithashtu përcaktohet se, seancat e KMCAP epror janë të përmuajshme dhe zhvillohen **brenda një muaji nga data e paraqitjes së dokumenteve në SHSSH**.

Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të një databaze ku të pasqyrohet aktiviteti i KMCAP-ve eprore, me analizimin e afateve të trajtimit të ankesave dhe rasteve me divergjencë nga KMCAP-et eprore. SHSSH-ja nuk administron një databazë ku të pasqyrohet për çdo aplikim data e hyrjes së dhe data e vendimmarrjes, me qëllim që vetë SHSSH-ja të aplikojë kontrollet e brendshme të nevojshme lidhur me respektimin e afateve të përcaktuara, për ofrimin në kohë të shërbimit, duke mos garantuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Me qëllim realizimin e këtij testimi nga grupi i auditimi, Shërbimi Social Shtetëror ka marrë masat për nxjerrjen manuale të të dhënave nga regjistri i protokollit dhe vendimet e KMCAP-ve eprore për aplikimet e administruara, si më poshtë:

- Lidhur me veprimtarinë e *KMCAP epror për paratetraplegjinë* për **muajt mars-prill 2025**, nga 35 ankimime të vendimeve të nivelit të parë, për 3 raste ka gabim në të dhëna (nuk pasqyrohet data e hyrjes së aplikimit). U konstatua se 29 raste janë trajtuar në tejkalim të afatit 30-ditor (rreth 90% e rasteve), ndërkohë që **koha mesatare për trajtimin e ankesave është rreth 90 ditë** dhe **trajtimi më i vonuar është 226 ditë nga paraqitja e ankimimit** ose 166 ditë me vonesë.
- Lidhur me veprimtarinë e *KMCAP epror për paratetraplegjinë* për **muajt mars-prill 2025**, u konstatua se nga 77 raste të dërguara për divergjencë nga niveli i parë, 75 raste janë trajtuar në tejkalim të afatit 30-ditor, pra vetëm 2 raste janë trajtuar brenda afatit. **Koha mesatare për trajtimin e rasteve me divergjencë është rreth 100 ditë/ komisionim** dhe **trajtimi më i vonuar është 253 ditë nga dërgimi me divergjencë** ose 193 ditë me vonesë.
- Lidhur me veprimtarinë e *KMCAP epror për verbërinë* për **muajin janar 2025**, nga 76 ankimime të vendimeve të nivelit të parë, për 3 raste ka gabim në të dhëna (nuk pasqyrohet data e hyrjes së aplikimit). U konstatua se 67 raste janë trajtuar në tejkalim të afatit 30-ditor (rreth 92% e rasteve), ndërkohë që **koha mesatare për trajtimin e ankesave është rreth 127.4 ditë** dhe **trajtimi më i vonuar është 253 ditë nga paraqitja e ankimimit**.
- Lidhur me veprimtarinë e *KMCAP epror për verbërinë* për **muajin janar 2025**, u konstatua se nga 98 raste të dërguara për divergjencë nga niveli i parë, 97 raste janë trajtuar në tejkalim të afatit 30-ditor, vetëm 1 rast është trajtuar brenda afatit 30-ditor. **Koha mesatare për trajtimin e rasteve me divergjencë është rreth 126 ditë/ komisionim** dhe **trajtimi më i vonuar është 329 ditë nga dërgimi me divergjencë**, ose 269 ditë me vonesë.

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara dhe të referuara në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit ngarkohen me përgjegjësi:
1. *Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror,* për mungesën e propozimeve konkrete për paketat higjieno-sanitare për skemën biopsikosociale, mospërcaktimin e aktiviteteve të kontrollit në lidhje me veprimtarinë e KMCAP-ve të paratetraplegjisë dhe verbërisë, si dhe parregullsitë e konstatuara në veprimtarinë e strukturave në varësi.
2. *Drejtori i Drejtorisë së Komisionimit të PAK-ut,* për mosraportimin e problematikave funksionale të lidhura me sistemin e PAK me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e funksionimit të sistemit sa i përket moduleve dhe raporteve të gjeneruara, për parregullsitë në menaxhimin e funksionimit të Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë së Kufizuar dhe Komisioneve të Shqyrtimit të Ankesave, si dhe për mungesën e propozimeve për paketat higjieno-sanitare për skemën biopsikosociale.
3. *Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave NE & PAK,* për moskryerjen e kontrollit çdo vit në zyrën e administrimit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të Shërbimit Social Shtetëror.

2.5. Vlerësimi i veprimtarisë me fokus shërbimet sociale dhe institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit nr. 17/1 prot., datë 13.01.2026, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:
2. Dokumentacion i vënë në dispozicion nga SHSSH lidhur me shërbimet e kujdesit shoqëror;
3. Dokumentacion i vënë në dispozicion lidhur me IPSH-të në varësi dhe bashkëvarësi të SHSSH-së;
4. Dokumentacion lidhur me projektet dhe shërbimet e financuara nga fondi social;
5. Dokumentacion lidhur me monitorimet e kryera në ofruesit e shërbimeve sociale dhe projektet e fondit social.

Gjithashtu, bazuar në pikën 67 të ISSAI 4000, grupi i auditimit ka mbajtur në konsideratë edhe konstatime nga auditime të mëparshme të zhvilluara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në institucionet e varësisë së SHSSH-së.

Shërbimet e kujdesit shoqëror përbëjnë një sistem të integruar përfitimesh dhe mbështetjeje, të ofruara nga subjekte publike dhe jopublike, me qëllim garantimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes sociale të individëve dhe familjeve në nevojë. Sipas nenit 5 të Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përfitues të këtyre shërbimeve janë individët dhe familjet që nuk janë në gjendje të sigurojnë vetë mjetet e jetesës ose të plotësojnë nevojat bazë për shkak të kushteve personale apo sociale.
Kuadri ligjor parashikon një gamë të gjerë shërbimesh, duke përfshirë shërbimet komunitare, rezidenciale, shërbimet në situata emergjence, kujdesin alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, shërbimet e specializuara dhe format e këshillimit në distancë. Në zbatim të nenit 32 të këtij ligji, Shërbimi Social Shtetëror është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimeve shoqërore në nivel kombëtar, nëpërmjet strukturës qendrore dhe drejtorive rajonale.

Funksionimi i sistemit të SHKSH

Kontrata e mirëmbajtjes për sistemin e SHKSH-së ka përfunduar në datë 18.05.2025, duke bërë që nga ajo datë sistemi të jetë pa mirëmbajtje. Mungesa e mirëmbajtjes së sistemeve paraqet risk për vazhdimësinë e punës dhe funksionimin normal të tyre, duke rritur mundësinë e ndërprerjeve të shërbimit dhe mosadresimit e zgjidhjes në kohë të problemeve teknike. Referuar përgjigjeve të pyetësorëve, SHSSH nuk ka qenë në asnjë rast e përfshirë si përfaqësuese në grupet e punës për ndjekjen e kontratave të mirëmbajtjes së sistemeve. Ndjekja

dhe monitorimi i kontratave të mirëmbajtjes janë realizuar nga përfaqësues të AKSHI-t dhe MSHMS-së.
Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së nr. 335, datë 22.10.2024, është ngritur grupi i punës për hartimin e treguesve kryesorë të riskut të sistemeve elektronike të ndihmës ekonomike, personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror. Risqet kryesore të evidentuara nga vetë SHSSH-ja lidhen me kufizimet në administrimin e sistemit dhe menaxhimin e përdoruesve, aksesin e pjesshëm në të dhëna, mungesën e filtrave dhe njoftimeve automatike për ndjekjen e rasteve, pamundësinë e gjenerimit të raporteve të sakta dhe në kohë reale, si dhe kufizimet në trajtimin e rasteve të rikthyera për rishikim. Gjithashtu, është evidentuar mungesa e ndërveprimit me sisteme të tjera shtetërore, si SMIP, ISSH, AKPA dhe ASHK, duke kufizuar shkëmbimin e informacionit dhe duke rritur riskun e vonesave, gabimeve dhe mungesës së koordinimit ndërinstitucionalProblematikat që evidentohen nga përdorimi i sistemeve, përcillen në rrugë elektronike nga ana e IT-së së SHSSH pranë strukturës IT të AKSHI-t pranë ministrisë. Pas përfundimit të kontratave të mirëmbajtjes janë konstatuar problematika të përsëritura të raportuara nga ana e SHSSH-së që konsistojnë në: mosfunksionim të plotë të sistemeve NE, PAK dhe SHKSH dhe probleme log in-i nga ana e përdoruesve fundorë të sistemit në Drejtori të Përgjithshme, Drejtori Rajonale, Njësitë Vendore, etj., duke cënuar disponibilitetin e sistemeve dhe vijueshmërinë e punës. Me qëllim ruajtjen e integritetit të të dhënave grupi i auditimit mori informacion nëpërmjet pyetësorëve mbi procedurat e ndjekura për realizimin e back-up të sistemeve, ku nga SHSSH-ja është vënë në dispozicion përgjigja e AKSHI-t ku citohet se back-up realizohet në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 31.07.2023 "*Për zbatimin e dokumentit të përditësuar të politikave të vazhdimësisë së punës dhe planit për ruajtjen e informacionit*".
Lidhur me pjesën funksionale të sistemit, grupi i auditimit kërkoi informacion mbi modulet e parashikuara në termat e referencës për secili sistem, modulet aktualisht të implementuara dhe ndryshimet që janë bërë që prekin funksionalitetet e sistemit.
Për sistemin e menaxhimit të shërbimeve shoqërore, janë aktualisht të implementuara: moduli i identifikimit dhe referimit të rasteve, moduli i trajtimit të rasteve, moduli i monitorimit dhe vlerësimit periodik, moduli i administrimit të proceseve të punës, moduli i Gjenerimit të Raporteve Statistikore, të Monitorimit dhe Performancës së Proceseve, moduli i ndërveprimit me sistemet e tjera dhe ndërveprimit të brendshëm, moduli i Regjistrit të Legjislacionit (për Portalin Intranet), moduli i Regjistrit të Institucioneve partnere të Shërbimeve Sociale (për Portalin Intranet), moduli web-GIS. Për sa i përket ndërveprimeve me sistemet e tjera aktualisht janë të implementuar ndërveprimet me: DPGJC, ISSH, DPT, QKB.

Mbi licencimin e subjekteve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror
Sipas nenit 27 të Ligjit nr. 121/2016, shërbimet e kujdesit shoqëror mund të ofrohen vetëm nga subjekte të licencuara. Nga auditimi rezultoi se SHSSH nuk disponon një databazë të plotë mbi statusin e licencimit të ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar, pavarësisht rolit të saj monitorues në këtë fushë. Të dhënat e vëna në dispozicion vetëm për institucionet në varësi ose bashkëvarësi të SHSSH-së treguan se, nga 29 institucione të përkujdesit shoqëror, 12 nuk dispononinlicencën përkatëse, në kundërshtim me nenin 27, pika 1, të Ligjit nr. 121/2016. IPSH-të që nuk disponojnë licencën përkatëse rezultojnë: Shtëpia e Fëmijëve 16-18 vjeç Shkodër, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë "Zyber Hallulli" Tiranë, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Sarandë, Qendra Kombëtare e Trajtimit të Emergjencave Tiranë, Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës, Qendra e Zhvillimit PAK Tiranë, Qendra e Zhvillimit PAK Shkodër, Shtëpia e Foshnjës Vlorë, Qendra Polivalente Poliçan, Qendra Komunitare e Moshës së Tretë Palasë, Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastër, Shtëpia e të Moshuarve Kavajë.

Ky konstatim tregon se edhe një pjesë e institucioneve publike të përkujdesit shoqëror, të cilat janë në varësi të drejtpërdrejtë të SHSSH-së dhe objekt monitorimi nga vetë ky institucion, nuk kanë zbatuar kërkesën ligjore për licencim, duke evidentuar dobësi në mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit të zbatimit të legjislacionit për shërbimet e kujdesit shoqëror.

Transferimi i IPSH-ve nga Shërbimi Social Shtetëror drejt Njësive të Vetëqeverisjes Vendore
Në nenin 52, pika 1, të Ligjit nr. 121/2016 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*", përcaktohet se "*brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësive të qeverisjes vendore*". Pavarësisht sa më sipër, edhe pse kanë kaluar thuajse 10 vjet nga hyrja në fuqi e këtij akti ligjor, sikurse cituar më sipër, akoma nuk u janë transferuar NJVV-ve të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i këtyre shërbimeve, duke vijuar të jenë nën varësinë e SHSSH-së institucione të përkujdesjes shoqërore nga Bashkitë Tiranë, Shkodër, Kamëz, etj.

Mbi monitorimet e kryera në ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror
Në Kreun II, pika 3.3, gërma *dh*, të VKM-së nr. 135, datë 07.03.2018 "*Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror*" përcaktohet se Shërbimi Social Shtetëror monitoron zbatimin e standardeve kombëtare nga njësitë e qeverisjes vendore dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, *që financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i qeverisjes qendrore*, dhe informon ministrinë përgjegjëse, si dhe jep rekomandime për njësitë e qeverisjes vendore përgjegjëse, duke specifikuar se *monitorimi realizohet në përputhje me metodologjinë e miratuar*.
Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror, që nga ndryshimet e strukturës nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit nr. 68, datë 24.05.2023, përbëhet nga 10 punonjës: 1 Drejtor (njëkohësisht zv. Drejtor i Përgjithshëm i SHSSH-së) dhe 3 sektorë, përkatësisht (i) Sektori i Shërbimeve Sociale për Fëmijë (3 punonjës – 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë), (ii) Sektori i Shërbimeve Sociale për të Rritur (3 punonjës – 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë) dhe (iii) Sektori i Koordinimit dhe Referimit me Komisionet Shumëdisiplinore të Aftësisë së Kufizuar (3 punonjës – 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë). Përpara këtyre ndryshimeve, struktura përbëhej nga 7 punonjës, nga të cilët një drejtor dhe 6 specialistë. Edhe në strukturat e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror ka Sektorë të Shërbimeve Sociale, me numër të ndryshëm të punonjësve sipas drejtorive rajonale të caktuara. Rregullorja e brendshme e SHSSH-së ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, *por nuk ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorëve përkatës, si dhe të punonjësve specifikë* (drejtori i drejtorisë, përgjegjësit e sektorit dhe specialistët), në kundërshtim me pikën 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Në auditime të mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, është konstatuar "*formalizëm në procesin e monitorimit, si dhe mosevidentim i disa problematikave të evidentuara nga grupet e auditimit, sidomos në aspektin e zbatimit të standardit lidhur me arsimimin e stafit, plotësimit të dosjeve, amortizimit të infrastrukturës ndërtimore, mosevidentim i problematikave në hartimin dhe miratimin e menusë javore... Auditimi i KLSH-së ka konkluduar se* ***prezenca e një metodologjie të mirëfilltë të miratuar në përdorim të strukturave përgjegjëse monitoruese në SHSSH do të ndikonte pozitivisht në cilësinë e punës monitoruese të këtij institucioni***"[25].
Lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi, nga Shërbimi Social Shtetëror është bërë me dije se "*MSHMS, SHSSH me ndihmën dhe mbështetjen e ekspertëve të organizatë UNDP*

[25] Raport Përfundimtar Auditim Performance "*Performanca e Institucioneve Rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijë*", KLSH, 2022, fq. 18-19.

nëpërmjet programit "Leave no one Behind (LNB)" ka nisur procesin dhe do të realizojë për vitin 2023 hartimin e "Metodologjisë së Monitorimit të Shërbimeve Sociale"[26].
Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të metodologjisë së hartuar dhe nga ana e SHSSH-së është dërguar[27] dokumenti "*Metodologji e Monitorimit të Shërbimeve Shoqërore – Version Përfundimtar – 29.02.2024*", ku citohet se "*ky dokument është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror me asistencën teknike të UNDP-së, si pjesë e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Leave no one behind (LNB)", që zbatohet në partneritet me Qeverinë Shqiptare dhe mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)*". Kjo metodologji nuk rezulton të jetë e miratuar as nga Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe as nga Shërbimi Social Shtetëror, duke mos i dhënë këtij dokumenti fuqi ligjore, rrjedhimisht duke vijuar mosplotësimin e kriterit ligjor që monitorimet të realizohen sipas një metodologjie të miratuar, sikurse përcaktuar në Kreun II, pika 3.3, gërma *dh*, të VKM-së nr. 135, datë 07.03.2018.
Sikurse cituar më sipër, Shërbimi Social Shtetëror monitoron zbatimin e standardeve kombëtare nga njësitë e qeverisjes vendore dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, *që financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i qeverisjes qendrore.*
Nga Harta e Shërbimeve Sociale, e vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në SHSSH-së, rezulton se aktualisht në Republikën e Shqipërisë operojnë 342 institucione të shërbimit të përkujdesit shoqëror publike e jopublike, përfshirë qendra rezidenciale, ditore, komunitare, multifunksionale, etj., nga të cilat 180 janë publike dhe 161 jopublike/ private. Sa i përket mënyrës së financimit, rezulton si më poshtë:

- Qendrat e shërbimit me financim *nga Buxheti i Shtetit* janë gjithsej 33, nga të cilat 1 jopublike.
- Qendrat e shërbimit me financim *nga fondi social* janë gjithsej 54, nga të cilat 4 janë jopublike.
- Qendrat e shërbimit me financim miks, ku përfshihet edhe financim *nga buxheti i shtetit dhe/ ose fondi social* janë gjithsej 91, nga të cilat 11 janë jopublike.
- 159 njësi shërbimi kanë financim nga burime të tjera, të kategorizuar si vetëfinancim, financim humanitar, privat, donatorë, etj., dhe 1 njësi financohet vetëm nga buxheti i qeverisjes lokale.

Për sa më sipër, rezulton se nga 342 institucione të shërbimit të përkujdesit shoqëror aktualisht në Republikën e Shqipërisë, **janë 178 institucione që financohen pjesërisht ose plotësisht nga buxheti i qeverisjes qendrore**.
Në nenin 12, pika 3 dhe 4, të "*Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Shërbimit Social Shtetëror*", të miratuar nëpërmjet Urdhrit të MSHMS-së nr. 856 prot., datë 30.05.2020 (këtej e tutje "*Rregullorja e brendshme e SHSSH-së*"), përcaktohet se Drejtoria e Shërbimeve Sociale (*i*) harton planin vjetor të monitorimit të institucioneve rezidenciale dhe ditore të përkujdesit shoqëror në nivel kombëtar dhe (*ii*) monitoron zbatimin e legjislacionit për shërbime shoqërore në të gjithë vendin sipas planit vjetor dhe sa herë e gjykon të nevojshëm, në institucionet rezidenciale dhe ditore publike, mbi ofrimin e shërbimit ndaj përfituesve sipas standardeve të përcaktuara me ligj dhe harton raportet mbi rezultatet e monitorimit.
Nga auditimi u konstatua se monitorimet nga Drejtoria e Shërbimit Social në SHSSH përgjatë viteve periudhë auditimi 2020 - 2025 janë planifikuar dhe realizuar vetëm për IPSH-të në varësi dhe bashkëvarësi të SHSSH-së, por nuk rezulton të jetë planifikuar dhe realizuar asnjë monitorim në ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror të tjerë që financohen pjesërisht

[26] Raport Përfundimtar Auditimi "*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në vitin 2022*", KLSH, 2023, fq. 39.
[27] Nëpërmjet e-mail të datës 03.02.2026.

apo plotësisht nga buxheti i qeverisjes qendrore, në mospërputhje me Kreun II, pika 3.3, gërma dh, të VKM-së nr. 135, datë 07.03.2018 "*Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror*".
Në pikën 5.3 të dokumentit të sipërcituar "*Metodologji e Monitorimit të Shërbimeve Shoqërore – Version Përfundimtar – 29.02.2024*" është argumentuar numri i monitorimeve që mund të realizohen brenda një viti, ku citohet se "***Ofrues publikë të shërbimeve janë 117, ndërsa ofrues të përzierë të shërbimeve janë 121, pra rreth 238 institucione[28]... Meqenëse janë 238 institucione, kjo do të thotë që këto institucione do të monitorohen një herë në tre vite****... Nëse SHSSH do të monitorojë edhe institucionet jopublike, siç është e drejtë dhe e logjikshme, atëherë grupi që do të monitorojë 61 bashkitë do të monitorojë edhe institucionet jopublike (153), domethënë 75 në një vit, pra përsëri llogaritjet tregojnë se bashkitë dhe institucionet private do të monitorohen një herë në 3 vjet. Nëse mobilizohet vetëm një ekip prej dy specialistësh, atëherë një institucion do të monitorohet një herë në 6.5 vite. Por kjo është një periudhë shumë e gjatë. Për rrjedhojë duhet të mobilizohen të paktën dy ekipe njëkohësisht për të realizuar monitorimin e institucioneve një here në tre vite. Nëse konsiderojmë faktin që grupet e monitorimit nuk mund të jenë gjatë të gjithë vitit në udhëtim, sepse duhet edhe një kohë e nevojshme për të përpunuar informacionin si edhe analizuar atë. Për këtë arsye është e nevojshme që të mobilizohen të paktën 3 ekipe me nga dy specialistë, të paktën 6 specialistë, 3 nga SHSSH dhe 3 nga drejtoritë rajonale*".
Pra, edhe në dokumentin e hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, me asistencën teknike të UNDP-së (i pamiratuar), në monitorimet që SHSSH duhet të kryejë përfshihen sikurse cituar në Statutin e SHSSH-së **të gjithë ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror që financohen pjesërisht ose plotësisht nga buxheti i shtetit**. Përpos kësaj, dokumenti çmon si "*të drejtë dhe të logjikshme*" që SHSSH të monitorojë edhe ofruesit jopublikë të këtyre shërbimeve, për të garantuar zbatimin e standardeve përkatëse.

Për mungesën e planifikimit dhe kryerjes së monitorimeve në të gjithë ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror që financohen pjesërisht ose plotësisht nga buxheti i qeverisjes qendrore ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

Shërbimet e kujdesit shoqëror për të mitur
Sipas pikës 55 të VKM-së nr. 518, datë 04.09.2018, shërbimi në strehëza për fëmijë përfitohet nga fëmijët 0–18 vjeç që ndodhen pa kujdes prindëror ose në situata të rënda sociale, përfshirë rastet kur prindërit kanë ndërruar jetë, u është hequr e drejta prindërore, janë të ndaluar ose të dënuar me heqje lirie, kur fëmija është deklaruar i braktisur ose është sistemuar me vendim gjykate në institucion përkujdesjeje. Gjithashtu, shërbimi mund të ofrohet për fëmijë të familjeve që përballen me kriza të rënda sociale, probleme të përkohshme që pamundësojnë kujdesin prindëror, si dhe për fëmijë të pambikëqyrur apo të larguar nga prindi ose kujdestari deri në identifikimin dhe sistemimin e tyre të qëndrueshëm.

Aktualisht, në Republikën e Shqipërisë janë 9 institucione rezidenciale publike për fëmijë, kapaciteti dhe numri i rezidentëve sipas viteve për të cilët paraqitet, si më poshtë:

	Institucioni	Kapaciteti	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Nr. aktual
1	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç – Tiranë	40	29	34	31	28
2	Qendra shërbime mbështetëse për fëmijë dhe familjen QSHMFF – Korçë	20	3	3	0	0

[28] Mospërputhjet e shifrave në raport me shifrat e konstatuara nga Harta e Shërbimeve Sociale, vijnë pasi dokumenti është i vitit 2024, ndërkohë që të dhënat nga Harta e disponuar nga grupi i auditimit janë të përditësuara.

3	Qendra shërbime mbështetëse për fëmijë dhe familjen QSHMFF – Vlorë	20	2	0	0	0
4	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç – Durrës	20	20	21	16	17
5	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç – Shkodër	20	17	19	15	13
6	Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç – Shkodër	32	18	24	25	26
7	Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç – Zyber Hallulli	40	37	36	38	38
8	Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç – Sarandë	30	22	24	16	16
9	Shtëpia e Fëmijës 16-18 vjeç – Shkodër	20	16	11	13	12
Totali		**229**	**164**	**172**	**154**	**150**

Nga të dhënat e vëna në dispozicion, ka rezultuar se:

Për vitin 2023, janë pranuar 34 fëmijë, nga këto 14 fëmijë janë pranuar në qendrat rezidenciale publike dhe 7 fëmijë në qendra jopublike për fëmijë, me koordinim të PMF dhe SHSSH, të vlerësuara si rast emergjente nga GTN (Grupet Teknike Ndërsektoriale), ndërsa 13 fëmijë pranuar dhe 20 transferime me vendim komisioni nga SHSSH.

Për vitin 2024, janë pranuar 48 fëmijë, Nga këto 33 fëmijë janë pranuar në qendrat rezidenciale publike, dhe 4 fëmijë në qendra jopublike për fëmijë, me koordinim të PMF dhe SHSSH, të vlerësuara si rast emergjente nga GTN (Grupet Teknike Ndërsektoriale), ndërsa 11 fëmijë pranuar dhe 17 transferime me vendim komisioni nga SHSSH.

Për vitin 2025, janë pranuar 42 fëmijë në IPSH-të publike, nga këto 27 fëmijë (18 në IPSH publike dhe 8 në qendra jopublike) janë raste emergjente të referuar nga GTN (Grupet Teknike Ndërsektoriale), ndërsa 15 fëmijë pranime dhe 22 transferime me vendim komisioni nga SHSSH.

Procesi i deinstitucionalizimit

Procesi i deinstitucionalizimit të kujdesit për fëmijët është orientuar drejt zëvendësimit të institucioneve rezidenciale me shërbime komunitare dhe forma alternative kujdesi, me synim integrimin e fëmijëve në familje dhe komunitet, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. Për këtë qëllim, me VKM nr. 706, datë 09.09.2020, u miratua Plani Kombëtar i Deinstitucionalizimit 2020–2022, i cili parashikonte që deri në fund të vitit 2022 të gjithë fëmijët rezidentë në 9 institucionet publike të përkujdesjes shoqërore të deinstitucionalizoheshin. Zbatimi i planit u mbështet nga Komiteti Drejtues i ngritur me Urdhrin nr. 548, datë 01.10.2020, me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore dhe organizatave partnere. Një nga objektivat kryesore të planit ishte zhvillimi i shërbimeve të integruara për ndërhyrje të hershme dhe parandalimin e ndarjes së fëmijëve nga familja, duke parashikuar ndër të tjera vendosjen e moratoriumit për institucionalizimin e fëmijëve dhe pilotimin e transformimit të Shtëpive të Fëmijës në Korçë dhe Vlorë.

Lidhur me veprimtarinë e institucioneve MSHMS, SHSSH, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Korçë, Kontrolli i Lartë i Shtetit është angazhuar në realizimin e një auditimi të përputhshmërisë dhe vlerësues me fokus Planin Kombëtar për Deinstitucionalizimin e fëmijëve 2020 – 2022, ku është konkluduar se "*niveli aktual i implementimit të Planit të Deinstitucionalizimit nuk favorizon zbatimin në një shkallë më të gjerë të tij... Përgjithësisht është evidentuar mungesë koordinimi dhe ndërveprimi midis institucioneve të përfshira në zbatimin e tij, kjo edhe për shkak të mungesës së një vizioni të përbashkët dhe të përgjithshëm për rezultatet afatgjata të tij*"[29].

Pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga Plani Kombëtar i Deinstitucionalizimit 2020–2022, me Vendimin nr. 1, datë 31.01.2023, Komiteti Drejtues miratoi vijimin e planit të veprimit edhe për vitin 2023. Në kuadër të pilotimit në Bashkitë Korçë dhe Vlorë u hartua një plan transformimi për institucionet e përkujdesit shoqëror, i fokusuar në kalimin nga kujdesi

[29] Raport Përfundimtar "*Auditim përputhshmërie dhe vlerësues në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror, Bashkinë Vlorë, Bashkinë Korçë, me fokus Planin Kombëtar për Deinstitucionalizimin e Fëmijëve 2020-2022*", KLSH, 2022.

rezidencial drejt shërbimeve me bazë familjen dhe komunitetin. Paketa e shërbimeve të parashikuara përfshinte shërbime komunitare për mbështetjen e fëmijës dhe fuqizimin e familjes, strehimin e përkohshëm emergjent për fëmijët në rrezik dhe nënat me fëmijë, si dhe shërbime mbështetëse për kujdesin alternativ. Në dokument evidentohet se këto shërbime janë ngritur në ambiente të veçanta nga institucionet rezidenciale, përkatësisht në një godinë pranë Shtëpisë së Fëmijës në Korçë dhe në ambiente të marra me qira në Bashkinë Vlorë.
Nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të SHSSH-së, konkretisht në dokumentin "*Harta e Shërbimeve Sociale*", evidentohen të listuara shërbimet, përkatësisht:

Shërbimi	Emërtimi	Financimi	Publike/ private	Kapaciteti	Nr. i përfituesve	Adresa	Përshkrimi
BASHKIA VLORË							
Qendër rezidenciale	Shtëpi foshnjë 0-6 vjeç	Buxheti i shtetit	Publike	30	0	L. "7 pallatet"	Qendra ofron shërbime rezidenciale për fëmijë pa përkujdesje prindërore.
Qendër ditore/ komunitare	Shërbimet mbështetëse për familjen	Fondi social	Publike	40	53	L. "7 pallatet"	Qendra ofron shërbime ditore të përkujdesit komunitar për fëmijë dhe familjet e tyre. Shërbimet që ofrohen janë shërbime parashoqërore, komunitare, të specializuara për të siguruar interesin më të lartë të fëmijës.
BASHKIA KORÇË							
Qendër rezidenciale	Shtëpia e fëmijës 0-6 vjeç	Buxheti i shtetit	Publike	20	1	Shëtitorja "Fan S. Noli"	Qendër rezidenciale për fëmijët 0-6 vjeç, të cilët janë me aftësi të kufizuar, ku prindërit e kanë te pamundur të kujdesen për ta.
Qendër komunitare	Shërbime mbështetëse për fëmijën dhe familjen	Fondi social	Publike	150	20	Shëtitorja "Fan S. Noli"	Qendër ditore për fëmijët qe vijnë nga familjet në nevoje, zhvillohen aktivitete të ndryshme, argëtuese dhe sociale. Qendër ku ofrohet këshillim psikologjik dhe mbështetje për familjet e fëmijëve bazuar në nevojat e evidentuara.

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale, SHSSH

Sipas "Planit të transformimit për institucionet e përkujdesit shoqëror në Shqipëri", transformimi i institucioneve rezidenciale në Korçë dhe Vlorë nuk synonte vetëm ndryshimin e tipologjisë së shërbimeve, por edhe riorganizimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale. Dokumenti parashikonte integrimin e përkohshëm të shërbimeve të mbështetjes për fëmijën dhe familjen me strukturat ekzistuese të institucioneve rezidenciale, ngritjen e shërbimeve të reja emergjente, si dhe vlerësimin e kapaciteteve, kompetencave dhe gatishmërisë së personelit ekzistues për t'u përshtatur me modelin e ri të ofrimit të shërbimeve. Në këtë kuadër, ishte planifikuar zhvillimi i programeve të trajnimit, hartimi i planeve individuale të zhvillimit profesional dhe përcaktimi i strukturave të reja organizative, me synim garantimin e një tranzicioni të qëndrueshëm nga kujdesi rezidencial drejt shërbimeve me bazë komunitetin dhe familjen.

Në Strukturën dhe organikën e Shërbimit Social Shtetëror, miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 168, datë 29.09.2025, në pikat 41–44 rezulton se emërtimi i institucioneve "Shtëpia e Fëmijës" në Korçë dhe Vlorë është ndryshuar në "Qendra e Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes" (SHMFF). Megjithatë, ndryshimi i reflektuar në strukturë ka prekur vetëm emërtimin e njësive, ndërsa numri i vendeve të punës ka mbetur i pandryshuar, ku SHMFF Korçë vijon të ketë 14 punonjës dhe SHMFF Vlorë 20 punonjës të miratuar në strukturë.
Këto dy institucione janë përzgjedhur si qendra pilot për zbatimin e procesit të deinstitucionalizimit që prej vitit 2020. Në kuadër të këtij procesi është aplikuar moratoriumi

për pranimin e rasteve të reja në shërbimin rezidencial, ndërsa gjatë kryerjes së auditimit Shtëpia e Fëmijës Vlorë nuk kishte më asnjë fëmijë rezident që prej vitit 2024 dhe Shtëpia e Fëmijës Korçë nuk kishte më asnjë fëmijë rezident që prej muajit mars 2025. Nga ana tjetër, në dokumentin "Plani Kombëtar për Transformimin e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijët drejt shërbimeve alternative për fëmijën dhe familjen", miratuar me Vendimin nr. 02, datë 15.09.2025 të Komitetit Drejtues për Zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitucionalizimit, citohet se "*deri tani janë finalizuar me sukses dy transformime të qendrave rezidenciale për fëmijë 0–5 vjeç në Korçë dhe Vlorë, të cilat janë shndërruar në shërbime që mbështesin drejtpërdrejt fëmijët dhe familjet*".
Grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë dokumentacion administrativ apo rregullator, si rregullore të brendshme, përshkrime pune, organigrama funksionale, akte për riorganizimin e detyrave apo dokumente të tjera që të përcaktojnë funksionet, rolet, përgjegjësitë dhe mënyrën e organizimit të këtyre institucioneve pas transformimit. Po kështu, nuk u administrua dokumentacion që të evidentojë zbatimin e elementeve të parashikuara në Planin e Transformimit të vitit 2023 lidhur me vlerësimin e kapaciteteve të personelit, pozicionimin e punonjësve sipas modelit të ri të shërbimeve, zhvillimin e planeve individuale të punës apo përcaktimin e strukturës së re organizative.
Në këto kushte, ndërkohë që transformimi i dy institucioneve konsiderohet "i finalizuar me sukses" në dokumentet strategjike, auditimi konstatoi se ndryshimi i materializuar dokumentarisht lidhet kryesisht me mbylljen e funksionit rezidencial dhe ndryshimin e emërtimit të institucioneve, ndërsa nuk rezulton i dokumentuar dhe i formalizuar transformimi i plotë organizativ dhe funksional i tyre në përputhje me modelin e ri të shërbimeve të mbështetjes për fëmijën dhe familjen.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se:
- Rregullorja e brendshme për Shtëpinë e Foshnjës "Lulet e Vogla" Korçë është miratuar nga vetë Drejtuesi i IPSH-së me nr. 2, datë 05.01.2015, pra as nga Kryetari i Bashkisë Korçë dhe as nga SHSSH.
- Rregullorja e brendshme për Shtëpinë e Foshnjës 0-5 vjeç Vlorë mban nr. 119 prot., datë 05.06.2019, por nuk rezulton të jetë miratuar as nga Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe as nga SHSSH.

Nëpërmjet shkresave (i) nr. 2879 prot., datë 02.04.2025, drejtuar Bashkisë Korçë dhe (ii) nr. 2497 prot., datë 02.04.2025, drejtuar Bashkisë Vlorë, me lëndë "*Bashkëpunim për vijimësinë e procesit të deinstitucionalizimit*", Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së citon se "*...janë duke u dizenjuar shërbimet e reja nga shërbime rezidenciale në shërbime multifunksionale për mbështetjen e fëmijës dhe familjes... Për sa më sipër, stafi i institucionit është njohur mbi procesin e deinstitucionalizimit dhe shërbimet e reja multifunksionale dhe në këto kushte do të ishte rezultative që stafi të bashkëpunojë me aktivitetin e SHMFF në aktivitetin që ato kryejnë*".

Nëpërmjet Vendimit nr. 02, datë 26.09.2025, të Komitetit Drejtues të Planit Kombëtar të Deinstitucionalizimit është miratuar "Plani Kombëtar për Transformimin e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijët drejt Shërbimeve Alternative për Fëmijën dhe Familjen 2025–2026". Në këtë dokument përcaktohet se *IPSH-të e Durrësit dhe Shkodrës janë vendosur nën moratorium për grupmoshën 0–2 vjeç dhe synohet që procesi i transformimit të tyre të përfundojë brenda muajit qershor 2026, ndërsa për IPSH-të e tjera të grupmoshave 6–15 vjeç dhe 16–18 vjeç transformimi parashikohet të finalizohet deri në fund të vitit 2026*. Ndër të tjera, dokumenti përfshin edhe vlerësimin e stafit ekzistues, ku parashikohet kryerja e një analize të detajuar të kapaciteteve aktuale në IPSH, me qëllim identifikimin e mundësive për

rikualifikimin dhe përshtatjen e personelit në shërbimet mbështetëse për fëmijët dhe familjet (Child & Family Hubs), të cilat do të ngrihen paralelisht me procesin e transformimit[30].
Në Progres Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2024 vlerësohet se "*ekziston një plan kombëtar për deinstitucionalizimin, si dhe programi përkatës i reformës ekonomike, por zbatimi i tyre nuk ka qenë efektiv*"[31], ndërsa për vitin 2025 vlerësohet se "*është në fuqi një plan kombëtar i deinstitucionalizimit dhe aktualisht po përditësohet, paralelisht me hartimin e ligjit të ri për kujdesin alternativ, si dhe me ndërmarrjen e masave për forcimin e ofrimit të shërbimeve për fëmijët që kanë nevojë për kujdes familjar*", duke rekomanduar se "*Shqipëria duhet në veçanti... të përfundojë procesin e deinstitucionalizimit të fëmijëve*"[32].

Pavarësisht ekzistencës së një kuadri strategjik dhe planeve të miratuara për deinstitucionalizimin, mbetet thelbësore që bashkëpunimi ndërinstitucional të sigurojë zbatimin efektiv të politikave dhe objektivave të përcaktuara. Aplikimi i moratoriumeve për pranimin e rasteve të reja apo ndryshimi formal i emërtimit të institucioneve, në mungesë të ndërhyrjeve organizative dhe funksionale, nuk garanton transformimin real të tyre. Për këtë arsye, është e nevojshme që paralelisht me procesin e transformimit të hartohen dhe miratohen aktet e brendshme përkatëse, duke përcaktuar qartë funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e organizimit të shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen, si dhe të realizohet vlerësimi dhe ripërcaktimi funksional i personelit në përputhje me modelin e ri të shërbimit.
Në të kundërt, përveç kufizimit të aksesit në shërbimet e parashikuara për kategoritë përfituese, ekziston rreziku i përsëritjes së situatës së konstatuar në ish-Shtëpitë e Fëmijës 0–5 vjeç në Vlorë dhe Korçë, ku aplikimi i moratoriumit për pranimin e fëmijëve që prej vitit 2020 nuk është shoqëruar me rishikimin në kohë të modelit të funksionimit dhe formalizimin e rolit të strukturave të reja të synuara (SHMFF) dhe, si pasojë, deri në përfundim të periudhës së auditimit, punonjësit vijojnë të jenë pjesë e strukturës dhe të trajtohen me pagë nga buxheti i shtetit, ndërkohë që funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në kuadër të modelit të ri të shërbimit nuk rezultojnë të jenë përcaktuar dhe formalizuar nëpërmjet dokumentacionit përkatës, duke mos ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror të përcaktuar.

Shërbimet e kujdesit shoqëror për të moshuarit
Aktualisht, në Republikën e Shqipërisë janë 6 institucione rezidenciale për të moshuar, nga të cilat 2 janë në varësi të plotë të SHSSH-së (Shtëpia e të moshuarve Shkodër dhe Tiranë) dhe 4 janë në bashkëvarësi të NJVV-ve dhe SHSSH-së. Kapaciteti dhe numri i rezidentëve sipas viteve paraqitet, si më poshtë:

Shtëpia e të moshuarve	Kapaciteti	Nr. i të moshuarve 31.12.2020	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2023	31.12.2024	31.12.2025
Tiranë	50	38	42	45	47	49	48
Shkodër	55	60	63	57	60	64	63
Fier	65	43	45	52	52	51	54
Kavajë	62	52	51	48	56	59	62
Poliçan	40	36	33	33	40	38	38
Gjirokastër	60	51	50	58	59	59	60
Total	**332**	**280**	**284**	**293**	**314**	**320**	**325**

Kërkesat për sistemim në IPSH komisionohen në SHSSH për Shtëpitë e të Moshuarve në varësi të SHSSH-së, ndërsa për Shtëpitë e të Moshuarve në bashkëvarësi komisionimi kryhet edhe nga SHSSH-ja edhe nga NJVV-ja përkatëse, sipas rastit. Të dhënat lidhur me kërkesat për

[30] Plani Kombëtar për Transformimin e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijët drejt shërbimeve alternative për fëmijën dhe familjen, 2025, fq. 6.
[31] Progres Raporti për Shqipërinë, Komisioni Evropian, 2024, fq. 40.
[32] Progres Raporti për Shqipërinë, Komisioni Evropian, 2025, fq. 6, 7, 40.

sistemim në SHSSH dhe numrin e të moshuarve të pranuar nga komisioni ndër vite paraqitet, si më poshtë:

Viti	Nr. i kërkesave për sistemim në IPSH	Nr. i të moshuarve të pranuar nga Komisioni
2020	64	35
2021	63	56
2022	89	73
2023	106	89
2024	111	72
2025	105	93
Total	**538**	**418**

Për sa më sipër, rezulton se kërkesat për sistemim kanë ardhur në rritje ndër vite, ndërkohë që numri i IPSH-ve dhe kapaciteti aktual për sistemim nuk ka ndryshuar. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga SHSSH-ja, rezulton se aktualisht janë në listë pritje për t'u sistemuar 30 të moshuar, të cilët janë pranuar nga SHSSH-ja.

Nëpërmjet shkresës nr. 3931 prot., datë 06.04.2023, drejtuar MSHMS-së, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së ka propozuar ngritjen e një shërbimi të ri "*Qendër polivalentente (PAK mbi 21 vjeç dhe të moshuar me probleme të shëndetit mendor)*", duke cituar, sa i përket të moshuarve, se "*në të gjitha institucionet rezidenciale ekzistuese për të moshuar janë sistemuar dhe marrin trajtim të moshuar, të cilët kanë probleme të rënduara shëndetësore, fizike dhe mendore, që kanë nevojë përkujdesje të veçantë.* ***Në këto kushte, këto institucione ofrojnë shërbime të diferencuara, të cilat sjellin përplasje shërbimesh dhe vështirësi në përshtatjen e jetës midis të moshuarve me diagnoza dhe nevoja të ndryshme. Trajtimi i të moshuarve me problem të shëndetit fizik dhe mendor sjell vështirësi gjithashtu edhe për stafin dhe ofrimin e shërbimeve***". Aktualisht, në institucionet rezidenciale për të moshuar janë rezidentë të moshuar me probleme të shëndetit mendor, si më poshtë:

Shtëpia e të moshuarve	Numri i rezidentëve	Numri i të moshuarve me probleme të shëndetit mendor
Tiranë	48	8
Shkodër	63	10
Fier	54	9
Kavajë	62	7
Poliçan	38	13
Gjirokastër	60	11
Total	**325**	**58**

Lidhur me kriteret për shërbimin në strehëza të të moshuarve:

a. Sa i përket nenit 58, pikat a dhe b, përcaktohet se shërbimi në strehëza ofrohet nëse (i) përfituesit kanë mbushur moshën për pension dhe (ii) të moshuarit përfitojnë pension social ose pension minimal. Sipas këtij përcaktimi, duke mbajtur në vëmendje se pensioni social akordohet pas moshës 70 vjeç, sipas përcaktimit në nenin 5/1 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*", përjashtohen nga mundësia e përfitimit të shërbimit në strehëza të moshuarit që kanë mbushur moshën për pension, por nuk plotësojnë kushtet për të përfituar pension nga sigurimet shoqërore dhe nuk kanë mbushur moshën 70 vjeç për të përfituar pensionin social, pavarësisht se mund të jenë në kushte të tilla që duhet të institucionalizohen në institucione të tilla rezidenciale për shkak të kushteve të jetesës. Këto kritere janë përjashtuese edhe për të moshuarit të cilët përfitojnë pension mbi kufirin e pensionit social e minimal, por të ardhurat sërish janë të pamjaftueshme për të përballuar jetesën dhe janë në kushte të vështira socio-ekonomike.

b. Sa i përket nenit 58, pika c, përcaktohet se shërbimi në strehëza ofrohet nëse subjektet nuk zotërojnë banesë apo llogari bankare. Pra, disponimi i një llogarie bankare përbën shkak për mospërfitimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në strehëza. Ligji nr. 100/2023 "*Për*

llogarinë e pagesave me shërbime bazike" synon të garantojë të drejtën për aksesin në llogari pagese me shërbime bazike për konsumatorët, **si një mjet i domosdoshëm për të mundësuar pjesëmarrjen e konsumatorëve në tregun financiar**. Sipas përcaktimit në nenin 8, pika 7, të këtij Ligji, ndër kategoritë e personave të cilët përfitojnë ofrimin e shërbimeve me tarifë zero nga bankat e nivelit të dytë, përfshihen *konsumatorët të cilët përfitojnë nga programet dhe politikat për skemat e ndihmës ekonomike dhe sociale*, sipas legjislacionit në RSH, ku përfshihen përfituesit e pagesës NE & PAK, pensionit të pleqërisë, etj. Pra, pavarësisht se ligjvënësi e konsideron disponimin e një llogarie si mjet të domosdoshëm për të mundësuar pjesëmarrjen e konsumatorëve në treg financiar, ku në llogaritë e pagesave me shërbime bazike përfshihen shërbimet si depozitim fondesh apo tërheqje fondesh në sportele dhe ATM, etj., si dhe ka parashikuar lehtësira si zerimi i tarifës për këtë kategori konsumatorësh, disponimi i këtij mjeti është kriter përjashtues sa i përket VKM-së nr. 518/2018, duke përjashtuar të moshuarit që kanë llogari bankare (pa asnjë përcaktim mbi gjendjen apo llojin e llogarisë) nga e drejta për të përfituar shërbim në strehëza.
Grupi i auditimit vlerëson se këto kritere nuk përcaktojnë gjendjen social-ekonomike të personave dhe rrjedhimisht pamundësojnë përfitimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, pavarësisht nëse këta individë (i) nuk kanë mjetet minimale të jetesës, (ii) nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe (iii) janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale, sipas përcaktimeve në nenin 5, pika 1, të Ligjit nr. 121/2016 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

Indeksimi i kuotave të shpenzimeve për rezidentët në IPSH
Sipas përcaktimit në Kreut V, pika 71, të VKM-së nr. 518/2018, nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare indeksohen çdo vit sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi "*Ushqime dhe pije joalkoolike*". Nga auditimi u konstatua se fillimisht kuotat e shpenzimeve për ushqime janë miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 02.10.2018. Nëpërmjet Udhëzimit të MSHMS-së nr. 662, datë 06.12.2022, është ndryshuar Udhëzimi nr. 689/2018, duke ngarkuar SHSSH për zbatimin e pikës 71 të VKM-së 518/2018 si dhe të planifikojë efektet financiare në zbatim të tij. Nëpërmjet Urdhrit të Zëvendësministrave të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 465/1 prot., datë 25.10.2022 është miratuar norma ushqimore për fëmijët 0-18 vjeç që trajtohen në institucionet rezidenciale. Kuotat ushqimore janë indeksuar që nga viti 2023, si më poshtë:

		2018	2023	2024	2025
Nr.	Emërtimi	VKM nr. 518/2018 Udhëzim nr. 589/2018 Udhëzim nr. 662/2022	Nr. 5566/2023 Nr. 5336/2023	Nr. 290/2024 Nr. 278/2024	Nr. 293/2025
		ISHTE	BEHET	BEHET	BEHET
1	Të moshuarit	360	430	430	440
2	Fëmijët 0-3 vjeç	360	400	400	400
3	Fëmijët 4-5 vjeç	400	400	400	400
4	Fëmijët 6-12 vjeç	440	490	490	500
5	Fëmijët 13-15 vjeç	480	600	600	610
6	Fëmijët 16-18 vjeç	500	600	600	600
7	Përfituesit mbi 18 vjeç	520	610	610	620
8	Qendra Zhvillimit 7-11 vjeç	400	510	510	510
9	Qendra Zhvillimit mbi 11 vjeç	500	610	610	620
10	Polivalente Ditore	230	310	310	310
11	Zhvillimi Ditor	320	350	350	350
12	Fëmijëve Ditor	320	350	350	350

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Shërbimet e kujdesit shoqëror në qendrat e zhvillimit

Në nenin 16, pika 1, të Ligjit nr. 121/2016 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, përcaktohet se shërbimet në qendrat e zhvillimit janë shërbime komunitare që synojnë sigurimin dhe përmirësimin e statusit dhe cilësisë së jetës së individëve me aftësi të kufizuara *deri në 21 vjeç*. Llojet e shërbimeve që ofrohen në këto qendra përfshijnë terapinë intensive psiko-sociale për aftësimin dhe përmirësimin e parametrave psikologjikë dhe të motorikës fine e globale, shërbimin psikomotor për aftësimin dhe përmirësimin e parametrave psikologjikë dhe të motorikës fine e globale, aftësimin e parametrave fizike, shërbimet e specializuara ortofonie për aftësimin e individëve me çrregullime të spektrit autik apo aftësisë për të komunikuar, terapi riaftësimi për punë dhe terapi zhvillimi. Aktualisht, në Republikën e Shqipërisë funksionojnë 6 Qendra Zhvillimi publike, përkatësisht Qendra e Zhvillimit Durrës, Berat, Korçë, Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga SHSSH-ja statusi aktual i tyre rezulton si më poshtë:

Nr.	Qendra e Zhvillimit	Kapa-citeti	Nr. aktual	3-14 vjeç	14-18 vjeç	18-21 vjeç	22-30 vjeç	31-40 vjeç	41-50 vjeç	Mbi 50 vjeç	Totali mbi 21 vjeç
1	**Durrës**	45	42	16	5	7	12	3	0	0	**15**
2	**Berat**	30	30	0	4	0	9	9	9	0	**26**
3	**Korçë**	38	42	0	0	1	1	10	12	18	**41**
4	**Tiranë**	30	31	5	7	11	6	2	0	0	**8**
5	**Shkodër**	45	43	1	1	3	2	15	15	6	**38**
6	**Vlorë**	30	29	2	2	12	12	12	0	0	**24**
TOTALI		**218**	**217**	**24**	**22**	**25**	**42**	**51**	**35**	**24**	**152**

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Për sa më sipër, rezulton se 152 nga 218 rezidentë në Qendrat e Zhvillimit (rreth 70%) aktualisht janë mbi moshën e përcaktuar ligjore, duke denatyruar objektin dhe qëllimin e këtyre qendrave. P.sh.:

- në QZH Korçë aktualisht janë 4 rezidentë mbi kapacitet, ku 41 nga 42 rezidentë (rreth 98%) janë mbi 21 vjeç;
- në QZH Shkodër 38 nga 43 rezidentë (rreth 88%) janë mbi 21 vjeç;
- në QZH Vlorë 24 nga 29 rezidentë (rreth 83%) janë mbi 21 vjeç;
- në QZH Berat 26 nga 30 rezidentë (rreth 87%) janë mbi 21 vjeç;
- në QZH Tiranë aktualisht është 1 rezident mbi kapacitet, ku 8 nga 31 rezidentë (rreth 26%) janë mbi 21 vjeç;
- në QZH Durrës 15 nga 42 rezidentë (rreth 36%) janë mbi 21 vjeç.

Në përfundim, situata aktuale në Qendrat e Zhvillimit evidenton devijim nga qëllimi ligjor i tyre, jo vetëm për shkak të pranisë dominuese të rezidentëve mbi moshën e përcaktuar, por edhe për pasojë të drejtpërdrejtë në funksionalitetin e këtyre strukturave. Mbajtja e kapaciteteve të zëna nga individë mbi 21 vjeç kufizon ndjeshëm, dhe në disa raste pamundëson, pranimin e fëmijëve/ të rinjve që janë objekt i drejtpërdrejtë i këtyre shërbimeve dhe që kanë nevojë për ndërhyrje të hershme zhvillimore. Kjo situatë rrezikon të krijojë lista pritjeje, të vonojë trajtimet kritike në fazat më të rëndësishme të zhvillimit dhe të ulë efektivitetin e sistemit të kujdesit shoqëror në tërësi, duke kompromentuar si parimin e targetimit të drejtë ashtu edhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Lidhur me këtë situatë, si dhe me faktin se një pjesë e rezidentëve në IPSH për të moshuar paraqesin probleme të rënduara të shëndetit mendor dhe kanë nevojë për trajtim të diferencuar, Shërbimi Social Shtetëror ka propozuar krijimin e një Qendre Polivalente për personat me aftësi të kufizuar mbi moshën 21 vjeç, por deri në përfundim të periudhës së auditimit, asnjë masë nuk është marrë për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar mbi moshën 21 vjeç.

Lidhur me sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë Shërbimit Social Shtetëror ka paraqitur observacionet, si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: 1. Është ngritur një grup pune me urdhrin nr. 165/2025 për rishikimin e kuadrit ligjor të shërbimeve sociale, në kuadër të të cilit po shqyrtohen edhe kriteret e pranimit të përfituesve në shërbimet rezidenciale për të moshuarit. Gjithashtu, me Urdhrin nr. 138/2025 është ngritur një grup pune për vlerësimin e kritereve të pranimit të të moshuarve në qendra rezidenciale, proces i cili ka përfunduar dhe ka prodhuar rekomandime konkrete, pra janë ndërmarrë masa për adresimin e këtyre çështjeve.
2. SHSSH vlerëson rëndësinë e rekomandimit dhe shpreh angazhimin për mbështetjen e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale, por argumenton se zbatimi i tij kushtëzohet nga ndërhyrje në nivel të kuadrit ligjor dhe rregullativ. Përcaktimi i metodologjisë së transferimit dhe rishikimi i kuadrit rregullativ janë kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Në këtë kuadër, ministria ka ngritur një grup pune për rishikimin e kuadrit rregullativ të kujdesit shoqëror dhe ka hartuar draftin e parë të projektligjit të ri për shërbimet sociale, i cili parashikon rishikimin e dispozitave që lidhen me decentralizimin e shërbimeve sociale publike rezidenciale dhe metodologjinë e transferimit të tyre tek njësitë e vetëqeverisjes vendore. Procesi përballet me sfida praktike që lidhen me mekanizmat e financimit dhe garantimin e burimeve të qëndrueshme financiare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
Qëndrimi i grupit të auditimit: 1. Deri në përfundim të periudhës së auditimit më 31.12.2025 dhe në paraqitjen e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit, nuk rezulton të jetë ndërmarrë asnjë ndryshim në kuadrin rregullativ që përcakton kriteret e pranimit të të moshuarve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror. Ngritja e grupeve të punës, kryerja e analizave apo formulimi i rekomandimeve të brendshme nuk përbëjnë masa të mjaftueshme për adresimin e problematikës së konstatuar për sa kohë ato nuk janë materializuar në propozime konkrete për ndryshime rregullative dhe nuk kanë prodhuar efekt në kuadrin normativ në fuqi. Pikërisht për këtë arsye, rekomandimi i është adresuar jo vetëm Shërbimit Social Shtetëror, por edhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Rekomandimi synon ndërmarrjen e masave konkrete për rishikimin e nenit 58 të VKM-së nr. 518, datë 04.09.2018, me qëllim eliminimin e kritereve që nuk lidhen me gjendjen reale social-ekonomike të të moshuarve dhe që krijojnë kufizime të pajustifikuara në aksesin e tyre ndaj shërbimeve rezidenciale të kujdesit shoqëror. *Për sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë*.
2. Procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale dhe transformimit të institucioneve rezidenciale është parashikuar në dokumente strategjike dhe politika publike prej disa vitesh dhe, që nga viti 2020, janë ndërmarrë hapa konkretë në këtë drejtim, si aplikimi i moratoriumeve (pra duke mos pranuar më asnjë fëmijë të ri). Megjithatë, deri në përfundim të periudhës së auditimit, procesi nuk rezulton i përmbyllur dhe vijon të shoqërohet me vonesa të konsiderueshme. Këto vonesa kanë sjellë pasoja të drejtpërdrejta si në ofrimin e shërbimeve sociale për grupet e synuara, ashtu edhe në përdorimin efektiv të burimeve publike. Konkretisht, në (ish-) Shtëpitë e Foshnjës Korçë dhe Vlorë, pavarësisht aplikimit të moratoriumit për pranimin e fëmijëve që prej vitit 2020 dhe mungesës së plotë të fëmijëve përfitues të shërbimit (që nga viti 2024 për Vlorën dhe që nga muaji mars 2025 për Korçën), institucionet vijojnë të funksionojnë dhe të mbajnë në organikë personel të paguar nga buxheti i shtetit, ndërkohë që nuk ofrojnë shërbimin për të cilin janë krijuar, madje me ndryshimin e emërtimit të institucionit në vitin 2025, nuk kanë të përcaktuar në asnjë dokument (rregullore e brendshme, përshkrim pune) as çfarë shërbimi duhet të japin. Situata të ngjashme rrezikojnë të ndodhin edhe në institucione të tjera ku janë vendosur moratoriume për pranimin e fëmijëve, si Shtëpitë e Foshnjës Durrës dhe Shkodër, në kushtet kur ende nuk janë përfunduar aktet e nevojshme rregullative dhe organizative që do të përcaktojnë mënyrën e funksionimit, objektivat dhe shërbimet që do të ofrohen pas transformimit të tyre. *Për sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë*, pasi problematikat e evidentuara dhe vonesat në përmbylljen e procesit të decentralizimit përbëjnë pikërisht arsyen mbi të cilën është bazuar rekomandimi i grupit të auditimit.

2.6. Prokurimet e fondeve publike

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit nr. 17/1 prot., datë 13.01.2026, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Regjistri i parashikimeve/realizimeve të periudhës 01/01/2020-31/12/2025;
- Dokumentacion i ngarkuar në SPE;
- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim të vënë në dispozicion nga SHSSH;
- Urdhra/Vendime të Titullarit të AK;
- Dokumentacioni shoqërues i marrjes në dorëzim.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në Ligjin Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, Udhëzimet, etj.), si dhe Rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik.

I. Për regjistrat e prokurimit

Për vitin 2020 janë parashikuar 27 procedura prokurimi, prej të cilave 13 procedura janë të tipit "Blerje nën 100.000 lekë", 10 procedura janë "Blerje të Vogla", 2 procedura "negocim pa shpallje" dhe 2 procedura janë Blerje të Mëdha ku fondi i parashikuar në total për to ka qenë në vlerën 12,378,641.88 lekë pa TVSH. Nga këto procedura janë realizuar 26 procedura prokurimi me fond limit 10,154,981.58 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 6.016.524,97 lekë pa TVSH, ose 59% e fondit të prokuruar. Procedura e parealizuar është "Shërbim me roje civile për Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH" me vlerë 1,847,777.30 lekë pa TVSH, e tipit "*Kërkesë për propozim*". Grupi i auditimit ka shqyrtuar 3 procedura prokurimi të kategorisë "Blerje të Vogla" , në vlerë të kontraktuar prej 1,826,500 lekë pa TVSH dhe 2 procedura "negocim pa shpallje" (shërbim roje), në vlerë të kontraktuar prej 1,044,555 lekë pa TVSH, në total 2,871,055 lekë pa TVSH, ose rreth 50% të vlerës totale të kontraktuar nga SHSSH-ja për vitin 2020.

Për vitin 2021 janë parashikuar 17 procedura prokurimi, prej të cilave 10 procedura janë të tipit "Blerje nën 100.000 lekë", 6 procedura janë "Blerje të Vogla" dhe 1 procedura është "E hapur e Thjeshtuar" ku fondi i parashikuar në total për to ka qenë në vlerën 5.509.333,33 lekë pa TVSH. Nga këto procedura janë realizuar 11 procedura prokurimi me fond limit 5,166,000 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 4,117,597 lekë pa TVSH, ose 79% e fondit të prokuruar. Prej 6 procedurave të parealizuara, 5 prej tyre janë të tipit "Blerje nën 100.000 lekë" dhe 1 prej tyre e tipit "Blerje e Vogël". Grupi i auditimit ka shqyrtuar 1 procedurë prokurimi "të hapur të thjeshtuar" dhe 3 procedura prokurimi të kategorisë "Blerje të Vogla", me vlerë totale të kontraktuar prej 2,967,020 lekë pa TVSH, ose 72% të vlerës totale të kontraktuar nga SHSSH-ja.

Për vitin 2022 janë parashikuar 13 procedura prokurimi, prej të cilave 8 procedura janë të tipit "Blerje nën 100.000 lekë", 5 procedura janë "Blerje të Vogla" ku fondi i parashikuar në total për to ka qenë në vlerën 2,915,000 lekë pa TVSH. Nga këto procedura janë realizuar 10 procedura prokurimi me fond limit 2,615,000 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 1,855,661 lekë pa TVSH, ose 71% e fondit të prokuruar. Procedurat e parealizuara janë të tipit "Blerje nën 100.000 lekë". Grupi i auditimit ka shqyrtuar 2 procedura prokurimi të kategorisë "Blerje të Vogla", në vlerë totale të kontraktuar prej 915,700 lekë pa TVSH, që përbëjnë 50% të vlerës totale të kontraktuar nga SHSSH-ja gjatë vitit 2022.

Për vitin 2023 janë parashikuar 18 procedura prokurimi, prej të cilave 9 procedura janë të tipit "Blerje nën 100.000 lekë", 7 procedura janë "Blerje të Vogla" 2 procedura janë "E hapur e thjeshtuar" ku fondi i parashikuar në total për to ka qenë në vlerën 12,794,533 lekë pa TVSH. Nga këto procedura janë realizuar 16 procedura prokurimi me fond limit 6,044,533 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 4,681,753 lekë pa TVSH, ose 77% e fondit të prokuruar. Një prej procedurave të parealizuara është e tipit "E hapur e Thjeshtuar" me objekt prokurimi "Projekt preventive zbatimi për godinën nr.1 dhe nr.3 njësia administrative Golem, Kavajë" me vlerë 6,250,000 lekë pa TVSH, dy procedurat e tjera janë të tipit "Blerje të Vogla". Grupi i auditimit ka shqyrtuar 1 procedurë prokurimi "të hapur të thjeshtuar" dhe 4 procedura prokurimi të kategorisë "Blerje të Vogla", në vlerë totale të kontraktuar prej 3,278,262 lekë pa TVSH, ose 70% të vlerës totale të kontraktuar nga SHSSH-ja përgjatë vitit 2023.

Për vitin 2024 janë parashikuar 17 procedura prokurimi, prej të cilave 10 procedura janë të tipit "Blerje nën 100.000 lekë", 7 procedura janë "Blerje të Vogla" ku fondi i parashikuar në total për to ka qenë në vlerën 4,605,000 lekë pa TVSH. Nga këto procedura janë realizuar 17 procedura prokurimi me fond limit 4,605,000 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 3,028,949 lekë pa TVSH, ose 65% e fondit të prokuruar. Nuk ka procedura të parealizuara. Grupi i auditimit ka shqyrtuar 2 procedura prokurimi të kategorisë "Blerje të Vogla", me vlerë

totale të kontraktuar prej 1,486,200 lekë pa TVSH, ose rreth 50% të vlerës totale të kontraktuar nga SHSSH-ja përgjatë vitit 2024.
Për vitin 2025 janë parashikuar 17 procedura prokurimi, prej të cilave 13 procedura janë të tipit "Blerje nën 100.000 lekë", 4 procedura janë "Blerje të Vogla" ku fondi i parashikuar në total për to ka qenë në vlerën 3,385,000 lekë pa TVSH. Nga këto procedura janë realizuar 17 procedura prokurimi me fond limit 3,234,706,81 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 2,726,387 lekë pa TVSH, ose 71% e fondit të prokuruar. Gjithashtu, SHSSH-ja ka zbatuar edhe kontratën me objekt "*Blerje për pajisje të ndryshme për institucionet në varësi të SHSSH*", në vlerë 3,240,000 lekë pa TVSH, ku procedura e prokurimit është zhvilluar nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Nga procedurat e parashikuara fillimisht, 5 procedura të tipit "Blerje nën 100.000 lekë" nuk janë realizuar sipas planifikimit fillestar. Në vend të tyre janë zhvilluar 5 procedura të tjera, konkretisht: 3 procedura "Blerje nën 100.000 lekë", 1 procedurë përmes Sistemit Dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror dhe 1 procedurë "Blerje e Vogël". Në total, numri i procedurave të realizuara mbetet 17, por me ndryshim në përbërjen e tyre krahasuar me planifikimin fillestar. Grupi i auditimit ka shqyrtuar 1 zbatim kontrate (procedurë e zhvilluar nga OBP) dhe 2 procedura prokurimi të kategorisë "Blerje të Vogla", me vlerë totale të kontraktuar prej 4,196,300 lekë pa TVSH, ose 70% të vlerës totale të kontraktuar nga SHSSH-ja përgjatë vitit 2025 prej 5,966,387 lekë pa TVSH.
Procedurat e shtuara në vitin 2025, të cilat nuk ndodhen në regjistrin e parashikimit, nuk janë shoqëruar me dokumentacionin përkatës që justifikon kryerjen e tyre, Kjo bie në kundërshtim me VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave Të Prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 2, pika 1.
Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik në SHSSH u konstatua në mënyrë të vazhdueshme se dosjet e procedurave të prokurimit janë të painventarizuara dhe të paarkivuara, në kundërshtim me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, duke përbërë risk për dëmtimin apo humbjen e dokumentacionit me ndërrimin e stafit të angazhuar në procedurat e prokurimit publik.

II. Blerjet e Vogla
Viti 2020
1.Objekti i Prokurimit: Mobilim i zyrave të KMCAP Rajonal
Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Mobilimi i zyrave të KMCAP Rajonal"**.** Procedura është iniciuar mbi bazën e kërkesës nr. 820 prot., datë 29.06.2020, me objekt *"Kërkesë për fillimin e procedurave të prokurimit për mobilimin e zyrave të KMCAP Rajonal"*, drejtuar Titullarit të SHSSH-së. Në vijim të kësaj kërkese, me datë 24.08.2020 është nxjerrë Urdhri i Prokurimit nr. 1086 prot., për kryerjen e procedurës së prokurimit me fonde të akorduara nga buxheti i shtetit. Fondi i parashikuar për realizimin e këtij objekti është në vlerën 777,643 lekë pa TVSH, i përcaktuar mbi bazën e testimit të tregut.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se procesverbali i testimit të tregut nuk mban datë. Gjithashtu, ndonëse në përmbajtje të tij citohet se fondi limit është përllogaritur mbi bazën e mesatares së tre ofertave të marra nga operatorë ekonomikë, këto oferta nuk rezultojnë të jenë bashkëlidhur procesverbalit përkatës. *Mungesa e dokumentimit të plotë të përcaktimit të fondit limit të procedurë*s bie në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2 dhe me VKM nr.285 datë 19.05.2021 "*Për Miratimin e Rregullave Të Prokurimit Publik*" i ndryshuar Neni 13, pika 4.
Në vijim të procedurës, është kryer publikimi i saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), me kod reference REF-69488-08-24-2020, nëpërmjet Ftesës për Ofertë nr. 1086/1 prot., datë 24.08.2020. Në Ftesën për Ofertë është përcaktuar se data e zhvillimit të procedurës do të ishte 25.08.2020. Nga procesi i hapjes dhe shqyrtimit të ofertave rezulton se kanë marrë pjesë

gjithsej 23 operatorë ekonomikë. Nga këta, një operator është skualifikuar për arsye se oferta e paraqitur prej tij rezultonte me vlerë më të lartë se fondi limit i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Në përfundim të vlerësimit, fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik N. H., me ofertë ekonomike në vlerën 628,000 lekë. Në vijim, ndërmjet palëve është nënshkruar kontrata nr. 1086/3 prot., datë 28.08.2020. Dorëzimi i mallrave objekt kontrate është kryer më datë 07.09.2020, brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në kushtet e kontratës.
Nga auditimi u konstatua se në dosjen e prokurimit mungon *Procesverbali për Shpalljen e Fituesit*. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.

2.Objekti i prokurimit: Përshtatja e ish-mensës së shtëpisë së fëmijës Zyber Hallulli për zyrat e KMCAP Rajonal dhe punime në zyrat e KMCAP Epror

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Përshtatja e ish-mensës së shtëpisë së fëmijës Zyber Hallulli për zyrat e KMCAP Rajonal dhe punime në zyrat e KMCAP Epror". Procedura është iniciuar mbi bazën e kërkesës nr. 820 prot., datë 29.06.2020, drejtuar Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm. Në vijim, me datë 30.06.2020 është nxjerrë Urdhri i Prokurimit nr. 1, si dhe është kryer përllogaritja e fondit limit. Fondi limit është dokumentuar nëpërmjet Procesverbalit të Përllogaritjes së Fondit Limit, datë 30.06.2020. Përllogaritja është realizuar duke u bazuar në çmimet e paraqitura nga tre inxhinierë të licencuar dhe ka rezultuar në vlerën 799,967 lekë pa TVSH. Më pas, procedura është publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik (SPE) dhe është hapur më datë 06.07.2020. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë gjithsej 10 operatorë ekonomikë. Në përfundim të procesit të vlerësimit, fitues është shpallur operatori ekonomik *N shpk, i renditur i shtati në klasifikimin përfundimtar. Kontrata nr. 750/9 prot., datë 17.07.2020, është lidhur me vlerë 778,500 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH dhe me afat përfundimi deri më datë 27.07.2020.
Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se në dosjen e prokurimit mungon *Procesverbali i shpalljes së fituesit dhe Procesverbali i marrjes në dorëzim*. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me pikat 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

3.Objekti i Prokurimit: Shërbim Printimi, Fotokopjimi, Skanimi.

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Shërbim printimi, fotokopjimi, skanimi". Procedura e prokurimit është iniciuar mbi bazën e kërkesës nr. 17 prot., datë 08.01.2020, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Statistikës, nëpërmjet së cilës është kërkuar realizimi i shërbimit të mirëmbajtjes së programit "Alpha" për vitin 2020, me vlerë 118,000 (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë me TVSH, si dhe sigurimi i shërbimeve të printimit dhe fotokopjimit për nevojat e vitit 2020, për një sasi prej 170,000 (njëqind e shtatëdhjetë mijë) fletësh.
Në vijim, është kryer testimi i tregut, i dokumentuar nëpërmjet Procesverbalit të Testimit të Tregut, datë 24.01.2020. Fondi limit, në vlerën 495,403 lekë, është përcaktuar duke marrë në konsideratë dy oferta ekonomike, si dhe kontratën e procedurës së fundit të të njëjtit objekt të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor. Më pas, procedura është publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik (SPE) me kod reference REF-48282-01-27-2020. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) operatorë ekonomikë. Në përfundim të procesit të vlerësimit, fitues është shpallur operatori ekonomik R.-AL, i renditur i pesti në klasifikimin përfundimtar, me ofertë ekonomike në vlerën 420,000 lekë.
Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se në dosjen e prokurimit mungon *Urdhri i Prokurimit, Ftesa për Ofertë, Procesverbali i Fituesit, Kontrata*. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", neni 21, pika 2.

4. Objekti i procedurës: Shërbim me roje civile për vitin 2020

-Më 17.03.2020 nr.447/1 prot. është kryer Shtesë Kontrate "Shërbim me Roje Civile" për kontratën nr.145/12 prot. datë 31.12.2019 mes SHSSH në rolin e AK dhe N. si "Kontraktuesi". Vlera totale e kësaj kontrate është 131,552.07 lekë (pa TVSH) dhe kohëzgjatja është 17.03.2020-31.03.2020. Kjo kontratë është shlyer me USH e datës 14.04.2020 nr.60 në vlerën 157,862 lekë (me TVSH).

- Me Urdhër Prokurimi datë 31.03.2020 nr.94/1 prot. inicion kryerja e procedurës "Shërbim me roje civile për Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH" me fond limit 526,702.87 lekë (pa TVSh). Lloji i kontratës është "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës". Arsyet e përdorimit të kësaj procedure janë: Kontrata shtesë me nr.447/1 prot. mes SHSSH dhe "N" përfundon më 31.03.2020. Pas kërkesës së drejtuar nga SHSSH, shoqëria "I. G." sha njofton një ditë para përfundimit të kontratës, më 31.03.2020, për pamundësinë e ofrimit të shërbimit deri më 28.09.2020. Moskryerja e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë për periudhën 01.04.2020-01.06.2020 përbën rrezik për ruajtjen e objekteve, pronës dhe sigurisë së personelit. Për rrethanat e krijuara, SHSSH nuk mund të zbatojë procedura të tjera për shkak të afatit të kohës që kërkohet për këto procedura. Nga verifikimi me Regjistrin e Parashikimit rezulton se kjo procedurë është e parashikuar për vitin 2020.

Njësia e Prokurimit përbëhet nga A. G., A. Gj., M. M..

Më 15.04.2020 në SPE hidhet procedura "Shërbim me roje civile për Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH", me vlerë 526,702.87 lekë (pa TVSH) dhe nr.REF-56041-04-10-2020. Kjo procedurë është e tipit "me negocim, pa shpallje" dhe arsyetimi ligjor pas saj është i njëjtë me atë të përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit. Ky arsyetim është pranuar nga APP.

Më 16.04.2020 nr.513/13 prot. lidhet Kontratë Shërbimi me "Roje Civile" mes SHSSH si AK dhe N.S.S. si Kontraktuesi. Vlera totale e kontratës pa TVSH është 397,185.77 lekë dhe kohëzgjatja për periudhën nga momenti i nënshkrimit deri më 01.06.2020. Kjo kontratë është shlyer me USH datë 16.04.2020 në vlerën 476,623 lekë (me TVSH) dhe USH nr.80 datë 12.05.2020 me vlerën 155,418 lekë (me TVSH).

-Më 16.06.2020 nr.751/ë prot. ngrihet Urdhër Prokurimi nr.117/1 prot. për kryerjen e procedurës së prokurimit "Shërbim me roje civile për Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH" me fond limit 526,702.87 lekë (pa TVSH). Lloji i procedurës është Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe arsyet e përdorimit të kësaj procedure janë: Procedura e negocimit pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për mbulimin e nevojës ekstreme ishte lidhur me afat deri më 01.06.2020 ndërkohë që ishte hedhur në sistem dhe procedura bazë e llojit "Kërkesë për Propozim" ku pas njoftimit të klasifikimit datë 21.04.2020 dhe ankesës së 3 OE në KPP, ky i fundit me datë 20.05.2020 ka vendosur anullimin e procedurës, vendim me të cilin SHSSH është njohur më 22.05.2020. Moskryerja e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë për periudhën 19.06.2020-19.08.2020 përbën rrezik për ruajtjen e objekteve, pronës dhe sigurisë së personelit për vetë specifikën e shërbimit që ofrohet në institucion. Nga verifikimi me Regjistrin e Parashikimit rezulton se kjo procedurë është e parashikuar për vitin 2020.

Njësia e Prokurimit përbëhet nga A.G., A. Gj., M. M.

Më 17.06.2020 në SPE hidhet procedura "Shërbim me roje civile për SHSSH" me REF-61402-06-16-2020 me arsyetimin ligjor të njëjtë me atë që shkruhet në Urdhrin e Prokurimit. Ky arsyetim është pranuar nga ana e APP dhe është fijuar me procedurën.

Më 19.06.2020 nr.751/7 prot nënshkruhet Kontrata e Shërbimit mes SHSSH si AK dhe N. si Kontraktuesi me vlerë 526,486.38 lekë (pa TVSH) me kohëzgjatje nga lidhja e kontratës deri më 19.08.2020. Kjo kontratë është shlyer me USH datë 22.06.2020 në vlerën 631,784 lekë (me TVSH) dhe USH nr.130 datë 10.07.2020 me vlerë 124.652 lekë (me TVSH).

Viti 2021

1.Objekti i Prokurimit: Shërbim Printimi, Fotokopjimi, Skanimi.

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Shërbim printimi, fotokopjimi, skanimi". Kjo procedurë nuk ka të bashkëlidhur *shkresën e kërkesës për nisjen e saj*.

Është kryer testimi i tregut, i dokumentuar nëpërmjet Procesverbalit të Testimit të Tregut, datë 25.01.2021. Fondi limit, në vlerën 500,000 lekë, është përcaktuar duke marrë në konsideratë tre oferta ekonomike. Ky PV nuk është nënshkruar nga Komisioni i Testimit të Tregut (E. B., E. B., M. M.), Më pas, është nënshkruar Urdhër Prokurimi nr.172, datë 28.01.2021 për "Prokurimin me Vlera të Vogla" nënshkruar nga Titullari i AK znj.A.C.Ftesa për Ofertë me nr. 172/1 prot., mban të njëjtën datë dhe përcaktohet se data e zhvillimit të procedurës do jetë 01.02.2021 ora 13:0, afati i lëvrimit të shërbimit/punës do të jetë 1 ditë duke filluar nga data e shpalljes fitues në sistemin e APP. Zyrtarët pjesë e Njësisë së Prokurimit dhe KVO janë E. B., M. M., E. B..

Procedura është publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik (SPE) me kod reference REF-85119-01-28-2021. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë gjithsej 11 operatorë ekonomikë. Në përfundim të procesit të vlerësimit, fitues është shpallur operatori ekonomik K.shpk, i renditur i shtati në klasifikimin përfundimtar, me ofertë ekonomike në vlerën 480,000 lekë. Më 15.02.2021 është nënshkruar Kontrata për "Shërbim Printimi dhe Fotokopjimi" nr.172/3 prot., me OE fitues

Në dosjen e prokurimit mungon *Kërkesa Fillestare, Procesverbali i Fituesit*. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.

2.Objekti i Prokurimit: Blerje kancelarie

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Blerje kancelari dhe letër". Procedura është iniciuar mbi bazën e kërkesës nr. 607 prot., datë 11.03.2021, paraqitur nga Magazinieri.

Procesverbali i përcaktimit të fondit limit nuk gjendet bashkëlidhur. Më 31.03.2021 është ngritur Urdhër Prokurimi nr.607/1 për "Prokurimin me Vlera të Vogla" nënshkruar nga Titullari i AK znj.L. S. dhe në po të njëjtën datë Ftesa për Ofertë me nr.607/2 prot., ku përcaktohet se data e zhvillimit të procedurës do jetë 02.04.2021 ora 12:0, afati i lëvrimit të shërbimit/punës do të jetë ditën e nesërme duke filluar nga data e paraqitjes në institucion. Zyrtarët pjesë e Njësisë së Prokurimit dhe KVO janë E. B., M.M., A. D.

Procedura është publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik (SPE) me kod reference REF-92504-03-31-2021 dhe fond limit 500,000 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë gjithsej 20 (njëzetë) operatorë ekonomikë.

Më 02.04.2021 është nënshkruar PV për Hapjen dhe Vlerësimin në Sistem të Prokurimit nga KVO. Në përfundim të procesit të vlerësimit, fitues është shpallur operatori ekonomik I. O. shpk, i renditur i katërti në klasifikimin përfundimtar, me ofertë ekonomike në vlerën 254,000 lekë. Më 12.04.2021 është nënshkruar nga Komisioni i Pritjes së Mallit (E. K, E. I., S.N.) PV i marrjes në dorëzim të mallrave dhe Fletë-Hyrja nr.02 nga Magazinieri dhe Fatura nr.192/2021. Urdhër Shpenzimi mban datën 30.04.2021.

Në dosjen e prokurimit mungon *Procesverbali i Përllogaritjes së Fondit Limit*. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.

3.Objekti i Prokurimit: Blerje materiale pastrimi

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Blerje materiale pastrami dhe detergjentë". Procedura është iniciuar mbi bazën e kërkesës nr. 606 prot., datë 11.03.2021, paraqitur nga Magazinieri.

Procesverbali i përcaktimit nuk mban datë dhe fondi limit është vendosur duke marrë cmimet referuese të Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara, në vlerën 410,000 lekë (pa TVSH). Nënshkruar nga E. B., M. M., A. D.. Më 24.05.2021 është ngritur Urdhër Prokurimi nr.606/1

për “Prokurimin me Vlera të Vogla” nënshkruar nga Titullari i AK znj.L. S.. Më 02.06.2021 është përgatitur Ftesa për Ofertë me nr.606/2 prot., ku përcaktohet se data e zhvillimit të procedurës do jetë 04.06.2021 ora 13:00, afati i lëvrimit të shërbimit/punës do të jetë ditën e nesërme duke filluar nga data e paraqitjes në institucion. Zyrtarët pjesë e Njësisë së Prokurimit dhe KVO janë E.B., M. M., A. D.
Procedura është publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik (SPE) me kod reference REF-97124-06-02-2021. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë gjithsej 36 operatorë ekonomikë. Më 04.06.2021 është nënshkruar PV për Hapjen dhe Vlerësimin në Sistem të Prokurimit nga KVO. Në përfundim të procesit të vlerësimit, fitues është shpallur operatori ekonomik I. C. shpk, i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar, me ofertë ekonomike në vlerën 155,900 lekë.
Më 08.06.2021 është nënshkruar nga Komisioni i Pritjes së Mallit (E.K., E. I., S.N.) PV i marrjes në dorëzim të mallrave dhe Fletë-Hyrja nr.06 nga Magazinieri dhe Fatura nr.42/2021. Urdhër Shpenzimi mban datën 22.06.2021.

Viti 2022

1.Objekti: Shërbim printimi, fotokopjimi, skanimi

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt “Shërbim printimi, fotokopjimi, skanimi”. Procedura është iniciuar mbi bazën e kërkesës nr. 118 prot., datë 20.01.2022, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme. Në vijim, me nr. 118/1 prot. është nxjerrë Urdhri i Prokurimit, si dhe është hartuar Procesverbali i Testimit të Tregut, nëpërmjet të cilit është përcaktuar fondi limit në vlerën 561,400 (pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë. Më datë 25.01.2022 është nënshkruar Ftesa për Ofertë, duke përcaktuar si datë të zhvillimit të procedurës 27.01.2022. Në përfundim të afatit të paraqitjes së ofertave rezulton se janë paraqitur gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) oferta. Pas procesit të vlerësimit, fitues është shpallur operatori ekonomik K.shpk, i renditur i shtati në klasifikimin përfundimtar, me ofertë ekonomike në vlerën 488,520 (katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Operatorët e tjerë ekonomikë janë tërhequr nga gara. Kontrata nr. 118/3 prot. është nënshkruar më datë 11.02.2022.
Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se mungon *PV i marrjes në dorëzim*, mungon *PV i argumentimit të specifikimeve teknike* dhe *PV i marrjes në dorëzim*. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, neni 21, pika 2.

2.Objekti: Shërbim riparim automjeti

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt “Shërbim riparim automjeti”.
Në dosjen e prokurimit nuk gjendet *kërkesa fillestare për nisjen e kësaj procedure* e gjithashtu mungon *Procesverbali i Testimit të Tregut* dhe *Procesverbali i argumentimit të specifikimeve teknike*. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, neni 21, pika 2.
Urdhri i Prokurimit është nënshkruar më datë 27.05.2022, me nr. 1110/2 prot. Nga të dhënat e administruara në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik (SPE) konstatohet se fondi limit për këtë procedurë është përcaktuar në vlerën 500,000 lekë. Ftesa për Ofertë është publikuar në sistem më datë 30.05.2022, ndërsa data e zhvillimit të procedurës është përcaktuar 01.06.2022. Në Ftesën për Ofertë është parashikuar që afati i lëvrimit të jetë 3 ditë nga data e shpalljes së fituesit në APP. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë gjithsej 9 operatorë ekonomikë. Në përfundim të procesit të vlerësimit, fitues është shpallur operatori ekonomik B. M., i renditur i pesti në klasifikimin përfundimtar, me ofertë ekonomike në vlerën 427,200 (katërqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind) lekë pa TVSH.

Viti 2023

1.Objekti: Blerje pajisje elektroshtëpiake

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Blerje pajisje elektroshtëpiake". Procedura ka nisur me kërkesën datë 29.06.2023 nr.51/2 prot nga Qendra e Zhvillimit "Pëllumbat" (Titullar A. Sh.) drejtuar SHSSH. Më pas është ngritur Urdhri i Prokurimit nr,6 datë 03.07.2023 nr.6672/1 prot. dhe PV i testimit të tregut datë 28.07.2023 nr.7362 prot. Nuk gjenden as në SPE, as në dosjen fizike të procedurës së prokurimit Procesverbali i Argumentimit të Specifikimeve Teknike.

Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se në procesverbalin e testimit të tregut nuk paraqitet mënyra e testimit të tregut, thjesht fondi limit i përllogaritur nga anëtarët e grupit. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave Të Prokurimit Publik" i ndryshuar Neni 13, pika 4.

Fondi limit për këtë procedurë është përcaktuar në vlerën 172,000 (njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë. Më datë 31.07.2023 është hapur procedura e prokurimit në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik (SPE), ku është përcaktuar se afati i lëvrimit do të jetë 1 ditë nga data e konfirmimit të fituesit në sistem. Në përfundim të afatit të paraqitjes së ofertave rezulton se kanë marrë pjesë gjithsej 40 (dyzet) operatorë ekonomikë. Nga të cilët, 22 operatorë janë skualifikuar për arsye se ofertat e paraqitura prej tyre rezultonin me vlerë më të lartë se fondi limit i përcaktuar. Pas procesit të vlerësimit, fitues është shpallur operatori ekonomik B. A., i renditur i dhjeti në klasifikimin përfundimtar, me ofertë ekonomike në vlerën 158,750 (njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë

Nga shqyrtimi i Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim konstatohet se në përmbajtje të tij *nuk është kryer identifikimi i saktë* dhe i individualizuar i pajisjeve të blera nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht, procesverbali nuk përmban të dhëna identifikuese për secilën pajisje (si p.sh. numër serie, kod unik identifikimi apo barcode), elementë të cilët përbëjnë praktikë standarde për pajisjet elektroshtëpiake dhe mundësojnë gjurmueshmërinë e tyre në inventar. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pamundur identifikimin e saktë të pajisjeve në strukturën e varësisë së SHSSH-së, ku ato janë dorëzuar, si dhe cenon parimin e gjurmueshmërisë dhe administrimit korrekt të pasurisë publike. Gjithashtu, në rast të shfaqjes së defekteve ose problematikave teknike gjatë periudhës së garancisë, mungesa e identifikimit të individualizuar të pajisjeve mund të krijojë vështirësi në procesin e zëvendësimit të tyre, si dhe në përcaktimin e përgjegjësisë kontraktore të operatorit ekonomik fitues. Kjo për shkak se nuk mund të provohet në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar se cilat pajisje janë marrë në dorëzim në kuadër të kontratës, duke cenuar kështu gjurmueshmërinë dhe kontrollin mbi zbatimin e obligimeve kontraktore. Kjo bie në kundërshtim me pikën 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar dhe me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.

2.Objekti: Blerje pajisje elektroshtëpiake

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Blerje pajisje elektroshtëpiake". Procedura ka nisur me kërkesën datë 06.07.2023 nr.50/2 prot nga Qendra e Zhvillimit "Pëllumbat" (Titullar A. Sh.) drejtuar SHSSH. Më pas është ngritur Urdhri i Prokurimit nr.10 datë 14.09.2023 nr.8456 prot. dhe PV i testimit të tregut datë 14.09.2023 nr.8456/1 prot. Në këtë procesverbal vendoset se fondi limit i procedurës është 810,000 lekë. Më pas ngarkohet në sistem Ftesa për Ofertë ku data e zhvillimit të procedurës caktohet 18.09.2023 dhe afati i lëvrimit të mallit ditën e nesërme duke filluar nga data e shpalljes së fituesit pas përfundimit të fazës së ankimimit. Nuk gjenden as në SPE, as në dosjen fizike të procedurës së prokurimit Procesverbali i Argumentimit të Specifikimeve Teknike.

Në këtë procedurë ka 32 ofertues, ku 18 prej tyre janë të skualifikuar. Fitues shpallet OE "B." i renditur i gjashti me ofertë 650,000 lekë (pa TVSH).

Nga shqyrtimi i Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim konstatohet se në përmbajtje të tij *nuk është kryer identifikimi i saktë* dhe i individualizuar i pajisjeve të blera nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht, procesverbali nuk përmban të dhëna identifikuese për secilën pajisje (si p.sh. numër serie, kod unik identifikimi apo barcode), elementë të cilët përbëjnë praktikë standarde për pajisjet elektroshtëpiake dhe mundësojnë gjurmueshmërinë e tyre në inventar. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pamundur identifikimin e saktë të pajisjeve në strukturën e varësisë së SHSSH-së, ku ato janë dorëzuar, si dhe cenon parimin e gjurmueshmërisë dhe administrimit korrekt të pasurisë publike. Gjithashtu, në rast të shfaqjes së defekteve ose problematikave teknike gjatë periudhës së garancisë, mungesa e identifikimit të individualizuar të pajisjeve mund të krijojë vështirësi në procesin e zëvendësimit të tyre, si dhe në përcaktimin e përgjegjësisë kontraktore të operatorit ekonomik fitues. Kjo për shkak se nuk mund të provohet në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar se cilat pajisje janë marrë në dorëzim në kuadër të kontratës, duke cenuar kështu gjurmueshmërinë dhe kontrollin mbi zbatimin e obligimeve kontraktore. Kjo bie në kundërshtim me pikën 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar dhe me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.

3.Objekti: Blerje pajisje elektroshtëpiake

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Blerje pajisje elektroshtëpiake". Procedura ka nisur me kërkesën datë 02.10.2023 nr.309 prot nga Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë (Titullari V. I.) drejtuar SHSSH, gjithashtu me kërkesën datë 02.10.2023 nr.202 prot nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë (Titullari A. P.) dhe kërkesën datë 03.10.2023 nr.97 prot nga Shtëpia e Fëmijës për Grupmoshën 16-18 vjec Shkodër (Titullar V. T.). Më pas është ngritur Urdhri i Prokurimit nr.11 datë 30.10.2023 nr.9615/1 prot. dhe PV i testimit të tregut në po të njëjtën datë nr.9615 prot. Në Procesverbalin e Testimit të Tregut vihet re se bashkëlidhur ka vetëm 1 shembull për pajisje, ndaj nuk mund të konsiderohet testim tregu i mirëfilltë, gjithashtu nuk gjendet pv i argumentimit të specifikimeve teknike. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.

Fondi limit i procedurës është 164,500 lekë. Më pas ngarkohet në sistem Ftesa për Ofertë ku data e zhvillimit të procedurës caktohet 02.11.2023 dhe afati i lëvrimit të mallit ditën e nesërme duke filluar nga data e shpalljes së fituesit pas përfundimit të fazës së ankimimit.

Konstatim: Grupi i auditimit konstaton se në specifikimet teknike ne Ftesën për Ofertë nuk përcaktohet garancia për elektroshtëpiaket që po prokurohen.

Në këtë procedurë ka 38 ofertues, ku 35 prej tyre janë të skualifikuar për vlerë të ofertuar më të lartë se fondi limit. Fitues shpallet OE "B. L." i renditur i dyti me ofertë 138,000 lekë (pa TVSH).

Në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim nuk ka identifikim të pajisjeve të blera nga AK. Ky identifikim mund të ishte në formën e barcode-it që çdo pajisje elektroshtëpiake ka në strukturë, por diçka e tillë nuk gjendet. Kjo e bën të pamundur identifikimin e këtyre pajisjeve në strukturën e varësisë së SHSSH ku janë dorëzuar. Gjithashtu në rast problematike, mund të sillte probleme për zëvendësimin ose marrjen e përgjegjësisë nga ana e OE fitues, për sa kohë nuk mund të provohet se cilat janë ekzaktësisht pajisjet e marra. Kjo bie në kundërshtim me pikën 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar dhe me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.

4.Objekti: Shërbim printimi, fotokopjimi, skanimi

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Shërbim printimi, fotokopjimi, skanimi". Procedura ka nisur me kërkesën datë 30.01.2023 nr.1061 prot. nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme. Më 01.02.2023 është ngritur Urdhri i

Prokurimit nr.1 dhe Procesverbali i Testimit të Tregut ku është vendosur fondi limit 695,500 lekë.
Nga auditimi rezulton se nuk ka PV të argumentimit të specifikimeve teknike. Kjo bie në kundërshtim me me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.
Më 02.02.2023 është nënshkruar Ftesa për Ofertë dhe data e zhvillimit të procedurës ka qenë 03.02.2023. Gjithsej kanë ardhur 10 oferta dhe fitues është shpallur OE i renditur i shtati "K." shpk me ofertë 675,000 lekë pa TVSH.

Viti 2024

1.Objekti: Shërbim lyerje të godinës së institucionit

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Shërbim lyerje të godinës së institucionit". Procedura është iniciuar mbi bazën e relacionit nr. 812/5 prot., datë 24.10.2024, të hartuar nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme, S. M., në të cilin është evidentuar gjendja e amortizuar e fasadës së godinës së SHSSH-së dhe e disa ambienteve të tjera brenda godinës. Në vijim, me datë 04.11.2024 janë nxjerrë Urdhri i Prokurimit nr. 8125/2 prot. dhe Procesverbali i Testimit të Tregut nr. 8125/1 prot., në të cilin është përcaktuar fondi limit. Ftesa për Ofertë është publikuar në sistemin elektronik të prokurimit më datë 07.11.2024, ndërsa data e zhvillimit të procedurës është caktuar më 08.11.2024. Afati i lëvrimit është përcaktuar një (1) ditë nga data e konfirmimit të fituesit në sistem. Nga procedura kanë marrë pjesë gjithsej 10 (dhjetë) operatorë ekonomikë, ku fitues është shpallur A. B., i renditur i teti, me ofertë në vlerën 698,000 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH. Më datë 03.12.2024 është nënshkruar kontrata nr. 8125/9 prot., ndërsa Procesverbali i Marrjes në Dorëzim është nënshkruar më datë 23.12.2024.

2.Objekti: Shërbim printimi, fotokopjimi, skanimi

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Shërbim printimi, fotokopjimi, skanimi". Procedura është iniciuar mbi bazën e kërkesës nr. 616 prot., datë 25.01.2024, të paraqitur nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe drejtuar Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të SHSSH. Në vijim, më datë 25.01.2024 është nxjerrë Urdhri i Prokurimit nr. 1, është hartuar Procesverbali mbi përcaktimin e specifikimeve teknike nr. 616/1 prot., datë 25.01.2024, si dhe Procesverbali i Testimit të Tregut nr. 616/3 prot., datë 26.01.2024, ku është përcaktuar fondi limit në vlerën 819,000 (tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë. Ftesa për Ofertë është publikuar me datë të zhvillimit të tenderit më 13.02.2024. Procedura është anuluar më datë 12.02.2024 për shkak të gabimeve të konstatuara në dokumentet e tenderit, dhe më pas është rihapur procedura. Hapja e procedurës është kryer më 13.02.2024, ku kanë marrë pjesë gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) operatorë ekonomikë. Më datë 05.03.2024 është nënshkruar Procesverbali i Njoftimit të Fituesit nr. 616/8 prot., ku fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik I.P., i renditur i teti në klasifikimin përfundimtar, me ofertë në vlerën 788,200 (shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind) lekë. Më datë 12.03.2024 është nënshkruar kontrata nr. 616/9 prot., për zbatimin e shërbimeve objekt të procedurës.

Viti 2025

1.Objekti: Blerje pajisje elektroshtëpiake për institucionet

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit "Blerje me Vlerë të Vogël" me objekt "Blerje pajisje elektroshtëpiake për institucionet". Procedura ka nisur me kërkesën datë 27.11.2025 nr.9750 prot. nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme A. M. drejtuar A. C. zv.dr. i përgjithshëm i shërbimit social shtetëror. Në këtë kërkesë nuk është përcaktuar se për cilin Institucion janë të nevojshme pajisjet elektroshtëpiake që do të prokurohen. Më pas është ngritur Urdhri I Prokurimit nr.17 datë 02.12.2025 nr.9750/2 prot. Fondi Limit është 395,000 lekë. Ftesa për Ofertë datë 04.12.2025 ka datën e zhvillimit datë 05.12.2025 dhe afatin e

lëvrimit 15 ditë nga data e konfirmimit të fituesit në sistem pas mbarimit të afatit të ankimit. Gjithsej kanë ardhur 30 oferta, prej të cilave 2 të papranuara. Fitues është shpallur OE "E. L." i renditur i pari me vlerë 198,900 lekë. Kontrata është nënshkruar më 12.12.2025 nr.9750/7 prot. Procesverbali i marrjes në dorëzim pas 5 ditësh, datë 17.12.2025 nr.9750/8 prot, fatura elektronike mban të njëjtën datë dhe nr.463/2025 dhe Urdhër Shpenzimi datë 30.12.2025
Nga shqyrtimi i kërkesës dhe i Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim konstatohet se nuk është e qartë se cilat institucione kanë pasur nevojë për këto pajisje. Gjithashtu, Procesverbali i Marrjes në Dorëzim nuk përmban identifikimin individual të pajisjeve të blera nga Autoriteti Kontraktor. Ky identifikim, i cili mund të bëhej përmes barcode-it ose çdo kodi unik që çdo pajisje elektroshtëpiake zakonisht ka në strukturën e saj, nuk gjendet në dokumentacion. Mungesa e një identifikimi të tillë e bën të pamundur përcaktimin dhe gjurmimin e këtyre pajisjeve brenda strukturës së varësisë së SHSSH-së ku ato janë dorëzuar. Në rast të shfaqjes së problematikave teknike ose defekteve, kjo situatë mund të krijojë vështirësi në procesin e zëvendësimit të pajisjeve ose në përcaktimin e përgjegjësisë kontraktore të operatorit ekonomik fitues, pasi nuk mund të provohet në mënyrë të qartë se cilat pajisje janë marrë konkretisht në dorëzim në kuadër të kontratës. Kjo bie në kundërshtim me pikën 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar dhe me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.

2.Objekti: Shërbim printimi, fotokopjimi, skanimi

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit Blerje me Vlerë të Vogël me objekt "Shërbim printimi, fotokopjimi, skanimi". Në vijim, më datë 21.02.2025 janë hartuar Urdhri i Prokurimit nr. 514/3 prot., Procesverbali mbi përcaktimin e specifikimeve teknike nr. 514/3 prot., si dhe Procesverbali i Testimit të Tregut nr. 514/4 prot. Procedura nr. 514/5 prot., datë 10.03.2025, është anuluar pasi asnjë nga ofertuesit nuk përmbushte kërkesat e Ftesës për Ofertë. Më datë 12.03.2025 është publikuar në sistem një ftesë e re për ofertë, me afat lëvrimi 1 (një) ditë nga data e konfirmimit të fituesit në sistem, dhe është hartuar Procesverbali nr. 514/7 prot. për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Hapja e procedurës është kryer më datë 13.03.2025, ku kanë marrë pjesë gjithsej 20 oferta. Më datë 08.04.2025 është nënshkruar Procesverbali i Njoftimit të Fituesit nr. 3037/1 prot., ku fitues është shpallur operatori ekonomik I.P., i renditur i nënti, me ofertë në vlerën 757,400 (shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind) lekë. Më datë 08.04.2025 është nënshkruar kontrata nr. 3037/2 prot., për zbatimin e shërbimeve objekt të procedurës.

III. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Zyrës Rajonale Durrës"

-Element i regjistrit të parashikimeve për vitin 2021 lloji i procedurës së prokurimit është procedurë "E Hapur e Thjeshtuar".

"Rikonstruksion i Zyrës Rajonale Durrës"		
Urdhër Prokurimi Nr. 1462 Prot., date 04.08.2021	***Njësia e Prokurimit*** 1.A.Sh. 2. E. B. 3. B. M.	***Komisioni i Vlerësimit Ofertave*** Urdhër nr.1462/1 prot., datë 06.08.2021 1.G.M. 2. D. M. 3. V. H.
Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar ", Punë publike		
Fondi Limit (pa TVSH) **Lekë** 2,166,000 Lekë	***Oferta fituese*** 2,078,120 Lekë	***Diferenca me fondin limit*** 87,880 Lekë
Data e hapjes së tenderit 20.01.2021	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatorët Ekonomike** 1.*.N shpk 2. *Z.K shpk 3. H.-*F shpk 4.M. K. shpk 5.V. K. shpk
Zbatimi i Kontratës së Shërbimit		
Lidhja e kontratës	**Vlera e kontratës**	Likuiduar 2,369,057 Lekë me TVSH

Nr.1462/13 Prot. Datë 28.10.2021	2,078,120 Lekë pa TVSH	

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se:

Për nisjen e procedurës

-Para fillimit të procedurës së auditimit, janë zhvilluar komunikime të shumta institucionale ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1092/2 prot., datë 22.10.2020, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH i është drejtuar MSHMS-së, duke kërkuar mbështetje për realizimin e procedurave të tenderimit në Durrës dhe Elbasan. Në këtë shkresë evidentohet mungesa në strukturë e një specialisti inxhinier dhe pamundësia për certifikimin e dokumentacionit teknik, si dhe mungesa e kapaciteteve financiare dhe kohore për realizimin e procedurës së prokurimit. Për këtë arsye, është kërkuar mundësimi i projektit të zbatimit të punimeve në formë donacioni.
- Me Urdhrin nr. 94, datë 26.02.2021 (nr. 487 prot.), është caktuar zyrtari i autorizuar për fillimin e procedurës së prokurimit, përkatësisht Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale A. C..
- Me shkresën nr. 929/1 prot., datë 02.03.2021, MSHMS ka kërkuar marrjen e masave për rehabilitimin e objektit, bazuar në akt-ekspertizën e kryer nga një inxhinier konstruktor, ku konstatohet nevoja për përforcime strukturore. Është kërkuar përditësimi i preventivit ekzistues duke përfshirë zërat shtesë për përforcimet e rekomanduara dhe dërgimi i tij në MSHMS në kohë sa më të shpejtë. Theksohet se kjo procedurë lidhet me realizimin e indikatorëve të projektit "Modernizimi i Asistencës Sociale", në zbatim të ligjit nr. 53/2018, dhe vonesat sjellin rrezik për penalizim në mosdisbursimin e fondit prej 2.5 milionë USD.
- Me shkresën nr. 718 prot., datë 29.03.2021, është kërkuar kryerja e oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit, ku kostoja e plotë e investimit sipas preventivit të zbatimit rezulton në vlerën 2,560,654 lekë me TVSH.
- Me shkresën nr. 569/2 prot., datë 31.03.2021, është lidhur akt-marrëveshja ndërmjet SHSSH dhe Institutit të Ndërtimit.
- Me shkresën nr. 569/3 prot., datë 22.04.2021, Instituti i Ndërtimit ka përcjellë oponencën teknike.
- Me shkresën nr. 796/3 prot., datë 22.04.2021, është kërkuar miratimi për fillimin e procedurave për objektin "Rehabilitim i Zyrës Rajonale të SHSSH Durrës", drejtuar Bashkisë Durrës.
- Me shkresën nr. 333/24 prot., datë 14.05.2021, MSHMS ka miratuar transferimin e fondeve të investimeve për vitet 2021–2023.
- Me shkresën nr. 1025 prot., datë 20.05.2021, është kërkuar nga MSHMS angazhimi i dy specialistëve inxhinier për vijimin e procedurës.
- Me shkresën nr. 1025/1 prot., datë 02.06.2021, MSHMS ka kthyer përgjigje, duke sugjeruar kontraktimin e specialistëve të jashtëm.
- Me shkresën nr. 1025/2 prot., datë 04.06.2021, SHSSH ka paraqitur arsyetimin mbi pamundësinë e kontraktimit të specialistëve të jashtëm për shkak të mungesës së fondeve, duke propozuar krijimin e një njësie të përbashkët prokurimi me përfaqësues nga të dy institucionet.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe përcaktimi i fondit limit

-Në hartimin e nevojave të Autoritetit Kontraktor në këtë rast Shërbimi Social Shtetëror bazuar në fushën e veprimtarisë së tij dhe realizimin e indikatorëve të projektit "Modernizimi i Asistencës Sociale", në zbatim të ligjit nr. 53/2018, pas komunikimeve me Ministrinë e

Shëndetësisë ka lindur nevoja për kryerjen e procecdurës së prokurimit. Më 29.03.2021 nr.718/8 prot. dërgohet Kërkesa për kryerjen e oponencës teknike drejtuar Institutit të Ndërtimit nga SHSSH. Kostoja e plotë e investimit e dalë nga preventivi i zbatimit është 2,560,654 lekë (me TVSH). Në datën 31.03.2021 nr.569/2 prot. është lidhur Akt Marrëveshja mes Institutit të Ndërtimit dhe SHSSH. Më 22.04.2021 nr.5693 prot. Instituti i Ndërtimit përcjell Oponencën Teknike.

Zhvillimi i Procedurës

Me Urdhrin e Prokurimit nr.1462 prot. datë 04.08.2021 përcaktohet fondi limit në vlerën 2,166,000 lekë, procedura do të jetë e tipit E hapur e thjeshtuar dhe njësia e prokurimit përbëhet nga A. Sh., E.B. dhe B.M.(përfaqësues i MSHMS).

Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se në pikën 2.7 të DST kërkohet "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion OE" dhe ndër të tjera listohet "Kamioncinë deri në 5 Ton". Nga ky përcaktim nuk është e qartë nëse bëhet fjalë për masën maksimale të autorizuar të kamioncinës apo kapacitetin mbajtës të mjetit. Kjo mund të krijojë paqartësi tek OE të cilët duan të marrin pjesë në këtë procedurë dhe rrjedhimisht mund të shërbejë si pengesë për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kjo bie në kundërshtim me Ligji 162/2020 "Për Prokurimet Publike" i ndryshuar, neni 36 pika 2.

Me Urdhrin nr.1462/1 prot datë 06.08.2021 "Për Ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) përcaktohet se kohëzgjatja e kontratës do të jetë 4 javë kalendarike, afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave data 31.08.2021 ora 10:00 dhe KVO përbëhet nga G. M., D. M., V. H. (përfaqësuese e MSHMS).

Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se punonjësja G.M. është në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Financës me detyrë nëpunës zbatues dhe *njëkohësisht anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, date 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 22, pika 3/b

Në datën 31.08.2021 është nënshkruar Procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave ku renditen 5 OE:

1. *.N shpk vlera 1,587,006 lekë (pa TVSH),
2. *Z K. shpk vlera 2,070,756 lekë (pa TVSH),
3. H.-*F shpk vlera 1,485,622 lekë (pa TVSH),
4. M. K.&R. E.shpk vlera 2,006,477.39 lekë (pa TVSH),
5. V.K.shpk vlera 1,792,368.05 lekë (pa TVSH).

Më 08.09.2021 KVO përgatit Procesverbalin për Procesin e Shqyrtimit dhe Vlerësimit të Ofertave ku konstatohet se të gjithë OE skualifikohen.

Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se OE *Z K. është skualifikuar pasi nuk ka dërguar certifikatën për transport mallrash brenda vendit si dhe licensën e shoqërisë për transport. Mungon fatura për blerjen e një "Motogjeneratori". Gjithashtu një nga drejtuesit teknik figuron i punësuar në kompani tjetër. Ky Operator Ekonomik ka nënshkruar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe në bazë të VKM nr.285 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 26 dhe pika 6. Në bazë të kësaj rezulton se OE është skualifikuar jo në bazë ligjore.

Më 22.09.2021 *Z K. dërgon një ankesë dhe më 23.09.2021 me shkresën nr.1462/4 prot ngrihet Urdhri për pezullimin e procedurës së prokurimit. KPP me Urdhrin nr.724/2021 vendosë të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur dhe lejon AK të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Lidhja e kontratës dhe zbatimi

Më 28.10.2021 nr.1462/13 prot. lidhet Kontrata mes *Z K. shpk dhe SHSSH, me vlerë 2,078,120 lekë (pa TVSH) dhe 2,493,744 lekë (me TVSH). Më 28.10.2021 Personi përgjegjës për Ndjekjen e Kontratës nënshkruan shkresën ku përcaktohet se kontrata u realizua në zbatim

të përpiktë të legjislacionit në fuqi, termat dhe kushtet u realizuan sipas parashikimit të DST dhe gjatë realizimit nuk u konstatuan problematika. Realizimi përfundoi më 26.11.2021 dhe më 23.12.2021 u krye shlyerja e detyrimit të kontratës në shumën 2,369,057 lekë me TVSH. Më 31.12.2021 Raporti përmbledhës për realizimin e kontratës.

IV. Procedura e prokurimit me objekt "*Projekt-preventiv për rikonstruksion të Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli" Tiranë*", me nr. REF-67693-04-28-2023, me fond limit 2,083,333 lekë pa TVSH.

<table>
<tr><td colspan="3">Procedura e prokurimit "Projekt-preventiv për rikonstruksion të Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli" Tiranë"</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 2, datë 18.04.2023</td><td rowspan="2">3. Njësia e Prokurimit
Urdhër nr. 247, datë 18.04.2023

- R. D. (person përgjegjës për prokurimin);
- B. O. (specialist fushe);
- S.D.</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 3, datë 18.04.2023

- F. S., kryetar;
- A.K.;
- F. Q. (specialist fushe).</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur e thjeshtuar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)

2,083,333 lekë</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)

1,656,512 lekë</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)

426,821 lekë (20%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
02.05.2023</td><td>9. Burimi i financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE
b) Skualifikuar: -</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
AK: -
KPP: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e kontratës (MK)
Nr. 5807/1 prot., datë 01.06.2023, amenduar.</td><td>13. Vlera e kontratës
1,987,814.4 lekë me TVSH</td><td>14. Afati i kontratës
75 ditë</td></tr>
</table>

Nëpërmjet Urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 245 dhe nr. 246, datë 14.04.2023, janë marrë si ekspertë të jashtëm B. O. dhe F. Q., si specialistë të fushës (inxhinierë) të licencuar. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr. 2, datë 18.04.2023, ku ka kërkuar kryerjen e procedurës me objekt "Projekt-preventiv për rikonstruksion të Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli" Tiranë", me fond limit 2,083,333 lekë pa TVSH. Nëpërmjet Urdhrit nr. 247, datë 18.04.2023, Titullari i AK ka ngritur Njësinë e prokurimit, të përbërë nga R. D. (person përgjegjës për prokurimin), B. O. (specialist fushe), S. D.. Komisioni ka hartuar PV e datës 28.04.2023 (i paprotokolluar), mbi argumentimin për vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit, si dhe Dokumentet Standarde të Tenderit për procedurën e hapur të thjeshtuar. Nga auditimi nuk u konstatuan parregullsi lidhur me kriteret e përcaktuara.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 3, datë 18.04.2023, Titullari i AK ka ngritur KVO, të përbërë nga F. S., kryetar, A. K., F. Q.(specialist fushe). Nga auditimi u konstatua se kryetari i KVO F. S. është njëkohësisht Nëpunës Zbatues pranë SHSSH, dhe rrjedhimisht nuk duhet të ishte përfshirë në hallkat e menaxhimit operacional përgjatë procesit të prokurimit, pasi bie ndesh dhe pamundëson realizimin e detyrave të nëpunësit zbatues, sipas nenit 12, pika 3, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, ku përcaktohet ndër të tjera se Nëpunësit Zbatues përgjigjen përpara Nëpunësit Autorizues për garantimin para miratimit të shkresave/ urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Nëpërmjet PV të datës 15.05.2023 (i paprotokolluar), KVO ka dokumentuar hapjen e ofertave, ku u konstatua se u paraqit vetëm 1 ofertues, përkatësisht OE "N. G." me ofertë ekonomike 1,656,512 lekë pa TVSH. Nëpërmjet PV të datës 19.05.2023 (i paprotokolluar), KVO ka dokumentuar shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, ku është konkluduar se oferta e paraqitur plotëson të gjitha kriteret e kualifikimit të përcaktuar në DST.

Titullari i AK ka miratuar Raportin Përmbledhës të procedurës së prokurimit nr. 5636 prot., datë 29.05.2023. Ndërmjet AK dhe OE "N. G." është lidhur kontrata e shërbimit nr. 5807/1

prot., datë 01.06.2023, me vlerë 1,656,512 lekë pa TVSH dhe 1,987,814.4 lekë me TVSH, me afat 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. Plani i zbatimit të kontratës nr. 5636/1 prot., datë 12.06.2023, është nënshkruar 11 ditë pas nënshkrimit të kontratës, pra në tejkalim të afatit 7-ditor pas nënshkrimit të kontratës, sipas përcaktimit të nenit 107, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. Kopja e këtij plani i është dërguar APP-së nëpërmjet shkresës nr. 6533 prot., datë 27.06.2023, 15 ditë pasi është nënshkruar, në tejkalim të afatit 5-ditor pas nënshkrimit të planit nga palët, të përcaktuar në të njëjtën dispozitë.
Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 336, datë 14.06.2023, është caktuar personi përgjegjës për ndjekjen e kontratës F. K. (përgjegjës i Sektorit Social të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor, Tiranë).
Nëpërmjet shkresës administruar në SHSSH me nr. 5807/2 prot., datë 26.06.2023, Administratori i N.G. shpk ka kërkuar zgjatje të afateve për dorëzimin e projektit, duke cituar: "*Referuar diskutimeve paraprake mbi prezantimin e projekt-idesë...kemi dakordësuar mbi detyrën e projektimit të dhënë nga ana juaj si AK, si dhe mbi shtimin e disa projekteve të cilat nuk ishin parashikuar në këtë detyrë, konkretisht: (1) realizimi i projektit të shkallës së emergjencës, (2) realizimi i një ashensori për godinën, (3) ndërhyrja për rikonstruksionin e kinemasë dhe furnizimi i pajisjeve të saj dhe mobiljeve, (4) realizimi i fasadës së ventiluar*".
Nga AK dhe OE "N. G." shpk është nënshkruar amendamenti i kontratës nr. 6533/3 prot., datë 30.06.2023, ku afati i zbatimit të kontratës nga 45 ditë bëhet 75 ditë. AK nuk rezulton të ketë raportuar në APP modifikimin e kontratës, në kundërshtim me nenin 107, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë përditësuar dhe dërguar në APP plani i zbatimit të kontratës pas modifikimit, në kundërshtim me nenin 107, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 396, datë 03.07.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të projekt-preventivit, i përbërë nga A. R., A. P., L.B. Në komision nuk rezulton të jetë përfshirë specialist fushe, në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011. Komisioni ka hartuar PV nr. 6533/5 prot., datë 14.08.2023, ku ka listuar dokumentacionin e marrë në dorëzim, duke cituar "*Materiali është sipas formatit të kërkuar në Detyrën e Projektimit*".
OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 259, datë 18.09.2023**, në vlerën prej **1,987,814 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 142/2023, datë 30.08.2023.

Oponenca teknike
Nëpërmjet shkresës nr. 8879 prot., datë 03.10.2023, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së ka dërguar projektin për oponencë teknike drejt Institutit të Ndërtimit. Më tej është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet SHSSH dhe IN në vlerën prej 220,870 lekë me TVSH për realizimin e shërbimit. Instituti i Ndërtimit ka dërguar drejt SHSSH-së Oponencën Teknike nr. 1483/2 prot., datë 03.11.2023, duke konkluduar se "*nga studimi i materialeve të vëna në dispozicion, për projektin e zbatimit të objektit konkludohet se projekti i paraqitur duhet të plotësohet me rekomandimet dhe konkluzionet e dhëna në këtë oponencë teknike që të konsiderohet i plotë për fazën e zbatimit*". Disa nga konstatimet e oponencës teknike ishin, si më poshtë:
- Mangësi në paraqitjen e dokumentacionit: (i) detyra e projektimit duhet të paraqitet e firmosur nga enti investitor dhe paraqitja duhet të jetë më e saktë, (ii) projektet dhe relacionet duhet të paraqiten të firmosura nga autorët, (iii) deklaratat e përgjegjësive profesionale të projektuesve;

- Sa i përket studimit gjeologjik, studimi shoqërohet me kolonë litologjike, por jo me plan vendosje të shpimeve. Në këtë studim ka disa të dhëna për një shesh tjetër (blloku i banimit Partizani, Mozaiku i Tiranës);
- Sa i përket studimit sizmik, është paraqitur i panënshkruar;
- Sa i përket projektit konstruktiv, për objektin ekzistues nuk është paraqitur projekt dhe relacion konstruktiv. Për këtë pikë, IN rekomandon të bëhet analizë e thelluar strukturore mbi gjendjen ekzistuese të godinës dhe qëndrueshmërinë e saj konstruktive;
- Sa i përket projektit elektrik, mungon licenca ose fotokopja e noterizuara e projektuesit të projektit elektrik;
- Sa i përket vlerësimit të ndikimit në mjedis, në raport citohet se projekti ndodhet në Bashkinë Dibër, ndërkohë që objekti ndodhet në Bashkinë Tiranë. Në përshkrimin e impakteve negative janë konstatuar ndikime në punime që nuk kanë lidhje me projektin por me ndërtimin e një spitali. Në planin e menaxhimit mjedisor është përshkruar për tjetër objekt, ndërtimi i një shkolle dhe jo rikonstruksioni i objektit në fjalë. Për këtë pikë, IN rekomandim që raporti i VNM-së duhet të rishikohet dhe plotësohet përpara miratimit të VNM-së paraprake, duke u përqendruar në konstatimet përkatëse.

Në mungesë të specialistit të fushës në komisionin e marrjes në dorëzim të ngritur nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së nr. 396, datë 03.07.2023, asnjë nga parregullsitë e mësipërme që lidhen me pjesët përbërëse të projekt-preventivit nuk është konstatuar gjatë marrjes në dorëzim.

Aktekspertiza e thelluar

Bazuar te detyrat e lëna nga Instituti i Ndërtimit, SHSSH-ja i është drejtuar Universitetit Politeknik të Tiranës nëpërmjet shkresës nr. 210 prot., datë 13.01.2025 me objekt "Kërkesë për shërbim", duke kërkuar shprehjen e interesit për realizimin e shërbimit "Aktekspertizë e thelluar për godinën e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor "Zyber Hallulli". Nëpërmjet shkresës nr. 110/1 prot., datë 16.01.2025, administruar në SHSSH me nr. 210/1 prot., datë 21.01.2025, UPT-ja shpreh gatishmërinë për kryerjen e shërbimit të kërkuar.

Ndërmjet SHSSH dhe UPT është lidhur kontrata nr. 210/2 prot., datë 21.01.2025 (për SHSSH), me objekt "*Aktekspertizë e thelluar për godinën e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor "Zyber Hallulli", ku në nenin 2, pika 2.2 përcaktohet se "çmimi total...do të rezultojë pas matjeve faktike në terren dhe çmimet për nënshërbimet e përcaktuara për këtë tipologji shërbimi në VKM nr. 26/2020...*".

Nëpërmjet shkresës nr. 110/4 prot., datë 25.02.2025, administruar në SHSSH me nr. 210/3 prot., datë 26.03.2025, UPT-ja bën me dije përllogaritjet financiare pas matjeve faktike në terren, në total 2,488,000 lekë me TVSH, me vlerat korrespondente, si më poshtë:

- Dokumentimi gjeometrik: 360,000 lekë me TVSH;
- Studimi gjeologjik: 108,000 lekë me TVSH;
- Studimi sizmik: 72,000 lekë me TVSH;
- Aktekspertiza: 144,000 lekë me TVSH;
- Provat laboratorike: 720,000 lekë me TVSH;
- Studimi i thelluar: 1,080,000 lekë me TVSH.

Palët kanë dakordësuar amendimin e kontratës nr. 210/4 prot., datë 04.03.2025 (për SHSSH), ku në nenin 2, pika 2.2, është përcaktuar se vlera e kontratës është 2,484,000 lekë me TVSH. Në pikën 2.3 është përcaktuar se "*pagesa do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së faturës tatimore, pas përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe marrjes në dorëzim të shërbimit*", si dhe në pikën 2.4 është përcaktuar se "*në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave... detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare*".

Nëpërmjet shkresës nr. 110/5 prot., datë 07.03.2025, administruar në SHSSH me nr. 210/5 prot., datë 11.03.2025, UPT ka përcjellë faturën elektronike nr. 62/2025, datë 07.03.2025, në vlerën prej 2,484,000 lekë me TVSH, si dhe faturën për arkëtim.
Nëpërmjet shkresës nr. 210/6 prot., datë 12.03.2025, drejtuar UPT-së, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH informon se "*SHSSH nuk ka fonde të çelura për investime dhe pagesa për faturat e sipërcituara do të likuidohet sapo të alokohen fondet nga MSHMS*".
Ndërmjet SHSSH dhe UPT është lidhur kontrata nr. 3131/1 prot., datë 16.04.2025 (për SHSSH), me objekt "Projekti i përforcimit për godinën e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor "Zyber Hallulli", me vlerë 720,000 lekë me TVSH. Në pikën 2.3 është përcaktuar se "*pagesa do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së faturës tatimore, pas përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe marrjes në dorëzim të shërbimit*", si dhe në pikën 2.4 është përcaktuar se "*në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave... detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare*". UPT ka faturuar shërbimin e kryer nëpërmjet faturës elektronike nr. 118/2025, datë 30.04.2025, në vlerën prej 720,000 lekë.

Nëpërmjet shkresës nr. 3619 prot., datë 24.04.2025, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH i është drejtuar MSHMS-së, duke kërkuar fonde për investime në shumën totale prej 3,204,000 lekë, për të mundësuar realizimin në kohë të pagesave. Kjo shkresë ka ardhur pasi janë ndërmarrë të dyja angazhimet kontraktore përkatëse. Nga ana e SHSSH-së nuk është vënë në dispozicion asnjë përgjigje e kthyer nga MSHMS-ja në lidhje me këtë kërkesë. Gjithashtu, nëpërmjet shkresës nr. 5174/2 prot., datë 30.06.2025, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së i është drejtuar sërish MSHMS-së, duke informuar mbi buxhetin e shpenzuar për rikonstruksionin e godinës "Zyber Hallulli", ku relaton se kosto totale (projekti, aktekspertiza, oponenca teknike, projekti i përforcimit) është 5,542,684 lekë, ku sërish citohet se "*dy shërbimet me UPT janë përfunduar dhe dorëzuar, por pagesat për to nuk janë realizuar, duke përbërë një total prej 3,204,000 lekë, për të cilat institucioni është në pritje të shtesës së fondit nga MSHMS*".
Për gjithë sa më sipër, të dyja angazhimet e sipërcituara kontraktore me UPT-në, përkatësisht kontrata nr. 210/2 prot., datë 21.01.2025, amenduar, dhe kontrata nr. 3131/1 prot., datë 16.04.2025, janë ndërmarrë përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndara, në vlerën totale prej 3,204,000 lekë, duke përbërë angazhime jashtë fondeve të parashikuara, në kundërshtim me nenin 50 dhe 51 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*". Deri në përfundim të periudhës së auditimit, këto detyrime nuk janë shlyer ende nga ana e Shërbimit Social Shtetëror, për shkak të mungesës së fondeve të disponueshme, duke përbërë risk edhe për aplikimin e penaliteteve nga UPT-ja sipas përcaktimit në nenin 2, pika 2.3 dhe 2.4, të secilës prej kontratave të sipërcituara.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi znj. R. Xh., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së ka kërkuar rishikimin e preventivit nga OE "N.G." 3 herë pas marrjes në dorëzim dhe pranimit të preventivit fillestar, përkatësisht me shkresat nr. 1829 prot., datë 05.03.2024, nr. 1829/2 prot., datë 17.04.2024 dhe nr. 3668/2 prot., datë 28.05.2024. Në të treja rastet operatori ka dërguar preventivët e rishikuar, por në asnjë rast nuk rezulton që marrja në dorëzim e tyre të kryhet nga një komision i posaçëm, në kundërshtim me pikën 42, 43, si dhe të jetë pasqyruar në procesverbalet përkatëse, në kundërshtim me pikën 35, gërma b dhe 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

V. Zbatimi i kontratës me objekt "*Blerje për pajisje të ndryshme për institucionet në varësi të SHSSH*", për vitin 2025, në vlerë 3,240,000 lekë pa TVSH, ku procedura e prokurimit është zhvilluar nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara

Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së nr. 200, datë 37.03.2025, është ngritur komisioni për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vlerës limit të kontratës për kryerjen e procedurës së prokurimit, të përbërë nga A. H., R.D., F. D.. Grupi i punës ka administruar kërkesat nga Institucionet Rezidenciale për Përkujdesje Shoqërore, ku janë përcaktuar pajisjet që kërkohen dhe specifikimet teknike për secilën. Për kryerjen e përllogaritjes së fondit limit, komisioni i është drejtuar studimit të tregut, duke siguruar oferta nga operatorë ekonomikë të ndryshëm. Nëpërmjet PV nr. 2733/2 prot., datë 10.06.2025, Komisioni ka dokumentuar përllogaritjen e fondit limit në vlerën prej 3,621,367 lekë pa TVSH. Nga auditimi nuk u konstatuan parregullsi në këtë fazë të procedurës së prokurimit.

Nëpërmjet shkresës nr. 2733/1 prot/., datë 10.06.2025, drejtuar Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, zv. Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së ka dërguar dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit për blerje pajisjesh të ndryshme për institucionet e varësisë.

Nëpërmjet shkresës administruar në SHSSH nr. 6350 prot., datë 28.08.2025, Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka dërguar dokumentacionin për lidhjen e kontratës me objekt "*Blerje për pajisje të ndryshme për institucionet në varësi të SHSSH*", duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin e paraqitur nga OE, si deklarata dhe formularë gjatë fazës së tenderimit, si dhe skedën teknike të pajisjeve që do të furnizohen.

Ndërmjet AK SHSSH dhe OE "E. L. PF" është lidhur kontrata nr. 7266 prot., datë 12.09.2025, në vlerën totale prej 3,240,000 lekë pa TVSH dhe afat për ekzekutimin 30 ditë nga data e nënshkrimit të saj, për gjithsej 16 artikuj, në sasi të ndryshme dhe destinacion 8 IPSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 7266/1 prot., datë 16.09.2025, drejtuar 8 IPSH-ve, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së ka dërguar për ndjekje dhe zbatim dokumentacionin për zbatimin e kontratës, duke kërkuar nga secila prej IPSH-ve ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të mallrave nga OE fitues, për të kryer verifikimin e sasisë, cilësisë dhe përputhshmërisë së mallrave me specifikimet teknike, për të hartuar PV e marrjes në dorëzim, si dhe për të raportuar pranë SHSSH mbi ecurinë dhe përfundimin e procedurës së dorëzimit.

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion administrohen procesverbalet e marrjes në dorëzim nga secila prej IPSH-ve, si dhe fletë-hyrjet përkatëse.

Në përfundim, është plotësuar Formulari i raportimit për zbatimin e kontratës, drejtuar APP-së më datë 28.10.2025.

Procedura e ndjekur për marrjen në dorëzim të artikujve të furnizuar dhe zbatimin e kontratës nuk është në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.10.2011 "*Për menaxhimi e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", për arsyet e mëposhtme:

Fillimisht, titullari i njësisë nuk ka miratuar urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, llojin, cilësinë, plotësinë dhe të dokumentacionit shoqërues, sipas përcaktimit në pikën 42 të këtij Udhëzimi, por ka deleguar te njësitë e varësisë këtë proces. Pika 41 e këtij Udhëzimi përcakton se, në raste të caktuara sipas nevojave të njësisë publike, bëhet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi te përdoruesi (p.sh direkt në njësinë shpenzuese të njësisë publike) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (p.sh në magazinën qendrore të njësisë publike). Në këtë rast, artikujt e furnizuar nuk kanë kaluar fare nga magazina qendrore e SHSSH-së, por direkt në magazinat e njësive shpenzuese.

Në nenin 107, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcaktohet se Komisioni i ngritur nga titullari i AK është struktura përgjegjëse për ndjekjen me përpikmëri të ecurisë së zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës, në përputhje me kushtet e prokuruara dhe me legjislacionin në fuqi, duke përcaktuar gjithashtu përgjegjësitë e kësaj

strukture. Në përfundim, kjo strukturë është përgjegjëse edhe për përgatitjen e formularit të raportimit për zbatimin e kontratës, por në kushtet kur nuk është miratuar kjo strukturë nga titullari i AK, nuk mund të verifikohet nga kush është hartuar dhe përgatitur formulari i raportimit për zbatimin e kontratës, i cili është dërguar pranë APP-së më datë 28.10.2025.
Në procesverbalet e paraqitur, të mbajtur nga grupet e punës të IPSH-ve përkatëse, janë pasqyruar të dhëna me sasinë e artikujve dhe specifikimet teknike, por nuk është dokumentuar asnjë verifikim i kryer lidhur me përputhshmërinë e artikujve me ofertën e paraqitur nga OE (skeda teknike dhe formularët), lidhur me firmat prodhuese dhe origjinën e mallrave të furnizuar, në mospërputhje me nenin 124, pika 1, të LPP-së dhe pikën 8 të Rekomandimit të APP-së nr. 2118 prot., datë 04.03.2024, ku citohet se "*Komisioni i ngarkuar me marrjen në dorëzim të mallit, duhet të administrojë dhe verifikojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për të siguruar që malli i dorëzuar i plotëson kërkesat e cilësisë sipas specifikimeve teknike dhe për të cilat është shpallur fitues kontraktori*", ku përfshihen edhe formularët mbi origjinën e pajisjeve, skeda teknike, etj.
OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër shpenzimit nr. 263, datë 22.10.2025**, në vlerën prej **3,888,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 363/2025, datë 09.10.2025.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Nga verifikimi i plotësisë së paraqitjes së pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2025, konstatohet se Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) nuk ka hartuar Shënimet Shpjeguese sipas formatit nr. 5, të përcaktuar në Aneksin nr. 2 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme". Megjithëse SHSSH ka hartuar dokumentin "Relacion mbi përgatitjen dhe mbylljen e llogarisë vjetore të vitit 2025", ky dokument përmban informacion të përgjithshëm shpjegues dhe nuk përmbush kërkesat formale dhe përmbajtësore të shënimeve shpjeguese sipas strukturës dhe përmbajtjes së detyrueshme të përcaktuar në udhëzimin përkatës. Si rrjedhojë, nuk është respektuar plotësisht kuadri rregullator për paraqitjen e pasqyrave financiare, duke kufizuar informacionin shpjegues që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve të pasqyrave financiare për interpretimin e elementeve të tyre. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës pranë Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për hartimin dhe paraqitjen e plotë të paketës së pasqyrave financiare vjetore, duke përfshirë edhe Shënimet Shpjeguese sipas formatit dhe kërkesave të përcaktuara, me qëllim garantimin e plotësisë, transparencës dhe kuptueshmërisë së raportimit financiar.

Në vijimësi

2. Gjetja nga auditimi: Nga verifikimi i saktësisë së paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare u konstatua se në zërin "Inventar i imët" (llog. 32), në listën analitike janë përfshirë 5 shtesa të kryera gjatë vitit 2025 në vlerën totale 641,264 lekë (Server, raft metalik, UPS, switch dhe aparat elektrik), të cilat janë klasifikuar si inventar i imët, ndërkohë që për shkak të natyrës, funksionit dhe përdorimit shumëvjeçar duhet të trajtoheshin si aktive afatgjata materiale (inventar ekonomik – llog. 218), veprim në kundërshtim me paragrafin 9 të SKK 5. Nga mos regjistrimi i tyre në llogarinë e duhur 218 "Inventar ekonomik", rrjedhimisht nuk është llogaritur amortizimi në përputhje me pikën 36/c të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme" me pasojë mos njohjen e këtij shpenzimi në vlerën 128,253 lekë, ndërkohë që është njohur si shpenzim e gjithë vlera e aktiveve prej 641,264 lekë. Për rrjedhojë, llogaria 32 "Inventar i imët" paraqitet e mbivlerësuar dhe llogaria 218 "Inventar ekonomik" e nënvlerësuar në shumën 641,264 lekë, ndërsa në Pasqyrën e Performancës shpenzimet janë mbivlerësuar në shumën 513,011 lekë dhe rezultati financiar është nënvlerësuar në të njëjtën vlerë. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës pranë Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për korrigjimin e klasifikimit të gabuar të aktiveve, duke i riklasifikuar nga llogaria 32 "Inventar i imët" në llogarinë 218 "Inventar ekonomik", në përputhje me SKK 5, si dhe të kryejë korrigjimin retrospektiv të gabimit, duke reflektuar efektet përkatëse në pasqyrat financiare, përfshirë amortizimin.

Në vijimësi

3. Gjetja nga auditimi: Nga verifikimi i saktësisë së paraqitjes së llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri dhe pajisje" rezultoi se për vitin ushtrimor 2025 kjo llogari është pakësuar në shumën 22,760 lekë, si pasojë transferimit të 2 printerave të tipit HP 1018 Jet pranë Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit Tiranë. Referuar pasqyrave statistikore 7/a dhe 7/b për vitin 2025 "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)/(vlera bruto)",

rezulton se aktivet e dala janë çregjistruar vetëm me koston historike, duke reflektuar pakësim vetëm në vlerën fillestare, pa u pasqyruar ulja përkatëse e amortizimit të akumuluar.
Ky trajtim është në kundërshtim me kërkesat e SKK 5, sipas të cilave në momentin e daljes aktivi duhet të çregjistrohet me vlerën kontabël neto, duke pakësuar njëkohësisht koston historike dhe amortizimin e akumuluar përkatës. Nga auditimi u konstatua se SHSSH nuk ka pakësuar amortizimin e akumuluar me vlerën e amortizimit të krijuar për printerat e çregjistruar dhe nuk ka pakësuar koston historike me vlerën e tyre fillestare, duke mos reflektuar saktë vlerën kontabël neto në momentin e daljes së aktiveve. Gjithashtu, amortizimi është llogaritur për të gjithë vitin ushtrimor dhe jo deri në datën e çregjistrimit, pa marrë në konsideratë faktin se printerat kanë qenë në përdorim vetëm për 7 muaj gjatë vitit 2025. Në mungesë të një pasqyre analitike sipas aktiveve individuale (kartelë llogarie me datën e hyrjes, datën e daljes dhe lëvizjet përkatëse), amortizimi është llogaritur në grup për të gjitha aktivet, duke mos mundësuar evidentimin e saktë të amortizimit të akumuluar për aktivet e dala. Si rrjedhojë, është njohur rreth 4 muaj më tepër shpenzim amortizimi për këto aktive, duke ndikuar në paraqitjen e saktë të vlerës kontabël të aktiveve dhe të shpenzimeve të periudhës. Veprimi i kryer është gjithashtu në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, lidhur me funksionimin kontabël të daljeve të aktiveve afatgjata, ku kërkohet çregjistrimi i njëkohshëm i kostos historike dhe amortizimit të akumuluar. Në rastin konkret, SHSSH ka çregjistruar vetëm koston historike, pa reflektuar pakësimin e amortizimit të akumuluar, në kundërshtim me funksionimin kontabël të llogarive përkatëse, duke mos reflektuar daljen e aktivit me vlerën e tij kontabël neto. Si pasojë, amortizimi i akumuluar paraqitet i mbivlerësuar, vlera neto e aktiveve afatgjata e nënvlerësuar, ndërsa Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e Performancës dhe pasqyrat 7/a e 7/b nuk pasqyrojnë saktë efektet e çregjistrimit të aktiveve. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës pranë Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për riparaqitjen e saktë të pakësimeve të llogarisë 214, duke çregjistruar aktivet me vlerën kontabël neto në përputhje me SKK 5. Gjithashtu, të rillogaritet amortizimi sipas periudhës reale të përdorimit dhe të reflektohen korrigjimet përkatëse në pasqyrat financiare.

Në vijimësi

4. Gjetja nga auditimi: Nga verifikimi i saktësisë së paraqitjes së llogarisë 215 "Mjete transporti" rezultoi se gjatë vitit ushtrimor 2025 janë regjistruar shtesa në shumën 1,156,820 lekë dhe pakësime në shumën 260,001 lekë, të cilat lidhen me Urdhrin nr. 429, datë 25.11.2025 "Për kalim kapital për automjetet". Në zbatim të këtij urdhri është kryer hyrja e automjetit tip Volksŵagen, sipas fletë-hyrjes nr. 2, datë 25.11.2025, dhe dalja e automjetit tip Nissan, sipas fletë-daljes nr. 3, datë 25.11.2025. Automjeti i marrë është regjistruar me kosto historike 1,156,820 lekë dhe amortizim të akumuluar 938,036 lekë, ndërsa automjeti i dhënë është çregjistruar me vlerë kontabël neto 260,001 lekë.
Transaksioni i këmbimit përbën një këmbim aktivesh jomonetare pa thelb tregtar. Në këto kushte kontabilizimi i tij është kryer në kundërshtim me pikën b, të paragrafit 16 të SKK 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale". Në rastin konkret, aktivi i marrë është regjistruar me vlerën kontabël neto 124,375 lekë dhe jo me vlerën kontabël neto të aktivit të dhënë prej 260,001 lekë. Si rrjedhojë, llogaria 215 "Mjete transporti" paraqitet e nënvlerësuar në shumën 135,626 lekë.
Gjithashtu, u konstatua se për automjetin e marrë nuk është përllogaritur amortizimi për muajin dhjetor 2025, ndërsa për automjetin e dhënë amortizimi nuk është llogaritur deri në datën e çregjistrimit të tij (11 muaj), në kundërshtim me kërkesat e pikës 36/c të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, duke mos reflektuar saktë

shpenzimin e amortizimit sipas periudhës ushtrimore. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 12-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës pranë Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për korrigjimin retrospektiv të trajtimit kontabël të transaksionit të këmbimit të aktiveve, duke korrigjuar vlerën e regjistruar në llogarinë 215 "Mjete transporti", me qëllim njohjen e aktivit të marrë me vlerën kontabël neto të aktivit të dhënë, në shumën 260,001 lekë, në përputhje me kërkesat e SKK 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale", si dhe të reflektojë efektin prej 135,626 lekë në pasqyrat financiare dhe të korrigjojë llogaritjen e amortizimit në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Në vijimësi

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën 2020–2025, njësia nuk ka krijuar dhe nuk ka vënë në funksionim Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe Grupin e Menaxhimit të Riskut, duke mos përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 2.2 dhe 3.2 të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, si dhe në nenet 4 dhe 10 të Udhëzimit nr. 16, datë 13.12.2024. Kjo tregon mungesë të strukturave përgjegjëse për koordinimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe për identifikimin, vlerësimin dhe administrimin e risqeve institucionale. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

5.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e **Grupit të Menaxhimit Strategjik** dhe **Grupit të Menaxhimit të Riskut**, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me qëllim garantimin e funksionimit efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm, integritetit të informacionit financiar, si dhe identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e risqeve që lidhen me veprimtarinë e institucionit.

Menjëherë

6. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se kërkesat për punonjës me kontratë të përkohshme kanë ardhur në rritje gjatë viteve periudhë auditimi, që reflekton nevojën e vazhdueshme të SHSSH-së dhe institucioneve të varësisë për staf shtesë për përmbushjen dhe realizimin e detyrimeve institucionale të përcaktuara, duke arritur nga 13% të strukturës së miratuar në vitin 2020 deri në 30% të strukturës në vitin 2025. Përdorimi i vazhdueshëm i kontratave të punës me kohë të pjesshme dhe me afat të caktuar paraqet risk për tejkalimin e kufijve kohorë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, me pasojë shndërrimin e tyre në kontrata pune me afat të pacaktuar, sipas nenit 151 të Kodit të Punës.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

6.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masat për vlerësimin e nevojave aktuale organizative dhe funksionale të strukturës së SHSSH-së, duke marrë në konsideratë volumin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor për Shërbimin Social Shtetëror dhe përdorimin e vazhdueshëm të punonjësve me kontrata të përkohshme. Mbi këtë bazë, MSHMS të bëjë propozimet përkatëse për përmirësimin e strukturës dhe organizimit funksional të SHSSH-së, me qëllim garantimin e përmbushjes efektive të detyrimeve në fushën e asistencës sociale.

Menjëherë

7. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se **s**truktura e Shërbimit Social Shtetëror ka gjithsej 15 specialistë IT, ku 3 specialistë IT janë në Drejtorinë e Përgjithshme dhe nga 1 specialist IT në secilën prej 12 Drejtorive Rajonale. Pavarësisht se SHSSH është pjesë e administratës shtetërore, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 90/2012, punonjësit aktualë specialistë IT të SHSSH-së nuk kanë kaluar tek AKSHI, në kundërshtim me pikën 23 të VKM-

së nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*", kalim i cili duhej të ishte bërë brenda datës 31.12.2017. Për çdo problematikë të evidentuar gjatë punës në sistem, punonjësit IT të Drejtorive Rajonale raportojnë te punonjësit IT pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH, të cilët më tej e përcjellin për ndjekje te struktura IT e AKSHI-t pranë MSHMS-së. Kjo mënyrë e menaxhimit të problematikave, me shumë hallka ndërmjetëse, rrit riskun për moskoordinim dhe vonesa në zgjidhjen e problematikave të mundshme, duke krijuar paqartësi në përgjegjësi, ulur efikasitetin operacional dhe duke ndikuar negativisht në vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimeve, sidomos në rastet kur kërkohet ndërhyrje e shpejtë teknike.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
7.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të marrin masat për kalimin e punonjësve IT në strukturën e AKSHI-t, për të garantuar qartësimin e linjave të përgjegjësisë institucionale, përmirësimin e koordinimit teknik në menaxhimin e sistemeve digjitale, si dhe rritjen e efikasitetit dhe kohës së reagimit ndaj problematikave që lidhen me funksionimin e tyre.

Menjëherë

8. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, pas kalimit të punonjësve të Shërbimit Social Shtetëror nga shërbimi civil në marrëdhënie pune në bazë të Kodit të Punës, nëpërmjet VKM-së nr. 23, datë 13.01.2022, SHSSH nuk ka miratuar një procedurë të shkruar për rekrutimin e punonjësve. Kjo situatë është në kundërshtim me nenet 20 dhe 22 të Ligjit "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, dhe pikat 3.1 dhe 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungesa e një procedure të miratuar cenon standardizimin e procesit të rekrutimit dhe gjurmën e auditimit për këtë proces.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
8.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një procedure të shkruar për rekrutimin e punonjësve, me qëllim standardizimin e procesit të rekrutimit.

Brenda vitit 2026

9. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:
a. Rregullorja e brendshme e SHSSH-së, e miratuar nëpërmjet Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 856 prot., datë 30.05.2020, ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorive përkatëse, por nuk ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorëve pjesë të tyre, si dhe të punonjësve specifikë (drejtori i drejtorisë, përgjegjësit e sektorit dhe specialistët), në mospërputhje me pikën 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Gjithashtu, kjo rregullore nuk është përditësuar me ndryshimet e strukturës në vitet pasuese.
b. SHSSH ka miratuar Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorive Rajonale të SHSSH nr. 353 prot., datë 13.02.2017. Në Kreun X të kësaj rregullore përcaktohet struktura organizative e DR SHSSH, si dhe detyrat për punonjësit e Sektorit të Shërbimeve Shoqërore dhe Sektorit të Pranueshmërisë në DR SHSSH, por nuk ka asnjë përcaktim mbi Sektorët për Vlerësimin Biopsikosocial ose Sektorët për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar (sipas rastit pasi DRSHSSH të ndryshme kanë sektorë të ndryshëm), të përcaktuar në strukturat organizative të Drejtorive Rajonale sipas Urdhrave përkatës të Kryeministrit. Kjo rregullore nuk rezulton të ketë pësuar ndryshime që nga miratimi fillestar, pavarësisht hyrjes në fuqi të akteve ligjore/ nënligjore të reja dhe/ ose përditësimit të akteve ekzistuese. Gjithashtu, me ndryshimet e miratuara nëpërmjet VKM-së nr. 855, datë 26.12.2024, në VKM-në nr. 597, datë

04.09.2019, është shtuar detyrimi që Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, për familjet që aplikojnë për herë të parë për ndihmë ekonomike, të kryejë verifikimin në terren pas vlerësimit social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Ky detyrim nuk rezulton të jetë reflektuar dhe detajuar në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorive Rajonale të SHSSH-së.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
9.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për hartimin dhe propozimin për miratim pranë MSHMS-së të Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të SHSSH-së, ku të reflektohen ndryshimet e pësuara ndër vite në strukturë, fushën që mbulojnë sektorët përkatës, si dhe detyrat e funksionet e punonjësve specifikë.

Brenda vitit 2026

9.2 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për rishikimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorive Rajonale të SHSSH-së, ku të reflektohen detyrat dhe përgjegjësitë e njësive dhe punonjësve të strukturave rajonale, të përcaktuara në kuadrin rregullator pas vitit 2017.

Brenda vitit 2026

10. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Shërbimi Social Shtetëror nuk ka ngritur dhe vënë në funksionim në mënyrë të plotë komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe aktet nënligjore përkatëse. Konkretisht:
a. Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 335, datë 22.10.2024, është ngritur grupi i punës për hartimin e treguesve kryesorë të riskut të sistemeve elektronike të ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror. Megjithëse dokumenti identifikon risqet që burojnë nga këto sisteme, ai nuk është hartuar sipas formatit të regjistrit të riskut të përcaktuar në Aneksin II të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016, pasi nuk përmban nivelin e riskut para kontrollit, kontrollet ekzistuese, nivelin e riskut pas kontrolleve, nevojën për kontrolle të mëtejshme, veprimet për adresimin e boshllëqeve dhe zotëruesit e risqeve, në kundërshtim me kërkesat e këtij udhëzimi.
b. Shërbimi Social Shtetëror nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmët e auditimit për proceset kryesore të lidhura me administrimin e skemës së ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kundërshtim me nenin 16, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe pikën 3.3.2 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Si pasojë, nuk garantohet dokumentimi i plotë i proceseve dhe gjurmueshmëria e veprimeve përgjatë hallkave përgjegjëse.
c. Në kuadër të monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, Shërbimi Social Shtetëror nuk ka hartuar, miratuar dhe paraqitur pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën e cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe raportin vjetor mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenet 18 dhe 24, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, pikën 3.5 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 2, datë 26.01.2024.
Mangësitë e mësipërme tregojnë se komponentët kryesorë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë, duke dobësuar procesin e identifikimit dhe administrimit të risqeve, dokumentimin e proceseve kryesore dhe monitorimin periodik të efektivitetit të kontrollit të brendshëm.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
10.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, koordinatorin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, koordinatorin e riskut dhe drejtuesit e strukturave përgjegjëse, të marrë masa për plotësimin dhe funksionalizimin e komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke:
a. hartuar dhe administruar regjistrat e riskut, përfshirë risqet që lidhen me sistemet elektronike të SHSSH-së, sipas formatit dhe elementëve të përcaktuar në legjislacionin në fuqi;
b. hartuar dhe miratuar gjurmët e auditimit për proceset kryesore të administrimit të skemës së ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
c. hartuar, miratuar dhe paraqitur, sipas afateve ligjore, pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën e cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe raportin vjetor mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Brenda vitit 2026 dhe në vijimësi

11. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Shërbimit Social Shtetëror u konstatua se:
a. Njësia e Auditit të Brendshëm mbulon me auditim Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH-së, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe institucionet e përkujdesit shoqëror në varësi të saj. Nga analiza e planeve fillestare dhe e ndryshimeve të tyre u evidentuan mangësi në mbulimin me auditim të drejtorive të Drejtorisë së Përgjithshme. Aktiviteti i Drejtorisë së Financës dhe Statistikës është audituar për herë të fundit në vitin 2021. Edhe pse auditimi i saj ishte planifikuar fillimisht edhe në vitet 2022, 2023 dhe 2025, në të gjitha rastet ai u hoq nga plani gjatë rishikimit vjetor dhe nuk u realizua. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtoria e Pagesave NE & PAK janë audituar për herë të fundit në vitin 2020 dhe nuk janë planifikuar më për auditim gjatë viteve 2021–2025. Auditimi i Drejtorisë së Komisionimit të PAK ishte planifikuar vetëm në vitin 2020, por u hoq nga plani gjatë rishikimit të tij dhe nuk u përfshi më në planet vjetore të auditimit. Gjithashtu, aktiviteti i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale nuk rezultoi të ishte planifikuar për auditim në asnjë prej planeve vjetore gjatë periudhës së auditimit.
b. Njësia e Auditit të Brendshëm pranë SHSSH-së nuk ka identifikuar si fusha me risk, nuk ka planifikuar dhe realizuar asnjëherë përgjatë periudhës së auditimit një angazhim auditimi mbi përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit për ndihmën ekonomike dhe veprimtarinë e zbatimit të legjislacionit në njësitë dhe institucionet në varësi të SHSSH-së dhe pranë pushtetit vendor sa i përket ndihmës ekonomike, në mospërputhje me pikën 1 të Metodologjisë së Kontrollit të Pagesave të Ndihmës Ekonomike, të miratuar nëpërmjet VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
11.1 Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm pranë Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për planifikimin dhe realizimin e angazhimeve të auditimit të përputhshmërisë (i) në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH-së, si dhe (ii) mbi përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit për ndihmën ekonomike.

Për vitin 2027 dhe në vijimësi

12. Gjetja nga auditimi: Nga verifikimi i procesit të planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve kapitale për vitin 2025 në SHSSH, rezultoi se institucioni nuk është përfshirë në mënyrë të plotë në fazat e PBA-së për planifikimin e investimeve. Konkretisht, në Fazën I dhe Fazën II të PBA 2025–2027, nga SHSSH nuk janë paraqitur kërkesa dhe detajime për shpenzime kapitale (llogaria 231), ndërkohë që në të njëjtat faza nga MSHMS janë parashikuar fonde për investime në vlerën totale 142,020,000 lekë për produkte specifike (rikonstruksione, projekte IPA, asistencë teknike). Në vijim, në Fazën III të PBA-së dhe në kërkesat buxhetore për programin 10430 nuk rezulton të jenë bërë parashikime as nga MSHMS për shpenzime

kapitale, pavarësisht parashikimeve në fazat e para, duke evidentuar mungesë koherence dhe vazhdimësie në planifikim.
Nga ana tjetër, gjatë zbatimit të buxhetit është çelur dhe realizuar projekti me kod 19AB001 "Blerje pajisje për SHSSH" në shumën 4,126,680 lekë, i cili nuk ka qenë i parashikuar në Fazën I dhe II të PBA-së, por është përfshirë në fazë të mëvonshme përmes formularit F3, i hartuar në një afat të shkurtër para fillimit të zbatimit, duke reflektuar një proces konceptimi formal dhe jo të mbështetur në analizë të plotë paraprake, veprim në kundërshtim me fazat e përcaktuara në Aneksin nr.1, të VKM nr. 887/2024 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", të ndryshuar.
Si pasojë, planifikimi i investimeve kapitale rezulton jo i qëndrueshëm dhe jo i besueshëm, duke sjellë mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe realizimit, përfshirje të projekteve në faza të vona të buxhetimit dhe rritje të riskut për përdorim joefektiv dhe jo transparent të fondeve publike. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 33-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
12.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me MSHMS, të marrë masa për përfshirjen e plotë dhe në kohë të projekteve të investimeve kapitale në të gjitha fazat e PBA-së (Faza I, II dhe III), duke siguruar paraqitjen e kërkesave të argumentuara dhe të shoqëruara me dokumentacionin përkatës (F3 dhe analizat mbështetëse), me qëllim garantimin e një planifikimi të qëndrueshëm, koherent dhe të besueshëm të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i procesit të planifikimit të fondeve për skemat e Ndihmës Ekonomike (NE) dhe Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK) rezultoi se metodologjia e përdorur për planifikimin e fondeve vijon të mbështetet në udhëzime dhe instrumente metodologjike të paazhornuara, të cilat referojnë kuadrin ligjor të vitit 2014, ndërkohë që baza ligjore dhe nënligjore në fuqi për përcaktimin e masës dhe kritereve të përfitimit ka pësuar ndryshime të vazhdueshme. Nga dokumentacioni i administruar gjatë auditimit nuk rezulton që nga Shërbimi Social Shtetëror të jenë ndërmarrë masa për rishikimin dhe përditësimin e metodologjisë, si dhe nuk u administruan dokumente apo korrespondencë që të evidentojnë kërkesa formale për përditësimin e saj. Për pasojë, planifikimi buxhetor për skemat NE dhe PAK ka pësuar ndryshime të konsiderueshme në të gjitha fazat e procesit buxhetor. Konkretisht, për skemën e Ndihmës Ekonomike, në Fazën II të PBA-së janë planifikuar 58,682 përfitues me fond 5,983,239 mijë lekë, ndërsa në Fazën III planifikimi është rritur në 62,000 përfitues me fond 7,232,000 mijë lekë. Gjatë zbatimit të buxhetit, nëpërmjet planit operativ fondi u planifikua në shumën 5,392,220 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik rezultoi 5,309,265 mijë lekë për 50,631 përfitues.
Për skemën e Personave me Aftësi të Kufizuar, në Fazën II të PBA-së janë planifikuar 170,634 përfitues me fond 18,807,753 mijë lekë, ndërsa në Fazën III planifikimi ndryshoi në 92,000 përfitues me fond 15,238,000 mijë lekë. Gjatë zbatimit të buxhetit, plani operativ rezultoi 18,696,948 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik ishte 18,603,925 mijë lekë për 76,586 përfitues.
Sa më sipër, evidentohet se metodologjia e paazhornuar nuk reflekton faktorët aktualë që ndikojnë në përllogaritjen e nevojave buxhetore dhe nuk mbështet një planifikim të bazuar në të dhëna reale, në kundërshtim me Hapin 3 "Formulimi i produkteve", pikat 3.2 dhe 3.3, të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", sipas të cilit kërkohet përcaktimi i saktë i sasisë së synuar dhe kostos për njësi për çdo produkt. Si rrjedhojë, janë krijuar devijime të konsiderueshme ndërmjet planifikimit dhe realizimit të fondeve, janë imponuar rishikime të vazhdueshme gjatë vitit buxhetor dhe është ulur besueshmëria e procesit të planifikimit të fondeve për skemat NE dhe PAK. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 33-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

13.1 Rekomandimi: Titullari i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për rishikimin dhe përditësimin e metodologjisë së planifikimit të fondeve për skemat e Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi të Kufizuar, duke reflektuar ndryshimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, si dhe ta përcjellë atë për miratim pranë Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në vijim, planifikimi i fondeve të bazohet në analiza të dokumentuara mbi numrin e përfituesve, dinamikën e skemave, kostot reale dhe faktorët që ndikojnë në përllogaritjen e nevojave buxhetore, me qëllim rritjen e saktësisë së planifikimit dhe minimizimin e devijimeve ndërmjet Programit Buxhetor Afatmesëm, planit vjetor, planit operativ dhe realizimit faktik të fondeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i procesit të planifikimit dhe analizës së realizimit të fondeve për skemat e Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi të Kufizuar, konstatohet se në fund të vitit buxhetor është miratuar mbështetje financiare shtesë në zbatim të VKM nr. 385, datë 30.12.2025 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta, për vitin 2025", efekti i së cilës është përfshirë në realizimin faktik të fondeve për skemat NE dhe PAK. Përfshirja në realizim e një elementi të paparashikuar dhe të pa lidhur me metodologjinë e përcaktimit të produkteve dhe kostove përkatëse deformon analizën plan–fakt, duke e bërë atë jo të krahasueshme dhe jo reale, në kundërshtim me pikën 4, nënpika 1, dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Qeverisjes Qendrore", sipas të cilit monitorimi duhet të bazohet në krahasimin e treguesve të planifikuar me realizimin faktik dhe në vlerësimin e performancës mbi tregues të matshëm dhe të krahasueshëm. Për rrjedhojë, paraqitet një nivel i shtrembëruar i realizimit dhe vështirësohet vlerësimi i saktë i performancës buxhetore. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 33-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

14.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në analizën e realizimit të fondeve për NE dhe PAK, të sigurojë trajtimin dhe raportimin e veçuar të mbështetjeve financiare të miratuara me VKM gjatë vitit buxhetor, me qëllim ruajtjen e krahasueshmërisë plan – fakt dhe paraqitjen reale të performancës buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të buxhetit për programin 10430 "Përkujdesje Sociale", rezultoi se nga ana e Shërbimit Social Shtetëror nuk hartohen dhe nuk paraqiten raporte monitorimi mbi zbatimin e buxhetit dhe treguesve të performancës dhe pse është institucioni përgjegjës për zbatimin e skemave të Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi të Kufizuar PAK, të përfshira në këtë program, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 20 dhe 21 të Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023, sipas të cilave drejtuesit dhe strukturat përgjegjëse të programeve kanë detyrimin për monitorimin e objektivave dhe produkteve buxhetore, si dhe për përgatitjen e raporteve të monitorimit në kohë dhe sipas standardeve të përcaktuara, si dhe me pikën 26 të po këtij udhëzimi, e cila ngarkon njësitë zbatuese me përgjegjësinë për raportimin periodik të realizimit të buxhetit dhe të treguesve përkatës. Megjithëse informacioni mbi realizimin përfshihet në raportet e monitorimit të ministrisë së linjës, mungesa e raportimit të drejtpërdrejtë nga institucioni zbatues cenon procesin e monitorimit, duke mos siguruar analizë të plotë dhe të besueshme të performancës së programeve, si dhe duke dobësuar mekanizmat e kontrollit dhe vendimmarrjes menaxheriale. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 33-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

15.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtori i Drejtorisë së Financës të marrin masa për organizimin dhe zbatimin e procesit të monitorimit të buxhetit, nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes periodike të raporteve të monitorimit, tek

MSHMS për programin 10430, me qëllim analizimin e devijimeve plan–fakt, ndjekjen e treguesve të performancës dhe paraqitjen reale të realizimit të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi verifikimin e alokimeve, rialokimeve dhe ndryshimeve që ka pësuar buxheti i Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2025, rezultoi se, megjithëse skemat e Ndihmës Ekonomike (NE) dhe Pagesave për Aftësinë e Kufizuar (PAK) janë pjesë e planifikimit fillestar buxhetor, gjatë zbatimit të buxhetit janë evidentuar ndryshime të konsiderueshme në shpërndarjen e fondeve dhe transferta për mbulimin e detyrimeve të krijuara gjatë vitit, si fondet për pagesën e vendimeve gjyqësore dhe mbështetjen financiare për kategori të veçanta, të cilat nuk janë parashikuar në mënyrë të plotë në fazën e planifikimit fillestar. Gjithashtu, në lidhje me investimet, rezulton se plani i investimeve ka pësuar ndryshime gjatë vitit buxhetor, duke reflektuar rishpërndarje dhe pakësime fondesh për projekte në sektorin social, ndërkohë që njëkohësisht janë kërkuar detajime dhe përgatitje dokumentacioni për projekte investimi gjatë fazës së zbatimit të buxhetit, çka tregon mungesë të një planifikimi të plotë dhe të qëndrueshëm në fazat paraprake. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultojnë raste ku mungon relacioni argumentues dhe analiza financiare që duhet të shoqërojë këto ndryshime dhe rishpërndarje fondesh. Veprime këto në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 9 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe me VKM nr. 887, datë 27.12.2022 "*Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike*", i ndryshuar, konkretisht me pikën 6, shkronja "c", pikën 8 dhe Aneksin 1 të tij. Për rrjedhojë, këto mangësi tregojnë dobësi në procesin e planifikimit buxhetor dhe në menaxhimin e ndryshimeve gjatë zbatimit të tij, duke rritur riskun për përdorim joefektiv dhe jo transparent të fondeve publike. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 33-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

16.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucion epror, të marrin masa për të siguruar që çdo ndryshim, rialokim apo rishpërndarje fondesh gjatë zbatimit të buxhetit, të jetë i shoqëruar me argumentimin përkatës dhe dokumentacionin mbështetës, në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe të sigurojnë administrimin, dokumentimin dhe arkivimin e plotë edhe në SHSSH të këtij argumentimi, si dhe përmirësimin e procesit të planifikimit dhe raportimit buxhetor, me qëllim rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe përdorimit efektiv të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se formula e pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe koeficientët e saj nuk rezulton të jenë rishikuar mbi baza të dhënash të përditësuara, pavarësisht kalimit të një periudhe afro 10-vjeçare nga miratimi i formulës së unifikuar të pikëzimit me VKM nr. 956, datë 07.12.2016, shfuqizimit të Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "*Për ndihmën shoqërore*", i ndryshuar, mbi të cilin VKM-ja bazohej, si dhe ndryshimeve të profilit të varfërisë, strukturës së shpenzimeve familjare dhe karakteristikave të popullsisë në nevojë. Gjithashtu, koeficientët e formulës nuk janë bërë publikë, duke kufizuar mundësinë e vlerësimit të mënyrës së funksionimit të sistemit të pikëzimit dhe nivelit të transparencës së procesit të përzgjedhjes së përfituesve.

Sipas pikës 3 të VKM-së nr. 956, datë 07.12.2016 "*Për përcaktimin e kritereve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike*", përditësimi i formulës së unifikuar të pikëzimit propozohet nga ministria përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, në varësi të ndryshimeve të nivelit të varfërisë në vend, të publikuara nga INSTAT, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Duke qenë se ndryshimet socio-ekonomike dhe të dhënat statistikore do të duhej të shoqëroheshin me një rishikim metodologjik të formulës së pikëzimit, konstatohet se nga

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, nuk janë ndërmarrë veprimet për hartimin dhe propozimin e përditësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit, për t'u miratuar më pas me vendim të Këshillit të Ministrave, duke krijuar risk për cenimin e efektivitetit të shënjestrimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe rritjen e gabimeve të përfshirjes dhe përjashtimit nga skema.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 69-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
17.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masa për ngritjen e një grupi pune ndërinstitucional për rishikimin e plotë metodologjik të formulës së unifikuar të pikëzimit, duke u mbështetur në të dhëna të përditësuara mbi profilin e varfërisë, strukturën e konsumit familjar dhe karakteristikat aktuale socio-ekonomike të popullsisë në nevojë. Në kuadër të këtij procesi, të vlerësohet përshtatshmëria e indikatorëve ekzistues, rivlerësimi i koeficientëve dhe peshat relative të tyre, si dhe të sigurohet një nivel i arsyeshëm transparence mbi strukturën e formulës së pikëzimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të shënjestrimit të skemës, reduktimin e gabimeve të përfshirjes dhe përjashtimit, si dhe forcimin e besimit publik në procesin e vlerësimit të përfitueshmërisë.
Brenda vitit 2026

18. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se formulari i aplikimit për ndihmë ekonomike, i përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 "*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike*", i ndryshuar, vijon të përfshijë në deklarimin e aseteve familjare pajisje që praktikisht kanë dalë nga përdorimi ose nuk përbëjnë më tregues domethënës të gjendjes ekonomike të familjes, si TV pa ngjyra, video/DVD player, magnetofon/CD player dhe kamera/videokamera, apo pajisje që, në kushtet aktuale socio-ekonomike, konsiderohen pjesë e pajisjeve bazike të familjes, si televizori me ngjyra, frigoriferi, lavatriçja dhe soba për ngrohje, të cilat nuk përbëjnë domosdoshmërisht indikatorë të besueshëm të nivelit të mirëqenies.
Gjithashtu, në pikën 20 të formularit, ku deklarohen asetet familjare, për kategoritë "makinë/veturë", "kamion" dhe "makinë dumdum" kërkohet vetëm deklarimi i zotërimit të mjetit me përgjigje "po/jo", pa mundësuar deklarimin e numrit të mjeteve në pronësi të familjes dhe duke kufizuar mbledhjen e informacionit të plotë mbi asetet familjare, në kundërshtim me Kreun II, pika 1, gërma a.III, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar, njëherazi duke kufizuar cilësinë e të dhënave që shërbejnë për vlerësimin e gjendjes socio-ekonomike të aplikantëve.
Mosreflektimi në formularin e aplikimit i ndryshimeve në strukturën e aseteve familjare, përfshirja e treguesve që nuk përbëjnë më indikatorë domethënës të nivelit të mirëqenies, si dhe mungesa e informacionit të detajuar mbi automjetet në pronësi, krijojnë risk që vlerësimi socio-ekonomik i aplikantëve të mos pasqyrojë në mënyrë të plotë gjendjen reale ekonomike të familjeve, duke ndikuar në saktësinë e shënjestrimit të individëve dhe familjeve në nevojë dhe, për rrjedhojë, në arritjen e qëllimit të skemës së ndihmës ekonomike, të përcaktuar në nenin 2 të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 69-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
18.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të Pagesave NE & PAK, të marrin masa për hartimin dhe propozimin e ndryshimeve në formularin e aplikimit për ndihmë ekonomike, duke synuar përditësimin e listës së aseteve familjare në përputhje me realitetin socio-ekonomik dhe standardet bashkëkohore të vlerësimit të mirëqenies së familjeve, duke përfshirë, por pa u kufizuar:

- heqjen nga formulari të pajisjeve praktikisht të dala nga përdorimi ose me fuqi të ulët diskriminuese në vlerësimin e gjendjes ekonomike të familjeve;

- rishikimin e trajtimit të pajisjeve bazike shtëpiake që nuk përbëjnë më tregues domethënës të nivelit të mirëqenies;
- plotësimin e formularit me elementë që mundësojnë deklarimin e numrit të mjeteve në pronësi të anëtarëve të familjes sipas kategorive përkatëse, me qëllim rritjen e saktësisë së vlerësimit të gjendjes ekonomike dhe përmirësimin e efektivitetit të shënjestrimit të skemës së ndihmës ekonomike.

Brenda vitit 2026

19. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, masa e ndihmës ekonomike *nuk është indeksuar* nga Shërbimi Social Shtetëror asnjëherë që pas vitit 2022, në kundërshtim me Kreun III, pika 2, të VKM-së nr. 598, datë 04.09.2019 "*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike*", i ndryshuar, ku përcaktohet se masa e ndihmës ekonomike indeksohet nga Shërbimi Social Shtetëror sa herë indeksohet pensioni social dhe në bazë të këtij indeksi. Që pas vitit 2022, pensioni social që duhet të përdoret për referencë është indeksuar në masën 8.6% në vitin 2023, në masën 4.1% në vitin 2024 dhe në masën 2.5% në vitin 2025. Mungesa e përditësimit të masave me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 57/2019, si dhe të indeksimit të masës së përfitimit nga ndihma ekonomike, sipas përcaktimeve ligjore, sjell në terma realë uljen e fuqisë blerëse të përfitimit, duke dobësuar efektivitetin social të skemës. Kjo situatë krijon risk për humbjen e funksionit mbrojtës të skemës së ndihmës ekonomike, rritjen e ekspozimit të familjeve në nevojë ndaj varfërisë dhe cënimin e koherencës së politikës sociale, pasi mekanizmi i indeksimit është parashikuar pikërisht për të ruajtur vlerën reale të përfitimit në kohë.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 69-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
19.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masat për inicimin e procedurave për përditësimin e masës së ndihmës ekonomike, në reflektim të indeksimeve të pensionit social të kryera për vitet 2023 – 2025, si dhe të sigurojë ndjekjen periodike të indeksimeve të ardhshme të pensionit social me qëllim reflektimin e tyre në kohë në masën e përfitimit të ndihmës ekonomike, për të garantuar efektivitetin social të skemës.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të Shërbimit Social Shtetëror lidhur me verifikimet social ekonomike në banesë të kryera u konstatua se:
a. Nga analiza e të dhënave të vëna në dispozicion nga Shërbimi Social Shtetëror rezulton se, gjatë periudhës 2020–2023 dhe në vitin 2025, verifikimet në banesë të realizuara nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së kanë mbuluar një përqindje shumë të kufizuar të familjeve përfituese nga ndihma ekonomike, duke variuar nga rreth 1.55% në vitin 2020 në rreth 5.45% në vitin 2023 dhe 6.7% në vitin 2025. Përjashtim përbën vetëm viti 2024, gjatë të cilit, si rezultat i angazhimit të Task-Forcës së ngritur me Urdhrin e MSHMS-së nr. 46, datë 30.01.2024, u realizuan verifikime në banesë për rreth 88% të përfituesve në nivel kombëtar, **ku nga verifikimet e kryera rezultoi se rreth 5% e familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike nuk plotësojnë kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike**. Këto të dhëna tregojnë se, jashtë ndërhyrjes së përkohshme të Task-Forcës në vitin 2024, verifikimet social-ekonomike në banesë nuk kanë siguruar një mbulim sistematik të përfituesve të skemës, duke kufizuar efektivitetin e kontrollit mbi përputhshmërinë e vetëdeklarimit me gjendjen faktike të familjeve. Shërbimi Social Shtetëror nuk ka përcaktuar objektiva minimalë mbulimi sa i përket verifikimeve socio-ekonomike në banesë për familjet përfituese nga ndihma ekonomike, për të garantuar një mbulim të qëndrueshëm dhe të planifikuar në kohë të verifikimeve në terren nga Drejtoritë Rajonale, të bazuar në analizë risku dhe prioritizim të rasteve me probabilitet më të lartë mospërputhjeje ndërmjet vetëdeklarimit dhe gjendjes faktike të familjeve.

b. Pas rezultateve të Task-Forcës së vitit 2024, nëpërmjet VKM-së nr. 855, datë 26.12.2024, u ndryshua VKM nr. 597, datë 04.09.2019, duke shtuar në Kreun II, pika 2.1 detyrimin për Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror për kryerjen e verifikimit në terren për familjet që aplikojnë për herë të parë, pas vlerësimit social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Ky detyrim nuk rezulton të jetë reflektuar në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorive Rajonale të SHSSH-së nr. 353 prot., datë 13.02.2017, si dhe nuk rezulton të jetë miratuar ndonjë akt tjetër udhëzues që të përcaktojë afatet dhe mënyrën e realizimit të këtij verifikimi. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave për NE & PAK rezulton se, gjatë vitit 2025, vizitat në terren për familjet që kanë aplikuar për herë të parë nuk janë realizuar plotësisht nga disa Drejtori Rajonale të SHSSH-së, ku niveli i mbulimit paraqitet i kufizuar (p.sh. DR SHSSH Elbasan 4 nga 140 raste, Korçë 11 nga 125 raste, Kukës 32 nga 112 raste, Shkodër 7 nga 59 raste dhe Tiranë 12 nga 41 raste), në mospërputhje me kërkesat e Kreut II, pika 2.1, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar. Kjo situatë tregon se, pavarësisht forcimit të kuadrit rregullator pas vitit 2024, zbatimi në praktikë i verifikimit në terren për aplikimet për herë të parë nuk ka qenë i plotë, duke kufizuar efektivitetin e kontrollit paraprak mbi saktësinë e vetëdeklarimit dhe duke rritur rrezikun e përfshirjes në skemë të familjeve që nuk plotësojnë kriteret për përfitim.
c. Nga intervistat e zhvilluara në Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së u evidentua si problematikë mungesa e automjeteve për realizimin e kontrolleve në terren/ vizitave në shtëpi. Nga auditimi u konstatua se Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së nuk disponojnë automjete ose i kanë në gjendje jofunksionale apo të amortizuara. Mungesa e automjeteve pamundëson përmbushjen e këtyre detyrave, sidomos sa i përket verifikimeve në terren për NE dhe PAK, të cilat shpeshherë ndodhen edhe në zona rurale që nuk mbulohen me shërbim transporti publik. Përgjatë muajit shtator 2025, Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së Gjirokastër, Shkodër, Dibër, Vlorë, Elbasan, Kukës, Durrës dhe Lezhë i janë drejtuar Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, duke kërkuar marrjen me qira të automjeteve, për mbarëvajtjen optimale të veprimtarisë së punës së përditshme të Drejtorive Rajonale.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 69-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
20.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të Pagesave NE & PAK, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një plani vjetor të strukturuar verifikimesh social-ekonomike në banesë për familjet përfituese nga ndihma ekonomike, duke përcaktuar objektiva minimalë mbulimi në nivel kombëtar dhe rajonal, bazuar në analizë risku dhe në prioritizimin e rasteve me probabilitet më të lartë mospërputhjeje ndërmjet vetëdeklarimit dhe gjendjes faktike, me qëllim forcimin e kontrollit të vazhdueshëm mbi përputhshmërinë e përfitueshmërisë në skemë.

Për 6-mujorin e dytë të vitit 2026 dhe në vijimësi

20.2 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të Pagesave NE & PAK, të marrin masa për garantimin e mekanizmave të ndjekjes periodike të nivelit të realizimit të verifikimeve në terren për aplikuesit për herë të parë, me qëllim zbatimin e njëtrajtshëm të procedurave të kontrollit paraprak dhe reduktimin e riskut të përfshirjes në skemë të familjeve që nuk plotësojnë kriteret për përfitim.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.3 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për mbledhjen e kërkesave nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së, për të mundësuar planifikimin dhe realizimin e procedurave përkatëse për disponimin e mjeteve të nevojshme për kryerjen e detyrave funksionale nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së.

Menjëherë

21. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të kontrollit të zbatuara nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së për monitorimin e tërheqjes së pagesave të ndihmës ekonomike brenda afatit 10-ditor dhe verifikimin e tërheqjes së tyre nga personat e autorizuar, u konstatua se:
a. pavarësisht se neni 11, gërma b, i VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, përcakton se përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë gjashtëmujore, familjet që nuk tërheqin ndihmën ekonomike brenda 10 ditëve pune nga dita e depozitimit në llogarinë bankare/ kryerjes së pagesave nga Posta Shqiptare sh.a, nga auditimi rezulton se rakordimi bëhet vetëm me postën, pasi banka nuk e ofron si informacion, duke e konsideruar si ruajtje të konfidencialitetit. Në këtë mënyrë, nga ana e SHSSH-së nuk aplikohet asnjë kontroll mbi përfituesit e ndihmës ekonomike që e tërheqin pagesën nga bankat e nivelit të dytë, sa i përket tërheqjes së pagesave brenda afatit 10-ditor dhe nga personat e autorizuar.
b. Nga shqyrtimi i raporteve të kontrollit të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, rezultoi se kontrollet e kryera për monitorimin e tërheqjes së pagesave të ndihmës ekonomike brenda afatit 10-ditor dhe verifikimin e tërheqjes së tyre nga personat e autorizuar nuk janë dokumentuar në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme. Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve nuk evidentohet kryerja e verifikimeve për respektimin e afatit 10-ditor të tërheqjes së pagesës dhe identifikimin e personit që ka kryer tërheqjen, ndërsa në raste të tjera dokumentacioni mbështetës nuk është vënë në dispozicion ose nuk disponohet nga strukturat përgjegjëse për kontroll. Për pasojë, nuk sigurohet gjurmë e mjaftueshme auditimi për të provuar ushtrimin efektiv të kontrolleve, duke pamundësuar (i) identifikimin dhe përjashtimin nga skema të rasteve kur ndihma ekonomike nuk tërhiqet brenda afatit ligjor pa shkaqe të arsyeshme, si dhe (ii) garantimin se pagesat tërhiqen nga personat e autorizuar me ligj.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 69-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
21.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të Pagesave të NE & PAK dhe Drejtuesit e Drejtorive Rajonale të SHSSH-së, të marrin masa për analizimin dhe pasqyrimin e situatës aktuale që lidhet me pamundësinë e verifikimit të tërheqjes së pagesave të ndihmës ekonomike pranë bankave të nivelit të dytë dhe referimin e situatës pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me qëllim ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për sigurimin e mekanizmave funksionalë të shkëmbimit të informacionit dhe ushtrimin efektiv të kontrollit mbi tërheqjen e pagesave nga personat e autorizuar brenda afatit 10-ditor.

Brenda vitit 2026

21.2 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK dhe Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së, për hartimin e një udhëzuesi të brendshëm operacional, për t'u zbatuar nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së, me qëllim garantimin e një qasjeje të njëtrajtshme në ushtrimin e kontrollit lidhur me verifikimin e tërheqjes së pagesave të ndihmës ekonomike nga personat e autorizuar me ligj dhe brenda afatit 10-ditor, duke përcaktuar procedurat standarde të verifikimit, kërkesat minimale të dokumentimit dhe format e raportimit të rezultateve të kontrollit.

Brenda vitit 2026

22. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në 13 nga 61 njësi të vetëqeverisjes vendore, përkatësisht në bashkitë Korçë, Pustec, Ersekë, Krujë, Kamëz, Rrogozhinë, Kavajë, Fushë Arrëz, Këlcyrë, Tepelenë, Gjirokastër, Memaliaj dhe Përmet, përfituesit nuk marrin vlerën e plotë të ndihmës ekonomike, pasi duhet t'u nënshtrohen tarifave apo komisioneve postare për shërbimin e pagesës, tarifa të cilat duhet të përballohen nga njësitë vendore referuar Kreut II, pika 13, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 "*Për përcaktimin e procedurave, të*

dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". Kjo problematikë lidhej me mungesën ose përmbajtjen e akt-marrëveshjeve të lidhura ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe operatorit postar, pasi në disa raste akt-marrëveshjet mungonin, ndërsa në disa të tjera nuk parashikohej që tarifa e shërbimit postar të përballohej nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

- Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së Durrës dhe Shkodër e kanë evidentuar dhe trajtuar këtë problematikë gjatë kontrolleve të ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore nën juridiksionin e tyre, duke lënë rekomandimet përkatëse për marrjen e masave korrigjuese;
- Drejtoria Rajonale e SHSSH-së Tiranë ka evidentuar nevojën për rishikimin e akt-marrëveshjeve ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe operatorit postar, por nuk ka evidentuar në raportet e kontrollit faktin se tarifa e shërbimit postar vijon të mbahet nga përfituesit e ndihmës ekonomike, në vend që të përballohet nga bashkitë, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së Korçë dhe Gjirokastër nuk rezulton ta kenë evidentuar këtë parregullsi gjatë kontrolleve të ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore nën juridiksionin e tyre;
- Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK, gjatë kontrolleve të ushtruara mbi veprimtarinë e Drejtorive Rajonale të SHSSH-së, nuk ka evidentuar mangësitë në ushtrimin e kontrollit lidhur me praktikën e tarifimit të përfituesve të ndihmës ekonomike nga Drejtoritë Rajonale përkatëse, duke mos identifikuar moskonstatimin e kësaj parregullsie në njësitë e vetëqeverisjes vendore nën juridiksionin e tyre.

Praktika e tarifimit të përfituesve të ndihmës ekonomike, në kundërshtim me kërkesat e Kreut II, pika 13, të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, nuk është evidentuar dhe adresuar në mënyrë të njëtrajtshme nga strukturat përgjegjëse të kontrollit, si në nivel rajonal ashtu edhe në nivel qendror. Kjo parregullsi ka vijuar të zbatohet në disa njësi të vetëqeverisjes vendore, si pasojë, përfituesit e ndihmës ekonomike nuk kanë përfituar vlerën e plotë të ndihmës ekonomike të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, pasi një pjesë e saj është reduktuar nëpërmjet tarifave/komisioneve të aplikuara për shërbimin postar, në kundërshtim me kërkesat e akteve nënligjore.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 69-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

22.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për analizimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për mosevidentimin e praktikave të tarifimit të përfituesve të ndihmës ekonomike në kundërshtim me përcaktimet ligjore, në kontrollet e ushtruara nga Drejtoritë Rajonale Korçë dhe Gjirokastër, si dhe mosidentifikimin e kësaj parregullsie nga strukturat përgjegjëse për kontrollin e pagesave në nivel qendror nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK, me qëllim forcimin e efektivitetit dhe njëtrajtshmërisë së kontrollit në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Menjëherë

22.2 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse, të marrë masa për propozimin e rishikimit të akt-marrëveshjeve me Postën Shqiptare, me qëllim garantimin e mbulimit të tarifës së shërbimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe sigurimin që përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike të marrin pagesën në vlerë të plotë, pa komisione/ tarifa të aplikuara ndaj tyre.

Menjëherë

23. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të VKM-së nr. 855, datë 26.12.2024, me të cilat u vendos detyrimi për paraqitjen dy herë në vit të vërtetimit të hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë për anëtarët madhorë të

familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, nga Shërbimi Social Shtetëror nuk rezulton të jetë miratuar një udhëzim i brendshëm për unifikimin e mënyrës së ushtrimit të kontrollit mbi këtë dokumentacion, në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, dhe pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Shërbimi Social Shtetëror nuk ka përcaktuar kriteret e vlerësimit të rasteve të mosparaqitjes ose paraqitjes së pjesshme të dokumentacionit, mënyra e dokumentimit të konstatimeve gjatë kontrollit, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së në trajtimin e këtyre rasteve. Duke qenë se dokumentacioni administrohet vetëm në format fizik pranë njësive të vetëqeverisjes vendore dhe metodologjia ekzistuese e kontrollit është miratuar përpara vendosjes së këtij detyrimi, mungesa e një kuadri të unifikuar operacional ka kufizuar njëtrajtshmërinë dhe efektivitetin e kontrolleve të ushtruara nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së.
Nga shqyrtimi i 12 raporteve të kontrollit të Drejtorive Rajonale të SHSSH-së për vitin 2025 rezulton se vetëm në 1 rast dokumentacioni rezulton i administruar dhe i verifikuar plotësisht (DR SHSSH Durrës); në 7 raste është konstatuar nga grupet e kontrollit se dokumentacioni nuk ishte administruar ose nuk ishte administruar i plotë në dosjet e përfituesve (DR SHSSH Berat, Elbasan, Fier, Korçë, Vlorë, Gjirokastër, Shkodër) dhe në 4 raste të tjera nuk rezulton të jetë përfshirë në objektin e kontrollit të ushtruar (DR SHSSH Dibër, Kukës, Lezhë, Tiranë).
Gjithashtu, në rastin e DR SHSSH Shkodër u konstatua se, megjithëse dokumentacioni rezulton të jetë administruar në dosjet e përfituesve, forma dhe përmbajtja e tij nuk kanë mundësuar kryerjen e një kontrolli efektiv të lëvizjeve të anëtarëve madhorë të familjes dhe marrjen e masave përkatëse, pasi dokumentacioni pasqyronte vetëm hyrje ose vetëm dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë, ose përmbante të dhëna të pjesshme dhe të paqarta që nuk lejonin rindërtimin e plotë të historikut të qëndrimit brenda ose jashtë vendit.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 69-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
23.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të Pagesave NE & PAK, të marrin masa për analizimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës lidhur me mosrealizimin e kontrolleve për verifikimin e administrimit të vërtetimit të hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë në katër Drejtori Rajonale të SHSSH-së, si dhe për marrjen e masave për sigurimin e përfshirjes sistematike të këtij elementi në objektin e kontrolleve të ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore;

Menjëherë dhe në vijimësi

23.2 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH-së, për hartimin e një udhëzuesi të brendshëm operacional që të përcaktojë mënyrën e verifikimit të administrimit dhe kontrollit të hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke standardizuar kriteret e vlerësimit të mospërmbushjes së këtij detyrimi, procedurat e dokumentimit të konstatimeve dhe mënyrën e trajtimit të rasteve të identifikuara, me qëllim garantimin e njëtrajtshmërisë së praktikës së kontrollit ndërmjet Drejtorive Rajonale dhe rritjen e efektivitetit të verifikimeve mbi deklarimet e përfituesve.

Brenda vitit 2026

24. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit të informacionit për Ndihmën Ekonomike, Shërbimet e Kujdesit Shoqëror dhe Personave me Aftësi të Kufizuar, u konstatua se aktualisht tre sistemet NE, PAK dhe SHKSH janë pa mirëmbajtje, në kundërshtim me Vendimin nr. 710, datë 21.08.2023, i ndryshuar *"Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* pika 2. Kontrata për mirëmbajtjen e sistemit të PAK ka përfunduar në datën 04.04.2024, ndërsa për mirëmbajtjen e sistemeve të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror ka përfunduar në datën 18.05.2025. Mungesa e

mirëmbajtjes së sistemeve paraqet risk të lartë për vazhdimësinë e punës dhe funksionimin normal të tyre, pasi rrit mundësinë e ndërprerjeve të shërbimit, mosadresimit dhe zgjidhjes në kohë të problemeve teknike, duke cenuar sigurinë e të dhënave, humbje të informacionit, si dhe pamundësi për përditësime dhe ndërhyrje emergjente në rast incidentesh. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 69-96, 159-173, 174-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

24.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me organin qendror blerës përkatës, të marrë masa për planifikimin dhe realizimin e procedurave përkatëse për të siguruar mirëmbajtjen e sistemeve të NE, PAK dhe SHKSH, me qëllim garantimin e funksionimit të plotë të sistemeve dhe ofrimin e pandërprerë të shërbimeve sociale.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi funksionalitetet, modulet dhe ndërveprimet e sistemeve elektronike është konstatuar se:

1. Pasi përfundon procesi i verifikimit automatik, i cili kryhet nëpërmjet sistemit të Ndihmës Ekonomike (NE) përmes ndërveprimit me sisteme të tjera, procesi kalon në fazën e trajtimit të *"mospërputhjeve"*. Megjithatë, pavarësisht emërtimit të tij, sistemi nuk identifikon në mënyrë automatike mospërputhjet, por vetëm paraqet rezultatet e kërkimeve të gjeneruara nga ndërveprimi me sisteme të tjera. Në praktikë, të gjitha të dhënat e përfituara nga këto ndërveprime shfaqen si "mospërputhje", ndërsa verifikuesi duhet të kryejë manualisht krahasimin e çdo rezultati me të dhënat e deklaruara në formularin e aplikimit, për secilin rast. Si rrjedhojë, edhe kur ekzistojnë mospërputhje reale, verifikuesi mund të vendosë manualisht pranimin e aplikimit dhe ta përcjellë atë për miratim te Drejtori Rajonal. Ky kontroll do të siguronte një nivel më të lartë garancie nëse do të realizohej automatikisht nga sistemi, ndërsa verifikuesi do të trajtonte vetëm rastet e evidentuara si mospërputhje. Në këto raste, ai do të mund të vlerësonte nëse bëhej fjalë për ndryshime të vogla jomateriale, që mund të justifikonin pranimin e aplikimit, apo për mosdeklarime ose ndryshime materiale, të cilat do të çonin në refuzimin e tij. Kjo problematikë nuk paraqitet vetëm gjatë fazës paraprake të verifikimit, por është e pranishme edhe në kontrollet pas-fakti që kryhen nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK.

2. Për sistemin e NE janë aktualisht të implementuara moduli i raporteve, moduli i integrimeve dhe verifikimeve me sisteme të tjera nëpërmjet ESB-së, moduli i gjurmimit të auditimeve, moduli i administrimit të sistemit, moduli i administrimit të ankimimeve, si dhe moduli i vlerësimit të analizës së riskut, i cili është i integruar në sistem, por ende nuk është funksional. Gjithashtu, me qëllim përmirësimin e proceseve të punës, është identifikuar si prioritet funksionalizimi i modulit të analizës së riskut. Në lidhje me ndërveprimin me sisteme të tjera, aktualisht janë të implementuara ndërlidhjet me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, Regjistrin Kombëtar të Bizneseve, Regjistrin e Tatimpaguesve (DPT), sistemin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Regjistrin Kombëtar të Mjeteve (sistemi i DPSHTRR-së), sistemin e AKPA-së, sistemin SMIP, portalin qeveritar e-Albania dhe sistemin e PAK. Ndërkohë, për sistemin e ASHK-së, ndërlidhja teknike është konfiguruar, por ndërveprimi i të dhënave nuk realizohet. Pavarësisht se mungesa e këtyre moduleve është evidentuar nga SHSSH-ja në përgjigjet e pyetësorit të hartuar nga grupi i auditimit, nuk është vënë në dispozicion asnjë korrespondencë e SHSSH-së me MSHMS-në apo AKSHI-n, ku SHSSH-ja të ketë relatuar të gjitha mangësitë në modulet e implementuara në sistemin e PAK-ut.

3. Raportet dhe të dhënat statistikore që gjeneron sistemi i PAK janë të kufizuara, veçanërisht në raport me treguesit statistikorë të kërkuar nga Udhëzimi nr. 122, datë 06.02.2026, i MSHMS-së, i cili ka hyrë në fuqi. Për pasojë, nxjerrja dhe përpunimi i këtyre të dhënave realizohen manualisht nga punonjësit e Drejtorive Rajonale dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH-së. Gjithashtu, grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të

SHSSH-së nr. 335, datë 22.10.2024, për hartimin e treguesve kryesorë të riskut në sistemet elektronike të ndihmës ekonomike, personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror, ka identifikuar si risk edhe gjenerimin e raporteve jo të sakta nga sistemi i PAK. Po ashtu, është konstatuar pamundësia e gjenerimit të borderosë përmbledhëse nga sistemi, për shkak të mungesës së konfigurimit të ndërlidhjes ndërmjet arkivës dhe skemës së vlerësimit biopsikosocial.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 69-96, 159-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
25.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrin masa për propozimin e përmirësimeve në lidhje me funksionalitetet, modulet, ndërveprimet dhe raportet e gjeneruara nga sistemet përkatëse, për të siguruar funksionimin e plotë dhe efektiv të sistemeve në të gjithë komponentët e tyre, në mënyrë që të përmbushet qëllimi i automatizimit të proceseve të punës të cilat mbështeten në këto sisteme.

Në vijimësi

26. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i kontrolleve të planifikuara dhe të realizuara nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së dhe krahasimi me faktin, konstatohet se evidentohen mangësi nga ana e Drejtorive Rajonale në ushtrimin e kontrollit të plotë periodik një herë në dy vite në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto mangësi lidhen me mosrealizimin e plotë të planeve të miratuara të kontrollit në Drejtoritë Rajonale Gjirokastër, Berat, Shkodër, Fier, Elbasan, Korçë, Tiranë, si dhe me mosplanifikimin e kontrollit për të gjitha njësitë përkatëse. Gjithashtu konstatohet se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH-së nuk janë ushtruar mekanizmat e duhur mbikëqyrës dhe koordinues për monitorimin e zbatimit të planeve të kontrollit nga Drejtoritë Rajonale si dhe për identifikimin dhe adresimin në kohë të problematikave që kanë ndikuar në mosrealizimin e kontrolleve të planifikuara. Sa më sipër bie në kundërshtim me VKM nr.257 datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*" pika 5, gërma b. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 69-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
26.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive Rajonale të SHSSH-së, të marrin masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe realizimit të kontrolleve periodike në njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke siguruar planifikimin e plotë brenda ciklit dyvjeçar të përcaktuar, monitorimin sistematik të zbatimit të planeve të miratuara të kontrollit, me qëllim garantimin e mbulimit të plotë territorial dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit mbi zbatimin e legjislacionit të asistencës sociale.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i aplikimeve të kryera në sistem dhe shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura nga Shërbimi Social Shtetëror, u konstatuan tre raste në të cilat administratorë të njësive vendore kanë aksesuar sistemin duke përdorur kredencialet e një administratori tjetër, me arsyetimin se llogaria e tyre e përdoruesit nuk ka qenë funksionale. Kjo praktikë cenon parimin e përdorimit individual të kredencialeve dhe ndarjes së roleve të përdoruesve, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", duke krijuar risk për përpunim të paautorizuar të të dhënave personale, humbje të gjurmueshmërisë së veprimeve në sistem dhe pamundësi për përcaktimin e përgjegjësisë individuale. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 97-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
27.1 Rekomandim: Strukturat përgjegjëse të SHSSH dhe Drejtorive Rajonale të marrin masa për forcimin e kontrollit të aksesit në sistemet e informacionit, duke garantuar respektimin e parimit të ndarjes së roleve dhe përdorimin individual të kredencialeve. Në rastet e

problematikave të sistemit, të kontaktohet Struktura Përgjegjëse pranë SHSSH duke shmangur përdorimin e user-it të një administratori tjetër.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi mbi vizitat në terren dhe verifikimin e periodicitetit të tyre nga ana e administratorëve shoqërorë, rezulton se ky detyrim nuk është respektuar në të gjitha rastet. Konkretisht, nga 100 aplikime të shqyrtuara, me kampionim të përfaqësuar nga të gjitha rajonet, në 53 raste nuk rezulton të jenë kryer vizitat në familje dy herë në vit. Moskryerja e vizitave në familje në frekuencën e përcaktuar është në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 "*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike*. Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së nuk ka siguruar një monitorim efektiv të zbatimit të këtij detyrimi, si dhe nuk ka adresuar në kohë mangësitë e konstatuara, duke mos ndërmarrë masa të mjaftueshme mbikëqyrëse për garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të kërkesave ligjore. Për rrjedhojë, mosrespektimi i këtij detyrimi cenon verifikimin e vazhdueshëm të gjendjes social-ekonomike të përfituesve, duke rritur rrezikun për përfitime të padrejta dhe duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e administrimit të skemës së ndihmës ekonomike. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 97-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

28.1 Rekomandimi: Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me administratorët shoqërorë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, të marrin masa për sigurimin e kryerjes së vizitave në familje sipas frekuencës së përcaktuar dhe dokumentimin e tyre në Regjistrin Elektronik Kombëtar, me qëllim garantimin e verifikimit të vazhdueshëm të gjendjes social-ekonomike të përfituesve dhe rritjen e saktësisë në administrimin e skemës së ndihmës ekonomike.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetja nga auditimi: Nga verifikimi në sistem i aplikimeve për periudhën objekt auditimi rezultoi se në aplikimin nr. NE-2023-018801, në emër të aplikantit A.R.H., janë konstatuar parregullsi në procesin e verifikimit dhe administrimit të të dhënave nga ana e drejtorive rajonale të Shërbimi Social Shtetëror. Konkretisht, aplikanti ka pasur një aplikim të mëparshëm nr. NE-2021-024015, i refuzuar më datë 27.04.2023 për shkak të ndërrimit të jetës së kryefamiljarit, fakt i evidentuar nga verifikimi në terren më datë 12.04.2023. Nga verifikimet automatike në sistem ka rezultuar se "*nuk ka lidhje me DPGJC*", duke treguar mungesë të ndërveprimit të plotë të sistemit me Regjistrin e Gjendjes Civile. Si rrjedhojë, sistemi nuk ka evidentuar në kohë ndryshimin e gjendjes civile dhe në deklarimin e ri nr. NE-2023-018801, datë 08.05.2023, aplikimi është kryer sërish në emër të kryefamiljarit të ndjerë dhe është regjistruar në sistem me status "*Draft*", ndonëse nuk duhej të lejohej regjistrimi i tij.
Nga verifikimi i këtij aplikimi evidentohet përfitim i kompensimit të energjisë elektrike për muajin korrik 2024 në shumën 1,288 lekë, pa qenë e qartë baza e këtij përfitimi.
Sa më sipër, kjo situatë është në kundërshtim me pikën 1/ç të nenit 15 dhe pikën 4, gërma "a" dhe "b", të nenit 20 të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe vjen si pasojë e mangësive në verifikimin e të dhënave, mungesës së integrimit të plotë të sistemit me Regjistrin e Gjendjes Civile dhe dobësive në kontrollin e brendshëm, duke krijuar risk për regjistrim të të dhënave të pasakta, përfitime të padrejta. Kjo problematikë nuk rezulton të jetë evidentuar në raportet e kontrolleve të ushtruara nga strukturat e Shërbimit Social Shtetëror, por u konstatua nga grupi i auditimit gjatë verifikimit të praktikave të përfituesve. Kjo tregon se mangësitë në funksionalitetin e sistemit dhe në ndërveprimin e tij me Regjistrin e Gjendjes Civile nuk janë identifikuar nëpërmjet mekanizmave ekzistues të kontrollit, duke krijuar risk për regjistrimin e të dhënave të pasakta dhe përfitime të padrejta.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 97-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
29.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të marrë masa për përmirësimin e ndërveprimit të sistemit me Regjistrin e Gjendjes Civile, duke siguruar verifikimin në kohë reale të të dhënave mbi gjendjen civile dhe bllokimin automatik të regjistrimit të aplikimeve në emër të personave që kanë ndërruar jetë si dhe të forcohen kontrollet verifikuese nga strukturat rajonale për të mos lejuar regjistrimin dhe trajtimin e aplikimeve me të dhëna të pasakta.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK nuk ka ushtruar kontrollin e plotë vjetor mbi Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave për skemën biopsikosociale, në kundërshtim me nenin 20, pika 3, shkronja "c", të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe me Kreun II "*Llojet e kontrollit*", pika 2.1, të Shtojcës nr. 2 të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*", sipas së cilës kontrolli i plotë ushtrohet çdo vit për zyrën e administrimit të procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të Shërbimit Social Shtetëror.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 159-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
30.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masat për analizimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për mosmbulimin me kontroll të aktivitetit të zyrës së administrimit të procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe të sigurojë për në vijim përfshirjen sistematike të kontrollit të plotë vjetor të kësaj strukture në programet e kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave NE & PAK.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të kontrollit periodik mjekësor në kuadër të modelit biopsikosocial u konstatua se, pavarësisht problematikave të evidentuara nga vetë Shërbimi Social Shtetëror dhe të referuara pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me realizimin e kontrolleve periodike mjekësore, nuk rezulton të jenë ndërmarrë iniciativa konkrete për analizimin e praktikës së kontrolleve periodike dhe vlerësimin, mbi baza teknike dhe mjekësore, nëse për kategori të caktuara diagnozash që nuk paraqesin potencial përmirësimi është i nevojshëm diferencimi i frekuencës së kontrollit periodik, sipas Kreut III, pika 4, të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019. Problematikat e evidentuara nga vetë Shërbimi Social Shtetëror përfshijnë vështirësitë në realizimin në kohë të ekzaminimeve të kërkuara, mungesën e fashave për shërbimet diagnostikuese, pamundësinë për kryerjen e vlerësimeve periodike në nivelin terciar, si dhe mungesën e mjekëve specialistë dhe të ekipeve multidisiplinore, veçanërisht në fushën e shëndetit mendor.
Në kushtet kur kuadri nënligjor parashikon kryerjen e kontrollit periodik mjekësor për të gjithë përfituesit, ndërkohë që vetë Shërbimi Social Shtetëror ka evidentuar kufizime objektive në realizimin e këtij procesi, mungesa e një analize të strukturuar mbi mundësinë e diferencimit të frekuencës së kontrolleve sipas natyrës dhe ecurisë së gjendjes shëndetësore kufizon mundësinë për një administrim më proporcional të skemës. Si pasojë, vijojnë të krijohen vështirësi për përfituesit në sigurimin në kohë të dokumentacionit të kërkuar, rritet risku i ndërprerjes së përfitimeve për shkaqe objektive dhe shtohet ngarkesa administrative dhe klinike për strukturat e sistemit shëndetësor, veçanërisht në nivelin terciar, duke cenuar parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore, të përcaktuara në nenin 3, pika 4 dhe 6, të Ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike*".
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 159-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
31.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Komisionimit të PAK, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me përfshirjen

e specialistëve të fushës, me qëllim analizimin e praktikës së kontrolleve periodike mjekësore dhe vlerësimin e mundësisë për diferencimin e frekuencës së tyre, në varësi të natyrës dhe ecurisë së gjendjes shëndetësore të përfituesve. Rezultatet e analizës, së bashku me propozimet përkatëse për diferencimin e frekuencës së kontrolleve periodike, t'i përcillen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me qëllim lehtësimin e procedurave për përfituesit e skemës, reduktimin e riskut të ndërprerjes së përfitimit për shkaqe që lidhen me pamundësinë për kryerjen në kohë të ekzaminimeve periodike, si dhe uljen e ngarkesës administrative dhe klinike në strukturat e shërbimit shëndetësor, veçanërisht në nivelin terciar.

Brenda vitit 2026

32. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të administruara nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në Shërbimin Social Shtetëror rezultoi se në KSHVAK QSH nr. 10, Tiranë, funksioni i mjekut është ushtruar nga një punonjës me profesion teknik imazherie dhe jo nga një mjek. Gjithashtu, rezultoi se për periudha të caktuara kohore disa komisione kanë funksionuar pa praninë e mjekut në përbërje (KSHVAK Dibër për periudhën 04.03.2025–15.07.2025 dhe KSHVAK Krujë për periudhën 31.12.2024–31.01.2025), në kundërshtim me Kreun III, pika 4, të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019 "*Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre*", si dhe pikën 2 të Rregullores nr. 225, datë 06.12.2019 "*Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KSHVAK-ve*". Mungesa e mjekut në përbërje cenon funksionimin e plotë të ekipit multidisiplinar dhe ndikon në cilësinë dhe efektivitetin e procesit të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 159-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

<u>32.1 Rekomandimi</u>: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social të marrë masa për garantimin e plotësimit dhe vijueshmërisë së përbërjes së Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar me staf mjek, me qëllim sigurimin e funksionimit të plotë të ekipit shumëdisiplinor dhe garantimin e cilësisë dhe besueshmërisë së procesit të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e Komisionimit të PAK nuk administron një databazë të dedikuar për monitorimin e procesit të shqyrtimit të ankesave, në të cilën të pasqyrohen për çdo ankimim data e administrimit, data e shqyrtimit dhe data e përfundimit të trajtimit të tij, duke pamundësuar monitorimin sistematik të respektimit të afatit ligjor 60-ditor për shqyrtimin e ankesave dhe duke mos siguruar gjurmën e auditimit për këtë proces, në kundërshtim me nenin 16, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror funksionojnë, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, tre Komisione të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), të organizuara si komisione ad hoc, të përbëra nga punonjës që ushtrojnë njëkohësisht funksione të tjera administrative në Drejtorinë e Përgjithshme, Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së dhe Institucionet Rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror. Sipas pikës 4 të Rregullores nr. 225, datë 06.12.2019 "*Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KSHVAK-ve*", Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave shqyrton ankesat brenda afatit 60-ditor.

Nga kampionimi i 185 praktikave të shqyrtuara për evidentimin e qëndrimeve të KSHA-së në raport me KSHVAK, përgjatë vitit 2025 rezultoi se 57 raste (rreth 30%) janë trajtuar në tejkalim të afatit 60-ditor. Po ashtu, për periudhat e testuara për afatet:

Për muajin mars 2025, nga 156 ankesa të administruara, 28 prej tyre janë shqyrtuar dhe trajtuar në tejkalim të afatit 60-ditor të përcaktuar në pikën 4 të Rregullores nr. 225, datë 06.12.2025.

Periudha maksimale për shqyrtimin dhe trajtimin e një ankese është 320 ditë, ndërkohë që koha mesatare e trajtimit dhe shqyrtimit të 156 ankesave të muajit mars 2025 është **54.2 ditë/ ankesë**. ***Për muajin shtator 2025***, nga 153 ankesa të administruara, 27 prej tyre janë shqyrtuar dhe trajtuar në tejkalim të afatit 60-ditor të përcaktuar në pikën 4 të Rregullores nr. 225, datë 06.12.2019. Periudha maksimale për shqyrtimin dhe trajtimin e një ankese është 177 ditë, ndërkohë që koha mesatare e trajtimit dhe shqyrtimit të 153 ankesave të muajit shtator 2025 është **47.8 ditë/ ankesë**.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 159-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
33.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Komisionimit të PAK, të marrin masat për analizimin e shkaqeve lidhur me mosrespektimin e afatit 60-ditor për trajtimin e ankesave, si dhe për përcaktimin e masave konkrete organizative dhe procedurale për reduktimin e kohës mesatare të trajtimit të ankesave dhe garantimin e respektimit të afateve të përcaktuara për shqyrtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

33.2 Rekomandimi: Drejtoria e Komisionimit të PAK të marrë masa për evidentimin dhe administrimin në mënyrë të strukturuar të të dhënave lidhur me datën e hyrjes dhe datën e shqyrtimit të çdo ankese, me qëllim garantimin e gjurmës së auditimit mbi respektimin e afateve procedurale për trajtimin e ankesave, si dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit të brendshëm mbi ofrimin në kohë të shërbimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, referuar Kreut IV, pika 5, i VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019 "*Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre*", përfituesit e aftësisë së kufizuar, të cilët vlerësohen se kanë nevojë për paketë higjieno-sanitare, përfitojnë një pagesë shtesë në të ardhura për mbulimin e këtyre shpenzimeve. Pavarësisht këtij përcaktimi, rezultoi se nuk është miratuar akti nënligjor që përcakton masën e këtij përfitimi dhe as nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë konkrete nga Shërbimi Social Shtetëror për t'i propozuar MSHMS-së miratimin e aktit përkatës, me qëllim garantimin e zbatimit të kësaj dispozite. Për rrjedhojë, gjatë periudhës 2020–2025 asnjë përfitues i skemës biopsikosociale nuk ka përfituar mbështetjen shtesë të parashikuar.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 159-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
34.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masa për hartimin dhe propozimin për miratim të akteve nënligjore ku të përcaktohen masat e përfitimit të paketës higjieno-sanitare, me qëllim garantimin e përfitimit të kësaj pakete nga personat me aftësi të kufizuar që vlerësohet se kanë të nevojshme akordimin e kësaj pakete.

Brenda vitit 2026

35. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në rastet e personave që rezultojnë të paaftë për punë, por nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitimin e pensionit të invaliditetit sipas legjislacionit të sigurimeve shoqërore, nuk është përcaktuar një procedurë e harmonizuar referimi ndërmjet skemës së pensionit të invaliditetit dhe skemës biopsikosociale të aftësisë së kufizuar. Si rezultat, personat e kësaj kategorie i nënshtrohen dy procedurave të veçanta administrative, duke u drejtuar fillimisht nëpërmjet institucioneve spitalore me shtretër për vlerësimin e aftësisë për punë nga KMCAP e ISSH-së dhe, pas mospranimit për përfitim të pensionit të invaliditetit, duhet të iniciojnë një procedurë të re aplikimi pranë KSHVAK për përfshirjen në skemën biopsikosociale.
Sipas nenit 8 të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë, ndër të tjerë, edhe personat e paaftë

për punë që nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitimin e pensionit të invaliditetit, të përcaktuara në nenin 35 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*".
Nga shqyrtimi i praktikave të administruara në KSHVAK nr. 10, Tiranë, rezultoi se mungesa e një procedure të integruar referimi ndërmjet dy skemave sjell zvarritje në trajtimin e rasteve dhe në fillimin e përfitimeve, si dhe krijon risk për mospërfshirjen në kohë në skemën biopsikosociale të personave që nuk përfitojnë pension invaliditeti për shkak të mosplotësimit të kriterit të periudhës së sigurimit. Gjithashtu, diferencat ndërmjet kritereve të vlerësimit të aftësisë për punë në skemën e sigurimeve shoqërore dhe kritereve të vlerësimit funksional të modelit biopsikosocial evidentojnë nevojën për harmonizimin e kuadrit rregullator dhe përcaktimin e një procedure të unifikuar referimi ndërmjet dy skemave.
Veprimet e mësipërme reflektojnë cënim të parimeve të organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore, të përcaktuara në nenin 3, pika 4-7, të Ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", duke ndikuar në aksesin në kohë dhe në mënyrë efektive të personave me aftësi të kufizuar në skemat e mbrojtjes sociale të destinuara për këtë kategori përfituesish.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 159-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
35.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim hartimin e propozimeve konkrete drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për të krijuar një sistem referimi që të mundësojë procedurë të lehtësuar dhe të reduktojë zgjatjen e procedurave administrative për të përfituar nga skema e aftësisë së kufizuar për personat e paaftë për punë që nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës.

Brenda vitit 2026

35.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për analizimin e situatës dhe propozimet e nevojshme për të garantuar përfshirjen në skemën e aftësisë së kufizuar të Shërbimit Social Shtetëror të personave të paaftë për punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.

Brenda vitit 2026

36. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Shërbimi Social Shtetëror vijon të zbatojë Urdhrin nr. 577, datë 14.10.2020 "Për një ndryshim dhe shtesë në Urdhrin nr. 266/1, datë 01.09.2020, për marrjen e masave të veçanta nga komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", i cili është miratuar në kushtet e masave të jashtëzakonshme për menaxhimin e pandemisë COVID-19 dhe parashikon mosparaqitjen fizike të personave pranë komisioneve të vlerësimit, duke realizuar komisionimin nëpërmjet platformave online ose vetëm mbi bazën e dokumentacionit në dosje.
Ndërkohë, Kreu II, pika 1.1, i VKM-së nr. 182/2020 përcakton se personi që vlerësohet për herë të parë për aftësi të kufizuar paraqitet personalisht para KMCAP-së së nivelit të parë, ndërsa pika 1.2 përcakton se rivlerësimi kryhet pa praninë fizike të personit. Nga auditimi rezultoi se, pavarësisht se situata epidemiologjike nuk është më aktuale, akti vijon të zbatohet nga Shërbimi Social Shtetëror, pa rezultuar të jetë rishikuar ose shfuqizuar.
Vijimi i zbatimit të një akti të nxjerrë për rrethana të jashtëzakonshme, pa një rivlerësim të nevojës dhe përshtatshmërisë së tij me kushtet aktuale, krijon mospërputhje ndërmjet kuadrit rregullator të përgjithshëm dhe praktikës së ndjekur nga administrata, duke ndikuar në njëtrajtshmërinë e procedurave të vlerësimit dhe duke krijuar pasiguri juridike në zbatimin e procesit të komisionimit të personave me aftësi të kufizuar.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 159-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

36.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Komisionimit të PAK-ut, të marrë masa për rikthimin e komisionimit me paraqitje fizike për personat që i nënshtrohen për herë të parë vlerësimit nga KMCAP-të e nivelit të parë, duke ndërprerë vijimin e zbatimit të Urdhrit nr. 577, datë 14.10.2020 , të nxjerrë si masë e përkohshme në kuadër të administrimit të pandemisë COVID-19. Paralelisht, të ngrihet një grup pune për të vlerësuar efektivitetin e modelit aktual të komisionimit me dhe pa paraqitje fizike, duke analizuar indikatorë si aksesueshmëria e procedurës për aplikantët, rastet e dërguara për divergjencë për shkak të pamundësisë së vlerësimit vetëm mbi bazën e dokumentacionit, kohëzgjatjen e procesit të komisionimit dhe cilësinë e vendimmarrjes. Në përfundim të vlerësimit, të hartohen konkluzionet përkatëse dhe, sipas rastit, t'i drejtohen MSHMS-së propozimet përkatëse.

Brenda vitit 2026

37. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në VKM-në nr. 257, datë 05.05.2021 "*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale*" nuk janë përcaktuar procedura apo aktivitete kontrolli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit në veprimtarinë e Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) të nivelit të parë dhe KMCAP-ve eprore, për paratetraplegjinë dhe verbërinë. Si rrjedhojë, Shërbimi Social Shtetëror nuk ka aplikuar asnjë mekanizëm kontrolli mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon veprimtarinë e këtyre komisioneve.
Kjo situatë është në kundërshtim me nenin 20, pika 3, shkronja "c", të Ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit Shërbimi Social Shtetëror kontrollon dhe monitoron veprimtarinë dhe zbatimin e legjislacionit të asistencës sociale. Gjithashtu, mungesa e mekanizmave të kontrollit bie ndesh me nenin 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, dhe pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të cilat kërkojnë vendosjen e aktiviteteve të kontrollit për menaxhimin e risqeve dhe sigurimin e përputhshmërisë së veprimtarisë me kuadrin ligjor në fuqi.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 159-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
37.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Komisionimit të PAK-ut dhe Drejtorinë e Kontrollit të Pagesave NE & PAK, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një kuadri të strukturuar kontrolli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale në veprimtarinë e KMCAP-ve të Shërbimit Social Shtetëror, duke përcaktuar objektin e kontrollit, procedurat e verifikimit, kërkesat minimale të dokumentimit dhe mënyrën e raportimit të rezultateve të kontrollit, me qëllim garantimin e funksionimit të një hallke efektive monitorimi mbi zbatimin e procedurave administrative dhe kritereve mjekësore të përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi.

Brenda vitit 2026

38. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së KMCAP-ve në Shërbimin Social Shtetëror u konstatua se:
1. Lidhur me veprimtarinë e KMCAP-ve të nivelit të parë u konstatua se Shërbimi Social Shtetëror nuk administron një databazë të strukturuar ku të pasqyrohen për çdo aplikim data e hyrjes dhe data e vendimmarrjes, me qëllim monitorimin sistematik të respektimit të afateve të përcaktuara për komisionim dhe garantimin e gjurmës së auditimit mbi ofrimin në kohë të shërbimit, në kundërshtim me nenin 16, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.
Për realizimin e testimeve nga grupi i auditimit, të dhënat janë nxjerrë manualisht nga regjistrat e protokollit dhe vendimet përkatëse, nga ku rezultoi se, ndërkohë që në KMCAP-të e nivelit të parë për paratetraplegjinë rastet e trajtuara në tejkalim të afatit 30-ditor paraqiten të kufizuara

(1 rast nga 200 aplikime në muajin mars 2025 dhe 2 raste nga 189 aplikime në muajin tetor 2025), në KMCAP-të e nivelit të parë për verbërinë u konstatuan tejkalime të konsiderueshme të këtij afati. Konkretisht, për rikomisionimet e muajit shtator 2025, 220 nga 269 raste (rreth 84%) janë trajtuar në tejkalim të afatit 30-ditor, ndërsa për aplikimet për herë të parë në të njëjtin muaj, 130 nga 159 raste (rreth 86%) janë trajtuar me vonesë, me një kohë mesatare trajtimi rreth 40–44 ditë dhe me raste të veçanta deri në 97 ditë nga data e aplikimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun II/I, pika 5, gërma ë, të VKM-së nr. 182, datë 26.02.2020 "*Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal*", i ndryshuar.

2. Nga auditimi i veprimtarisë së KMCAP-ve eprorë u konstatua se kuadri rregullator në fuqi ka përcaktuar që seancat e KMCAP epror duhet të zhvillohen brenda një muaji nga data e paraqitjes së dokumentacionit. Nga verifikimet e kryera rezultoi se Shërbimi Social Shtetëror nuk administron një databazë të strukturuar ku të pasqyrohen për çdo rast data e hyrjes së aplikimit dhe data e vendimmarrjes, duke mos mundësuar monitorimin sistematik të respektimit të afateve procedurale dhe duke mos garantuar gjurmën e auditimit mbi aktivitetin e KMCAP-ve eprorë, në kundërshtim me nenin 16, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.

Bazuar në të dhënat e nxjerra manualisht nga regjistrat përkatës, u konstatua se një pjesë shumë e konsiderueshme e rasteve janë trajtuar në tejkalim të afatit 30-ditor. Konkretisht, për muajt mars–prill 2025, nga 35 ankimime për paratetraplegjinë, 29 raste (rreth 90%) janë trajtuar me vonesë, ndërsa nga 77 raste të dërguara për divergjencë, 75 raste janë trajtuar jashtë afatit, me një kohë mesatare trajtimi rreth 90–100 ditë dhe raste të veçanta deri në 253 ditë. Po ashtu, për muajin janar 2025, nga 76 ankimime për verbërinë, 67 raste (rreth 92%) janë trajtuar me vonesë, ndërsa nga 98 raste të dërguara për divergjencë, 97 raste janë trajtuar në tejkalim të afatit, me një kohë mesatare trajtimi rreth 126 ditë dhe raste të veçanta deri në 329 ditë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun V, pika 3, të VKM-së nr. 182, datë 26.02.2020 "*Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal*", i ndryshuar.

Situatat e mësipërme paraqesin mosfunksionim normal të veprimtarisë së strukturave të KMCAP-ve të nivelit të parë dhe eprorë, duke ndikuar në mosrespektimin e afateve procedurale për trajtimin e rasteve, zgjatjen e proceseve të vlerësimit dhe ankimimit, si dhe në cenimin e ofrimit në kohë të shërbimit ndaj përfituesve. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 159-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

38.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Komisionimit të PAK, të marrin masa për analizimin e shkaqeve lidhur me tejkalimin e afateve procedurale për trajtimin e aplikimeve, ankimimeve dhe rasteve me divergjencë nga KMCAP-të e nivelit të parë dhe KMCAP-të eprore, si dhe për përcaktimin e masave konkrete organizative dhe procedurale për reduktimin e kohës mesatare të trajtimit të tyre dhe garantimin e respektimit të afateve të përcaktuara për komisionim dhe shqyrtim.

Menjëherë dhe në vijimësi

38.2 Rekomandimi: Drejtoria e Komisionimit të PAK të marrë masa për evidentimin dhe administrimin në mënyrë të strukturuar të të dhënave lidhur me datën e hyrjes së aplikimit dhe datën e vendimmarrjes për çdo rast të trajtuar nga KMCAP-të e nivelit të parë dhe eprore, me qëllim garantimin e gjurmës së auditimit mbi respektimin e afateve procedurale të komisionimit dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit të brendshëm mbi ofrimin në kohë të shërbimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

39. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga 29 institucione të përkujdesit shoqëror në varësi të SHSSH-së dhe bashkëvarësi ndërmjet SHSSH-së dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, 17 prej tyre janë të licencuara, ndërsa 12 IPSH nuk janë të licencuara, në kundërshtim me nenin 27, pika 1, të Ligjit nr. 121/2016 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. IPSH-të që nuk disponojnë licencën përkatëse janë: Shtëpia e Fëmijëve 16-18 vjeç Shkodër, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë "Zyber Hallulli" Tiranë, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Sarandë, Qendra Kombëtare e Trajtimit të Emergjencave Tiranë, Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës, Qendra e Zhvillimit PAK Tiranë, Qendra e Zhvillimit PAK Shkodër, Shtëpia e Foshnjës Vlorë, Qendra Polivalente Poliçan, Qendra Komunitare e Moshës së Tretë Palasë, Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastër, Shtëpia e të Moshuarve Kavajë. Nga dokumentacioni i administruar gjatë auditimit nuk rezultoi që kjo problematikë të jetë evidentuar dhe ndjekur në mënyrë sistematike nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror në kuadër të funksioneve të saj të monitorimit të zbatimit të legjislacionit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
Ushtrimi i veprimtarisë nga institucione të përkujdesit shoqëror pa licencën përkatëse cenon efektivitetin e funksionit monitorues dhe mbikëqyrës të vetë institucionit për garantimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke krijuar një standard të ndryshëm zbatimi ndërmjet institucioneve në varësi të tij dhe ofruesve të tjerë publikë apo jopublikë të shërbimeve sociale, të cilët i nënshtrohen detyrimit ligjor për licencim.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 174-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
39.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe drejtuesit e IPSH-ve përkatëse, të marrin masat për ndjekjen e procedurave ligjore për të siguruar licencimin e institucioneve të përkujdesit shoqëror, sipas kategorive përkatëse për shërbimet që ofrojnë.

Menjëherë

40. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, pavarësisht përcaktimit të nenit 52, pika 1, të Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e ligjit të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale duhet t'u transferoheshin njësive të vetëqeverisjes vendore, procesi i transferimit nuk është përfunduar ende. Edhe pse kanë kaluar rreth 10 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit, një pjesë e institucioneve rezidenciale të përkujdesit shoqëror vijojnë të jenë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, konkretisht institucionet që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Bashkive Tiranë, Shkodër dhe Kamëz, në kundërshtim me dispozitën e sipërcituar. Mosrealizimi i procesit të transferimit brenda afatit ligjor ka penguar zbatimin e plotë të modelit të decentralizimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror të parashikuar nga ligji, duke ruajtur një organizim institucional që nuk përputhet me ndarjen e kompetencave të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 174-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
40.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të marrin masa për incentivimin dhe ndjekjen në mënyrë aktive të procesit të transferimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror në njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse, me qëllim përmbylljen e procesit të decentralizimit të ofrimit të shërbimeve dhe garantimin e ushtrimit të përgjegjësive nga strukturat vendore.

Brenda vitit 2026

41. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Shërbimi Social Shtetëror nuk disponon një metodologji të miratuar për ushtrimin e funksionit të monitorimit të zbatimit të standardeve kombëtare të shërbimeve të kujdesit shoqëror, pavarësisht se Kreu II, pika 3.3, shkronja "dh",

i VKM-së nr. 135, datë 07.03.2018 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror" përcakton se monitorimi duhet të realizohet në përputhje me një metodologji të miratuar. Në kuadër të auditimit, Shërbimi Social Shtetëror vuri në dispozicion dokumentin "Metodologji e Monitorimit të Shërbimeve Shoqërore – Version Përfundimtar – 29.02.2024", të hartuar me asistencën teknike të UNDP-së. Megjithatë, nga auditimi rezultoi se kjo metodologji nuk është miratuar as nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe as nga Shërbimi Social Shtetëror, duke mos prodhuar efekte juridike dhe duke mos përmbushur kërkesat e përcaktuara në VKM-në nr. 135, datë 07.03.2018.
Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se gjatë periudhës 2020–2025 monitorimet e kryera nga Drejtoria e Shërbimit Social pranë Shërbimit Social Shtetëror janë planifikuar dhe realizuar vetëm për institucionet e përkujdesit shoqëror në varësi dhe bashkëvarësi të Shërbimit Social Shtetëror. Nuk rezultoi të jetë planifikuar apo realizuar asnjë monitorim ndaj ofruesve të tjerë të shërbimeve të kujdesit shoqëror që financohen pjesërisht ose tërësisht nga buxheti i qeverisjes qendrore, në kundërshtim me Kreun II, pika 3.3, shkronja "dh", të VKM-së nr. 135, datë 07.03.2018.
Si rrjedhojë, funksioni monitorues i Shërbimit Social Shtetëror nuk ushtrohet në mënyrë të plotë dhe të njëtrajtshme për të gjithë ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror që financohen nga buxheti i shtetit, duke kufizuar efektivitetin e mbikëqyrjes mbi zbatimin e standardeve kombëtare dhe të legjislacionit në këtë fushë.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 174-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
41.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për vlerësimin, rishikimin dhe miratimin e Metodologjisë së monitorimit të shërbimeve sociale të hartuar me asistencën teknike të UNDP, ose për hartimin dhe miratimin e një metodologjie të re, për të garantuar kryerjen e monitorimeve nga Shërbimi Social Shtetëror bazuar në një metodologji të konsoliduar.

Brenda vitit 2026

41.2 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale të marrë masa për planifikimin dhe realizimin e monitorimeve përtej IPSH-ve në varësi/ bashkëvarësi të SHSSH-së, duke përfshirë institucione të përkujdesit shoqëror që financohen plotësisht ose pjesërisht nga buxheti i qeverisjes qendrore.

Në vijimësi

42. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitucionalizimit, miratuar me VKM nr. 706, datë 09.09.2020, në Shtëpinë e Fëmijës Vlorë dhe Shtëpinë e Fëmijës Korçë është aplikuar moratoriumi për pranimin e rasteve të reja me synim transformimin e tyre nga institucione rezidenciale në qendra me bazë komunitare për mbështetjen e fëmijës dhe familjes. Si rezultat, në Shtëpinë e Fëmijës Vlorë nuk ka më fëmijë rezidentë që prej vitit 2024, ndërsa në Shtëpinë e Fëmijës Korçë që prej muajit mars 2025.
Pavarësisht se në dokumentet strategjike procesi i transformimit konsiderohet i finalizuar, nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2025 është realizuar vetëm ndryshimi i emërtimit të institucioneve nga "Shtëpia e Fëmijës" në "Qendra e Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes", ndërsa nuk rezulton të jenë ndërmarrë ndryshimet organizative dhe funksionale të nevojshme për funksionimin e modelit të ri të shërbimeve. Rregulloret e brendshme të funksionimit nuk janë përditësuar, nuk janë përcaktuar shërbimet që do të ofrohen në kuadër të modelit të ri, si dhe nuk janë miratuar përshkrime pune dhe akte të tjera rregullative që të përcaktojnë qartë funksionet, përgjegjësitë dhe mënyrën e organizimit të veprimtarisë. Për pasojë, megjithëse institucionet nuk kanë më përfitues rezidentë, ato vijojnë të funksionojnë me të njëjtën strukturë organizative dhe me personel të financuar nga buxheti i shtetit, pa u përcaktuar në aktet e brendshme shërbimet që duhet të ofrohen dhe mënyra e organizimit të tyre, duke bërë që modeli i ri i shërbimeve komunitare të mos funksionalizohet në praktikë.

Kjo situatë nuk është në përputhje me nenin 8, pika 3, të Ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", sipas të cilit veprimtaria e njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve drejtohet dhe bashkërendohet nga institucioni përkatës i varësisë, si dhe me nenin 20 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.
Mosmiratimi i rregulloreve të funksionimit dhe përshkrimeve të punës nuk përbën vetëm mungesë dokumentacioni administrativ, por pasqyron mosfunksionalizimin e mjedisit të kontrollit të nevojshëm për operimin e modelit të ri të shërbimeve komunitare. Në kushtet kur gjatë vitit 2025 ka filluar zbatimi i moratoriumit edhe në dy institucione të tjera rezidenciale për fëmijë, mosadresimi në kohë i këtyre problematikave krijon risk për përsëritjen e të njëjtit model transformimi formal edhe në institucionet e tjera, duke cenuar parimin e qartësisë në përcaktimin e përgjegjësive dhe parimin e ekonomisë, eficiencës dhe efektivitetit në organizimin e administratës shtetërore të përcaktuar në nenin 3, pika 5 dhe 6, të Ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", me pasojë përdorimin joefektiv të burimeve njerëzore dhe financiare të financuara nga buxheti i shtetit, si dhe mosfunksionalizimin e shërbimeve komunitare për mbështetjen e fëmijës dhe familjes, të cilat përbëjnë objektivin kryesor të procesit të deinstitucionalizimit.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 174-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
42.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve tip për t'u përdorur nga Qendrat e Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes, për të garantuar funksionalitetin e tyre të plotë organizativ dhe operacional të tyre, në përputhje me objektivat politike dhe strategjike të procesit të deinstitucionalizimit, duke minimizuar riskun e vijimit të transformimeve vetëm në nivel formal, pa funksionalizim efektiv të modelit të ri të shërbimeve me bazë komunitare dhe pa përdorim efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare të financuara nga buxheti i shtetit.

Brenda vitit 2026

43. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se kriteret për përfitimin e shërbimit në strehëzat për të moshuarit, të përcaktuara në nenin 58 të VKM-së nr. 518, datë 04.09.2018 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar*", nuk reflektojnë në mënyrë të plotë gjendjen reale social-ekonomike të personave në nevojë për shërbime rezidenciale.
Konkretisht, kriteri që parashikon si kusht mospasjen e një llogarie bankare për përfitimin e shërbimit në strehëza, pa asnjë përcaktim mbi gjendjen apo llojin e llogarisë, rezulton të jetë i natyrës përjashtuese dhe jo proporcional me qëllimin e shërbimit social, pasi disponimi i një llogarie bankare nuk përbën tregues të drejtpërdrejtë të gjendjes ekonomike të individit. Ky përcaktim nuk është në përputhje me orientimin e kuadrit ligjor në fuqi për nxitjen e përfshirjes financiare të kategorive në nevojë dhe krijon kufizime të pajustifikuara për aksesin në shërbime rezidenciale të kujdesit shoqëror.
Gjithashtu, në këtë dispozitë përcaktohet se shërbimi në strehëza ofrohet nëse (i) përfituesit kanë mbushur moshën për pension dhe (ii) të moshuarit përfitojnë pension social ose pension minimal. Sipas këtij përcaktimi, duke mbajtur në vëmendje se pensioni social akordohet pas moshës 70 vjeç, sipas përcaktimit në nenin 5/1 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*", përjashtohen nga mundësia e përfitimit të shërbimit në strehëza të moshuarit që kanë mbushur moshën për pension, por nuk plotësojnë kushtet për të përfituar pension nga sigurimet shoqërore dhe nuk kanë mbushur moshën 70 vjeç për të përfituar pensionin social, pavarësisht se mund të jenë në kushte të tilla që duhet të institucionalizohen në institucione të tilla rezidenciale për shkak të kushteve të jetesës.

Kriteret e mësipërme nuk përcaktojnë gjendjen social-ekonomike të personave dhe rrjedhimisht pamundësojnë përfitimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, pavarësisht nëse këta individë (i) nuk kanë mjetet minimale të jetesës, (ii) nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe (iii) janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale, sipas përcaktimeve në nenin 5, pika 1, të Ligjit nr. 121/2016 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 174-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
43.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masa për hartimin e propozimeve konkrete lidhur me rishikimin e nenit 58 të VKM-së nr. 518, datë 04.09.2018, sa i përket kritereve për përfitimin e shërbimit në strehëzat për të moshuarit, me qëllim përcaktimin e fokusit te gjendja reale social-ekonomike e personave në nevojë për shërbime rezidenciale.

Menjëherë

44. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se funksionimi aktual i Qendrave të Zhvillimit publike nuk është në përputhje me grupin e synuar të përfituesve të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, pasi një pjesë dominuese e rezidentëve rezulton të jetë mbi moshën 21 vjeç. Konkretisht, nga 217 rezidentë në 6 Qendra Zhvillimi publike në nivel kombëtar, 152 rezidentë (rreth 70%) janë mbi moshën 21 vjeç, në kundërshtim me nenin 16, pika 1, të Ligjit nr. 121/2016 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
Në disa qendra kjo përqindje është veçanërisht e lartë, konkretisht në Qendrën e Zhvillimit Korçë 41 nga 42 rezidentë (rreth 98%), në Qendrën e Zhvillimit Shkodër 38 nga 43 rezidentë (rreth 88%), në Qendrën e Zhvillimit Berat 26 nga 30 rezidentë (rreth 87%) dhe në Qendrën e Zhvillimit Vlorë 24 nga 29 rezidentë (rreth 83%) janë mbi moshën e përcaktuar nga ligji.
Në këto kushte, funksionimi aktual i këtyre qendrave nuk është në përputhje me qëllimin dhe grupin e synuar të përfituesve të përcaktuar në nenin 16, pika 1, të Ligjit nr. 121/2016. Mbajtja e kapaciteteve të zëna nga persona mbi moshën 21 vjeç kufizon mundësinë e pranimit të fëmijëve dhe të rinjve që janë përfituesit e drejtpërdrejtë të synuar të këtij shërbimi, duke rritur riskun e vonesës së ndërhyrjeve zhvillimore dhe rehabilituese në fazat më të rëndësishme të zhvillimit.
Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se, nëpërmjet shkresës nr. 3931 prot., datë 06.04.2023, drejtuar MSHMS-së, Shërbimi Social Shtetëror ka propozuar krijimin e një Qendre Polivalente për personat me aftësi të kufizuar mbi moshën 21 vjeç. Pavarësisht këtij propozimi shumë të hershëm, ende nuk është ofruar ky shërbim, duke bërë që problematika e evidentuar të vijojë.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 174-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
44.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrë masat për krijimin e kushteve për ngritjen dhe funksionalizimin e një strukture të dedikuar për ofrimin e shërbimeve rezidenciale dhe shërbimeve të integruara shëndetësore e sociale për personat me aftësi të kufizuar mbi moshën 21 vjeç, me qëllim krijimin e alternativave të përshtatshme të shërbimit për këtë kategori, lirimin gradual të kapaciteteve në Qendrat e Zhvillimit për grupmoshën e synuar sipas përcaktimit ligjor dhe rikthimin e funksionimit të këtyre strukturave në përputhje me objektin dhe qëllimin e tyre ligjor.

Brenda vitit 2026

45. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik në SHSSH u konstatua në mënyrë të vazhdueshme se dosjet e procedurave të prokurimit janë të painventarizuara dhe të paarkivuara, në kundërshtim me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, duke përbërë risk për dëmtimin apo

humbjen e dokumentacionit me ndërrimin e stafit të angazhuar në procedurat e prokurimit publik. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 186-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

45.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masat për ngritjen e një grupi pune për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit publik, si dhe për vendosjen dhe zbatimin e praktikave administrative për inventarizimin dhe arkivimin e rregullt të dokumentacionit për procedurat e ardhshme të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

46. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit "Blerje të Vogla" të zhvilluara në periudhën 2020-2025 u konstatua se:

-Për procedurën e prokurimit me objekt "Mobilimi i zyrave të KMCAP Rajonal" zhvilluar në vitin 2020, Procesverbali për Përllogaritjen e Fondit Limit nuk ka të bashkëlidhur ofertat mbi të cilat është bazuar llogaritja e këtij fondi. Gjithashtu në dy procedurat për "Blerje pajisje elektroshtëpiake" kryer në vitin 2023, procesverbali i testimit të tregut rezulton i paplotë pasi nuk pasqyrohet qartë metodologjia e ndjekur për testimin e tregut, por vetëm vlera e fondit limit. Për procedurën "Blerje Kancelarie" zhvilluar në vitin 2021 në dosjen e prokurimit mungon Procesverbali i Përllogaritjes së Fondit Limit. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr.285 datë 19.05.2021 *"Për Miratimin e Rregullave Të Prokurimit Publik"* i ndryshuar Neni 13, pika 4.

-Dosjet e prokurimit nuk janë administruar në mënyrë të plotë, duke paraqitur mungesa dokumentacioni. Konkretisht evidentohen mungesa të Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim, Procesverbalit të Argumentimit të Specifikimeve Teknike, Procesverbalit të Shpalljes së Fituesit, në disa raste mungon dhe Urdhri i Prokurimit, Ftesa për Ofertë. Gjithashtu rezulton se procedurat e prokurimit të shtuara në vitin 2025, të cilat nuk ndodhen në Regjistrin e Parashikimit, nuk janë shoqëruar me dokumentacionin përkatës që justifikon kryerjen e tyre. Sa më sipër bie në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.

-Për dy procedurat me vlerë të vogël "Blerje pajisje elektroshtëpiake" të vitit 2023 dhe "Blerje pajisje elektroshtëpiake për institucionet" në vitin 2025, nuk është kryer identifikimi i saktë dhe i individualizuar i pajisjeve të blera nga Autoriteti Kontraktor dhe nuk është përcaktuar në cilat institucione do të dorëzohen këto elektroshtëpiake. Procesverbali i marrjes në dorëzim nuk përmban të dhëna identifikuese për secilën pajisje (si p.sh. numër serie, kod unik identifikimi apo barcode), elementë të cilët përbëjnë praktikë standarde për pajisjet elektroshtëpiake dhe mundësojnë gjurmueshmërinë e tyre në inventar. Gjithashtu, në rast të shfaqjes së defekteve ose problematikave teknike gjatë periudhës së garancisë, mungesa e identifikimit të individualizuar të pajisjeve mund të krijojë vështirësi në procesin e zëvendësimit të tyre, si dhe në përcaktimin e përgjegjësisë kontraktore të operatorit ekonomik fitues. Kjo bie në kundërshtim me pikën 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar dhe me Ligjin nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 21, pika 2.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 186-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

46.1 Rekomandimi: Komisioni i Përllogaritjes së Fondit Limit të marrë masat për hartimin dhe administrimin e plotë të Procesverbalit të Përllogaritjes së Fondit Limit duke siguruar që të dokumentohet dhe të bashkëlidhen të gjitha ofertat ose referencat e përdorura për përllogaritjen, të përshkruhet qartë metodologjia e testimit të tregut në mënyrë që ky proces të jetë transparent dhe i verifikueshëm. Njësia e Prokurimit të marrë masat e nevojshme për administrimin e plotë dhe sistematik të dokumentacionit të çdo procedure prokurimi dhe pasqyrimin e çdo faze të procedurës nga planifikimi deri në zbatimin e kontratës.

Në vijimësi

46.2 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit dhe Komisioni për Marrjen në Dorëzim të Mallrave të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e praktikave të administrimit dhe evidencës së aktiveve të përfituara nga procedurat e prokurimit. Të kryhet identifikimi i plotë për çdo pajisjeje të blerë, përmes regjistrimit të elementeve identifikues, përcaktimi i qartë i vendndodhjes së pajisjeve të dorëzuara dhe plotësimi i Procesverbaleve të marrjes në dorëzim me të dhëna të detajuara që mundësojnë gjurmueshmërinë dhe administrimin korrekt të aktiveve.

Në vijimësi

47. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Zyrës Rajonale Durrës" rezulton se në pikën 2.7 të DST kërkohet "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion OE" dhe ndër të tjera listohet kërkesa "Kamionçinë deri në 5 Ton". Nga ky përcaktim nuk është e qartë nëse bëhet fjalë për masën maksimale të autorizuar të kamionçinës apo kapacitetin mbajtës të mjetit. Kjo mund të krijojë paqartësi tek OE të cilët duan të marrin pjesë në këtë procedurë dhe rrjedhimisht mund të shërbejë si pengesë për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kjo bie në kundërshtim me Ligji 162/2020 "Për Prokurimet Publike" i ndryshuar, neni 36 pika 2. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 186-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

47.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit në Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për hartimin më të qartë dhe të saktë të kërkesave në DST, duke specifikuar në mënyrë të detajuar kriteret teknike që kërkohen nga Operatorët Ekonomikë, duke synuar që formulimi i kritereve të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe jo kufizues në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja sa më e gjerë dhe të shmangen paqartësitë ose keqinterpretimet.

Në vijimësi

48. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, lidhur me përbërjen e strukturave pjesë të prokurimit publik u konstatua se:

1. Në procedurat e prokurimit publik me objekt (i) "Projekt-preventiv për rikonstruksion të Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli" Tiranë", me fond limit 2,083,333 lekë pa TVSH dhe (ii) "Rikonstruksioni i Zyrës Rajonale Durrës", me fond limit 2,166,000 lekë pa TVSH, në Komisionet e Vlerësimit të Ofertave janë përfshirë Nëpunësit Zbatues të institucionit, të cilët nuk duhet të ishin përfshirë në hallkat e menaxhimit operacional përgjatë procesit të prokurimit, pasi bie ndesh dhe pamundëson realizimin e detyrave të nëpunësit zbatues, sipas nenit 12, pika 3, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, ku përcaktohet ndër të tjera se Nëpunësit Zbatues përgjigjen përpara Nëpunësit Autorizues për garantimin para miratimit të shkresave/ urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

2. Në procedurën e prokurimit me objekt "Projekt-preventiv për rikonstruksion të Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli" Tiranë", me fond limit 2,083,333 lekë pa TVSH, grupi i punës i ngritur për marrjen në dorëzim të projekt preventivit nuk ka në përbërje specialist fushe, në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011. Në oponencën teknike të kryer nga Instituti i Ndërtimit janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe të marrë në dorëzim, të cilat nuk ishin konstatuar nga grupi i marrjes në dorëzim.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 186-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

48.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për:

- plotësimin e komisioneve specifike përgjatë procedurës së prokurimit me specialistë të fushës, kur objekti i procedurës së prokurimit kërkon njohuri teknike nga fusha të caktuara.

- mospërfshirjen e Nëpunësit Zbatues në hallkat e menaxhimit operacional përgjatë procedurave të prokurimit.

Në vijimësi

49. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Rikonstruksioni i Zyrës Rajonale Durrës", grupi i auditimit konstaton se operatori ekonomik *Z K. është skualifikuar nga KVO pasi nuk ka dërguar certifikatën për transport mallrash brenda vendit, licencën e shoqërisë për transport dhe faturën për blerjen e një "Motogjeneratori". Ky Operator Ekonomik ka nënshkruar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit i cili mjafton si provë paraprake për këto pika, deri në fazën e dorëzimit të dokumentave fizike, ndaj skualifikimi nuk është kryer mbështetur në bazë ligjore. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" neni 82 dhe VKM nr.285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 186-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

49.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror në rolin e Autoritetit Kontraktor të konsiderojnë si provë paraprake në përputhje me legjislacionin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe verifikimi i dokumentacionit të kryhet përpara se të japë kontratën, me dorëzimin e dokumentave fizike, sipas procedurave përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

50. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt "Blerje për pajisje të ndryshme për institucionet në varësi të SHSSH", për vitin 2025, në vlerë 3,240,000 lekë pa TVSH u konstatua se:

Titullari i AK nuk ka miratuar urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, llojin, cilësinë, plotësinë dhe të dokumentacionit shoqërues, sipas përcaktimit në pikën 42 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", por e ka deleguar te njësitë e varësisë këtë proces. Pika 41 e këtij Udhëzimi përcakton se, në raste të caktuara sipas nevojave të njësisë publike, bëhet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi te përdoruesi (p.sh direkt në njësinë shpenzuese të njësisë publike) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (p.sh në magazinën qendrore të njësisë publike). Në këtë rast, artikujt e furnizuar nuk kanë kaluar nga magazina qendrore e SHSSH-së, por direkt në magazinat e njësive shpenzuese.

Në procesverbalet e paraqitur, të mbajtur nga grupet e punës të IPSH-ve përkatëse, janë pasqyruar të dhëna me sasinë e artikujve dhe specifikimet teknike, por nuk është dokumentuar asnjë verifikim i kryer lidhur me përputhshmërinë e artikujve me ofertën e paraqitur nga OE (skeda teknike dhe formularët), lidhur me firmat prodhuese dhe origjinën e mallrave të furnizuar, në mospërputhje me nenin 124, pika 1, të LPP-së dhe pikën 8 të Rekomandimit të APP-së nr. 2118 prot., datë 04.03.2024.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 186-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

50.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, të cilat, në çdo rast, të kryejnë dhe dokumentojnë verifikimin e sasisë, cilësisë dhe përputhshmërisë së mallrave me specifikimet teknike, kontratën dhe ofertën e pranuar, si dhe evidentimin e tyre në fletë-hyrje magazine, edhe në rastet kur artikujt synohet të kalohen te institucionet e varësisë.

Në vijimësi

51. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i kryer rezultoi se, ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Universitetit Politeknik të Tiranës janë nënshkruar kontratat (i) nr. 210/2 prot., datë 21.01.2025, e amenduar me kontratën nr. 210/4 prot., datë 04.03.2025, me objekt "*Aktekspertizë e thelluar për godinën e Shtëpisë së Fëmijëve Zyber Hallulli*", me vlerë

2,484,000 lekë me TVSH dhe (ii) nr. 3131/1 prot., datë 16.04.2025 me objekt "*Projekti i përforcimit për godinën e Shtëpisë së Fëmijëve Zyber Hallulli*", me vlerë 720,000 lekë me TVSH.
Të dyja angazhimet e sipërcituara kontraktore me UPT-në janë ndërmarrë përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndara, në vlerën totale prej 3,204,000 lekë, duke përbërë angazhime jashtë fondeve të parashikuara, në kundërshtim me nenin 50 dhe 51 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*".
Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror ka informuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mbi pamjaftueshmërinë e fondeve për likuidimin e angazhimeve të ndërmarra kontraktore, duke kërkuar njëkohësisht akordimin e fondeve shtesë në shumën prej 3,204,000 lekë për realizimin e pagesave përkatëse, kërkesë për të cilën, nga dokumentacioni i administruar gjatë auditimit, nuk rezulton të jetë kthyer përgjigje.
Këto detyrime në vlerën totale prej 3,204,000 lekë nuk janë shlyer ende nga ana e Shërbimit Social Shtetëror për shkak të mungesës së fondeve të disponueshme, pavarësisht faturimit nga ana e UPT-së nëpërmjet faturave elektronike (i) nr. 62/2025, datë 07.03.2025 dhe (ii) nr. 118/2025, datë 30.04.2025, duke përbërë risk edhe për aplikimin e penaliteteve nga UPT-ja sipas përcaktimit në nenin 2, pika 2.3 dhe 2.4, të secilës prej kontratave të sipërcituara.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 186-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
51.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të marrin masa për sigurimin e fondeve të nevojshme për likuidimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe për forcimin e mekanizmave të planifikimit dhe kontrollit financiar me qëllim shmangien e ndërmarrjes së angazhimeve kontraktore përtej kufirit të fondeve buxhetore të miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

52. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i rasteve të aplikimeve të individëve/ familjeve pa mbaruar afati 6-mujor i penalitetit dhe shqyrtimi i pretendimeve të SHSSH, rezultoi se përjashtimi nga skema nuk ka ardhur vetëm si pasojë e mosplotësimit të kushteve ligjore nga aplikantët, por dhe si rezultat i gabimeve të kryera nga administratorët shoqërorë gjatë administrimit të aplikimeve dhe përpunimit të të dhënave. Konkretisht:
-Në qarkun Fier, 2 observacione të ardhura, të dyja përjashtuar për këtë arsye;
-Në qarkun Lezhë 2 raste nga 9 raste të observuara;
-Në qarkun Shkodër, 2 raste nga 8 të observuara;
-Në qarkun Tiranë 1 rast nga 6 raste të observuara;
-Në qarkun Elbasan 2 raste nga 6 raste të observuara
-Në qarkun Korçë 2 raste nga 7 raste të observuara
Përjashtime të tilla nga skema e ndihmës ekonomike evidentojnë mangësi në administrimin e aplikimeve dhe në funksionimin e mekanizmave të kontrollit, duke sjellë penalizimin e individëve dhe familjeve për shkaqe që nuk lidhen me sjelljen apo përmbushjen e detyrimeve të tyre, por me gabime të administratës. Si pasojë, këta individë/familje humbasin të drejtën e përfitimit të ndihmës ekonomike deri në momentin e riaplikimit ose korrigjimit të situatës, duke u cenuar përkohësisht e drejta për të përfituar mbështetjen sociale.
Pavarësisht se gabimet janë kryer nga administratorët shoqërorë dhe strukturat e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, përgjegjësia për funksionimin efektiv të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes i takon Shërbimit Social Shtetëror, i cili, në përputhje me Kreun II, pika 3.1, të VKM-së nr. 135, datë 07.03.2018, "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror", ushtron funksionin e kontrollit mbi zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, merr pjesë në procesin e vendimmarrjes për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe

ofron mbështetje metodologjike e monitorim për njësitë e qeverisjes vendore në administrimin e kësaj skeme. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 97-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
52.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të marrë masat për forcimin e monitorimit dhe kontrollit të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe për unifikimin e praktikave administrative nëpërmjet udhëzimeve dhe trajnimeve të vazhdueshme, me qëllim reduktimin e gabimeve që sjellin përjashtimin e padrejtë të individëve dhe familjeve nga skema e ndihmës ekonomike.

Në vijimësi

53. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i rasteve të aplikimeve të individëve/familjeve që kanë riaplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike pa përfunduar afati 6-mujor i penalitetit, si dhe nga shqyrtimi i praktikave të ndjekura nga Shërbimi Social Shtetëror, rezultoi se nuk ekziston një metodologji e qartë, e standardizuar dhe e dokumentuar që të rregullojë procesin, nga momenti i identifikimit të një rasti si "deklarim i rremë" ose "fshehje informacioni", deri në trajtimin e kërkesave për riaplikim dhe rifutje në skemën e ndihmës ekonomike përpara përfundimit të afatit të penalizimit. Gjithashtu, u konstatua se termi "deklarim i rremë" interpretohet dhe zbatohet në mënyra të ndryshme në raste të ngjashme, pa disponuar një përkufizim të qartë dhe kritere të unifikuara në aktet e brendshme rregullatore të Shërbimit Social Shtetëror. Si rrjedhojë, raste me karakteristika të ngjashme trajtohen në mënyrë të ndryshme, duke krijuar mungesë të njëtrajtshmërisë në vendimmarrje.
Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, në raste të caktuara, është lejuar riaplikimi ose rifutja në skemën e ndihmës ekonomike përpara përfundimit të afatit 6-mujor të penalizimit nëpërmjet komunikimeve elektronike (e-mail), pa një procedurë të formalizuar, pa një akt administrativ të dokumentuar dhe pa lënë gjurmë të plota në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike. Kjo praktikë nuk parashikohet në legjislacionin që rregullon skemën e ndihmës ekonomike dhe nuk garanton transparencën, gjurmueshmërinë, dokumentimin e procesit dhe trajtimin e barabartë të aplikantëve, në kundërshtim me Kreun II të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike, si dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i cili përcakton procedurat dhe kriteret e administrimit të skemës së ndihmës ekonomike mbi bazën e rregullave të dokumentuara dhe zbatimit të njëtrajtshëm të tyre. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 97-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
53.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të Pagesave për NE & PAK, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një dokumenti të brendshëm metodologjik, në të cilin të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe të unifikuar rastet që konsiderohen "deklarim i rremë" dhe "fshehje informacioni", si dhe mënyra e dokumentimit dhe trajtimit të tyre nga të gjitha strukturat përgjegjëse, me qëllim garantimin e një zbatimi të njëtrajtshëm të legjislacionit, shmangien e interpretimeve të ndryshme për raste me karakteristika të ngjashme, si dhe rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së procesit të vendimmarrjes.

Brenda vitit 2026

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vendimet gjyqësore për çështje të lidhura me marrëdhëniet e punës, gjatë periudhës së auditimit 2020 – 2025, kanë sjellë për Shërbimin Social Shtetëror një efekt negativ financiar prej **8,108,258 lekë**. Aktualisht, Shërbimi Social Shtetëror ka në proces gjykimi (pa marrë ende vendim të formës së prerë) 14 çështje për

ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, 8 prej të cilave janë iniciuar gjatë përgjatë periudhës së auditimit 2020 – 2025, ndërsa 6 çështje i përkasin periudhave më të hershme. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masat për analizimin e shkaqeve që kanë sjellë efektin negativ financiar prej **8,108,258 lekë**, forcimin e mekanizmave të kontrollit për zbatimin me përpikmëri të dispozitave të Kodit të Punës dhe Kontratave individuale me punëmarrësit, si dhe dokumentimin e plotë të proceseve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për të garantuar pozita më të favorshme në procese gjyqësore dhe reduktim të kostove që rrjedhin nga vendime gjyqësore për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetja nga auditimi: Nga verifikimi i praktikave të përfitimeve të përzgjedhura nga grupi i auditimit për periudhën objekt auditimi, mbi bazën e një kampioni prej 100 aplikimesh të paraqitura pas refuzimit për deklarim të rremë ose fshehje informacioni, rezultoi se në 81 raste aplikimet janë pranuar dhe trajtuar përpara përfundimit të afatit 6-mujor të përcaktuar në pikën 1, shkronja "ç", të nenit 15 të ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, aplikantët e konstatuar me deklarim të rremë ose fshehje informacioni kanë të drejtë të riaplikojnë vetëm pas kalimit të një periudhe 6-mujore nga data e refuzimit të aplikimit. Konkretisht, u konstatuan:

- Qarku Dibër: 20 raste me vlerë totale 661,474 lekë;
- Qarku Durrës: 9 raste me vlerë totale 168,206 lekë;
- Qarku Elbasan 14 raste me vlerë totale 953,674 lekë;
- Qarku Fier 5 raste me vlerë totale 192,083 lekë;
- Qarku Berat: 2 raste me vlerë totale 16,952 lekë;
- Qarku Kukës: 9 raste me vlerë totale 560,505 lekë;
- Qarku Korçë: 6 raste me vlerë totale 329,719 lekë
- Qarku Lezhë: 6 raste me vlerë totale 199,813 lekë;
- Qarku Shkodër: 11 raste me vlerë totale 190,726 lekë;
- Qarku Tiranë: 14 raste me vlerë totale 345,636 lekë;
- Qarku Vlorë: 3 raste me vlerë totale 77,152 lekë.

Në total, u evidentuan 81 raste me përfitim në kundërshtim me dispozitat e pikës 1, shkronja "ç", të nenit 15 të ligjit nr. 57/2019, me një efekt negativ financiar në vlerën **3,695,940 lekë**, në mënyrë analitikë, të paraqitura në tabelën nr. A.4.1 të aneksit nr. IV. Gjithashtu, në asnjë nga rastet e verifikuara nuk janë pasqyruar në sistem arsyet që kanë çuar në pranimin e aplikimeve përpara përfundimit të afatit 6-mujor të penalizimit dhe nuk është ngarkuar dokumentacion mbështetës që të mundësojë gjurmueshmërinë e procesit vendimmarrës dhe verifikimin e bazueshmërisë së këtij trajtimi. Pavarësisht shpjegimeve të dhëna nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH se aplikimet janë pranuar për shkak të gjendjes së vështirë social-ekonomike të aplikantëve, mungesa e dokumentimit në sistem nuk lejon verifikimin e këtyre rrethanave dhe të ligjshmërisë së vendimmarrjes. Për rrjedhojë, mosrespektimi i afatit ligjor të penalizimit ka sjellë trajtim jo të njëtrajtshëm të aplikantëve, ka cenuar parimin e barazisë përpara ligjit, ka rritur riskun e përfitimeve të padrejta dhe ka ulur besueshmërinë në administrimin e skemës së ndihmës ekonomike.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 97-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror të marrë masat për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi të Kufizuar, për të analizuar shkaqet dhe përgjegjësitë që kanë çuar në lejimin e riaplikimit të individëve/familjeve përpara përfundimit të afatit 6-mujor të penalizimit, si dhe mungesën e dokumentimit të verifikimeve të kryera nga Drejtoritë

Rajonale të SHSSH-së. Në përfundim të analizës, nëse konstatohen paqartësi ose boshllëqe në kuadrin rregullator apo metodologjik, të vlerësojë nevojën për përmirësimin e tij, duke parashikuar, sipas rastit: (i) kriteret dhe rastet në të cilat mund të lejohet rishqyrtimi i një aplikimi përpara përfundimit të afatit 6-mujor të penalizimit, nëse kjo rezulton e nevojshme nga analiza dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi; (ii) procedurën e unifikuar që duhet të ndiqet nga strukturat përgjegjëse për shqyrtimin dhe vendimmarrjen në këto raste; (iii) kërkesat minimale për dokumentimin, gjurmueshmërinë dhe evidencimin e verifikimeve të kryera nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së dhe strukturat përgjegjëse.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, nëpërmjet strukturave verifikuese dhe vendimmarrëse, të marrin masa për respektimin e kritereve ligjore për pranimin dhe rishqyrtimin e aplikimeve, me qëllim parandalimin e përfitimeve të padrejta dhe garantimin e trajtimit të njëjtë aplikantëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetja nga auditimi: Nga verifikimi i aplikimeve të mëparshme të refuzuara nga sistemi apo nga verifikuesit e drejtorive rajonale të Shërbimi Social Shtetëror, rezultuan mangësi në procesin e verifikimit, pasi në disa raste deklarimet e rreme të evidentuara nga verifikimet automatike të sistemit nuk janë marrë në konsideratë, që prej shfaqjes për herë të parë në sistem, nga strukturat përkatëse, në kundërshtim me pikën 4, germat "a" dhe "b", të nenit 20 të Ligjit nr. 57/2019 "*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Konkretisht janë evidentuar 10 raste, me periudhë përfitimi të padrejtë në total 139 muaj dhe në vlerë **1,663,742 lekë**, të paraqitura në mënyrë analitike sipas qarqeve në tabelën nr. A.4.2 të aneksit nr. IV, situatë e ardhur si pasojë e dobësive në kontrollet verifikuese dhe mosreagimit në kohë ndaj sinjalizimeve të sistemit, duke sjellë përfitime të padrejta nga fondet publike, shtrembërim të të dhënave mbi përfituesit dhe ulje të besueshmërisë në administrimin e skemës së asistencës sociale. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 97-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE & PAK, për të analizuar shkaqet dhe personat përgjegjës për moskryerjen e verifikimeve të nevojshme për të dhënat e rezultuara nga verifikimi automatik në sistem jo në përputhje me deklarimet e individëve përfitues të ndihmës ekonomike.

Menjëherë

3.2 Rekomandimi: Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, nëpërmjet strukturave verifikuese dhe vendimmarrëse, të marrin masa për shqyrtimin dhe trajtimin e menjëhershëm të rasteve të evidentuara nga sistemi që në fazën e parë të verifikimit, si dhe të dokumentojë në sistem verifikimet e kryera, me qëllim parandalimin e përfitimeve të padrejta dhe garantimin e saktësisë në vendimmarrje.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, gërmat b, c dhe ç, të Ligjit nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror të marrin masa për vlerësimin e problematikave të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe caktimin e masave disiplinore të nevojshme, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*" dhe kontratat individuale të punonjësve, sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT